UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË

CIKLI: PHD

TEMA E DOKTORATURËS

“ TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE SI PASOJË E NDIKIMIT TË PROCESEVE TË MIGRACIONIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË GJATË PERIUDHËS 2005-2015 ”

Kandidati:

Ma.Sc. Ersin SULEJMANI

Mentori:

Prof. Dr. Ismail ZEJNELI

Tetovë, 2020

Mirënjohje

Për realizimin e punimit të Doktoraturës përveç shëndetit, është më se e nevojshme koha, mbështetja, udhëzimi dhe përkrahje financiare.Andaj në këtë rast mirënjohja dhe falenderimi i takon Zotit, familjes time të ngushtë në veçanti prindërve, bashkëshortes vajzës time, për përkrahjen dhe mbështetjen e pafund që kanë treguar gjatë periudhës së përpunimit të tezës pa kursyer asgjë.

Falenderim dhe mirënjohje padyshim takon edhe stafit të fakultetit juridik, Dekanit Pr.Dr.Adnan Jasharit dhe profesorëve të tjerë sidomos profesorët të cilët kanë qenë prezent në prezentimin e parë dhe të dytë të punimit dhe me këshillat e tyre si në teori ashtu edhe në praktik kanë dhënë kontribut të madh.

Udhërrëfyesi i cili në çdo moment dhe kohë ka qenë në disponim pa kursyer asgjë dhe pa të cilin ky punim nuk do të ishte i këtij niveli me këshillat, sugjerimet dhe propozimet të ofruara nga zemra i falenderohem dhe jam mirënjohës deri në fund për kontributin e palodhshëm të tij, Mentorin e punimit të Doktoraturës Pr.Dr. Ismail Zejneli.

Punimin e Doktoraturës nga zemra i dedikoj vajzës time ***Zejnep Sulejmani****-it*

Me respekt,
Ersin Sulejmani

PJESA E PARË

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME MBI DUKURINË E MIGRACIONIT

KAPITULLI I
HISTORIKU, ZHVILLIMI, TEORITË DHE PROBLEMATIKA TERMINOLOGJIKE MBI DUKURINË E PROCESEVE TË MIGRACIONIT

1. Historiku dhe zhvillimi i proceseve të migracionit
   1.1. Historiku dhe zhvillimi i proceseve të migracionit në botë
   1.2. Historiku dhe zhvillimi i proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë
2. Disa teori mbi dukurinë e proceseve të migracionit
   2.1. Teoria e Ligjeve të Ravenstein-it
   2.2. Teoria e Modelit shtytës-tërheqës
   2.3. Teoria e Oportunitetit Ndërhyrës
   2.4. Teoria Neo-klasike ose Ekonomike
      2.4.1. Teoria Neo-klasike mikro-ekonomike
      2.4.2. Teoria Neo-klasike makro-ekonomike
   2.5. Teoria e rrjeteve të emigrantëve dhe Ekonomia e re e migrimit
   2.6. Teoria e Sistemit transnacional (botëror) dhe Modeli i Globalizmit
   2.7. Teoria e Kapitalit social të migracionit
3. Përkufizimi i migracionit dhe disa kuptime mbi problematikën terminologjike për dukurinë e migracionit
   3.1. Përkufizimi i migracionit
   3.2. Disa kuptime mbi problematikën terminologjike për dukurinë e migracionit

KAPITULLI II
ETIOLOGJIA, FENOMENOLOGJIA DHE DISA KARAKTERISTIKA TJERA TË MIGRACIONIT

1. Etiologjia e proceseve të migracionit
   1.1. Faktorë shtytës në vendin e origjinës
      1.1.1. Socio-ekonomik
      1.1.2. Papunësia dhe varfëria
      1.1.3. Konfliktet politike
      1.1.4. Konfliktet kulturore dhe fetare
      1.1.5. Luftërat dhe siguria e njerëzve
      1.1.6. Arsimimi dhe migracioni i "trurit"
      1.1.7. Familja dhe problemet familjare
   1.2. Faktorë tërheqës në vendin e destinacionit (pritës)
      1.2.1. Mundësitë e punësimit, pagat e larta dhe kushtet e mira të punës
      1.2.2. Arsimimi dhe kushtet e saj
      1.2.3. Bashkim Familjar
      1.2.4. Globalizmi
      1.2.5. Informacioni përmes mjeteve të komunikimit publik-masmedia dhe inkurajimi dhe përshtypjet pozitive të migrantëve ndaj familjarëve në vendin e origjinës

2. Fenomenologjia (llojet) e migracionit
   2.1. Sipas kriterit të territorit dhe të kufijve shtetëror
      2.1.1. Migracioni i brendshëm
         2.1.1.1. Migracioni i brendshëm urban-urban
         2.1.1.2. Migracioni i brendshëm urban-rural
         2.1.1.3. Migracioni i brendshëm rural-rural
         2.1.1.4. Migracioni i brendshëm rural-urban
      2.1.2. Migracioni ndërkombëtar
         2.1.2.1. Migracioni i rregullt
         2.1.2.2. Migracioni i parregullt
   2.2. Sipas kriterit të numrit të personave
      2.2.1. Individual
      2.2.2. Grupor
   2.3. Sipas kriterit kohor
      2.3.1. Përkohshëm
      2.3.2. Përhershëm
   2.4. Sipas kriterit të cilësis së migrantëve
      2.4.1. Punëtor i thjesht pa kualifikim
      2.4.2. Intelktual
   2.5. Sipas kriterit individual të dëshirës së migrantëve
      2.5.1. Vullnetar
      2.5.2. Detyruar
   2.6. Sipas kriterit të territorit ku gjindet migranti
      2.6.1. Migracion në territorin origjinë
      2.6.2. Migracion në territorin tranzit
      2.6.3. Migracion në territorin e destinacionit
3. Subjektet gjatë proceseve të migracionit
   3.1. Shteti si subjekt
   3.2. Migranti si subjekt
4. Pasojat dhe efektet e proceseve të migracionit në shtetin e origjinës
   4.1. Pasojat dhe efektet demografike
   4.2. Pasojat dhe efektet ekonomike

KAPITULLI III
NDIKIMI I PROCESEVE TË MIGRACIONIT SI DUKURI SOCIALE NË KRYERJEN E DISA VEPRAVE PENALE, ME THEKS TË VEÇANTË NË TRAFIKIMIN ME QENIE NJERËZORE

1. Migracioni dhe Krimi i organizuar
2. Migracioni dhe Kontrabanda me migrantë
3. Migracioni dhe Trafikimi me qenie njerëzore

PJESA E DYTË

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE SI PJESË E KRIMIT TË ORGANIZUAR

KAPITULLI I
HISTORIKU DHE PËRKUFIZIMI I TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE SI PJESË E KRIMIT TË ORGANIZUAR

1. Historiku i shkurtër mbi lindjen dhe zhvillimin e trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar
   1.1. Historiku dhe zhvillimi i krimit të organizuar
   1.2. Historiku dhe zhvillimi i trafikimit me qenie njerëzore
2. Kuptimi dhe përkufizimi trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar sipas akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit të Republikës së Maqedonisë
   2.1. Kuptimi dhe përkufizimi i krimit të organizuar sipas akteve ndërkombëtare
   2.2. Kuptimi dhe përkufizimi i krimit të organizuar sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë
   2.3. Kuptimi dhe përkufizimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas akteve ndërkombëtare
   2.4. Kuptimi dhe përkufizimi i veprës penale trafikimi me qenie njerëzore sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë
3. Dallimi në mes të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe veprave tjera penale
   3.1. Dallimi midis veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrantë
   3.2. Dallimi midis viktimave të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit ose përfitimit nga shërbimi seksual të ofruar nga viktimat e trafikimit

KAPITULLI II
ETIOLOGJIA DHE FENOMENOLOGJIA E VEPRËS PENALE TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE

1. Etiologjia (Faktorët dheShkaqet) që ndikojnë në trafikimin me qenie njerëzore
   1.1. Faktorët shtytës të trafikimit me qenie njerëzore
      1.1.1. Faktorët ekonomiko-shoqëror
      1.1.2. Faktorët socio-patologjik
      1.1.3. Faktorët mikrogrupor
      1.1.4. Faktorët politik
      1.1.5. Faktori i proceseve të migracionit
      1.1.6. Faktor të tjerë
   1.2. Faktorët tërheqës (nxitës)
      1.2.1. Fitimi i lartë dhe risku i ulët
      1.2.2. Kërkesa e tregut botëror dhe liberalizimi i vizave për shetasit e Republikës së Maqedonisë
      1.2.3. Faktori i mjeteve të komunikimit publik, elektronik dhe rrjetet sociale
2. Fenomenologjia (Format dhe Llojet) dhe qëllimi trafikimit me qenie njerëzore
   2.1. Trafikimi i femrave me qëllim të prostitucionit
   2.2. Trafikimi i femrave dhe fëmijëve me qëllim të lëmoshës

2.3. Trafikimi i personave me qëllim të kryerjes së krimeve
2.4. Trafikimi i personave me qëllim të punës të detyruar
2.5. Trafikimi i personave për qëllime tjera

KAPITULLI III
POZITA E SHTETEVE GJATE TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE DHE MËNYRA E VEPRIMIT (MODUS OPERANDI) TË KRYERËSVE TË SAJ
1. Trafikimi me qenie njerëzore dhe pozita e shteteve
1.1. Shteti origjinë
1.2. Shteti tranzitë
1.3. Shteti i destinacionit
2. Mënyra e veprimit (Modus operandi) të kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore dhe fazat e kryerjes së saj
2.1. Kuptimi i mënyrës së veprimit (Modus Operandi) të kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore
2.2. Fazat e trafikimit me qenie njerëzorë
2.2.1. Faza e rekrutimit
2.2.2. Faza e transportimit
2.2.3. Faza e transferimit
2.2.4. Faza e fshehjes dhe shfrytëzimit
2.2.5. Faza e ritrafikimit ose riciklimi i viktimave
2.3. Kompjuteri si mjet i kryerjes së trafikimit me qenie njerëzore (modus operandi)

KAPITULLI IV
AKTORËT E VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE
1. Kuptimi dhe llojet e aktorëve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore
1.1. Kuptimi i aktorëve të trafikimit me qenie njerëzore
1.2 Aktorët aktiv të trafikimit me qenie njerëzore
1.3 Aktorët pasiv të trafikimit me qenie njerëzore
2. Përkufizimi i Profilit të kryerësve dhe të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore
3. Profili i trafikantëve ose kryerësve të trafikimit me qenie njerëzor
3.1. Vëllimi dhe dinamika e tratikantëve
3.2. Nacionaliteti i trafikantëve
3.3. Gjinia e trafikantëve
3.4. Mosha e trafikantëve
3.5. Niveli i arsimimit të trafikantëve
3.6. Territori (vendbanimi) i trafikantëve
3.7. Statusi social i trafikantëve
3.8. Gjendja martesore të trafikantëve
3.9. Veçoritë kohore dhe sezonale aktiviteteve të trafikantëve
3.10. Recidivizmi (rikthimi) i trafikantëve
4. Profili i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore trafikuara
4.1. Vëllimi dhe dinamika e viktimave të trafikuara
4.2. Nacionaliteti i viktimave të trafikuara
4.3. Gjinia e viktimave të trafikuara
4.4. Mosha e viktimave të trafikuara

4.5. Niveli i arsimimit të viktimave të trafikuara
4.6. Vendbanimi dhe shpërndarrja territoriale e viktimave të trafikuara
4.7. Statusi social i viktimave të trafikuara
4.8. Gjendja martesore e viktimave të trafikuara
4.9. Veçoritë kohore dhe sezonale viktimizimit të viktimave të trafikuara
5. Profili organizativ i grupeve për trafikim me qenie njerëzore
5.1. Organizata kriminale të nivelit të ulët
5.2. Organizata kriminale të nivelit të mesëm
5.3. Organizata kriminale të nivelit të lartë (kriminaliteti i jakës së bardhë)
5.4. Organizata kriminale transnacionale
6. Sktruktura dhe veçoritë e organizatave kriminale për trafikim me qenie njerëzore

KAPITULLI V
IDENTIFIKIMI, MBROJTJA DHE NDIHMA NDAJ VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE
1. Identifikimi i viktimave të trafikuara
1.1. Kuptimi dhe Rëndësia
1.2. Fazat dhe rregullat e identifikimit
1.3. Mjetet dhe teknikat e identifikimit
2. Mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të trafikuara
2.1. Mbrojtja dhe ndihma viktimave për ndihmë të parë, strehim dhe ushqim
2.2. Mbrojtja dhe ndihma viktimave dhe anëtarëve të familjes për siguri fizike nga kërcënimet
2.3. Mbrojtja dhe ndihma juridike pa pagesë viktimave të trafikimit
2.4. Mbrojtja dhe ndihma viktimave në organet shtetërore
2.5. Mbrojtja dhe ndihma viktimave nga dhuna në familje
2.6. Mbrojtja dhe ndihma në integrimin e viktimave të trafikimit
2.7. Mbrojtja dhe ndihma viktimave të trafikimit për kompensim dhe dëmshpërblim të dëmit
2.8. Mbrojtja dhe ndihma viktimave sipas parimit të mosdënimit

PJESA E TRETË

MASAT PËR LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE DHE ASPEKTI KRAHASIMOR NË DISA SHTETE

KAPITULLI I
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE DHE SANKSIONIMI I SAJ SIPAS AKTEVE NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
1. Trafikimi me qenie njerëzore si figurë e veprës penale dhe masat që parashihen sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë
2. Masat që parashihen dhe aplikohen sipas akteve ndërkombëtare
3. Masat tjera që parashihen dhe aplikohen në Republikën e Maqedonisë
3.1. Parimet kryesore të parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore

KAPITULLI II

MASAT PREVENTIVE TË LUFTIMIT DHE PARANDALIMIT TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

1. Masat preventive të institucioneve shtetërore

1.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional në vend, rajonal dhe ndërkombëtar

1.2. Bashkëpunimi dhe koordinimi mes institucioneve shtetërore dhe institucioneve lokale dhe organizatave joqeveritare

2. Masat preventive të institucioneve joshtetërore

2.1.Përkrahja e aktiviteteve të organizatave joqeveritare kundër trafikimit me qenie njerëzore

2.2.Ngritja e vetëdijes dhe reagimi i shoqërisë ndaj trafikimit me qenie njerëzore

KAPITULLI III

TRAJTIMI JURIDIKO-PENAL I VEPRËS PENAËE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE NË DISA SHTETE

1. Trajtimi juridiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës
2. Trajtimi jurudiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Shqipërisë
3. Trajtimi jurudiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës
4. Trajtimi jurudiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Turqisë

HYRJE

Trafikimi i qenieve njerëzore që nga kohërat e lashta të historisë së njerëzimit vazhdon të jetë prezent në çdo shoqëri edhe në shekullin XXI duke i atakuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, dinjitetin, integritetin duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e e njerëzve. Sot, trafikimi për nga mënyra e kryerjes së saj ka marë forma dhe mënyra më të sotisfikuara të cilët e vështirësojnë parandalimin dhe luftimin e saj. Me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë janë të zhvilluar edhe mjetet, mënyrat dhe format e realizimit të kësaj vepre penale të rrezikshme e cila e vështirëson zbulimin e veprave penale, kryerësve dhe viktimave të tyre duke përdorur kompjuterin dhe programet e saj për kryerje prej destinacioneve të largëta gjë që ka ndikuar në rritjen e numrit të errët dhe të përhimtë të kësaj vepre penale. Trafikimi me qenie njerëzore si forma më e shpeshtë dhe më e rrezikshme e krimit të organizuar sot përveç se i atakon dhe i viktimizon çdo profil të popullatës, pa marrë parasysh moshën, gjininë, vendbanimin, viteve të fundit është në rritje viktimizimi i migrantëve të cilët llogariten edhe si kategori e rrezikuar dhe e cenuar e popullatës duke u bazuar në procesin e migrimit të tyre në distanca të gjata territoriale. Kjo vepër penale si një fenomen global që shqetëson të gjitha shtetet për dallim se shteti konkret se a është në pozitën e saj si shtet i origjinës, tranzitit apo të destinacionit, por ajo paraqet shqetësim për të gjithë dhe në një farë mënyre në çdo pozitë shtetërore në mënyra dhe forma të ndryshme popullata e rrezikuar është si pikësynim me qëllim të përfitim financiar nga shfrytëzimi i tyre. Për shkak të aspektit heterogjen të kësaj dukurie është bërë një studim si nacionale ashtu edhe ndërkombëtar duke i krahasuar disa sisteme juridike në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore duke u bazuar në aktet nacionale të shteteve konkrete dhe akteve ndërkombëtare të rregullimit jurudiko penal.

Trafikimi i qenieve njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015 është përfshirë aspekti i studimit kriminologjik dhe juridiko-penal si dhe aspekti social dhe ekonomik të kryerësve dhe viktimave të cilët i përdorin për qëllime të ndryshme të shfrytëzimit sidomos me qëllim të shfrytëzimit seksual, lëmoshës, kryerjen e krimeve, punës së detyruar, heqjen e organeve dhe për qëllime tjera. Përmes analizës së detajuar në bazë të metodave të përdorura do të vijmë në konkluzione të ndryshme në lidhje me shkaqet e paraqitjes të kësaj vepre penale, ndikimi dhe devijimi migracionit në kontrabandë me migrantë dhe në trafikim me njerëz, profilin e kryerësve dhe të viktimave, identifikimin e viktimave të trafikimit, masat juridiko penale të disa shteteve si: Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Turqia, bashkëpunimi ndërkombëtar rajonal dhe në vend në mes të institucioneve shtetërore dhe ato joshtetërore si dhe ngritja e vetëdijes të shoqërisë në lidhje e trafikimin dhe pasojat e viktimizimit të kësaj dukurie mjaft të rrezikshme.

Punimi ka një strukturë të përgjithshme e përbërë nga tri pjesë dhe nëntë kapituj. Pjesa e parë ka tri kapituj.

Kapitulli i parë të pjesës së parë do ti shtjellojë në përgjithësi dukurin e migracionit në aspektin historik dhe zhvillimit të saj, si në nivel botëror që kështë karakteristik për të gjitha shtetet dhe në nivel nacional e cila përmbahet në territorin e Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu vlen të theksohet edhe teoritë kryesore në të cilën bazohet dukuria e migracionit dhe e drejta e migracionit. Problematika e terminologjisë në lidhje me migracionin gjithashtu është e përfshirë sepse shpesh në litaratura të ndryshme kemi përzierje dhe mos qasje konkrete në lidhje me terminologjinë e migracionit.

Kapitulli i dytë koncentrohet në lidhje me etiologjinë dhe fenomenologjinë e çështjes së migracionit sepse pa sqarimin e shkaqeve dhe llojeve të migracionit nuk mund të vijmë në përfundimë të qarta të luftimit dhe parandalimit të pasojave negative. Në lidhje me shkaqet i kemi dalluar shkaqet që e shtyjnë njerëzit të migrojnë nga vendi i origjinës dhe në shkaqe që e tërheqin migrantët në vendin e destinacionit. Gjithashtu në kuadër të këtij kapitulli ceken edhe karakteristikat e përgjithsme si dhe pasojat dhe efektet e migracionit në jetë e përditshme. Kur flasim për pasojat dhe efektet që reflektohen duhet të cekim edhe shtetet dhe migrantët si subjekte aktivë gjatë këtyre proçeseve.
Kapitulli i tretë paraqet lidhshmërinë e dukurisë së migracionit me dukurin e krimit të organizuar përshkak se si veprimtari kryesore e shumë grupeve kriminale të krimit të organizuar e kanë kontrabandën me migrantë. Përshkak se shpesh organizatat e ndryshme kriminale e shfrytëzojnë lëvizjet legale të proceseve të migracionit për kryerjen edhe të veprave të ndryshme penale për atë arsye kemi paraqitur edhe disa vepra penale që lindin si pasojë e ndikimit të saj. Si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit me detajisht kemi paraqitur edhe veprën penale të kontrabandës me migrant e cila është domosdoshme pët të spjeguar sepse nga kjo lindën edhe vepra tjetër penale e cila është edhe si temë e disertacionit të doktoraturës pra vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore. Si dhe në pjesën e fundit të këtij kapitulli është shtjelluar edhe lidhshmëria e migracionit dhe trafikimit me qenie njerëzore ku shpesh viktimat trafikantëve si shënjestër janë edhe migrantët të cilët ikin nga vendet e tyre të origjinës për shkaqe të ndryshme.
Pjesa e dytë ka pesë kapituj.
Kapitulli i parë ka të bëjë me historikun dhe zhvillimin e veprës penale trafikimi me qenie njerëzore si dhe të krimit të organizuar e cila është edhe pjesë e saj të. Në këtë kapitull paraqitet edhe kuptimi dhe përkufizimi juridik sipas akteve ndërkombëtare që janë po të kësaj fushe si dhe dallimin mes të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të kontrabandimit me migrant e cila ka një rëndësi të veçantë. Këtu kemi edhe dallimin më detajisht të veprës penale trafikmi me qenie njerëzore nga kontrabanda me migrantë të cilët rëndë është të bëhet dallimi gjatë disa fazave të zbulimit, hetimit dhe procedurës penale. Në fund të këtij kapitulli kemi parashtruar edhe dallimin në mes të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe të ndërmjetësimit në prostitucion e cila mund të jetë vetëm një nga qëllimet e trafikantëve.
Kapitulli i dytë sqaron faktorët ose shkaqet të cilët ndikojnë dhe shprehen direkt apo indirekt si dhe llojet apo format e realizimit të trafikimit me qenie njerëzore. Këto faktorë në masë të madhe ose të vogël varësisht nga situata në terren ndikojnë në kryerjen e kësaj vepre penale të organizuar. Gjithashtu faktorët i kemi ndarë në dy grupe dhe ate në grupin e faktorëve që e shtyjnë personin të bëhet viktimë e trafikantëve dhe faktorët nxitës ato që e nxisin pesonin të bëhet viktimë e trafikantëve. Gjithashtu këtu i kemi parashtruar edhe llojet dhe qëllimet e trafikimit me qenie njerëzore.
Kapitulli i tretë harton pozitën e shteteve aktiv gjatë trafikimit me qenie njerëzore. Për të pasur pasqyrë më të qartë për kryerjen e kësaj vepre penale këtu shtjellohet edhe Modus operandi i trafikantëve ose mënyra e veprimit të tyre gjatë kryerjes së kësaj vepre penale, gjegjësisht fazat e saj: Faza e rekrutimit, faza e trafikimit, faza e transportimit, faza transferimit, faza e fshehjes dhe shfrytëzimit dhe faza e ritrafikimit. Për realizimin e kësaj vepre penale dhe dinamikën e saj në aspektin ndërkombëtar por edhe nacional rol të madh luajnë edhe shtetet siq janë shteti i origjinës, shteti tranzit dhe shteti i destinacionit përmes aktorëve që janë pjesë e trafikimit me qenie njerëzore. Viteve të fundit e cila në masë të madhe përdoret nga trafikantët për reklamat e tyre si dhe mjet mashtrimi ndaj viktimave është edhe kompjuteri si modus operandi.

Kapitulli i katërt pasqyron kuptimin e aktorëve ose të subjekteve të cilët ndahen në aktorë aktiv dhe ato pasiv. Në kuadër të kësaj detajisht parashtrohet edhe profili të aktorëve-kryerës dhe të aktorëve-viktima të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore. Vëmendje të veçantë i është kushtuar dhe profilit organizativ të grupeve për trafikimi me qenie njerëzore të cilat ndahen në grupe të nivelit të ulët. Nivelit të mesëm, nivelit të lartë dhe grupe transnacionale. Në kuadër të profileve analizohet edhe veçoritë e profileve të aktorëve pjesëmarë në këtë vepër penale
Kapitulli i pestë ka të bëjë me si dhe rëndësinë e identifikimit të viktimave të mundshëm të kësaj vepre penale e cila mund të jetë si ndikim në efikasitetitn e luftimit dhe të parandalimit të kësaj vepre penale, si dhe fazat, mjetet dhe teknikate identifikimit. Në këtë kapitull analizohet edhe mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të zbuluara të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore. Pjesa e tretë ka tre kapituj.
Kapitulli i parë pasqyron drejtën pozitive si e drejtë e aplikueshme kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe qëllimi i saj është luftimi dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar dhe ate edhe sipas akteve ndërkombëtare po ashtu edhe me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë. Këtu janë cekë edhe parimet mbi të cilat luftohet dhe parandalhoet ky lloj i veprës penale të rrezikshme.
Kapitulli i dytë ka të bëjë me luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, gjegjësisht masat preventive të institucioneve shtetërore. Në kuadër rë masave preventive shtetërore ceken bashkpunimi dhe kordinimi mes institucioneve shtetërore në vend, rajon dhe në nivel ndërkombëtar dhe në grupin tjetër mes institucioneve në vend me organizatata joqeveritare. Masat tjera preventive janë ato të institucioneve joshtetërore sidomos përkrahja e aktiviteteve të organizatave joqeveritare si dhe ngritja e vetëdijes dhe reagimin e shoqërisë ndaj kësaj dukurie shumë të rrezikshme për shoqërinë dhe nacionale qe aplikohen për luftimin dhe parandalimin e kësaj dukuri shume negative dhe vepër e cila llogaritet një ndër veprat më të rënda penale në çdo shtet poashtu edhe në Republikën e Maqedonisë.
Kapitulli i tretë koncentrohet në implementimin metodën krahasuese dhe të analizës sipas legjislacioneve të disa shteteve të rajonit cilët gjithashtu po përballohen me këtë dukuri negative. Në kuadër të krahasimit të kësaj vepre penale të rëndë sipas legjislaionit të shteteve që janë objekt studimi në këtë kapitull janë shtete të rajonit dhe një shtet e cila në aspektin e largësisë është më afër vendeve ku janë edhe vend origjine për migrantët të cilët janë edhe si grup në rrezik për trafikantët e qenieve njerëzore. Ky kapitull ka një rëndësi të veçantë përshkak se këtu mund të studjojmë legjislacione dhe përvoja të shteteve të ndryshme për luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, në rastin konret legjislacionin penal të Republikës së Turqisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Objekti: i temës së disertacionit të doktoraturës është Trafikimi me qenie njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015. Trafikimi me qenie njerzore si formë e krimit të organizuar është një vepër penale shumë e rëndë dhe një fenomen që e brengos çdo shtetë dhe që ka përmasa nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare. Me këtë temë do mundohem të kemë nje qasje shumë serioze dhe shumë dimensionale e cila do të afrohet edhe realitetit gjegjësisht luftimin më efikas të kësaj dukurie e cila është e dukshme dhe e rezikshme edhe në jetën e përditshme. Përderisa deri më tani kemi pasur studime dhe kërkime të shumta për këtë dukuri por na mungonte këndvështrimi i trafikimit me qenie njerzore e cila është si pasojë e ndikimit proceseve të migracionit (proçese të cilat janë legale). Me temën e punimit të disertacionit të doktoraturës së pari do të paraqitet studimi i migracionit (brendshëm dhe ndërkombëtar) sidomos shkaqet dhe pasojat, si dhe lidhshmëria e migracionit legal me veprën penale të trafikimit me qenie njerzore. Para lidhshmërisë së fenomenit migracionit dhe trafikim

me qenie njerzore është e detyrueshme edhe sqarimi i lidhshmerisë ose të transferimit të migracionit legal në migracion ilegal e më pas edhe në trafikim me qenie njerzore. Këto fenomene kanë një lidhshmëri dhe është e patjetërsueshme mos sqarimi i tyre para se të vijmë deri tek trafikimi me qenie njerzore.

Rëndësia e temës së punimit të disertacionit të doktoraturës është në drejtim të analizës së ndikimit të proceseve të migracionit si proces i ligjshëm me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Duke e marë parasysh pozitën gjeo-strategjike në Ballkan të vendit tonë, shtet i cili ka aspirata të qarta për anëtarësim në Unioni Evropian duke i konsoliduar të gjitha aktet juridike nacionale me legjislacionin juridik të Unionit Evropian është në përmirësim të sipër të akteve juridike në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore. Rëndësia e veçantë e temës qëndron në ate se në kuadër të konsolodimit të legjislacionit juridik me legjislacionin ndërkombëtare një ndër detyrat primare të Republikës së Maqedonisë është edhe luftimi dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerzore dhe migracionin ilegal. Republika e Maqedonisë ka pasur rol shumë të rëndësishëm gjatë migracionit transnacional në vitin 2015, vit i cili ishte edhe si provim për përballjen e shtetit me ruten e migrantëve që ikin nga luftrat e shteteve të Lindjes së Mesme si shtet tranzit dhe kapacitetet shtetrore për menaxhimin e kësaj krize të migrantëve ku dukshëm ishte reziku i madh i trafikimit me qenie njerzore ku viktimat ishin edhe migrantët e huaj. Respektimi dhe zbatueshmëria e legjislacioneve juridike dhe menaxhuese të Maqedonisë dhe ato ndërkombëtare në një mënyrë e tejkaloj krizën e lëvizjes së migrantëve nga Greqia deri në Serbi. Trafikimi me qenie njerzore gjatë historisë e deri vonë ka pasur mënyra dhe metoda të ndryshme me të cilat trafikantët e kanë kryer trafikimin e viktimave e cila varet prej kohës, vendit dhe shkaqeve të viktimës. Por sot kur globalizimi dhe migracioni është në rritje të madhe shkak i ekonomisë, luftërave të ndryshme, papunësisë, trafikimi është më i profesionalizuar dhe më i komplikuar për luftimin dhe parandalimin e saj nga organet kompetente. Kjo temë e ka rëndësinë e saj edhe në ate që do të ofroj edhe zgjedhje dhe metoda më të sotisfikuara organeve kompetente për luftimin dhe parandalimin e saj.

Qëllimi i punimit është njohja dhe shqyrtimi shumë dimensional dhe i thelluar i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore e cila është pasojë e ndikimit të migracionit të regullt si dhe faktorët, shkaqet dhe format e e saj. Gjithashtu me këtë punim për këtë vepër penale si formë e krimit të organizuar sa i takon mënyrës së veprimit (Modus Operandi) të trafikantëve të veprës penale e cila kërkon profesionalizëm dhe bashkpunim ndërkombëtar të paraqesim një pasqyrë reale se si ato funksionojnë në jetën reale, si dhe mënyra e veprimit dhe metodat që përdorin për viktimat e mundshëm të trafikimit me qenie njerzore. Ndikimi i fenomenit të globalizimit viteve të fundit ënë rritjen e lëvizjeve të migracionit qoft i brendshëm apo ndërkombëtar si dhe ndikimi i drejtëpërdrejt të tyre në aktivizimin e trafikantëve për shfrytëzimin e momentit për gjetjen e viktimave të mundshëm të trafikimit të tyre prej një vendi në një vend tjetër sidomos në shtete të zhvilluara ekonomikisht. Përmes qasjes juridiko-penale, kriminologjike, viktimologjike dhe sociale për këtë vepër penale do të ndihmohet shkencës, jurispudencës dhe institucioneve shtetrore, joshtetërore dhe organizatave ndërkombëtare të cilat e kanë si objekt kryesor këtë vepër penale në gjetjen e risive, rrugëve, zgjidhjeve të kësaj problematike si dhe në luftimin dhe parandalimin duke filluar nga masat preventive deri në masa represive. Ndihma me këtë temë të punimit të disertacionit do të jetë qoftë në aspektin e parandalimit të saj duke i përforcuar aktivitetet e shumta preventive deri në ato represive me risi, me metoda të reja dhe kordinime jo vetëm nacionale por edhe rajonale dhe ndërkombëtare me të gjitha subjekte të shtetit nacional konkret por edhe me subjekte tjera ndërkombëtare qe e kanë si detyrë primare luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerzore.

Arsyeshmëria e temës ka të bëj me ate se fenomeni, gjegjësisht vepra penale e cila është edhe objekt studimi është një dukuri e cila është e përhapët anë e mbanë botës dhe nuk ka shtet qe nuk e lufton këtë problematikë duke munduar të sigurojë mjetet dhe masat më të përshtatshme. Mjetet dhe masat nacionale të luftimit dhe parandalimit të trafikimit me qenie njerzore i aplikojnë bazë të legjislacionit të brendshëm të shtetit konkret paraprakisht legjislacioni nacional i shtetit konkret i konsoliduar me të gjitha aktet ndërkombëtare që e kanë këtë fushë si objekt studimi. Edhe Republika e Maqedonisë si shtetë i cili ende është në tranzicion në njërën anë dhe në anën tjetër aspiratat e saj të hyrjes në familjen e Unionit Evropian dhe në Nato deri në një masë e ka të konsoliduar legjislacionin e saj me legjislacioni e Unionit Evropian ku bën pjesë edhe strategjia botërore e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar.

Zbatueshmëria dhe efektet e punimit të disertacionit në praktikë do të ketë dritën pozitive të zgjedhjes së moduseve dhe metodave me të reja te luftimit dhe parandalimit të trafikimit me qenie njerzore e cila lindë edhe nga pasoja e ndikimit të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë. Në këtë punim në bazë të metodës krahasimore do të shohim edhe dallimet dhe ngjajshmëritë ose të arriturat dhe mangësitë e aplikimit të masave represive dhe preventive kundër kësaj dukurie negative në aktet juridike nacionale të Republikës së Maqedonisë në njërën anë dhe në anën tjetër aktet juridike ndërkombëtare. Duke e marë parasysh pasojat e mëdha ndaj viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, për luftimin e kësaj vepre penale parashihen akte, strategji, plane, programe dhe kordinime të përbashkëta si nacionale, po ashtu edhe regjionale dhe ndërkombëtare. Duke u bazuar në ate se me këtë vepër penale cenohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut e cila është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me aktet tjera nënligjore si dhe me akte ndërkombëtare, çdo shtetë e ka për detyrë ligjore që deri në fund të luftojë me masa represive dhe të parandalojë me masa preventive këtë fenomen.

Metodologjia e hulumtimit të temës së punimit të disertacionit ka për detyrë gjetjen e rrugëve, mënyrave, procedurave ose metodave për të realizuar qëllimin studimor.

Studimi dhe trajtimi i trafikimit me qenie njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë me një qasje serioze është e pashmangshme aplikimi i një metodologjie për shqyrtim sa më efikas për të ardhur në rezultate pozitive dhe të mirëfillta të disertacionit të doktoraturës. Në punim janë përdorur metodat standarde që praktikohen gjatë kërkimeve shkencore sidomos në shkencën e drejtësisë. Gjatë punimit të temës së disertacionit të doktoraturës janë përdorur metodat kualitative pra metodat e përgjithshme ose universale (këto metoda përbëhen nga parimet dhe praktikat cilët janë të aplikueshme nga të gjitha shkencat), duke marrë parasysh trajtimin e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas legjislacionit të brendshëm të Republikës së Maqedonisë por edhe asaj ndërkombëtarë. Metodat që janë përdor në temë janë: Metoda historike dhe e analizës teorike, metoda juridiko-komparative, metoda e hulumtimit të rasteve individuale, metoda statistikore, metoda e anketës dhe intervistës dhe metoda tjera.

Metoda historike dhe e analizës teorike: me këtë metodë do të kemi mundësinë e trajtimit të historisë së trafikimit me qenie njerëzore dhe të migracionit në përgjithësi dhe në veçanti në Republikën e Maqedonisë si nga lindja e saj dhe parashikimi historik i regullimit të tyre ligjore si nga kohërat e lashta e deri sot, nga literature të ndryshme vendore rajonale dhe ndërkombëtare.

Metoda juridiko–komparative: duke e marë parasysh karakterin ndërkombëtar dhe mënyrën e kryerjes (modus operandi) të veprës penale e cila shpesh shfaqet mes dy shteteve kjo metodë na mundësoj të shohim edhe ngjajshmëritë dhe dallimet duke krahasuar disa legjislacione penale të disa shteteve përmes të cilës luftohet kjo vepër penale e cila duhet të jetë e konsoliduar me aktet ndërkombëtare të kësaj fushe. Në rastin konkret komparacioni i sistemeve juridiko penale në lidhje

me trafikimin me qenie njerëzore u realizua ër Kosovën, Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe Turqinë në një anë dhe sistemi jonë juridiko penal për veprën e trafikimit me qenie njerëzore.
Metoda e hulumtimit të rasteve individuale: përmes kësaj metode kemi trajtuar dhe hulumtuar aktgjykime dhe aktvendime të gjykatave kompetente të Republikës së Maqedonisë në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore dhe do të shohim rastet individuale në praktikën gjyqësore, sidomos të faktorëve që kanë ndikuar drejtëpërdrejtë në kryerjen e veprës penale tek trafikanti dhe viktimizimi tek viktima. Pra, këtu janë mbledhur fakte për trafikantin dhe viktimën si dhe rregullimi juridiko penal dhe lloji i masës së shqiptuar.
Metoda statistikore: aplikimi i kësaj metode është bazuar në mbledhjen dhe analizimin e evidencave statistikore gjatë periudhës 2005-2015 të institucioneve shtetërore por edhe ato joshtetërore për migracionin dhe veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, që kanë një rëndësi të veçantë për shtetin sepse përmes këtyre analizave hartohen strategji, plane dhe programe për luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie negative.
Metoda e anketës dhe intervistës: është një ndër metodat e njohura përmes të cilës na mundësohet mbledhja direkte e të dhënave për çështjen e migracionit dhe trafikimit me qenie njerëzore, sidomos për shkaqet dhe faktorët që kanë ndikuar në paraqitjen e viktimës së veprës penale dhe të lëvizjeve të migracionit. Për mbledhjen e saktë dhe real të deklaratave dhe plotësimeve të tyre në pyetësorët paraprakisht, personave që marin pjesë ne anketë dhe intervistë kemi sqaruar se të dhënat do të shfytëzohen për punimin e temës së disertacionit të doktoraturë që të jenë më objektiv gjatë deklarimeve.

PJESA E PARË

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME MBI DUKURINË E MIGRACIONIT

KAPITULLI I

HISTORIKU, ZHVILLIMI DHE TEORITË MBI DUKURINË E PROCESEVE TË MIGRACIONIT

1. Historiku dhe zhvillimi i proceseve të migracionit

Dukuria e migracionit ekziston që nga kohërat më të lashta të historisë dhe llogaritet se është e vjetër sa vet historia e njerëzimit. Duke u bazuar në lashtësinë e migracionit, mund të thuhet se kjo dukuri është pjesë e historisë së njerëzimit, sepse njerëzit që atëherë në mënyrë individuale apo në grupe më të vogla ose më të mëdha dhe për arsye të shumta ku më së shpeshti për shkak të luftërave, pushtimeve, shtypjeve, kushteve klimatike dhe arsyeve të tjera, përherë kanë qenë të detyruar të nënshtrohen lëvizjeve dhe zhvendosjeve në vende të tjera më të sigurta dhe në vende me kushte më të mira për mbijetesë. Sot, dukuria e proceseve të migracionit është përhapur dhe present në çdo vend të botës dhe llogaritet si një dukuri dhe sfidë botërore me të cilën ballafaqohet e tërë njerëzia. Pra, viteve të fundit dukuria e migracionit është ndryshuar për nga shumë aspekte dhe llogaritet si një dukuri me përmasa universale sepse i prek të gjitha shtetet e botës, qoftë shtetet e origjinës, tranzitit ose të destinacionit dhe shtetet mundohen me rregullimin dhe menaxhimin nacional dhe ndërkombëtar të formave të reja të dukurisë së migracionit, por edhe të ketë një unifikim normativ ndërkombëtar të saj.

Disiplinat shkencore si ekonomia, sociologjia, demografia, gjeografia, historia, marrëdhëniet ndërkombëtare, shkenca politike dhe psikologjia i referohen çështjeve që lidhen me migrimin në këndvështrime të ndryshme.[1] Në këtë drejtim me rëndësi është të ceket edhe roli i shkencave juridiko-penale sidomos devijimet dhe keqpërdorimet që lidhen me migracionin siç janë: migracioni ilegale dhe i paligjshëm. Ne do të përqëndrohemi në studimin juridik të dukurisë së proceve të migracionit si një dukuri dhe e drejtë e ligjshme e njerëzve dhe në anën tjetër ndikimin e saj në paraqitjen e veprave penale sidomos të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore në aspektin juridiko-penal, kriminologjik dhe viktimologjik.

1.1. Historiku dhe zhvillimi i proceseve të migracionit në botë

Migracioni si një dukuri natyrore e lëvizjes së njerëzve prej një vendi drejt një vendi tjetër brenda kufijve shtetëror të shtetit ose jashtë saj llogaritet si faktor kryesor që ka dhënë formën demografike të botës së sotme. Njerëzit që nga kohërat e lashta primitive apo që nga fillimi i njerëzimit e deri më sot njerëzit janë në lëvizje të vazhdueshme duke i ndryshuar vendbanimet e tyre shkaqe të ndryshme. Gjatë historisë por edhe sot si shkaqe më të shpeshta paraqiten: mbijetesa, luftërat, pushtimet, fatkeqësit natyrore, tregëtia e lirë, bashkimi familjar, arsimimi dhe viteve të fundit rritet numri I shkaqeve ekonomike siç janë: punësimet, kushtet më të mira të punës, paga më të larta, barazia gjinore në punë, etj. Në fillim njerëzit për të mbijetuar kanë udhëtuar dhe ndëruar vendbanimet e tyre duke u vendosur në vende ku kushtet e jetesës kanë qenë më të volitshme. Këtu duhet të kemi parasysh edhe mendimin e ***Childe-it*** se qeniet njerëzore që nga

[1] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës" Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.9

kohërat më të hershme janë përshtatur në mjedise natyrore joreale por sipas ideve të tyre personale rreth këtyre mjediseve.[2] Vendbanime të volitshme janë llogaritur hapësirat ku toka ka qenë pjellore për të punuar dhe prodhuar gjësende ushqimore, vende ku ka pasur ujëra (lumej, liqene dhe detë) për peshkatari dhe në vende ku ka pasur edhe kafshë për gjueti. Megjithatë, pasi këto lëvizje të popullsisë në kohën primitive janë bërë atëherë kur nuk kanë ekzistuar shtete-qytetet dhe e drejta e shkruar dhe kjo nuk nënkupton migracionin në kuptimin modern-bashkëkohor e drejtë e cila tani është e rregulluar dhe garantuar me aktet juridike nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare.

Në kohërat e lashta njihet migrimi i njerëzve nga vendet që kanë pasur klimë shumë të nxeht, thatësi, mungesë të ujit dhe për arsye të gjetjes së kushteve më të mira kliamtike ata janë zhvendosur nga vendbanimet e tyre të përhershme si p.sh., zhvendosjet nga vendet e Afrikës në vende të Azisë dhe Australisë, kështu që fillojnë edhe vendosjet e para të popullatës në kontinente jo aq të banuara ose në kontinente të reja. Megjithatë, kërkimi për ushqim në periudhë kohore të shkurtër dhe ndryshimet klimatike kanë qenë nxitje kryesore për migrimet reale ekologjike.[3] Edhe sot e kësaj dite ndryshimet klimatike botërore në vendet e ndryshme të botës (si p.sh., në Francë ka shumë shtetas afrikan që kanë migruar) mbetet si faktorë të drejtëpërdrejtë të migracionit si shembull janë vendet afrikane ku shumë njerëz migrojnë në vende tjera si shkak i thatësisë dhe mungesës së ujtit, pra të kushteve të rënda klimatike. Gjatë migracionit të njerëzve në vete kanë bartur dhe kanë përhapur edhe shumë sëmundje të ndryshme ngjitëse të cilët janë përhapur lehtë dhe shpejt dhe si pasojë e mungesës së gjësendeve elemtare higjienike, mungesës së ushqimit të shëndoshë kanë rezultuar edhe me vdekje masive të njerëzve. Gjatë historisë, migracioni ka qenë vullnetar ose e detyruar, migracion i brendshëm (brenda shtetit) ose i jashtëm (jashta kufijve shtetëror), migracion në grupe të vogla individësh ose në grupe të mëdha, kurse sa i takon shkaqeve, migrimet përveç shkaqeve klimatiko-ekologjike kanë qenë edhe si shkak i dallimeve fetare, klasave, fiseve, nacionale, ekonomike, pushtimit, luftërave dhe shkaqeve tjera. Deri në shekullin e XV nuk ka pasur e drejtë e shkruar në lidhje me migracionin dhe të drejtat e migrantëve dhe refugjatëve, por, sot me Deklaratën universale mbi të drejtat e njeriut është bërë një hap drejt njohjes ndërkombëtae ku në nenin 1 ceket se: "Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Ata kanë arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të sillen ndaj njëri tjetrit me frymë vëllazërimi."[4] Deri në shekullin XV proceset e migracionit llogariten migracione të llojit para-modern. Me fjalën paramodern nënkuptojmë migrimet që nga fillimi i historisë së shkruar, gjatë periudhës antike, përmes Mesjetës deri në shekullin XV.[5]

Periudha mes shekullit XV-XVII në një anë karakterizohet me zbulime të mëdha gjeografike ku evropianët zbuluan një botë të re me burime natyrore dhe tokë pjellore, duke i kolonizuar ato dhe në anën tjetër lidhjet tregtare të realizuara kontribuan në zhvillimin dhe pasurimin e shpejtë të kolonive dhe kështu në botë fillon edhe kolonizimi dhe vendosja në vende të reja për shkak të kushteve më të mira për të mbijetuar. Evropianët, të inkurajuar nga tregëtia e pasurisë, duke tejkaluar Oqeanin e përhapin gjuhën e tyre, fenë dhe kulturën dhe në këtë mënyrë arijnë qëllimin e migrimit të popullsisë në mënyrë vullnetare. Duke ditur se populli afrikan është i përshtatshëm në klima të nxehta, fizikisht të fortë, përballues të sëmundjeve gjatë kohërave të nxehta, afrikanët kanë qenë fuqia punëtore më e lira e nevojshme për punë nëpër plantazhe të pasanikëve françez, anglez dhe spanjoll. Pra, pas shekullit të XV paralel me paraqitjen e shteteve të fuqishme kemi

[2] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.19
[3] Po aty
[4] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948, neni 1
[5] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.25

paraqitjen e migracionit modern. Në shekuullin e XV-të paraqiten shtetet e lashta moderne cilët theksojnë fuqitë e tyre në kuptimin e rritjes ekonomike, ushtarake dhe diplomatike.[6]
Edhe pse njerëzit edhe më herët kanë qenë në lëvizje dhe migrim, por këto lëvizje në shekullin e XVII-të kanë një vend të veçantë sepse në këtë periudhë kohore në shumë vende si në Evropë, Azi, Lindjen e Mesme dhe Afrikë në pah dalin edhe shtete të posaformuara ose shtetet e reja. Pra, vendet perëndimore të fuqishme me aparatin e tyre ushtarak dhe administrative si dhe me sipërmarjet e mëdha private me mbështetje të shtetit ndikoi në dy lëvizjet më të mëdha botërore dhe ate lëvizjet e grupit të parë janë 2-3 milion evropian në Botën e Re por në formën e migrantëve gjysdetyruar (punëtor me kontrat detyruese), kurse grupi i dytë i migrantëve janë skllevërit e zi në mënyrë të detyruar (afër 7,5 milion) nga Afrika perëndimore në kolonitë europiane.[7] Në këto shtete duke pas parasysh ndarjet etnike, fetare dhe politike, shumë regjime e kanë hapur rrugën e forcës për të udhëhequr dhe miliona njerëz kanë qenë të detyruar të zhvendosen nga vendet e tyre të lindjes. Pra, nga kjo rezulton edhe lindja e statusit të refugjatëve ose në kuptimin më të gjerë të migrantëve.

Pas Luftës së Parë Botërore, Evropa gati tre shekuj ka qenë e kyçyr në lëvizjet e mëdha të migracionit të cilët mund t'i radhisim në disa flukse të lëvizjeve të njerëzve:
Fluksi i parë. Ky fluks i migrantëve llogaritet si fluksi i migrantëve evropian të cilët përmes kolonizimit nga disa shtete evropiane si: Franca, Gjermania, shtetet Skandinave, Spanja, Portugalia, Britania kanë ndikuar në rritjen e emigrimit drejt vendbanimeve të reja si SHBA, Australia dhe Zelanda e Re. Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë këtij fluksi ishte shtet destinacioni ku evropianët me numër më të madh afër 8,2 milion njerëz migruan gjatë viteve 1900-1909, nga të cilët ata janë ende 82 përqind britanik dhe gjerman, por me më shumë ndikim të gjermanëve.[8] Shtetet tjera siç janë Zelanada e Re, Australia dhe Kanadaja radhiten pas SHBA-ve ku më së shumti u vendosën evropianët gjatë fluksit të parë dhe kështu shtetasit e këtyre shteteve u bënë pakicë në shtetinë amë. Pra, fluksi i parë i migrantëve fillon me krijimin e shteteve evropiane dhe mbaron me përfundimin e Luftës së parë botërore. Nga fundi i shekullit XVII deri në mes të shekullit XIX migrantët e detyruar nga Afrika dhe pasardhësit e tyre punuan si skllevër në plantazhe dhe në minierat, cilët në Botën e re e organizuan pushtuesit evropian dhe pasardhësit e tyre.[9],
Fluksi i dytë i migracionit ishte në të njëjtën periudhë kohore si fluksi i parë, por destinacioni i migrantëve-skllevërve afrikan ishin në një drejtim tjetër tani drejt Amerikës së Jugur dhe Brazilit gjatë shekullit XVII-të dhe XVIII-të, kur edhe filloj revolucionin industrial, ekonomik. Populsin e një shteti e përbëjnë shtetasit e tyre cilët kanë spektër të gjerë të drejtave dhe detyrave (ndër të cilët është edhe siguria e shtetit), andaj të huajit, persona pa shtetësi, rrefugjatët dhe azilantët janë nën regjimin e veçantë juridik të shtetit[10], gjë që është me statusin e migrantëve në vendet e destinaionit. Rritje e shpejtë e popullsisë përballë industrializimit kapitalist e çoj në migrim të fuqisë punëtore e cila deri atëherë ishte popullsi e brendshme rurale e cila ndikoj që vendet e prekura industriale të kenë rritje të shpejtë në qendra industriale dhe më pas përtej kufijve të saj, përtej oqeanit drejt Botës së re.[11]

[6] Po aty, fq.29
[7] Po aty, fq.33
[8] Po aty, fq.35
[9] Po aty, fq.41
[10] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.44
[11] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.34

Fluksi i tretë i migracionit ndërkombëtar është në periudhën e pas Luftës së Parë Botërore, sidomos pas shpërbërjes së perandorive duke i hapur dyert e krijimit të shteteve të reja në Evropë (në mes viteve 1920 deri 1940). Gjatë këtij fluksi në shumë shtete filluan lëvizjet nacionaliste dhe rregullimit më të rreptë juridik për emigrantët, rrefugjatët dhe azil kërkuesit. Kur këto shtete vendosën të krijojnë popullsi homogjene, nëpërmjet ndikimit të lëvizjes nacionaliste dhe miratimit të politikës së detyrueshme për migracion u krijuan numër të madh të azilkërkuesve. Viti 1920 ishte periudhë kohore kur në skenë dolën shkëmbimet më të mëdha të popullsisë. Gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, shtetasit e Evropës Jugore dhe Lindore si dhe shtetasit jo-evropian kanë qenë shkaktar të ndryshimit të politikave të vendeve që marrin emigrantë. Pra, kështu për herë të parë kanë filluar të dalin politika restriktive të migracionit, ku emigrantët kanë filluar të vendosen artificialisht në vendbanime të reja. Në këtë kuptim, mund të thuhet se migrimi ndërkombëtar është zhvilluar nën ndikimin e fuqive dhe politikave evropiane para Luftës së Parë Botërore dhe gjatë periudhës midis dy luftërave botërore.

Fluksin e katërt masovik të emigracionit kemi pas Luftës së Dytë Botërore në territoret e shteteve të Azisë, Lindjes së Mesme dhe Afrikës. Ndryshe nga migrimi transit, migrimi i detyruar është një nga konceptet që kanë ndodhur në literaturën e migrimit shumë kohë më parë.[12] Fluksi i katërt karakterizohet me migrime për arsye ekonomike. Pas Luftës së Dytë Botërore, duke e ndjekur politikat e zhvillimit dhe migracionit, shpesh migrimi fuqisë punëtore dhe migrimi i trurit kanë qenë prezent nga vendet më pak të zhvilluara drejt vendeve të zhvilluara. Në këtë periudhë Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë kenë vende të destinacionit për migrantët. Në vitet 1950 deri 1960 Evropa Perëndimore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Lindjes së Mesme që prodhonin naftë, filluan të importojnë fuqi punëtore të huaj me qëllim të mbulohet fuqia punëtore e cila ishte mungesë. Këto punëtor edhe pse ishin marrë për fuqi punëtore me koh të caktuar, me kalimin e kohës ato shprehin dëshirën për t'u mbetur në këto shtete sidomos në Evropë dhe Amerikë. Sipas Rystad-it proceset migratore gjatë historisë mund të klasifikohen në 4 grupe dhe ate:

1) Dera e hapur imigracioni i lirshëm dhe emigracioni ekstenziv (1860-1914),
2) Dera e mbyllur kufizimi i imigracionit dhe kontrolli i të huajve, sistem i përkohshëm, e cila është si shkak papunësisë dhe racizmit që ka kaluar në të përhershëm (1914-1945).
3) Dera e hapur imigracioni relativisht i lirshëm dhe regrutim direkt i fuqisë punëtore (1945-1974),
4) Dera e mbyllur kontrolli i rreptë i imigracionit, por u lejua vetëm ribashkimi familjar dhe pranimi i rrefugjatëve politik.[13]

Pas përfundimit të Luftës së dytë botërore ishin përafërsisht 40 milion refugjatë të kategorive të ndryshme dhe persona të zhvendosur[14] dhe me zhvillimin e industrisë dhe të ekonomisë botërore edhe proceset e migracionit në botë e ndryshuan kuptimin e tyre. Në këtë periudhë kohorë më shumë kemi migrime të popullsisë prej një vendi në një vend tjetër për shkaqe të ekonomisë së dobët dhe jo të zhvilluar në vendet e tyre duke kërkuar shtete me ekonomi më të zhvilluar me qëllim të punësimit dhe përfitimit material. Në këtë periudhë kemi edhe kategori të personave migrantë që janë të kualifikuar në profesione të ndryshme dhe intelektuale të cilët migrojnë në shtete dhe qytete të mëdhaja ku kërkohet fuqia punëtore profesionale e cila sot emërtohet edhe si migracion i "trurit". Hapat për ngritjen përsëri të ekonomisë botërore dhe zbutjen e nevojës së fuqisë punëtore në shtetet e zhvilluara si pasojë e krizës ekonomike botërore, vërehen edhe

[12] Öner, S.Gülfer-İlhamur. Öner, Aslı-Şirin. "Küreselleşme Çağında Göç". Istanbul, 2016, fq.17
[13] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.40
[14] Po aty, fq.80

themelet e migracionit ndërkombëtar. Gjatë kësaj periudhe nuk mungojnë edhe migrime të popullsis për arsye politike, sociale-ekonomike dhe lufte nga vende të ndryshme të Evropës Lindore e në shtetet e Evropës Perëndimore duke llogaritur si shtete demokratike dhe ekonomikisht të zhvilluara dhe me perspektivë. Kriza ekonomike e cila ishte pas krizës së naftës gjatë viteve 1970-1980, shtetet ishin më të prirur drejt proceseve të migracionit sidomos vendet e zhvilluara që kishin nevojë për fuqi punëtore. Kriza ekonomike dhe politike e viteve 1980 gjithashtu rriti aktivitetet kundërshtuese ndaj emigrantëve në shumë vende si shkak i paraqitjes së racizmit dhe fanatizmit ndaj të huajve duke fituan forcë të madhe në vendet evropiane, si dhe rritja e ksenofobisë ndaj shtetasve të huaj ndikoj që në shumë shtete të largohen vet migrantët por edhe i detyronin me politikat e reja ekonomike, të cilët mendonin se me largimin e migrantëve do të parandalohet papunësia dhe varfëria për shtetasit e vet. Kështu që, kjo situat e posaformuar në këto shtete ndikoj që në shumë vende, buxhetet e dedikuara për programet e imigrantëve të destinohen për ekonominë e vendit duke larguar ndihmat dhe sigurimet sociale të migrantëve. Këto vite kanë qenë vitet kur shumë emigrantët potencialë në kërkim të punësimit filluan të përdorin mënyra të paligjshme kundër politikës së dyerve të mbyllura në vendet qendrore e cila zgjati deri në vitet 1990-ta. Vitet 1990-ta, së bashku me globalizimin, janë ofruar mundësi të reja dhe të përmirësuara të komunikimit dhe transportit për emigrantët, si dhe lëvizjen ndërkufitare të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, si dhe rritjen e mundësisë për migrim.[15] . Si shembull mund të cekim periudhën e viteve 1876 dhe 1920 nga 15 milion emigrant nga Italia afër gjysma (6.8 milion) migruan në vende tjera evropiane (Francë, Gjermani, Zvicër).[16] Pra, sot siç e kuptojmë migrimet paqësore dhe vullnetare, në kohët e mëparshme ishte një përjashtim sesa një rregull.[17] Nga viti 2000, ky problem vazhdon të rritet, sidomos pas sulmeve të 11 shtatorit, dhe debatet për rritjen e sigurisë bëhet primare të shumë shteteve duke vënë mekanizma dhe kushte të rënda për migrantët. Zhvillimi dhe transformimi historik i migracionit ndërkombëtar tregon se lëvizjet e migracionit janë formësuar nga shkaqet politike dhe ekonomike ndërkombëtare të kohës. Në të njëjtën kohë, këto procese të migracionit mund të jenë të rëndësishme në formimin e politikave ndërkombëtare dhe kombëtare, të cilat mund të kenë efekte të rëndësishme në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të shtetit. Për këtë arsye, paralelisht me zhvillimin historik të migracionit, ka shumë teori të migracionit që përpiqen të shpjegojnë arsyet për lëvizjet e migracionit sidomos të migracionit ndërkombëtar. Këto teori do të sigurojnë mendime dhe ide për qasjen më efektive ndaj cilësive dhe transformimit të fenomenit të migracionit bashkohor. Studimet për përcaktimin e terminologjisë për migracion që u zhvilluan në vitet 1990-ta, kur u paraqit edhe termi i migrimit tranzit, e cila shpesh trajtohet në lidhje me migrantët e parregullt.[18]

Por, me kalimin e kohës gjatë periudhave të ndryshme kohore, migrimet e popullsisë dallohen dhe ndryshojnë si nga forma por edhe nga shkaqet e tyre. Sot, në botën bashkëkohore, lëvizjet mekanike të popullsisë në çdo rajon dhe vend të botës janë bërë një proces shumë dinamik gjeodemografik, socioekonomik, politik etj., dhe proces i pafrenueshëm i evolucionit kuantitativ dhe kualitativ të popullatës.[19]

Pra, proceset e migracionit si fenomen social paraqitet në çdo shoqëri dhe është e pandarë nga historia e njeriut, dhe sot në shoqërin bashkohore kur kemi përparim të shteteve pothuajse në

[15] Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës ”Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan ticareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede uluslararası işbirliği”. Istanbul, 2010, fq.30

[16] Mesić, Milan. “Međunarodne Migracije”, Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.66

[17] Po aty, fq.27

[18] Öner, S.Gülfer-İlhamur. Öner, Aslı-Şirin. “Küreselleşme Çağında Göç”. Istanbul, 2016, fq.17

[19] Islami, Hivzi. “Aspekti etnik i Migrimeve”. Prishtinë, 2012, fq.19

çdo sferë, migracioni veç më është pjesë e proceseve të ndryshme shoqërore, sepse ekzistojnë një sërë faktorësh dhe shkaqe të ndikojnë në proceset e migracionit cilët mund ti grupojmë në dy grupe: a) *faktorët negative* (në shtetin e origjinës): ka të bëjë me shtetin e origjinës së migrantit ku ka mangësi në këto fusha: luftërat, kushte të rënda klimatike, shërbimet e dobëta mjekësore, nuk ekziston liria fetare, politike, sociale dhe kulturore, ekonomia e dobët, papunësia, varfëria dhe skamja etj., dhe b) *faktorët pozitivë* (në shtetin e destinacionit): ndërlidhet me vendin e destinacionit (pritës) të cilin e zgjedh vet migranti si shtet ku shpreson dhe beson në siguri fizike, shërbime më të mira mjekësore, standard më të larta jetësore, mundësi për të punësuar, arsim kualitativ, bashkim familjar etj.

Pra, proceset e migracionit në fillim kanë qenë shkak i mbijetesës dhe të ndryshimeve klimatike, pastaj shkak i pushtimeve dhe persekutimeve dhe viteve të fundit si shkak i luftërave të ndryshme dhe shkaqe ekonomike. Kurse sot, me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë u rrit dhe u modernizua edhe numri i mjeteve transportuese ku tani më lehtë dhe më shpejt nga çdo vend i botës migrantët mund të kyçen në procesin e migracionit. Për shkak të trafikut intenziv midis vendeve të Europës Lindore dhe Europës Perëndimore, kamionët janë bërë mjeti kryesor i transportit për emigrantët.[20] Më drejtë transporti i shpejt, lirë dhe i sigurt e mundësoi rritjen e shpejt të lëvizjeve migratore transatlantike (dhe përtej detit), si dhe përhapjen e saj në vende të reja për migrantë.[21] Deri në fund të shekullit të 19-të në SHBA ajo ishte praktikisht e lirë pa asnjë rregullim ligjor si dhe politika e hapur e emigracionit përputhej me konceptin liberal të shtetit dhe Republikës Popullore të Amerikës, si dhe nevojën e vërtetë dhe të përhershme të vendit për banorët e rinj dhe fuqinë punëtore.[22] Në të vërtetë një nga ligjet e para që Kongresi i ri miratoj ishte Ligji mbi Natyralizimin të vitit 1790 me të cilën u parapa e drejta për shtetësi amerikane ka çdo person me kusht që të jetë i lindur i lirë dhe të takoj racës së bardhë.[23] Kështu në vitin 1882, Kongresi Amerikan hartoi miratoj dy rregullore mbi imigracionin i cili përbën përpjekjen e parë për të parashikuar në ligj se kush ka të drejtë dhe kush nuk ka të drejtë të hyjë në territorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Sipas rregulloreve Rregullore për përjashtimin e Kinezëve (the Chinese Exclusion Act) më të cilën ndalohet hyrje e plotësishme kinezëve në shtet dhe kufizimi I nënshtetësis edhe kur konfirmohet raca tyre dhe Rregullorja për imigracion e cila e kufizon drejtën e imigracionit të dënuarve, prostituteve personave me probleme mendore idiotëve dhe atyre që mund të bëheshin barrë e shoqërisë.[24] Ligje të ngjashme u miratuan edhe në Kanada, Australi dhe shtetet e Evropës. Në Kanadë gjatë periudhës kohore 1923 deri 1947 imigracioni aziatik ka qenë plotësisht e ndaluar, por ende në praktik është vërtetuar rregulla si shtet më pak i dëshirueshëm, kështu që tre milionë u larguan nga vendi në të njëjtën periudhë.[25]Në vitin 1996 në Itali me status të rregullt gjenden 60 mijë imigrantë shqiptar.[26]

Nuk është lehtë të përcaktohet numri i migrantëve në çdo periudhë kohore të historisë, e sidomos në fazat e para të lëvizjeve të migracionit për shkak edhe të mungesës së infrastrukturës së mbajtjes së të dhënave dhe mungesës së zhvillimit të pajisjeve teknike dhe teknologjike. Megjithatë, një fakt i gjithëpranuar është se lëvizjet e migracionit kanë qenë të pranishme në çdo

[20] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.213
[21] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.31
[22] Po aty, fq.53
[23] Po aty, fq.53
[24] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.54
[25] Po aty, fq.47
[26] Raufer, Xavier. Quere Stephane. "Pretnja Evropi-Albanska Mafija". Beograd, 2005, fq.56

periudhë kohore dhe të rralla janë ato shtete që nuk janë prekur nga migracioni, qoftë si shtete të origjinës, tranzitit ose si vende të destinacionit. Charles Tilly përmendën tre faktorë cilët kanë qenë vendimmarrës për lëvizjet e migracionit në hapësira të largëta gjatë pesë shekujve të fundit:
1) ndryshim të territorit gjeografik me qëllim të mundlsive të punësimit,
2) pabarazia demografike-rritja natyrale të dallimeve rajonale dhe
3) veprimet dhe politikat e shteteve kombëtare, nisja e luftëlrave,dëbime ose zhvendosjen e e grupeve të caktuara etnike, kontrolli i migracionit.[27] Statistikat tregojnë se aktualisht rreth 192 milion njerëz jetojnë jashtë vendit të tyre të lindjes, që do të thotë rreth 3% e popullsisë botërore është jashtë vendit të lindjes, ose e thënë ndryshe një person në tridhjetë e pesë është emigrant.

Deri në shekullin e XX, shtetet janë përpjekur të drejtojnë lëvizjet e migracionit duke marrë parasysh parametrat si sovraniteti, shtetësia, siguria, interesat politike dhe ekonomike të shtetit konkret. Sot, për shkak të globalizimit të ekonomisë dhe ndikimit në ekonomitë kombëtare të shteteve konkrete, migrimi tani po bëhet një fenomen ndërkombëtar përtej kontrollit kufitar të shteteve. Meqenëse emigrantët konsiderohen si përgjegjës për krizat ekonomike, papunësia dhe rritja e nivelit të krimit, kontrollimi i politikës për ndalimin e emigracionit ka ardhur përsëri në ballë[28] rregullimi dhe menaxhimi I lëvizjeve të migrantëve sidomos flukseve të mëdha të migrantëve. Në këtë kontekst, lëvizjet e njerëzve nga vendet e origjinës garantohet edhe me nenin 13 Deklaratën universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948 ku thuhet: " Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti. Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet."[29] Sipas statistikave në vitin 2005 në mbarë botën paraqiten rreth 200 milion emifrantë, ku përfshiheshin edhe 9 milion refugjatë.[30]

Migracioni si dukuri sociologjike globale, përveç aspektit sociologjik të studimit të saj është e domosdoshme edhe rregullimi jurudik ndërkombëtar, rajonal dhe nacional të proceseve të migracionit dhe të shteteve dhe vet migrantëve si subjekte kryesorë të këtyre proceseve. Rregullimi juridik të çështjes së proceseve të migracionit mundë të cekim disa akte ndërkombëtare siq janë:

- Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre,
- Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare,
- Konventa ndërkombëtare në lidhje me abuzimin fizik (ILO),
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës,
- Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore,
- Konventa kundër tortures dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese,
- Deklarata e organizatës ndërkombëtare të punës (ILO) lidhur me parimet dhe të drejtat themelore në punë dhe ndjekja e saj,
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre,

[27] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.29
[28] Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës "Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan tıcareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede uluslararası işbirliği". Istanbul, 2010, fq.30
[29] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948, neni 13
[30] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.43

- Konventa mbi migracionin për motive punësimi,
- Konventa për Punëtorët Migrantë,
- Konventa mbi diskriminimin në lidhje me punësimin dhe vendin e punës,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore,
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike,
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial,
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave,
- Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit të Miratuar nga Rezoluta 260 (III) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1948;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve,
- Konventa mbi statusin e personave pa shtetësi, dhe konventa e reduktimit të pa shtetësisë,
- Konventa mbi krimin e organizuar ndërkombëtar dhe protokollet e saj,

Pra, migracioni nënkupton lëvizjet me rrugë legale ose ilegale të individëve ose të grupeve, nga arsye të ndryshme e cila mund të jetë e detyruar ose vullnetar me qëllim të vendosjes nga një territori në një territor tjetër ose nga një shtet në një shtet tjetër për një periudh të përkohshme për t'u kthyer prap.[31]

1.2. Historiku dhe zhvillimi i proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë

Pothuajse të gjitha vendet, pa dallim, ballafaqohen me sfida që ndërlidhen me migrimin, qofshin si vende të origjinës, transitit apo vende të destinacionit përfundimtar,[32] poashtu edhe Republika e Maqedonisë është e prekur nga kjo dukuri. Gjatë historisë së Republikës së Maqedonisë, e deri më sot të gjitha llojet e proceseve të migracionit kanë pësuar ndryshime të mëdha si në vëllimin, sasin, format, shkaqet po ashtu edhe në intenzitetin e saj e cila ka qenë varur nga zhvillimet e brendshme shtetërore kurse disa procese të migracionit kanë qenë të varur edhe nga zhvillimet ndërkombëtare dhe po këto zhvillime kanë ndikuar që proceset ndërkombëtare të reflektohen direkt edhe në territorin e saj. Republika e Maqedonisë si shtet karakterizohet edhe me lëvizjet e brendshme të popullsisë dhe me lëvizjet ndërkombëtare gjegjësisht, emigracionin drejt shteteve tjera. Deri në pavarësinë e Maqedonisë pra, deri në vitin 1991, më shumë proceset e migracionit në këto territore ka qenë e llojit migracion i brendshëm, pra brenda shtetit. Deri në këtë periudhë kohore më shumë vërehen migrimet rurale-urbane dhe urbane-urbane brenda shtetit. Kjo lëvizje e shtetasve të vet garantohet edhe me nenin 27 të Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë : "Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë që të lëvizë lirisht në territorin e Republikës dhe lirisht ta zgjedhë vendbanimin e tij."[33] Njerëzit janë zhvendosur nga vendet rurale sidomos nga fshatrat malësore në fshatra fushore më të mëdha dhe të zhvilluara por edhe në qytetet më të afërta kurse lëvizjet e migracionit urban-urban, kanë qenë nga qytetet e vogla dhe me ekonomi më pak të zhvilluar në qytete më të mëdha dhe me ekonomi më të zhvilluar. Destinacioni i migracionit të brendshëm në Republikën e Maqedonisë është nga vendet rurale drejt vendeve urbane si dhe nga qytetet më të vogla sidomos drejt kryeqytetit Shkupit duke marë parasysh madhësinë territoriale, hapësirë për punësime, fillimin dhe zhvillimin e bizneseve sepse këtu është e përqëndruar pothuajse kapitali më i madh shtetëror dhe si pasojë e kësaj llogaritet si qytet i mbipopulluar. Si qytete tjera të mëdha ku ekonomija është më e zhvilluar dhe perspektiva e njerëzve në lidhje me punësime dhe biznese të ndryshme do të është më e favorshme janë: Tetova,

[31] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.36
[32] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.6
[33] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2006, neni 27, paragrafi 1

Gostivari, Ohri, Struga, Manastiri, Velesi etj, ku fshtrat të cilat janë përeth janë në migrim të përhershëm të shpërnguljes duke shitur ose lërë pasurin në vendet e tyre dhe vendosjen në qytetet e lartë përmendura. Vala më intensive të këtij lloji të migracionit ndodhi gjatë periudhës së industrializimit të shtetit (vitet e 60-ta dhe 70-ta të shekullit të kaluar), ku llogaritet se në këtë periudhë, më shumë se 175.000 individ i lëshuan vendbanimet rurale për të kërkuar ekzistencën e tyre në vendbanime urbane.[34] Kjo rrugë çon në një fluks të papritur të njerëzve drejt qyteteve, dhe ky fenomen shoqërohet edhe me sjellje kriminale dhe sociopatologjike.[35] Koncepti i patologjisë sociale përcakton një grup fenomenesh të ndryshme të cilat konsiderohen të padëshirueshme dhe negative nga pikëpamja e disa vlerave dhe normave të pranuara përgjithësisht në shoqëri[36] e cila ndikon edhe në paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore. Migracion të brendshëm në Maqedoni kemi edhe në vitin 2001 gjatë konfliktit të armatosur ku qytetarët e regjioneve të përfshirë në konflikt sidomos gra, fëmijë dhe pleq u zhvendosën në vendbanime të sigurta sidomos tek familjarët dhe miqtë që ishin në vendbanime të sigurta dhe jo të prfshira në konfliktin e armatosur. Ky lloj i migrimit të brendshëm të popullsisë së vendbanimeve të rezikuara pjesa më e madhe e migrimit ishte e përkohshme e cila zgjati më pak se nje vitë sidomos për atë kategori të cilët nuk pësuan dëme materiale në shtëpitë e tyre. Pjesa tjetër e cila edhe pse në numër është e vogël rikthimi në vendbanimet e tyre zgjat më shumë kohë derisa u regulluan shtepit e tyre të banimit. Shkalla e lartë e lëvizjes së popullsisë pengon formimin e një bashkësie stabile dhe rezulton në "dezorganizimin shoqëror".[37]

Përveç migracionit dhe lëvizjeve të brendshme në vendin tonë pas pavarësisë kemi pasur edhe migrime ndërkombëtare me shtetet e rajonit si dhe më gjërë. Pas pavarësisë Maqedonia ishte si shtet i cili pranoj një numër të konsiderueshëm të refugjatëve ose migrantëve të ikur nga lufta e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës po edhe të Shqipërisë edhe pse në numër ishte shumë e vogël, për periudhë kohore derisa sa zgjati koha e luftës dhe e destabilizimit të shteteve. Në dekadën e fundit të shekulli XX, u zhvillua Lufta në Bosnje e cila shkaktoi shumë viktima Edhe në luftën e Kosovës si shtet fqinj dhe me shumë lidhje familjare Maqedonia ishte si shtet i pranimit të refugjatëve të ikur nga lufta e cila e kaploj territorin e Kosovës. Në luftën e cila filloj në vitin 1998 deri në vitin 1999 shumica e refugjatëve u vendosën në familje shqiptare të cilët i hapën dyert refugjatëve shqiptar të Kosovës dhe pjesa tjetër u vendosën nëpër kampet e vendosura në disa vendbanime me shumicë shqiptare në Republikën e Maqedonisë. Në këtë luftë u dëbuan shumë njerëz ku një pjesë e saj si shtet fqinj dhe lidhjet mes dy popujve u pranuan në vendin tonë. Me regjistrimin e popullsisë, familjet dhe banesat në vitin 2002, total janë regjistruar 694.032 persona cilët nuk kanë karakter të popullsisë autoktone (kur kanë migruar), nga të cilët 32,1% kanë realizuar migrim lokal (kuadër të komunës së njejtë), 56,5,% kanë migruar prej një komune në komunë tjetër dhe 11,4 cilët kanë migruar nga shtetet e jashtme[38], e cila tregon procesin e migracionit në Republikën e Maqedonisë.

Përveç se Maqedonia ka qenë shtet origjine dhe shtet destinacioni në proceset e migracionit, gjithashtu pas vitit 2001 sidomos gjatë vitit 2015 me krizën e migrantëve të ikur nga lufta në Lindjen e Mesme ishte si shtet tranzit i mijëra apo miliona refugjatëve dhe migrantëve. Republika e Maqedonisë me pozitën e saj gjeografike duke e lidh Lindjen me Perëndimin mbetet shtet tranzit

[34] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.13
[35] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164
[36] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.154
[37] Repovac, Hidajet. "Krestomaci Sociologjike". Prishtinë, 2005, fq.182
[38] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.13


për migrantët ilegal.[39] Sot, edhe pse numri i personave që jetojnë apo gjenden jasht vendbanimit të vet janë me miliona njerëz, nuk mundë të llogariten të gjithë si migrantë sepse në kuadër të tyre kemi edhe udhëtime turistike, udhëtime për biznese të cilët nuk mbesin më shumë se 6 muaj ose 1 vit, drejtë e cila rregullohet me ligjin për të huajt varësisht nga shteti ku shkojnë. Në Republikën e Maqedonis në nenin 47, paragrafi 2, të Ligjit për te huajt ceket: "I huaji i cili është shtetas i shtetit me të cilin Republika e Maqedonisë ka vendosur regjim pa vizë, nëse i plotëson kushtet për hyrje të përcaktuara me këtë ligj, mund të hyjë dhe të qëndrojë në Republikën e Maqedonisë më së shumti deri në tre muaj gjatë çdo periudhe gjashtëmujore, duke llogaritur nga dita e hyrjes së parë të të huajit."[40] I huaji mund të hyjë në Republikën e Maqedonisë, nëse:
- ka dokument të vlefshëm dhe të pranueshëm të udhëtimit,
- posedon vizë të vlefshme, nëse është e nevojshme,
- ka mjete për mbajtje si gjatë periudhës së qëndrimit ashtu edhe gjatë kthimit në shtetin nga i cili vjen apo për udhëtim në shtet të tretë në të cilin është e sigurt se do të pranohen, apo do të ketë mundësi që ligjërisht t'i fitojë ato mjete,
- bashkëngjit, nëse ka nevojë dokumente që e arsyetojnë qëllimin dhe rrethanat e qëndrimit të paraparë në Republikën e Maqedonisë dhe dokumente për sigurimin e udhëtimit,
- nuk është dëbuar nga Republika e Maqedonisë dhe për të cilin nuk ka ndalim të vlefshëm për hyrje,
- nuk paraqet rrezik për rendin publik, sigurimin nacional, shëndetin publik apo për marrëdhëniet ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë.[41]

Kurse në nenin 47, paragrafin 1 e përkufizon qëndrimin deri në tre muaj ku thot se "me qëndrim deri në tre muaj në kuptim të këtij ligji, llogarite qëndrimi i të huajit me vizë apo pa vizë, nëse me këtë ligj apo me marrëveshje të ratifikuar të udhëtimit nuk është caktuar ndryshe."[42] Për këtë arsye, shumë shtete në politikat e tyre e marin parasysh proceset e migracionit dhe kështu i kategorizojnë migrantët në migrantë të përhershëm, migrantë përkohshëm (këtu marin pjesë migrantë me qëllim studimi, pune dhe vizite). Rrjetet kriminale shfrytëzojnë dëshpërimin dhe cenueshmërinë e migrantëve që kërkojnë t'i shpëtojnë konfliktit të armatosur, persekutimit dhe privimit[43] dhe i atakoojn gjegjësisht afrohen për të siguruar klient migrantë si në shtetin e origjinës, tranzitit ose destinacionit duke ofruar lehtësime dhe ndihma duke paguar sasi të caktuara. Për këto arsye shtetet në flukset e migrantëve duhet ti forcojnë kontrollet dhe mekanizmat kundër kontrabandimit me migrantë po edhe kundër trafikimit me qenie njerëzore si vepra penale shumë të rrezikshme. Sipas Strategjisë për Zbatimin e Modelit të Analizës së Riskut, do të arrihet koordinim më i lartë në fushën e operacioneve kufitare dhe shkëmbimit të informacionit, si dhe në luftën kundër krimit ndërkufitar dhe migracionit të paligjshëm[44] në mes të institucioneve përgjegjëse nacionale po edhe ndërkombëtare. Pjesa dërmuese e migrantëve ishin me prejardhje nga Sirija, Avganistani, Iraku dhe Pakistani dhe normale është që migrantë viktima të trafikantëve të jenë edhe nga këto vende. *Pranimi, transportimi dhe strehimi i mbi 60 migrantëve, shtetas nga Afganistani, Pakistani,*

[39] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.24
[40] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr.35 miratuar më 23.03.2006, neni 47, paragrafi 2
[41] Закон за странци, Бр. 07-1144/1, 14 март 2006 година, Скопје, neni 11, paragrafi 1
[42] Ligjit për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.35 miratuar më 23.03.2006, neni 47, paragrafi 1
[43] https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/facilitation-of-illegal-immigration, të datës 14.09.2020, ora 17:03
[44] Национална Стратегија. "Развој на воспоставениот систем за интегрирано гранично управување". Скопје, 2009, fq.8

Sudani, Somalia dhe vendet e tjera[45] (e shkëputur nga Aktgjykimi nr.113 të datës 24.02.2016) Duke pasur parasysh se regjistrimi filloi në qershor të vitit 2015, ku më shumë se një vit shumë refugjatë kaluan si të paregjistruar, si dhe një numër të madh të kalimeve të paligjshme në të gjithë territorin e vendit, numri i vërtetë i refugjatëve dhe emigrantëve që mbërritën në Evropë midis 2014 dhe 2016 është shumë më i madh se ai i regjistruar, pra, tejkalon numrin e 1 milion refugjatëve dhe emigrantëve.[46] Në vijim nëpërmjet grafikonit do të paraqesim lëvizjen dhe dinamikën e refugjatëve dhe të migrantëve që kaluan tranzit në Republikën e Maqedonisë gjatë fluksit masovik nga Lindja e Mesme.

Grafikoni nr.1 Dinamika e tranzitit të refugjatëve dhe migrantëve nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë në periudhën midis 19 qershorit 2015 (në ora 00:00) dhe 7 Mars 2016 (në ora 24:00) sipas muajit dhe vendit / territorit të origjinës:[47]



Nga Grafikoni nr.1 shihet se për periudhën kohore 19 qershor 2015 deri 7 mars 2016 nga totali i 477,856 migrantëve më shumë ka pasur shtetas të Siris me 260,891, pastaj e ndjekur nga shtetas të Avganistanit me 122,237, kurse më pak ka pasur migrantë të paevidentar nga shtetësia me 21,447 dhe pastaj shtetas të Irakut me 73,281 migrantë. Nga totali më shumë ka pasur migrantë në nëntor të 2015 me 94, 690, pastaj në dhjetor 2015 me 93,305 migrantë, kurse më pak në mars të vitit 2016 me 1,783 migrantë.

Si çdo shtet në botë që i ka pikat zyrtare kufitare në rrugë tokësoe, ajrore, ujore dhe hekurudhore, edhe në Maqedoni ekzistojnë kalime zyrtare kufitare përveç kufirit ujir detar nuk ekziston. Në Republikën e Maqedonisë ka:

- pesëmbëdhjetë vendkalime zyrtare kufitare, përkatësisht: 3 me Bullgarinë, 3 me Greqinë, 4 me Shqipërinë dhe 5 me Unionin e Serbisë dhe Malit të Zi.
- tre vendkalime kufitare hekurudhore, nga të cilat 2 me Unionin e Serbisë dhe Malit të Zi dhe 1 me Greqinë.
- dy aeroporte ndërkombëtare dhe ate: Aeroportet e Shkupit dhe Ohrit.[48]

[45] Aktgjykim nr.113 të datës 24.02.2016 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

[46] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.2

[47] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа". Скопје, 2016, vep. e cit., fq.30

[48] Национална Стратегија. "Интегрирано гранично управување". Скопје, 2003, fq.10

Kriza e migrantëve dhe vala e refugjatëve në Evropë në vitin 2015 paraqet katastrofën më të madhe humanitare që nga Lufta e Dytë Botërore.[49] Nga fillimi i krizës më 19 qershor deri në fund të vitit 2015, u regjistruan 388.233 migrantë dhe azilkërkues duke hyrë në[50] Republikën e Maqedonisë. Në fund të vitit 2015 dhe fillim të vitit 2016, Maqedonia vendosi të kufizojë hyrjen e njerëzve përmes kufijve të saj.[51] Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi vendim me nr. 110/1 të datës 19 gusht të vitit 2015 ku u vendos se ekziston gjendje krize si shkak i rritjes së vëllimit të hyrjeve dhe tranzitimit në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në përgjithësi, "kriza" paraqet një situatë dhe strukturë të paqëndrueshme që nuk funksionon mirë dhe kërkon ristrukturim[52] nga ana e institucioneve shtetërore. Neni 1, paragrafi i parë i Vendimit gjendje krize si shkak i rritjes së vëllimit të hyrjeve dhe migrantëve tranzit në territorin e Republikës së Maqedonisë ceket se: "Ky vendim përcakton ekzistencën e një situate krize në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë në zonat e kufirit jugor dhe veri të Republikës së Maqedonisë, për shkak të rritjes së vëllimit të hyrjes dhe tranzitimin e emigrantëve në të gjithë territorin e Republikës Maqedonia, e cila kërcënon sigurinë, shëndetin dhe pasurinë e popullatës."[53] Me vendimin e Kuvendit të R.M., gjendja e krizës ishte propozuar deri qershor të vitit 2016, a plotësisht ishte propozuar deri 31.12.2016 në seancën menjëherë para lëshimit jokushtetues të Kuvendit.[54] Gjendja e krizës ose gjendja e jashtëzakonshme në lidhje me fluksin e migrantëve ishte e pashmangshme për vendin me të vetmin qëllim të menaxhimit më adekuat dhe efikas me qëllim të mosdaljes nga kontrolli shtetëror të situatës së paraqitur. Gjendja e jashtëzakonshme mund të definohet si situatë e cila kërkon përgjigje të shpejtë dhe shumë të strukturuar[55] nga të gjitha aktorët e kyçur në raste të krizave të migrantëve. Por, për shkak të rritjes masovike të valës së migrantëve nga Maqedonia si shtet tranzit ishte e nevojshme edhe zgjatja e afatit të gjendjes së krizës së shpallur e cila ishte deri 15.06.2016 ku më datën 28.03.2016 u pru Vendim me nr. 08-1883/1 për ndryshimin e Vendimit për miratimin e vazhdimit të afatit ekzistimin e gjendjes së krizës për shkak të rritjes së vëllimit të hyrjes dhe tranzitimin e emigrantëve në të gjithë territorin e Republikës Maqedonia ku gjendja e shpallur e krizës do të vazhdohej deri më 31.12.2016. Kështu që në fillim të marsit 2016, qeveria vendosi të mbyllë plotësisht kufijtë për hyrjen e njerëzve pa vendbanim të rregullt, i cili paraprakisht i klasifikonte ato si "emigrantë" paraprakisht.[56] Përmes mbylljes së plotë të kufijve shtetërorë dhe ngritjes së një gardh teli me gjemba, në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar dhe vendor, Maqedonia po shmang detyrimin e saj për të respektuar të drejtat e refugjatëve.[57] Gjendjen e krizës apo gjendjen e jashtëzakonshme të shpallur për fluksin e migrantëve nga ana e shtetit tonë si organ përgjegjës dhe menaxhues të saj është Qendra për menaxhim me kriza e cila detyrat dhe

[49] Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Гевгелија, Октомври 2017-Февруари 2018 година, fq.1

[50] Të dhëna statistikore nga organizata ndërkombëtare për migracion (International Office for Migration- IOM) doe.iom.int/docs/Flows%20Compilation%202015%20Overview.pdf në pjesën e të dhënave për Republikën e Maqedonisë, fq.11, të dates 29.05.2020, ora 11:55

[51] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.2

[52] Tutar, Hasan. "Kriz ve Stres yönetimi". Ankara, 2004, fq.13

[53] Одлука за постоење на кризна состојба заради зголемен обем на влез и транзитирање на мигранти низ територијата на Република Македнија Бр.110/1, 19.08.2015, Скопје, neni 1, paragrafi 1

[54] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, vep. e cit., fq.4

[55] Дончев, Александар. "Кризен Менаџмент". Скопје, 2007, fq.105

[56] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.2

[57] Po aty, fq.10

obligimet e saja i kryen në bazë të Ligjit për menaxhim me kriza e cila u miratua në vitin 2005. Me këtë ligj rregullohet sistemi i menaxhimit me kriza në Republikën e Maqedonisë, dhe atë: "organizimi dhe funksionimi, vendimmarrja dhe përdorimi i burimeve, komunikimi, koordinimi dhe bashkëpunimi, vlerësimi i rrezikshmërisë të sigurisë të Republikës, planifikimi dhe financimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me sistemin e menaxhimit me kriza."[58] Edhe pse shteti ynë insiston në respektimin e drejtave ligjore të rrefugjatëve dhe të migrantëve duke u konosliduar me aktet ndërkombëtarë për refugjatë dhe migrantë në praktikë prap ekzistojnë një sërë problemesh me menaxhimin e fluksit dhe në respektimin e drejtave dhe lirive të tyre. Që nga fillimi i krizës mbi 1 milion migrantë dhe rrefugjatë kaluan në Evropë në kërkim të mundësive më të mira.[59] Gjatë zbatimit të dispozitave ligjore, lëshimi jo në kohë të dokumenteve të duhura për identifikim i ekspozon azilkërkuesit në rrezikun të mos pasjes së mundësisë për fitim të mbrojtjes ndërkombëtare ose të ushtrimit të të drejtave që janë specifike për statusin e mbrojtjes ndërkombëtare.[60] Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë u thye dhe erdh deri te mosrespektimi i parimit të moskthimit duke e shkel drejtën e hyrjes në territorin shtetëror dhe drejtën e azilit të cilat janë të garantuara me drejtën nacionale të Maqedonisë dhe me akte ndërkombëtare. Azili është mbrojtje nga përndjekja e cila i pranohet refugjatit i cili për shkak të frikës së arsyetuar nga përndjekja për shkak të rasës, fesë, nacionalitetit, përkatësisë në ndonjë grup të caktuar social ose opinion politik nuk mundet ose nuk dëshiron që të kthehet në vendin e nënshtetësisë së tij ose në vendin ku ai qëndron.[61] Sipas nenin 29, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë e parasheh drejtën e azilit për të huajt e cila thot: " Republika ua garanton të drejtën e azilit të huajve dhe personave pa shtetësi, të përndjekur për shkak të bindjeve dhe veprimeve politike demokratike."[62] Shoqata e juristëve të rinj është një organizatë e autorizuar për të siguruar ndihmë juridike falas sipas LNJF dhe është e vetmja organizatë në R.M.V. e cila me mbështetjen nga zyra e Komisionerit të Lartë për refugjatë siguron ndihmë juridike falas dhe përfaqësim për azilkërkuesit në të gjitha fazat e procedurës.[63] Ndalimi dëbimit ose të moskthimit (non-refoulement) parashihet edhe me nenin 33 paragrafi 1 në pjesën për "Masat në lidhje me personat e rrezikuar ose të humbur" të Konventës së Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197 ku thot se: "Kur një Palë, në bazë të informacionit që ka në dispozicion, ka shkaqe të arsyeshme të besojë se jeta, liria ose integriteti fizik i një personi është në rrezik të menjëhershëm në territorin e një Pale tjetër, Pala që ka informacionin, në rast emergjence, do ta transmetojë pa vonesë te ky i fundit, në mënyrë që të marrë masat mbrojtëse të përshtatshme."[64] Pas mbylljes së kufijve, në Maqedoni mbetën pothuajse 1,500 refugjatë dhe emigrantë të regjistruar, dhe në shtator 2016, si

[58] Ligji për menaxhim me kriza, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.29/05, neni 1, paragrafi 1

[59] Прв Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Бутел и Општина Шуто Оризари, Октомври 2017-Февруари 2018 година, fq.2

[60] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.4

[61] Analizë nga Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Maqedoni "Integrimi i refugjatëve dhe personave pa nënshtetësi ne Maqedoni", fq. 38

[62] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me Amandamentet e Kushtetutës I-XXX, Shkup, 2006, neni 29, paragrafi, 2


[63] Анализа. "Достапноста и пристапот до безплатна правна помош за лицата баратели на азил во Република Македонија". Скопје, 2016, fq.20

[64] Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197, neni 33, paragrafi 1

rezultat i vazhdimit të rrugëtimit drejt Serbisë, numri i tyre ishte më pak se 200.[65] "Gjatë Tetorit 2016, Qeveria vendosi përsëri të vazhdojë krizën deri në fund të Qershorit 2017. Gjatë qershorit 2015, Kuvendi i RM miratoi ndryshimet në Ligjin për ndryshimet në Ligjin për azil dhe mbrojtje të përkohshme. Zgjidhja e propozuar u jep mundësi refugjatëve të shprehin qëllimin e tyre për të paraqitur një kërkesë për azil para një oficeri policie. Prandaj, ata kanë mundësinë që të paraqesin një kërkesë të tillë brenda 72 orëve. Në periudhën nga deklarata e qëllimit deri në paraqitjen e kërkesës, ata nuk konsiderohen migrantë të paligjshëm, duke u mundësuar atyre që të lëvizin përkohësisht lirshëm dhe ligjërisht të përdorin mjetet e transportit publik."[66]

Sot, Republika e Maqedonisë së Veriut përballohet seriozisht me migrimet e parregullta përshkak të pozitë gjeografike të saj e cila gjendet në rutën e Ballkanit-Perëndimor prej nga emigrantët shkak i ikjes nga luftërat që zhvillohen në Lindjen e Mesme të cilët përmes Turqisë duke kaluar nga Greqia vijnë në Maqedoni duke tranzituar shtetin tonë drejtë Sërbisë, pastaj hyrje në territorin e Unionit Evropian me qëllim të arritjes në shtetet e Evropës Perëndimore cilët e kanë edhe si destinacion të preferuar. Vendet kryesore të prejardhjes së migrantëve ishin: Siria, Avganistani dhe Iraku.[67] Në krahasim me numrin e migrantëve të cilët kalojnë shtetin tonë drejt Evropës Perëndimore numri i azilkërkuesve është shumë i vogël si më herët po ashtu edhe gjatë vitit 2015 dhe 2016 kur ishte fluksi më i madh i migrantëve në territorin e Republikës së Maqedonisë. Në vijim do të paraqesim numrin e migrantëve dhe të refugjatëve azilkërkues në vendin tonë, sidomos gjatë periudhës 2015-2016 kur numri i tyre u rrit në masë të madhe.

Grafikoni nr.2 Numri i përgjithshëm i refugjatëve dhe migrantëve që kanë bërë kërkesë për azil në Republikën e Maqedonisë, në periudhën midis 19 qershorit 2015 (në 00:00) dhe 7 Mars 2016 (në 24:00) sipas vendeve dhe territoreve të origjinës[68] nga gjithsej 477.876 janë vetëm 115 kërkesa.



Siç shihet në grafikonin e paraqitur nga numri i përgjithshëm i azil kërkuesve prej 115 migrantë për vitin 2015 dhe vitin 2016 dominon shtetas-migrantë të Sirisë me gjithsejt 78 kërkesa (në vitin

[65] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.5

[66] Po atyr, fq.4

[67] Прв Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Бутел и Општина Шуто Оризари, Октомври 2017-Февруари 2018 година, fq.2

[68] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа". Скопје, 2016, vep. e cit., fq.29

2015 56, kurse 2016 me 22 kërkesa). Pas shtetasve të Sirisë më pas vijojnë, Avganistani me 20 kërkesa (në vitin 2015 me 13 kërkesa, kurse në vitin 2016 me 7 kërkesa), Palestina me gjithsejt 4 kërkesa vetëm në vitin 2015, Iraku vetëm 3 kërkesa vetëm në vitin 2015, Pakistani me 3 kërkesa vetëm në vitin 2015, Algjeria me 2 kërkesa vetëm në vitin 2015, Libani me 2 kërkesa vetëm në vitin 2015, Maroko me 2 kërkesa vetëm në vitin 2015 dhe Egjipti me 1 kërkesë vetëm në vitin 2015. Nga numri i përgjithshëm për dy vitet e paraqitura më shumë kemi në vitin 2005 me 86 kërkesa kurse në vitin 2016 me 29 kërkesa. Viti 2005 është dominuese me azilkërkues për të gjith shtetasit e huaj të paraqitur në grafikonin nr.2. Shumica e tyre hoqën dorë nga kërkesat e tyre dhe u larguan nga vendi në mënyrë të paligjshme.[69] Konventa për statusin e refugjatëve parasheh se asnjë shtet kontraktues nuk do të largoj apo në mënyrë të dhunshme të kthej, në çfarëdo mënyre, refugjat në kufirin e territorit ku jeta e tij dhe liritë do të ishin të shkelura për shkak të rasës së tij, fesë, nacionalitetit, përkatësi në një grupë sociale të caktuar apo për shkak mendimit të tij politik (non-refoulement).[70] Lëvizjet e migrantëve në territorin e Maqedonisë, për shtetin ishte përvojë e parë të kësaj përmase masovike dhe sfidë aparatitit shtetëror me kapacitetet institucinale, koordinim në teren dhe menaxhim të mirëfillt duke i mbrojtur lirit dhe të drejtat themelore të njeriut dhe migrantëve dhe garantimin e sundimit të ligjit të parapara me akte ndërkombëtare. Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit janë atribute të personalitetit njerëzor imanent ndaj çdo qenie njerëzore të lindur.[71] Miratimi i një politike konsistente të migracionit në Republikën e Maqedonisë kushtëzohet nga intensifikimi i lëvizjeve ndërkombëtare të migracionit në botë, të cilat nuk e anashkalojnë Republikën e Maqedonisë, si dhe trendet e lëvizjeve të imigracionit dhe emigracionit në vend gjatë dekadës së fundit.[72]

Edhe vendi ynë po ballafaqohet me ndikimin negativ të emigracionit ndërkombëtar ku më së shumti migrojnë të rrinjtë sipas moshës e cila ndryshon edhe strukturën e popullsisë pothuajse në çdo aspekt, sidomos në plakjen e popullsisë së përgjithshme. Vendi ynë karakterizohet me dy lloje të migrantëve njëra e fuqisë punëtore nga shkaqe ekonomike, kurse tjetra migrimet e trurit (migrantë që kanë kryer së paku arsim të lartë) dhe kështu fillojë të ndjehet mungesa e të rrinjve cilët llogariten si ardhmëria më e shëndoshë dhe më e fortë e një shteti. Ndryshimet në shtrirjen dhe natyrën e emigrimit që në vitin 1946 deri sot korrespondojnë me faza të ndryshme në zhvillimin shoqëror dhe ekomonik të vendit, si dhe me ndryshimet e politikave të migracionit në vendet pritëse.[73] Bazuar në të gjitha të dhënat e disponueshme (nga burime vendase dhe të huaja), vëllimi i përgjithshëm i emigracionit nga Republika e Maqedonisë në periudhën e tranzicionit mund të përafrohet të paktën 150 mijë njerëz.[74] Ky numër nuk është aspak real sepse personat që emigrojnë nuk paraqesin ndryshimin e vendbanimit ose shtetësisë së tyre ose qëndrimin në një shtet tjetër në organet kompetente e cila do të ndikonte që edhe në të dhënat statistikore të jenë më të realta dhe të sakta. Vala më e rëndësishme e emigracionit, që filloi në vitin 1990 dhe vazhdon

[69] Анализа. “Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен”. Скопје, 2017, fq.3

[70] Analizë nga Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Maqedoni “Integrimi i refugjatëve dhe personave pa nënshtetësi ne Maqedoni”, fq.31

[71] Petrović, Borislav. Jovasević, Dragan. Perhatović, Amila. “Krivično Pravo II ”, Saučesnistvo, krivične sankcije i posebni dio. Sarajevo, 2016, fq.336

[72] Резолуција. “Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014”. Скопје, 2008, fq.4

[73] Raport. “Ndikimi social i emigracionit dhe migrimit rural-urban në Evropën Qendrore dhe Lindore”. Shkup, 2012, fq.2

[74] Резолуција. “Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014”. Скопје, 2008, fq.13

edhe sot numëron rreth 200.000 njerëz.[75] Sa i përket shpërndarjes gjeografike të shtetasve maqedonas jashtë vendit, bazuar në të gjitha të dhënat e disponueshme, mund të konkludohet se në periudhën 2009-2014, Australia, Italia, Gjermania, Shtetet e Bashkuara dhe Zvicra mbetën pesë vendet me numrin më të madh të emigrantëve nga Republika e Maqedonisë.[76] Këto emigrime masovike me të madhe kanë ndikuar edhe në mungesën e profesionistëve vendas në lëmi të ndryshme, sidomos me lehtësimin e Gjermanisë në lidhje marrjen e vizave të punës dhe si pasojë e saj në masë të madhe filloj edhe migracioni intelektual të profileve të ndryshme dhe mjekë në fushën e mjekësisë, pra migracioni i trurit. Me qëllim të uljes së migrimit të rrinjve shteti ynë duhet të hartoj strategji dhe plane afatshkurtëra, mesme dhe afatgjate me qëllim që hap pas hapi të ndikoj në uljen e migracionit duke përmirësuar ekonominë e vendit, "(p.sh. politikat industriale, promovimi i ndërrmarjeve, politikat e investimeve) janë të rëndësishme për krijimin e punësimeve."[77]

Rishikimi i politikave dhe programeve ekzistuese që nxisin punësimin e të rinjve është hap kryesor për vendet që kanë marrë përsipër të zhvillojnë dhe zbatojnë[78] masa për reforma ekonomike sidomos në lidhje me punësimin e të rinjve në vend e në rastin konkret në Republikën e Maqedonisë e cila do të ishte një hap në zbutjen e migracionit masovik. Ekonomija e Maqedonisë llogaritet një ndër ekonomit më të pazhvilluar në ish Jugosllavi, rajon por edhe më gjërë. Shumë kriminologë mendojnë se, për shkak të goditjeve ekonomike, lindin edhe kriza personale, protesta dhe konflikte, lind një atmosferë konfliktuale e cila është shumë e favorshme për sjelljet delikuente.[79] Papunësia ka arritur në nivelin më të lartë të saj, ku pjesa më e madhe e popullsisë jeton nga bujqësia kurse në anën tjetër investime dhe përkrahje shtetërore kësaj sfere është e kufizuar dhe e politizuar ku qytetarët mbeten pa shpresë në përmirsimin e sektorit të bujqësisë. Njerëzit e goditur nga varfëria janë të papunët, familje me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura, familje shumë anëtarëshe me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura, të rrinjtë të papunë, fëmijët nga familje shumë anëtarëshe me të ardhura të uëta ose pa të ardhura, fëmijë pa prindë ose kujdes prindëror, prindër të vetëm me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura,, popullata nga mjediset rurale dhe pakicat etnike, gratë nga mjediset rurale dhe pakicat etnike, pakicat etnike (sidomos bashkësia rome), gratë që përballen me diskriminim (shumëfisht) ose dhuna gjinore, persona me arsim të ulët, persona në moshë me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura etj[80] e cila e karakterizon Republikën e Maqedonisë si shtet ekonomikisht i dobët. Masa të veçanta për barazinë mes gjinor pra mes burrave dhe grave e parasheh edhe Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave e vitit 1979. Miratimi i masave të përkohshme të veçanta nga shtetet palë që synojnë përshpejtimin de facto të barazisë midis burrit dhe gruas, nuk konsiderohet diskriminim, siç është përkufizuar në këtë Konventë, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçanta.[81] Studiuesi ***Gil***, duke analizuar disa veçori të kryerësve të sjelljeve abuzive ndaj fëmijëve, konstaton se ata cilësohen me nivel të ulët të

[75] Raport. "Ndikimi social i emigracionit dhe migrimit rural-urban në Evropën Qendrore dhe Lindore". Shkup, 2012, fq.2

[76] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.6

[77] Rosas, Gianni. Rossignotti, Giovanna. Udhëzues. "Përgaditja e planit kombëtar të aksionit për punësimin e të rinjve", Zyra Ndërkombëtare e Punës, Gjenevë, 2008, fq.26

[78] Po aty, fq.30

[79] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.166

[80] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.7

[81] Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, neni 4, paragrafi 1

shkollimit, me të ardhura më të ulëta se mesatarja në vend.[82] Sipas kushtetutës së R.Maqedonisë është e rregulluar së nëpërmjet kujdestarisë siguron mbrojtjen e fëmijëve pa prindër, të fëmijëve, të miturve pa përkujdesje prindërore dhe të personave madhor nën kushte dhe mënyrë të rregulluar me ligj njëkohësisht edhe neni 12 i ligjit mbi familjen të R.M-së rregullon këtë çështje.[83] Zhvillimi ekonomik dhe dhe ulja e papunësis janë shtyllat më kryesore të parandalimit ose të uljes së migrimeve masovike jashtë vendit sepse shtetasit që migrojnë shumica arsyetohen për papunësi, krizë ekonomike, standardi i lartë i jetës. Kur bëhet fjalë për arsye ekonomike, është motivi më i rëndësishëm i migrimit që tërheq njerëzit për të jetuar në vendin ku ata jetojnë, për të kërkuar punë dhe për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës.[84] Në janar të vitit 2008, Komisioni Evropian i ftoi vendet e Ballkanit Perëndimor për të nisur dialogun për liberalizimin e vizave.[85] Maqedonia në vitin 2010 arriti Marëveshjen me Bashkimin Evropian për libelarilizim të vizave u rrit numri i azil kërkuesve duke marë parasysh se shumë shtetas jetojnë edhe jashtë vendit duke insistuar në migrim të përhershëm me qëllim të bashkimit familjar. Bashkimi harton një politikë të përbashkët për azilin, mbrojtjen plotësuese dhe mbrojtjen e përkohshme, me qëllim ofrimin e statusit të duhur çdo shtetasi të një vendi të tretë që kërkon mbrojtje ndërkombëtare dhe sigurimin e respektimit të parimit të moskthimit në vendin ku rrezikohet liria ose jeta e azilkërkuesit.[86] Sipas regjioneve, moshës dhe nacionalitetit të emigrantëve në Maqedonis, popullsia që emigron jashta shtetit, më shumë mer pjesë popullata e Pollogut dhe regjioni jugperëndimor, ku sipas dhënave të regjistrimit të vitit 2002, më shumë janë meshkuj të moshës 20 deri 39 kurse dominues janë popullata e bashkësisë etnike shqiptare.[87]Sa i përket vendeve evropiane, destinacionet më të rëndësishme janë: Gjermania, Italia, Zvicra, Austria, Sllovenia dhe Belgjika (të dhënat e Eurostat), si dhe Suedia (Regjistrimi i Popullsisë, 2011).[88] Pas liberalizimit të vizave, "Ikja e trurit" në mesin e të arsimuarve është bërë një problem serioz, sepse pjesa e emigrantëve me arsim të lartë është rritur ndjeshëm nga viti 1990 dhe shkalla e emigrimit është mbi 29%.[89]

Si shkak i lëvizjeve të emigraionit ndërkombëtar më së shumti janë prekur vendbanimet rurale ku sot me të madhe vërehet mungesa e të rrinjve, dominimi i gjinis femërore dhe të pleqëve. Në Republikën e Maqedonisë ndikimi i migracionit të brendshëm në gjendjen demografike është e dyfisht e cila në një anë ajo direkt ndikon në gjendjen e numrit, paraqitjen territorial dhe strukturën e popullsisë dhe anën tjetër përcakton edhe natalitetitn dhe mortalitetitn përshkak të pasojës nga struktura e gjinisë dhe plakjes së popullatës.[90] Kjo kategori e individëve që emigrojnë nga vendet e tyre të origjinës është rezultat i mungesës së vendeve të punës, hapësirës së ngushtë për gjetje të punës duke i ikur punëve bujqësore duke llogaritur si profesion joprofitabil kurse anën tjetër vendet e destinacionit vin në pozitën e papunësisë dhe varfërisë shkak i mbipopullimit të qyteteve më të mëdha siç është Shkupi. Një ndër sfidat më të mëdha, me të cilën Maqedonia po përballet në moment, janë pabarazitë rajonale në shkallën e varfërisë dhe rritjes ekonomike në

[82] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.84
[83] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.150
[84] Sever, Muhammed. Doktora tezi "Türkiye'yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ", Ankara. 2015, fq.24
[85] Raport. "Largimi drejt shteteve anëtare të BE-së-shkaqet dhe pasojat e migrimit të fundit nga Kosova". Prishtinë, 2015, fq.6
[86] Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila është shpallur në Strasburg, më 12 dhjetor 2007 nga Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni (GZ C 303, 14.12.2007, neni 78, paragrafi 1
[87] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.14
[88] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.6
[89] Raport. "Ndikimi social i emigracionit dhe migrimit rural-urban në Evropën Qendrore dhe Lindore". Shkup, 2012, fq.2
[90] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.13

vend.[91] Duke marrë parasysh se në nivel shtetëror edhe pse investimet janë të pakta ato janë bërë më së shumti në qytete kështu që vendbanimet rurale janë diksrimunuar në aspektin e investimeve dhe migrimi ndërkombëtar në nivel të lartë shtë shprehur në fshatra ku duket mungesa e kushteve industriale, sociale-shëndetësore, arsimore etj. Gjatë qëndrimit të tyre jashtë vendit, emigrantët vazhdojnë të kenë marrëdhënie me vendin e tyre në fusha të ndryshme. Në periudhën pas vitit 2009, Gjermania, Italia dhe Zvicra mbetën vendet evropiane të pritjes me numrin më të madh të qytetarëve maqedonas, me pjesëmarrjen e tyre të përbashkët në vitin 2009 ishte 215305, dhe në vitin 2013 214130 persona.[92] Aktivitetet kryesore ekonomike janë dërgimi i parave, konsumimi i produkteve nga vendi i tyre, investimi në vendlindje (kryesisht në ndërtimin e shtëpive), dhe angazhimi në filantropi atje[93], pra, ndihma anëtarëve të familjes bëhet përmes remitancave të emigrantëve. Në të vërtetë, migrimet shoqërohen nga një rritje e paqëndrueshmërisë së familjes, sepse zhdukja e marrëdhënieve tradicionale në të, familja gradualisht humbet ndikimin tradicional të fortë mbi fëmijët në rininë që mbahet gjithnjë e më pak në të.[94] Lëvizjet e migracionit jasht shtetit të Maqedonisë gjithashtu ka ndikuar edhe në rolin e gruas në familjet e migrantëve. Në shumë familje migrantësh shpesh në ato vendbanime rurale gruaja është kategori e rrezikuar për shkak se rriten detyrat dhe obligimet në familje sepse mungon anëtar i familjes që ka migruar ku shpesh janë meshkujt migrantë. Ka raste kur fëmit rriten në mungesë të dy prindërve kështu që pleqtë janë ata që mundohen të kryejnë detyrat dhe obligimet ndaj femijëve që janë kategori e rrezikuar nga veprime të ndryshme kriminale. Sjelljet e tilla mund të lulëzojnë ngase në rajonet në të cilat popullsia ndryshon, kontrolli shoqëror është i dobët.[95]

Për menaxhim të suksesshëm të politikave të migracionit duhet një strategji gjithkombëtare dhe regjionale e shtetit për tu ballafaquar me aspektet negative të migracionit. Deri më tani ende nuk kemi rezultate të mjaftueshme edhe pse në dhjetor të vitit 2008, Kuvendi i Maqedonisë miratoi për herë të parë Rezolutën për politikën e migracionit të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2009-2014, më vonë për eriudhën 2015-2020 dhe Plani akcional për politikën e migracionit, por de facto ky hap nuk tregoj shumë rezultate gjatë implementimit të saj shkak i mungesave të shumta të kapaciteteve shtetërore për t'i përballuar obligimet nga kjo Rezolutë. Republika e Maqedonisë gjithashtu ka nënshkruar marëveshjen me Bashkimin Evropian në lidhje me ripranimin e migrantëve ilegal e cila hyri në fuqi në vitin 2008. Më pas në vitin 2010 u miratua Programa për riintegrimin e migrantëve të kthyer pajtueshmëri me marëveshjen për ripranim, por realizimi i saj po lëviz shum ngadal. Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoj Strategji për zhvillim regjional për periudhën 2009-2019 e cila duhej të regulloj gjendjen demografike, ekonomike, sociale dhe nevojat tjera për kategorit e rezikuara nga proceset e migracionit. Në vendet nga të cilat ka migrim të konsiderueshëm, integrimi i politikave të lidhura me migrimin në strategjitë kombëtare të zhvillimit mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social.[96] Për implementimin e këtyre dokumenteve strategjike të miratuara nga Republika e Maqedonisë nga qeveria shtetërore duhet planifikim të rritjes së buxhetit për qëllimet e këtyre strategjive dhe të investohet në koordinim të mirëfillt dhe profesional nga profesionist të vërtet të këtyre lëmive sidomos paraprakisht të sigurohen të dhëna të sakta statistikore në lidhje me migracionin dhe kategorit e prekura nga këto

[91] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.7

[92] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.7

[93] Raport. "Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë". Banka botërore, 2011, fq.18

[94] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.165

[95] Repovac, Hidajet. "Krestomaci Sociologjike". Prishtinë, 2005, fq.182

[96] Raport. "Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë". Banka botërore, 2011, fq.17

procese. Por fatkeqësisht në Republikën e Maqedonisë nuk kemi të dhëna të sakta oficiale në lidhje me migracionin e brendshëm dhe ndërkombëtar për këtë jemi dëshmitar se që nga viti 2002 nuk kemi regjistrimin e popullsisë. Në bazë të dhënave të regjistrimit të vitit 1994 jashtë shtetit kanë jetuar 173.611 persona, nga e cila për periudhën 1989-1994, 50.000 persona kanë lëshuar Maqedoninë, pra numrat flasin se jashtë shtetit (shumica në shtetet evropiane) jetojnë 35.123 persona nga Maqedonia nga cilat 22.995 persona cilët jetojnë dhe punojno jashta, a të tjerët takojnë në grupin tjetër.[97] Por, nëse ndalemi tek evidencat e shteteve të destinacinit të këtyre emigrantëve, llogaritet se niveli vjetor i emigrimeve nga RM lëvizë mes 10.000 dhe 15.000 persona.[98] Për shkak të mosekzistimit të dhënave definitive të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë në institucione të ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare ekzistojnë shifra të ndryshme për numrin e personave që kanë emigruar ose imigruar në Maqedoni. Sipas të dhënave të Bankës Botërore tregojnë se numri i shtetasve maqedonas që banojnë në të gjitha vendet që mbulohen nga këto të dhëna në vitin 2010 ishte 447138 persona, ndërsa shkalla e emigracionit ishte rreth 21.8%.[99] Sipas Rezolutës "Politika e Migracionit të Republikës së Maqedonisë 2015-2020", Shkup, të vitit 2015 vlerësohet se sipas të dhënave të disponueshme nga regjistrimet e popullsisë dhe statistikat zyrtare të Shteteve të Bashkuara, Kanadasë, Australisë dhe Zelandës së Re, numri i shtetasve maqedonas në këto vende është 183383, që është 105,707 më shumë se të dhënat e Bankës Botërore për vitin 2010.[100] Nëse për vendet përtej oqeanit përfshihen këto të dhëna, atëherë numri i përgjithshëm i shtetasve maqedonas jashtë vendit është rreth 553000, dhe shkalla e emigracionit është 26.8%.[101] Këto të dhëna statistikore nga institucionet dhe vendet e ndryshme sot mund të pranohet vetëm si një vlerësim, por asesi si e saktë në lidhje me proceset e migracionit. Për qasje më profesionale dhe të suksesshme ndaj migracionit duhet të respektohet edhe Parimi i Bashkëpunimit dhe Bashkërendimit që nënkupton bashkëpunimin dhe bashkërendimin e brendshëm ndërinstitucional, partnerët social, rrjetet akademike, organizatat ndërkombëtare, qeveritare, jo-qeveritare dhe organizatat tjera vendore, me qëllim të luftimit të migrimit të parregullt dhe promovimit të migrimit të rregullt.[102] Pra, devijimet dhe veprat penale që pësojnë nga proceset e migracionit siç është migrimet ilegale, kontrabanda me migrantë dhe trafikimi me qenie njerëzore janë shqetësuese për të gjitha vendet dhe sigurinë botërore. Qëllimi primar dhe themelor i Kombeve të Bashkuara, është të ruaj qetësinë dhe sigurinë botërore.[103] Siç e shikojmë, jemi larg nga OKB-ja që qëndron si zgjidhëse konfliktesh, e njohur dhe efektive, si një garanci për rritjen e mirëqenies dhe bartëse e zhvillimit për të gjithë.[104] Qëllimet e OKB-së janë të orientuara në disa drejtime, që shtrihen nga evitimi i shkaqeve që mund të rrezikojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, e deri te masat për pengimin ose ndalimin e agresioneve[105] në rastin konkret efektet negative nga proceset e migracionit, kontrabandës me migrantë dhe të trafikimit me qenie njerëzore të cilët janë të lidhura njëra me tjetrën.

2. Disa teori mbi dukurinë e proceseve të migracionit

[97] Стратегија . “Демографски развој на Република Македонија 2008-2015”. Скопје, 2008, fq.13
[98] Po aty, fq.14
[99] Резолуција. “Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020”. Скопје, 2015, fq.6
[100] Po aty
[101] Po aty
[102] Strategjia shtetërore. “Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018”. Prishtinë, 2013, fq.7
[103] Филиповски, Зоран. “Меѓународни организации”. Скопје, 2017, fq.111
[104] Kval. Mellbye. Tranoy. “Politika dhe Demokracia”. Prishtinë, 2006, fq.148
[105] Gruda, Zejnullah . “E Drejta Ndërkombëtare Publike”.Prishtinë, 2005, fq.323

Çështja e dukurisë së proceseve të migracionit mundë të analizohet dhe shqyrtohet në shumë aspekte dhe ate: në aspektin sociologjik, demografik, kulturor, ekonomik, politikë po edhe juridiko penal. Nga kjo del se studimet mbi proceset e migracionit kanë një qasje ndërdisiplinare dhe multi-metodike. Por këndvështrimi sociologjik i studimit të dukurisë së migracionit është më gjithpërfshirëse duke u bazuar në ate se emigrimi në shkencat sociale analizohet si një fenomen shoqëror, sepse përfshin edhe faktorët socio-kulturor që ndikojnë në marrjen e vendimit për të emigruar, analizimin e procesit të emigrimit si faktor ndikues në ndryshimet të strukturës sociale të vendeve të origjinës dhe pritëse, analizimin e faktorëve ndikues të rëndësishëm në jetën sociale të emigrantëve, vështirësitë dhe lehtësimet me të cilat ata përballen gjatë përshtatjes dhe integrimit në vendin e origjinës, si dhe analizën e kapitalit social të emigrantëve etj.[106] Pra, përmes këndvështrimit sociologjik analizohet migracioni si dukuri sociale-shoqërore që ka ndikim edhe në shtetin e origjinës nga ku edhe emigrojnë, në shtetet e tranzitit ku ata kalojnë dhe në shtetin e destinacionit ku ata e kanë edhe qëllimin përfundimtar të vendosjes si migrantë. Për shqyrtimin e proceseve të migracionit, si dukuri globale gjatë historisë së migracionit ekzistojnë teori të ndryshme që e trajtojnë këtë dukuri. Shumica e teorive të poshtë përmendur mundohen në një farë mënyre të paraqesin shkaqet kryesore se pse njerëzit migrojnë prej vendeve të tyre të origjinës. Megjithëse kjo gjë është përmirësuar kohët e fundit, administrimi i rrjedhës migruese është bërë dhe mbetet pjesë integrale e procesit të Stabilizim Asociimit[107] dhe në të ardhmen do të kemi permanent hapa në pajtueshmëri me aktet ndërkombëtare për çështjen e migracionit.

Sot në kohën moderne dhe bashkëkohore, për të kuptuar më mirë shkaqet e lëvizeve të migracionit duhet të kthehemi që nga paraqitja e saj pra që nga paraqitja e njerëzimit e deri më sot. Në shekullin XXI, koncepti i dukurisë së migracionit, në njërën anë shfaq karakteristikat e saja historike, kurse në anën tjetër shfaq karakteristika të reja të fituara gjatë aktit të emigracionit.[108] Prandaj, në studimet që kanë të bëjnë me migracionin, teoritë që e studjojnë këtë dukuri analizojnë shkaqet individuale dhe strukturore të migracionit dhe efektet e këtyre shkaqeve në formimin e migracionit në përgjithësi.

2.1. Teoria e Ligjeve të Ravenstein-it

Studimi i parë shkencor të dukurisë së proceseve të migracionit që e njeh historia është bërë në vitet 1885 deri 1889 nga ana e ***Ravensteinit*** dhe në sociologji njihet si teoria e parë mbi migracionin e cila u bë edhe nxitës të paraqitjes së teorive tjera. Por para kësaj periudhe, për të vërtetuar ekzistimin e disa proceseve lidhur me migracionin, ai që nga viti 1840 u përpoq të përcaktojë ndryshimet në lëvizjet e popullsisë duke shqyrtuar të dhënat e regjistrimit të popullsisë të Anglisë, Uellsit, Skocisë dhe Irlandës që ishin në kuadër të Mbretërisë së Bashkuar, duke i përdor të dhënat që i kishte në dispozicion të fituara në 1871 dhe 1881 si të dhëna të fundit të regjistrimit të popullsisë.[109] ***Ravenstein*** përcaktoi njëmbëdhjetë rregullat që ndikuan në migrimin e brendshëm (imigrimin) dhe më të jashtëm në shoqërinë angleze.[110] Për të kuptuar më mirë vlerën e metodologjisë që e ka përdorur ***Ravensteini*** para aprovimit të Ligjeve, duhet të kemi parasysh

[106] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.59

[107] Strategjia kombëtare. "Migracioni dhe plani i veprimit për migracionin". Tiranë, 2005, fq.1

[108] Sever, Muhammed. Disertacion i doktoraturës "Türkiye'yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ", Ankara. 2015, fq.35

[109] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.95

[110] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.63

edhe kushtet socio-ekonomike të periudhës e cila ka qenë edhe si baza kryesore e studimit si dhe të dhënat që i ka pasur në dispozicion në atë periudhë kohore.[111]

A.Quetelet, matematikani dhe statisticieni belg në fillim të shekullit të kaluar i pari vuri në dukje rëndësinë kriminogjene të krizave ekonomike dhe depresionit[112], të cilët janë edhe shkaktarë të migracionit por edhe të veprave penale. Sidomos, pas zhvillimit të industrializimit në vendet Evropiane dhe rritjes së numrit të emigrantëve, teoria e ***Ravenstein-it*** ndikoi në analizimin e dimensioneve sociale të migrimit social.[113] Gjatë periudhës së lartëpërmendur ***Ernest G.Ravenstein*** dhe ***Grigg*** në lidhje me ligjet e migracionit, publikuan dy artikuj për migracionin ku përmenden edhe 11 ligjet e emigrimit dhe ate:

1. Shumica e migrantëve lëvizin vetëm në distanca të shkurtëra,
2. Migrimi vazhdon hap pas hapi,
3. Migrantët që shkojnë në distanca më të gjata në përgjithësi shkojnë sipas preferencës së tyre në një nga qendrat e mëdha të tregtisë apo industrisë,
4. Çdo rrymë e migrimit prodhon një kundër rrymë kompensuese,
5. Vendasit e qyteteve janë më pak migrues sesa ato të zonave rurale,
6. Brenda Mbretërisë së Bashkuar ku kanë lindur femrat më shumë migrojnë sesa meshkujt, por meshkujt më shpesh bëjnë përpjekje për tej,
7. Shumica e emigrantëve janë të rritur: rrallë migrojnë me familjet e tyre jashtë qarkut të tyre të lindjes,
8. Qytetet e mëdha rriten më shumë me migrim sesa me rritje natyrore,
9. Vollumi i migrimit rritet sepse zhvillohet industria dhe tregtia dhe transporti përmirësohet,
10. Drejtimi kryesor i migrimit është nga zonat bujqësore në qendra të industrisë dhe tregtisë,
11. Shkaqet kryesore migrimit janë ato ekonomike.[114]

Pra, ***Ligjet e Ravenstein-it*** që nga ajo kohë e deri sot në botën bashkëkohore shërbejnë shkencës për përkufizimin e modeleve të reja të proceseve të migracionit. Kjo Teori me njëmbëdhjetë ligjet e saj tregon se shkaqet e lëvizjeve të migracionit të njerëzve bazohen në ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe ate si faktor kryesor e llogaritë faktorin ekonomik, më pas industrializmi dhe urbanizmi i vendbanimeve, preferencat e individëve për një jetë më të mire dhe punësimi dhe kushtet në vendet e punës. Përveç faktorëve ekonomikë, në lëvizjet migruese ndërkombëtare kanë ushtruar ndikim edhe determinantet joekonomike, çfarë janë shkaqet politike, persekutimet etnike, fetare, racore, pastaj motivet individuale-psikologjike, familjare etj.[115] ***Ravensteini*** thotë se variablat jo-ekonomike siç janë regjimet shtypëse, taksimi i rëndë dhe kushtet e këqija klimatike nuk mund të hyjnë në dimensionin e valës së migrimit që individi ka krijuar për përfitim ekonomik.[116] "Ligjet e këqija dhe shtypëse kanë shkaktuar dhe kanë vazhduar të shkaktojnë lëvizjet emigruese, taksa të rënda, kushte klimatike jo të këndshme, mjedis të papërshtatshëm social dhe madje edhe presion (tregtia e skllevërve, izolim). Megjithatë, asnjë nga këto rryma nuk mund të krahasohet me mëshirën e migrantëve duke marrë parasysh vëllimin e

[111] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.94
[112] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.166
[113] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.63
[114] Grigg, Daniel.B. 'E.G.Ravenstein and the 'laws of migration'. Journal of Historical Geography, No:3, fq.41-54; 1977; fq.2 dhe 3
[115] Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012, fq.38
[116] Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës "Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan tıcareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede uluslararası işbirliği". Istanbul, 2010, fq.38

migrimeve të njerëzve që është si pasojë e dëshirës së madhe për të jetuar një jetë më të mirë".[117] Puna e Ravenstein-it ndikoi dukshëm në krijimin e teorive të mëvonshme të migrimit: modelin shtytës-tërheqës dhe modelin ekonomik neoklasik.[118]

2.2. Teoria e Modelit shtytës-tërheqës

Kjo teori prej vet emërtimit të saj nënkuptojm se për të migruar një person duhet të ekzistojnë faktorë që do të shtyjnë personin në vendimarje për të migruar nga vendbanimi i tij ku jeton drejt vendeve tjera, kurse në anën tjetër tërheqës janë faktorët të cilët do të ndikojnë tek personi të zgjedh vendin e destinacionit ku do të migrojë. Po edhe sot, migrimet qoftë të brendshme ose të jashtme ndodhin përshkak të faktorëve shtytës në vendin e origjinës dhe faktorëve tërheqës në vendin e destinacionit.Teoria e Modelit shtytës-tërheqës u krijua në vitin 1966 nga ana e ***Everet Lee*** e cila me kalimin e kohës edhe u përsos nga ana e studjuesve tjerë. Sipas ***Lee***, si faktor nxitës dhe tërheqës të emigrimit konsiderohen informacionet që individët marrin prej personave që kanë emigruar më parë.[119] ***Lee***, përcakton katër faktorët të cilët lidhen me:1. vendin e origjinës, 2. vendin e destinacionin, 3. pengesat ndërhyrëse dhe 4. karakteristikat personale të migrantit. Sipas tij ka tre tipe faktorësh që ndërhyjnë në origjinë dhe destinacion: (+) faktorët që promovojnë migrimin, (-) faktorët që e pengojnë atë dhe (0) faktorët që nuk ndikojnë fare.[120] Lee mendon se lëvizjet migratore prej një vendi në vend tjetër shkak i dy proceseve dhe ate:

a) *Së pari*, ato fillojnë kur pesha e faktorëve që i shtyn njerëzit të largohen nga një vend është më e madhe se e atyre që i mban aty. Në mes faktorëve më të rëndësishëm shtytës janë rritja e shpejtë e popullsisë, varfëria dhe mungesa e mundësive ekonomike si dhe shtypja politike.
b) *Së dyti*, ndodhin kur pesha e faktorëve që i tërheqin njerëzit drejt një tjetër lokaliteti është më e madhe se ato që e frenojnë largimin. Në mes faktorëve kyç që i tërheqin njerëzit drejt një tjetër shoqërie janë mundësitë e punësimit, paga më të larta sesa në vendin ku banojnë, mundësitë për të përvetësuar tokë, dhe liri politike dhe kulturore.[121]

Sipas kësaj teorie migrantët duke e njohur vendin e tyre të origjinës shumë më mirë në lidhje me kushtet e jetesës, punësimet dhe kushtet e punës, kushtet sociale dhe shëndetësore, kushtet klimatike, lufëra, përdorimi i dhunës, ata vendosin të migrojnë në vende për të cilët kanë shumë pak informata ose aspak në lidhje me pritshmëritë e tyre, ku shpesh ndodhën që të mashtrohen me pritshmlritë në vendin e destinacionit, e cila llogaritet edhe si faktorë që ndikon në devijimin e migracionit dhe më pas në vendosjen e migrantëve që ilegalisht të migrojnë. Në veçanti, gjatë lëvizjeve migratore prej një vendi (shteti i origjinës) drejt një vendi tjetër (shteti i destinacionit) individët që migrojnë mund të hasin në pengesa si në shtetin e origjinës dhe destinacionit poashtu edhe gjatë rrugëtimit[122] ose në vendet tranzite. Shkak tjetër i pamohueshëm janë edhe faktorët që lidhen me dëshirat personale të njerëzve pa ndonjë ndikim nga jasht të emigrojnë drejt vendeve të

[117] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, vep. e cit., fq.98.
[118] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.35
[119] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.55
[120] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.35
[121] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.35
[122] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.108

tjera. Faktorët e grupit të tretë janë ato të pengesave ndërhyrëse kur migrantët gjatë udhëtimit të largët drejt vendit të destinacionit sidomos në vendet tranzite përballohen me pengesa të shumta qoftë ligjore, shpenzime udhëtimi, ushqimi ose strehimi, shtypje dhe kufizime të ndryshme gjatë migrimit, pengesa për gjetjen e transportit të duhur dhe problemet gjatë transportit, bariera fizike etj.

Kjo Teori si faktorë të migrimit të individëve nuk e llogaritë shumë luftën, pushtimet, dhunën por më shumë si faktorë kryesor e llogaritë shkaqet ekonomike gjegjësisht pagesat e ulëta. Faktorët që ndikojnë në vendim, kanë të bëjnë me shumëllojshmërinë e mundësive të punësimit dhe pagesat e larta.[123] Pra, kjo teori nuk e analizon në tërësi dukurin e proceseve të migracionit sepse fokusimi i këtij modeli ka të bëj vetëm me iniciativën e migrantëve dhe faktorët shtytës dhe tërheqës kurse nuk e tangojn karakteristikat sociale, kulturore, shëndetësore, arsimore etj. Si përfundim, kjo teori është e bazuar në emigrimin e forcave punëtore, të cilat nëpërmjet vendimmarrjes për shkak të faktorëve ekonomik të dobët, nxisin emigrimin dhe faktorët ekonomik të zhvilluar të vendeve pritëse, të cilët tërheqin këta emigrantë dhe formohen kështu rrymat emigratore.[124] Nëse e analizojmë në praktikën bashkëkohore këtë teori, sot, kemi kategori të emigrantëve që kanë migruar si fuqi punëtore në shtete evropiane ku edhe punojnë të cilët përveç se përfitimit material nuk i marrin parasysh dhe nuk i llogarritin përfitimet tjera siç janë përfitime kulturore, shëndetësore, arsimore, politikat e punësimit dhe pensionimit, politikat e marrjes dhe vazhdimit të lejeve të qëndrimit dhe të punës etj. Sipas Lee-it, përveç faktorëve ekonomikë dhe socio-kulturorë të vendit të origjinës, shkaqet individuale dhe familjare, fqinjët dhe komunitetet më i gjërë të mjedisit ku jeton mund të jenë shkak i migrimit.[125] Nga kjo nënkuptojmë se familjarët, fqinjët dhe personat që i njohin e që jetojnë jashta vendit mund të jenë thithës të tyre duke i dhënë një siguri dhe ndihmë gjatë emigrimit drejt vendeve të destinacionit ose siç njihet në terminologjinë e migracionit si *bashkim familjar*. Të afërmit e migrantëve në shtetet e destinacionit mund të ndihmojnë në periudhën e adaptimit, djetjes së strehimit, tejkalimin e barierave gjuhësore, dhetjen e punës, ushqimit dhe nevojat tjera financiare derisa të rregullohet migranti.

2.3. Teoria e Oportunitetit Ndërhyrës

Teoria e mundësive ndërhyrëse përmendet së pari në vitin 1940 nga ***Samuel A. Stouffer***, i cili ka punuar në statistikat e popullsisë të shtetit amerikan të Cleveland, Ohio.[126] Në përgjithësi kjo teori ka të bëjë të drejtat personale të migrantëve dhe shkaqet e vendimeve në lidhje emigrimin nga vendbanimet e tyre të përhershme, ku sipas nevojës intervenohet në përmirësimin e nevojave të migrantëve që nënkupton ndërhyrjen ndaj migrantëve. Sipas kësaj teorie gjatë proceseve të migracionit duhet të analizohen edhe mundësitë dhe shpenzimet e saj në vendet e destinacionit, pra të shihet si janë mundësitë për të migruar dhe për punësim. Prandaj sipas tij, numri i njerëzve që do të emigrojnë në një distancë të caktuar është drejtpërdrejt proporcional me shumëllojshmërinë e mundësive të punësimit në këtë vend.[127] Kështu që vijmë në përfundim se kjo teori ka për detyrë të analizojë rëndësinë e mundësive që ofrojnë vendet e origjinës dhe vendet

[123] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, vep. e cit., fq.66

[124] Po aty

[125] Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës "Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan tıcareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede ululararası işbirliği". Istanbul, 2010, fq.49

[126] Sever, Muhammed. Disertacion i doktoraturës "Türkiye'yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ", Ankara. 2015, fq.46

[127] Po aty

e destinacionit në vendimmarrjen e individëve për të migruar. "Oportunitetet" mund të përcaktohen si shtëpi bosh ose disponibël, mundësi punësimi, lehtësira sociale, ose faktorë të tjerë të ngjashëm tërheqës.[128] Për uljen e numrit të individëve që dëshirojnë të migrojnë për shkaqe ekonomike dhe sociale vendet e origjinës mund të marin hapa të tilla të cilët sado pak do të zbusin numrin e migrantëve që dëshirojnë të ikin nga vendet e tyre. Forma të tilla të hapave të vendeve mund të tërheqin migrantë edhe nga jashtë siq bëjnë sot shtetet e zhvilluara duke thithur fuqi punëtore nga vendet jo të zhvilluara ku mundësia e punësimit është shumë e ulët dhe me paga minimale.

2.4. Teoria Neo-klasike ose Ekonomike

Prej vet emërtimit Neo-Klasik ose Ekonomik nënkuptojm lëvizjet e migracionit të individit ose të njerëzve në kuadër të një shteti (migrim i brendshëm) dhe prej një shteti në një shtet tjetër (ndërkombëtare) për arsye ekonomike. Pra, nga kjo del se, sipas Teorisë neo-klasike migrimet e brendshme dhe ndërkombëtare edhe pse mes veti kanë dallime të shumta, ato kanë edhe pika të përbashkëta e cila shihet edhe me faktorin ekonomik si pikë e përbashkët që ndikon në lëvizjet e njerëzve për punësim dhe përfitim material qoftë brenda apo jashta shtetit. Kur themi arsye ekonomike ato janë kushtet jo të mira ekonomike për punësim dhe paga jo solide në vendin e tyre të origjinës në njërën anë, barazia gjinore në vende të punës dhe gjatë aplikimit për punë, kurse në anën tjetër në shtetin e destinacionit ose nëse kemi migrim të brendshëm në vendbanimin e destinacionit ekzistojnë më shumë oferta për punë, kushte më të mira të punës dhe paga më të mira. Për, arsyet e lartëpërmendura pjesa dërmuese njerëzve qoft individualisht ose në grupe, nga vendet më pak të zhvilluara lëvizin drejt shteteve më të zhvilluara sidomos në qytete të mëdha dhe shtete evropiane të zhvilluara po edhe më tej drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila llogaritet si shteti me ekonomi më të fuqishme botërore. Neo-Klasike është bazuar në ekonominë e një vendi, që e analizon emigrimin drejt vendeve të zhvilluara në raport me mungesën e fuqisë punëtore dhe me kapitalin, pra duke u bazuar në elemente ekonomike[129], në vendet e origjinës. Kështu pra, në teorinë neoklasike emigranti si individ vendos racionalisht të kalojë nga shoqëria "tradicionale" në atë "moderne" për të kontribuar në zhvillimin qoftë të shoqërisë së origjinës, qoftë në atë pritëse, duke ridimensionuar pabarazitë mes këtyre shoqërive.[130] Pra, proceset migratore sipas Teorisë Neo-Klasike ose Ekonomike mund t'i ndajmë në grupe:

1. Procese migratore në relacion rural-rural (fshatra më pak të zhvilluara sidomos fshatrat malësore në fshatra më të mëdha ku ka hapësirë për të punuar)
2. Procese migratore në relacion rural-urban (lëvizje nga fshatrat në qytete më të afërta)
3. Procese migratore në relacion urban-urban (lëvizje nga qytete të vogla dhe me ekonomi të dobët në qytete më të mëdha dhe me ekonomi të zhvilluar, më shpesh lëvizin drejt kryeqytit)
4. Procese migratore në relacion urban-rural (lëvizje që u përhapë viteve të fundit duke u bazuar se në qytetet e mëdha dhe të zhvilluar një numër solid lëvizin drejt fshatrave përeth dhe afër qytetit duke ikur nga ndotja e ajrit, zhurma duke kërkuar qetësi etj)

[128] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.37

[129] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.76

[130] Zenelaga, Brunilda. Disertacion i doktoraturës "Familja emigrante përballë sfidave të integrimit. Rasti i emgrantëve shqiptarë në rajonin e Toskanës, Itali". Tiranë, 2013, fq.19

5. Procese migratore ndërkombëtare në relacion shtet-shtet (lëvizje nga shteti i cili nuk i kënaq kushtet jetësore të njerëzve duke migruar në shtetin tjetër ku ka pritshmëri për një jetë më të mirë).

Sipas ***Massey***, individët si dhe familjarët e tyre bëjnë një analizë përfitimi ekonomik që vjen prej procesit të emigrimit.[131] Teoria neoklasike ekonomike presupozon se individët përpiqen të maksimalizojnë dobitë e tyre: individët "kërkojnë" për vendin e rezidencës që maksimalizon mirëqenien e tyre.[132] Duke u bazuar në dallimet e mëdha të pagave për fuqi punëtore sidomos në shtetet evropiane dhe në anën tjetër shumë shtete tjera sidomos shtetet Afrikane dhe ato joevropiane cilët me pagat në shtetin origjinë nuk munden t'i mbulojnë shpenzimet primare, edhe në shekullin XXI ky faktor mund të llogaritet si një ndër faktorët kryesor. Epërsia e provave nga të gjitha tregjet botërore, tregon se diferenca në paga është faktori më i favorizuar i ekonomisë Neo-Klasike.[133] Në kohën e krizave ekonomike, domethënë, mungesa e të mirave materiale vjen në një rritje të madhe dhe të shpejtë të çmimeve që tejkalojnë normat e fuqisë blerëse të shtresave më të gjera të popullsisë.[134] Në lidhje me migrantët si subjekte që marrin pjesë në proceset migratore dallohen:

2.4.1. ***Teoria Neo-Klasike mikro-ekonomike*** lëvizjet migratore të brendshme dhe ndërkombëtare e lidh me vullnetin dhe dëshirën individuale të migrantëve për të emigruar drejt shteteve të zhvilluara për shkaqe ekonomike dhe për paga më të larta. Pra, qasja individualiste strukturore e propozuar nga ***Coleman*** (1990) shpjegon procesin e migrimit duke analizuar veprimet individuale.[135] Njerëzit zgjedhin të lëvizin atje ku mund të jenë më produktiv, bazuar në aftësitë e tyre; por para se të kapin pagat më të larta të lidhura me produktivitetin më të madh të punës, ata duhet të ndërmarrin disa investime që përfshijnë kostot e udhëtimit, kostot e vetëmbajtjes ndërkohë që lëvizin dhe kërkojnë punë, përpjekjet për mësimin e një gjuhe dhe të një kulture të re, vështirësitë e përjetuara gjatë përshtatjes në një treg të ri pune, dhe kostot psikologjike të ndërprerjes së lidhjeve të vjetra dhe krijimit të lidhjeve të reja.[136]

2.4.2. ***Teoria Neo-Klasike makro-ekonomike*** lëvizjet e brendshme dhe ndërkombëtare shkak i ekonomisë dhe pagave të ulëta ndikon tek njerëzit të lëvizin në vendet e zhvilluara me ekonomi dhe paga më të larta, pra në vende destinacioni ku edhe shpresat janë të mëdha për përmirësimin e kualitetit jetësor. Migrimi pra është "zhvendosja e krahut të punës si kundërpërgjigje ndaj nevojave të tregut", shkalla e së cilës mund të lëvizë nga një hapësirë lokale deri në shkallë globale.[137] Në jetën e përditëshme njerëzit të cilat kanë migruar para një kohe më të gjatë me arritjen e përmirësimit të standardit jetësor ata prap nga ai shtet kërkojnë të lëvizin në ndonjë shtet tjetër ku pagat janë edhe më të

[131] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.76

[132] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.40

[133] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.76

[134] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.166

[135] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.40

[136] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, vep. e cit., fq.40

[137] Po aty

larta duke mos e pranuar më pagën e arritur si pagë e lartë, kështu që lëvizjet migratore janë permanente dhe varet edhe nga planet personale të individëve.

2.5. Teoria e rrjeteve të emigrantëve dhe Ekonomia e re e migrimit

Vullneti apo detyrimi i vazhdueshëm dhe permanent të njerëzve për të migruar nga vendet e tyre të origjinës që është rezultat i faktorëve shtytës dhe nxitës drejt vendeve të sidurta dhe me ekonomi zhvilluar ndikon në daljen në shesh të Teorisë së rrjeteve dhe Ekonomisë së re të migrimit në jetën e përditëshme e cila është prezente edhe sot e kësaj dite. Në krahasim me teoritë e mëparshme që e arsyetojnë migrimin si pasojë e një ose dy shkaqeve, kjo teori për nga natyra e analizës së proceseve të migracionit është më gjithpërfshirëse që në vete ngërthen më shumë arsye se pse njerëzit vendosin të migrojnë dhe ate: shkaqe të luftërave dhe persekutimeve, ekonomike, sociale, kulturore, bashkim familjar, pabarazia gjinore në punë, punësimi, përfitime më të larta materiale etj. Në lidhje me emërtimin e Teorisë së rrjeteve dhe Ekonomia e re migrimit, në shumë literatura dhe publikime mund të gjejm edhe emërtimet siç janë: zinxhiri i migacionit, migracioni kumulativ, migracioni i vazhdueshëm ose permanent. Këto janë emërtime që kanë të përbashkët ate se lëvizjet e migracionit të njerëzve bëhen përmes formimit te rrjeteve miqësore, farefisnore, familjare, në mes personave që dëshirojnë të migrojnë dhe migrantëve që veç më kanë migruar jashta vendit të origjinës. Personat që dëshirojnë të migrojnë quhen edhe si migrantë potencial të cilët shprehin dëshirë të migrojnë përmes kontakteve dhe informacioneve që marrin parparakisht nga familjarët dhe miqtë migrantë në vendet e destinacionit në lidhje me rrjedhojën e procesit të migracionit nga vendi i origjinës, tranzitit dhe në vendin e destinaionit. Informacionet kanë të bëjnë me transportin, procedurat në kufijt shtetëror, shpenzimet, pengesat dhe vështirësit eventuale gjatë transportit, strehimi, ushqimi, pengesat gjuhësore, dokumentet e nevojshme, punësimi dhe shumë informacione të tjera. Rrjetet e migrantëve janë vendosje lidhjesh ndërpersonale ndërmjet migrantëve, ish migrantëve dhe jomigrantëve në vendet origjinë dhe destinacion nëpërmjet lidhjeve të gjakut, miqësisë dhe komunitetit të përbashkët të origjinës. Ato e rrisin mundësinë e lëvizjeve ndërkombëtare sepse ulin kostot dhe riskun e lëvizjeve dhe rrisin përfitimet e pritshme nga migrimi dhe kështu tek rrjeti I tyre krijohet një ekonomi e re. Lidhjet e rrjeteve përbëjnë një formë të kapitalit social që njerëzit mund të ndërtojnë në mënyrë që të gjejnë akses në punësimin jashtë.[138] Pra, për formimin struktural të rrjeteve të emigrantëve mes individëve në shtetin e origjinës dhe individëve në shtetin e destinacionit realizohet përmes *informacioneve tërheqës-lehtësues* në shtetin e destinacionit sipas të cilit mundësohet në një vendimmarje më të lehtë ose e fuqizojnë vullnetin për të emigruar, nga ana e familjarëve migrantë të cilët japin informacione pozitive paraprake në lidhje me procedurat e punësimit, banimit, dokumentacionit, rregullimin social, shëndetësor dhe arsimor, si dhe vështirësitë e mundshme të udhëtimit, pengesat gjuhësore dhe pengesave të tjera me qëllim të lehtësimit të emigrimit përfundimtar me shpenzime minimale dhe me hapa të sigurta.

Duke u bazuar në statistikat dhe studimet e ndryshme në fushën e emigrimit, vihet re se migrantët me origjinë nga i njejti vend emigrojnë drejt një vendi, si dhe shumë prej tyre punojnë në të njëjtat vende pune,[139] ky lloj vërehet edhe tek shtetasit e Republikës së Maqedonisë, ku familjarët emigrantë sidomos ato që janë më të pasur dhe me biznese i tërheqin familjarët e vet e cila në një

[138] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, vep. e cit., fq.41

[139] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.71

farë mënyre nënkupton edhe bashkim familjar. Sipas ***Wilpert***, teoria e rrjetit dhe rrjeti i emigrantëve punojnë si më poshtë: Emigrantët kryesorë krijojnë një infrastrukturë ose lidhje që lidh burimet e emigrantëve dhe shoqëritë e synuara.[140] Me këtë teori qëllimi kryesor i proceseve të migracionit është se emigrimet bëhen duke i grumbulluar të afërmit jomigrantë për të migruar, duke vazhduar emigrimin e vazhdueshëm familjar, duke u transferuar në zinxhir të emigrimit në relacion vend origjine dhe vend destinacioni për një ekonomi të re dhe më të mirë, duke formuar rrjetet e forta strukturore të emigrimit. Kjo teori ndikon në formimin e rrjeteve të forta strukturore të cilat janë aktiv edhe gjatë migracionit të bredshëm edhe ndërkombëtar. Pra, rrjetet social të emigrantëve mundësojnë themelimin e rrjeteve transnacionale ose ndërkombëtare të emigrimit.[141]

2.6. Teoria e Sistemit transnacional (botëror) dhe Modeli i Globalizmit

Nga vet emërtimi i kësaj teorije nënkuptojmë se kjo teori përqëndrohet në lëvizjet e migracionit të njerëzve prej një shteti në një shtet tjetër e cila në vete ngërthen lëvizjet drejt shteteve fqinje ose edhe më larg, pra njihen si lëvizje transnacionale, ndërkombëtare ose botërore. Lëvizjet në shtetet fqinje është më e shpeshtë për shumë arsye si p.sh., punët sezonale, mospasja e pengesave gjuhësore, largësisë, transportit, shpenzimeve për shkak të largësisi etj. Sa i takon lëvizjeve më të largëta transnacionale, si shtete të destinacionit janë shtetet evropiane me ekonomi të zhvilluar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtete të cilat gjithashtu kanë nevojë për fuqi punëtore kështu që këtu kemi edhe punësime për periudha të ndryshme kohore. Kjo teori e cila viteve të fundit në botën bashkëkohore ka një rol të veçantë sepse më bota shkon drejt një unifikimi në të gjitha sferat e saj ku rol më të madh ka ekonomia sidomos tregu i punës dhe të drejtat universale pa marrë parasysh vendin se ku jeton dhe punon. Me kapitalizimin e ekonomisë botërore dhe me zhvillimin e teknikës dhe të teknologjisë vendet e zhvilluara (destinacionit) dhe vendet e pazhvilluara (destinacionit) kanë formuar një urrë lidhjeje dhe është krijuar një sistem botëror e quajtur globalizim. Viteve të fundit globalizimi ka ndikuar në masë të madhe që shtetet e pazhvilluara, popujt që dëshirojnë të migrojnë e kanë shumë lehtë që sot përmes teknologjisë pa shpenzime shtesë të interesohet, të marrin informacione në lidhje me shtetin dhe sistemin shtetëror të vendit ku a kanë qëllimin të migrojnë.

Në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, Teoria e Sistemit të emigracionit në baza ekonomike dhe politike bazohet në shkëmbimin reciprok të emigrantëve midis dy ose më shumë vendeve për të formuar një sistem imigrimi dhe një zinxhir marrëdhëniesh.[142] ***Wallerstein*** e ka mohuar klasifikimin e rendit botëror (në bazë të nivelit të sipërrmarjeve të kapitalizmit, industrializimin dhe urbanizimin), duke këmbëngulur në argumentin se ekziston një botë ku gjithë shoqëritë janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura prej tij, nëpërmjet rrugës së kapitalizimit ekonomik, pra shoqëri në një sistem botëror modern e cila është edhe fillimi i Teorisë së Globalizimit.[143] Shumë shtete të zhvilluara sipas kësaj teorije duke e përqëndruar kapitalin botëror në shtetet e tyre dhe duke e bërë si epiqendër të ekonomisë, kanë ndikuar në masë të madhe në emigrimin e popujve

[140] Sever, Muhammed. Disertacion i doktoraturës ”Türkiye’yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ”, Ankara. 2015, fq.52

[141] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës “Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990”. Tiranë, 2015, vep. e cit., fq.69

[142] Sever, Muhammed. Disertacion i doktoraturës ”Türkiye’yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ”, Ankara. 2015ö fq.50

[143] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës “Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990”. Tiranë, 2015, fq.74

të vendeve të varfëra duke ofruar shumë vende pune për profile të ndryshme. Emigrantët në këto shtete të zhvilluara shpesh janë të pabarabarta në lidhje me pagesatpër punët e kryera në krahasim me shtetasit e vet. Emigrantët shpesh punojnë me orar të zgjatur dhe me paga më të ulëta sesa punëtorët vendas. Sipas ***Wallerstein***, në sistemin botëror është zhvilluar një ndarje globale, duke u bazuar në kategorizimin e shteteve sipas pasurisë dhe zhvillimit ekonomik dhe ate: në periferi (vendet e pazhvilluara), gjysmë periferi (vende në zhvillim) dhe qendrën (vendet e zhvilluara).[144] Nga kjo del se vendet në periferi janë vende të varfëra me ekonomi të pazhvilluar dhe mundësi të rënda gjetje të punës, vendet në zhvillim janë ato vende cilët kanë një ekonomi solide dhe paga solide për të përmbushur kërkesat e veta dhe këto shtete shkojnë në rritje të ekonomisë, si dhe vendet qendra ose vende të zhvilluara cilët kanë ekonomi, industri dhe infrastrukturë shumë të zhvilluar të cilëve nevojiten edhe fuqi punëtore shtesë për ta përballuar atë industri. Gjegjësisht, procesi i industrializimit dhe migracionit konsiderohet të ketë pasoja të ndryshme sociale në zonat urbane të zhvilluara.[145]

Sipas, kësaj që u përmend më lartë për këtë teori shihet se ky sistem botëror dhe globalizimi është faktori kryesor i emigrimit të njerëzve në nivel botëror nga vendet e pazhvilluara drejt vendeve të zhvilluara për arsye të fuqisë punëtore. Teoria e Sistemit botëror dhe Modeli i Globalzimit, sugjeron se gjatë procesit të përfshirjes në vendet e zhvilluara, vendet kapitaliste zhvendosin ekuilibrin në ekonomitë e reja, influencën sociale, kulturore dhe politike, si dhe nxisin motivimin për të emigruar, duke i tërhequr emigrantët drejt vendeve kapitaliste.[146]

2.7. Teoria e Kapitalit social të migracionit

Kjo teori ka një lidhshmëri të ngushtë me Teorin e rrjeteve të emigrantëve, sepse kjo teori duke u përqëndruar në vlerat sociale dhe kulturore, me lidhshmëritë familjare dhe miqësore të migrantëve cilët veç më koh të gjatë jetojnë dhe punojnë jasht vendit të tyre pra, në ndonjë shtet destinacioni e lehtësojnë emigrimin e të afërme të tyre në aspektin social për çmime më të ulëta pra, duke ikur shpenzimeve të larta gjatë procesit të emigrimit dhe duke emigruar sigurt dhe për një periudhë më të shkurtër kohore. Pra, Teoria e kapitalit social vjen në shprehje duke realizuar emigrimin e familjarëve të cilët janë financiarisht të dobët ose të varfër përmes lidhjeve familjare kështu që formohen lidhjet e kapitalit social. Lidhjet mund të formohen edhe nëpërmjet të martesave, sigurimit të vizave, asistencave, finansimin dhe stimulimin e emigrimit jo të rregullt, mundësinë për strehim dhe punësim etj.[147] Kjo karakteristikë e kësaj teorie mund të vërehet edhe në Republikën e Maqedonisë edhe pse kemi martesa të personave që jetojnë jashtë vendit me persona të etnive dhe vendbanime të ndryshme më të largëta të bashkëshortit pra, jashta vendlindjes së tyre prap, pjesa dërmuese e martesave bëhen me persona të etnive të njejta dhe nga i njejti vend prej nga e ka prejardhjen.

Përmes kësaj teorie, jepet mundësia e përforcimit të raporteve farefisnore në të dy shtetet duke i hapur rrugët vazhdueshmërisë së këtij modeli të lëvizjeve të migracionit, ndikon shumë në lehtësimin e vendimmarrjes për të emigruar, si dhe ka efekt pozitiv në rruajtjen e vlerave kulturore, sociale, humane etj. Pra, del se për realizimin e kësaj dukurie të lëvizjeve të migracionit tek

[144] Po aty

[145] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164

[146] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.75

[147] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.67

individët ndikojnë vlerat sociale në shtetin e destinacionit, vlerat kulturore, lehtësimi i migrimit përmes lidhjeve familjare, punësimi etj. Migrantët gjatë lëvizjes së tyre nga vendi i origjinës në vete bartin edhe kulturën, traditën, identitetin, mënyrën e jetesës dhe kështu e kanë të patjetërsueshme sipas kësaj teorije të formojnë rrjete mes etniciteteve të njejta ose lidhjeve farefisnore dhe familjare sepse kështu ata do të ndjejnë veten të sigurt dhe të mbrojtur tek rrjeti i kapitalit social dhe do të kenë mundësinë e vazhdimsisë së kapitalit social.

3. Përkufizimi i migracionit dhe disa kuptime mbi problematikën terminologjike për migracionin

Përkufizimi i migracioni dhe zgjedhja e problematikës në lidhje me terminologjinë mbi migracionin do të ishte një hap dhe ndihmë e madhe shkencës dhe lehtësim për hartimin e politikave migratore të shteteve të cilat mirren me çështjen e fenomenit të migracionit. Sot, nëpër libra, artikuj, shkrime si dhe në konferenca hasim në debate të ndryshme në lidhje me përdorimin e termeve joadekuate mbi fenomenin e migracionit ku shpesh hasim në emërtime të gabuara dhe jo të sakta të termeve dhe përkufizimeve në lidhje me proceset e migracionit.

3.1. Përkufizimi i migracionit

Dukurisë së lëvizjeve të migracionit gjegjësisht migracionit duhet një përkufizim i vetëm dhe unik e cila do të jetë e pranuar në të gjitha vendet e botës. Por, një përkufizim të vetëm dhe unik është shumë e rëndë ose e pamundur sepse për të kuptuar dhe pasur një qasje të pastër rreth migracionit duhet të kemi parasysh se shumë terma dhe koncepte që përdoren sot prejardhjen e kanë që nga kohërat primitive sidomos në shekullin e XIX, kur dalin në sipërfaqe shkencat shoqërore për studimin e kësaj dukurie. Andaj, përkufizimi i migracionit është një çështje e ndërlikuar përshkak se migracioni sidomos migracioni ndërkombëtar është një fenomen shumë dinamik, e përzier dhe me përmasa të mëdha si dhe është në lëvizje të vazhdueshme,[148] e cila viteve të fundit paraqitet me forma të reja të saja dhe për këtë arsye paraqiten edhe paqartësi gjatë definimit të kësaj dukurie. Fjala migrim vjen nga gjuha latine ***migrare, migratio, migro*** që do të thotë migrojë, migrim, shtegtoj, shtegtim[149], lëvizje, zhvendosje etj. Për përkufizimin sa më të qartë duke përfshirë të gjitha aspektet rol të madh luan edhe roli i dimenzioneve që ka paraparë ***G.Standing***, i cili paralajmëron se lëvizshmëria territoriale si pjesë përbërëse të saj përfshin katër dimenzione cilët shpesh janë konfuze dhe nuk dallohen por janë të rrëndësishëm për të kuptuar më mirë dhe gjërësisht fenomenin e lëvizshmërisë dhe në veçanti të migracionit 1) para së gjithash, fenomeni i lëvizshmërisë nënkupton një lëvizje fizike nga një vend në tjetrin, 2) një aspekt tjetër i lëvizjes në hapësirë ose duke lënë një hapësirë është distanca, 3) aspekti i tretë i lëvizjes së popullsisë është dimensioni i përkohshëm që nënkupton se sa gjatë duhet njerëzit të mungojnë nga ndonjë vend që të llogaritet migrant, dhe 4) aspekti i veprimtarisë që nënkupton se një person mund të ndryshojë vendin e veprimtarisë pa ndryshuar vendbanimin e përhershëm ose të zakonshëm, si dhe dikush mund të ndryshojë vendbanimin e vet por duke qëndruar në të njëjtën veprimtari.[150]

Termi "migracion" shpreh fenomenin e natyrës demografike të lidhur me transferimin e një personi apo të një grupi njerëzish nga një territor i origjinës në një tjetër ku vendosen përkohësisht

[148] Öner, S.Gülfer-İlhamur. Öner, Aslı-Şirin. "Küreselleşme Çağında Göç". Istanbul, 2016, fq.13
[149] Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012, fq.17
[150] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.241

apo përfundimisht.[151] Pra, migracioni është një lëvizje në kuadër të territorit të shtetit ose transnacional të individit ose të grupit të individëve prej një vendi të origjinës në një vend tjetër destinacioni që bazohet në shkaqe të ndryshme për periudhë të caktuar kohore ose migrim i përhershëm.

3.2. Disa kuptime mbi problematikën terminologjike për dukurinë e migracionit

Për shkak të ekzistimit të llojeve dhe formave të ndryshme të proceseve të migracionit e cila varet direkt nga faktorët shtytës dhe ato nxitës ekzistojnë shumë terme për këtë dukuri. Duke u bazuar në atë se vet terminologjia e proceve të migracionit është në zhvillim të vazhdueshëm dhe permanent dhe zhvillohet paralel me me format e shfaqjes së saj sot ndodh që në vende të ndryshme dukuria e migracionit të konceptohet me terma të ndryshëm.

Edhe Republika e Maqedonisë po përballohet me këtë problematikë të përdorimit adekuat të terminologjisë për fenomenin e migracionit sidomos për format e saja. Shpesh nga ana e studjuesve, gazetarëve, zyrtarë shtetëror etj, një term përdoret në vend të një termi tjetër si p.sh. në vend të termit "refugjat" përdoret termi "migrant" ose e kundërta, përshkak se kjo dukuri në vendin tonë viteve të fundit filloj të jetë një ndër problemet më të mëdha dhe shkak i mungesës së konsolidimit të plotë të legjislacionit të Maqedonisë me legjislacionin e Unionit Evropian dhe aktet ndërkombëtare të kësaj fushe sidomos gjatë fluksit të migrantëve dhe rrefugjatëve në vitin 2015. Duke u bazuar në ate se me proceset e migracionit më shumë interesohet shkenca e sociologjisë ne do të mundohemi të paraqesim terminologjin edhe në këndvështrimin sociologjik.

Migracion, Migrim kuptojmë procesin e lëvizjes apo zhvendosjes së individit ose të një grupit të individëve prej vendbanimit të tij të përhershëm drejt një vendbanimi tjetër, për arsye të ndryshme, në suaza të kufijve shtetëror të shtetit ose jashta saj (ndërkombëtar), përkohësisht ose për përgjithmon. Migrimet paraqesin çdo ndërrim të vendbanimit të përhershëm të personave ose grupe të mëdha. Migrimi nënkupton ndërrimin e vendbanimit të zakonshëm me një vendbanim tjetër (komunë, regjion, shtet), apo zhvendosja nga një vendbanim në një vendbanim tjetër respektivisht: komune, regjion apo shtet tjetër.[152] Kjo është një shpërngulje e individëve, pavarësisht nga kohëzgjatja, përbërja dhe shkaqet.

Emigracion, Emigrim është largimi, lëvizja ose dalja nga vendbanimi i përhershëm drejt një vendbanimi tjetër në kuadër të shteti ose vendosja në një shtet tjetër.

Imigracion, Imigrim është ardhja e personit në vendin e origjinës, pra, në vendbanimin e tij paraprak, përgjithmon të vendoset nga vendi ku personi më herët ka qenë emigrantë ose në vend tjetër.

Migrim qarkullues kuptojmë fenomenin e një migracioni të përkohshëm, të përsëritur – migrantët kthehen në vendin e tyre njëherë ose disa herë brenda një periudhe kohore dhe se migrimi qarkullues është një lëvizje (kryesisht e përkohshme) e njerëzve midis dy ose më shumë vendesh e cila, kur lidhet në mënyrë të vetëdijshme me nevojat e vendit të origjinës dhe të destinacionit, mund të jetë përfituese për të gjithë të përfshirët në proces.[153]

Migracion i brendshëm është lëvizja e individit ose grup individësh në kuadër të territorit shtetëror të shtetit konkret. Migracioni i brendshëm ka të bëjë me lëvizjet e brendshme si p.sh.: prej vendeve rurale në urbane, prej vendeve urbane në urbane dhe prej vendeve urbane në vende rurale.

---

[151] Kraja, Blerta. Disertacion i doktoraturës "E drejta migratore dhe e azilit", Tiranë, 2012, fq.10

[152] Raport. "Migrimi kosovar". Prishtinë, 2014, fq.12

[153] Kraja, Blerta. Disertacion i doktoraturës "E drejta migratore dhe e azilit", Tiranë, 2012, fq.24

Migracion ndërkombëtar është migracioni apo lëvizja e individit ose grup individësh jashta shtetit shtetas i të cilit është drejt shtetit ose shteteve të tjera ku kërkohet kalimi i së paku një kufiri shtetëror.
Migrant është person apo individi i cili në mënyrë vullnetare ose detyruar dhe për arsye personale, lëviz nga vendi i tij i origjinës, në një destinacion të posaçëm, i detyruar ose jo për një gjë të tillë.[154] Fëmijët e tyre të lindur në vendin emigrues (nga prindërit emigrues), sipas standardeve ndërkombëtare ata nuk janë emigrant. Ata (fëmijët) nuk emigruan nga ndonjë vend tjetër por, ata aty linden (vendlindja e tyre) dhe si vendbanim të zakonshëm kanë vendin emigrues të prindërve të tyre.[155]
Imigrant është personi i cili ka ardhur të jetojë përherë ose përkohësisht në një vend që ka jetuar më herët ose që nuk është vendlindja e tij e mëhershme.
I huaj është personi i cili nuk është i lidhur me shtetësin e shtetit në territorin e të cilit gjendet. Statusi i të huajit në vendin tonë është i rregulluar me ligj të posaçëm e quajtur si Ligji mbi të huajit. I huaji në kuptim të këtij ligji është personi i cili nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë.[156]
Migrant, emigrant i përkohshëm, me qëndrim të shkurtër, sezonal është individi, i cili lëviz prej vendbanimit të tij drejt një vendt tjetër për një periudhë të shkurtër kohe (e cila nuk është më shumë se një vit) për të punuar gjatë sezonit në pajtueshmëri me punën e jo me qëllim që atje të jeton për përgjithmonë.
Emigrant ekonomik është individi i cili largohet prej vendbanimit të tij për të jetuar dhe punuar jashtë vendit të tij të origjinës me qëllim të përmirësimit të ekonomisë personale dhe familjare dhe të ardhurave materiale e.
Emigrant punëtor është individi ose personi i cili e ka lëshuar vendbanimin e tij të përhershëm dhe është vendosur në vendin e destinacionit si fuqi punëtore.
Migrimi/migracioni i rregullt është lëvizja ose zhvendosja e personit migrantë prej vendit të origjinës në vendin e destinacionit, e realizuar në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e vendit të destinacionit, tranzitit po edhe të origjinës. Migracioni i rregullt ka të bëjë me respektimin e procedurave dhe kompletimin e dokumenacionit të nevojshëm në procesin e transferimit të personit migrantë prej shtetit të vet gjatë transferimit duke kaluar prej shteteve të tranzitit si dhe në fund në shtetet e destinacionit.
Migrimi/migracioni i parregullt është lëvizja ose zhvendosja e personit migrantë prej vendit të origjinës në vendin e destinacionit, e cila është realizuar pa mos i respektuar ligjet dhe rregullat e vendit to destinacionit, tranzitit po edhe të origjinës duke përdorur mënyra apo mjete të parregullta, pa pasur dokumenta të vlefshme, me dokumenta të falsifikuara, duke përdorur hyrje-daljet kufitare në mënyrë ilegale ose në vendin e destinacionit duke qëndruar në mënyrë të parregullt dhe ilegal ose nëse i ka kaluar afati i qëndrimit. Pra, migracioni i parregullt paraqet lëvizjen që kryhet jashtë normave rregulluese të vendeve dërguese, të tranzitit dhe pritëse.[157] Këtu përfshihet edhe dhënia e kalim të paligjshëm i kufirit shtetëror ku shpesh migrantët ndihmohen nga ana e kontrabanduesve për hyrje daljet e parregullta ose ilegale. Pra, migracion i parregullt konsiderohen personat që hyjnë të pakontrolluar ose me dokumente të falsifikuara ose që qëndrojnë përtej afatit të parashikuar nga

[154] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.43
[155] Raport. "Migrimi kosovar". Prishtinë, 2014, fq.18
[156] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.35 miratuar më 23.03.2006, neni 2, paragrafi 1
[157] IOM, "E drejta migratore ndërkombëtare" Fjalorth i terminologjisë migratore, Tiranë, ISSN: 1995-7467, nr.10, 1995, fq.38

viza e rregullt, duke përfshirë personat që u është refuzuar azili, migrantët e detyruar dhe personat e trafikuar, migrantët ekologjik dhe punëtorët migrant të paligjshëm.[158] Duke pas parasysh se me migracionin e parregullt ballafaqohen pothuajse çdo shtet në botë, mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë e parasheh në mënyrë decide Konventa për migrimet në kushte abuzive dhe mbi nxitjen e barazisë së mundësive dhe të trajtimit të punëtorëve migrantë e datës 1975 e miratuar në Gjenevë. Në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore kombëtare duhet të hartohen dispozita për zbulimin efektiv të punësimit të paligjshëm të punëtorëve migrantë, si dhe për përcaktimin dhe zbatimin e sanksioneve administrative civile dhe penale të cilët brenda fushës së tyre përfshijnë edhe burgimin lidhur me organizimin e lëvizjeve të punëtorëve migrantë për motive punësimi, që përcaktohen të përfshira në abuzimet e përmendura në nenin 2 të kësaj Konvente dhe lidhur me ndihmën e vetëdijshme ndaj këtyre lëvizjeve për qëllime përfitimi ose jo.[159]

Azil kërkues është një person, i cili kalon kufijtë ndërkombëtarë për shkak të frikës nga persekutimi.[160] Përkufizohet kështu, për sa kohë që nuk ka marrë ende përgjigje apo vendimin mbi kërkesën e tij për status refugjati. Në nenin 3, paragrafi 1, të Ligjit për Azil dhe mbrojtje të përkohëshme të Republikës së Maqedonis në pjesën për "Kërkesë të drejtës për azil" thot: Azilkërkuesi është një i huaj që kërkon mbrojtje nga Republika e Maqedonisë dhe ka kërkuar njohjen e së drejtës për azil, për të cilën nuk është marrë asnjë vendim përfundimtar në procedurën për njohjen e së drejtës për azil.[161]

Kthim kuptohet procesi i kthimit mbrapa të personit në shtetin e origjinës apo të tranzitit, i cili pa të drejtë mundohet të hyjë ose ka hyrë në territorin e një shteti.

Kthim virtual konsiderohet mundësia që një emigrant të dërgojë përfitime drejt shtetit të origjinës, pa u kthyer fizikisht atje, p.sh si me investime direkte, ose me anë të teknologjisë së informacionit, duke ofruar shërbime të ndryshme.[162]

Riatdhesim është e drejta personale të një refugjati ose të një robi lufte, për t'u kthyer në vendin e shtetësisë.[163] Këta persona të cilët si shkak i luftimeve që zhvillohen në vendin e tij amë janë larguar nga vendbanimet e tyre, ata kthehen në vendet e tyre pas përfundimit të luftërave ose ndonjë fatkeqësie natyrore e cila i ka shtyrë ata të ikin nga vendi e cila e ka kuptimin e riatdhesimit.

Deportim, Dëbim është akti i një shteti për largimin e një jo-shtetasi nga territori i tij, i cili në kundërshtim me ligjet pozitive të shtetit është duke qëndruar në territorin e tij dhe i cili vullnetarisht pa detyrim të shtetit konkret është dasht të lëshoj territorin e shtetit. Ne dallim me migracionin e kthimit që mund të jete spontan ose i asistuar, deportimi është ekzekutimi faktik i largimit e cila në aspektin kohor është shumë më e shkurtër. Ky largim i jo-shtetasit nga territori i shtetit konkret vlen edhe në rastet e refuzimit të personave që kanë kërkuar azil në vend. Sipas nenin 25, të Ligjit për Azil dhe mbrojtje të përkohshme të Republikës së Maqedonisë në pjesën për "Zbatimi i dispozitave të dëbimit të Ligjit për të Huajt." thot: Në rast se personi i refuzuar, azilkërkuesi nuk largohet nga territori i Republikës së Maqedonisë, brenda kohës së parashikuar në vendimin e Departamentit të Azilit, dëbimi i tij nga Republika e Maqedonisë kryhet në pajtim me këtë ligj dhe

[158] Informacion. "Nxitja e migracionit të rregullt dhe parandalimi i trafikimit në njerëz në Shqipëri". Tiranë, 2006, fq.15

[159] Konventa për Migrimet në Kushte Abuzive dhe mbi Nxitjen e Barazisë së Mundësive dhe të Trajtimit të Punëtorëve Migrantë. C143, miratuar më 1975 Gjenevë, hyrja në fuqi 1978, neni 6, paragrafi 1

[160] Qendra Europiane "Guidë mbi të drejtën e azilit", Tiranë, fq.7

[161] Закон за азил и привремена заштита, (Пречистен текст), Службен весник на Република Македонија број.27 од 12.04.2013 година), neni 3, paragrafi 1

[162] Kraja, Blerta. Disertacion i doktoraturës "E drejta migratore dhe e azilit", Tiranë, 2012, fq.52

[163] Po aty, fq.24

dispozitat e Ligjit për të huajt[164], ose ka raste kur një person ka kryer vepër penale në një shtet dhe shteti sipas ligjeve nacionale vendos për dëbimin e tij. Sipas KPM (n.38-ç p.1) gjykata, kryerësit që nuk është shtetas i RM mund t'i shqiptojë dëbim nga vendi kur të vlerësojë se natyra e veprës, motivet e kryerësit dhe rrethanat në të cilat është kryer, tregojnë se qëndrimi i kryerësit në vend është i padëshirueshëm.[165] Dënimin me dëbim nga vendbanimi i tij, mund të shqiptonte gjykata në rastin kur i çmonte faktet se, qëndrimi i fajtorit në një vend të caktuar, ishte i dëmshëm dhe i rrezikshëm për shoqëri, për shkak të rrethanave, kushteve, mundësive dhe lidhjeve që ekzistonin e të cilat fajtorit ia mundësonin ose lehtësonin përsëritjen e veprës penale të njëjtë apo të një vepre tjetër penale.[166] Në praktikë duke marrë parasysh se kryerës të veprave penale në vendin ton janë edhe shtetas të huaj dhe se qëndrimi i tyre në territorin e shtetit është i rrezikshëm për shoqërin shpesh nga gjykatat kompetente atyreve u shqipton edhe dënimin e quajtur dëbimin e të huajit nga vendi për një periudhë të caktuar sipas vlerësimit të gjykatës. *"Në pajtim me dispozitat nga n.38 nga KP, gjykata të akuzuarit i shqipton dënim Dëbim i të huajit nga vendi në kohëzgjatje prej 5 vjet, ndërsa e cila fillon nga dita e dëbimit nga territori i Republikës së Maqedonisë."*[167]

Ripranim është në vetvete një marrëdhenie e dyanshme mes shtetit pritës që kërkon që personi me qëndrim të paligjshëm të rikthehet në shtetin e origjinës apo të tranzitit, bazuar në marrëveshjen e ripranimit, si dhe pranimi nga shteti.

Remitancat (dërgesat e emigrantëve) kuptojmë paratë e fituara nga emigracioni, të cilat emigranti ia dërgon në mënyrë periodike, si mbështetje familjes së origjinës së tij.[168] Pra, remitancat është buxheti ose të mirat materiale të cilët migranti vet ose pa prezencën fizike të tij i dërgon familjarëve në shtetin e origjinës.

Refugjatë është personi i cili gjendet jashtë vendit të tij ose ka ikur nga vendi i tij drejt një vendi më të sigurt dhe që nuk dëshiron mbrojtje nga vendi amë si pasojë e frikës nga persekutimi dhe luftërat si shkak i dallimeve racore, fetare, kombësisë, dhe përcaktimit politik.

Diaspora është komuniteti i migrantëve të vendosur përgjithmonë në një vend tjetër të ndryshëm nga ai i origjinës por të ndërgjegjshëm dhe lidhur shpirtërisht me vendin e origjinës duke ruajtur lidhjet me të në mënyrë të vazhdueshme përmes aktiviteteve të ndryshme sociale, kulturore etj.

Riemigrimi është lëvizja e një personi i cili pasi është kthyer në vendin e tij të origjinës prej nga ishte larguar për disa vite, largohet përsëri për një tjetër periudhë migrimi apo për një tjetër vend destinacioni.

Feminizimi i migracionit është një dukuri e cila viteve të fundit është në rritje e sipër dhe nënkupton kur gjatë migrimeve të popujve prej një vendi në një vend tjetër brenda shtetit ose jashta saj pjesa dërmuese e migrantëve i takojnë gjinisë femërore.

Qëndrim ligjor është qëndrimi i të huajit në bazë të lejes së lëshuar nga organi kompetent të Republikës së Maqedonisë me të cilën i lejohet të huajit ligjërisht të qëndroj në territorin e saj.[169]

Shtet i origjinës është shteti, shtetas i të cilit është personi i interesuar.[170]

---

[164] Закон за азил и привремена заштита, (Пречистен текст), Службен весник на Република Македонија број.27 од 12.04.2013 година), neni 23

[165] Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018, fq.270

[166] Ukaj, Bajram. "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë". Prishtinë, 2006, fq.169

[167] Aktgjykim nr.13 të datës 27.02.2015 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2

[168] Kraja, Blerta. Disertacion i doktoraturës "E drejta migratore dhe e azilit", Tiranë, 2012, fq.25

[169] Коментари на Македонско здружение на млади правници (МЗМП) на Предлог Законот за странци од април 2018, Скопје, fq.1

[170] IOM, "E drejta migratore ndërkombëtare" Fjalorth i terminologjisë migratore, Tiranë, ISSN: 1995-7467, nr.10, 1995, fq.68

Shtet tranzit është çdo shtet përmes të cilit personi i interesuar kalon gjatë udhëtimit për në shtetin e punësimit ose nga shteti i punësimit për në shtetin e origjinës ose për në shtetin e vendbanimit të zakonshëm.[171]
Shtet i destinacionit është shteti, që është destinacion për flukset migratore (të ligjshme apo të paligjshme).[172]
Viktimë është individi ose personi që pëson ose dëmtohen fizikisht ose psiqikisht nga një aktivitet ose veprim I një personi tjetër e cila është kundër normave shoqërore dhe ligjore.

KAPITULLI II

ETIOLOGJIA, FENOMENOLOGJIA DHE DISA KARAKTERISTIKA TJERA TË MIGRACIONIT

1. Etiologjia e proceseve të migracionit

Për të pasur një pasqyrë sa më reale dhe objektive mbi fenomenin e migracionit si ate të brendshëm ose ndërkombëtar paraprakisht duhet të japim përgjigje ndaj pyetjeve: pse njerëzit migrojnë? për çfarë arsye ata migrojnë? cilët janë ato rrethana, shkaqe apo arsye që ata i shtyjnë ose i tërheqin, nxisin migrimin e njerëzve nga vendbanimet e tyre? Për t'i dhënë përgjigje ndaj këtyre pyetjeve duhet mirë të studjohet etiologjia e proceseve të migracionit, pra, shkaqet dhe arsyet që ndikojnë direkt apo indirekt tek njerëzit për të vendosur të ti lëshojnë vendbanimet e tyre të përhershme drejt vendeve tjera. Studimi i shkaqeve, arsyeve dhe faktorëve që ndikojnë në emigrimin e njerëzve në përgjithësi mund të jenë shkaqe endogjene (të brendshme) dhe ekzogjene (të jashtme). Andaj detyra kryesore e etiologjisë në fushën e dukurive të migracionit si problematikë sociologjike është njohja dhe analiza e faktorëve, shkaqeve, dukurive dhe rethanave të jashtme dhe të brendshme që ndikojnë në vendimmarrjen për emigrim të një individi ose të një grupi të vogël ose më të madh individësh. Në praktikë gjatë tërë historisë shkaqet e jashtme

[171] Po aty, fq.69
[172] Po aty, fq.17

(ekzogjene) pra shkaqe që nuk ka të bëjë personalisht me personin por është një rrethanë jasht personalitetit të tij dhe kanë qenë dominues në emigrimin e njerëzve. Si faktorë të jashtëm llogariten: faktorët ekonomik, social, papunësia, varfëria, arsimimi, luftërat, kushtet klimatike, fatkeqësi natyrore, problemet familjare dhe shumë arsye të tjera.

Gjatë histories lëvizjet migruese kurrë nuk kanë qenë procese spontane dhe autonome, por janë nxitur nga një varg faktorësh, të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar në kohë dhe hapësirë të caktuar.[173] Pra, për të ardhur në përfundim se pse njerëzit migrojnë prej një vendi në një vend tjetër është e patjetërsueshme të studjohen faktorët që ndikojnë të njerëzit që të marrin vendimin për të migruar. Duke u bazuar në shumë llojshmërinë e proceseve të migracionit automatikisht direkt lidhet me faktorët dhe shkaqet e llojllojshme që ekzistojnë në lidhje me migracionin e që ndikojnë direkt apo indirekt tek individi në vendimmarrje. Faktorët të cilët ndikojnë në emigrimin e individëve, janë të ndërlikuara, sepse formohen prej kombinimit të vendimit personal me ato të sfondit social,[174] pra formohen prej faktorëve objektiv dhe subjektiv. Këto shkaqe mund të ndahen në të ashtuquajturat faktorët ***"push"*** dhe ***"pull"***, d.m.th. faktorë që "shtyjnë" dikë, d.m.th. "tërheq" që të vij në një situatë e cila do të përfundojë si trafikim me qenie njerëzore.[175] Më poshtë do të paraqesim në përgjithësi faktorët shtytës (Push) dhe tërheqës (Pull) të proceseve të migracionit si dhe në veçanti që janë karakteristike edhe për Republikën e Maqedonisë.

1.1. Faktorët shtytës në vendin e origjinës

Siç, dihet në lëvizjet e migracionit ndikojnë shumë faktorë, por si faktorë shtytës (Push) ose nxitës që ekzistojnë ne vendin e origjinës janë të shumta të cilat mund t'i ndajmë në: faktorë socio-ekonomik, papunësia dhe varfëria, konfliktet politike, konfliktet kulturore dhe fetare, luftërat dhe siguria e njerëzve arsimimi dhe migracioni i "trurit", familja dhe problemet familjare etj. Këto faktorë kanë ndikim në ndryshimin e demografisë së popullatës në botë përmes emigracionit por edhe në kryerjen e veprave penale të ndryshme. Në gjysmën e shekullit të fundit, rritja e popullsisë botërore ka arritur një dimension që nuk është parë më parë dhe pothuajse e gjithë kjo rritje vjen nga vendet e pazhvilluara.[176] Faktorët shtytës ose nxitës janë ato faktorë të cilat ndikojn tek individi të emigrojë nga vendbanimi ku ai ose ajo përballet me kushte dhe rrethana negativite të ndryshme drejt vendbanimeve ku kushtet negative mund të transformohen në kushte dhe rrethana pozitive. Këto faktorë ndikojnë direkt ose indirekt në dëshirën e individit ose kundër dëshirës (detyron të migrojë) në vendimmarrje (përshpejtim dhe lehtësim në vendimmarrje) për të migruar nga vendi i origjinës në vendin e destinacionit. Edhe Republika e Maqedonisë po karakterizohet me shumë faktorë nxitës të emigrimeve të popullatës të këtij vendi të cilët janë të ngjajshme edhe me faktorët që paraqiten në shtetet tjera. Pati premtime dhe eufori, por jo edhe ide përmbajtësore e progresive, andaj rrjedhimisht përpjekjet për instalimin e sistemit të ri, ktheheshin vetëm në trajta restaurimesh të sistemit të vjetër,[177] por fatkeqësisht në Maqedoni ende nuk kemi një sistem shtetëror stabil në

[173] Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012, fq.19

[174] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.51

[175] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.12

[176] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.201

[177] Avdiu, Avni. Disertacion i doktoraturës "Ndikimi dhe roli i medieve të Kosovës në globalizim dhe anasjelltas-globalizimit në medie, prej vitit 1990 deri më 2010". Tiranë, 2017, fq.61

lidhje me politikën shtetërore për emigrimin e shtetasve të vet. Në studimet e IOM, si faktor kryesor nxitës të emigrimit janë:

1. Rritja e faktorëve që ndikojnë në uljen e ekonomisë dhe të pabarazisë së të ardhurave të individëve,
2. Mbipopullimi në shoqëri të ndryshme,
3. Niveli i lartë i papunësisë
4. Konfliktet e armatosura apo spastrimet etnike,
5. Abuzime me të drejtat e njeriut, diskriminimi dhe trajtimet çnjerëzore dhe degraduese,
6. Persekutimi apo frika nga persekutimi për shkak të races, kombësisë, bindjes politike, fejës apo përkatësitë në një grup social,
7. Katastrofat natyrore dhe degradimi ekologjik,
8. Keqqeverisja.[178]

"Në vende të origjinës ekzistojnë faktorë të cilët detyrojnë njerëzit, sidomos gratë, të lëshojnë bashkësitë e tyre në kërkim të së ardhmes më të mirë jashtë vendit.
Në "Push" faktorë llogariten:

- Shkalla e lartë e papunësisë
- Varfëria
- Mungesa e arsimimit dhe qasjes në informacion
- Diskriminimi gjinor
- Diskriminimi në tregun e punës
- Dhuna në familje"[179] dhe shumë faktorë të tjerë.

Në përgjithësi, si faktorë shtytës ose nxitës të proceseve të migracionit në vendin e origjinës janë faktorët:

1.1.1. Socio-ekonomik

Mirëqenia sociale dhe ekonomike është një nga shtyllat më kryesore e çdo shteti të familjes dhe të individit përmes të cilës harmonia në mes të njerëzve, siguria financiare, mbulimi i shpenzimeve elementare varet direkt nga statusi social dhe ekonomik i personit. Në këtë drejtim, theksohet se zhvillimi i hovshëm industrial, të arritura e mëdha teknike, zhvillimi i elektronikës dhe një varg transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri, kanë ndikuar edhe në proceset e formimit të njeriut dhe personalitetit të tij.[180] Në litaraturë, para së gjithash, mendohet se këto janë shkaqe ekonomike, shoqërore dhe sociale-psikologjike që lidhen drejtpërdrejt me procesin e zhvillimit dinamik industrial dhe lëvizjeve të migracionit që ky zhvillim po ndjek në mënyrë të pashmangshme.[181] Në botë një pjesë e saj jeton me investime kapitale, me shumë vende të reja të punës, paga të larta për fuqi punëtore dhe me teknologji të përsosur duke rritur edhe standardin jetësor kurse në anën tjetër të botës kemi shtete ku ekonomija nuk i plotëson edhe standardet minimale, ku njerëzit vuajnë dhe vdesin nga uria, varfëria, papunësia, mospërballimin klimatik si dhe shumë mangësi dhe kriza të tjera ekonomike. Gjegjësisht, kriza ekonomike dhe depresioni

[178] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.56
[179] Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. "Prevencija trgovine ljudima". Beograd, 2006, fq.28
[180] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.241
[181] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164

ekonomik si një nga produktet e saj gjithashtu e ka varfërimin e popullsisë[182] e cila më pas ndikon që kjo kategori të jetë e cenueshme dhe e pambrojtur nga migracioni, dhe viktimizimi nga kriminaliteti.

Rezultatet e hulumtimit në shumë vende konfirmojnë këtë lidhje, për më tepër, janë vërtetuar edhe format e veçanta të veprave penale që po kryhen në periudhat para krizës, gjatë krizës dhe pas krizës[183] ekonomike. Si faktor i drejtëpërdrejtë i migracionit llogaritet varfëria dhe uria e cila është pasojë e problemeve ekonomike të shpëndarjes jo të balancuar të të ardhurave.[184] Mjafton të ndalemi për një çast në skenat tmerruese dhe trishtuese të banorëve të kontinentit afrikan ose më saktë në regjionin e sub-Saharasë dhe të Afrikës juglindore, ku me mijëra fëmijë, gra pleq e të tjerë, për çdo ditë vdesin nga uria, nga sëmundjet dhe epidemitë e ndryshme, katastrofat natyrore dhe epidemitë e ndryshme siç është AIDS-i.[185] Më poshtë do të paraqesim disa faktorë ekonomik siç janë: varfëria, papunësia, kushtet e punës dhe të banimit, profesioni- mjeshtria etj.
Statusi ekonomik dhe social e secilës prej kategorive të mëparshme të personave është e pafavorshme, që ndër të tjera, individët mund ti çojë në pakënaqësi, zhgënjim, kryengritje e të ngjashme.[186] Gjithashtu faktorët socio-ekonomik janë ato faktorë të cilët ndikojnë tek individët në vendimmarrje për të emigruar shkak i rrethanave dhe kushteve sociale dhe ekonomike të cilët nuk janë në nivel të duhur dhe nuk i kënaq kërkesat e tyre për një jetë më të mirë në vendin e origjinës.

1.1.2. Papunësia dhe varfëria

Papunësia dhe varfëria bëjnë pjesë në grupin e faktorëve ekonomik dhe llogariten si faktorë më me rëndësi sepse ka të bëjë me nevojën elementare të mbijetesës së njerëzve. Në literaturën e shkencave sociale, të cilat fokusohen në fushën e emigrimit, por edhe në jetën e përditëshme përsëritet shpesh, se një ndër faktorët kryesor të emigrimit është ekonomia,[187] sidomos segmenti i papunësisë e cila si pasojë e ka edhe varfërin e njerëzve e më pas skamjen. Fenomeni tjetër shoqërues i këtyre shqetësimeve është papunësia e cila në radhën e parë rëndë e godet familjen dhe tërhek si një epidemi një valë më të gjërë të varfërimit të përgjithshëm.[188] Duhet të analizohet dhe të jepet përgjigje në lidhje me ate se pse njerëzit vendosin të emigrojnë, cilët janë arsyet në vendin e origjinës që ndikojnë dhe në vendin e destinacionit që i tërheqin njerëzit për të emigruar. Si arsye kryesore e cila ndikon në pabarazinë brenda shtetit dhe ndërmjet shteteve, si shkak i rritjes së numrit të popullatës që e kanë mbushur moshën për të punuar, llogaritet mos realizimi i kushteve për punë dhe punësimin e asaj kategorie të popullatës.[189] Lehtësimin e vendimmarrjes të individit për të migruar në masë të madhe ndikon papunësia e njerëzve në vendet e tyre e cila rezulton në mospërfitimin e të mirave materiale dhe vjen deri në varfëri. Për këtë arsye papunësia dhe varfëria si koncepte janë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën ku varfëria buron direkt nga papunësia e njerëzve, e cila mund të jetë për një kohë të shkurtër ose më të gjatë. Për shkak të pamundësisë së

[182] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[183] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.166
[184] Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës "İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri:TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul'a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ". Erzurum, 2012, fq.14
[185] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.242
[186] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.149-150
[187] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.51
[188] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.166
[189] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.197

plotësimit të nevojave elementare për jetesë, të anëtarëve të familjeve, për shkak të pamundësisë së shkollimit dhe mbrojtjes shëndetësore, pason braktisja e shkollës dhe mësimit, paraqitja e sëmundjeve dhe e sjelljeve kriminale[190] si dhe në fund pason edhe vendimi për t'u emigruar në një vend më të zhvilluar me ekonomi të zhvilluar me shpresë për një punë më të mirë dhe me kushte më të mira të punës brenda shtetit të vet ose jashtë shtetit. Më në fund varfëria është faktori kryesor e cila shumë njerëz i sjell në pozitë të viktimës së veprave penale si dhe kështu në mënyrë indirekte deri tek kriminaliteti i trafikimit të personit.[191] Grupet, të cilët më së shumti janë të goditur nga varfëria, janë të papunët dhe familjet shumë anëtarëshe.[192] Siç shihet, pothuajse të gjitha faktorët ekonomik që ndikojnë në vështirësimin e kushteve për jet;, punë etj., janë të lidhura njëra me tjetrën në kuptimin e ngushtë. Përveç papunësisë, pabarazitë në shpërndarjen e të ardhurave midis rajoneve konsiderohen gjithashtu si përcaktues të rëndësishëm ekonomik të lëvizjeve të migracionit të brendshëm[193] në Republikën e Maqedonisë. Në fakt papunësia mund të jetë dy lloje: e para pamundësia për punësim, dhe tjetra, humbja e punës ekzistuese.[194]

Dukuria e ndikimit të papunësisë dhe të varfërisë nuk reflektohet vetëm tek individët që emigrojnë jashtë vendbanimeve të tyre, por ajo me të madhe ndikon edhe ndaj anëtarëve tjerë të familjes, kush shpesh tek ato familjare paraqiten edhe mosmarrëveshje në lidhje me kushtet e vështira dhe të pamundëshme të punësimit për të mirëmbajtur familjen e cila mund të ndikoj edhe negativisht edhe në rritjen e shëndoshë të fëmijëve. Kjo ndikon edhe në emigrimin e gjinisë femërore për të gjetur një punë, ku kushtet e punës dhe përfitimet materiale janë të një niveli më të lartë në krahasim me vendin e origjinës, kështu që këta individ përveç emigrimit nuk mendojnë diçka tjetër. Në disa vende botërore dukuria e varfërisë është bërë e zakonshme dhe një dukuri e cila vauhdon ku dita ditës kemi edhe njerëz që vdesin nga varfëria në disa shtete. Papunësia, në thelb, mund të përcaktojë shumë segmente të jetës njerëzore,[195] e cila më pas ndikon edhe në segmentin e varfërisë. Për shembull: shkalla e vijës së urisë në Azinë Lindore dhe në rajonin Pacifik ishte vetëm 15% në vitin 2001, kurse ata që jetonin në vijën e varfërisë pothuajse përbënin gjysmën e popullsisë.[196] Shembull tjetër: në Amerikën Latine, që nga viti 1999, kuadër 211 milion banorëve, 77 milion ishin të varfër që jetonin në zonat rurale, ndërsa pjesa tjetër 134 milionë jetonin në qytete.[197] Varfëria ndikohet edhe nga shtetet e fuqishme botërore sespe në këtë kontekst ***Pogge*** sugjeron se rendi global i institucionit të sotëm është jashtëzakonisht i padrejtë dhe se është një nga shkeljet më të mëdha të të drejtave të njeriut që ndonjëherë janë vërejtur nga shtetet e fuqishme të botës[198] e cila lidhet drejtpërdrejt me varfërinë. Kjo shihet edhe në rregullimin juridik të Deklaratës universale të njeriut sidomos në pikën 1 të nenit 25 ku thuhet se: "Secili ka të drejtë për një nivel jetese që siguron shëndetin dhe mirëqenien e tij dhe të familjes së tij, duke përfshirë këtu ushqimin, veshmbathjen, strehimin, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si dhe të drejtën për të qenë i siguruar në rast papunësie, sëmundjeje, invaliditeti, vejërie, pleqërie

[190] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.249
[191] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[192] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.7
[193] Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës "İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri:TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul'a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ". Erzurum, 2012, fq.14
[194] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.149
[195] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.149
[196] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.193
[197] Po aty, fq.194
[198] Po aty, fq.195

ose në raste të tjera të mungesës së mjeteve të jetesës për shkak të rrethanave që nuk varen nga vullneti i tij".[199]

Kjo dukuri është shumë e shprehur, si në çdo vend tjetër të botës ku ekonomia pothuajse nuk ekziston, e cila ndikon direkt për emigrime jashtë vendit shkak i papunësisë dhe pagave të ulëta, e cila ndikon në varfërin familjare të këtyre individëve. Nëse shihet punët e para të punëtorëve në shtetet e huaja, në rend të parë radhitet punëtorët në fabrika me 60.4% dhe pëson punëtor në ndërtimtari dhe punëtorë shërbyes mes 15.4% dhe 11.0%.[200] Në Republikën e Maqedonisë dukuria e proceseve të migracionit kanë ekzistuar edhe gjatë periudhave të ndryshme të ish-Jugosllavisë sepse shteti ynë edhe atëherë ka qenë si shteti me ekonomi më të dobët ku papunësia ka qenë e madhe e cila ka rezulltuar me emigrimin e shtetasve tanë në shtetet tjera të Jugosllavisë ku ka pasur hapësirë për punë dhe hapjen e bizneseve të ndryshme por edhe më larg drejt vendeve evropiane me ekonomi të zhvilluar. Këtu është me rëndësi të ceket se si shtete më të zhvilluara të ish-Jugosllavisë janë llogaritur Kroacia, Sllovenia dhe Mali i zi si vende turistike ku dominonte të ardhurat nga turizmi po edhe hapja e vendeve të punës sezonale, Serbia dhe Bosnja Hercegovina si shtete të cilët ishin të njohur me vende historike në kryeqytetet e tyre. Ndryshimi i sistemit dhe shkatërrimi i ish -Jugosllavisë në vitet e 90-ta solli si pasojë kryesore dobësimin e ekonomisë dhe rritjen e papunësisë, të inflacionit dhe të varfërisë. Për shkak të periudhës pesëmbëdhjetëvjeçare të tranzicionit të shoqërisë maqedonase, ndodhën ndryshime të mëdha strukturore dhe transformime në tregun e ekonominë së orientuar.[201] Pas, pavarësisë në vitin 1991 ekonomija e Maqedonisë kaloi në periudha të ndryshme me rrënie dhe ngritje të vogla në disa sektorë, sidomos stagnimi i rritjes së ekonomisë gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001 dhe me bllokimin e zhvillimeve euro-atlantike të Maqedonisë nga ana e shtetit fqinjë me vite të tëra, duke u llogaritë edhe si shtet i pasigurt për investime të huaja e cila ndikonte edhe në ekonominë e vendit. Pas, pavarësisë në Maqedoni u aktivizua privatizimi i shumë fabrikave shtetërore, ku një pjesë shumë e vogël e tyre rifilloi punën, me kapacitete shumë të reduktuara. Ristrukturimi i sektorit publik nuk u shoqërua me rritje të mjaftueshme dhe të shpejtë të sektorit privat që të mund të siguronte punë për popullsinë relativisht të re, gjë që çoi në shkallë të lartë të papunësisë.[202] Edhe me privatizimin e shumë subjekteve juridike të bizneseve të ndryshëm kushtet e punës janë jo të mjaftueshme për punëtorët sepse nuk kemi lehtësim dhe investime duke pas parasysh zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë botërore, ku shume punëtor ankohen edhe në kushtet e rënda në vendet e tyre të punës si dhe për pagat e ulëta në krahasim me punën e bërë. Shteti duhet që më shumë të koncentrohet në hartimin dhe realizimin e politikave ekonomike për punësim dhe rritjen e pagave sidomos për kategoritë më të prekura dhe cenueshme që mund të jetë edhe si masë parandaluese e emigrimit në Maqedoni. Mekanizmat e avancuar të mbrojtjes sociale si kompensimi i papunësisë, sigurimi i aftësisë së kufizuar, sistemi i pensioneve, sigurimi social dhe format e tjera të mbështetjes së të ardhurave janë gjithashtu një nga komponentët kryesorë të strategjive për të reduktuar varfërinë dhe pabarazitë[203] në Maqedoni. Shumë nga ata kanë ndikim të madh në të gjitha aspektet shoqërore dhe ekonomike, që rezulton me ndryshime të mëdha në strukturën sociale të popullsisë, si varfëria

[199] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948, neni 25, paragrafi 1

[200] Güven, Sami. "Uluslararası işçi Göçünün sosyal politika sorunları". Bursa, 1996, fq.95

[201] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.11

[202] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq. 164

[203] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.200

e rritur, niveli i lartë i papunësisë dhe shtimi i numrit të personave të përjashtuar.[204] Mbi të gjitha, ajo ndikon negativisht në gjendjen ekonomike, pastaj në vet statusin social të individit, familjeve të tyre, por edhe në shtresat e caktuara shoqërore.[205]

1.1.3. Konfliktet politike

Sot e kësaj dite pra, në botën moderne, sidomos në disa shtete të Lindjes së mesme konfliktet politike vazhdojnë dhe ka ndikuar që shumë njerëz t'i braktisin vatrat e tyre të përhershme duke ikur sistemit politik dhe persekutimeve politike ndaj personave që e kundërshtojnë sistemin shtetëror aktual. Konfliktet politike të cilët shpesh rezultojnë edhe me demonstrata të dhunshme kanë ndikuar në rrezimin e shumë sistemeve komuniste, socialiste dhe një partiake për arritjen e vënies së sistemit demokratik shtetëror, ku të gjithë njerëzit do të jetojnë të lirë dhe të barabartë. Këto faktorë kanë ndikuar në masë të madhe në disa shtete me sistem një partiak shtetëror të cilët kanë përdorur dhunë, persekutime dhe likuidime të kundërshtarëve, ku zëri i i lirë i popullit nuk ka ardhur në shprehje që, njerëzit të emigrojnë. Këto faktorë krijojnë konfliktet politike të rrezikshmërisë së lartë dhe si pasojë e saj edhe pasiguria e individëve dhe të anëtarëve tjerë të familjes duke e penguar aktivitetet e lira politike. Kështu që në këto shtete paraqitet një kaos, panikë, frikë, dezorganizim të shoqërisë nga dhuna dhe shtypja politike të sistemeve komuniste ndaj individëve dhe grupeve ndaj individëve që e kundërshtojnë atë sistem. Dezorganizim shoqëror si gjendje jostabile në një shoqëri të caktuar, nxit edhe dezorganizimin individual, d.m.th. çregullon jetën dhe punën e individëve, familjeve, grupeve të caktuara etj.[206] Individët që e kundërshtojnë sisteme të tilla i takojnë partive politike që llogariten si kundërshtar të sistemit, lëvizjeve të ndryshme qytetare, grupeve të ndryshme etnike apo fetare. Ka raste kur në një periudha të ndryshme dhe në raste të ndryshme shteti mund të shkaktojë zhvendosjen jo-vullnetare (migrim të detyruar ose mërgim) në shoqëri si një mekanizëm presioni.[207]

Në kushtet e konflikteve politike dhe kundërthenieve që mbretërojnë në shtetet dhe regjimet ku këto konflikte janë të përhershme, nuk janë të rralla, por për kundrazi, janë dukuri e përditshme proceset e montuara gjyqësore, persekutimet policore, malltretimet e pjesëtarëve të grupeve tjera politike, grupeve tjera nacionale të cilat ndiqen dhe ndëshkohen për shkak të shfaqjes së mendimeve të tyre politike, për shkak se i përkasin nacionalitetit tjetër.[208]

Në kohën e sistemit socialist të Jugosllavisë së atëhershme një sërë veprimtar dhe individë të grupeve të ndryshme që ishin të përkatësive të ndryshme nacionale dhe politike shkak i aktiviteteve të ndryshme në sferën politike ishin të detyruar të braktisin vendin e tyre nga shtypjet dhe ndjekjet politike. Kjo nuk përfundoj me pavarësinë e Republikës Maqedonisë ku edhe më pas gjatë viteve 90-ta dhe pas saj. Pra, këto shtypje dhe ndjekje politike vazhdon edhe sot por jo në formë klasike por si shtypje dhe ndjekje moderne duke përdorur forma të ndryshme duke i akuzuar shume individë dhe grupe sikur kanë qenë kundër rregullimit shtetëror dhe politik. Sidomos gjatë viteve 2005 deri 2017 kemi një sërë rraste të montuara ku janë të ndjekur dhe burgosur shumë njerëz pa kur faji akuzohen, vetëm për mos ta rrezikoj pushtetin e tyre, ku jemi edhe dëshmitar kur viteve të

[204] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq. 11
[205] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.149
[206] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.100
[207] Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës "İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri:TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul'a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ". Erzurum, 2012, fq.17
[208] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.254

fundit dolën edhe bombat e përgjimeve të udhëheqësis shtetërore së atëhershme e cila rezultoj edhe me zgjedhe të përkohëshme dhe me rrëzimin e qeverisë dhe pushtetarëve të atëhershëm nga qeveria, të cilat gjatë vitit 2018 nga Prokuroria publike speciale filluan edhe rastet gjyqësore ndaj ish politikanëve.

1.1.4. Konfliktet kulturore dhe fetare

Në grupin e ideo-politik mund të llogarisim ndikimin e konflikteve politike, kultutore dhe fetare si faktorë që ndikojnë në disa shtete botërore në emigrimin e individëve nga trrojet e veta. Këta faktorë kulturoro-fetar gjithashtu kanë lidhje të ngushtë mes veti duke e marrë parasysh se përcaktimet kulturore dhe fetare janë të lidhura me traditat dhe zakonet e individëve të cilët nga shumë arsye nuk mund të respektojnë dhe realizojnë në vendet e tyre vendosin të emigrojnë. Duke u bazuar se shumë shtete sot kanë përbërje heterogjene në kuptimin e përcaktimit fetar dhe kulturore, shpesh mos realizimi i traditave dhe zakoneve kulturore dhe fetare në vendet e origjinës të individëve janë përshkak se ato në ato vende janë si pakicë dhe gjenden në shtypje, pengesa kërcënime të ndryshme të mbajtjes së rritualeve kulturore dhe fetare. Kushtet sociale janë ndër shkaqet e detyrueshme të migracionit social dhe kulturor sepse njerëzit nuk munden ti shohin fytyrat e njëri-tjetrit për shkak të skandaleve dhe konflikteve që njerëzit kanë përjetuar me familjet e tyre ose me familje të tjera.[209]

Sot, ndoshta nuk ka shumë shtete ku ekziston emigrimi i personave si shkak i konflikteve kulturore ose fetare për mos realizimin e aktiviteteve dhe rritualeve kulturore-fetare por ekzistojnë ashtu shtete ku nacionalizmi dhe ekstremizmi fetar herë pas here del në shesh dhe shkak i kësaj emigrojn individët e kulturës dhe fesë tjetër. Në këtë mënyrë lindin dukuritë e mostolerancës, paraqitja e urrejtjes dhe konflikteve të hapura[210] në lidhje me respektimin dhe realizimin e aktiviteteve kulturore dhe fetare e cila ndikon edhe në vendosjen apo emigrimin e njerëzve në vende më demokratike ku do të respektohen këto dukuri. Në Republikën e Maqedonisë emigrimi si shkak i faktorëve kulturorë dhe fetar nuk ka qenë dhe nuk është një ndër faktorët kryesor të emigrimit të njerëzve edhe pse herë pas here edhe tek na paraqiten konflikte të këtij lloji.

Edhe në botë ky lloj i konflikteve është i njohur sidomos në shtetet e Lindjes së mesme ku sot në luftërat që zhvillohen atje si pjesë dominuese janë edhe sektet e ndryshme të cilët me ekstremizmin e tyre i vënë në rrezik sigurinë e jetës së shumë njerëzve të religjioneve të tjera pakicë. Religjioni si formë e vetëdijes njerëzore dhe si shpjegim i rregullave dhe formave jetësore, në një aspekt të veçantë edhe në të kaluarën por edhe në ditët e sotme, ka ndikim të madh në qëndrimet, veprimet dhe sjelljet e individëve dhe grupeve të ndryshme njerëzore.[211] Kështu që disa individë ndaj besimtarëve të konfeksioneve të tjera që janë pakicë ushtrojnë dhunë, shtypje frik që mos t'i realizojnë obligimet fetare dhe kështu që shume njerëz vendosin edhe në emigrim. Përkundër asaj se çdo fe udhëzon në rrespket, mirëqenie, ndihmë dashuri dhe shumë rregulla tjera të etikës njerëzore, prap kemi shtete ku nga ky faktor njerëzit i lëshojnë vendet e tyre. Këto dukuri është dominante në vendet e pazhvilluara ku demokracia ende nuk është në sistemet e tyre shtetërore.

[209] Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës "İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri:TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul'a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ". Erzurum, 2012, fq.16

[210] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.255

[211] Po aty, fq.270

1.1.5. Luftërat dhe siguria e njerëzve

Luftërat dhe siguria e njerëzve janë faktorë kyç dhe shumë të rëndësishëm të emigrimieve masovike të njerëzve nga vendet e tyre duke e arsyetuar me ate se jeta, shëndeti dhe siguria e njerëzve janë një ndër drejtat më kryesore, vitale dhe natyrore të garantuara edhe me drejtën e brendshme dhe me drejtën ndërkombëtare në botë. Siguria paraqet nevojë primare dhe dëshirë, por njëkohësisht është kusht thelbësor për rendin dhe qetësinë, e cila mundëson zhvillimin shoqëror[212], përkundrazi ndikon në rritjen e kriminalitetit. Supozimet teorike kanë ardhur deri në përfundim se ndikimi i luftërave në krimin mund të ndahet në tri periudha: paralufte, gjatë lufte dhe pas lufte.[213] Kushtetuta e çdo shteti e garanton jetën njeriut si e drejtë e shtetasve të tyre e cila është e pacenueshme dhe e paprekshme. Jeta e njeriut garantohet edhe me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë ku në nenin 10 paragrafin e parë thuhet se: "Jeta e njeriut është e pacenueshme."[214] Kushtetuta e Republikës së Kosovës në paragrafin e parë të nenit 25 të saj në pjesën e "E drejta për jetën" cekën se: "Secili individ gëzon të drejtën për jetën".[215] Kurse sipas nenit 3 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut parashihet: "Secili ka të drejtë të jetojë, të jetë i lirë dhe të ketë siguri vetjake".[216] Njerëzimi vetëm në një njëqind vjet përjetoi dy luftëra të mëdha botërore, një periudhë ishte e luftës të ftohtë që zgjati 40 vjet dhe shumë konflikte të armatosura ndërshtetërore dhe vendase, ku rreth 187 milion njerëz vdiqën pas këtyre konflikteve.[217] Gjatë periudhave të mëhershme historike por edhe viteve të fundit në ato shtete ku ka luftë shteti me humbjen e kontrollit, mosfunksionimit të institucioneve shtetërore ku shpesh përmenden edhe vrasjet masive të popullatës së pambrojtur civile, gjenocide ndaj grupeve të caktuara, shkatërime, zhdukje, pengmarrje ndikojnë direkt edhe në ikjen e njerëzve nga këto rrezikshmëri, në vende më të sigurta sidomos në shtetet fqinje. Këto pasoja të periudhës derisa sa zgjatë lufta shumë njerëz me status të rrefugjatit emigrojnë brenda shtetit në rajone më të sigurta ose drejt shteteve më të sigurta. Shpesh analistë të ndryshëm të proceseve të migracionit e llogarisin luftën si faktorë e cila ndikon në emigrime masovike të njerëzve pa dallim gjinie, moshe, feje, nacionaliteti etj. Luftërat dhe konfliktet e brendshme në shekullin e XX-të, si pasojë e shkaqeve socio-politike dhe politike 43 milion njerëz u strehuan ose emigruan në shtete tjera.[218] Po ashtu janë të freskëta pasojat e luftërave që ndodhën në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë, në Ruandë dhe Burundi, në Çeçeni dhe në Amerikën Latine,[219] por pasoja të luftërave kemi edhe gjatë luftës së parë botërore, luftës së dytë botërore ku shumë njerrëz u zhvendosën në shtete tjera të sigurta. Si rezultat i luftës në Kosovën dy milionëshe, pothuajse gjysma e popullsisë që jeton në Kosovë emigruan në vende të tilla si Shqipëria (500 mijë), Maqedonia (300 mijë), Sanxhak (70 mijë) dhe Bosnja dhe Hercegovina (12 mijë).[220] Gjithashtu destinacion i emigrantëve nga lufta e Kosovës ishin shtetet evropiane dhe amerikane ku një pjesë e tyre mbetën dhe vazhdojnë të jetojnë atje. Edhe lufta e Bosnjës dhe Hercegovinës ishte një ndër luftërat më tragjike në këtë pjesë të Ballkanit ku kishte emigrime gjatë

[212] Дончев, Александар. "Кризен Менаџмент". Скопје, 2007, fq.19
[213] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.150
[214] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me Amandamentet e Kushtetutës I-XXX, Shkup, 2006, neni 9, paragrafi 1
[215] Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008, neni 25, paragrafi 1
[216] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948, neni 3
[217] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.159
[218] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.159
[219] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.259
[220] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.171

luftës nga friga e vrasjeve të policisë së atëhershme Jugosllave ndaj popullatës civile. Në Maqedoni deri më tani kemi pasur imigrime si shkak i luftës së Kosovës dhe Bosnjës dhe Hercegovinës por kemi edhe emigrime brenda shtetit gjatë konfliktit të vitit 2001 si shkak i luftës dhe sigurisë së njerëzve.

Maqedonia nga pavarësia e saj të vitit 1991 ka qenë një shtet me popullatë mikëpritëse të refugjatëve të ikur shkaku i luftërave të ndryshme që i kaploj shtetet e ish Jugosllavisë. Deri në fillim të vitit 2015 Maqedonia ka pasur emigrime dhe imigrime, derisa në fillim të vitit 2015 sidomos pas gjashtë mujorit të parë të këtij viti kur kaploj vala e migrantëve të cilët kalonin nga Maqedonia drejt shteteve evropiane e kishte statusin e shtet-subjektit tranzit i cili me gjith kapacitetet e saja shtetërore në një mënyrë e menaxhoj krizën e paraqitur të emigrantëve dhe refugjatëve të cilët ishin si pasojë e luftërave në vendet e tyre dhe sigurisë së njerëzve. Republika e Maqedonisë si rezultat i pozitës gjeostrategjike të saj në Ballkan ishte pjesë e rrugës së migrantëve Ballkanit e cila lëvizte përmes rrugës hekurudhore nga Gjevgjelija në hyrje në vend nga Republika e Greqisë deri në dalje drejt Republikës së Serbisë në kalimin hekurudhor në f.Tabanovcë.[221] Pra, peridha e vitit 2015 sidomos gjatë muajve nga qershori deri në shtator mbi një milion migrantë ishin pranë kufirit të Maqedonisë me Greqinë të cilët duke e shfrytëzuar territorin e shtetit tonë si territor tranzit tentonin me çdo kusht të kalojn në territorin e Serbisë e më pas drejt shteteve evropiane. Kohën e fundit është hapur edhe një drejtim të ri drejt Kosovës, që të vazhdojnë drejt Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë.[222]

Edhe pse në numër të vogël praktika e parë e pranimit të migrantëve dhe refugjatëve ishte periudha e zhvillimeve të vitit 1991 në Shqipëri, ku personat që kishin ikur kërkuan strehim në Maqedoni, kryesisht nga rajonet kufitare, ku të gjithë këta u strehuan në qytetet më të afërta si Resnje, Ohër dhe Strugë. Pas qetësimit të situatës në Republikën e Shqipërisë numri më i madh i tyre u kthye në vendlindje, ndërsa një numër i caktuar të shtetasve shqiptar nga Prespa e Vogël mbeti në Maqedoni.[223] Pastaj, gjatë vitit 1992 Republika e Maqedonisë shërbeu si strehim për refugjatët nga Bosnja dhe Hercegovina, ku rreth 35 mijë qyetarë të ikur nga lufta u vendosën në qendrat kolektive anembanë vendit, ndërsa disa qytetare u vendosën nëpër shtëpi private, ku Republika e Maqedonisë u ka mundësuar strehim deri në vitin 1997 dhe pas qetësimit të situatës në BeH është bërë e mundur kthimi i sigurt i tyre në mënyrë të organizuar.[224]

Si pasojë e krizës në Kosovë, në pranverë të vitit 1999, gjithësej 360 mijë persona, kryesisht shqipëtar etnik kërkuan mbrojtje ndërkombëtare në Maqedoni, Qeveria e Republikës së Maqedonisë më 02.03.1999 solli Konkluza për ofrimin e mbrojtjes së përkohshme për 234 mijë persona të cilët kanë qenë të strehuar në shtëpi private, ku 126 mijë persona të tjerë kanë qenë të vendosur në tetë qendra kolektive të ndërtuara për këtë qëllim në teritorin e Republikës së Maqedonisë, pjesa më e madhe e tyre, 91.476 persona janë vendosur në qendrën kolektive "Stenkovec" në afërsi të Shkupit.[225] "Person nën mbrojtje të përkohshme" është një i huaj që i

---

[221] Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Гевгелија, Октомври 2017-Февруари 2018 година, fq.1

[222] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.24

[223] https://www.aa.com.tr/sq/politik%C3%AB/nga-pavarsimi-i-maqedonis%C3%AB-mbi-400-mij%C3%AB-refugjat%C3%AB-kan%C3%AB-q%C3%ABndruar-n%C3%AB-vend/456671, të datës 19.09.2020, ora 09:23

[224] https://www.aa.com.tr/sq/politik%C3%AB/nga-pavarsimi-i-maqedonis%C3%AB-mbi-400-mij%C3%AB refugjat%C3%AB-kan%C3%AB-q%C3%ABndruar-n%C3%AB-vend/456671 të datës 19.09.2020, ora 09:49

[225] https://www.aa.com.tr/sq/politik%C3%AB/nga-pavarsimi-i-maqedonis%C3%AB-mbi-400-mij%C3%AB-refugjat%C3%AB-kan%C3%AB-q%C3%ABndruar-n%C3%AB-vend/456671 të datës 19.09.2020, ora 10:11

është njohur e drejta për mbrojtje të përkohshme, në përputhje me Ligjin për azilin dhe mbrojtjen e përkohshme[226].
Lloji i njohur si emigrim i brendshëm brenda territorit të Maqedonisë kishim gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001 ku pjesa e popullatës që ishin nga territoret ku zhvilloheshte luftë kemi emigrimet e tyre tek familjarët në rrajone, qytete dhe fshatra tjera ku mund të garantoheshte jeta dhe siguria e tyre.

1.1.6. Arsimimi dhe migracioni i *"trurit"*

Si kurrë më parë, sot, zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë së komunikimit në mes të njerëzve e lehtëson komunikimin, lëvizjen si dhe arsimimin e njerëzve në vende të ndryshme si brenda po ashtu edhe jashta shtetit. Arsimimi i njerëzve dhe ngritja intelektuale e tyre ndikon në formimin e një shoqërie të shëndosh e cila do të ndikojë në krijimin e mirëqenies socio-ekonomike mbarë shoqërore. Përmes arsimimit njerëzit janë më të vetëdishëm për jetë kualitative, perspektif ekonomike, sociale dhe të sferave tjera. Përkundrazi mos pasja e një jete kualitative dhe perspektif në vendin e vet atëherë rrugëdaljen njerëzit e kërkojnë në vendet tjera duke i shfrytëzuar lehtësimet që ofron teknologjia, globalizmi po edhe arsimi duke kërkuar një jetë më të mirë. Një shoqëri apo një individ që ka mungesë të një arsimimi të mirëfilltë atëherë kemi të bëjmë me stagnim të asaj shoqërie e cila do të ishte edhe si një faktor që do ndikonte që shumë njerëz të migrojnë. Në shumë vendbanime në shtetin tonë kushtet për arsim janë jo të mira dhe larg standardeve evropiane ku sot e kësaj dite ka shkolla sidomos në vendet rrurale ende janë pa kushte elementare të funksionimit të tyre duke filluar nga: infrastruktura, siguria, higjiena, pajisje teknike dhe teknologjike etj. Në anën tjetër edhe mos pasja e perspektivës pas arsimimit sidomos në lidhje me punësimin profesional ka ndikuar në masë të madhe të njerëzve intelektual të migrojnë drejt shteteve ku arsimimi dhe punësimi është sipas meritës dhe vlerësimit të dijes. Kështu që shtetet e zhvilluara me industri dhe ekonomi të fortë i tërheqin nga shtetet me ekomoni të pazhvilluar sidomos të rrinjtë përmes sistemit arsimor dhe kushtet që i kanë këto institucione që të arsimohen në këto shtete dhe pas kryerjes së arsimit të duhur ti mbajnë si kuadër të tyre. Nga ana tjetër kategoria e të pasurve në shtetet e origjinës sidomos tek ato shtete ku arsimi nuk i plotëson kushtet primare ku bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë fëmitë e tyre i dërgojnë nëpër institucione arsimore të njohura në nivel botëror për të siguruar një arsim më të mire dhe një të ardhme perspektive.

Në vend që arsimimi të jetë si një forcë e cila do të ndikojë në pengimin e emigrimeve përmes formësimit dhe aftësimit të tyre profesionale, por ajo përkundrazi njerëzit e arsimuar duke u bazuar në pamundësitë e punësimit dhe perspektivës si dhe kushtet e rrënda të arsimimit njerëzit intelektual i braktisin me të madhe vendet e tyre duke emigruar në vende evropiane për një punë, përfitim material dhe perspektivë më të mirë profesional. Ky lloj i emigrimit ndryshe quhet edhe si emigrim i trurit. Largimi i mësuesve në emigracion apo përfshirja në punë e fëmijëve që janë në moshën e shkollës kanë qenë gjithashtu probleme të mprehta.[227] Ekziston një numër në rritje i të rinjve me arsim të lartë, si dhe studentët e viteve të fundit të fakulteteve të shkencave teknike dhe natyrore të cilët po mendojnë ose planifikojnë të largohen jashtë vendit.[228] Njerëzit intelektual me dijenin e tyre më lehtë e kanë të marrin vendime pozitive dhe të dallojnë pasojat negative ose

[226] Закон за вработување и работа на странци (Службен весник на Република Македониј број.217 од 11.12.2015 година), neni 2, paragrafi 1, pika 6
[227] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.172
[228] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.4

pozitive të emigrimit. Duhet mirë të analizohen pasojat afatgjate të emigrimit të trurit sepse arsimimi është forca më e madhe e arritjeve të ngritjeve dhe zhvillimeve të ndryshme të shoqërisë në çdo shtet. Kështu që tani kemi një numër të madh njerëzish që, për arsye të ndryshme, mbeten të papunë, por edhe ata që pas marrjes së një kualifikimi të caktuar nuk mund të punësohen.[229] Në Maqedoni situata është pothuajse e njejt ku deri në vitin 2010 nuk ishte shumë e shprehur emigrimi i të rrinjve intelektual (emigrimi i trurit) por pas këtij viti me liberalizimin e vizave dhe hyrjen e programës për shkëmbim të studentëve Erasmus shumë të rrinjë nga shteti emigruan duke gjetur punën dhe perspektivën e tyre në vendet e zhvilluara evropiane. Andej, punësimi i të rrinjve, duke përfshirë edhe ata me kualifikime më të larta të arsimit, mbetet problem serioz me qëllim të zvogëlimit të emigrimit të të rinjve ose siç njihet në botë largimi i trurit.[230]

Duke pas parasysh edhe nivelin e ulët të natalitetit në shumë shtete evropiane dhe nevoja e fuqisë punëtore disa shtete të Ballkanit perëndimor u bënë si vende origjine të emigrimeve ligjore si: Maqedonia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Kosova dhe Mali i Zi. Si shembull më i mirë është shteti i Gjermanisë, duke pas parasysh nevojën shtetërore për fuqi punëtore të kualifikuar dhe profesionalizuar ndikoj me të madhe tek intelektualët të rrinj nga Maqedonia me të madhe para zyrave konzullore të saj në Shkup të aplikojnë për vizë pune në këtë shtet e cila është në rritje e sipër. Emigrimi i punëtorëve mjekësor sot është bujë e madhe në mediat e vendit që paraqesin situatë alarmuese ku me të madhe mjekët dhe motrat medicinale braktisin vendet e tyre të punës duke emigruar në Gjermani. Sfida e "migrimit të varfërisë" e rajonit të Ballkanit drejt Europës Perëndimore dhe Gjermanisë është kthyer ndërkohë në një çështje të rëndësishme e të ashtuquajturit "Proces i Berlinit" dhe u debata fuqishëm në Samitin e Vjenës në 2015 dhe të Parisit në 2016,[231] sepse migrantë nga shtetet e Ballkanit perëndimor llogariteshin si vende të sigurta të origjinës. Në këto shtete si arsye kresore e shtytjes së njerëzve për të emigruar në Gjermani janë papunësia e lartë, pagat e ulëta, korrupcioni në institucione shtetërore, mungesa e investimeve kapitale shtetërore, pra në përgjithësi mungesa e një perspektive për një jetë më të mirë. Në Rezolutën mbi politikën e migracionit për periudhën 2015-2020, në pjesën e "Qëllimi strategjik 1. Zvogëlimi i intensitetit të emigrimit të përhershëm, sidomos të emigracionit intelektual, nëpërmjet adresimit të vazhdueshëm të arsyeve për qëllimet e shprehura të migracionit", në paragrafin "qëllimet specifike" përmendet edhe ikjet e trurit nga Maqedonia dhe ate "Një intensitet më i ulët i emigrimit të kuadrove dhe talenteve të rinj të arsimuar, një ikje e trurit (ikjes së trurit)".[232] Pasojat e këtyre emigrimeve individuale në vitet në vijim pritet të shihen a janë pasoja pozitive (pritshmërit ti realizojnë) ose pasoja negative (mashtrim nga pritshmëritë). Miratimi i ligjit për të huajt në vitin 2006 (i cili është në fuqi nga 1 janari i vitit 2008) është një arritje e konsiderueshme në harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë me standardet ndërkombëtare në këtë lëmi.[233] Në këto situata emigrantët ose do të kthehen në vendlindje kjo dukuri e kthimit në Maqedoni përmes lajmeve të portaleve në rrjetet sociale ka raste të shumta të kthimit ose vendosin të marrin edhe familjet e tyre e cila për ne është një humbje e madhe si shtet. Megjithatë, në mjedisin e ri, ai ndesh një mënyrë të re të jetës, me kontrolle të ndryshme sociale, zakone, kulturë, veshje, strehim, ushqim dhe në përgjithësi sisteme të ndryshme normative.[234] Nga kjo pikëpamje,

[229] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.149
[230] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.14
[231] Analizë. "Të kuptojmë migrimin shqiptar në Gjermani gjatë periudhës 2014-2016". Tiranë, 2016, fq.3
[232] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.46
[233] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.215
[234] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164

hidhërimi, mosinteresimi, neglizhimi në vendimmarrje, zhgënjimi, paragjykimet e të tjera, migrimi është vështirë në përshtatjen me mjedisin, vendin e punës, njerëzit rreth tyre, pengesat gjuhësore e të tjera.[235]

Emigrimi i individëve pa arsimim të nivelit të arsimit të lartë dhe kualifikime profesionale është pjesa dërmuese e popullatës që dëshirojnë të emigrojnë edhe në nivel botëror por edhe në Maqedoni. Kjë kategori e popullatës e ka rëndë të punësohet ne vend për shkak se zhvillimi ekonomik nuk është në nivel ku nuk kemi investime dhe hapje të vendeve të reja të punës dhe Maqedonia llogaritet si shtet me përqindje të lartë të papunësisë sipas numrit të popullatës së përgjithshme, andaj kjo kategori më lehtë e ka të vendosë për të emigruar. Një pjesë të individëve veç emigruar në vende evropiane vendosin që t'i marrin edhe femijët e tyre duke arsyetuar me kushtet e arsimimit në vendin e origjinës, pra në rastin konkret në Maqedoni duke menduar në investim për fëmitë e tyre në shkolla evropiane ku kushtet janë me teknologji dhe të nivelit të lartë të kushteve arsimore, kulturore, respektit ndaj arsimit etj. Edukimi dhe arsimimi krijojnë perspektivën e ngritjes së vetëdijes së qytetarëve, për të marrë pjesë në vazhdimësi në procesin e shkollimit dhe të edukimit, proces ky që është i lashtë dhe paraqet përpjekjen e përhershme të njeriut për t'u edukuar dhe emancipuar.[236] Në vendin tonë arsimi fillor dhe ai i mesëm janë të obligueshëm për shtetasit e vet dhe prindërit janë përgjegjësit për ndjekjen e arsimit të fëmijëve të tyre e cila do të ndikoj në ngritjen e vetëdijes, së kuptuarit për një jetë më cilësore, do të dijë shkrim lexim, dë t kuptohet për çështjet e përditshme jetësore. Prindi, domethënë kujdestari i nxënësit është i detyruar që t'i mundësojë fëmijës së tij/saj që të përmbushë detyrimin për arsimin e detyruar fillor dhe edukimin.[237] Kësaj duhet të shtohen edhe personat që nuk e mbarojnë shkollën, prandaj ata nuk kanë kualifikime.[238] Personat e paarsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore, atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme, për çka ata nuk janë të aftë t'u bëjnë rezistencë nzitjeve dhe sprovave të ndryshme të ambientit shoqëror[239] dhe me shumë lehtësi është vendimmarrja e tyre për emigrim.

1.1.7. Familja dhe problemet familjare

Hapat e para pas lindjes, për formësimin, zhvillimin e personalitetit dhe përgaditjen për ballafaqimin me sfidat në botën e jashtme, dhe ambinetin ku jeton dhe vepron njeriu rolin kryesor e ka familja. Familja është bashkësi jetësore e prindërve dhe fëmijëve dhe të afërme të tjerë, nëse jetojnë në shtëpi të përbashkët.[240] Familja si faktor mikrogrupor ka një rëndësi të veçantë sepse si institucion përher ka pasur dhe ka edhe sot funksione dhe detyra të shumëfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos fëmijëve dhe të rrinjve. Këto janë familje të shëndosha me raporte normale të cilët pengesat jetësore mund t'i kalojnë me vështirësi të vogla, por në anën tjetër ekzistojnë familje ku shkak i disa faktorëve siç janë: familjet me shumë anëtar, familje ku prindërit janë të papunë, raporti në mes të prindërve dhe fëmijëve jo në nivel, familje të degraduara dhe familje të mangëta, nuk mundë t'i përballojnë sfidat dhe

[235] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.147

[236] Osmani, Fadil. Disertacion i doktoraturës "Integrimi në BE-Sfidë e Kosovës". Tiranë, 2016, fq.63

[237] Закон за основното образование, Службен весник на Република Македнија, број. 103 од 19.08.2008 година, neni 5

[238] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.149

[239] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2002, fq.250

[240] Закон за семејството (пречистен текст), (Службен весник на Република Македонија број.153 од 20.10.2014 година), neni 2, paragrafi 1

vështirësitë. Mos përballimi i vështirësive dhe sfidave jetësore të familjeve të tilla shpesh tek këto familje rrugëdalja nga këto probleme ndikojnë individdët të gjejnë rrugëdalje duke emigruar jasht vendibanimit të tij në suaza të shtetit të vet ose jashta saj. Të paktën në shekullin e fundit, përfaqësimi kulturor i personave të rinj ka qenë e tillë sa që ndaj tyre është shiquar si "problem" ose burim i vështirësive ose si rrezik.[241]

Në vendin tonë ekziston Ligji mbi familjen përmes të cilës "rregullohen: martesa dhe familja, marrëdhënie në martesë dhe familje, forma të caktuara të mbrojtjes së veçantë të familjes, dhuna familjare, birësimi, kujdestaria, mirëmbajtja, si dhe procedura para gjykatës në mosmarrëveshjet martesore dhe familjare dhe procedura për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtjen nga dhuna në familje."[242]

Te familjet e degraduara ose problematike paraqiten probleme të adaptimit të fëmijëve dhe të miturve në kushtet e krizës dhe të skamjes, kështu që me kalimin e kohës fëmitë që rriten në kushte të tilla largohen nga bashkësia familjare duke u vendosur në vend tjetër e nuk janë të pakta kur ata dalin edhe jashtë shtetit për të gjetë një jetë më të mirë. Në këto familje, për shkak të konflikteve të tilla, zakonisht pason shthurja e bashkësive familjare, ndarja e prindërve, braktisja dhe lënia e familjes nga njëri ose dy prindërti, ikja e fëmijëve nga familja, ndarja e bashkëshortëve (shkurorëzimi).[243] Këta individ që rrjedhin nga familje problematike e kanë rëndë të adaptohen në mjedise të rreja kështu që shpesh ato edhe devijojnë duke marrë rrugën e kryerjes edhe të aktiviteteve kriminale dhe devijante si p.sh. alkoolizmi, përdorimi i substancave narkotike, vjedhje etj. Një migrant duhet të ndryshojë shprehit, botëkuptimin, vlerat dhe zakonet e tij nëse sheh se bota që e ka rrethuar është armiqësore, e huaj dhe e largët.[244] "Si të tilla trajtohen familjet e mangëta trajtohen familjet në të cilën mungojnë të dy prindët apo vetëm njëri nga ata. Këto mungesa të prindërve mund të jenë për shkak të proceseve natyrore, vdekjes, ndarjes së prindërve, braktisjes nga njëri prind, shkuarjes në botën e jashtme për shkak të punësimit dhe veçmas si pasojë e luftës."[245] Në këto familje fëmitë rriten në mungesë të një anëtari të familjes dhe janë të izoluara si dhe mund të mbretëroj edhe varfëria familjare shkak i mungesës së individiëve që janë fuqi punëtore. Kështu në këto familje të rrinjtë vendosin të emigrojnë drejt shteteve evropiane për të punuar dhe përfituar duke qenë i detyruar të gjejë një rrugëdalje për te dhe anëtarët tjerë të familjes për një jetë më të mirë. Persona të papunë të rrinjë mendojnë të largohen nga shteti, para së gjithash nga shkaqet që kanë të bëjnë me financat, punësimin dhe avancimin në punë.[246] Pothuajse atmosferë e njejtë mbretëron edhe te familjet me shumë anëtar ku shkak i standardeve të ulëta, mos pasja e vendeve të punës dhe pagat e ulëta tek këto familje nuk mund të arrihet ekzistenca dhe ushqimi i familjes. Mungesa e mjeteve materiale për ekzistencë, veshmbathje, ushqim, shkollim,[247]ndikojnë që së paku një anëtar i familjes të emigroj asjta shtetit me qëllim të tejkalimit të vështirësive që e ka kapluar familjet e tilla. Në këto familje dominon mendimi se emigrimi jashtë shtetit është e patjetërsueshme për të gjetë një jetë më të mire të cilët shpesh në të ardhmen i tërheqin edhe anëtarët tjerë të familjes duke gjetur punë.

---

[241] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.575

[242] Закон за семејството (пречистен текст), (Службен весник на Република Македонија број.153 од 20.10.2014 година), neni 1

[243] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.278

[244] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.147

[245] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.279

[246] Анализа. "Невработеноста на младите луѓе во Република Македонија". Скопје, 2016, fq.28

[247] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.280

Raportet familjare janë shumë të rëndësishme të cilët ndikojnë direkt në formësimin dhe edukimin e mirrëfillt të njeriut që nga lindja e deri në vdekje. Me rëndësi është edhe raportet mes prindërve dhe fëmijëve të jenë në nivel të normave të shoqërisë e cila ndikon edhe në formësimin e dhe zhvillimin e shëndoshë të familjes ku jetojnë. Në ambientet familjare, ku këto raporte nuk janë të mira, ku nuk ka mirëkuptim në mes të prindërve dhe fëmijëve dhe anasjelltas përher paraqiten konflikte të cilat lënë gjurmë të thella në jetën psikike dhe shpirtërore të fëmijëve dhe të miturve,[248] tek individët mund të mbisundoj mendimi se emigrimi do të ishte rrugë dalja për të penguar këto raporte jo të mira në familje. Mirëpo, duhet theksuar se zhvillimi i gjithanshëm fizik e psikik i personave të mitur dallon nga zhvillimi i personave të rritur dhe karakterizohet me një intensitet të lartë si për sa i përket rritjes së tyre ashtu edhe për sa i përket lëkundshmërisë lidhur me vlerat shoqërore.[249] Punësimi i prindërve në një farë mënyre nënkupton edhe të kundërtën e skamjes, varfërisë dhe urisë. Familjet ku prindërit janë të papunë kurse fëmitë të mitur kanë pasoja në moshkollim e cila ndikon që ata në moshën e rritur të emigrojnë shkak i mosplotësimit të kushteve të ekzistencë, banimit, shkollimit dhe rrugëdalja e vetme është emigrimi i tyre pët të punuar. Si problematikë tjerë me këtë lloj të faktorëve është edhe prezenca e dhunës ndaj anëtarëve tjerë në disa familje. Kur flitet për këtë dhunë, shpesh herë dhuna i drejtohet ndaj fëmijëve, ndaj anëtarëve të moshuar dhe ndaj gruas. Si dhunë e tillë konsiderohet shtrëngimi në veprime të caktuara kundër dëshirës së njërit apo tjetrit bashkëshort, malltretimit fizik e psikik etj.[250] Familjet të cilët janë viktimë të dhunës së përdorur ndaj tij në disa raste është edhe shkak direkt i emigrimit ose të gjetjes së rrugëdaljes së shpërnguljes jashta vendit.

1.2. Faktorët tërheqës në vendin e destinacionit (pritës)

Paralel me faktorët "push", ekziston edhe një seri "pull" faktorë që i bëjnë njerëzit edhe më të nënshtruar ndaj kurtheve të vendosura nga trafikantët, dhe përfshin:

- Pritja e punësimit, kompensimi financiar dhe aksesi në të mirat materiale që lidhen me Perëndimin dhe vendet e tjera me ekonomi të qëndrueshme.
- Pritjet për përmirësimin e statusit shoqëror dhe trajtimit personal.
- Pritjet në lidhje me punët e paguara më shumë.[251] Pra, përveç faktorëve shtytës-nxitës,

ndikim në vendimmarrjen dhe përforcimin e saj që individët të vendosin që të emigrojnë nga vendet e tyre të origjinës rol të madh kanë edhe faktorët tërheqës në vendin e destinacionit (pritës). Nganjeherë, ndodhë që individët emigrojnë pa ndonjë arsye shumë të fortë si p.sh. varfëria, papunësia ose luftërat por ka individë edhe pse kushtet e jetës dhe fitimet në vendin e origjinës janë të nivelit të duhur ato prap migrojnë në shtete ku standardi dhe luksi i jetës është mbi nivel domethënë këta persona janë në kërkim të luksit jetësor. Por, në përgjithësi si faktorë tërheqës në vendin e destinacionit (pritës) janë: mundësia e punësimit më të lehtë dhe pagat më larta se në vendin e origjinës, arsimimi dhe kushtet e saj më të volitshme dhe më bashkkëkohore, bashkimi familjar, ndikimi i globalizimit, informacione-reklama pozitive përmes mjeteve të komunikimit publik-masmedia dhe rrjetet sociale, inkurajimi dhe përshtypjet pozitive të emigrantëve ndaj familjarëve në vendin e origjinës, etj. Realizimi i dukurisë së migracionit prej një vendi në një vend tjetër paralel me shkaqet nxitëse varet edhe nga shkaqet tërheqëse të shtetit të destinacionit

[248] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.282
[249] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.425
[250] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.181
[251] Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. "Prevencija trgovine ljudima". Beograd, 2006, fq.28

siç janë qendrat e mëdha aktraktive-turistike dhe me zhvillim ekonomik. Këto qendra apo qytete të cilët janë destinacion i migrantëve kanë karakteristika dhe veçori të llojllojshme dhe që janë të ndryshme nga vendet e origjinës të cilët janë edhe si oferta për migrantët që të zgjedhin si vendbanime të reja ku do të jetojnë dhe punojnë. Një tjetër faktor i rëndësishëm tërheqës ishte roli i diasporës ekzistuese të emigrantëve,[252] të cilët i inkuraojnë të afërmit e tyre sidomos për atë kategori të cilët kanë nevojë për t'u emigruar. Pra, me një fjalë faktorët tërheqës vin në shprehje për dukurinë e migracionit që del nga shumica e karakteristikave që zonat rurale dhe shtetet me ekonomi të dobët dhe të varfëra të cilët nuk i posedojnë kushtet e atyre vendeve. Sipas studimeve të IOM-it si faktorë tërheqës së emigrimit janë llogaritur:

1. Siguria dhe zhvillimi ekonomik në vendin e destinacionit,
2. Mundësia e punësimit,
3. Mundësia për legalizim të dokumentacionit,
4. Mundësitë e integrimit,
5. Distancat me vendin e destinacionit dhe ekzistenca e rrjeteve migratore.[253]

Në përgjithësi si faktorë tërheqës në vendet e destinacionit (pritës) ngjajshëm dhe në Republikën e Maqedonisë llogariten:

1.2.1. Mundësitë e punësimit, pagat e larta dhe kushtet e mira të punës

E vërteta e dukurisë së migracionit është se në krye të shkaqeve që ndikojnë në emigrimin e njerëzve janë kushtet dhe vështirësitë ekonomike në vendet e tyre ku jetojnë dhe veprojnë. Në një anë duke i marrë parasysh këtë probleme ekonomike sidomos mungesa e mundësisë së punsimit, pagat e larta dhe kushtet solide të punës në vendet e tyre të origjinës nuk ekzistojnë, kurse në anën tjetër në vendet e destinacionit këto mundësi janë reale dhe të realizueshme individët lehtë vendosin të emigrojnë. Personat që vendosin të emigrojnë mendojnë dhe besojnë në mundësitë për punësim, më shumë të ardhura materiale në bazë të pagave më të larta në krahasim nga vendi i origjinës, kushtet më të mira të punës duke e përmirësuar kushtet e jetesës. Individët që emigrojnë në shtetet tjera duke kërkuar punësim dhe paga më të larta rezulton nga shkaku i politikës shtetërore në vendet e origjinës ku investimet kapitale në sektorë të ndryshëm dhe hapja e vendeve të punës është pothuajse aspak të realizueshme sidomos pagat e larta dhe kushte të mira të punës kështu që lehtë dhe shpejtë njerëzit vendosin për emigracion sidomos jashta shtetit. Në emigrimin e brendshëm shkaqet janë pothuajse të njejta duke marrë parasysh se kemi mungesë e punësimit në zonat rurale dhe kështu sidomos të rrinjtë detyrohen të vendosen prej vendeve rurale në vendbanime urbane sidomos në qytete më të mëdha.

Punësimi, pagat e larta dhe kushtet më të mira në vendet e punës mund të përmirësohen me politika ekonomike reformatore duke thithur investime të huaja kapitale, zhvillimin e sektorëve të harruar në vend duke i përkrahur me projekte dhe subvencione të ndryshme dhe këto investime kapitale shtetërore dhe ato ndërkombëtare duhet në mënyrë proporcionale të shpërndahet në të gjithë territorin e Republikës Maqedonisë, pra edhe në zona urbane por edhe në zona rurale që në një farë mënyre të mbahet baraspesha ekonomike e cila do të jetë edhe si një metodë për parandalimin e migrimive brenda dhe jashta shtetit. Prevencioni i emigrimit të ardhshëm të personave të rrinjë kërkon përpjekje të përbashkëta të shumë institucioneve dhe të ardhura drejtuara për përmirsimin e standardit jetësor të rinjve në çdo aspekt (arsim dhe kualifikim, punë dhe trajnime profesionale,

[252] Analizë. "Të kuptojmë migrimin shqiptar në Gjermani gjatë periudhës 2014-2016". Tiranë, 2016, fq.16

[253] Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015, fq.56

familja dhe fëmitë, kushtet e banimit, zhvillim individual në shoqërinë qytetare etj).[254] Veprimi preventiv realizohet nga të gjithë organizatat apo institucinet shtetërore dhe ato joshtetëërore në shtet siç janë ministritë, agjencionet dhe drejtoritë shtetërore, familja, shkollat, organizatat joqeveritare nacionale, rajonale ose ndërkombëtare etj. Në të dy llojet të migrimit (brendshëm dhe ndërkombëtar) nga ky lloj i shkaqeve shumica e migrantëve vijnë nga vendet rurale, pra burimi më i madh i këtyre migrimeve janë vendet rrurale qoft drejt vendeve urbane të të njëjtit shtet qoft edhe jashtë shtetit të vet. Industrializimi dhe urbanizimi në kuadër të faktorëve ekonomik kanë një vend të veçantë sepse me rritje e shpejtë të popullsisë u rritën edhe qytetet dhe u bënë gjithnjë e më të globalizuar me një infrastrukturë, urbanizëm dhe industri të zhvilluar e cila direkt ndikon edhe hapjen e shumë vendeve të punës, me kushte më të mira dhe me paga të larta në krahasim me vendet e origjinës. Anën tjetër zhvillimi i hovshëm dhe i shpejt i ekonomisë dhe industrisë mund të ndikoj edhe në rritjen e kriminalitetit. Statistikat e shumë vendeve që janë në procesin e industrializimit të shpejtë tregojnë se në këto vende ka një rritje të krimit.[255] Në shumë vende, fenomeni i krimit është rritur në përmasa anormale dhe është një nga problemet më serioze të pazgjidhura që po shqetësojnë popujt dhe qeveritë e tyre.[256] Ndoshta me parandalimin e emigracionit nga vendet rurale në një mënyrë do të ndikojnë në zhvillimin e teknologjisë bujqësore me qëllim që të kapërcehen modelet primitive të kuptimit tradicional të prodhimit bujqësor në zonat rurale dhe të përpunohen dhe të vlerësohen produktet bujqësore në një mënyrë që krijon vlerë më të madhe të shtuar dhe duke mbajtur popullatën në ato vende. Kjo është vështirë të realizohet në vendin tonë për shumë arsye dhe mund të ndodh shkak i emigrimeve masovike nga vendet rurale që në vendet rurale në të ardhmen nuk do të ketë fuqi punëtore në bujqësi dhe duke rënë sasia e produkteve bujqësore në treg do të rrit interesimin e rritjes së vlerës së bujqësis në përgjithësi dhe në veçanti të produkteve bujqësore. Pothuajse gjysma e fuqisë punëtore potenciale të familjeve rurale është forca punëtore jo aktive, domethënë pa vend pune. Pra, në vendin tonë, një nga mënyrat më efektive të vlerësimit të burimeve njerëzore në fjalë është zhvillimi i industrisë dhe bujqësisë rurale.

Pra, nga kjo mund të konkuldojmë se në përgjithësi, ekziston dallimi mes nivelit të të ardhurave të qyteteve ku ardhurat janë më të larta se niveli i të ardhurave të vendeve rurale apo fshatrave, në kuadër të një shteti por edhe në kuptimin e migracionit ndërkombëtar ku në shtetet me ekonomi dhe industri të zhvilluar niveli i ardhurave janë shumë më të larta sesa në shtetet e tyre të origjinës. Popullsia që largohet nga fshati në qytet e lë atmosferën e saj socio-kulturore me marrëdhënie të veçanta fqinjësore, miqësore, emocionale dhe të tjera që janë të natyrës tradicionale, me përvojat e tyre të fituara dhe transformohen në një mjedis krejtësisht të ri.[257]

1.2.2. Bashkimi familjar

Në kuadrin e faktorëve mikrogrupor, bashkimi familjar është një faktorë tjetër që ndikon tek njerëzit të emigrojnë. Duke pas parasysh se kemi migrime individuale ku një person emigron në një shtet dhe pas marjes së lejes së qëndrimit të përhershëm dhe gjetjes së punës hapi i dytë që e bëjnë migrantët është bashkimi familjar duke i marrë edhe anëtarët tjerë të familjes. Më së shumti tek migrimet individuale janë meshkujt të cilët një periudhë jetojnë dhe punojnë vet dhe të cilët pas disa viteve përmes rrugës së bashkimit familjar i marrin edhe anëtarët tjerë të familjes sidomos

[254] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.14
[255] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164
[256] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.72
[257] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001. fq.164

bashkëshorten dhe fëmijët për të siguruar edhe anëtarëve tjerë të familjes një perspektivë më të mirë dhe më të shndosh. Nëse shiqohet për një periudhë më të gjatë bashkimi familjar është një hap shumë i rëndësishëm dhe pozitiv përshkak se shumë familje sidomos prindërit në moshë dhe fëmitë e tyre rriten pa njërën prind ose të dy prindët e cila ka pasoja negative për formësimin e personalitetit të fëmijëve. Kurse në anën tjetër nëse e shohim bashkimi familjar në një far mënyrë ka të bëjë me emigrimin masovik të popujve sidomos kjo vërehet në vendet rurale ku numri i banorëve është më vogël në numër. Vazhdimsia e bashkimit familjar në të ardhmen do të ndikoj në shprazjen e vendeve rurale ku do të ndjehet mungesa e kategorisë së quajtur popullsia aktive të cilët e mbajnë ekonominë dhe perspektivën e një vendi.

Edhe në Republikën e Maqedonisë sidomos viteve të fundit me rastin e hapjes së kufijëve për fuqi punëtore në Gjermani shumica e emigrantëve janë emigrime individuale përshkak se hapi i parë derisa të rregullojnë dokumentacionin, punësimin dhe kushtet e banimit pjesa dërmuese disa vite vendosin të jetojnë vet e më pas ti marin edhe anëtarët tjerë të familjes. Kjo periudhë kohore që nevoiten emigrantëve individual është një koh të gjatë e cila mund të ndikoj sidomos tek fëmitë e miturr gjatë moshës adoleshente, moshë e cila është më e vlefshme kur fëmitë fitojnë virtyte të mira ose të këqija. Është e nevojshme kohë të gjatë për tu përshtatur, e cila për disa asnjëherë nuk kanë sukses[258] dhe kjo quhet si periudha e përshtatjes ose adaptimit.

1.2.3. Globalizimi

Që nga kohërat e lashta të njerëzimit me qindra vite më parë deri më sot, bota dhe zhvillimet botërore në mënyrë permanente po zhvillohen dhe ndryshojnë formën e tyre. Më herët njerëzit kanë udhëtuar në kushte shumë të rënda duke kaluar periudha të gjata të vendosen nga një vendi në një vend tjetër, transporti i mallrave për tregëti ka qenë në kushte shumë të rrënda dhe në sasi më të vogla. Duke pasur parasysh dukurinë e lëvizjeve migratore që nga historia e deri në ditët e sodit, të dhënat në nivel botëror e përshkruajnë konceptin e migracionit si fenomen global dhe se migracioni llogaritet hapi i rëndësishëm në procesin e integrimit global dhe shekulli që jetojmë sot quhet "shekulli i migracionit".[259] Por, sot bota bashkëkohore ka arritur nivelin e lartë të zhvillimit të teknikës dhe teknologjisë ku bashkëpunimi mes njerëzve të vendeve të ndryshme, lehtësimi i komunikimit dhe transferimi i të mirave materiale përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave moderne, tregtia ndërkombëtare sot është bërë shumë më e thjesht në çdo aspekt të saj sidomos në kohë më të shkurtër. Në këndvështrimin e sotëm, termi "globalizim", i vështruar në tërësinë e tij, nënkupton zhvillimin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve të ndërsjellta ndërmjet njerëzve, ideve dhe informacioneve, aktiviteteve ekonomiko-financiare e tregtare, politike e kulturore në shkallë planetare.[260] Globalizimi ka të bëjë me krijimin e një ekonomie globale më të integruar, më të zhvilluar. Pra, përmes globalizmit ekonomitë botërore po lëvizin nga rajonet dhe sistemet e pazhvilluara drejt rajoneve dhe sistemeve të zhvilluara duke tejkaluar çdo barrierë, kulturore, fetare, distanca duke investuar në zhvillim ekonomik botëror duke krijuar një sistem të vetëm unik dhe global, gjë që nënkupton edhe migrimin e njerëzve së bashku me tregëtinë e mallrave prej një vend drejt një vendi tjetër.

---

[258] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.145

[259] Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës "Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan tıcareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede uluslararası işbirliği". Istanbul, 2010, fq.91

[260] Ajazi, Kristina. Disertacion i doktoraturës "Sfidat e përkthimit në epokën e globalizmit. Globalizmi dhe ndikimi i tij në përkthimologji parë në qasjen e teksteve publicitare në anglisht dhe shqip". Tiranë, 2012, fq.1

Sot, njerëzit në këtë jetë aq dinamike përmes lehtësirave të globalizimit shumë shpejt nga shkaqe të ndryshme arrijnë në realizimin e qëllimeve të tyre përmes procedurave shumë më të lehta, njerëzit po lëvizin botën për kohë të shkurtër e cila është e ndikuar nga intensiteti i rritmit të jetës., që nënkupton edhe bashkimin e botës në një botë për të gjithë njerëzit. Por disa intelektualë mendojnë se globalizimi është faktorë i dëmshëm që e ka ndarë botën në të pasur dhe të varfër, në të zhvilluar dhe të pazhvilluar dhe mendohet se ky fenomen është në dëm të shteteve të pazhvilluara por në favor të shteteve të fuqishme. Pra, më herët njerëzit për të mbijetuar kanë përdorur metodën e bashkëpunimit klasik mes tyre e cila me kalimin e kohës sot bashkëpunimi është bërë në formë shumë më të përsosur dhe e pandashme e njerëzve dhe të shteteve për ti përballuar sfidat e botës bashkohore duke aplikuar edhe metoda bashkëkohore. Globalizmi sot ka depërtuar në çdo fushë të jetës dhe në çdo pjesë të globit, ku bashkëpunimi i njerëzve dhe i shteteve, qarkullimi i mallrave, ideve, institucioneve e njerëzve, zhvillimet, progresin që ne shohim, prekim apo i nënshtrohemi sot vjen si rezultat globalizimit botëror. Pra, globalizmi ndikon direkt në largimin e të ashtuquajturave "kufijtë e lëvizjeve, kulturave, bizneseve, transporteve, tregtisë" duke insistuar që njerëzit në vendet e origjinës dhe ato të destinacionit përmes ofrimit të zgjidhjes së ofertave për një jetë më të mirë të jetojnë nën një ombrellë të quajtur globalizim ose një botë e vetme kulturore, ekonomike, sociale dhe shoqërore e cila ka ndikuar edhe në rritjen e migrimeve të popujve të ndryshëm. Globalizmi mundohet të largoj kulturat bizneset lëvizjet në kuadër të një shteti por ajo kërkon që këto aktivitete të jenë transnacional. Kështuqë njerëzit përmes lëvizjeve të migracionit për arsye të ndryshme i tejkalojnë kufijtë nacional duke e përmbledhur botën nën ombrellën e globalizmit.

Nga kjo del se individët e emigruar nga Maqedonia me të afërmit në vendet e origjinës sot mbajnë gjallë më mirë se kur bashkëpunimin, kontaktet dhe lidhshmërit e tyre përmes përmes lehtësimeve të ndryshme që mundëson glabalizmi botëror. Vizitat më të shpeshta familjare duke u bazuar në mjetet e përsosura të transportit të njerëzve, komunikimet e lehtësuara mes familjarëve përmes rrjeteve sociale dhe aplikimeve programore të përsosura telefonike, dërgesa të të mirave materiale përmes bankave të ndryshme që kanë bashkpunime ndërshtetërore mes dy shteteve e cila vetëm e përforcon dhe e rrit ndikimin e saj në migrimin e njerëzve. Kështu që deri në migrimin e popullsisë ka ardhur edhe si shkak i lehtësimit të komunikimit.[261] Tashmë janë bërë 27 vite nga pavarësia e Maqedonisë dhe shkalla e papunësisë në Maqedoni është jashtëzakonisht e lartë apo mund të themi se është një ndër shtetet me papunësi më të lartë në Evropë dhe se globalizmi është një dukuri me ndikim shumë të madh në të gjitha zhvillimet ekonomike, sociale, politike, po edhe të proceseve të migracionit. Globalizimi nxiti lëvizshmërinë e madhe të njerëzve nga njëri vend në një vend tjetër dhe kjo ka bërë që të kemi një ndërthurje të kulturave nëpërmjet përshtatjes kulturore dhe sociale të tyre gjithashtu zgjeroi njohuritë teknologjike të cilat e kanë bërë më të lehtë dhe më të shpejtë këtë fenomen. Një rol tepër të rëndësishëm në globalizimin e vendeve luajnë edhe emigrantët, të cilët kontribuojnë si në nivelin ekonomik të vendeve pritëse të tyre, por edhe të vendeve përkatëse nga ata vijnë po ashtu dhe në nivelin social, kulturor gjë që sjell dhe përfitime. Migrimet e popullsisë ose lëvizja mekanike e popullsisë si proces dhe dukuri masive janë një çështje komplekse dhe shumëdimensionale hapësionore, demografike, ekonomike, sociale, politike, familjare dhe individuale[262] e cila kohëve të fundit ka një lidhshmëri shumë të ngushtë edhe me dukurinë e globalizmit. Globalizmi si dukuri ka nisur të ekzistojë në formën e shkëmbimeve të thjeshta tregëtare por sot është shndërruar në një dukuri komplekse që përfshin të

[261] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.213

[262] Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012, fq.20

gjitha sferat e jetës të njerezve dhe të shteteve në të gjithë botën duke filluar nga më të mëdhatë dhe më të zhvilluarat, që përfshijnë brenda tyre miliona banorë, deri në ato vende me disa mijëra banorë dhe me sipërfaqe të vogël. Kështu që globalizimi definitivisht llogaritet si faktorë tërheqës të lëvizjeve migratore botërore, përmes të cilave në të ardhmen do të kemi një ndryshim të madh të rendit ndërkombëtar dhe rolit dominues në disa fusha të shteteve të ndryshme. Nëse në të ardhmen globalizmi nuk pengohet atëherë pritet që në të ardhmen të kemi "*Aktorët e rinjë global"*me çka nënkuptojmë se rritja e mundshme e potencialit të Kinës dhe Indisë, si lojtarë të rinj e të mëdhenj globalë, të ngjashme me fillimet e një Gjermanie të bashkuar në shekullin XIX dhe një SHBA-je të fuqishme në fillim të shekullit XX, do të transformojnë hartën gjeopolitike me impakte potencialisht dramatike më tepër sesa ato të dy shekujve të kaluar.[263] Këto shtete duke pas parasysh numrin në rritje të popullsisë dhe paralel me rritjen e ekonomisë në të ardhmen mund të jenë si udhëheqës dominant të politikës globale botërore. Në të ardhmen Evropa duhet të bëj hap për gjetjen e rrugëdaljes nga mungesa e fuqisë punëtore dhe rritjen e natalitetit për të pasur fuqi punëtore të rrinj, duke realizuar masa sociale dhe ekonomike.

1.2.4. Informacioni përmes mjeteve të komunikimit publik-masmedia dhe inkurajimi dhe përshtypjet pozitive të migrantëve ndaj familjarëve në vendin e origjinës

Sot komunikimi publik dhe gjitha llojet e masmediave ku bën pjesë edhe rrjetet sociale në botën bashkëkohore, janë bërë mjete të fuqishme të shpërndarjes së informacioneve dhe të cilët ndikojnë tek indivi dhe popullata brenda apo jashtë shtetit mos të ndjejnë largësinë dhe vonesën e informacioneve. Më herët shpërndarja e lajmeve, komunikimet e njerëzve kanë qenë shum të rënda kështu që njerëzve është dashur një koh më të gjatë për marrjen e informacioneve në lidhje me ndonjë dukuri ose çështje, po edhe për migracionit. Sot, në jetën moderne këto rrugë janë lehtësuar ku efekti i teknikës dhe teknologjisë është aq i madh sa që për një periudhë kohore shumë të shkurtër njerëzit sot informohen dhe komunikojnë njëri me tjetrin sikur të jenë në të njëjtin vend ku është edhe burimi i informacionit. Si mjete të komunikimit masiv llogariten shtypi, televizioni, literatura, radio, filmi, rrjetet sociale etj. Mediat ofrojnë mundësinë e shprehjes, promovimit dhe shkëmbimit të lirë të mendimit dhe vënies së shpejtë në kontakt me ata që duam dhe përmes tyre, dijet kanë gjetur rrugën e depërtimit dhe zgjerimit në largësi të mëdha brenda kohës së shkurtër.[264] Sot, jemi dëshimitar sidomos përmes televizionit dhe rrjeteve sociale ku reklamohen firma ndërmjetësuese për rregullimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe gjetjen e punës në disa shtete evropiane. Këto të ashtuquajtur agjenci ndërmjetësuese shpesh i mashtrojnë klientët e tyre ku shumica janë të zonave rrurale duke marrë shuma të larta të parave dhe duke i lë përgjys punët ose aspak nuk i fillojnë. Realiteti është se të rinjtë që gjejnë punë përmes agjencive të punësimit që u premtojnë atyre punë në familje, hotelieri dhe të ngjashme, zakonisht përfundojnë duke punuar në kushte skllavërie, duke marrë pak ose aspak kompensim financiar, pa orë normale pune, pa sigurime sociale ose shëndetësore, duke punuar në mënyrë të paligjshme , shpesh vetëm me një vizë turistike, ose pa vizë, gjë që e bën situatën e tyre edhe më të vështirë dhe i ndalon ata të

[263] Ajazi, Kristina. Disertacion i doktoraturës "Sfidat e përkthimit në epokën e globalizmit. Globalizmi dhe ndikimi i tij në përkthimologji parë në qasjen e teksteve publicitare në anglisht dhe shqip". Tiranë, 2012, fq.39

[264]Avdiu, Avni. Disertacion i doktoraturës "Ndikimi dhe roli i medieve të Kosovës në globalizim dhe anasjelltas-globalizimit në medie, prej vitit 1990 deri më 2010". Tiranë, 2017, fq.15

kërkojnë ndihmë nga frika e masave që autoritetet lokale mund të marrin.[265] Më së shumti reklamat e këtyre agjencioneve të rrejshme bëhet përmes rrjeteve sociale të facebook-ut dhe instagram-it ku viktimat potencial të këtyre reklamave mund të jenë shumë njerëz. Duke marë në përgjithësi, ***Ericksoni*** dhe të tjerit arritën në përfundim se edhepse mediat dhe tregjet kanë një model të ndryshëm të lajmeve, prapëseprapë artikujt mbi devijimin dhe kontrollin, në kuptimin më të gjerë të fjalës, janë të një rëndësie kryesore dhe vendimtare për "vlerën" e lajmit.[266]

Në shfrytëzim të lehtësimeve të mjeteve të komunikimit sot shumë emigrantë në shtetet evropiane ndikojnë dhe inkurajojnë familjarët e tyre të cilët jetojnë në shtetet e origjinës duke i lavdëruar dhe dhënë informata për ato shtete se ka perspektivë, mundësi punësimi, paga të larta, duke i spjeguar edhe procedurat për të emigruar. Kjo ndikon shumë tek këta persona sepse familjarët që jetojnë në mërgim japin një besim të fortë duke besuar në thëniet e tyre dhe ky ndikim reflektohet edhe tek vendimmarrja e individëve për të emigruar dhe pëlqimin e anëtarëve tjerë të familjes. Inkurajimi i familjarëve më shumë bëhen nga emigrantët që jetojnë kohë të gjatë, e njohin mirë procedurën e rregullimit të dokumentacionit dhe ofrojnë lehtësime si në pagimin e shpenzimeve të transportit, banimit dhe ushqimit në muajtë e parë të emigrantit të ri derisa ai të stabilizohet me kushtet që ofronë shteti i destinacionit.

2. Fenomenologjia (llojet) e migracionit


Proceset e migracionit, gjatë historisë që nga kohërat e lashta e deri më sot, si për nga forma, struktura, vëllimika, dinamika por edhe sipas kritereve individuale të tyre ka pësuar ndryshime. Këto ndryshime janë varësisht nga periudha kohore dhe shkaqet që kanë ndikuar deri tek migracionit. Gjatë historisë në shtete të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore, dukuria e proceseve të migracionit në jetën reale janë shfaqur në forma, struktura dhe vëllime të ndryshme. Për të analizuar format e shfaqes dhe realizimit të proceseve të migracionit, strukturën e personave që janë edhe subjekte të migracionit dhe në çfarë vëllimi dhe dinamike janë të përhapur këto procese në botë por edhe në Republikën e Maqedonisë do të na ndihmoj dega shkencore e cila quhet fenomenologji. Pra, pasqyra objektive dhe reale mbi dukurinë e proceseve të migracionit arrihet përmes analizës së etiologjisë dhe fenomenologjisë së këtyre proceseve sociologjike. Proceset e migracionit janë të llojit nacional dhe ndërkombëtar e cila në vete ngërthen edhe emigracionin edhe imigracionit e popujve prej një vendbanimi drejt një vendbanimi tjetër. Më poshtë do të paraqesim llojet e proceseve të migracionit total të cilët sipas viteve e kanë prekur edhe Republikën e Maqedonisë. Në vijim do të paraqesim emigrimin e përgjithshëm të qytetarëve vendas, pra si emigrimi nacional po ashtu edhe ajo ndërkombëtar gjatë periudhës 2005-2015.

Grafikoni nr.3[267] Emigrimi i përgjithshëm (nacional dhe ndërkombëtar) i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë sipas viteve

[265] Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. "Prevencija trgovine ljudima". Beograd, 2006, fq.14


[266] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.306

[267] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/675_Migracii_op_VkDosOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 16.07.2020, ora 15:39



Në këtë grafikon bëhet fjal për emigrimin e përgjithshëm të qytetarëve të vendit si brenda ashtu edhe jashta shtetit prej vitit 2005 deri në vitin 2015 ku dominon numri i rasteve të emigrimit në vitin 2005 me 12693 raste më pas vijon në vitin 2006 me 11813 raste dhe viti 2012 me 9664 raste, kurse më pak vërehet në vitin 2010 me 8199 raste të emigrimit dhe më pas vijon viti 2009 me 8554 raste dhe viti 2011 me 8755 raste.

Grafikoni nr.4[268] Imigrimi i përgjithshëm (nacional dhe ndërkombëtar) i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë sipas viteve



Grafikoni nr.4 ka të bëjë me imigrimin e përgjithshëm të njerëzve si nacional ashtu edhe ndërkombëtar sipas viteve, ku si vit ku më shumë shprehet imigrimi drejt shtetit tonë është në vitin 2005 me 11935 raste dhe më pas pëson viti 2006 me 11285 raste dhe në vendin e tretë sipas sasisë së imigrimit është viti 2007 me 9804 raste. Vite që karakterizohet me imigrim më të vogë në shtetin tone është viti 2008 me 913 raste dhe më pas pëson viti 2010 me 7579 dhe viti 2009 me 8044 raste. Një krahasim mund të bëhet në mes të emigracionit dhe imigracionit total nga/në Republikën e Maqedonis sipas grafikonit 4 dhe 3, ku shihet qartë se emigrimi prej periudhës 2005 deri 2015 në çdo vit dominon emigrimi sesa imigrimi përveç se në vitin 2007 shihet e kundërta më shumë kemi imigrim sesa emigrim dhe ate emigrim 9662 kurse imigrim 9804 raste me dallim prej 142 raste më shumë të rasteve të imigrimit.

2.1. Sipas kriterit të territorit dhe të kufijve shtetëror


[268] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/725_VM_Migracii_VkDosOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 16.07.2020, ora 19:05

Territori dhe kufijtë shtetëror të një shteti rregullohet edhe me të drejtën e brendshme (kushtetutë dhe me ligj) si dhe me akte ndërkombëtare, ku ceket rëndësia dhe vlera e territorit dhe kufijëve shtetëror. Në Republikën e Maqedonisë edhe territori shtetëror dhe kufijtë shtetëror të saj parashihet në nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë. Sipas këtij neni, në paragrafinë 1 të saj ceket për lirin e lëvizjes së qytetarëve të saj ku ceket se: "Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë ka të drejtë që të lëvizë lirisht në territorin e Republikës dhe lirisht ta zgjedhë vendbanimin e tij".[269] Kurse në paragrafin e 2 ceket: "Çdo qytetar ka të drejtë ta lëshojë territorin e Republikës dhe të kthehet në Republikë".[270] Pra, sipas kriterit të territorit dhe kufijve shtetëror ekziston migracion i brendshëm dhe migracion ndërkombëtar

2.1.1. Migracion i brendshëm

Përveç migracionit ndërkombëtar e cila viteve të fundit është shumë e përhapur mes shteteve të Lindjes së Mesme drejt shteteve evopiane ku ekonomija është shumë më e zhvilluar në krahasim nga vendet e tyre të origjinës ekziston edhe migracioni i brendshëm apo nacional. Migracioni i brendshëm është një migracion e cila ndoshta nuk është si ajo ndërkombëtare me flukse të mëdha dhe masovike për periudhë të shkurtër kohore por është më permanent dhe me të cilën nënkuptojmë livizjet e individëve prej një vendi në një vend tjetër, prej një rajoni në një rajon tjetër, për shkaqe të ndryshme qoft nxitëse ose tërheqëse, por në kuadër të kufijve shtetëror të shtetit konkret. Pra, ky lloj I migracionit në vete ngërthen emigrimin dhe imigrimin e njerëzve prej një vendi në një vend tjetër. Pra, emigrimi kombëtar (i brendshëm), tregon largimin e popullsisë nga një vendbanim në ndonjë vendbanim tjetër (komunë, regjion) por, brenda kufijve kombëtar.[271] Llojet e migracionit të brendshëm janë: migracioni urban-urban, urban-rural, rural-rural, rural-urban.


Grafikoni nr.5[272] Numri i qytetarëve të emigruar brenda territorit të Republikës së Maqedonisë sipas viteve



[269] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me Amandamentet e Kushtetutës I-XXX, Shkup, 2006, neni 27
[270] Po aty
[271] Raport. "Migrimi kosovar".Prishtinë, 2014, fq.55
[272] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/175_Migr_reg_VMOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 12.07.2020, ora 12:45

Siç shihet në grafikonin nr.5 edhe Republika e Maqedonisë është i prekur nga proceset e migracionit, në rastin konkret emigrimi i qytetarëve brenda territorit të shtetit sipas viteve, ku viti 2012 dominon me numër më të madh të emigrimeve me 3641, kurse me numër më të vogël të emigrimeve kemi në vitin 2006 me 2837 qytetar.

Grafikoni nr.6[273] Numri i qytetarëve të emigruar brenda territorit të Republikës së Maqedonisë sipas viteve dhe gjinisë




Grafikoni nr.6 paraqet gjendjen reale të emigracionit nacional ku prej vitit 2005 deri në vitin 2015 në çdo vit me numër të madh dallimi dominon numri i emigrimit të gjinisë femërore. Emigracioni i gjinisë femërore më shumë është shprehur në vitin 2012 kurse më pak në vitin 2006 e cila konsolidohet edhe me numrin e përgjithshëm të emigracionit e paraparë në grafikonin nr.5 ku edhe aty më shumë emigracion shihet në vitin 2012, kurse më pak në vitin 2006.

Grafikoni nr.7[274] Emigrimi i brendshëm në Republikën e Maqedonisë sipas viteve dhe regjioneve

[273] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/175_Migr_reg_VMOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 12.07.2020, ora 14:13

[274] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/175_Migr_reg_VMOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 12.07.2020, ora 16:28



Nga grafikoni i paraqitur shihet se nga numri i përgjithshëm prej 34733 të emigrimeve në nivel të shtetit për periudhën 10 vjeçare 2005-2015, në rend të parë është regjioni i Shkupit me 6669 raste (më shumë në vitin 2008 me 811 raste, më pak në vitin 2007 me 452 raste), më pas vijojnë regjionet: Vardarit me 4626 raste (më shumë në vitin 2012 me 503 raste, më pak në vitin 2006 me 359 raste), Lindja me 4525 raste (më shumë në vitin 2012 me 489 raste, më pak në vitin 2010 me 339 raste), Pelagonis me 4409 raste (më shumë në vitin 2012 me 500 raste, më pak në vitin 2006 me 333 raste) Jugperëndimit me 4069 raste (më shumë në vitin 2015 me 417 raste, më pak në vitin 2010 me 324 raste), Verilindjs me 3783 raste (më shumë në vitin 2005 me 393 raste, më pak në vitin 2007 me 313 raste), Pologut me 3616 raste (më shumë në vitn 2005 me 376 raste, më pak në vitin 2010 me 236 raste) dhe Juglindjes me 3036 raste (më shumë në vitin 2015 me 324 raste, më pak në vitin 2006 me 235 raste). Pra, siç shihet për nga numri më i madh i emigrimeve të brendshme sipas regjionit më shumë regjione shprehen në vitin 2012 pastaj në vitin 2015 dhe në fund në vitin 2008, kurse më pak e shprehur është në vitin 2006 sipas regjioneve, pastaj në mënyrë të barabartë shprehet në vitin 2007 dhe 2010.

Këtu vlen të ceket se numri i imigracionit të brendshëm në Republikën e Maqedonisë sipas viteve dhe gjinisë përputhet me numrin e emigracionit të brendshëm në Republikën e Maqedonisë sipas viteve dhe gjinisë të paraqitur në grafikonin nr.5 dhe 6, kurse dallohet vetëm në pjesën e shpërndarjes së regjioneve dhe ate si në grafionin e mëposhtëm.

Grafikoni nr.8[275] Imigrimi i brendshëm në Republikën e Maqedonisë sipas viteve dhe regjioneve

[275] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/125_Migr_reg_VnDos_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të dates 17.07.2020, ora 22:21



Ky grafikon paraqet imigrimin, ardhjen vendosjen e qytetarëve në vendbanime të reja dhe e cila dallon për nga numri në regjionet e vendit ku janë realizuar imigrimet. Shihet se nga numri i përgjithshëm prej 34733 të imigrimeve në nivel të shtetit për periudhën 10 vjeçare 2005-2015, në rend të parë është regjioni i Shkupit me 13702 raste (më shumë në vitin 2015 me 1545 raste, më pak në vitin 2010 me 964 raste), më pas vijojnë regjionet: Jugperëndimit me 3801 raste (më shumë në vitin 2012 me 416 raste, më pak në vitin 2014 me 269 raste), Vardarit me 3273 raste (më shumë në vitin 2013 me 363 raste, më pak në vitin 2006 me 224 raste), Lindja me 2830 raste (më shumë në vitin 2010 me 295 raste, më pak në vitin 2013 me 212 raste), Pologut me 2815 raste (më shumë në vitn 2008 me 305 raste, më pak në vitin 2014 me 182 raste), Pelagonis me 2796 raste (më shumë në vitin 2011 me 359 raste, më pak në vitin 2013 me 261 raste), Juglindjes me 2651 raste (më shumë në vitin 2011 me 271 raste, më pak në vitin 2013 me 195 raste) dhe Verilindjes me 2265 raste (më shumë në vitin 2008 me 269 raste, më pak në vitin 2007 me 146 raste). Pra, siç shihet për nga numri më i madh i imigrimeve të brendshme sipas regjionit më shumë regjione shprehen në vitin 2008 dhe 2011 në mënyrë të barabartë sipas regjioneve pastaj vijojnë në vitin 2010, 2012, 2013 dhe 2014, kurse më pak e shprehur është në vitin 2006 sipas regjionit në vitin 2013më pas vijon viti 2014, pastaj në mënyrë të barabartë shprehet në vitin 2006, 2007 dhe 2010.

2.1.1.1. Migracion i brendshëm urban-urban

Migracioni i brendshëm urban-urban (qytet-qytet) nënkupton lëvizjen e individëve prej një qyteti në një qytet tjetër, për arsye të ndryshme në kuadër të shtetit konkret duke kërkuar një jetë më të mirë nga ajo që e ka ose për shkaqe apo qëllime tjera të ndryshme. Në përgjithësi është e njohur lëvizja e individëve nga qytetet më të vogla dhe më pak të zhvilluara drejt qyteteteve më të mëdha dhe më të zhvilluara sidomos ku ekonomija është më e zhvilluar dhe si shkak i asaj edhe mundësit e punësimit ose të gjetjes së punëve më të mira janë më të favorshme. Në Republikën e Maqedonisë është e përhapur ky lloj i migracionit ku më e theksuar është emigrimi drejt kryqytetit ku Shkupi llogaritet edhe për nga territori edhe për nga numri i institucioneve shtetërore dhe vendet e punës të subjekteve juridike private, pra, të kompanive të ndryshme, ku mundësia e punësimit, investimit dhe krijimit të bizneseve është më e volitshme, në krahasim prej vendeve të tjera urbane brenda shtetit.

2.1.1.2. Migracion i brendshëm urban-rural

Migracioni i brendshëm urban-rural ka të bëjë me lëvizjen e individëve nga vendbanimet urbane në ato rurale, pra nga qytetet në fshatra në kuadër të shtetit konkret për arsye të shumta si p.sh. ndotja e ajrit, mbi popullimi i qyteteve, komunikacioni i stërngarkuar, kërkim i qetësis etj. Ky lloj i migrimit më shumë realizohet nga kategoria e njerëzve të cilët llogariten si të pasur në kuptimin e të mirave materiale duke kërkuar një vend ku do të ketë qetësi, ajër të pastër etj. Në Maqedoni ky lloj i emigracionit drejt periferisë dhe fshatrave përreth viteve të fundit vërehet emigrimet nga qyteti Shkupit si kryeqendër, e cila është e mbipopulluar sidomos gjatë ditës kur shumë njerëz vijnë edhe nga vendet përreth dhe nga qytete të tjera.

2.1.1.3. Migracion i brendshëm rural-rural

Migracioni i brendshëm rural-rural është migracion e cila realizohet nga fshati në fshat në kuadër të territorit të shtetit konkret për arsye të ndryshme nxitëse të fshatit të lindjes ose tërheqëse të fshatit pritës. Ky lloj i migracionit të brendshëm më shumë është e përhapur lëvizjet e migracionit që bëhen nga fshatrat malësor drejt fshatrave fushore ose në fshatra më të mëdha. Në Republikën e Maqedonisë ky lloj i emigracioneve është shumë e përhapur sidomos nga individët të cilët një periudhë kohore ose ende punojnë dhe jetojnë jashtë shtetit sidomos në vendet evropiane ku puna dhe fitimet materiale në krahasim me Maqedoninë kanë dallim të madh. Emigrimi i këtij lloji nga individët që emigrojnë bëhet në ato fshatra ku elementet kryesore për jetë janë të rënda si: infrastruktura, shërbimet shëndetësore, arsimimi dhe kushtet e arsimit, ambienti dhe aktivitetet sociale shpesh u mungojnë, toka nuk është punuese dhe pjellore sepse shumica e popullatës në fshatra mirren me blegtori dhe bujqësi dhe arsye tjera.

2.1.1.4. Migracion i brendshëm rural-urban

Migracioni i brendshëm rural-urban është lloji më i përhapur imigracionit të brendshëm në nivel botëror por e njejta është e shprehur edhe në territorin e Republikës së Maqedonisë.
Ky lloj i emigracionit nënkupton lëvizjen e individëve nga fshatrat malësore dhe fushore drejt qyteteve më të afërt që i kanë në kuadër të shtetit konkret për arsye të ndryshme. Edhe ky lloj i emigracionit të brendshëm është e ngjajshme me migracionin e brendshëm rural-rural (fshatrat malësore drejt fshatrave fushore), në aspektin e faktorëve nxitës dhe shtytës të procesit të migracionit. Edhe te ky lloj shpesh emigrojnë individë të cilët ose vet ose ndonjë anëtar tjetër i familjes ka jetuar ose jeton dhe punon në shtetet perëndimore të cilët në aspektin material e kanë të përmirësuar gjendjen materiale dhe përmes remitancave mund të bëjnë një emigrim të tillë drejt qytetit më të afërt duke blerë tokë, shtëpi. Si shkaqe të emigrimit të këtij lloji edhe këtu llogariten: infrastruktura, shërbimet shëndetësore, arsimimi dhe kushtet e arsimit, ambienti dhe aktivitetet sociale shpesh u mungojnë, toka nuk është punuese dhe pjellore sepse shumica e popullatës në fshatra mirren me blegtori dhe bujqësi dhe arsye tjera, pra me një fjalë emigrojnë për një jetë më të mirë nga vendi i tyre i origjinës. Industrializimi dhe urbanizimi ndjeken rregullisht nga lëvizja masovike të popullsisë nga fshati në qytet që në letërsi quhet migracion.[276]


Nga kjo del në Republikën e Maqedonisë, tek migracioni i brendshëm nëse urbanizimi tejkalon një normë (nivel) të caktuar të zhvillimit të saj, sasia e migrimit nga zonat rurale në ato urbane do të bëhet më e madhe se emigrimi nga qyteteti në qytet.

2.1.2. Migracioni ndërkombëtar

[276] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164

Ndër tipat e rëndësishëm të migrimeve të popullsisë janë migrimet e jashtme, të njohura si migrime ndërkombëtare, që zhvillohen midis vendeve, pastaj brenda kontinenteve dhe midis kontinenteve.[277] Me fjalën migracion ndërkombëtar nënkuptojmë lëvizjen e individëve nga një shtet në një shtet tjetër, e cila mund të jetë shtet fqinjë ose shtet më i largët, për arsye të ndryshme nga shteti i origjinës (arsye që e shtyjnë ose nxisin individin në vendimmarrje) dhe nga shteti i destinacionit ose pritës (arsye që e tërheqin individin në vendimmarrje). Gjatë migracionit ndërkombëtar kur kemi lëvizjen e individëve në shtete fqinje nuk kemi shtet tranzit por vetëm vendosje nga territori i shtetit të origjinës në shtetin fqinjë pritës, kurse kur kemi lëvizjen e individëve që emigrojnë në një shtet jo-fqinjë ose në shtet më të largët ndonjeherë ndodhë që shteti i destinacionit të jetë një shtet të një kontinenti tjetër atëherë kemi edhe shtetin ose shtetet tranzit nga ku kalojnë migrantët e cila ka detyra dhe obligime të menaxhimit të këtyre lëvizjeve. Pra, me migracionin ndërkombtar nënkuptojmë lëvizjet migratore të personave prej një vendi drejt një vendi duke lëvizur përtej kufirit shtetëror, nga e cila edhe Maqedonia është e prekur si në tabelën e mëposhtme.

Grafikoni nr.9[278]




Ky grafikon paraqet lëvizjen apo migrimin e njerëzve për çdo 5 vjet dhe ate prej vitit 2005 deri në vitin 2015 shënon një rritje permanente dhe shihet se migracioni ndërkombëtar nga viti 2005 me 191.6 milion raste në vitin 2010 arrin deri në 222.8 milion dhe në vitin 2015 kur edhe u rrit numri i lëvizjeve të migracionit nga Lindja e Mesme drejt shteteve perëndimore arrin në 248.9 milion raste dhe e cila është në rritje e sipër sot e kësaj dite.

Grafikoni nr.10[279]

[277] Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012, fq.38

[278] https://migrationdataportal.org/?i=stock_abs_&t=2019&m=4, të datës 18.08.2019, ora 10:12

[279] https://migrationdataportal.org/?i=stock_perc_&t=2019&cm49=807, të datës, 18, ora 11.29




Kjo tabelë paraet sasinë apo stokun e migrantëve ndërkombëtar e cila është e llogaritur në përqindje dhe e njejta tregon se viti 2010 dhe 2015 është në rritje të sasisë në krahasim me vitin 2005 prej 0,10% të migrantëve ndërkombëtar në nivel botëror.

Pra, sipas definicioneve dhe standardeve mbi emigrimin ndërkombëtar: një person është emigrant nëse ai/ ajo ka lënë vendin e tij/saj të lindjes në mënyrë që të vendoset përgjithmonë në një shtet tjetër pa marrë parasysh nëse ai / ajo ka ndonjë status të veçantë në vendin në të cilin ka emigruar.[280] Kjo bëhet edhe më aktuale në ditët e sotme, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se përafërsisht, vlerësohet se në ditët e sotme jetojnë diku rreth 214 milion njerëz jashtë vendit të vendlindjes së tyre ose 3% e numrit të përgjithshëm të njerëzimit, dhe se ky numër ka pësuar rritje enorme, veçanërisht në 20 vitet e fundit.[281] Historikisht edhe Republika e Maqedonisë edhe si shtet i pavarur edhe si territor në kuadër të sistemit të ish Jugosllavisë ka qenë i prekur nga proceset e migracionit sidomos në emigrimin e njerëzve nga vendi drejt shteteve tjera më shumë se 100 vjet. Si pasojë veçohen katër periudha:

- Periudha e parë, nga 1945 deri në fillim të viteve gjashtëdjeta, karakterizohet me emigrim intensiv të njerëzve me kombësi turke, kurse numri i qytetarëve të tjerë që u larguan nga vendi është relativisht i vogël,
- Periudha e dytë, 1961-1975, përkon me intensifikimin e emigracionit ekonomik - punësim të përkohshëm jashtë vendit dhe zhvendosje të përhershme në vendet tejoqeanike,
- Në periudhën e tretë, 1976-1990, pati një ulje të punësimit jashtë vendit, kthim më intensiv të punëtorëve migrantë, ribashkim të familjeve të atyre që mbetën, vetë-riprodhim të kontigjentit të migracionit dhe shndërrim gradual të qëndrimit të përkohshëm në përhershëm,
- Intervali kohor nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë deri më sot, dallohet si një periudhë e veçantë në të cilën është vërejtur vala më e madhe e emigracionit që nga fillimi i emigracionit ekonomik në vitet gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar.[282]


[280] Raport. "Migrimi kosovar". Prishtinë, 2014, fq.18
[281] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.6
[282] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.12

Grafikoni nr.11[283] Emigrimi i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në shtete tjera sipas viteve



Në këtë grafikon e kemi paraqitur numrin e emigrimeve të shtetasve të vendit drejt shteteve të tjera, pra emigrimin ndërkombëtar sipas viteve. Nga grafikoni nr.11 mund të përfundojmë se gjatë perudhës 2005 deri 2015 emigrimi ndërkombëtar më shumë është shprehur në vitin 2012 me 1330 raste, më pas vijon viti 2005 me 1282 raste dhe në rendin e tretë është viti 2011 me 1143 raste. Emigrimi ndërkombëtar më pak i shprehur është në vitin 2007 me 224 raste.

Grafikoni nr.12[284] Imigrimi i qytetarëve në Republikën e Maqedonisë nga shtetet tjera sipas viteve



Grafikoni i paraqitur tregon se edhe vendi ynë nuk është imun ndaj imigrimit të të huajve në vendin tonë ku sipas viteve të paraparë prej 2005 deri 2015 më shumë të huaj të vendosur në vendin tonë është në vitin 2006 me 545 të huaj më pas vijon viti 2005 me 524 raste dhe 2013 me 490 raste, kurse numri më i vogël i zhvendosjes së huajve në Maqedoni është në vitin 2008 me 219 raste.

[283] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/725_VM_Migracii_VkDosOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 16.07.2020, ora 11:10

[284] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Naselenie__VnatresniMigracii/725_VM_Migracii_VkDosOts_mk.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 15.07.2020, ora 08:23

Imigrimi i të huajve në vendin tonë është si pasojë e faktorëve të ndryshëm që mund të llogariten si shkak i: hapjes së bizneseve, studimeve, bashkimit familjar etj.

2.1.2.1. Migracioni ndërkombëtar i rregullt

Migracioni ndërkombëtar i rregullt konsiderohet lëvizja e individit nga shteti i origjinës drejt shtetit të destinacionit (pritës), për arsye të shkaqeve të ndryshme duke i respektuar rregullat ligjore për kompletimin e dokumentacionit që kërkohet nga shteti që e lëshon, shteti që kalon tranzit dhe nga shteti që e pranon, me qëllim që migracioni të jetë ligjor dhe i regullt. Varësisht nga faktorët që ndikojnë në emigracionin e njerëzve individët migrant duhet të kompletojnë dokumentet e nevojshme siç janë aplikimi i vizave të punës në ambasadat e vendit, marrëveshje me kompani në vendet e destinacionit cilët janë garancë e punës (nëse kemi shkaqe ekonomike), gjetja a banesës për qndrim, aplikimi për të drejtën e azilit dhe qëndrimi në kampe refugjatësh nëse kemi faktorin e luftërave, epidemive etj. Por ka raste edhe kur emigrimi bëhet përmes rrugës së martesave ose bashkimit familjar duke i respektuar ligjet e shteteve konkret të origjinës dhe të destinacionit. Në Republikën e Maqedonisë ky lloj si shkak i martesave dhe bashkimit familjar është i përhapur shumë. Migrantët kanë tendencë që përmes vendosjes, grumbullimit dhe hyrjes grupore të kyçen në zinxhirin e lidhjes shoqërore (ashtuquajtura migracioni zinxhiror manifestohet në ftesën e emigrantëve nga vendet e origjinës).[285]

2.1.2.2. Migracioni ndërkombëtar i parregullt

Përveç mënyrës së hyrjes së rregullt dhe ligjërish të lejuar të individëve në kufijt e shteteve kemi raste edhe të hyrjes jo të rregullt apo illegal, përdorimin e dokumenteve të falsifikuara të udhëtimit ose mos respektimin e afatit të qëndrimit për individët të cilët më veç kanë emigruar dhe me kalimin e afatit ata nuk e lëshojnë shtetin konkret duke u transformuar si emigrant të parregullt ose ilegal. Shpesh ky lloj i migracionit emërtohet edhe si migracion ilegal, migracion klandestin ose të padokumentuar. Pra, me fjalën migracion ndërkombëtar i parregullt nënkuptojm migrantin i cili në shtetin tranzit apo në shtetin e destinacionit ka realizuar hyrje-dalje të paligjshme apo afati i qëndrimit sipas shtetit tranzit ose destinacionit ka kaluar.

2.2. Sipas kriterit të numrit të personave që migrojnë

Kriteri i numrit të personave ka të bëj me sasinë e migracionit, pra migracionin e një personi ose migracion ku marin pjesë dy ose më shumë persona në të njëjtën kohë. Kjo ka rëndësi të veçantë se nëse bëhet fjalë për flukse të migrantëve atëherë ky numër mund të jetë edhe me qindar mijëra apo miliona njrëz migrantë të cilët japin një mund, dhe sakrifice për shtetin kufirin e të cilit duhet të kalojnë sidomos gjatë hyrjes në territorin e tij.

2.2.1. Migracion individual

Migracioni individual është migracioni i cili në të shumtën e rasteve zhvillohet në kohë të paqes dhe në kushte normale (pa ndonjë fatkeqësi natyrore, luftëra ose shkaqe tjera që e detrojnë)

[285] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama”. Zagreb, 1985, fq.147

dhe nënkupton kur një individ për shkaqe të ndryshme migron nga vendi i tij i origjinës dhe vendoset në një vend tjetër për të siguruar një jetë më të mirë për të dhe anëtarët tjerë të familjes.

2.2.2. Migracion grupor

Ky lloj i migracionit vin në shprehje më shumë kur si faktorë paraqiten luftërat, pushtime, fatkeqësirë natyrore dhe shkaqe tjera dhe ndikon që njerëzit ose grup njerëzish të vendosen nga vendet e tyre të origjinës. Lidhja grupore vepron si një element mbrojtës[286] gjatë migracionit grupor duke I tejkaluar së bashku pengesat gjatë lëvizjeve të tyre brenda ose jashta shtetit.

2.3. Sipas kriterit kohor

Kriteri kohor ka të bëj me kohëzgjatjen e periudhës kohore të vendosjes së migrantëve në vendet e destinacionit, të cilët mund të migrojnë për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar.

2.3.1. Migracion i përkohshëm

Migracioni i përkohshëm ka të bëjë me vendosjen e migrantëve në vendin e destinacionit për një periudhë të caktuar, e jo për një emigrim për përgjithmon. Te migracioni I përkohshëm më shumë janë personat që vendosen përkohësisht në vendin e destinacionit si shkak I punëve sezonale, shëtitjet turistike, studime apo specializime të ndryshme, kërkime shkencore etj.

2.3.2. Migracion i përhershëm

Migracioni i përhershëm është migracioni për një periudhë të përhershme ose të përjetshme ku individi vendos të marrë edhe nënshtetësinë e vendin të destinacionit dhe të vazhdojë jetën në atë shtet. Deklarata universal për të drejtat e njeriut në paragrafin 2, të nenin 15 parasheh :"Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij, e as nga e drejta për të ndërruar shtetësinë."[287] Pra, duke respektuar liritë dhe të drejtat e njeriu, çdo kujt i lejohet e drejta për ta ndërruar shtetësinë, por nuk mund të privohet nga shtetësia që e ka.

2.4. Sipas kriterit të cilësisë së migrantëve

Kriteri i cilësis së migrantëve nënkupton cilësin në aspektin e përgaditjes profesionale të individëve që migrojn dhe kryerjen e shkollave profesionale me kualifikme të profileve të caktuar.

2.4.1. Punëtor pa kualifikim arsimor

Ky lloj i punëtorëve ka të bëj me individët që migrojnë por që nuk kanë ndonjë kualifikim ose arsim në ndonjë fushë të caktuar por thjesht janë individë për fuqi punëtore të cilët shpesh në

[286] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.147

[287] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948, neni 15, paragrafi 2

praktikë përdoren më shumë për punë fizike në vendet ku migrojnë. Migrantët pa kualifikim shumica janë me arsim fillor, të mesëm ose pa arsim dhe të cilët si fuqi punëtore më shumë angazhohen në fabrika, miniera, plantazhe, punë bujqësore, punë në ndërtimtari etj.

2.4.2. Punëtor me kualifikim arsimor

Punëtor me kualifikim arsimor në përgjithësi janë individët që kanë kryer shkollë të mesme profesionale ose arsim të lartë ose janë magjistra apo doktora shkence në lëmi të ndryshme të cilët përndryshe quhen edhe migrantë truri. Këtu nuk mungojnë edhe profilet e migrantëve që kanë arsim dhe përgaditje profesionale në zanate dhe mjeshtri të fushave të ndryshme. Në vendin tonë viteve të fundit shumë të diplomuar në drejtimin e mjekësis, informatikës dhe arkitekturës janë duke migruar drejt Gjermanisë e cila para disa viteve fillojë të marrë migrantë me kualifikim arsimor si mungesë e disa profileve në vendin e vet, e cila ndikoj që shumë individ të këtyre profesioneve të largohen nga Maqedonia.

2.5. Sipas kriterit individual të dëshirës së migrantëve

Kriteri individual i dëshirës së migrantëve nënkupton lëvizjen e individëve sipas dëshirës ose kundër dëshirës së tyre, nga një vendbanim në një vendbanim tjetër për shkaqe të ndryshme brenda territorit shtetëror ose jashta saj (migracion ndërkombëtar).

2.5.1. Vullnetar

Migracioni vullnetar vin në shprehje kur individi cili migron është vullnetarisht I përcaktuar dhe pa ndikimin e faktorit të persanova tjerë ose shkaqeve tjera shoqërore apo natyrore, por ai emigron nga vendi i tij sipas dëshirës individuale. Migracioni vullnetar vin në shprehje në raste kur individi kërkon punë më të mire, kushte më të mira sociale dhe shoqërore etj.

2.5.2. Detyruar

Ndryshe nga migrantët vullnetarë, refugjatët dhe azilkërkuesit nuk migrojnë vullnetarisht, ata janë të detyruar të migrojnë për të mbrojtur sigurinë e jetës, shëndetin, besimet dhe identitetin e tyre.[288] Pra, Migracioni i detyruar është ai migracion kur individi detyrohet apo është i shtyrë kundër dëshirës së tij të emigroj nga vendbanimi i tij në një vendbanim tjetër kuadër të shtetit ose jashtë saj. Migracioni i detyruar më shumë vin në shprehje në rastë të varfërisë së madhe dhe skamjes, shkak i luftërave dhe sigurisë, shkak i ndjekjeve dhe pushtimeve të ndryshme, shkak i fatkeqësive natyrore etj. Të detyruar ti lëshojnë shtepitë flitet atëherë kur migranti më ska asnjëfarë mundësie të vendosë.[289] Është e qartë se mungesa e arsimit cilësor, mundësive ekonomike, pabarazisë, ndryshimit të klimës dhe qeverisjes kombinohen për të formuar shkaqet themelore të zhvendosjes së detyruar.[290]

---

[288] Pačariz, Sabina. "The migrations of bosniaks to Turkey from 1945 to 1974", The case od Sandžak. Sarajevo, 2016, fq.22

[289] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.260

[290] https://www.undp.org/content/undp/en/home/blog/2019/migrant--displacement-and-the-sdgs-at-the-high-level-political-f.html, të datës 09.09.2020, ora 11:12

2.6. Sipas kriterit të territorit ku gjindet migranti

Territori i shtetit gjatë proceseve të migracionit ka rëndësi sepse proceset e migracionit zhvillohen në kuadër të territorit të disa shteteve dhe nga kjo varet se cili shtet e ka për obligim të menaxhoj me migrantët të cilët shpesh janë edhe masovike ku paraqiten probleme me menaxhimin e këtyre flukseve si dhe koordinimin e detyrave në mes të institucioneve të shteteve konkrete.

2.6.1. Migracioni në territorin e shtetit të origjinës

Migracioni në territorin e shtetit të origjinës është migracioni i shtetit amë ku personi migrantë më veç ka vendosur të emigrojë jashtë shtetit ose në kuadër të shtetit por në një vendbanim tjetër. Në shtetin e origjinës shpesh individët emigrojnë për shkaqe të ndryshme si shembull ikja nga shkaku i luftës ku emigrojnë në vende më të sigurta brenda shtetit ose jashta saj në shtete tjera. Ka raste kur migrantët edhe në këto shtete sidomos nga shkaku i luftës lëvizin territore të gjata derisa të dalin nga territori i atij shteti dhe pastaj duke kaluar direkt në shtetitn e destinacionit ose përmes shtetit tranzit kalojnë në shtetin e destinacionit.

2.6.2. Migracioni në territorin e shtetit transit

Ky lloj i migracionit ndodh kur kemi migracion ndërkombëtar ku shpesh migrantët kalojnë një periudhë kohore dhe hapësira të mëdha dhe të gjata territoriale në shtetin tranzit derisa të arrijnë në shetetet e destinacionit. Qëllimi i migrantëve nuk është të mbeten në territorin e shteteve tranzit dhe janë të rralla kur migrantët mbeten në shtetet tranzit duke aplikuar për azil. Roli i këtyre shteteve tranzit është të siguroj një menaxhim efikas për një tranzit të rregullt dhe të ligjshëm të migrantëve drejt shtetit të destinacionit si dhe ti mbroj liritë dhe të drejtat themelore të migrantëve derisa gjenden në territorin e shtetit tranzit.

2.6.3. Migracioni në territorin e shtetit të destinacionit

Ky lloj i migracionit më është destinacioni fundit ku migrantët shpesh e kanë edhe si pikësynim që nga vendi i tyre të origjinës. Vendet e destinacionit zgjidhen shpesh ato vende ku migrantët i kanë familjarët, shokët apo miqtë e tyre me qëllim të bashkimit familjar ose për gjetje të punës dhe për të siguruar një jetë më të mire ose mendojnë se në ato vende do të sigurojnë një jetë dhe perspektive më të mirë.

3. Subjektet e proceseve të migracionit

Gjatë proceseve të migracionit (emigrime, imigrime dhe kalim tranzit) qoftë në kuadër të territorit të një shteti ose asaj ndërkombëtar subjektet kanë një rol të madh dhe kryesor si, aktorë kryesorë të këtyre proceseve pa të cilat nuk do të ekzistonte migracioni. Edhe pse në shikim të parë migranti shihet si subjekt kryesor dhe i vetëm në proceset e migracionit, por subjekti tjetër i cili lejon ose ndalon, e lehtëson procedurën ose e komplikon llogaritet edhe shteti si subjekt.

3.1. Shteti si subjekt

Shteti mund të llogaritet edhe subjekti kryesor përshkak se me institucionet e saja dhe me regullativën juridike të saj por me pajtueshmëri të plotë me aktet juridike ndërkombëtare i ka të caktuar parimet kryesore lidhje me lejimin dhe ndalimin e emigrimeve dhe të imigrimeve të shtetasve të tij dhe të huaj gjegjësisht të drejtën dhe lirin e lëvizjes së qytetarëve. Shteti është subjekti kryesor i cili në kuadër të territorit të shtetit të vet ka detyra dhe obligime në lidhje me proceset e migracionit dhe migrantët. Me shtet nënkuptohet çdo "njësi" e organizuar nga një popullsi e përhershme në një territor të kufizuar, i cili kontrollohet nga kjo popullsi nëpërmjet një sistemi politik të organizuar.[291] Republika e Maqedonisë në nenin 29, paragrafin 2 rregullon lëvizshmërin e të huajve drejt Maqedonisë ku bën pjesë e drejta e azilit për të huajt dhe për personat pa shtetësi si shkak i bindjeve dhe përcaktimeve politike. Përgjegjësia dhe detyra e shtetit si e drejtë diskrecionale është që të sigurojë implementimin e drejtave të individëve që dëshirojnë të emigrojnë, imigrojnë ose të kalojnë duke e mbrojtur sigurinë shtetërore me kontrollimin e kufijve dhe të vendos për pranimin dhe mospranimin e të huajve ose largimin e të huajve nga territori i shtetit ose dëbimin e tyre nëse janë me qëndrim të kundërligjshëm ose kanë kryer vepra penale. Kufizimet nga ana e shteteve konkrete është sipas parimit të drejtës autoritative të shtetit.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike në nenin 13 të saj parashah se: "Një i huaj që ndodhet ligjërisht në territorin e një shteti palë të këtij Pakti mund të dëbohet nga ai shtet vetëm sipas vendimit të marrë në bazë të ligjit dhe me përjashtim të rasteve kur arsyet e forta lidhur me sigurinë kombëtare nuk e lejojnë një gjë të tillë, atij duhet t'i jepet mundësia të parashtrojë arsyet kundër dëbimit të tij dhe të kërkojë shqyrtimin e çështjes së tij nga një organ kompetent ose nga një a më shumë persona të caktuar posaçërisht nga ky organ, duke qenë i përfaqësuar aty edhe ai vetë."[292] Politikat migratore të shteteve marrin parasysh interesat edhe të shtetit por edhe të migrantëve me qëllim sigurimin e të siç janë: shëndetin, sigurinë, mirëqënien sociale, kulturore dhe ekonomike. Shtetet janë ato që vendosin për kushtet dhe kriteret ndaj personave që dëshirojnë të migrojnë ose emigrojnë, të lejohen të hyjnë dhe ata që mund të qëndrojnë, në pajtueshmëri me ligjet pozitive të shtetit dhe aktet ndërkombëtare të kësaj çështjeje duke e reskpektuar parimin e jodiskriminimit dhe parimin e moskthimit cilët janë pjesë e së drejtës zakonore ndërkombëtare. Deklarata universale për të drejtat e njeriut në nenin 13 të saj më detajisht e ka caktuar edhe lirin e lëvizjes së njerëzve ku në dy paragrafet e saj thot: 1. " Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të çdo shteti."[293] dhe 2. "Gjithkush ka të drejtë të largohet nga cilido vend qoftë, përfshirë këtu edhe të vetin, si dhe të kthehet në vendin e vet"[294]. Në paragrafin 1 të nenit 13 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut kuptojm se shtetet duhet të garantojnë të drejtën dhe lirinë e lëvizjes apo qarkullimi brenda vendit, pra gjithkush që ndodhet brenda kufijve të një shteti ka të drejtë të shkojë nga një vend drejt një vendi tjetër të shtetit në mënyrë lirshëm pa kufizime. Gjithashtu edhe e drejta e banimit brenda një shteti është i përfshirë me të cilën kuptojmë se çdo njeri që jeton në një shtet të caktuar ka të drejtë të ketë një vend banimi, në këtë shtet. Në paragrafin e dytë të nenin 13 parashihet të drejtën e largimit nga cilido shtet, përfshirë këtu edhe shtetin shtetas i të cilit je. Në fund të kësaj ceket edhe e drejta e kthimit në vendin origjinë, pra çdo kush ka të drejtën që nëse është larguar nga shteti i vet, të

[291] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.43

[292] Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, hyrja në fuqi: 23 mars 1976, neni 13

[293] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948, neni 13, paragrafi 1

[294] Po aty, paragrafi 2

rikthehet. Të drejtat e parapara me nenin 13 të Deklaratës mundë të llogaritet edhe si të drejta të imigrimit.

Sipas parimit të moskthimit shteteve nuk ka mbetur gjë tjetër përveç se të reduktojnë hyrjen e të huajve e cila nga ekspertët ekonomik llogaritet edhe si rrezik në tregun e punës për shtetasit e vet, duke forcuar kriteret për hyrje përmes dhënies së vizës për qëndrim ose punë. Përveç rrezikut në tregun e punës për shtetasit e vendit në reduktimin e hyrjeve apo dhënies së vizave shtetet e kanë forcuar kontrollet kufitare edhe shkak i akteve terroriste në nivel botëror sidomos pas ngjarjeve të 11 shtatorit të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku shumë njerëz ishin viktima të këtij sulmi dhe pas kësaj shumë shtete filluan zbatimin e masave më rrigoroze ndaj të huajve shkëmbim dhënave mes shteteve, kontrolle më të detajuara me skener në vendkalimet kufitare, identifikimi biometrik, përdorimin e qenve të stërvitur për kërkim të gjurmëve të ndryshëm sidomos për gjetjen e mjeteve dhe substancave eksplozive dhe narkotike, gjurmët e gishtave etj. Pra, reduktimi apo aplikimi i kritereve rrigoroze nga ana e shtetit për hyrjen e të huajve më shumë ndikohet nga shkaqet ekonomike duke i avancuar rolin e shtetasve të vet dhe shkaqe të mjeteve financiare të cilët dë ti shfrytëzojnë për mbulimin e shpenzimeve të veta dhe anëtarëve tjerë të familjes derisa sa qëndrojnë në shtetin konkret.

3.2. Migranti si subjekt

Përveç shtetit si subjekt I proceseve të migracionit paraqitet edhe migrant si subjekt dhe gëzon të drejtën të lëvizë lirshëm dhe të zgjedh vendin ku do të lëviz, jetoj ose punoj sipas të drejtës nacionale të shtetit konkret po edhe sipas të drejtës ndërkombëtare. Shtetet kanë ndikim të drejtpërdrejtë në garantimin dhe implementimin e të drejtave dhe lirive themelore të migrantëve, të parashikuara me aktet ndërkombëtare për të drejtat të njeriut, drejtn ndërkombëtare zakonore dhe drejtën nacionale. Migrantët kanë drejtë të zgjedhin vendin ku do të emigrojnë duke i respektuar ligjet e shtetit të destinacionit dhe në shtetin e destinacionit i njihet e drejta e punës. Imigranti është pakicë në mjedisin e ri, me situata të konfliktit të përditshëm për arsye të thjeshtë sepse mjedisi i tij i ri është ndërtuar sipas nevojave, zakoneve, shprehive, kulturave, kushteve natyrore, psikologjike të mjedisit dhe njerëzve që kanë jetuar aty dhe jetojnë përher.[295] Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre i përforcon të drejtat themelore të njeriut të parapara në akte ndryshme ndërkombëtare dhe në një mënyre e shqyrton në mënyrë më të detajuar të drejtat e punëtorëve migrantë. Migrantët në shumë shtete gjenden në diksriminime dhe kufizime të ndryshme dhe vijnë në një situate të pambrojtur në lidhje me punësimin, e cila mund të ndikoj në paraqitjen e veprës penale të kontrabandimit të punëtorëve. Konventa parasheh standartet minimale të mbrojtjes në kuadrin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të punëtorëve migrantë, përfshire edhe ata që gjenden në situatë të parregullt, duke qenë i pari dokument i këtij lloji në kuadrin e të drejtave të migrantëve. Çdo shtet duhet ti respektoj këto detyrime që dalin nga kjo Konventë e cila në nenin 7 të pjesës së dytë thot se duhet të respektohet dhe realizohet "në përputhje me instrumentat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut".[296] Është e natyrshme që migrantët, si të gjithë njerëzit me status jo-migrantë të gëzojnë liritë dhe të drejtat e njeriut të parashikuara në akte ndërkombëtare. Neni 2 i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre si punëtor migrant

[295] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.145

[296] Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 1998, hyri në fuqi në 1 Korrik 2003, pjesa II, neni 7

cekën: "çdo person që punon, do të punojë apo ka punuar në një vend pune kundrejt shpërblimit në një shtet në të cilin ai nuk është shtetas".[297] Çdo anëtar për të cilin kjo Konventë është në fuqi zotohet të respektojë të drejtat themelore të njeriut për të gjithë punëtorët migrantë.[298] Liritë dhe të drejtat e njeriut, duhet t'i garantohen të gjithë individëve të pranishëm në një shtet, pa diskriminim përshirë dhe migrantëve pavarësisht nga statusi i tyre ligjor apo kohëzgjatja e qëndrimit, por vetëm në raste të caktuara me ligj. Edhe Kushtetuta e Maqedonisë në nenin 54, paragrafi 2 të saj parasheh kufizim të lirive dhe drejtave në raste të caktuara ku ceket: "Liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit mund të kufizohen gjatë kohës së gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme sipas dispozitave të Kushtetutës"[299], përndryshe liritë dhe të drejtat e njeriut nuk mund të kufizohen në kushte normale.

Ndalimi i diskriminimit parashihet edhe në Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore: "Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër."[300] Vetë përkufizimi i diskriminimit, dmth mos-diskriminimi në Ligjin për procedurën penale nuk është vendosur drejtpërdrejt, por një numër dispozitash të Ligjit për procedurën penale indirekt i referohen parimit të trajtimit të barabartë të përcaktuar nga Deklarata Universale për të drejtat e njeriut, Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe direktivat evropiane.[301] Natyrisht, kush vepron në mënyrë të paligjshme, përgjegjësia e tij duhet të merret parasysh.[302]

Në përgjithësi të drejtat e migrantëve si subjekt i proceseve të migracionit janë të njejta me drejtat e çdo qytetari që i gëzon në shtetitn e vet siç janë: e drejta për t'u larguar nga çdo shtet dhe e drejta për të hyrë dhe qëndruar në vendin e vet, e drejta e jetës, ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor, ndalimi i skllavërisë, punës së detyruar apo me forcë, e drejta e mendimit, e drejta e punës, e drejta e qarkullimit të lirshëm, e drejta e lirisë dhe sigurisë së personit, ndalimi i dëbimit pa arsye etj. "Neni 3 i KEDNJ-së parashikon që askush nuk do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues ose dënimit. Sipas nenit 11 të Kushtetutës, integriteti fizik dhe moral i njeriut është i paprekshëm. Çdo formë e mashtrimit, trajtimit çnjerëzor ose poshtërues dhe ndëshkimi është e ndaluar."[303] Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre e vitit 1998 parasheh se të drejtat e parashikuara do të respektohen pa asnjë dallim racor, kombësis, statusi martesor, statusi gjinor ose statusi financiar, e cila në nenin 45 parasheh:

1. Anëtarët e familjeve të punëtorëve migrantë gëzojnë në shtetin e punësimit barazi në trajtim me shtetasit e atij shteti, në lidhje me,

a) të drejtën për në institucione dhe shërbime arsimore, në pajtim me kërkesat për pranim dhe rregulla të tjera të institucioneve dhe shërbimeve përkatëse,

---

[297] Po aty, neni 2

[298] Konventa për Migrimet në Kushte Abuzive dhe mbi Nxitjen e Barazisë së Mundësive dhe të Trajtimit të Punëtorëve Migrantë. C143, miratuar më 1975 Gjenevë, hyrja në fuqi 1978, neni 1

[299] Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë me Amandamentet e Kushtetutës I-XXX, Shkup, 2006, neni 54, paragrafi 2

[300] Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, 4.XI.1950, neni 14

[301] Анализа. "Меѓународните стандарди и најдобри практики и на постоечките национални закони, политики и планови на антидискриминаторската легислатива". Скопје, 2010, fq.104

[302] Sözüer, Adem."Türk Ceza Hukuku Mevzuatı". Istabul, 2013, fq.11

[303] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.12

b) të drejtën për udhëzim profesional dhe shërbimet e institucioneve të trajnimit, me kusht që të përmbushen kushtet për pjesëmarrje,
c) të drejtën për shërbimet shoqërore dhe shëndetësore, me kusht që të përmbushen kërkesat për pjesëmarrje në skemat përkatëse,
d) të drejtën dhe pjesëmarrjen në jetën kulturore.[304]

4. Pasojat dhe efektet e proceseve të migracionit në shtetin e origjinës

Proceset e migracionit në përgjithësi e në veçanti emigrimi i popullatës nga vendi i përhershëm i tyre drejt shteteve apo vendbanimeve të tjera në kuadër të shtetit domosdo të ketë edhe pasoja dhe efekte në shtetin konkret. Pasojat dhe efektet mund të jenë edhe pozitive por edhe negative. Si pasoja dhe efekte që reflektohen shtetit të origjinës janë:
Pasojat dhe efektet demografike Demografija si shkencë ka për detyrë të studjoj dhe analizoj popullatën e një vendi. Pra, demografija është shkencë shoqërore e cila në kuptimin kuantitativ studjon dhe planifikon popullsinë, lëvizshmërinë e saj numerike, strukturën, karakteristikat socio-ekonomike dhe shpërndarjen në hapësirë.[305] Ndryshimet në shpërndarjet rajonale të dendësisë së popullsisë vijnë si rrjedhojë jo vetëm e lëvizjes së brendshme, por edhe e emigracionit.[306] Kështu që në shumë vende të botës por edhe në Maqedoni numri i popullsisë së përgjithshme dhe ndryshime në gjininë e popullsisë së përgjithshme si dhe mungesën e të rrinjve dukshëm është rritur si pasojë e emigrimeve të shumta. Emigrimit nga Maqedonia më shumë ka reflektuar tek të rrijtë të gjinisë mashkullore, ku ndjeshëm është rritur mungesa e të rrinjve e cila mund të vërehet në zvoglimin e numrit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore dhe e cila llogaritet si kategori active e popullatës. Nataliteti ose lindshmëria paraqet element pozitiv e cila ndikon në rritjen e e lëvizshmërisë natyrore të popullsisë.[307] Gjithashtu duke u bazuar në atë se emigrantët më shumë janë të gjinisë mashkullore paraqitet një proporcion ku gjinia femërore bëhet më dominante sesa meshkujt e cila quhet edhe si feminizmi i migracionit. Por migrimi ka qenë ndoshta ndër të vetmet zgjidhje afatshkurtra për mbijetesën e familjeve më të varfëra, apo përmirësimin e kushteve të jetesës së të tjerave, në kushtet e kolapsit të plotë ekonomik, por edhe politik dhe social.*[308]* Kjo më së shumti mundë të ndikojë në numrin e popullatës në vendet rurale përshkak se emigrimet që ndodhin qoftë brenda shtetit apo ndërkombëtar më shumë si vende origjine llogariten vendet rurale (fshatrat). Kështu që për një periudhë kohore të shkurtër zonat rurale mundë të jetë e rrezikuar nga rreziku i zbrazjes[309] (emigrimit).
Gjithashtu, emigrimi i popullsisë ka ndikuar edhe në uljen natalitetin e cila është shtylla kryesore e shtetit nga e cila varet edhe numri i popullsisë së përgjithshme të shtetit sidomos të të rrinjve. Efekti i migrimit, i kombinuar me rënien e vlerave të lindshmërisë, është përshpejtimi i mplakjes

[304] Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 1998, hyri në fuqi në 1 Korrik 2003, neni 45, paragrafi 1
[305] Димитров, Никола. "Демографија". Битола, 2013, fq.9
[306] Strategjia kombëtare. "Migracioni dhe plani i veprimit për migracionin". Tiranë, 2005, fq.13
[307] Димитров, Никола. "Демографија". Битола, 2013, fq.37
[308] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.175
[309] Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës "İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri:TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul'a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ". Erzurum, 2012, fq.31

së popullsisë së lënë pas[310] ka ndikuar në moshën e popullatës. Emigracioni ka ndikim negative të fuqishëm ndaj riprodhimit të popullatës, sepse "eksporti" i femrave në periudhën fertile sjell deri në nivel të ulët të shkallës së lindjeve e cila pritet jo vetëm gjatë 10-15 vitet e ardhshme, por edhe për periudhën më të gjatë e cila vjen, sidurisht për 40-50 vite si dhe me uljen e emigracionit në sasi të madhe do të zbuten pasojat cilët paraqesin procesin e plakjes demografike të popullatës së përgjithshme[311] mund të llogarisim si efekt pozitiv. Remitancat ose dërgesa e të mirave materiale nga emigrantët kanë efekte positive sidomos për anëtarët tjerë të familjes që I kanë në shtetin e origjinës ka ndikuar në uljen e varfërisë, duke siguruar ushqim, veshëmbathje dhe regullim të kushteve të banimit.

Pasojat dhe efektet ekonomike: nga emigracioni i njerëzve është pozitiv në ekonominë e vendit si rezulltat i dërgesave materiale të emigrantëve (remitancave) dhe se buxheti i dërguar shpenzohet në shtetin e origjinës. Dërgesat e emigrantëve përbëjnë një nga shtyllat kryesore të ekonomisë duke siguruar një hyrje të vazhdueshme të valutave të huaja në vend si edhe duke konsoliduar bazën për kursime dhe investime. Nganjëherë ndodh që përmes remitancave të investohet edhe në biznese më të vogla për anëtarët që janë pa punë në vendin e origjinës duke mundësuar përfitime ekonomike për fitime më të mira nga ajo që ka fituar deri atëherë. Ndikimi pozitiv i remitancave është se intensifikohen punët e vendasve të profileve të ndryshme, duke punuar ndërtimin e shtëpive dhe objekteve tjera përmes ndihmës së remitancave nga emigrantët. Kështu që me investimet nga ana e emigrantëve në vendet e tyre të origjinës në rastin konkret në Republikën e Maqedonisë atëherë kemi edhe rritjen e vendeve të punës, përfitime matariale duke ndikuar direkt në tregun e punës edhe pse janë investime sezonale. Veçanërisht, në vendet ku realizohet dukuria e emigracionit, ndikon në pjesën aktive të popullatës si dhe zvogëlimi i imigrimeve rezulton me numër të vogël të popullatës active dhe kjo më shumë ndikon në ngadalësimin e zhvillimeve ekonomike të këtyre shteteve.[312] Anën tjetër pasojat dhe efektet ekonomike negative janë të kuptimit se emigrimi ndikon negative në ekonominë e shtetit dhe vendit të origjinës sepse me largimin drejt shteteve tjera humbet edhe fuqia punëtore dhe investimet sdo të kishin kuptimin e tyre. Më së shumti përfitues nga lëvizjet e migracionit sidomos nga emigracioni janë shtetet e destinaciot për të cilët imigrantët janë të mirëseardhur në kuptimin e sigurimit të fuqisë punëtore, mbajtja gjallë të industrisë së prodhimit dhe në përgjithësi ekonominë e vendit.

KAPITULLI I III

NDIKIMI I PROCESEVE TË MIGRACIONIT SI DUKURI SOCIALE NË KRYERJEN E DISA VEPRAVE PENALE, ME THEKS TË VEÇANTË NË TRAFIKIMIN ME QENIE NJERËZORE

[310] Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013, fq.176

[311] Стратегија . "Демографски развој на Република Македонија 2008-2015". Скопје, 2008, fq.14

[312] Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës "İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri: TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul'a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ". Erzurum, 2012, fq.21

Proceset e migracionit sidomos migracioni ndërkombëtar si dukuri e cila viteve të fundit është ndër temat kryesore të ekspertëve të kësaj çështjeje në këndvështrimin e shtetit të origjinës (nga ku njerëzit largohen, emigrojnë) ashtu edhe në këndvështrimin e shteteve të destinacionit (cilët po përballen me pranimin ose mos pranimin e tyre imigrojnë) po ashtu edhe nga këndvështrimi i shteteve me pozitën e tyre të tranzitit ku bën pjesë edhe vendi ynë (vetëm kalojnë pa qëllim që të mbeten në vendin e tranzitit). Shtetet e destinacionit po edhe të tranzitit shpesh alarmohen në lidhje me flukset masovike të migrantëve me prejardhje nga vende të ndryshme sidomos viteve të fundit nga Lindja e Mesme cilët përmes shteteve të Ballkanit vazhdojnë drejt vendeve evropiane. Arsyet dhe shkaqet e emigrimeve masovike karakterizohet me llojllosjhmërinë e tyre siç janë luftërat, konfliktet politike, konfliktet fetare, terrorizmi, varfëria, papunësia, skamja etj, por vitet e fundit si shkak i emigrimeve dominon arsyet e luftës dhe sigurisë së individëve dhe varfërisë në vendet e tyre të origjinës ku ende janë duke zhvilluar luftëra dhe konflikte të armatosura të përmasave të ndryshme, të cilëve u ritet papunësia dhe skamja. Duke marrë parasysh thëniet e lartëshënuara në kontekstin e sjelljeve kriminale, pa dyshim mund të konfirmohet dhe përgjithësisht e pranuar në pikëpamje shkencore se ekziston një lidhje kauzale midis papunësisë dhe sjelljes kriminale.[313]

Duke marrë parasysh se proceset e migracionit janë të rregulluara edhe me drejtat nacionale të shteteve por edhe me aktet ndërkombëtare, duhet të ceket se jogjithmonë këto lëvizje janë të ligjshme dhe në bazë të rregullave. Joligjshmëria e proceseve të migracionit vin në shprehje kur vendet apo shtetet e destinacionit i reduktojnë numrin e pranimit të migrantëve ose disa shtete aspak edhe nuk pranojnë si rrezik për shtetasit e vet në aspektin e integrimit, punësimit dhe kapaciteteve shtetërore për ti ofruar atyreve shërbimet që i takojnë me ligj me qëllim të rruajtjes së interesave ekonomike të shteteve të tyre. Si shkak i reduktimit dhe mos pranimit të shteteve të destinacionit shpesh migrantët kërkojnë moduse për të hyrë në këto shtete kështu që vin në shprehje edhe aktivizimi i mënyrave jashtëligjore sidomos aktivizohet krimit të organizuar përmes grupeve kriminale ndërkombëtare pët të realizuar ofertën e kontrbandës me migrantë e cila më vonë mund të kalojë në veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore sepse migrimi i regullt ka shumë pengesa dhe barriera të llojeve të ndryshme. Por, në përgjithësi ka shumë probleme sociale të imigrantëve dhe emigrantëve duke filluar nga barriera gjuhësore dhe deri te izolimi social, shqetësimeve emocionale dhe refuzimit nga vendasit e vjetër[314] e cila është në favor të krimit të organizuar për kryerjen e kontrabandës me migrantë dhe si viktima të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore. Në përgjithësi gjatë lëvizjeve të individëve prej një vendi në një vend tjetër hasen në pengesa të ndryshme në lidhje me daljen nga shteti i tyre, gjatë lëvizjeve në shtetet e tranzitit si dhe gjatë hyrjes në shtetet e destinacionit. Për tejkalimin e këtyre pengesave individët migrantë që janë në lëvizje shpesh vet dhe vullnetarisht i kontaktojnë personat të ndryshëm shpesh edhe me persona të cilët edhe aspak nuk ni njohin për të gjet një rrugëdalje për tejkalimin e penegesave gjegjësisht arritjen në shtetet e destinacionit përmes pagesave të larta. Kështu që, migrantët arrijnë të kontaktojnë edhe me persona që janë anëtar të grupeve të ndryshme kriminale të cilët për përfitime materiale kërkojnë migrantë cilëve u duhet ndihmë për arritjen e qëllimit të tyre domethënë vendosjen në shtetet e destinacionit. Këto udhëtime, gjithmonë të kryera me mënyra të paligjshme dhe shumica me anije pa flamur, janë shprehje e vuajtjes së njerëzve të mbigarkuar, të cilët nuk kanë mënyra ligjore dhe sidoqoftë mjete më pak të rrezikshme për të arritur në Europë,

[313] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.150
[314] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.145

duke rrezikuar të bien në duar të rrjeteve të trafiqeve të paligjshme të emigrantëve dhe të trafikimit të qënieve njerëzore.[315]

Duke mare parasysh se migracioni në vete është një dukuri e cila ka të bëjë me lëvizjen e individëve prej një vendi në një vend tjetër po ashtu edhe grupet edhe organizatat e ndryshme kriminale janë të organizuar dhe lëvizin në disa shtete përmes njerëzve të vet duke siguruar organizatave të tilla sa më shumë klient-viktimë nga të cilat edhe përfitojnë shuma të mëdha të të mirave materiale ose të gjësende tjera të vlefshme. Duke u bazuar në atë se shumica e migrantëve i kanë lërë pasuyritë e tyre në vendet e origjinës dhe kanë ikur nga vendet e tyre duke i mbrojtur sigurin e tyre dhe të familjes nuk ezitojnë edhe të paguajnë kriminelëve të ndryshëm shuma të larta vetëm e vetëm të shpëtojnë nga ajo gjendje e rëndë. Për transportin ilegal të njerëzve përmes kufirit, merren fonde të mëdha apo kompensime të tjera, ndërsa rritja e popullsisë në vendet ku imigrantët kanë ardhur paraqet një problem të madh social.[316] Kontaktet me grupet e tilla fillojnë nga vendi i origjinës, pastaj në vendet e tranzitit si dhe në vendet e destinacionit.

Në bazë të kësaj që u përmend në lidhje me lëvizjet e migrantëve lind edhe raporti dhe ndikimi i proceseve të migracionit në disa aktivitete kriminale shumë të rrezikshme. Pra, proceset e migracionit ndikojnë në aktivizimin e krimit të organizuar, pastaj në kontrabandën me migrantë si dhe në fund të veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore ndaj migrantëve.

1. Migracioni dhe Krimi i organizuar

Migracioni si proces i lëvizjes së individëve prej një vendi në një vend tjeter nga arsye të ndryshme, pra me dimenzionin e saj nacional dhe transnacional e cila është më e shprehur është shënjestër e krimit të organizuar. Përvoja na mëson se krimi është një fenomen kompleks dhe heterogjen, i cili manifestohet në forma të ndryshme dhe manifestohet në çdo fushë të jetës shoqërore[317] ku përveç kryerjes së krimit nga individi ekziston edhe krimi i cili kryher nga një grup të personave në mënyrë të organizuar. Definimi i vetëm dhe unik i krimit të organizuar ende nuk është arritur edhe kundër faktit se shumë autor mundohen ti konsolidojnë qëndrimet për një definim të tillë duke ikur përdorimit të termeve të ndryshme për dukurinë e njejtë dhe duke i konsoliduar edhe format dhe elementet e saj, e cila ndikon në mospasjen e përkufizimi të vetëm. Duhet të ceket se sot në botë për këtë fenomen përdoren shumë terme siç janë kriminaliteti i organizuar internacional, kriminaliteti i organizuar transnacional, kriminaliteti i organizuar multinacional dhe kriminaliteti i organizuar global dhe të njejtat e vështirësojnë përkufizimin e termit.[318] Veprimtaria e paligjshme e krimit të organizuar në botë por edhe në Republikën e Maqedonisë karakterizohet jo vetëm ndaj migrantëve dhe të bëj kontrabandimin e migrantëve dhe trafikimit me qenie njerëzore, por ata në shënjestër e kanë çdo kategori të popullatës pa dallim të statusit të tyre se a janë migrantë ose nuk janë, si dhe pa dallim të gjinisë, moshës, racës, kombësis, ngjyrës, fejës etj. Si veprimtari të grupeve të ndryshme të krimit të organizuar përveç trafikimit të drogës, trafikimit të armëve, vrasjet me pagesë, krimit kibernetik, et., janë edhe veprat e trafikimit me qenie njerëzore dhe të kontrabandës me migrantë duke mos dalluar të rritur, të mitur ose fëmijë. Organizimi, ndërmjetësimi ose pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në shitjen ilegale të fëmijëve çifteve që janë në martesë, është gjithashtu aktiviteti i krimit të organizuar transnacional që i jep atij fitime

[315] Kraja, Blerta. Disertacion i doktoraturës "E drejta migratore dhe e azilit", Tiranë, 2012, fq.151

[316] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.213

[317] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq. 162

[318] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.191

të konsiderueshme.[319] Shumë autorë, në veçanti ***Dobovšek,*** në aktivitetet kryesore të krimit të organizuar i klasifikojnë aktivitetet e mëposhtme dhe ate trafiku i drogës, trafiku I armëve, vjedhje dhe trafiku i veturave, trafikimi me njerëz, kreditim, trafiku me fëmijë, trafiku me organe të njerëzve, pastrami i parave, kriminaliteti kompjuterik, falsifikime, trafiku me materiale nukleare, prostitucioni, lojërat e fatit dhe shantazhe.[320] Meqë format e krimit të organizuar janë të shumta, ne do të përqëndrohemi vetëm në veprën penale të kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore dhe lidhshmëris së tyre me proceset e migracionit si një e drejtë dhe process i ligjshëm. Krimi i organizuar nënkupton bashkëpunimin dhe organizimin e grupit kriminal të së pakut dy personave me një hierarki të funksionimit mes tyre për kryerjen e veprave penale në kuadër të një shteti ose edhe jashtë kufijve të shtetit me qëllim të fitimeve finansiare.

Lyman dhe ***Potter*** krimin e organizuar e llogarisin si një lloj krimi që munt të realizojnë punë legjitime dhe punë me organizata politike e cila përfshin grupe të shumta të etnicitetit të njejt dhe ndërkombëtar, të cilët punojnë së bashku ose ndaras nga njëra tjetra.[321] Krimi i organizuar parashihet në të dretjën e brendshme nacionale të Maqedonisë por edhe me aktet ndërkombëtare. Sipas nenit 2 paragrafi a) e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar parasheh kuptimin e krimit të organizuar ku ceket se: *"Grup kriminal i organizuar"* nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale."[322] "Përkufizimi operacional përcakton njëmbëdhjetë kritere: veprimi i më tepër se dy personave, çdo anëtar i grupit të ketë rolin e vet, organizata të ekzistojë në një periudhë më të gjatë apo për një kohë të pacaktuar, në organizatë të jenë të zhvilluar disa forma të disiplinës dhe kontrollit, anëtarët e organizatës të kryejnë vepra më të rënda, organizata t'i realizojë aktivitetet e veta në planin ndërkombëtar, të aplikojë hunën dhe mjetet e frikësimit, anëtarët e tij t'i përdorin strukturat ekonomike apo format institucionale të organizuara për profit, të jetë e inkuadruar në larjen e parave, të uhstrojë ndikim mbi strukturat politike, mediumet, pushtetin ekzekutiv, jurspudencë dhe subjektet tregtare, anëtarët e saj veprojnë për të realizuar profit gjegjësisht fuqi. Aktiviteti kriminal mund të konsiderohet si i organizuar nëse janë prezente së paku gjashtë nga këto kritere, nga të cilat janë të domosdoshme këto: pjesëmarrja e më tepër se dy personave, kryerja e veprave më të rënda dhe kryerja e veprave me qëllim të realizimit të profitit ose fuqisë."[323] Ekziston një dilemë nëse terrorizmi është krimi i organizuar ose është një aktivitet kriminal i pavarur me karakter politik ose klasik[324] e cila ka lidhshmëri të ngushtë me migracionin dhe krimin e organizuaruar. Në të shumtë e rasteve në nivel botëror terrorizmi i ka përmasat ndërkombëtare dhe paraqet më shumë problematikë ndërkombëtare sesa nacionale dhe shtetet e kanë rëndë që ta parandalojnë dhe luftojnë vet këtë kriminalitet. Në fakt, terrorizmi ndërkombëtar, i cili kërcënon sigurinë e brendshme të shteteve, si dhe disa forma të një pasnjëshme të krimit të rëndë dhe të organizuar (përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, trafikimin e drogës dhe

[319] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.699

[320] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.191

[321] Sever, Muhammed. Disertacion i doktoraturës "Türkiye'yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ", Ankara. 2015, fq.34

[322] Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000. neni 2, paragrafi a)

[323] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.19

[324] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.191

trafikimin e armëve, transferimin e paligjshëm të teknologjisë, sulmet ndaj sistemeve të informacionit, krimin ekologjik) paraqesin sfida që nuk mund të luftohen në nivelin thjesht kombëtar.[325] Aktivitetet e organizatave kriminale të krimit të organizuar realizohet përmes kriminalizimit të dukurive natyrore që janë legale siç është rasti me migracionin legal të cilat funksionojnë si organizata me hierarki të brendshme dhe me parim të diskrecionit dhe të bashkëpunimit të cilët shpesh janë të lidhura edhe me pushtetin e shtetit konkret me qëllim të përfitimeve materiale nga aktivitetet e tyre kriminale të cilët përdorin dhunë dhe abuzime gjatë kryerjes së aktiviteteve kriminaëe. Pas akteve të panumërta të dhunës ndaj njeriut, deklarativisht është bërë përparim kolosal në formulimin e të drejtave të njeriut në relacion individ-pushtet politik, me qëllim kufizimin e forcës mbi njeriun.[326]

Karakteristikat e krimit të organizuar janë: organizatë kriminale-sindikat kriminale, hierarkija-përgjegjësi dhe subordinim, struktura rrjetore, fleksibiliteti në punë, infiltrimi në strukturat shtetërore dhe komerciale, lidhshmëria me organet qeveritare dhe institucioneve tjera, dhuna si metodë, përfitimi si qëllim, profesionalizmi si karakteristikë, akrakteri transnacional, shprehja e rrezikut shoqëror, shumë forma të ndryshme të caktimit të udhëheqësve nga pjesët e operative të sistemit, specificiteti në format e organizimit kriminal dhe të tjerë.[327] Quhen të organizuara ato grupe të cilat kanë planin e tyre, kanë rregullat e brendshme të grupit, grupe që kanë kryer vepra penale të organizuar si dhe planifikojnë që edhe në të ardhmen të kryejnë veprimtari kriminale.[328] Ligji përdor nocione të ndryshme për sa i përket nocionit të shoqatës kriminale: komplot, bandë, rrjet, shërbim.[329] Duke u bazuar në bashkëpunimin e personave për kryerjen e veprave penale nga ana e grupeve të krimit të organizuar edhe Kodi penal i Maqedonisë parasheh kryerjen e veprave penale me bashkëpunim e cila në nenin 22 të saj thot pjesëmarrja e dy ose më shumë personave me pjesëmarrje në veprim të kryerjes ose me kontribut aktivitet tjetër të veçantë për realizimin e krimit, së bashku e realizojnë krimin, secili prej tyre do të jetë përgjegjës dhe do të dënohet për krimin e vet.[330] Kjo do të thotë që çdo person, në mënyrë që të jetë bashkëkryerës, duhet të posedojë të gjitha veçori që kërkohen ligjërisht për kryerësin e veprës.[331] Për ekzistimin e bashkëkryerjes, përveç shumë personave, duhet të ekzistojë edhe lidhje objektive dhe subjektive mes tyre dhe veprës së kryer që ajo të jetë akti i përbashkët.[332] Në kuadër të aktiviteteve të grupeve të krimit të organizuar ndaj migrantëve Kodi penal Maqedonisë e parasheh në nenin 418-v, me titullin "Organizimi i grupit dhe inkurajimi për kryerjen e veprave trafikimi me njerëz me persona të mitur dhe kontrabanda me migrantë"dhedhjësisht për organizimin e organizatës kriminale për kryerjen e veprave penale të llojit të organizuar e paraparë dhe e sanksionuar në paragrafin 1 të këtij neni. Në mënyrë më të detajuar në kodin e saj penal Republika e Kosovës në paragrafin 1 të nenit 283 parasheh këtë vepër penale: "Pjesëmarrja ose organizimi i

[325] Хекер, Бернд. "Европско Кривично Право". Скопје, 2010, fq.54
[326] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.51
[327] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.202
[328] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.71
[329] Po aty, fq.77
[330] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 22
[331] Petrović, Borislav. Jovasević, Dragan. Perhatović, Amila. "Krivično Pravo II ", Saučesnistvo, krivične sankcije i posebni dio. Sarajevo, 2016, fq.41
[332] Po aty

grupit criminal të organizuar" ku thuhet se: personi i cili me dashje dhe me dijeni për qëllimin dhe veprimtarinë e grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për kryerjen e krimit, ose aktivisht është pjesëmarrës në aktivitetet kriminale të grupit duke ditur kontribon ose ndihmon në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, llogaritet si vepër penale e organizimit të grupit kriminal të organizuar.[333], kurse në paragrafin 2 të nenin të njejtë thotë se: personat e organizojnë, themelojnë, mbikëqyrin, menaxhojnë ose drejtojnë veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar llogaritet si organizator apo drejtues i krimit të organizuar"[334]

Shumë grupe, individë dhe organizata legale, gjysmë legale, por edhe mafioze, fitojnë shuma të mëdha të parave duke organizuar bartjen ilegale të këtyre viktimave në nevojë, me dokumentacione false ose pa dokumentacion fare.[335] Në kërkim të një jete më të mirë shumë persona vendosin ilegalisht të migrojnë në vende të pasura veçanërisht në SHBA dhe Unionin Europian.[336] Trafikimi i njerëzve i shkakton dëme të drejtpërdrejta dhe të shumëfishta cilësisë së jetës në çdo shoqëri ku ajo shfaqet, pavarësisht nga fakti a është vendi i kësaj shoqërie vend origjine, tranziti apo edhe destinimi.[337] Republika e Maqedonisë si shtet është shtet burim, zonë tranzitë dhe destinacion përfundimtar për meshkujt, femrat dhe fëmitë cilët përmes grupeve kriminale të organizuara kanë qëllim eksploatimin seksual dhe punës së detyruar, sidomos femrat dhe fëmitë janë janë objekt i trafikimit për punë të detyruar dhe eksploatim seksual në restorante, bare dhe klube nate në vend dhe jashtë saj. Karakteristikat e migrantëve sidomos profili në bazë shtetësisë dhe moshës janë të llojllojshme. "Sipas të dhënave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në periudhën prej vitit 1990 deri në gusht të vitit 2008, janë regjistruar gjithsej 87,775 kalime ilegale. Shumica e tyre ishin shtetas shqiptarë (52.797 persona), rumunë (21.578), maqedonas (4,133) dhe shtetas të RF të Jugosllavisë (3,457), dhe relativisht më pak bullgarë (2,861), moldave (1.729), turq (221), indianë 187) dhe qytetarë ukrainas (163)."[338] Sipas karakteristikave të tyre demografike (gjinia dhe mosha), shumica e refugjatëve dhe migrantëve që hynë në territorin e Republikës së Maqedonisë ishin burra (244.295 persona), ndjekur nga fëmijët (148.051 persona) dhe gratë (85.510 persona)[339], gjatë periudhës kohore 19 qershor 2015 (nga ora 00:00) deri në 7 mart 2016 (deri në ora 24:00) kur ishte edhe fluksi më i madh i migrantëve dhe refugjatëve. Karakteristikë e këtyre krimeve të organizuara është se për lëmoshë më shumë viktima paraqiten fëmitë e nacionalitetit romë dhe trafikim për eksploatim seksual përmes martesave të detyruara.

Në periudhën e tranzicionit në Republikën e Maqedonisë sidomos pas pavarësisë së vitit 1991 në skenën politike nisën të shfaqen dhe forcohen lidhje midis strukturave shtetërore dhe krimit të organizuar në vend. Fillet e krimit të organizuar në Maqedonin e pavarur nisi sidomos në vitin 1992, vit e cila karakterizohet me embargon ndërkombëtare ekonomike. Si struktura, ashtu edhe përbërja e grupeve të krimit të organizuar nuk janë forte të shtrënguara, lidhjet formohen në familje, ose në marrëdhënie të tjera të ngushta, por gjithsesi, stereotipi i grupit të krimit të organizuar, mono-etnik dhe familjar, është kapërcyer dhe është vërejtur angazhimi edhe i një numri kriminelësh nga Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Mali i Zi dhe Serbia.[340] Ky vit ishte viti më i

[333] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës; neni 283, paragrafi 1
[334] Po aty, paragrafi 2
[335] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.109
[336] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[337] Gërxhaliu, Selvete. "Trafikimi dhe prostitucioni i femrave". Prishtinë, 2003, fq.181
[338] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.30
[339] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа".Скопје, 2016, vep. e cit., fq.28
[340] Raporti i Projektit CARPO mbi gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, Strasburg, gusht 2006, fq.16

volitshëm për organizatat kriminale për ta shfrytëzuar si një mundësi e ofruar për përfitime aktivitetet e tyre kriminale sidomos nga kontrabandimi transnacional. Në këtë moskontroll shtetëror shum organizata kriminale në vend ku ishin të kyçur edhe nëpunës shtetëror dhe politikan për përfitime nga aktivitetet kriminale sidomos nga kontrabanda me naftë dhe cigare me shtetet fqinje Shqipërinë dhe Greqinë. Nga kjo gjendje Maqedonia e zhutur në një kaos pasigurie shtetërore u shëndrua në një vend të volitshëm për grupe kriminale për përfitime të paligjshme duke i ndihmuar nga korrupsioni dhe lidhjeve të krimit të organizuar me politikën shtetërore. Korrupsioni në vendet e pazhvilluara dhe me ekonomi të dobët siç është edhe Maqedonia është e shprehur në lehtësimin e punëve nga ana e idnividëve të caktuar për kryerjen e veprimeve të kundërligjshme në interes të grupeve të krimit të organizuar. Kështu që vendet ku ekziston korrupsioni në një shkallë të lartë edhe grupet kriminale e kanë më lehtë që ti zhvillojnë aktivitetet e tyre fitim-prurëse përmes rrugës së korrupsionit. Në vendet ku ka paqëndrueshmëri politike, burokracia bëhet edhe më rëndë, rritet degjenerimi moral dhe, si rezultat, rriten krime të turpshme si ryshfeti dhe abuzimi i detyrës.[341] Korupsioni paraqet marrëdhëniet të paktën dy personave, në të cilat ata, me veprime të paligjshme dhe të ndaluara, shkelin normat ligjore dhe morale, shkelin interesin publik dhe shkaktojnë shkatërrimin e besimit në funksionimin e sundimit të ligjit dhe organeve të tij.[342] Në kontekstin e kësaj, duhet të shihet edhe krijimi i lidhjeve midis kriminelëve dhe individëve të lartëpozicionuar, gjë që është një nga karakteristikat themelore të krimit të organizuar.[343] Kështu filloj edhe ndërhyrja e grupeve kriminale në politikë direkt duke i kontrolluar politikanë ose më mirë të thuhet si mbështetëse të njërit ose krahut tjetër politik duke u llogaritur edhe si shtet i kriminalizuar.

Në rajon si vende më të prekura nga veprimtarit kriminale të krimit të organizuar ishin vendet fqinje me të cilët kufizohet vendi ynë si me Greqinë, Shqipërinë, Bullgarinë dhe Serbinë, të cilat shfrytëzoheshin për kontrabandim mallrash dhe migrantësh si dhe trafikim me qenie njerëzore, kryesisht femra, me qëllim shfrytëzimi për prostitucion. Kurse në vendin tone ishin vendet si qyteti i Shkupit dhe qytetet tjera më të mëdha kufitare, ishin si vende destinacioni të viktimave dhe mallrave të trafikuara si shkak i mundësive të shumta që ofronin ato vende. Nëse shohim shpërndarjen territoriale të kriminalitetit, mund të vërtetojmë se kriminaliteti është më i shpeshtë dhe i përhapur në qytete sesa në zonat rurale.[344] Megjithatë, situata e shkretë në të cilën gjendej i gjithë vendi në atë periudhë përveç dobësisë së institucioneve për tu bërë ballë mangësive dhe nevojave urgjente për ndërhyrje, lejuan që këto grupe dhe veprimtari të paligjshme të shfaqeshin në të gjithë territorin. Hapja ndaj Perëndimit u shoqërua menjëherë me valë masive emigrimi, kontrabandimi klandestinësh dhe trafikimi të femrave me qëllim shfrytëzimi seksual. Maqedonia e ka të fuqizuar normat ligjore lidhur me menaxhimin e kufijve dhe kalimin e paligjshëm të kufirit përmes ligjeve kryesore dhe akteve nënligjore për menaxhimin dhe kontrollimin sa më efikas të kufijve shtetëror sepse është një krim shumë serioz. Me krim serioz nënkuptojmë atë akt që përbën një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim maksimal të heqjes së lirisë prej të paktën katër vjetësh ose me një dënim më të rëndë.[345] Këto ligje janë miratuar në kërkesë dhe konsolidimi me kërkesat e procesit të integrimit të Maqedonisë në Bashkimin Europian, duke ndjekur në mënyrë të veçantë kërkesat e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Ligjet i adresojnë çështjet që kanë

[341] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.357

[342] Бабић, Милош. Марковић Иванка."Кривично Право", Посебни дио. Бања Лука, 2007, fq.303

[343] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq. 151

[344] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164

[345] Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000, neni 2, paragrafi b)

të bëjnë me menaxhimin e kufirit, dhe me parandalimin, zbulimin dhe luftimin e veprimtarive të paligjshme, përfshirë migrimin e parregullt, kontrabandimin me migrantë dhe trafikimin me qenie njerëzore. Pra gjatë proceseve të migracionit shpesh migrantët me dëshirë ose padëshirë bëjnë kalimin e kufijve në mënyrë të paligjshme përmes marrëveshjeve me grupet e organizuara kriminale të cilët do të sigurojnë kalimin e tyre të sigurt dhe transferimin deri në shtetet e destinacionit për shuma të larta të parave të cilët më vonë mund të jenë edhe viktima të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore si një ndër veprimtarit kryesore të krimit të organizuar. Pra, nga kjo që u parashtrua pak më lartë mund të konkludojmë se migracioni i paligjshëm nënkupton situatën kur një individ ose grup individësh të organizuar në mënyrë vullnetare në përgjithësi për shkaqe ekonomike me qëllim që në atë shtet, të jetojë ose të kaloj në një shtet tjetër duke mos i respektuar rregullat për hyrje ose edhe në rast të hyrjes legale por keqpërdorin lejen e qëndrimit dhe të punës[346] të cilët me devijimet e tyre mund të jenë në situata të viktimizimit edhe të veprave të tjera penale të krimit të organizuar.


Kriminaliteti i organizuar në vendet që u krijuan me prishjen e Jugosllavisë, e cila është gjeneruar kryesisht nga lufta, është në rritje të madhe[347] është një karakteristikë për shtetet e rajonit sidomos të shteteve fqinje të vendit tonë. Duke u bazuar në ate se veprimtaria e krimit të organizuar nga grupet e ndryshme kriminale janë të llojllojshme, varësisht nga lloji i paraqitjes së krimit të organizuar në Maqedoni ekzistojnë edhe ligje dhe strategji të sferave të ndryshme për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar siç janë: Kodi Penal, Kodi i procedurës penale, Ligji mbi korrupsionin, Ligji për terrorizmin, Strategji për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar, Strategji për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabanda me migrantë etj. Pra, ndaj kriminalitetit çdo shoqëri reagon në mënyrë të organizuar dhe ate në kuptimin preventiv dhe represiv[348], pra masa preventive (ex ante) dhe masa represive (ex post). Poashtu, edhe në disa pjesë të Ballkanit grupet e organizuara kriminale edhe pse jo aq të forta sa mafia ruse dhe kineze, gajtë luftave të fundit në Ballkan janë forcuar edhe konsoliduar dhe kanë vënë bashkëpunim me mafian dhe krimin e organizuar ndërkombëtar në vendet e Evropës perëndimore si në Francë, Itali dhe Belgjikë duke rrezikuar shtetet e posa formuara ballkanike por edhe vet Bashkimin Evropian.[349] Pra, duke marrë parasysh se proceset e migracionit shpesh zhvillohen si shkak i krizave ekonomike, faktorë social-politik, faktori i përkatësive fetare, luftërat dhe pushtimet etj, edhe krimi i organizuar ndikohet ose përfiton nga faktorët e njejt. Kuptohet se shfaqja e kriminalitetit ndikohet gjithashtu nga një sërë faktorësh të ndryshëm, disa prej të cilave kanë të bëjnë me personalitetin e delikuentit si pas komponentëve të tyre bio-psikologjike, kurse të tjerët sipas mjedisit shoqëror në kuptimin më të përgjithshëm[350] e cila është më e shprehur. Nxitja e migracionit të parregullt më shumë i konvenon grupeve kriminale të cilëve i hapen dyert për të atakuar tek migrantët të cilët dëshirojnë hyrjen në shtetin e destinacionit.

Me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë ndikim të madh ka pasur në lehtësimine veprimtarisë kriminale të grupeve kriminale sidomos ato transnacionale. Teknologjia informatike është një faktor kryesor dhe lehtësues për kryerjen e punëve të tyre të paligjshme.[351] Përmes teknologjisë së telefonave moderne dhe të internetit kriminelëve lehtësojnë kontaktet me viktimat e mundshëm të trafikimit të tyre përmes webfaqeve në internet dhe profile të ndryshme në rrjetet

[346] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.36
[347] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.151
[348] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007,fq. 155
[349] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.68
[350] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.162
[351] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.111

sociale të facebook-ut, instagram-it si dhe programe të ndryshme ku pjesëmmarrja e njerëzve që i shfytëzojnë ato janë me miliona njerëz, ku grupet kriminale të organizuara më lehtë mund të gjejnë klientë pa patur shumë rrezik për zbulim dhe ka shumë webfaqe fiktive që konktrollohen nga vet grupi kriminal. Këto manipulime konsistojnë në futjen dhe regjistrimin e të dhënave të pasakta ose dështimit për të futur të dhënat e sakta në kompjuter, me qëllim të vetit apo të tjerëve të iu sjellin përfitime pasurore ose dobi tjera në mënyrë të paligjshme.[352] Pra, reklamat dhe ofertat përmes rrjeteve social mund të ndikojnë në masë të madhe në viktimizimin e shoqërisë sidomos kategorisë së cenuar dhe të dobët të shoqërisë.

Grafikoni nr.13 Pyetja nga anketa: Sa ndikojnë rrjetet sociale në viktimizimin e personave nga trafikantët.



Testi Chi-Square tregon një ndryshim statistikisht të rëndësishëm (χ 2 = 68.776, df = 12, p = 0.000 <0.05) për mendimin e të anketuarve se a ndikojnë rrjetet sociale si Facebook dhe Instagram në viktimizimin e personave nga trafikantët sipas grafikonit nr.13. Midis të anketuarve, nëse të anketuarit me përgjigje aspak, nuk e di dhe ndoshta që llogariten si përgjigje negative i bashkojmë atëherë del se shumica nuk kanë informata se këto rrjete mund të jenë shkak i viktimizimit të personave sidomos kategorisë së cenuar. Nga grafikoni shihet se mosha 18-29 16.33% nuk e dinë se a ka ndikim kurse 9.25% nga to mendojnë me përgjigjen ndoshta ndikon e cila nëkupton se nuk janë të sigurt, kurse 1.67% janë me përgjigje se aspak nuk ndikojnë. Mendime të ngjajshme janë edhe tek mosha 30-51, 52-61 dhe mbi 61 ku dominon mendimi se nuk e dijnë a ndikon negativ ose jo.

Këto grupe përmes këtyre programeve me të ashtuquajtura "firma legale" ndërmjetësojnë për punësime të ndryshme në shtete evropiane duke siguruar gjetjen e punëve me paga të larta mujore, të cilët shkak i kontrollit të plotë nga grupet kriminale ata mashtrohen dhe bëhen viktima të veprimtarive të tyre kriminale ku merr pjesë edhe kontrabanda me migrntë dhe trafikimi me qenie njerëzore. Grupet kriminale shumë lehtë e kanë ti bindin migrantët për me i kaluar kufitë në mënyrë të paligjshme duke mos pritur nëpër shtete tranzit dhe kampe të ndryshme për refugjatë duke shfrytëzuar gjendjen e tyre fizike të lodhshme, mosnjohjen e gjuhëve të shteteve në territoret e të cilëve kalojnë, shfrytëzimin e tyre psiqik të depresionit gjatë rrugëtimit por edhe nga përjetimet e tyre në vendet e origjinës. Nga momenti kur migrantët pranojnë që ata të kalojnë për një shumë të hollash kufirin e një shteti konkret ata janë edhe viktima potencial edhe të trafikimit me qenie njerëzore, gjë që e len të kuptojmë se veprimtaria kriminale e grupeve të krimit të organizuar kryejnë vepra kriminale të llojllojshme. Veprat penale më së shpeshti të kryera nga kriminelë të

[352] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.35

tillë ndërkombëtarë, internacional janë mashtrime të ndryshme, trafik narkotikësh, kontrabanda e arit dhe diamanteve, trafikimi imoral i grave dhe fëmijëve, falsifikimi i çekut të kontrolleve të udhëtarëve dhe parave, vjedhjet e makinave, veprat e artit, etj.[353] Viktimat gjithnjë e më shumë janë të pa përgaditur dhe nuk janë në gjendje t'i ndihmojnë vetes. [354] Sipas shtetit të destinacionit, migracion i parregullt është hyrja, qëndrimi ose puna e paligjshme në një shtet të huaj. Edhe Republika e Maqedonisë e parashe në nenin 100 të Ligjit për të huaj qëndrimin e paligjshëm e cila llogaritet si e paligjshme nëse:

- ka hyrë në mënyrë të palejueshme në Republikën e Maqedonisë,
- nuk posedon dokument udhëtimi të vlefshëm dhe valid me vizë ose leje për qëndrim,
- viza e lëshuar i është anuluar, revokuar, është shkurtuar vlefshmëria e saj,
- skadon afati i caktuar me vizë,
- i është hequr e drejta për qëndrim,
- qëndron më gjatë se tre muaj gjatë periudhës gjashtëmujore, duke llogaritur nga dita e hyrjes së parë të të huajit në Republikën e Maqedonisë, ndërsa për hyrje në Republikën e Maqedonisë nuk i nevojitet viza, ose
- është refuzuar përfundimisht në procedurën pas kërkesës së paraqitur për pranimin e së drejtës për azil dhe nuk e lëshon territorin e Republikës së Maqedonisë, në afatin e caktuar.[355]

Migrantët edhe pse vet individualisht nganjeherë tentojnë të hyjnë kufirin e një shteti por pjesa dërmuese e migrantve pranojnë që transferimin e tyre në një shtet të bëjnë personat cilët janë të atij shteti duke menduar se kanë lidhshmëri me kontrollet kufitare ose përmes rrugës së korrupsionit ose me kalimin e kufirit përmes maleve dhe vendeve periferike duke menduar se trafikantët më mirë e njohin terrenin, pra ky është momenti kur migrantët bien në duart të kontrabanduesve dhe trafikantëve. Pra, nga kjo shihet edhe lidhshmëria zinxhirore të këtyre dukurive duke filluar nga dukuria e cila nuk është vepër penale pra procesi i migracionit duke u transferuar në migracion të parregullt, pastaj viktimizimi i migrantëve të rregullt nga grupet e krimit të organizuar duke vazhduar me kontrabandën me migrant dhe në fund me veprën penale më të rrezikshme e trafikimit me qenie njerëzore.

Krimi i organizuar nga ana e grupeve profesionale kriminale të cilët janë shpërndarë ndërkombëtarisht në aspektin e territorit duke i shfrytëzuar këto gjendje të kaosit të shteteve cilët kanë luftëra ose kriza ekonomike, politike apo fetare kryejn veprime të shumta kriminale. Ndër organizatat më të njohura të krimit të organizuar të cilat përmenden shpesh në literaturën bashkëkohore kriminologjike jan: "Mafia" italiane, "Koza Nostra" amerikane, "Triadat" kineze, "Jakuza" japoneze, "Mafia ruse" dhe shumë organizata të tjera kriminale që veprojnë në Evropë dhe Amerikë, nga të cilat duhet vequar "Mafinë italiane" dhe "Koza Nostrën amerikane".[356] "Veprimtaritë kriminale të këtyre grupeve përfshin edhe kontrabandaën me migrantë dhe trafikimin me qenie njerëzore. Sipas nivelit të krimit të brendshëm dhe mënyrës së veprimit të krimit të organizuar, interpoli dallon katër lloje të organizatave kriminale:

- I pari është tradicional dhe përbëhet nga organizata mafioze të bazuara në parimin hierarkik me të drejta të rrepta të jetës të brendshme dhe normave të sjelljes, me një sërë aktivitetesh legjitime dhe të paligjshme,
- Lloji i dytë është e ashtuquajtura organizata profesionale me anëtarë të specializuar me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve të caktuara kriminale.Organizatat e tilla nuk janë të

[353] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.74
[354] Xhukleski, Goce. Racaj Muhamet."Hyrje në kriminalistikë". Shkup, 2012, fq.248
[355] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.35, 2006, neni 100, paragrafi 1
[356] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.65

përhershme dhe nuk kanë forma të rrepta të organizimit. Mirren me vjedhje të automjeteve, falsifikimin e parave, grabitje, presion, shantazh etj,
- Lloji i tretë janë organizatat aktiviteti i të cilëve realizohet në planin ndërkombëtar, por me thelbin e grupeve etike homogjene siç janë: trijada dhe jakuza,
- Grupin të katërt takojnë organizatat ndërkombëtare terroriste, në kuptimin kriminologjik format e krimit të organizuar janë: grupa kriminale, grupa kriminale e organizuar, organizata kriminale, mafia si shkalla më e lartë e organizatës.[357]

Gjendja jostabile në shumë vende të Evropës Juglindore dhe të vendeve të Ballkanit, të cilët po kalojnë periudhën e tranzicionit politik ndaj vendeve ish komuniste, përkatësisht socialiste në vende demokratike po krijojnë një hapësirë të përshtatshme për organizimin e grupeve kriminale të krimit të organizuar dhe paraqitjen e shumë formave të këtij lloji të kriminalitetit, të cilat më herët nuk kanë qenë të njohura në këto vende.[358] Viktimat e grupeve kriminale të krimit të organizuar pas viktimizimit të tyre primar ata nënshtrohen në mënyrë permanented he shpesh me keqtrajtime, abuzime nga më çnjerëzore dhe shfrytëzimin e tyre me qëllim të prostitucionit, për punë të rënda dhe për lypje të detyruar etj. Përpjekjet e migrantëve për të arritur deri në shtetin e destinacionit ku më shpesh janë rrugët tokësore dhe ujore pësojnë edhe fatkeqësi gjatë rrugëtimit të tyre ku ka shumë raste edhe kemi aksidenteve të mejeteve të transportit (kamiona dhe trene), përmbytjet e anijeve lundruese. Mes viteve 1847 dhe 1857 në Atlantik u përmbyt 40 anije britanike me migrantë, duke sjellë me vete mbi një mijë jetëra.[359] Sistemi i Kombeve të Bashkuara është qendror në bashkësinë ndërokmbëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare.[360] Për arsye të shumta në lidhje me luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar në nivel botëror Kombet e Bashkuara e fuqizuan aspektin ligjor ndërkombëtar të luftimit të krimit të organizuar ndërkombëtar me miratimin edhe të dy protokoleve dhe ate: "Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare dhe Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve".

2. Migracioni dhe Kontrabanda me migrantë

Gjatë historisë së njerëzimit në periudha të ndryshme kohore për arsye të ndryshme njerëzit kanë qenë në lëvizje të ndryshme brenda shtetit dhe jashta saj duke kërkuar kushte për një jetë më të mirë për to dhe të afërmit e tyre. Pas shekullit XIX sidomos pas vitit 2000 në botën moderne u krijuan shumë lehtësira të sferës në teknikës dhe teknologjisë së komunikimit shoqëror dhe të transportit të mallrave dhe njerëzve anë e mbanë botës e cila ndikoj që migracioni të jetë edhe më dinamik. Gjegjësisht, rrjedha e emigrantëve ndërkombëtarë në periudhën 1990-2000 u rrit për 1.2% në vit dhe nga viti 2000 deri në 2013 me 3.6%.[361]

Gjatë lëvizjeve të migrimeve masovike, lëvizjet shpesh janë duke u zhvilluar jashta mbikëqyrjes së plotë të institucioneve shtetërore përgjegjëse nacionale apo ndërkombëtare, përshkak se ato lëvizje janë të parregullta dhe realizohen në kundërshtim me legjislacionet e migracionit dhe kufijve shtetëror. Kushtet që e krijojnë këtë situatë të lëvizjeve të kundërligjshme nuk mund të mendohet ndaras nga globalizmi dhe zhvillimet gajtë periudhës së pasluftës së ftohtë botërore të

[357]Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.200

[358] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq. 306

[359] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.30

[360] Диксон, Мартин. Мекоркуоел, Роберт. "Случаи и материали од Меѓународно Право". Скопје, 2010, fq.6

[361] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.1

cilët kanë ndikuar që shumë njerëz të migrojnë prej një vendi drejt një vendi tjetër. Me rritjen e migracionit ndërkombëtar paralelisht ka ndikuar edhe në rritjen e veprës penale të kontrabandës me migrantë, vepër e cila realizohet me marrëveshjen paraprake të migrantit dhe kontrabanduesit. Pra, kontrabanduesit janë ato të cilët në të shumtën e rasteve e realizojnë kalimet ilegale dhe të kundër ligjshme të migrantëve dhe e cila llogaritet si një kërcënim global të shteteve sidomos ato të cilë janë të prekur nga valët e migrantëve. Kontrabanda e emigrantëve të paligjshëm është bërë një marrëveshje biznesi fitim-prurës që kryhet nën kontrollin e disa rrjeteve të organizuara kriminale.[362]

Pra, migracionet ilegale janë të lidhura ngusht me krimin e organizuar, gjegjësisht me veprën e kontrabandës me migrantë. Migracioni ilegal në kuptimin e qëllim dhe motivit të migrantëve pothuajse nuk dallohet nga migracioni legal apo ligjor, sepse të dy llojet e migracionit kanë për qëllim arritjen dhe vendosjen në shtetin e destinacionit. Po, dallimi thelbësor dhe kryesor i migracionit ilegal dhe legal është se migracioni ilegal nuk është i lejuar dhe është në kundërshtim me rregullat e migracionit, kurse migracioni legal është i lejuar sipas drejtave nacionale të shteteve konkrete dhe aktet ndërkombëtare të kësaj fushe duke i respektuar këto rregulla. Sipas organizatës ndërkombtëtare për migracion (IOM), migracioni ilegal ka të bëjë me format më të shpeshta të migracionit jo të rregullt, sidomos hyrjes, qëndrimit ilegal dhe punë të paautorizuar, dhe definohet si lëvizje që ndodh jashtë normave të rregullta të shteteve të cilat dërgojnë, përmes së cilës kalojnë dhe ata që pranojnë migrantë.[363] Pas problemeve terminologjike që përdoren në artikujt të ndryshëm për proceset e migracionit përcaktimi i migracionit ilegal ose të paligjshëm e pranuar në nivel botëror nuk ka dhe në këtë kontekst siç e përfkufizon edhe IOM nuk është e përkufizuar qartë dhe të jetë e pranuar universalisht. Sipas IOM-it "Migracioni i paligjshëm (i parregullt) janë lëvizjet njerëzore që janë jashtë normave ligjore të vendeve burimore, tranzitore dhe të destinacionit, dhe nga pikëpamja e vendeve të destinacionit, është hyrja, qëndrimi ose puna joligjore e emigrantëve që nuk kanë dokumentet ose lejet e nevojshme në kuadrin e legjislacionit të shtetit të destinacionit për emigracion me qëllim të hyrjes, qëndrimit ose punës, kurse nga pikëpamja e vendeve të origjinës, parregullsia ndodh kur njerëzit nuk kanë pasaportë të vlefshme ose dokument udhëtimi ose nuk i plotëson kërkesat administrative për të dal nga shteti gjatë kalimit të kufijve ndërkombëtar."[364] Nga kjo mund të konkludojmë se emigrantët që kalojnë nga migracioni legal në situatë të migracionit të ilegal mund të ndodh në çdo fazë të procesit të migracionit që nënkupton në shtetin e origjinës, në shtetin tranzit por edhe në shtetin e destinacionit. Andaj mund të thuhet se një nga format më modern dhe bashkëkohore të kontrabandës llogartitet kontrabanda e njerëzve gjegjësisht të migrantëve. Me fjalën kontrabandë me migrantë nënkuptojmë sigurimin dhe hyrjen ilegale të individëve në një shtet konkret që nuk është shtetas i atij shteti ose ata individë që nuk kanë vendbanim të përhershëm, me qëllim të përfitimeve financiare pose të mirave tjera materiale. Deri në fund të shekullit të 19 nuk kishte emigrantë të paligjshëm, sepse nuk kishte kufizim ligjor të hyrjes në vendet tradicionale të imigracionit si dhe në shumicën e vendeve evropiane.[365] Sipas nenin 3 paragrafi (b) të Protokollit kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare" e cila është protokol shtesë e

[362] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.213

[363] Влада на Република Македонија, Национална Комисија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција "Стандардни оперативни процедури за постапување со жртви на трговија со луѓе", Скопје, 2010, fq.8

[364] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.27

[365] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.120

"Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj, e përkufizon termin "Kalim i paligjshëm" e cila do të thotë kalim i kufirit pa iu përmbajtur kërkesave të domosdoshme për kalimin e ligjshëm në shtetin pritës".[366] Me rëndësi është që të kemi një dallim gjatë përkufizimit të kontrabandës me migrantë për dallim nga refugjatët. Refugjatët janë në gjendje të krijojnë trafik njerëzor dhe kontrabandim të migrantëve në rrethanat në të cilat ata gjenden në shtetin konkret. Pra, kontrabanda me migrant është një veprimtari e cila ndihmon dhe lehtëson hyrjen ilegale të migrantëve në një shtet të huaj me dëshiron dhe pëlqimin e individëve migrantë që janë subjekt të proceseve të migracionit të cilët në periudha të ndryshme kohore paraqiten me numër shumë të madh ose migracion masovik të popujve të ndryshëm. Llogaritet se në vitin 1973 migrantë ilegal kanë përbërë rreth 10 përqind të popullatës imigrante të përgjithshme në Evropën Perëndimore.[367] Kontrabanda me migrantë në përgjithësi ka të bëjë me dëshirën e emigrimit ose tejkalimin e pengesave në shtetin ku gjenden (shtet i origjinës, transit ose hyrje në shtetin pritës) përmes rrugëve ilegale duke ikur kushteve dhe konflikteve poltike, sociale dhe ekonomike që e kanë kapluar vendin e tij drejt shteteve ku do të ofrohen kushte dhe standarde më të mira ekonomike, jetësore dhe punësim. Në këtë drejtim, ***Heckman*** cekën se pavarësisht nga fakti se ka shumë nën-forma dhe variacione që ndryshojnë sipas rrethanave, ekzistojnë tri forma themelore të imigrimit të paligjshëm dhe këto janë kalimi i paligjshëm dhe fsheht i një kufiri shtetëror, së dyti, duket se është e ligjshme duke përdorur dokumente të nevojshme për kalim të kufirit, duke përdorur dokumente origjinale por të lëshuara në emër të një personi tjetër të ligjshëm ose hyrje legale të kufirit por me qëllime jashtligjore dhe së treti, vazhdimi I qëndrimit në një shtet edhe pas përfundimit të statusit ligjor të qëndrimit.[368] Pra, rrugët që shfrytëzohen për kalimin e kufirit të një shteti në mënyrë të paligjshme janë hyrja e fshehtë të kufirit në të shumtën e rasteve përmes rrugëve malore dhe fshehurazi në bagazhet e automjeteve transportuese si dhe përmes përdorimit të dokumenteve të identifikimit të falsifikuara. Transporti më shpesh kryhet përmes automjeteve për pasagjerë, me autobusë të rregulltë të linjës Gjevgjeli-Shkup-Kumanovë dhe linjat e rregullta të hekurudhave të Maqedonisë.[369] Nëse i shqyrtojmë këto situata më nga afër, kalimi i kufijve të një shteti nëpërmjet rrugëve të paligjshme zhvillohet në dy mënyra: i pari është që të hyjë fshehurazi në kufirin pa përdorur portat doganore, zakonisht përmes pikave ku kufijtë janë të vështira për t'u kontrolluar dhe e dyta duke përdorur dokumente të rreme të identitetit dhe të udhëtimit e cila në "pamje" duket si hyrje përmes rrugëve legale.[370] "Kufiri shtetëror" është kufiri tokësor i Republikës së Maqedonisë, përfshirë kufiri i lumenjve dhe liqeneve, si dhe aeroportet dhe portet liqenore që janë të caktuar si vende përmes të cilave zhvillohet trafiku ndërshtetëror dhe ndërkombëtar[371]. Shpesh këto kalime janë aq të rrezikshme për migrantët ku ka shumë raste të aksidenteve në trafik, ku kemi edhe raste të vdekshmërisë së migrantëve viktima të cilët shfrytëzojnë çdo lloj të kalimit me qëllim të arritjes deri në shtetin e destinacionit. "Më 24 Prill 2015, afër Velesit, nga treni vdiqën 14 refugjatë, të paktën gjashtë prej të cilëve ishin të mitur. Midis fundit të 2014 dhe majit 2015, të paktën 29 refugjatë dhe migrantë

[366] Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi b)

[367] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002. fq.120

[368] Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, vep. e cit., fq.28

[369] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.24

[370] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.29

[371] Закон за гранична контрола. Службен весник на РМ, бр. 171, 2010, neni 3, paragrafi 2

vdiqën, përfshirë foshnjë, fëmijë dhe gra."[372] Kodi penal i Republikës së Maqedonisë në paragrafin 1 të nenit 418-b parasheh në mënyrë të qartë si vepër penale për ata që posedojnë dokumente të rrejshme të udhëtimit pë kalimin e kufijve shtetëror dhe ate: personi i cili krijon, furnizon ose posedon dokumente të rrejshme të udhëtimit me qëllim të kalimit të kufirit shtetëror e cila llogaritet si e paligjshme, është përgjegjës dhe do të dënohet për atë vepër.[373] Sipas Protokollit kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare si dokument i falsifikuar udhëtimi ose identifikimi llogaritet dokument udhëtimi ose identifikimi, i cili: "(i) është bërë ose ndryshuar në mënyrë të falsfikuar në rrugë noteriale nga çdokush, me përjashtim të një personi ose agjencie të autorizuar me ligj për të bërë ose lëshuar dokumente udhëtimi ose identifikimi në emër të një shteti; ose (ii) është lëshuar ose marrë në mënyrë të parregullt, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të falsifikuara, korrupsionit, kërcënimit ose të ndonjë mënyrë tjetër të paligjshme; ose (iii) përdoret nga një person tjetër dhe jo nga mbajtësi i ligjshëm."[374] Pra, hyrja ilegale realizohet duke marrë parasysh këto kritere: vazhdimi i qëndrimit edhe pas afatit të kalimit të vizës së qëndrimit, hyrja në shtet pa dijenin e institucioneve përgjegjëse d.m.th.: hyrje përmes rrugëve jashtë ligjore, përdorim të dokumenteve të falsifikuara për hyrje, praktikimin e qëndrimeve të rreme për hyrje sidomos duke përdorur drejtën e azilit si alibi dhe hyrje ilegale të kufirit përmes ndihmës dhe asistencës së grupeve kriminale të krimit të organizuar sidomos të kontrabanduesve të migrantëve. Siç është rritur papunësia dhe armiqësia e publikut ndaj të huajve, shumë shpejt qeveritë i kanë shtrënguar politikat veçanërisht ndaj imigrantëve ilegal.[375] Andaj, kontrabandimi me migrantë kryhet për përfitime finansiare nga grupet kriminale duke pas parasysh tërësinë e aktiviteteve të cilat realizohen gjatë kontrabandës. Tranzitimi në Republikën e Maqedonisë kryhet në mënyrë të organizuar nga ana e grupeve kriminale, më shpesh nga zonat e Shkupit, Kumanovës dhe Gjevgjelisë, por kohëve të fundit ajo është organizuar nga ana e udhëheqësve nga Avganistani dhe Pakistani cilët janë migrantë ilegal, por janë të detyruar nga ana e grupeve kriminale në bazë të borxhit në të holla për kontrabandën, të punojnë si udhëheqës të migrantëve për periudhë të caktuar.[376] Konsiderohet se i huaji ka hyrë legalisht në Republikën e Maqedonisë kur e ka kaluar kufirin shtetëror dhe pas kontrollit të kryer kufitar lejohet hyrja në Republikën e Maqedonisë.[377] Ekzistimin rrezikut nga kontrabanduesti dhe trafikantët në pjesën e Gjevgjelisë afër kufirit me Republikën e Greqisë për gjetjen e viktimave të mundshëm e pohon edhe Z.L. nëpunës në Qendrën për menaxhim kriza i cili thot se: "Sigurisht, ekzistonte një rrezik i tillë sepse numri i migrantëve ishte i madh dhe ata janë një shënjestër e lehtë për kontrabandistët, por mënyra e organizimit të punës, numri i shtuar i forcave policore sepse është një pikë hyrëse në Maqedoni, zvogëlon numrin e kontrabanduesve në minimum. Më vonë, ligji për qëndrimin dhe tranzitin e rregulluar të migrantëve për 72 orë përmes vendit tonë u miratua dhe transporti i migrantëve përmes vendit tonë u lehtësua ndjeshëm. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për mënyra të organizuara të trafikimit njerëzor,

[372] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.10

[373] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418-b, paragrafi 1

[374] Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Palermo/Itali, 2000, neni 3. paragrafi c), pika i, ii dhe iii

[375] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.120

[376] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.24

[377] Закон за странци, Бр. 07-1144/1, 14 март 2006 година, Скопје, neni 9, paragrafi 1

ekziston gjithmonë një mundësi e tillë, por jashtë Qenrës pranuese tranzitore Vinojug."[378] Pra, kontrabandimi me migrantë si veprimtari kryesore kanë aktivitetet në lidhje me hyrjen ilegale të migrantëve në kufijtë e një shteti të huaj si dhe sigurimin e qëndrimit ilegal në një shtet të huaj kur ka hyrë ilegalisht ose ka kaluar afati i qëndrimit të tyre. Hyrjet ilegale shpesh realizoht përmes nëpunësve të korruptuar ose lidhje tjera, dokumente të falsifikuara, rrugë tjera ilegale përmes maleve dhe pyjeve etj. "*Migrantët dëshmitar D.M. i S.R. të dyjat nga R.S., për të cilat edhe pse ka ditur se kanë ndalesë për hyrje në R.M. nga viti 12.09.2012 deri vitin 12.09.2013, prap i ka bindur të vijnë në R.M., për ata ka organizuar përmes KK "J." ku do të jenë të lëshuar jolegjitmisht nga njeriu i tij, nëpunës policer"*[379]. Sipas neni 100 paragrafi 1 të Ligjit për të huaj të Republikës së Maqedonisë në pjesën e "Qëndrimi i paligjshëm" parashah se i huaji qëndron në mënyrë të paligjshme në Republikën e Maqedonisë, nëse: "ka hyrë në mënyrë të palejueshme në Republikën e Maqedonisë".[380] Sipas Protokollit kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare, nenin 3 pikën (a) e përkufizon definimin e fjalës ""Trafik i migrantëve" që do të thotë prokurimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kalimi i paligjshëm në një Shtet Palë të një personi, në të cilin ai/ajo nuk është shtetas ose rezident i përhershëm."[381] Për arsye të luftimit dhe parandalimit të hyrjeve ilegale dhe kontrabandimit me migrantë shumë shtete praktikojnë viza për të huajt të cilët dëshirojnë të hyjnë në një shtet. Vizat jepen nga zyrtarë të ambasadave dhe konsujve të një shteti, duke kontrolluar dokumentet e udhëtimit dhe qëllimin e aplikimit të vizave për të hyrë në territotin e një shteti, pra përmes vizës përcaktohen edhe kriteret dhe kushtet e qëndrimit të një personi një një shtet. Sipas këtyre kritereve njerëzve u jepen ose refuzohen marrja e vizave sipas vlerësimit të zyrtarëve të ambasadave. Shumë herë pas hyrjes legjitime përmes vizave në një shtet me skadimin e afatit të vizës për të cilin është dhënë personit shpesh bëhet vazhdimi i qëndrimit në mënyrë ilegale. Shkelja e afatit të vizës bëhet duke tejkaluar periudhën e përcaktuar në vizën e marrur ose duke përdorur vizën jashtë qëllimit të dhënies (sip una me viza studentre ise studimi me viza turistike).[382]

Sot, bota moderne sidomos shtetet evropiane të cilët kanë një ekonomi të zhvilluar e cila është edhe destinacioni i migrantëve, veprën e kontrabandës me migrantë e llogarisin si një kërcënim shoqërorë dhe ekonomik dhe si një akt kundër rendit dhe sigurisë publike, të shteteve të tyre. Gjatë kontrabandës me migrantë, elementi njerëzor që përbën kompleksitetin kryesor të kontrabandimit të migrantëve nuk mund të anashkalohet sepse në mes të kontrabanduesit dhe migrantit ekziston vullneti dhe dëshira për kalimin illegal të kufirit shtetëror. Për këtë arsye, nuk është e mundur të zgjidhet aq lehtë problemi i kontrabandës me migrant me mjete të zhvilluara si një krim i vetëm, sepse kuadër të kësaj vepre penale kemi edhe pëlqimin dhe vullnetin e migrantëve. Drejtat e migrantëve dhe shkelja e normave të krijuara në fund të migrimit ilegal janë të drejta të cilat kërkojnë një përkushtim të veçantë. Andaj për luftimin dhe parandalimin e veprës penale të kontrabandës me migrantë duhet të hartohen dhe realizohen masa preventive ekonomike dhe sociale për rritjen e standardit jetësor në vendet e origjinës së migrantëve duke luftuar shkaqet dhe arsyet që ndikojnë në emigrimin e popullsisë. Shtetet të cilat më shumë janë të prekur nga ky

[378] Intervista me Z.L. Nëpunës shtetëror në Qendrën për Menaxhim me Kriza, në njësinë rajonale në Gjevgjeli, përgjegjës në kampin për migrantë Vinojug

[379] Aktgjykim nr.59 të datës 03.02.20104 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

[380] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.35 të datës 23.03.2006, neni 100, paragrafi 1

[381] Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi 1)

[382] Eker, Kemal. Disertacion doktoraturës" Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, vep. e cit., fq.30

lloj i kriminalitetit duhet të rrisin kapacitetet teknike dhe teknologjike me qëllim të menaxhimit dhe kontrollit më efikas të pikave dhe vijave kufitare shtetërore.

Në regjionin e Ballkanit është shumë e zhvilluar edhe vepra e kalimit ilegal të emigrantëve në vendet e Unionit Europian ku sipas të dhënave të Europol-it afër 10% nga imigrantët e përgjithshëm cilët hyjnë në UE kanë ardhur përmes Ballkanit dhe sipas të dhënave të kësaj organizate policore në vit afër 500 000 imigrantë hyjnë në Unionin Europian nga të cilët gjysma ilegalisht, nga vendet e Ballkanit veçanërisht përmes Serbisë[383] që nënkupton se paraprakisht kanë kaluar edhe nga vendi ynë. Europoli duhet të përmirësojë kapacitetin e punës dhe bashkëpunimin e shërbimeve përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, trafikimit ilegal të drogës dhe formave të tjera serioze të krimit ndërkombëtar, nëse ekzistojnë indikacione të një strukture organizative kriminale dhe nga fushat e cekura të krimit janë të prekur nga krimi dy ose tre shtete-anëtare në mënyrë, e cila kërkon veprim të përbashkët (neni 2 i Traktatit të Europolit)[384] që është rasti edhe me kontrabandën me migrant. Edhe Republika e Maqedonisë i kushton një rëndësi të posaçme proceseve të migracionit dhe raportin e tyre me kontrabandën me migrantë duke u adaptuar edhe akteve ndërkombëtare të kontrabandës me migrantë sidomos në pjesën e bashkëpunimit ndërkombëtar për luftimin dhe parandalimin e kontrabandës me migrantë. Për shkak të realizimit të suksesshëm të qëllimeve prioritare të lartëpërmendura, të gjitha angazhimeve që i bën Republika e Maqedonisë duhet të shpiejnë në funksion të rritjes së nevojës së bashkëpunimit ndërkombëtar edhe atë jo vetëm me vendet e Evropës Juglindore por edhe me vendet e Bashkimit Evropian, si dhe nëpërmjet krijimit të lidhjeve me organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë siç janë KB (OH), Interpol, Europol etj.[385] Edhe pas mbylljes së kufijëve të Maqedonisë për refugjatët dhe migrantët në mars të vitit 2016 kanalet e kontrabandës u rihapën dhe policia maqedonase, në bashkëpunim me forcat policore të Austrisë, Republikës Çeke, Sllovakisë, Polonisë, Hungarisë, Sllovenisë, Kroacisë dhe Serbisë, zbuloi kontrabandimin e mijëra refugjatëve dhe emigrantëve.[386] Përveç bashkëpunimit ndërkombëtar është më se e nevojshme edhe bashkëpunimi i brendshëm sidomos me vendbanimet të cilët janë të prekur nga valët e migrantëve. Kjo është një qasje që promovon bashkëpunimin me komunitet bazuar në strategjinë e orientuar për të vepruar ndaj shkaqeve dhe çregullimeve të kriminalitetit dhe ndaj frikës nga kriminaliteti.[387] Ka shumë raste të përdorimit të dhunës dhe forcës nga forcat policore gjatë menaxhimit të fluksit të migrantëve në Republikën e Maqedonisë, sidomos gjatë viteve 2015 të cilën e shfrytëzojnë si vend tranzitor duke vazhduar rrugën drejt Serbisë e më pas drejt shteteve Evropiane. Pas shpalljes së gjendjes së krizës nga Qeveria e RM, nga materialet e publikuara në media dhe vërejtjen e menjëhershme të përfaqësuesve të Komitetit të Helsinkit të cilët ishin të pranishëm në kufirin jugor, kanë mund të shohin trajtimin çnjerëzor të refugjatëve nga nëpunësit e policisë speciale që përdorën forcë të tepruar dhe të paarsyeshme dhe masa shtrëngimi, duke përdorur gaz lotsjellës dhe bomba shoku në dështimin për të parandaluar refugjatët të kalonin në territorin e shtetit.[388] Me hulumtimet e ***Sampson*** dhe ***Groves***, është zbuluar se çrregullimi social nuk shkakton krim të drejtpërdrejtë, por vërtetoi se mekanizmat tradicionalë të kontrollit u rrëzuan

[383] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.699

[384] Хекер, Бернд. "Европско Кривично Право". Скопје, 2010, fq.197

[385] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.102

[386] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.3

[387] Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011, fq.146

[388] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.11

me çrregullimin shoqëror, dhe më pas kolapsi në këtë mekanizëm shkaktoi krim.[389] Është poashtu i domosdoshëm edhe bashkëpunimi dhe bashkërendimi i përhershëm dhe intensiv i të gjithë pjesëmarrësve në punët rreth luftimit të kriminalitetit.[390] Sa i përket lëvizjeve të migracionit të ligjshëm, edhe më tej sasia e emigrimeve është më e madhe sesa të imigrimeve të individëve të cilët mbetën pakë dhe me praninë dominante të qëndrimeve të përkohëshme të të huajve.[391] Sa i përket lëvizjeve të migracionit, është e rëndësishme të theksohet migrimi potencial - një fenomen që ka arritur një dimension shqetësues në pesë vitet e fundit në Republikën e Maqedonisë ku numri i të rinjve, nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve, si dhe stafit me arsim të lartë (sidomos nga shkencat teknike dhe natyrore) që po mendojnë apo planifikojnë të largohen jashtë vendit, po rritet vazhdimisht.[392] Maqedonia si shtet qendror i Ballkanit, nga dita e pavarësisë së saj ka qenë shtet origjine të kontrabandës me migrantë por që nga viti 2010 Maqedonia filloj të menaxhoj migrantë të ndryshëm si shtet tranzit. Maqedonia si shkak i pozitës së saj gjeo-strategjike e cila e cila e lidh Evropën me Lindjen e Mesme, Azinë dhe Afrikën, me pozitën e saj si shtet tranzit ishte në qendër të vëmendjes së organizatave ndërkombëtare për migracion në lidhje me menaxhimin e valëve të migrantëve të cilët vinin nga shteti fqinjë i Greqisë në Maqedoni, e cila ishte si pasojë e shkaqeve ekonomike, shkaqeve të luftërave që zhvillohen në vendet e tyre dhe sigurisë së njerëzve. Pas luftës në Afganistan dhe valës revolucionare në botën arabe e ashtuquajtur Protestat arabe, numri i kalimeve ilegale të kufirit dhe numri i azilkërkuesve në vendet e Ballkanit Perëndimor janë rritur[393] dhe së bashku me migracionin ilegal vërehen edhe rritjet e numrit të kontrabandimit t migrantëve dhe trafikimit me qenie njerëzore në territorin e Maqedonisë. Hyrja e migracionit ilegal eksluzivisht është nga Greqia, më shpesh në zonën e Gevgelisë dhe zonat afër saj, kurse dalja më e shpeshtë është nga Serbia përmes kalimeve ilegale në zonën e komunës së Lipkovës, kurse fshatrat Vaksinca dhe Llojanip paraqiten si qendra ilegale pritëse, para lëshimit ilegal të territorit të Republikës së Maqedonisë.[394] "*Pasi i pandehuri H. A.bisedoi në telefon mobil me të pandehurit A. dhe I. dhe inspektoi zonën drejt kufirit maqedono-grek, me automjetin Volkswagen furgon ... ai u largua në rrugën fushore për në fabrikën Vori, pra në pompën e benzinës Shimov-Okta, ku ai pranoi migrantë të dëmtuar dhe i vendosi në automjet"*[395]. Nga ana tjetër, ka një rritje të konsiderueshme të migrantëve që vijnë nga rajone që nuk janë parë më parë në vala të tilla të mëdha, kryesisht nga Afrika Veriore dhe Perëndimore, Azia Jug-Qendrore dhe Perëndimore dhe Lindja e Mesme dhe përveç kësaj, ka pasur edhe qytetarë të Serbisë, Kosovës, Greqisë, Mbretërisë së Bashkuar, Kinës, etj.[396] Përmes vendeve të regjionit të Ballkanit, veçanërisht përmes Serbisë, ilegalisht drejt Unionit Europian kalojnë edhe Kinezët, Irakianët, Avganët.[397] Me pozitën qendrore të saj Maqedonia dhe Sërbia luajnë rol kyç në kuadër të rrugës Ballkanike në lëvizjen e migrantëve

[389] Dolu, Osman. "Suç Teorileri", Teori, Araştırma ve uygulamada Kriminoloji. Ankara, 2011, fq.217
[390] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.18
[391] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.1
[392] Po aty
[393] Анализа. "Националните политики и практики за справување со илегалната миграција и брателте на азил". Лембовска, Магдалена, Скопје, 2013, fq.8
[394] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.24
[395] Aktgjykim nr.76 të datës 27.02.2012 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2
[396] Анализа. "Националните политики и практики за справување со илегалната миграција и брателте на азил". Лембовска, Магдалена, Скопје, 2013, fq.9
[397] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.699

drejt vendeve perëndimore evropiane.[398] Në fillim të valës së migrantëve sidomos në vitin 2015 përshkak të mospasjes së kalimit tranzit legal në territorin e Maqedonisë migrantët u detyruan të kërkojnë rrugë tjera ilegale dhe jo të sigurta si dhe duke kërkuar ndihmë nga kontrabanduesit dhe trafikantët. "Më shumë se 90% e migrantëve që udhëtojnë në BE përdorën shërbime lehtësuese. Në shumicën e rasteve, këto shërbime ofroheshin dhe ofroheshin nga grupe kriminale."[399] Pas kësaj problematike të kalimit tranzit legal shteti ynë u detyrua të intervenoj në përmirësimin e ligjit për azil dhe qëndrim të përkohshëm me të cilën u dha e drejta prej 72 orëve nga momenti i hyrjes në vend të kalonin tranzit vendin. Luftimi dhe parandalimi i migracionit ilegal ose të paligjshëm është e një rëndësie shumë të veçantë përshkak se përmes migracionit ilegal vijnë në shprehje edhe disa dukuri dhe vepra penale tjera siç janë rreziku mbi jetën dhe shëndetin e migrantëve, mund të jenë viktima të mundshme të grupeve kriminale që kanë për qëllim kontrabandën me migrantë e cila është në lidhshmëri të ngushtë nga këto grupe për të kaluar në veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, si dhe kryerjen e aktiviteteteve tjera kriminale (vjedhje, terrorizëm etj). Është e tmershme niveli i lartë i trajtimit dhe degradimit më çnjerëzor gjatë transportit të migrantëve duke i fshehur në bagazhet e automjeteve transportuese (vetura, kamion, anije) ku drejtëpërdrejtë rrezikohet edhe shëndeti dhe jeta e migrantëve të cilët në vende të izoluara ku frymëmarja është e kufizuar sepse gjenden në bagazhe të izoluara dhe udhëtimi është i gjatë që zgjatë me orë të tëra. Gjithashtu gjatë transportit rrezikohet edhe jeta e migrantëve nga fatkeqësi në komunikacion të cilët më leht mund të humbin jetën duke qenë të shtrënguar. Shumat e të mirave materiale shpesh janë aq të mëdha sa që migrantët nuk mund të paguajnë krejt të cilët përmes marrëveshjeve plotësuese pranojnë që pas arritjes në vendet e destinacionit ata do ti paguajnë ato të holla kurse në anën tjetër gruçet kriminale ndërkomb.tare në shtetet pritëse përmes anëtarëve të vet kriminal i detyrojnë migrantët të punojn duke i mbajtur si skllevër dhe automatikisht nga kontrabanda me migrantë kalohet në trafikim me qenie njerëzore. Themi kështu sepse këto grupe kriminale i detyrojnë duke i kanosur dhe frikuar migrantët të punojnë punë fizike, femrat më shumë i dërgojnë në prostitucion, fëmitë i dërgojnë për lëmoshë. Përveç kësaj është rritur kontrolli kufitar dhe rregullimi i qëndrimit, si dhe janë paraparë sanksione edhe për kompanitë e transportit ajror dhe detar cilët sigurojnë udhëtarë pa dokumente të vlefshme për hyrje[400] llogariten si masa preventive. Si elemente kryesore të kontrabandës me migrantë me qëllim të migracionit të paligjshëm janë: 1. Marëveshja paraprake mes migrantit dhe kontrabanduesit në mënyrë vullnetare dhe sipas dëshiros së të dy palëve, 2. Pagesa e çmimit që janë marrë vesh palët për të kontrabanduar, 3. Sigurimi i terrenit ose automjetit përmes cilës do realizohet migracioni i paligjshëm i migrantit nga ana e kontrabanduesit. Pra, koncepti i migracionit të paligjshëm apo ilegal bazohet në të ashtuquajturën "vullnetarizëm" të migrantit i cili në mënyrë vullnetare pranon të kontrabandohet nga individë ose grupe kriminale në mënyrë të kundërligjshme dhe kjo vullnetarizëm e dallon nga vepra pena e trafikimit me njerëz e cila është e detyrueshme. Në këtë kuptim sidomos gjatë procedurave gjyqësore në pjesën e kualifikimit të veprës penale sado që "trafikantët e trafikimit me njerëz" dhe "viktimat e trafikimit me qenie njerëzore" edhe pse here pas here hyjnë në kuadër të migracionit të paligjshëm ose ka qenë e ndikuar nga migracioni por do të ishte më mirë që të mos llogaritet në kuadër të saj por të kualifikohet si vepër penale në vete. Në procedurë penale nga ana e gjykatave kur kemi raste të dyshimit se një person dyshohet se ka kryer vepër penale të trafikimit si shkak i

[398] Прв Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Бутел и Општина Шуто Оризари, Октомври 2017-Февруари 2018 година, fq.2

[399] https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/facilitation-of-illegal-immigration, të datës 14.09.2020, ora 15:38

[400] Mesić, Milan. "Međunarodne Migracije", Tokovi i teorije. Zagreb, 2002, fq.120

i fakteve jo të plota dhe jo të sigurta gjykatat mund të kualifikojë edhe si vepër tjetër penale e cila është më pak e rëndë sesa trafikimi. Kujdes i veçantë duhet bërë për hetimin e fakteve që kanë lidhje me thelbin e çështjes, për zbulimin, fiksimin, verifikimin dhe çmuarjen e provave, si dhe për zbatimin e rregullave të parashikuara me ligj, të cilat garantojnë zbulimin e së vërtetës.[401] Rëndësia e provave tani është e pashmangshme për ndriçimin e një ngjarjeje që ka ndodhur dhe për funksionimin më efikas të sistemit ligjor.[402] Në proedurë penale duhet të synohet arritja e të vërtetës objektive, të vërtetës për të gjithë, ndonëse e vërteta objektive si e vërtetë për të gjithë nuk mund të arrihet as në jetën e përditshme, e vështirë që arrihet edhe në procedurën penale.[403] Në një kuptim të gjerë, prova është tërësia e rregullave të zbatueshme me rastin e konstatimit të një vepre penale, në mënyrë të tillë që ky konstatim të lidhet me faktet ose me personalitetin e personit që ndiqet penalisht.[404] Në procedurë penale ekziston edhe parimi i së vërtetës si një ndër parimet kryesore dhe e cila llogaritet edhe si qëllimi i procedurës penale. E vërteta materiale nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha fakteve releavante nga të cilat varet zbatimi i së drejtës penale materiale dhe i së drejtës së procedurës penale duke e përputhur gjendjen faktike, të vërtetuar me vendim gjyqësor, me ngjarjen reale, e cila është marrë si vepër penale.[405] Në këtë drejtim teorija e procedurës penale është marrë me trajtimin e parimit-rregullës procedurale in dubio pro reo, i cili mundëson dalje nga situata kur faktet e rëndësishme (në dëm apo në dobi të pandehurit) nuk kanë mundur të vërtetohen me bindshmëri të plotë.[406] Ligji i procedurës penale të Republikës së Maqedonisë në nenin 4 të saj në lidhje vendosjen në mënyrë më të volitshme për të akuzuarin (in dubio pro reo) thot:"Për dyshimin në lidhje me ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve që e përbëjnë karakterin e vepërs penale, apo nga të cilat varet zbatimi i ndonjërës nga dispozitat e Kodit penal, gjykata do të vendosë në mënyr më të volitshme për të akuzuarin".[407] LPP në nenin 2 parag.2 parimin in dubio pro reo e ngritë në nivel të parimit ligjor[408], sipas së cilës gjykata do të vendos në mënyrën e cila do të jetë më e favorshme për të pandehurin. Me ligjin për ndryshimin e Kodit Penal të datës 30.03.2004 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 19/04), është shtuar neni 418b, i cili i referohet Kontrabandimit të migrantëve.[409] Për dallimn nga kjo tek vepra e kontrabandës me migrantë nuk ekzistojnë mekanizmat nga kontrabanduesit siç janë tek trafikimi me qenie njerëzore: shfrytëzimi, dhuna, kanosja, shtrëngimi ose shkelja e të drejtave themelore të njeriut. Në periudhën nga viti 2005 deri më sot, gjatë monitorimit të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore dhe migrimit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë, ky lloj i krimit ishte më i përhapuri.[410]

Çdo shtet mundohet të ndërtojë një doktrinë dhe strategji të përgjithshme të reagimit në lëmin e sigurisë, sikurse dhe bazat për realizimin e qëllimeve globale dhe mbrojtjen e brendshme të vlerave të saja, pa marrë parasysh në madhësinë dhe fuqinë e tyre.[411] Për këto arsye shteti përmes

---

[401] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.26

[402] Gazeta policore "IPUCU", 2012. ISSN: 1303-7854. Ankara, 2012, fq.48

[403] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.101

[404] Shegani, Altin. "E drejta penale krahasuar". Tiranë, 2008, fq.115

[405] Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë". Tetovë, 2007, fq.49

[406] Po aty, fq.62

[407] Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150, 2010, Neni 4

[408] Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë". Tetovë, 2007, fq.62

[409] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.9

[410] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.10

[411] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.26

instiucioneve të saja dhe kapaciteteve shtetërore duhet të luftoj dhe parandaloj çdo lloj të kriminalitetit sidomos përmes Ministrisë së punëve të brendshme e cila e ka detyrë primare luftimin dhe parandalimin e çdo lloji të vepre penale. Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të funksionit të saj, është përgjegjëse për mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit dhe të qytetarëve të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, mbrojtjen e rendit juridik, parandalimin dhe fshehjen e veprave penale, masa për të ndjekur penalisht këta autorë dhe për të ruajtur rendin dhe paqen në shoqëri.[412] Koncepti i mirëmbajtjes së rendit dhe qetësisë është i lidhur ngushtë me ate të kontrollit shoqëror, pra qëllimi është shoqëria të ketë qetësi dhe rend dhe ajo të mbahet nën kontroll.[413] Në rastin ku vepra e caktuar penale kryhet në një territor më të gjerë, kur kryhen shumë vepra penale dhe nga ana e grupeve të ndërlikuara e të të organizuara mire, atëherë funksionin e koordinimit të punëve rreth zbulimit mun ta marrë dhe duhet ta marrë mbi vete qendra përkatëse e policies.[414] Sot, në fund të shek. 20, policia për shkak të natyrës siguruese të punëve të saj edhe më tej konsiderohet si "establishment" me institucion burokratik të theksuar, gjysmë ushtarake, konservative, paramilitare, me struktura politizuese të cilat paraqesin rolin kyç në mbrojtjen e sigurisë së brendshme, në dakord me rregullat dhe rregulloret në korrelacion me marrëdhëniet shoqërore përbëjnë sistemin juridik shtetërorë.[415] Policia me aparatin e saj pa zero tolerim-nulta tolerim nuk mund të luftoj kriminalitetin që të siguroj qytetarëve së shtetit të vet siguri dhe qetësi. Me ate dëshirohet të dërgohet sinjal kriminelëve dhe qytetarëve që respektojnë ligjin që policia ka forca dhe motive për tu arestuar të gjithë kryerësit e krimeve anti-sociale dhe veprat penale të lehta që kontribuojnë për popullsinë vendore të ndjehen të pasigurtë.[416]

Republika e Maqedonisë hap drejt konsolidimit të ligjeve të saj me aktet ndërkombëtare morri pas vitit 2004 kur edhe e ratifikoj Marëveshjen për stabilizim dhe asocijim si dhe mori obligimin për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar ndërkombëtar. Me ndryshimet e Kodi penal në vitin 2002 u inkriminua vepra penale "Trafikimi me qenie njerëze" (neni 418 të kodit penal), ndërsa në vitin 2004 vepra e "kontrabanda e migrantëve" (neni 418-b nga Kodi penal) dhe "Organizimi i grupit dhe nxitja për kryerjen e veprave tregti me njerëz dhe kontrabandë të migrantëve" (neni 418-v nga Kodi penal), kurse në vitin 2008 sipas ndryshimeve, u rritën sanksionet penale, gjithashtu u parapa një vepër e re penale në nenin 418-g nga kodi penal "trafikimi me person të mitur" dhe në shtator të vitit 2009 me ndryshimet e reja të Kodit penal u parapanë dënime më të rrepta në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për luftë kundër tregtisë me njerëz.[417] Në praktikë për arsye të ndryshme ndodh që personat për kryerjen e veprës penale të trafikimit me persona të mitur të marrin dënime shumë të ulëta e cila është pengesë për luftimin sa më efikas të kësaj vepre penale. "*Petre Vasilev nga N., është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale të Trafikimit me persona të mitur nga neni.418-g pa.3 nga KP, si shkak është gjykuar me dënim me burg në gjatësi prej 4-katër viteve dhe 6-gjashtë muajve"*[418]. Një hap i rëndësishëm në

[412] Национална Стратегија. "Развој на воспоставениот систем за интегрирано гранично управување". Скопје, 2009, fq.8

[413] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.913

[414] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.18

[415] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.27

[416] Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011, fq.147

[417] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.3

[418] Решение бр.10 датум 29.07.2013 од Кривичниот Совет на Одделението за Организиран Криминал и Корупција при Основниот Суд Скопје 1 Скопје, fq.1

promovimin e instrumenteve ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar transnacional, domethënë një dokument me rëndësi globale është Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar me Protokollin për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Sidomos Grave dhe Fëmijëve, dhe Protokolli kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore emigrantëve nga toka, uji ose ajri.[419] "Republika e Maqedonisë, më 12 dhjetor 2000 në Palermo - Itali, nënshkroi Konventën me Protokollet dhe e ratifikoi atë më 28 shtator 2004. Konventa dhe dy protokolet e saja janë aktet e para të cilët kërkojnë nga shtetet palë që të inkriminojnë trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve si vepra të ndara penale me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandimin e migrantëve, mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave dhe nxitjen e bashkëpunimit."[420] Ndihma juridike përbëhet nga informimi i viktimës për drejtat dhe statusin, dhënia e informacioneve juridike të përgjithshme për të gjitha veprimet procedurale cilët dalin nga përfaqësimi, përpilimi dhe dorëzimi i padive, ankesave ose të tjera, rrjedhën e procedurës, gjegjësisht, pjesëmarrja e tyre në cilësi të dëshmitar/dëmtuar gjatë zhvillimit të procedurave penale, për opcionet juridike që janë në dispozicion për mbrojtjen e tyre nëse paraqiten si dëshmitar në procedurën hetimore dhe seancën kryesore, mundësia për inicimin dhe kompenzimin e dëmeve si dhe veprime tjera lidhje me zhvillimin e procedurës.[421] Kompenzimi i dëmit të viktimës duhet të sigurohet nga kryerësi i veprës penale përshkak se te kontrabanda me migrantë kryerësit janë ato që ilegalisht fitojnë shuma maramendëse. Një rrjet kompleks, i pamëshirshëm dhe shumëkombësh i kontrabandës së migrantëve është zhvilluar rreth krizës së paparë të migrimit në Evropë, duke gjeneruar kështu miliarda euro për grupet kriminale të përfshira.[422] Pra, paraprakisht ekziston një marëveshje të mëhershme dhe për dobi pasurore kontrabanduesi e ka për qëllim bartjen ilegale të emigrantëve përmes kufirit shtetëror të shtetit konkret me qëllime të ndryshme ku shpesh paraqitet qëllimi i punësimit. "*Me datën 12.10.2007, pas marëveshjes së përbashkët të mëhershme, duke konktaktuar përmes telefonave mobil të katër të akuzuarit për dobi pasurore ilegalisht kanë bartur emigrantë përmes kufirit shtetëror të R.Greqisë, ku është deshtë të punojnë*"[423]. Në këto raste të marrëveshjes paraprake mes dy palëve edhe lufta dhe parandalimi si dhe zbulimi nga ana e nëpunësve shtetëror të kësaj lëmije si dhe hartimin e statistikave pët këtë çështje nuk mun të ketë rezultate të duhura, duke e ditur se asnjë palë nuk e lajmëron dhe e denoncon se kanë kryer veprën penale të kontrabandës me migrantë. Sipas Rrjetit Europian për Parandalimin e Krimit të EUCPN-së që nga viti 2001, parandalimi i krimit përfshin të gjitha masat që reduktojnë ose kontribuojnë në reduktimin sasior dhe cilësor të krimit dhe ndjenjat e pasigurisë në mesin e qytetarëve, qoftë përmes parandalimit të drejtpërdrejtë nga aktivitetet kriminale ose përmes politikës dhe ndërhyrjes me qëllim zvogëlimin e potencialit për krimin dhe shkaqet e krimit[424], pra këtu bëjnë pjesë edhe shkaqet për të cilat migrantët emigrojnë.

3. Migracioni dhe Trafikimi me qenie njerëzore

[419] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.7
[420] Po aty, fq.8
[421] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. "Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе". Скопје, 2014, fq.18
[422] https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/facilitation-of-illegal-immigration, të datës 14.09.2020, ora 14:29
[423] Aktgjykim nr.51 të datës 14.08.2008 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2
[424] Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. "Prevencija Kriminaliteta". Beograd, 2010, fq.33

Edhe pse këtu dy dukuri kanë dallime të mëdha njëra prej tjetrës, ku migracionit është dukuri sociologjike legale e garantuar me akte nacionale dhe ndërkombëtare, kurse trafikimi me qenie njerëzore është një dukuri e kriminalitetit dhe e cila është rreptësisht e ndaluar dhe e dënueshme me aktet nacionale dhe ndërkombëtare, por prap se prap këto dy dukuri janë të kryqëzuara shumë njëra me tjetrën sidomos shpesh viktima të trafikimit paraqiten migrantët. Trafikimi me qenie njerëzore dhe migracioni në përgjithësi e në veçanti migracioni ilegal si shkak kanë një lidhshmëri shum të afërt dhe të ngusht mes veti ka të bëjë me atë se migracioni shpesh paraqitet edhe si një burim kryesor i trafikantëve për sigurimin e klientëve-viktima të trafikimit. Trafikimi me qenie njerëzore, kontrabanda me migrantë dhe migracioni i paligjshëm dhe ilegal janë dukuri antiligjore dhe kriminale të cilët në masë të madhe mirren parasysh si fenomene gjatë hartimit të politikave migratore të shteteve duke u munduar të ikin rrezikut të viktimave të mundshëm të këtyre veprave penale. Sipas Organizatës ndërkombëtare për migracionin (IOM), migrimi i paligjshëm i referohet formave më të zakonshme të migrimit të parregullt, veçanërisht hyrja ilegale, qëndrim dhe puna e paautorizuar, dhe përcaktohet si lëvizje që zhvillohet jashtë nga normat rregulluese të vendeve dërguese, përmes të cilave kalojnë dhe të cilat pranojnë migrantë[425] cilët shpesh realizohet nga ana e kontrabanduesve dhe të trafikantëve. Kontrabandimi me migrantë dallon nga trafikimi i qenieve njerëzore, edhe pse, shpesh herë, këto dy nocione ngatërrohen dhe raportohen jo saktësisht në komunikimet zyrtare. Por, është një fakt i pamohueshëm se migrantët nga kontrabanda me migrantë shumë lehtë mund të kalojnë në viktima të trafikimit me qenie njerëzore përshkak se kontrabandën me migrantë dhe trafikimin me qenie njerëzore shpesh e realizojnë grupet e krimit të organizuar të cilët si veprimtari profitabile i kanë të dy veprat dhe shpesh bëhen nga personat e njejt. Nga kjo lidhshmëri e ngusht e këtyre dukurive ku njëra është dukuri sociologjike kurse tjetra dukuri kriminale shpesh kemi edhe përzierje dhe turbulence në përcaktimin e terminologjisë dhe përdorimit të termeve adekuate në lidhje me këto dukuri siç janë kontrabanda, trafikimi, migracioni dhe migracioni legal. Për tejkalimin e përcaktieve terminologjike dhe përcaktimin e drejt të defioniocioneve të këtyre dukurive duhet edhe përcaktim dhe kufizim i qartë dhe të mpreht të këtyre dukurive veç a veç sidomos në pjesën e dallimeve mes veti. Dallimi i këtyre dukurive është e rëndësisë së veçantë si shkak i karakterit multidimensional të trafikimit me qenie njerëzore dhe është e domosdoshme që në pjesën e përcaktimit të viktimizimit të personave a janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore ose të kontrabandës me migrantë e cila njëkohësisht do të ndihmoj organet shtetërore dhe ato jo shtetërore që e luftojnë këto dukuri si policia, gjykatat, prokuroria dhe organizatat e soecalizuara joqeveritare nacionale dhe ato ndërkombëltare për të identifikuar saktësisht viktimat e këtyre dukurive.

Migracionit e cila nënkupton lëvizjen e individit vullnetarisht ose të detyruar nga një vend gjeografik në një vend tjetër e cila mund të jetë kuadër të atij shteti ose jashta, për shkaqe të ndryshme dita ditës është në rritje të vazhdueshme në nivel botëror, e asesi të jetë imun vendi ynë. Republika e Maqedonis më herët si shtet i destinacionit dhe të tranzitit viktimave të trafikimit me qenie njerëzore viteve të fundit llogaritet edhe si vend i origjinës së viktimave të cilët shfrytëzohen në vendet e Evropës po edhe më gjërë. Statistikat tregojnë se në vitin 2013 numri i migracioneve ndrkombëtare në tërë botën arriti në 232 milion, e cila është në rritje në krahasim me vitin 2000 (175 milion) dhe 1990 (154 milion).[426] Migrimet masovike të njerëzve sidomos migracioni ndërkombëtar e cila viteve të fundit është edhe top temë në arenën ndërkombëtare që i tangon çdo shtet ndikon dhe shpesh transferohen në migrime ilegale individualisht pa ndihmën e

[425] http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Nacionalna-strategija-i-akciski-plan-za-borba-protiv-trgovija-so-lugje.pdf, të datës 17.09.2020, ora 07:23

[426] http://esa.un.org/unmigration/wallchart2013.htm, të datës 18.07.2020, ora 10:41

kontrabanduesve të migrantëve por ndonjeherë ajo realizohet edhe përmes ndihmës së kontrabanduesve të migrantëve në mënyrë vullnetare të migrantit që nënkupton edhe veprën penale të kontrabandës me migrantë nëse ajo bëhet nga ana e kontrabanduesit me dhënien e parave për të kaluar kufirin e një shteti dhe e cila shpesh përfundon në shtetin e destinacionit si viktimë e trafikimit me qenie njerëzore. Shfrytëzimi i këtyre viktimave në vendet e destinacionit realizohet përmes kanosjes dhe frigës ndaj tyre duke i frikësuar se ata janë ilegalisht në vend dhe se nëse mundohen të ikin vet ata do të arrestohen, dënohen dhe do të dëbohen në vendet e origjinës prej edhe nga kanë ikur. Shkaku i kalimit ilegal të kufitit shtetëror të një shteti nga migranti me ose pa ndihmën dhe ndërmjetësimin e kontrabanduesve për migrantë është kalimi sigurt dhe më të lehtë duke pas parasysh se shpesh në kufijtë e shteteve të ndryshme kemi edhe pengesa objektive dhe subjektive për migrantët që të hyjnë në territorin e një shteti si shkak i politikave migratore të shteteve konkrete dhe si shkak si plotësimit të kushteve të migrantëve për hyrje. Por, nuk janë të ralla edhe rastet kur ky zinxhir i veprimtarisë së proceseve të migracionit arrijnë deri tek trafikimi me qenie njerëzore. Pra, zinxhiri i transferimit nga një dukuri legale në ate ilegale funksionin në këtë mënyrë, pra migranti në fillim bën lëvizje legale e më pas për ti tejkaluar vështirësitë pranon migracionin ilegal të bëj vet ose me ndihmën e kontrabanduesve të migrantëve duke i paguar para për kalim të kufirit dhe pas kësaj duke mos pasur para për ti paguar bëhen viktima të trafikimit me qenie njerëzore në vendin e destinacionit ose për gjetje të punës së sigurt në vendin e destinacionit oferta të cilët ofrohen nga trafikantët. Pra, migrantët tani fitojnë statusin e personit i cili është nën kontrollin e trafikantëve në bazë të borxhit të krijuar gjatë kontrabandës me migrantë dhe kështu fillon të funksionoj ky zinxhir i viktimizimit e cila nuk ka fund. Pra, migracionet legale dhe ato ilegale janë të lidhura në mënyrë indirekte me trafikimin e qenieve njerëzore gjegjësisht me trafikantët. Nga kjo mund të konludojmë se kontrabanda me migrantë kuptim më të ngusht dhe më të kufizuar dhe është vepër penale kundër shtetit në krahasim me trafikimin me qenie njerëzore e cila është vepër penale kundër individit. Kjo sepse nëse e marim parasysh se kontrabanda me migrantë ka të bëj ndihmën dhe asistencën për kalimin dhe hyrjen si dhe qëndrimin jashtë ligor të migrantit në një shtet kur i ka kaluar afati i lejes për qëndrim në kundërvlerë të parave, mund të jetë vetëm nën ombrellën e trafikimit me qenie njerëzore ose veç një fazë apo pjesë e trafikimit me qenie njerëzore.

Grupet e migrantëve kanë nevoja relativisht të larta për mbrojtjen sociale, mbrojtjen e familjes, kujdesin e fëmijëve, probleme në martesë dhe probleme në zhvillimin e të rinjve deri në nevojën e mbrojtjes së njerëzve të moshuar.[427] "E lidhur ngushtë me trafikimin njerëzor është çështja e kontrabandës së njerëzve, pasi shumë migrantë mund të bëhen viktima të punës së detyruar përgjatë udhëtimit të tyre. Kontrabandistët mund të detyrojnë migrantët të punojnë në kushte çnjerëzore për të paguar për kalimin e tyre të paligjshëm përtej kufijve."[428] Nga kjo del edhe lidhshmëria dhe ndikimi i migracionit dhe trafikimit me qenie njerëzore që ka të bëj edhe në ate se migrantët ilegal janë persona të cilat janë në rrezik të madh të viktimizimit të trafikimit me njerëz sepse ato janë të pambrojtur sidomos femrat, gratë dhe fëmitë sidomos ndihma që u nevoitet në shtetet e destinacionit i afrojnë migrantët edhe më shumë me trafikantët në lidhje me: borxhin që duhet paguar nga kalimi ilegal i kufijve deri në vendin e destinacionit, gjetja e punës, sigurimi i banesës, barierat gjuhësore dhe shumë nevoja tjera të cilët migrantin e vendon në një farë mënyre si hipotek nda trafikantëve. Në kuadër të kësaj veprimtarie kriminologjike mund të kategorizohen: adoptimi i fëmijëve, nxjerrja dhe shitja e organeve njerëzore, kontrabanda e migrantëve dhe

[427] https://www.unicef.org/social-policy/social-protection, të datës 13.09.2020, ora 13:30
[428] https://www.interpol.int/en/Crimes/Human-trafficking/Types-of-human-trafficking, të datës 14.09.2020, ora 12:52

eksploatimi i tyre fizik dhe seksual[429], me qëllim të ti plotësojnë nevojat e tyre dhe borxhin e paraparë duke pranuar apo mashtruar për punësim në sektorë të ndryshëm ku do të fitojnë shuma të mëdha. Si punë me përfitime të larta janë puna si modele ose kamariere përmes të cilëve më lehtë kalojnë edhe në industrinë e seksit dhe të prostitucionit duke menduar se fitimet do të jenë të larta duke mos ditur se pjesën më të madhe të fitimeve të tyre i marrin direkt trafikantët dhe kështui ata mbahen nën kontrollin e tyre për periudha të gjata kohore. Pra, trafikimi i njerëzve është një nga dukurit me formë më të rëndë të krimit të organizuar, e cila merr përmasa gjithnjë më të mëdha, që çon deri në eksploatimin seksual, ekonomik, social dhe lloje tjera, e cila manifestohet si një lloj i ri i skllevërisë dhe me karakteristikat e saja paraqet rrezikshmëri shoqërore të shkallës së lartë.[430]

Në kuadër të trafikimit me qenie njerëzore, trafikimi i femrave është një biznes shumë fitim prurës dhe i përhapur në të gjithë botën sepse femra përdoren në industrin e seksit sidomos për prostitucion. Mirëfilli është e ditur se trafikimi i femrave dhe i grave është shkelje e të drejtës themelore të njeriut, ngase me trafikim në mënyrë më të vrazhdë atakohen liria dhe e drejta e njeriut, në këtë rast e femrës, që vet të zgjedhë dhe të vendosë për raportet e ndryshme me njerëz të tjerë, e veçmas për të hyrë në marëdhënie intime dhe për të krijuar bashkësi martesore apo kontakt të lirë seksual pa dhunë, pa kërcënim apo mashtrim.[431] Trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion dallohet nfa dukuria e prostitucionit dhe të ndërmjetësimit në prostitucion e cila shpesh këto dy fenomene ngatërrohen. Prostitucioni paraqet një sjellje devijante-negative shoqërore e cila çregullon funksionimin normal të raporteve në mes të gjinive në shoqëri dhe si e tillë është e dëmshme dhe e papranueshme[432] si dhe raporte intime të një femre me numër të pacaktuar të personave tjerë për përfitime materiale. Trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit paraqet formën më të vrazhdë të prostitucionit. Këtu duhet të dallohet prostitucioni dhe trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit në pjesën e dëshirës ku tek prostitucioni vullnetarisht hynë në marëdhënie seksuale me qëllim të përfitimit material kurse tek trafikimi me njerëz për prostitucion përmes forcës, kanosjes ose në mënyra tjera të shtrëngimit shfrytëzohet seksualisht ku dhe njëkohësisht femrat prostitute janë në rrezik të lartë të viktimizimit nga trafikantët me qenie njerëzore për shfrytëzim seksual. Kjo ndodh përshkak se kemi prostitucion vullnetar dhe me dëshirë të femrave të cilët përmes veprimtarisë së tyre sigurojnë të mira materiale dhe të ardhura për vet dhe për anëtarët tjerë të familjes. Femrat dhe vajzat e reja të cilët vullnetarisht pa asnjë shtypje nga persona të tjerë, ofrojnë shërbime seksuale për një kompenzim të caktuar dhe është kategoria më e rrezikuar nga viktimizimi i trafikantëve. Kjo formë e përhapur e trafikimit prek çdo rajon në botë, qoftë si vend burim, tranzit apo destinacion.[433] Prostitucioni në dalim nga trafikimi me njerëz për shfrytëzim seksual ka të bëj se në grupin e parë mund të largohen vullnetarisht kurse tek grupi i dytë janë të ralla ose të pamundshme.

Tek vepra penale e trafikimi me qenie njerëzore përveç shfrytërimit të të rriturve meshkuj dhe femra nuk janë të rralla rastet kur viktima të shfrytëzimit janë të miturit dhe fëmijët. Gjithashtu është në rritje e sipër edhe numri i të miturve në krimin e organizuar në trafikimin me njerëz, me drogë, me armë dhe forma të tjera të krimit të organizuar.[434] Protokoli opsional i Konventës për të drejtat e fëmijëve në lidhje me shitjen e fëmijëve, prostitucionin me fëmijë dhe pornografinë me

[429] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.212
[430] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.200
[431] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.102
[432] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.288
[433] https://www.interpol.int/en/Crimes/Human-trafficking/Types-of-human-trafficking, të datës 14.09.2020, ora 10:19
[434] Salihu, Ismet. "E drejta Penale për të mitur" (Me ligjin penal për të mitur). Prishtinë, 2005, fq.12

fëmijë në nenin 2, paragrafin b) të saj cekën se "prostitucion me fëmijë është përdorimi i fëmijës në aktivitete seksuale me pagesë ose çdo mënyrë tjetër, kurse në paragrafin"[435] c) thot se "pornografia me fëmijë është çdo formë përfaqësimi, me çfarëdo mjeti, i një fëmije të përfshirë në aktivitete të qarta seksuale, të vërteta ose të simuluara, ose çdo demonstrim i pjesëve seksuale të një fëmije për qëllime kryesisht seksuale".[436] Ligjet dhe politikat e Republikës së Maqedonisë gjithnjë e më shumë i llogarisin lypjen e fëmijëve dhe martesat e fëmijëve me marëveshje si problem shqetësues por jo përher edhe të trafikimit me qenie njerëzore.[437] Martesat e detyruara të viktimave të mitur nga komuniteti etnik romë viteve të fundit në vazhdimsi është prezente, si shkak i abuzimit të regjimit të vizave, i cili si faktor ndikon në rritjen e numrit të viktimave të trafikimit njerëzor.[438] Për shkak të ndieshmërisë së personalitetit të fëmijës dhe dëmtimet që i ka pësuar nga vepra penale të sipërmendura të kryera ndaj tij, procedura penale ndaj fëmijës duhet të zhvillohet me kujdes të posaçëm, duke pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton, në mënyrë që t'iu shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij.[439] Por, vlen të ceket se ekziston edhe lëmosha individuale apo familjare e cila nënkupton se personat që kërkojnë lëmoshë nuk janë të kontrolluar nga grupet kriminale të krimit të organizuar por ate e bëjnë vullnetarisht si profesion dhe përmes kësaj rruge të lehtë përfitojnë financa me të cilat jetojnë dhe mbajnë familje. Në këtë drejtim ka shumë keqpërdorime të këtyre personave të cilët paraqiten si lypës sepse financat që i përfitojnë i harxhojnë në vende ku luhet lojërat e fatit dhe bixhozi. Puna profesionale e këtyre personave lypës janë në drejtim të veshjes, aktrimit, papastërsisë dhe shumë karakteristika të tjera. Kanë aftësi të veçantë të luajnë role të ndryshme, të kamuflohen, të shtiren se janë të sëmurë, se kanë të meta fizike, shëmtime të ndryshme në trup e krejt këto me qëllim që te kalimtarët të shkaktojnë dhimbje e mëshirë dhe të nxiten që ata t'u japin të holla apo diçka tjetër.[440] Nuk janë të rralla rastet kur pas fëmijëve lypës të paraqiten prindërit ose anëtarë tjerë të rritur të familjes të cilët e mbajnë nën kontroll dhe mbikqyrje fëmijët gjatë punës nëpër rrugë. Shumë e përhapur është edhe trafikimi i fëmijëve të cilët përmes rrugës së trafikantëve ata rekrutohen, transportohen, transferohen dhe shiten me qëllim të shfrytëzimit të tyre sidomos për shfrytëzim seksual dhe realizimin e filmave porgnografik. "Trafikimi është një kërcënim shumë real për miliona fëmijë në të gjithë botën, veçanërisht për ata që janë dëbuar nga shtëpitë dhe komunitetet e tyre pa mbrojtje adekuate," tha Drejtori Ekzekutiv i UNICEF *Henrietta Fore*.[441] Është e varfër realiteti në të cilën jetojmë duke pas parasysh se të dhënat në Maqedoni tregojnë se shumë viktima të tregtisë me njerëz janë të miturit dhe kuadri i kufijve të moshës lëviz nga 8 deri 17 vjeç.[442] Gjithashtu, trafikantët e njerëzve, në masë të madhe e shfrytëzojnë varfërinë për organizim të prostitucionit. Veç kësaj, në qoftë se rekrutimi apo transportimi i fëmijës - pavarësisht nga synimi përfundimtar - përfshin çdo njërin nga mjetet e përdorura në trafikimin e të rriturve, siç janë kërcënimet, dhuna, rrëmbimi ose

[435] Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, 2000, neni 2, paragrafi b)
[436] Po aty, paragrafi c)
[437] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.23
[438] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.5
[439] Salihu, Ismet. "E drejta Penale për të mitur" (Me ligjin penal për të mitur). Prishtinë, 2005, fq.101
[440] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, vep. e cit., fq.325
[441] https://www.unicef.org/press-releases/children-account-nearly-one-third-identified-trafficking-victims-globally , të datës 12.09.2020, ora 14:41
[442] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.2

mashtrimi, rastet do të shihen gjithashtu si trafikim.[443] Sipas nenit 3 paragrafi d) të Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve e cila është edhe plotësim i Konventës së Kobeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar parasheh se me fjalën "Fëmijë" nënkupton çdo person nën 18 vjeç.[444] Klient të shfrytëzimit seksual të fëmijëve janë persona të ashtuquajtur pedofil. Pedofilia paraqet deformim tjetër të epshit seksual i cili manifestohet në kontaktet seksuale me fëmijë, e qëllim të kënaqjes së epshit seksual.[445] Sipas organizatës së mirënjohur për mbrojtjen e fëmijëve-UNICEF, gjatë një viti, me qëllim të shfrytëzimit, në botë trafikohen rreth 1.200.000 fëmijë[446] e cila dallon nga prostirucioni vullnetar i të rriturve edhe nga ekstistimi vullnetit por edhe nga mosha sepse shumica janë të rritur dhe prostitucionin e kryejnë individualisht ose me ndërmjetësues.

Sot, në botën moderne trafikimi me qenie njerëzore konsiderohet si skllavëri moderne duke i shfrytëzuar njerëzit përmes shtypjes, shtrëngimit, kërcënimit, mashtrimit më shume femrat për prostitucion dhe meshkujt për punë fizike për ti paguar borxhet ndaj trafikantëve. Trafikimi nga kontrabanda me migrantë në aspektin territorial dallohet në ate se kontrabanda me migrant e siguron kalimin e kufirit të shtetit nga një shtet në një shtet tjetër kurse trafikimi me qenie njerëzore përveç se mund të realizohet jashta shtetit ajo mund të bëhet edhe kuadër të një shteti prej një vendi në një vend tjetër në territorin e të njejtit shtet. Ka shumë raste kur viktima të trafikimit me qenie njerëzore janë migrantët dhe këtu shihet ndikimi i migracionit të ligjshëm, migracionit të paligjshëm dhe kontrabandës me migrant ndaj trafikimit me qenie njerëzore, në kuadër të proceseve të migracionit. Qeveria e Republikës së Maqedonisë me qëllim të arritjes së nivelit më të lartë dhe të veprimit të përbashkët në luftën kundër migracionit ilegal më shtator të vitit 2015 e miratoj "Strategjinë nacionale për zhvillim të menaxhimit të integruar të kufirit 2015-2019"[447] e cila ndikoj në përmirësimin e kushteve për menaxhim të kufijve shtetëror sidomos në sferën e bashkëpunimit ndërkufitar sidomos gjatë valës së migrantëve në fund të vitit 2015 deri në mes të vitit 2016. Hapi tjetër shumë i rëndësishëm ishte me miratimin e Programës nacionale për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migracionit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë[448] si dhe e pastaj në bazë të kësaj programe u hartuan dhe miratuan edhe Strategjia nacionale për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe migracionit ilegal për periudhën 2017-2020 dhe Plani akcional nacional për luftë kundër trafikimit me njerëz dhe migracionit ilegal në Republikën e Maqedonisë. Plani akcional Nacional përmban katër fusha: kornizë mbështetëse, parandalimi, mbështetja dhe mbrojtja e viktimave dhe migrantëve dhe procedurat paraprake dhe penale kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës së migrantëve.[449]

Për luftimin dhe parandalimin sa më efikas të trafikimit me qenie njerëzore në përgjithësi po edhe trafikimit e cila ndikohet nga proceset e migracionit ku si viktima paraqiten edhe migrantët, paraprakisht duhet të studjohet dhe të mësohet për etiologjinë, shkaqet , arsyet e trafikimit me qenie njerëzore po edhe të migracionit. Në një anëarsyeja kryesore e trafikimit me qenie njerëzore dhe të kontrabandës me migrantë nga ana e grupeve kriminale të krimit të organizuar është se te

[443] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.14

[444] Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi d)

[445] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.300

[446] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.107

[447] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.29

[448] Национална програма за борба против трговијата со луѓе и илегалната миграција во Република Македонија, („Службен Весник на Република Македонија„) бр.10, 2002 година.

[449] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.12

të dy veprat penale si qëllim kryesor e kanë përfitimin material sa më të madh nga këto vepra kriminale duke kërkuar, gjetur dhe siguruar sa më shumë klientë-viktima po edhe migrantë për to. Në anën tjetër migrantët për shumë arsye vendosin të emigrojnë dhefatkeësisht të bien në duart e trafikantëve ku më së shumti paraqiten shkaqet e: luftës, kushtet e rënda klimatike, kushtet e rënda ekonomike si papunësia e cila ndikon në varfëri dhe në fund përfundojnë në skamje dhe uri, paga të ulëta, kushte jo të mira të punës etj. Nëse i shohim këto dy shkaqe edhe të migrantëve dhe të trafikantëve atëher shumë lehtë është viktimizimi përshkak se nevojat e migrantëve i plotësojnë trafikantët duke i vënë në situatë të tillë që patjetër të pranojnë ofertat e tyre siç është rasti i borxhit paraprak gjatë kalimit të kufijve me ndihmën e marrëveshjes paraprake me kontrabanduesit. Nëse emigrant nuk mund të paguaj borxhin ndaj kontrabanduesve ata automatikisht bëhen viktima të trafikimit të cilët përmes rrugës së dhunimit, kanosjes apo shtrëngimit i detyrojnë emigrantët në punë dhe aktivitete devijante dhe kriminale. Organizatorët e bartjes ilegale shtrenjtë i paguajnë shërbimet azilantëve (së paku një mijë dollar për person).[450] Pra, këtu vërehet edhe pika e kryqëzimit të kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore. Nga kjo del se kjo kategori e njerëzve ose migrantëve hyjnë në vendin e destinacionit përmes kontrabanduesve për migrantë dhe po shëndrohen në viktima të trafikimit me qenie njerëzore. Prandaj, është e pamohueshme lidhshmëria e krimit të organizuar me trafikimin me qenie njerëzore, organet e njerëzve, fëmijëve dhe transferimin e emigrantëve.[451] Në shtetin e destinacionit migrantëtn hasen me shumë probleme të tjera të cilët duhet ti rregulloj për kohë sa më të shkurtër që sa më efikas të adaptohet në sistemin e ri shtetëror. Në literaturë, gjithashtu konsiderohet se problemi i adaptimit të popullsisë së urbanizuar është një problem themelor, dhe se procesi i përshtatjes nuk funksionon normalisht dhe pa vështirësi, kriza individuale dhe devijimi në sferën e tipareve të personalitetit mendor dhe emocional.[452] Emigrantët vuajnë në të drejtat njerëzore të tyre më shumë se vendasit, ata janë të diksriminuar në mbrojtjen shëndetësore, në mbrojtjen ligjore, në punë, në shkollë, në gjithçka që përbën status të plotë ligjor të një qytetari.[453] Grupet e migrantëve kanë nevoja relativisht të larta për mbrojtje sociale, nga mbrojtja e familjes, kujdesi për fëmijët, problemet bashkëshortore dhe çështjet e zhvillimit të të rinjve e deri te nevoja e mbrojtjes së të moshuarve.[454]

Trafikimi me qenie njerëzore si pjesë e migraionit ilegal viteve të fundit por edhe në Maqedoni pati rritje të dukshme. Trafikimi me qenie njerëzore si pasojë e ndikimi i migracionit ndërkombëtar më së miri u pa me të ashtquajturën rrugë e Ballkanit ku gjatë periudhës 2015 dhe 2016 në Republikën e Maqedonisë e cila ishte shtet tranzit llogaritet të kenë kaluar mbi 1 milion migrantë nga vendet e Lindjes së Mesme drejt shteteve perëndimore evropiane si shkak i luftërave në vendet e tyre të origjinës dhe në këtë rrugë dhe valë e migrantëve, migrantët ishin shënjestër e grupeve kriminale të krimit të organizuar e cila kuadër të veprimtarive të tyre e kanë edhe trafikimin me qenie njerëzore. "Sidoqoftë, duke gjetur dhe kapur grupe të mëdha migrantësh që janë në shënjestër të transportit të paligjshëm, ka edhe viktima të trafikimit njerëzor, të cilët regjistrojnë shërbimet e ngarkuara me të, kryesisht MPPS, Ministria e Brendshme dhe IOM"[455] deklaroi Z.L. gjatë intervistës në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore. Në këtë periudhë, sidomos në disa vite të fundit, rritje u vërejt në migracionin ilegal, kontrabanda me migrantë dhe azil, si dhe në trafikim

[450] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.699
[451] Po aty, fq.700
[452] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.165
[453] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.147
[454] Po aty, fq.148
[455] Intervista me Z.L. Nëpunës shtetëror në Qendrën për Menaxhim me Kriza, në njësinë rajonale në Gjevgjeli, përgjegjës në kampin për migrantë Vinojug.

me qenie njerëzore.[456] Maqedonia edhe në periudhën deri në vitin 2015 kishte sadopak rezultate pozitive në lidhje me masat e marura kundër trefikimit me qenie njerëzore dhe migracionit ilegal, por jo edhe rezultate të shkëlqyera. Maqedonia ka të nënshkruar Konventën për bashkëpunim policer në Evropën Juglindore e cila parashah të gjitha format e bashkëpunimit Regjional dhe shërben si bazë e nënshkrimit të marëveshjeve bilaterale si shembull janë protokolet dhe marëveshjet për patrullim të përbashkët kufitar me Serbinë, Shqipërinë, Kosovën dhe Bullgarinë ku shihet se vetëm me Greqinë nuk ka,[457] e nënshkruar më datën 05.05.2006 në Vienë, e ratifukuar më datën në Vienë 01.06.2007, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.74 të datës 14.06.2007. Përkundër marëveshjeve të nënshkruara për bashkëpunim policer mes disa shteteve, Maqedonia ka edhe pengesë në lidhje me bashkëpunimin me shtetin fqinjë të saj siç është Greqia. Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar është pranuar në nivel ndërkombëtar (si edhe në nivel rajonal, përfshirë këtu edhe Evropën Juglindore).[458] Aspekti ndërkombëtar i këtyre dukurive kriminale bën që format e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, siç është bashkëpunimi polici me polici, si edhe instrumentet ligjore më zyrtare, siç janë ndihma e ndërsjelltë juridike apo ekstradimi, të jenë jetike për suksesin e hetimeve, ndjekjeve penale apo dënimeve ndërkombëtare.[459] Shërbimet policore të të dyja vendeve nuk ka pasur bashkëpunim për shkak të mosmarrëveshjeve ekzistuese politike ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë, në lidhje me emrin të cilat, nga ana tjetër, e pengojnë luftën kundër krimit të organizuar. Pra, është e nevojshme të zhvillohet komunikim i ndërsjelltë, koordinim të aktiviteteve, planifikim dhe gatishmëri me qëllim të reagimit të shpejt dhe efikas të kanosjeve.[460] Por si hap pozitiv dhe i rëndësishëm ishte se si rezultat i luftës efikase gjatë menaxhimit të trafikimit me qenie njerëzore Republika e Maqedonisë për vitin 2008 hyri në grupin e shteteve, TIER 1 në pajtueshmëri me rangimin që e bën Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në bazë të kriteriumeve dhe të dhënave konkrete.[461] Objektivi i parë i këtij lloji të veprimit është rritja e nivelit të sigurisë dhe në këtë mënyrë të cilësisë së jetës së popullatës lokale.[462]

Siç u cek edhe më lartë Republika e Maqedonisë karakterizohet edhe si shtet i destinacionit për migrantët apo refugjatët nga vende të ndryshme të botës si dhe për shtetasit e vet që jetojnë jashta territorit të saj por edhe për shfrytëzimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për prostitucion si në grafikonin nr.14

Grafikoni nr.14[463]

[456] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.1

[457] Анализа. "Националните политики и практики за справување со илегалната миграција и брателте на азил". Лембовска, Магдалена, Скопје, 2013, fq.25

[458] Udhëzues për bashkpunim ndërkombëtar. "Trafikimi i qenieve njerëzore-kalimi kontrabandë i migruesve". UNODC, Beograd, 2010, fq.18


[459] Udhëzues për bashkpunim ndërkombëtar. "Trafikimi i qenieve njerëzore-kalimi kontrabandë i migruesve". UNODC, Beograd, 2010, fq.18

[460] Национална Стратегија. "Интегрирано гранично управување". Скопје, 2003, fq.2

[461] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.33

[462] Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011, fq.146

[463] https://migrationdataportal.org/?i=stock_refug_abs_&t=2010&cm49=807, të datës 23.08.2019, ora 10:52



Nga ky grafikon shihet se numri i refugjatëve ndërkombëtar apo migrantëve të cilët si shtet të destinacionit e kanë Republikën e Maqedonis karakterizohet me 2000 raste në vitin 2005 dhe e cila në vitin 2010 shënon rënie prej -400 rasteve pra, në 1600 raste si dhe në vitin 2015 kemi një rënie drastike deri në 718 raste, të cilët ndikohen nga faktorë të ndryshëm dhe nga kjo nënkuptojmë se destinacioni i fundit në përfgjithësi të migrantëve dhe refugjatëve nuk është vendi ynë por e llogarisin vetëm si shtet tranzit.

Migrantët që jetojnë jashta territorit të Maqedonisë sidomos në shtetet perëndimore ku standardet dhe përfitimet e tyre në të mira materiale në krahasim me vendin tonë janë shumë të larta gjatë sezonit të pushimeve verore dhe dimërore harxhojnë shuma të larta parash e cila emërtohet si remitanca të migrantëve. Remitancat e migrantëve të cilët vijnë nga shtetet tjera për vizitë të familjarëve në vendlidje ndikon direkt edhe tek grupet kriminale të aktivizohen në sigurimin e femrave dhe vajave të reja. Remitancat janë të mirat materiale në para të cilët transferohen përmes sistemit banker ose në formën e dërgesave kesh në vendlindjen e tyre. Remitancat nga mërgimtarët dërgohen për mbështetjen finansiare familjarëve të tyre siç janë prindërit, bashkëshortja dhe fëmijët, për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe ushqimit, kushteve të banimit, në veshëmbathje etj. Pra, remitancat kanë efekt pozitiv dhe të forte në luftën kundër varfërisë dhe kontribojnë në rritjen e cilësisë dhe standardit jetësor dhe në zhvillimin e ekonomisë. Por, në kuadër të këtyre remitancave disa emigrantë një pjesë të tyre i harxohet në zbavitje, shëtitje të ndryshme. Pra, sigurimi i vajzave me qëllim të ofrimit të shërbimeve seksuale bëhet përshkak se në periudhat e pushimeve vjetore rritet numri i vizitorëve në klube të natës dhe hapësira tjera ku zhvillohet prostitucioni. Shumë organe të sistemit të OKB-së janë angazhuar me çështje që lidhen me zhvillimin dhe luftën kundër varfërisë.[464] Por, përveç efektit pozitiv kemi edhe efekt negative të remitancave të mërgimtarëve sepse përveç harxhimit të tyre për familjarët një pjesë e tyre i harxhojnë remitancat edhe për jetën e tyre private duke vizituar objekte ku zhvillohen aktivitete devijante siç janë: striptiz baret dhe objektet hotelierike për shërbimet të vajzave shumica e të cilave janë të trafikuara. Si vende ku jetojnë dhe punojnë imigrantët që vijnë në Maqedoni përndryshe shtetas dhe ish shtetas janë ngavendet e zhvilluara ekonomikisht të Evropës por edhe më larg siç janë Gjermania Zvicra, Italia, Austria Amerika etj, por statistikat në lidhje me imigrantët tregojnë edhe shtetet tjera siç janë:

Tabela nr.1[465]

Tre grupe më të mëdha të imigrantëve në Republikën e Maqedonisë			
Viti	2005	2010	2015


[464] Kval. Mellbye. Tranoy. "Politika dhe Demokracia". Prishtinë, 2006, fq.145

[465] https://migrationdataportal.org/?i=groups&t=2005&cm49=807, të datës 23.09.2019, ora 14:19

Grupet (prej më shumë drejtim më pak)	Shqipëri 69.8 mijë Turqi 19.3 mijë Serbi 16.1 mijë	Shqipëri 70.2 mijë Turqi 19.8 mijë Serbi 16.5 mijë	Shqipëri 67.8 mijë Turqi 19.9 mijë Serbi 17.9 mijë


Nga tabela e paraqitur shihet se vendi ynë është destinacion i qytetarëve të 3 shteteve me më shumë imigrime, shtete të cilët Maqedonia ka raporte të mire ndërshtetërore dhe ate në vend të parë për është shtetas të Shqipërisë si shtet fqinj që dominon gjatë periudhës 2005 deri 2015, pastaj janë shtetasit e Republikës së Turqisë që është një shtet jofqinj dhe në vend të tretë janë shtetasit e Sërbisë si shtet fqinj. Më shumë imigrime të shtetasve të Shipërisë kemi në vitin 2010 me 70.2 mij më pak në vitin 2015 me 67.8 mijë. Shtetas të Turqisë dhe Sërbisë për periudhën 2005 deri 2015 janë pothuajse të njejta gjatë kësaj periudhe.

Grafikoni nr.15[466]



Ky grafikon paraqet sasinë e migrantëve ndërkombëtar sidomos të gjinisë femërore në vendin tonë dhe e cila gjatë periudhës 2005 deri 2015 ka një sasi të përhapjes standarde me 58.30% dhe e cila tregon se gjinia femërore është e shprehur shumë në proceset e migracionit ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë.

Grafikoni nr.16[467]



Përveç gjinisë dhe personave të rritur në proceset e migracionit ndërkombëtar në Maqedoni vërehen edhe persona nën moshën 19 vjet e cila llogaritet sim osha më e vlefshme dhe active e një popullate. Gjatë periudhës 2015-2015 dominon viti 2015 me 15.50% të migrantëve ndërkombëtar

[466] https://migrationdataportal.org/?i=stock_perc_female&t=2019&cm49=807, të datës 18.08.2019, ora 12:13
[467] https://migrationdataportal.org/?i=stock_child_perc&t=2019&cm49=807, të datës 18.08.2019, ora 14:38

nën moshën 19 vjet, më pas vijon viti 2010 me 14.40% dhe më pak është e shprehu në vitin 2005 me 13.20%.

Si vend i destinacionit, në Republikën e Maqedonis, në të shumtën e rasteve është prezente trafikimi i brendshëm ose viktima të trafikimit me qenie njerëzore të vendit, por gjtë periudhës së kaluar janë të identifikuar viktima nga Serbia, Kosova, Shqipëria dhe Bullgaria më shpesh në objektet hotelierike në Maqedoninë perëndimore (zonat e Tetovës dhe Gostivarit) me qëllim të shfrytëzimit seksual dhe të punës.[468] Përveç objekteve hotelierike në zonat e lartë përmendura shumë është e përhapur edhe objektet dhe restorantet ku zhvillohet muzikë të gjallë ku vajzat e reja të cilët dyshohen se janë të trafikuara dhe sidomos shtetaset e huja të cilët gjenden aty janë pa leje qëndrimi dhe leje për punë. Në këto restorante përveç muzikës kemi edhe valltare të femrave dhe vajzave të reja ku shumica vijnë nga Shqipëria dhe Kosova por nuk përjashtohen edhe shtetaset serbe, bullgare dhe shtetase të Maqedonisë. "*I pandehuri F.B. deklaroi në gjyq se dëshironte të tregonte të vërtetën, pas së cilës ai deklaroi se në qershor 2013 nga T. ka organizuar kalimin ilegal përmes kufirit K.-M. migrantëve S.R. dhe D.M. me qëllim që të punojnë për të, në objektin e tij hotelierik "B". në T. edhe atë si valltare dhe shoqërues të mysafirëve".*[469] Në këto objekte dhe vende ku sipas gjasave femrat që janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion. Për këto arsye dhe arsye të ngjajhme në këto periudha kohore të kthimit të mërgimtarëve në vendlindje duhet të përforcohen dhe shpeshtohen racionet policore, sidomos gjatë periudhës së verë dhe dimrit. Racia është aksion operativ i përgaditur mirë dhe i rrufeshëm, i cili, të shumtën e herave, shtrihet në sipërfaqe më të mëdha (kompleks godinash, rrugicash) e qëndron në mbylljen e të gjitha shtigjeve të një vendi të caktuar me qëllim heqje të lirisë personave të caktuar dhe kategorive të njerëzve të caktuar.[470] Numri i shtetasve të huaj , cilët u identifikuan si viktima të trafikimi me njerëz, dukshëm ra me anëtarësimin e Rumunisë dhe Bullgarisë në Unionin Evropian, dhe tregon faktin se nga viti 2005 deri në vitin 2007, pjesa dërmuese e viktimave të trafikuara ishin të huaj, kurse Republika e Maqedonisë ishte destinacion primar të viktimave të trafikuara, shumica e cilave vinin nga shtetet e Evropës Lindore.[471] Duke e anaizuar periudhën e viteve 2008-2012 raste të zbuluara të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandaës me migrantë mund të konkludohen këto karakteristika: Në pjesën e trafikimit me njerëz karakteristike është trafikimi i brendshëm, viktimat në numër më të madh janë të mitur nda mosha 14 deri 17 vjet, Mënyra e rekrutimit është përmes rrugës së mashtrimit përmes premtimit të rremë për punësim legal në objekte hotelerike, Viktimat shpesh vijnë nga pjesa lindore dhe qendrore të Maqedonisë, Eksploatimi kryhet në objekte hotelerike në pjesën perëndimore të Maqedonisë: Tetovë, Gostivar dhe Kërçovë, Trafikantët në të shumtën e rasteve janë edhe pronar të objekteve hotelierike ose bashkëpuntor të tyre, Eksploatimi është përmes prostitucionit të dhunshëm dhe eksploatimit për punë.[472] Numri i viktimave me prejardhje nga jashtë pësoi rënie kohëve të fundit, por, në të njëjtën kohë paraqitet rritja e numrit të viktimave nga vendi (sidomos të grave dhe fëmijëve), me të cilët kryhet trafikimi i brendshëm nga mjediset rurale në ato urbane, por vërehet edhe rritje e numrit të viktimave të mitur të trafikimit me njerëz.[473] Pjesa më e madhe

[468] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.23

[469] Aktgjykim nr.59 të datës 03.02.20104 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.4

[470] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.73

[471] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.9

[472] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.23

[473] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.8

e rasteve të zbuluara në Republikën e Maqedonisë të trafikuara për qëllim të shfrytëzimit janë femra të reja dhe vajza (zakonisht më të reja , a shpesh edhe persona të mitur),[474] që vijnë nga rajoni i lindjes dhe qendror.[475] Por, në anën tjetër sa i takon viktimave të trafikimit me njerëz ndërkombëtar vlen të ceket se tani femrat që trafikohen nga Maqedonia në rastet dërmuese me qëllim të prostitucionit ka ndikuar shumë edhe liberalizimi i vizave që i mundësoi që femrave dhe vajzave të reja sidomos të rajoneve rurale të jenë viktimë potencial. Femrat e tilla në shoqëri të trafikantëve zakonisht hyjnë përmes rrugës legale duke i kaluar procedurat kufitare që hyrja e femrave të jetë legale ose përmes vizave të punës ose vizave turistike nganjëherë duke u paraqitur edhe si punonjëse fiktive si baby sister ose punë të ngjajshme dhe më pas duke e keqpërdorur cenueshmërinë e tyre i detyrojnë të mirren me prostitucion. Pra, edhe këtu shihet lidhshmëria e ngusht e migracionit legal, migracionit ilegal dhe të trafikimit me qenie njerëzore.
Gjithashtu, trafikantët e njerëzve, në masë të madhe e shfrytëzojnë varfërinë për organizim të prostitucionit.[476] Në Maqedoni shumica e rasteve të zbuluara të viktimave të trafikimit me njerëz qoftë ato shtetas të Maqedonisë ose të huaj nga shtetet tjera shumica vijnë nga familje të varfëra, ku kushtet e jetesës janë të rënda dhe janë të papunë, ku ekzostonë dhunë familjare, mospasja e kushteve për shkollim etj dhe vijnë sidomos nga vendet rurale. Grupet më të prekura ose viktima potencijal të trafikimit me njerëz jan fëmijët dhe të rrinjtë me arsim të ulët ose pa arsimim në moshë prej 10 deri 22 vjet, nga familje të varfëra dhe jofunksional-kryesisht maqedon dhe anëtarë të bashkësisë etnike rome, familje me dhunë familjare, keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit, fëmij pa prindër dhe kujdes prindëror, gra dhe të mitur nga familje të varfëra dhe familje pa të ardhura, nëna të vetme.[477] Viktimat femra dhe fëmijë të tafikimit me qenie njerëzore në botë por edhe në Maqedoni dhe me qëllim të eksploatim seksual përmes martesave të detyruara llogaritet si trend i ri. Në Maqedoni ky lloj i trafikimit më shumë është e shprehur tek nacionaliteti romë. Në përgjithësi në një anë gjendja e rëndë ekonomike, papunësia, varfëria dhe skamja e madhe dhe në anën tjetër mungesa e arsimimit, mundësitë për punësime tek popullata rome në vendin tonë ndikojnë direkt në rrezikun e viktimizimit të tyre nga vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore. Kështu, të dhënat nga regjistrimi i vitit 2002 tregojnë se grupi më i prekur me papunësi janë Romët, dhe ate, me shkallë të papunësisë dy herë më të lartë se shkalla në nivel kombëtar (78.5% kundrejt mesatares kombëtare prej 38.1%).[478] Viktimat janë eksluzuvisht nga bashkësia etnike rome, që është e lidhur dhe mban rënjët nga e drejta zakonore tradicionsale mes Romëve të negociuar matesa ose e ashtuquajtura "nuse me porosi" dhe eksluzivisht janë të miturit në moshë prej 14 deri 17 vjet dhe janë të përfaqësuar nga të gjizhë pjesët e Republikës së Maqedonisë.[479] Trafikantët ose porositësit e nuseve më së shumti janë nga Serbia dhe Maqedonia, por të cilët gjenden në punë të përkohhme në vendet e Unionit Evropian.[480] Republika e Maqedonisë si shtet e cila gjatë historisë së saj që nga pavarësia e saj e deri sot ka pësuar ndryshime të mëdha të sistemit shtetëror duke insistuar të plotësoj kushtet për anëtarësim në Bashkimin Evopian ende nuk ka arritur standardet

[474] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.23
[475] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.8
[476] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[477] Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011, fq.7
[478] Збирка "Ризични фактори кај Ромската популација по однос на феноменот трговија со луѓе", Здружение за еманципација, солидарност и еднаквост на жените РМ, Скопје 2006, fq.7
[479] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.24
[480] Po aty

evropiane dhe botërore në lidhje me luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore ndaj grupeve të cenueshme siç janë romët. Rritjen e femrave dhe vajzave të trafikuara për shfrytëqim seksual ose për punë në Maqedoni viteve ka ndikuar edhe turizmi sezonal, studimi i të huajve në vend dhe vizitor për investime në ekonominë e vendit të cilët vijnë përkohësisht me qëllim të caktuar. Kushtet dhe kohë zgjatja e lejeve të qëndrimit për të huajt parashihet dhe përcaktohet me ligjet pozitive të shtetit sipas drejtës së saj nacionale për shtetasit e huaj. Sipas ligjit për të huajt të Republikës së Maqedonisë sidomos në nenin 11 paragrafin e parë parashihen kushtet për hyrje në Republikën e Maqedonisë. Kushtet e përgjithshme për hyrje në Republikën e Maqedonisë janë nëse i huaji

- ka dokument të vlefshëm dhe të pranueshëm të udhëtimit,
- posedon vizë të vlefshme, nëse është e nevojshme,
- ka mjete për mbajtje si gjatë periudhës së qëndrimit ashtu edhe gjatë kthimit në shtetin nga i cili vjen apo për udhëtim në shtet të tretë në të cilin është e sigurt se do të pranohen, apo do të ketë mundësi që ligjërisht t'i fitojë ato mjete,
- bashkëngjit, nëse ka nevojë dokumente që e arsyetojnë qëllimin dhe rrethanat e qëndrimit të paraparë në Republikën e Maqedonisë dhe dokumente për sigurimin e udhëtimit,
- nuk është dëbuar nga Republika e Maqedonisë dhe për të cilin nuk ka ndalim të vlefshëm për hyrje,
- nuk paraqet rrezik për rendin publik, sigurimin nacional, shëndetin publik apo për marrëdhëniet ndërkombëtare në Republikën e Maqedonisë.[481] Funksioni legjislativ i shtetit në fillim është e kufizuar në organizimin e shtetit, në masata adminsitrative, por ajo gradualisht zgjerohet në rregullimin e të gjitha sferave tjera sociale, madje edhe në fushën e sigurisë.[482] Periudha kohore me qëllim të studimit të shtetasve të huaj në Republikën eMaqedonisë parashihet me nenin 60, paragrafin 1 të Ligjit për të huaj ku ceket se "Leja për qëndrim të përkohshëm për arsye të shkollimit apo studimit, jepet për periudhën deri në një vit dhe e njëjta mund të vazhdohet nëse i huaji i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 57 të këtij ligji dhe nëse bashkëngjit vërtetim nga institucioni arsimor se ka arritur përparim të rëndësishëm në arsimim."[483] Kështu që edhe ky lloj i emigrimeve ka ndikuar në trafikimin e femrave dhe vajzave të reja nga jashta ose brenda përshkak se edhe kjo kategori e migrantëve janë vizitor të shpeshtë të këtyre objekteve sidomos të striptiz bareve.

Nga e gjith kjo del se trafikimi me qenie njerëzore nënkupton shkeljen e lirive dhe drejtave themelore të njeriut si dhe të drejtën ndërkombëtare përmes mashtrimit duke përdorur kërcënimin dhe dhunën dhe me qëllim të përfitimeve materiale për periudhë kohore sa më të gjatë i shfrytëzojnë për qëllime të prostitucionit, punës fizike, lëmoshës ose heqjes së organeve migrantët nga ana e trafikantëve shihet si një treg shumë i volitshëm të viktimizimit të tyre duke filluar nga të gjitha fazat e trafikimit siç janë rekrutimi, tranzitimi, shfrytëzimi dhe eliminimi. Eksploatimi kriminologjik i njerëzve dhe i organeve të tyre është një koncept i ri kriminologjik dhe juridiko-penal, gjegjësisht biznes i paligjshëm, megjithëse është njohur gjatë gjithë historisë si trafikimi i skllevërve të bardhë.[484] "Gratë viktima të trafikimit nuk mund të quhen "skllevër të bardhë", sepse trafikimi nuk prek vetëm gratë e një përkatësie të caktuar racore, etnike ose kombëtare. Gratë "e bardha" nuk janë viktimat e vetme të trafikimit, por ato janë gjithashtu edhe afrikane, rome,

[481] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.35, 2006, neni 11, paragrafi 1
[482] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.46
[483] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.35, 2006, neni 60, paragrafi 1
[484] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.212

aziatike. Ajo është një term racist, i cili nuk korrespondon me realitetin. Problem paraqet edhe termi "skllav", i cili është diskriminues - ajo stigmatizon një grua, duke e paraqitur atë si dikë, fati i të cilit është vulosur dhe asgjë nuk mund të bëhet për të ndryshuar një situatë të tillë."[485] Për këtë shkak edhe njohja dhe identifikimi sa më i hershëm i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore do të na ndihmonte edhe në luftimin dhe parandalimin sa ml efikas të ksaj vepre kriminale, e cila quhet edhe si identifikim fillestar. Identifikimi fillestar i viktimave të mundshme të trafikimit është tërësia e veprimeve të ndërmarra nga institucionet shtetërore dhe joshtetërore në kufi, jashtë territorit dhe brenda vendit.[486] Identifikim nënkupton identifikimin adekuat krahas përcaktimit të identitetit të personit e cila ka të bëjë me përcaktimin edhe të kategorisë se kujt i takon personi: azil kërkues, viktima të trafikimit me qenie njerëzore, persona të mitur të pashoqëruar, migrantë ilegal.[487]Identifikimi është procedurë me të cilën përmes sërë tregues dhe intervistë me personin fitohen informacione në bazë të cilave bëhet vlerësimi i personit se a është viktimë e trafikimit me njerëz[488] në të cilën dëshmia e dëshmitari ka rol të veçantë. Një person në bazë të dëshmisë së të cilit ose rrethanave në të cilat ai / ajo u gjet, tregojnë se ai / ajo është subjekt i rekrutimit, transportit, transferimit, strehim ose pranim, për qëllime shfrytëzimi[489] janë vetë viktimat e trafikimit. Institucionet qeveritare raportojnë për rritje të vëllimit të imigrantve të padokumentuar në vend, kategori e cila më shpesh është i nënshtruar trafikimit me qenie njerëzore, ku mes tyre është evidente sidomos rastet e të miturve cilët janë të pashoqëruar dhe është kategori për të cilat institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare e llogarisin jashtëzakonisht të pambrojtur dhe me rrezik të lartë për trafikim me qenie njerëzore[490] të cilët edhe në rast të zbulimit të tyre e kanë rëndë të dëshmojnë si dëshmitar-viktimë të trafikimit përshkak sepse kanë qenë pa shoqërim të prindërve dhe me trauma të mëdha dhe shkak i ende joformësimit të tyre bio-psikik. Të mitur të pashoqëruar e parasheh edhe Direktiva e Këshillit të Evropës për anëtarët e vet dhe ate si vijon: " "të mitur të pashoqëruar" janë shtetasit e vendeve të treta nën tetëmbëdhjetë vjeç që mbërrijnë në territorin e shteteve anëtare të pashoqëruar nga një person në moshë madhore përgjegjës për ta, sipas ligjit ose sipas traditës, dhe për sa kohë ata nuk janë efektivisht nën kujdesin e këtij personi ose të miturit që lihen të pashoqëruar pasi kanë hyrë në territorin e shteteve anëtare[491]". Luftimi dhe parandalimi i këtij fenomeni negativ duhet të koncentrohet edhe me shoqërin civile sidomos me aktivitetet preventive të saja. Sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile në sferën e migrimit, në fushën e azilit ekziston një bashkëpunim në ofrimin e ndihmës juridike të azilkërkuesve dhe përfaqësimit të tyre juridik.[492] Duke filluar nga 19.06.2015 (në bazë të ndryshimeve të Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme të datës 18.06.2015), azil kërkuesit mund të dërgojnë kërkesë-deklaratë me qëllim të kërkesës për azil në kufijtë shtetëror ose në

[485] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.19

[486] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.19

[487] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.27

[488] Влада на Република Македонија, Национална Комисија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција "Стандардни оперативни процедури за постапување со жртви на трговија со луѓе", Скопје, 2010, fq.11

[489] http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/Nacionalna-strategija-i-akciski-plan-za-borba-protiv-trgovija-so-lugje.pdf, të datës 17.09.2020, ora 08:56

[490] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.22

[491] Direktivë e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004, "Për lejen e qëndrimit të lëshuar shtetasve të vendeve të treta që janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë objekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente", Gazeta Zyrtare L 261, 6.8.2004 F. 0019 – 0023, neni 2, paragrafi f

[492] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.17

cilindo stacion policor, me cilën kërkuesit i jepet leje me qëndrim për 72 orë, në afat të cilit kërkuesi duhet edhe formalisht të parashtroj kërkesë për azil, por në rast se gjendet në shtet, azil kërkuesi mund të parashtroj kërkesë për azil në stacionin policor më të afërt ose drejëpërdrejtë në Ministrin e punëve të brendshme-Sektori për azil (neni 16-a, Ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme).[493] Hapi ose përparimi më i madh në përmirësimin e statusit të rrefugjatëve dhe të migrantëve u realizua me ndryshimet e dates 18.06.2015 e Ligjit të azilit dhe mbrojtjes së përkohëshme. Me këtë ndryshim u mundësua "legalizimi" i statusit të rrefugjatit dhe migrantit i cili tranziton nga Republika e Maqedonisë, duke siguruar bazë ligjore për pranin e tyre në territorin e saj, si dhe përdorimin e transportit publik dhe ndihmës humanitare.[494] Ky ligj rregullon dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit, dhënien e statusit të mbrojtjes plotësuese apo të përkohshme, personave që kanë nevojë si dhe kthimin e tyre në vendin e origjinës, të prejardhjes ose në një vend të tretë.[495] Në thelb, këto të drejta janë të njëjtat që i gëzojnë secili qytetar i shtetit, me përjashtim të së drejtës së votës, të drejtës për të krijuar marrëdhënie pune, për të krijuar shoqata të qytetarëve dhe parti politike kur nënshtetësia e Republikës së Maqedonisë është detyrim ligjor (neni 57-50 nga LAMP).[496] Është karakteristikë se krimi i organizuar e cila në kuadër të veprimtarisë së saj e ka edhe trafikimin me qenie njerëzore është në rritje permanente dhe e cila është problematikë universale përshkak se ka lidhje të ngushta me autoritetet e policisë, politikan dhe figura tjera publike në shtete konkrete dhe me ndihmën e tyre të korruptuar do të jenë vështirë të luftohet dhe të parandalohet. Duke pasur parasysh natyrën e tij simbiotike dhe lidhshmërinë me strukturat e caktuara shtetërore, observimi i krimit të organizuar depërton në pështjet e ndieshme të politikës dhe pushtetit, duke u nënshtruar kështu ndikimeve dhe manipulimeve politike.[497] Rrezikshmëria shoqërore e kësaj dukurie është në atë se ajo përbën numrin e errët shumë të lartë të kriminalitetit, si në planin nacional po ashtu edhe në atë ndërkombëtar.[498] Enriko Ferri, krimet i ndan në krime të njohura nga policia dhe gjykata dhe në krime reale që kanë ndodhur në botën reale, mirëpo për të cilat nuk ka shënime dhe të dhëna dhe ato nuk janë të evidentuara.[499] Pra, numri errët ose i paevidentuar i kriminalitetit nënkupton veprat e realizuara në praktikë de facto por të cilat de jure nuk janë të regjistruara dhe zbuluara tërësisht nga organet kompetente pra de jure. Sipas kësaj edhe kontrabanda me migrantë dhe trafikimi me qenie njerëzore sado që të jenë vepra penale të zbuluara nga ana e një shteti anën tjetër ka shumë vepra të errëta, të paevidentuara, kryerësit e të cilëve nuk janë të njohur organeve kompetente ose janë të njohur por nuk mund të arrestohen për shkaqe të ndryshme. Nëse aktet ndërkombëtare dhe ligjet nacionale pozitive të shteteve të ndryshme kanë arritur deri në ndarjen teorike të këtyre dy veprimeve kriminale në aspektin teorik por në këndvështrimin e praktikës për shkak të strukturave të komplikuara të këtyre grupeve kriminale dhe ngjajshmërisë shumë të ngushtë të këtyre verpave penale ka ndikuar që gjatë procedurës penale për këto verpa penale shpesh të kemi edhe vendime jo të drejta të kualifikimit të veprës penale nga ana e Gjykatave dhe Prokurorisë publike. Përkatësisht, në diskutimet ndërmjet personave të ndryshëm përgjegjës, në faza të ndryshme të identifikimit të

[493] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.5

[494] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа". Скопје, 2016, fq.32

[495] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.8

[496] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.4

[497] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.10

[498] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.700

[499] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.56

veprave penale dhe përgjigjes juridike penale, ekzistojnë analiza të ndryshme për arsyen e numrit të vogël të çështjeve, të cilësuar si Trafikim i Qenieve Njerëzore.[500] Megjithatë, duhet gjetjen e metodave më efektive dhe përshtatja e metodave ekzistuese për zbulimin e veprave penale dhe kryersve të tyre, si dhe përsosja, përshtatja e sfhrytëzimi i metodave të shkencave të tjera për këtë qëllim,[501] pra për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi por edhe të trafikimit me njerëz. Duke u bazuar në ate se në procedure penale pranë gjykatave kompetente gjatë dhe pas përfundimit të zhvillimit të procedures ndaj të pandehurit duhet të vërtetohet se i pandehuri është kryerës përgjegjës i veprës penale me të cilin akuzohet sipas fakteve të vlefshme dhe të rëndësishme që ndikojnë në marrjen e vendimit përfundimtar të ligjshëm me qëllim të vërtetimit të së vërtetës për çështjen me të cilin akuzohet. Zbulimi i së vërtetës objektive dhe marrja e një vendimi të drejtë kërkon konstatimin me siguri të të gjitha fakteve që kanë lidhje me çështjen.[502] E gjithë kjo procedure që zhvillohet ndaj të pandehurit në procedure penale bëhet me qëllim të vërtetimit të së vërtetës për cilën akuzohet dhe në anën tjetër që most ë dënihen njerëzit e pafajshëm. Në praktikë vërtetimi i plotë i së vërtetës është pothuajse i pamundur dhe për këtë shkak në procedure penale vlen parimi *in dubio pro reo.* Në këtë drejtim teoria e së drejtës së procedures penale *in dubio pro* reo, I cili mundlëson dalje nga situate kur faktet e rëndësishme (në dëm apo në dobi të pandehurit) nuk kanë mundur të vërtetohen me bindshmëri të plotë.[503] Ky qëllim i procedures penale për vërtetimin e së vërtetës ceket edhe në nenin 1 parë të Ligjit të Procedurës penale të Maqedonisë e cila është edhe qëllimi i Ligjit dhe thot: "Ky ligj përcakton rregullat me të cilat mundësohet udhëheqje e drejtë e procedurës penale, ashtu që asnjë i pfajashëm të mos dënohet kurse kryerësit të veprës penale ti shqiptohet sanksion penal me kushtet e parapara në Kodin penal dhe në bazë të procedurës penale".[504] Kurse neni 18 I të njëjtit ligj parashah parimin e ligjshmërisë së ndjekjes penale nga ana e Prokurorisë publike dhe ate: "Prokurori public është I obliguar që të ndërmarrë ndjekje penale nëse ekzistojnë prova se është kryer vepra penale për të cilën ndiqet me detyrë zyrtare, përveç nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe".[505] Siç shihet, rëndësia e çështjes për të cilën vendoset në procedurë penale kërkon angazhim serioz, pikësëpari të gjykatës e pastaj edhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedure për vërtetim të drejtë dhe të plotë të fakteve.[506] Prokurori publik ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare e bën edhe ndaj personave të krimit të organizuar kur ka bazë ligjore dhe dyshim I bazuar. Vepra penale për të cilat ndjekja ndërmerret sipas detyrës zyrtare, të kryera nga grupi ë organizuar prej së paku tre personave, që vepron një periudhë të caktuar, me qëllim të realizojë dobi financiare direkte ose indirekte apo nddonjë lloj tjetër të dobies materiale dhe e cila do të kryejë një apo më shumë vepra penale si dhe vepra penale tjera për të cilat është paraparë me ligj dënimi me burg prej së paku katër vitesh[507], të cilën e parashah edhe ligji për prokurorinë publike. Edhe ligji mbi policinë e parasheh parandalimin dhe luftimin e veprave penale të rënda ose siç e quajmë ne vepra penale të krimit të organizuar në nenin 18. Në shërbimet Qendrore policore funksionon njësia organizative për luftimin e krimit të organizuar dhe vepra të rënda penale, përgjegjës për parandalimin dhe zbulimin

[500] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.8

[501] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.2

[502] Po aty, fq.26

[503] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.114

[504] Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150, neni 1

[505] Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150, neni 18

[506] Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë". Tetovë, 2007, fq.153

[507] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.25

e veprave penale të kryera nga grupi i strukturuar prej tre ose më shumë personave, që ekziston një periudhë të caktuar dhe vepron me qëllim të kryej një ose më shumë vepra penale për të cilët është e paraparë denim me burg prej së paku katër vitesh, me qëllim të realizojë direct ose indirect dobi financiare ose dobi tjetër.[508] Si akt ndërkombëtar e një rëndësie të veçantë është Protokolli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, e cila parashah se "Trafik personash" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitutet."[509] Pra, *causa criminalis* i trafikantëve me njerëz janë pothuajse të gjithë kategoritë e njerëzve të cilët me viktimizimin e tyre i shfrtëzojnë për qëllime të ndryshme. ***Causa criminalis*** është ngjarje reale, e cila me përmbajtjen e vet tregon në vepër penale konkrete dhe kryerësin e saj, për të cilën zhvilloher procedurë penale.[510] Vitet e fundit edhe interesimi ndërkombëtar është rritur ndaj trafikimit me qenie njerëzore e cila shqyrtohet analizohet me qëllim të luftimit të saj së bashku me kontrabanëdn me migrantë dhe migracionin e paligjshëm për shkak të lidhshmëris mes tyre. Si shkak i zvoglimit të numrit të lëndëve penale, të kualifikuara si Trafikim me njerëz, mund të jetë edhe fakti se në vitin 2008, si vepër penale është shtuar edhe neni për Trafikim me persona të mitur.[511] Por, në lidhje me luftimin dhe parandalimin e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore vërehet ulje sidomos në pjesën identifikimit të viktimave dhe dënimin e kryerësve të kësaj vepre penale gjë që nënkuton ende nuk kemi mekanizma të mirëfillta për luftimin e kësaj dukurie nga institucionet shtetërore. Qëllimi i indentifikimit është që viktima të vij deri tek shërbimet/organet kompetente për përkrahje dhe ndihmë sa më shpejt dhe në mënyrën më të përshtatshme të jetë e mundur.[512] Për t'i mbrojtur dhe ndihmuar ata, procesi i identifikimit është i një rëndësie të madhe viktimat të identifikohen shpejt dhe saktë.[513] Megjithatë, viktimat e trafikimit me njerëz në rajonin e Ballkanit perëndimor duhet të jenë të orientuara drejt rehabilitimit dhe (ri) integrimitt të viktimave, duke dhënë viktimave mundësi për integrim krejtësisht / tërësisht në shoqëri.[514] Domethënë në vitin 2005 kemi 11 raste të zbuluara dhe të procesuara në proedurë gjyqësore, kurse për vitin 2006 kemi 3 raste të procesuara, gjatë vitit 2007 në 2 raste kurse në vitin 2008 në 4 raste.[515]

---

[508] Закон за полиција (пречистен текст), 2015, neni 18, paragrafi 1, pika 1

[509] Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi a)

[510] Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë". Tetovë, 2007, fq.64

[511] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.9

[512] Влада на Република Македонија, Национална Комисија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција "Стандардни оперативни процедури за постапување со жртви на трговија со луѓе", Скопје, 2010, fq.11

[513] Правилник (Прирачник). "Регионални упатства за идентификација на жртвите на трговија со луѓе", за Југоисточна и Источна Европа, Татјана Фомина, Интернационален центар „Ла Страда"- Молдавија и Мариа Вогиаци, Центар за заштита на човековите права – Грција, 2012, fq.9

[514] Упатства за рехабилитација и реинтеграција на жртви од трговија со луѓе -Прирачник за земјите од Западен Балкан, Скопје 2015, fq.4

[515] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.8

PJESA E DYTË

SHQYRTIME TË PËRGJITHSHME TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE SI PJESË E KRIMIT TË ORGANIZUAR

KAPITULLI I

HISTORIKU DHE PËRKUFIZIMI I TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE SI PJESË E KRIMIT TË ORGANIZUAR

1. Historiku i shkurtër mbi lindjen dhe zhvillimin e trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar

1.1. Historiku dhe zhvillimi i krimit të organizuar

Vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore si veprimtari e kundërligjshme dhe shumë e rrezikshme dhe e dëmshme për shtetin, sistemin shtetëror, shoqërinë në përgjithësi dhe në veçanti për individin nuk është e mundur të organizohet dhe as të realizohet pa krimin e organizuar dhe për këtë shkak studimi i krimit të organizuar ka një rëndësi të veçantë. Shikuar nga këndi etimologjik termi krim është i kohës Romake, nga shprehja post klasike latine; ***Crimen, Maleficium, Delictum, Scelus,*** që në përkthimin e thjeshtë, në shqip do të thotë: krim, keqbërje, delikt i rëndë, xhelozi, kundërvajtje e normës shoqërore.[516] Në periudha të ndryshme kohore gjatë historisë së njerëzimit kriminaliteti ka pasur forma të ndryshme të shfaqjes e deri te reagimi shtetëror dhe shoqëror ndaj kësaj dukurie negative. Dukuria e skllavërisë dhe rrobërisë ka qenë e nevojshme të pritet që nga fillimi i shoqërisë njerëzore, e deri në shekullin e 18-të për ta përkufizuar atë si një veprim kundër njerëzimit.[517] Bashkësinë primitive e karakterizojnë rregullat e sjelljes dhe normat e karakterit moral, prandaj sulmi ndaj atyre rregullave kuptohej si atak në jetën kolektive, traditën dhe integritetin e tërë shoqërisë.[518]

Pra, në periudhën e paraformimit të shteteve të para kemi një krim të organizuar klasik dhe primitiv duke e pasur parasysh nivelin e zhvillimit të jetës shoqërore të asaj kohe. Në atë kohë më shumë kemi grupe të vogla të kriminelëve që janë bashkuar për kryerjen e aktivitetetve kriminale. Derisa teoritë e para në lidhje me këtë dukuri në përgjithësi e lidhin me një shkak shembull struktura atipike e trupit, anomalitë gjenetike, sëmundjet mendore, anomalitë fizike dhe varfëria, teoritë e mëvonshme kriminalitetin e kanë pranuar si dukuri sociale nga shumë shkaqe.[519] Me fillimin e kolonializmit në shekullin e 15-të, ku si nevojë primare e Perëndimit ishte fuqia punëtore, filloi të realizohet tregtia e skllevërve.[520] Tregtia me skllevër ka pasur edhe para periudhës së kolonializimit por në forma të tjera të organizimit. Sidoqoftë, tregtia e skllevërve në këtë periudhë dallon në atë se për kohë shumë të shkurtër dhe sistematik janë tregtuar miliona njerëz dhe më e keqja e saj është vdekja miliona njerëzve gjatë udhëtimit[521] e cila ka qenë e organizuar nga grupe të ndryshme. Por, më vonë me formimin e shteteve të para sidomos me kalimin në sistemin e reagimit institucional apo të organizuar shtetëror është karakteristik për fazën e paraqitjes së ligjeve të para të shkruara, të cilat parashihnin dënime të rënda trupore (Kodi i Hamurabit, Kodi Romak i 12 Tabelave, Kodi i Moisiut)[522] ndaj kryerësve të krimeve. Termi "Krim i organizuar",

[516] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.24

[517] Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës "Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan tıcareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede uluslararası işbirliği". Istanbul, 2010, fq.154

[518] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.22

[519] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.67

[520] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, fq.41

[521] Po aty

[522] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.22

është përdorur për herë të parë në vitin 1896, në Raportin e Shoqatës për Parandalimin e Krimit në Nju Jork.[523] Pra, mund të thuhet se krimi është i vjetër sa vet historia e njerëzimit përshkak se me vet zhvillimin e shoqërisë njerëzore është zhvilluar edhe krimi si dhe më vonë edhe krimi i organizuar.

Pra, siç u tha më lartë në fillim të njerëzimit kriminaliteti ka qenë individual ose në grupe të vogla jo të organizuara në mënyrë profesionale siq është në vitet e fundit. Sipas autorit ***R.Halili***, me nocionin kriminalitet kuptohet, tërësia e të gjitha krimeve të kryera në një kohë, hapësirë dhe perudhë të caktuar,[524] dhe në të gjitha periudha kohore dallohet me karakteristika të veçanta të asaj periudhe kohore kur realizohet aktiviteti kriminal. Historikisht shiquar, krimi i organizuar si nocion e ka origjinën në Itali kurse ngritja e saj në në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nga aspekti i trajtimit penalo-juridik të pjesëmarrjes së organizuar të më shumë personave në vepër penale, më i përshtatshëm është definicioni që i kombinon elementet dhe qëllimet penalo-juridike të reaksionit të posaçëm dhe të përforcuar: kryerja e veprave penale nga ana e shoqatës kriminale për të realizuar profit ose fuqi, me përdorimin e forces ose me shfrytëzimin e pozicionit të posaçëm në shoqëri, me zvogëlimin e rrezikut nëpërmjet kyçjes në aktivitete legale ekonomike, politike dhe aktivitete të tjera dhe me system që më pare të krijuar të mbrojtjes nga ndjekja.[525] Ndër organizatat më të njohura të krimit të organizuar të cilat përmenden shpesh në literaturën bashkëkohore kriminologjike janë: "Mafia" Italiane, "Koza Nostra" Amerikane, "Triadat" Kineze, "Jakuza" Japoneze, "Mafia Ruse" dhe shumë organizata të tjera kriminale që veprojnë në Evropë dhe Amerikë, nga të cilat duhet vequar "Mafinë Italiane"dhe "Koza Nostrën" Amerikane.[526] Mafia e ka origjinën në Sicili që nga kohërat e lashta të pushtimit të Napoleonit ndaj Italisë jugore.[527] Si organizatë më e njohur kriminale dhe e cila llogaritet si organizata e parë dhe më e vjetër është "Mafia" italiane. Sipas disa autorëve, vetë fjala "MAFIA" rrjedh nga një emërtim i një organizate e cila ishte e krijuar në Sicili, dikund kah viti 1282, për të rezistuar ndaj pushtimit françez të këtij ishulli.[528] Më pas ajo u shtri edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku shumë familje mafioze emigruan për shkaqe të ndryshme atje dhe vazhduan veprimtarinë e tyre.[529] Në dekadat e para të këtij shekulli, mafia e përhapi veprimtarinë e saj në SHBA si një organizatë kriminale sekrete në mesin e emigrantëve italianë, që synonin kryesisht prodhimin e paligjshëm të narkotikëve, organizimin e kumarit dhe prostitucionit dhe sjelljet e tjera asociale.[530] Një ndër shefat më të njohur të Mafia-s amerikane, ka qenë edhe Al Cappone, i cili ka vepruar në qytetin e Çikagos dhe është marrë me: reket, shantazhe, plaçkitje të armatosura të bankave, organizimin e bixhozit dhe prostitucionit ilegal, trafikimin e alkoolit në kohën e Prohibicionit etj.[531]

Zhvillimi më i hovshëm i krimit të organizuar shihet pas shekullin XX kur edhe e merr formën më të rrezikshme të saj. Me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë ka ndikuar edhe në paraqitjen e formave të reja të kriminalitetit gjegjësisht risi në veprimtarinë e aktiviteteve kriminale është përdorimi i teknikës dhe teknologjisë së sotisfikuar pëer kryerjen e aktiviteteve kriminale.

[523] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.23
[524] Po aty, fq.21
[525] Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018, vep. e cit., fq.22
[526] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.65
[527] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.204
[528] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.143
[529] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.174
[530] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.204
[531] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.146

Siç theksuam më parë, krimi i orgnizuar, veten e tregon në të gjitha fushat ku ka fitim të madh material[532] duke depërtuar në çdo sferë të jetës shoqërore dhe ndikon si një dukuri reale dhe shumë e rrezikshme në jetën e njerëzve dhe në zhvillimet e mëtutjeshme shoqërore, ekonomike dhe në përgjithësi për sistemin shtetëror.

1.2. Historiku dhe zhvillimi i trafikimit me qenie njerëzore

Trafikimi me qenie njerëzore ekziston që në kohërat më të lashta të njerëzimit, sidomos gjatë sundimeve dhe pushtimeve të territoreve të ndryshme nga ana e perandorive të ndryshëm e njohur si trafikimi i skllevërve e cila zgjat deri në ditët e sodit. Që nga kohërat e lashta e deri më sot trafikimi me qenie njerëzore ka ndryshuar format dhe mënyrat e veprimit varësisht nga periudha kohore, vendi dhe qëllimi i shfrytëzimit të njerëzve. Ai ekziston nga një kohë më e gjatë se vendosja e kufijve ndërmjet popujve dhe kombeve,[533] gjë e cila nënkupton se dukuria e shfrytëzimit të qenies njerëzore daton shumë herët. Nëse i referohemi periudhave më të hershme kategoria e personave me statusin ―skllav nuk ekzistonte, kjo dukuri filloi të shfaqej për shkak të luftërave të shumta të ndodhura dhe për shkak të trofeve të përftuara gjatë luftimeve.[534] Në këtë kontekst, skllavëria dhe trafikimi i personave si bashkudhëtarë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore mbeten forma më brutale dhe tronditëse e shkeljes së të drejtave të njeriut, të cilat lidhen me epoka sa të errëta aq dhe të largëta të historisë së njerëzimit.[535] Të dhënat tregojnë se në epokën antike skllavëria ka ekzistuar në forma shumë të rënda dhe degraduese, që dëshmohet në gjurmët më të hershme të shkruara të tilla si Kodi i Hamurabit dhe shkrimet e tjera të analizuara si transkriptet e historive gojore etj.[536] Trafikimi me qenie njerëzore, sipas disa statistikave, është industria e dytë kriminale më e madhe me fitimin vjetor prej mbi 10 miliardë dollar amerikan.[537] Trafikimi i qenieve njerëzore është një veprim në të cilin një person shndërrohet në një mall dhe shfrytëzohet në mënyra të ndryshme dhe më çnjerëzore. Trafikimi i qenieve njerëzore përkufizohet si një punë globale e paligjshme gjithnjë me rritje të shpejtë.[538] Si rrjedhojë e këtyre luftimeve dhe trofeve të marra nga lufta, ku pjesa më e madhe e trofeve përfaqësohej nga njerëz të kthyer në robër, numri i skllevërve pati një rritje të madhe dhe për pasojë lindi dhe tregëtia me ta.[539] Studiuesit social kanë argumentuar se lindja e prostitucionit, pra edhe skllavërimi i grave për shfrytëzim seksual, lidhet, së pari, me përmbysjen e raporteve midis burrave e grave, pikërisht me kalimin nga e drejta amtare (matriarkati), në të drejtën atërore (patriarkati).[540] Nga ana tjetër, në kohën kur tregtia e skllevërve filloj të rritet edhe më shumë nga sundimtarët dhe kolonialistët filloj edhe interesimi i regullimit të kësaj dukurie. Metodat dhe mjetet e realizimit të trafikut të skllavërve, rregullimet juridike në

[532] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.301
[533] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.101
[534] Imeraj, Elizabeta. Disertacion i doktoraturës "Aspektet teorike dhe praktike për studimin e trafikimit të qenieve njerëzor". Tiranë, 2011, fq.7
[535] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.18
[536] Po aty
[537] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, fq.1
[538] Rehberlik. "İnsan Ticareti suçunu anlamak". İngiltere Buyukelçiliği Ankara, 2017, fq.10
[539] Imeraj, Elizabeta. Disertacion i doktoraturës "Aspektet teorike dhe praktike për studimin e trafikimit të qenieve njerëzor". Tiranë, 2011, fq.7
[540] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.19

lidhje me skllevërit, shfrytëzimin e skllevërve për fuqi punëtore ndryshojnë dhe dallohen sipas shoqërive dhe periudhave. Për shembull, **Váquez de Menchaca**, që jetonte midis viteve 1512-1569 dhe një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të Shkollës Salamanca, argumentoi se skllavëria ishte kundër natyrës njerëzore dhe se qëllimi i mendimtarëve si Aristoteli që pranuan skllavërinë tjetër si një institucion legjitim e bënin për arsye arsyetimit luftërave jolegjitime dhe jo të drejta. Viktimat mund të angazhohen në bujqësi, miniera, peshkim ose punë ndërtimore, së bashku me shërbimin shtëpiak dhe punë të tjera që kërkojnë shumë punë.[541] Tregëtia e skllevërve ka qënë më e përhapur duke filluar nga shek XV deri në shekullin XIX,[542] sidomos me krijimin e perandorive të ndryshëm. Sidoqoftë, sot e kësaj dite trafikimi me qenie njerëzore vazhdon të jetë prezente, shumë e përhapur dhe në trend në çdo shtet në nivel botëror për shkak të rritjes gjithnjë e më të tepërta të kërkesave. Trafikimi me qenie njerëzore në kohërat e lashta e njohur si trafikimi me skllevërve është karakterizuar edhe me trafikimin Evropian të njerëzve pra të skllevërve nga vendet e Afrikës dhe janë të transportuar në vendet e Evropës si në Portugali, Britani të Madhe, Spanja, Franca, dhe në vendet skandinave, që ishin subjekt i tregtisë së skllevërve. Trafikimi i skllevërve afrikanë është me rëndësi të madhe sepse është një shans i mirë për të kuptuar konceptin e skllavërisë për shkak të brutalitetit të mënyrave të skllavërimit, dhunës ndaj skllevërve dhe ndikimi i skllevërve në zhvillimin ekonomik të Perëndimit. Nuk ekzistonte asnjë lloj e drejte për personat e kthyer në skllevër, pasi ata konsideroheshin si sende që flasin, por që nga ekzistenca e tyre dhe çdo gjë tjetër ishte në favor të pronarit të tyre apo të ashtuquajturit-padronit.[543] Lumturia e tyre varet nga marrëdhënia që ata do të zhvillonin me pronarët e tyre.[544] Tregtia dhe shfrytëzimi i skllevërve ka vazhduar gjatë Mesjetës, sidomos gjatë kohës së zbulimeve gjeografike, revolucionit industrial dhe deri në shek.XX gjatë Luftës së dytë Botërore në kampet e përqendrimit nazist ose të punës së detyruar, prostitucionit.[545] Në fund të mesjetës, ndryshimet dhe zhvillimet politike dhe ekonomike në shumë vende të botën e ndryshuan mendimin dhe botëkuptimin e shteteve ndaj skllevërve dhe shfrytëzimit të tyre duke llogaritur si vepër kundër njerëzimit, por tani fillon emërtimi i ri si trafikim me njerëz. Por në vitin 1688 u botua një libër që do t'i nxiste shumë njerëz të fillojnë të mendojnë për skllavërinë si një fenomen jo veçanërisht i favorshëm për njerëzit.[546] Novela e quajtur **Oroonoko** nga autori i atëhershëm **Aphre Behn** „ka treguar për vuajtjet e princit afrikan dhe personit të tij të dashur që u transportuan në skllavërinë e Surinamit.“[547] Kjo mund të konsiderohet si zhvillim i një mekanizmi dhe metode mbrojtëse në ndërgjegjen e shoqërisë po edhe të shteteve si një dënim për skllavërinë dhe trafikimin e tyre. Si shtet i parë i cili në sistemin e vet e miraton ligjin për ndalim të skllevërisë është Britania e Madhe në vitin 1807. Në vitin 1820 Shtetet e Bashkuara të Amerikës miraton ligj me cilën trafikimin me skllevër e dënon me vdekje.[548] Në vitin 1833, skllavëria u shfuqizua në kolonitë britanike, duke liruar më shumë se tre të katërtat

[541] https://www.interpol.int/en/Crimes/Human-trafficking/Types-of-human-trafficking, të datës 14.09.2020, ora 08:15
[542] Imeraj, Elizabeta. Disertacion i doktoraturës “Aspektet teorike dhe praktike për studimin e trafikimit të qenieve njerëzor”. Tiranë, 2011, fq.7
[543] Po aty
[544] Burić, Željka. Disertacion i doktoraturës “Pravni i institucionalni okvir za suzbivanje trgovanja ljudima u Republici Hrvatskoj”. Zagreb, 2011, fq.10
[545] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës “Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij”. Tiranë, 2015, fq.19
[546] Burić, Željka. Disertacion i doktoraturës “Pravni i institucionalni okvir za suzbivanje trgovanja ljudima u Republici Hrvatskoj”. Zagreb, 2011, fq.12
[547] Burić, Željka. Disertacion i doktoraturës “Pravni i institucionalni okvir za suzbivanje trgovanja ljudima u Republici Hrvatskoj”. Zagreb, 2011, fq.12
[548] Po aty, fq.13

e miliona skllevërve.[549] Në shume shtete evropiane janë të shfrytëzuar me miliona njerëz skllevër për qëllime të ndryshme. Gjermania naziste ka shfrytëzuar rreth 12 milion persona, kryesisht me origjine nga Europa Lindore, ndërsa Japonia ka shfrytëzuar më shumë se 18 milion nga Lindja e Largët.[550] Në vitin 1862, Abrahami Lincoln lëshoi një dokument (të ashtuquajturën Shpallja e Emancipimit), sipas të cilit të gjithë ata që ishin në në marëdhënie si skllevër duhej të liroheshin nga kjo marrëdhënie.[551] Pastaj shumë vende organizuan konferenca përmes të cilëve filluan të bisedojnë për inkriminim e veprës si krim dhe caktoheshin dënime për kryerësit e tyre sidomos pas viteve 1900-tat. Pas Luftës së II Botërore, u miratua një nga dokumentet e para ndërkombëtare të themelore - Konventa për Ndalimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Shfrytëzimin e Prostitucionit të tjerat nga 02 dhjetorit 1949.[552] Forma e paraqitjes dhe shfaqjes së saj në kohërat e lashta ka qenë sipas kushteve të asaj kohe, por, me kalimin e kohës sidomos forma e shfaqjes në kohën bashkëkohore ka marë një koncept dhe definim përfundimtar.

2. Kuptimi dhe përkufizimi i trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar sipas akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit të Republikës së Maqedonisë

2.1. Kuptimi dhe përkufizimi i krimit të organizuar sipas akteve ndërkombëtare

Gjatë historisë e deri në vitet e fundit krimi i organizuar është shfaqur në periudha të ndryshme kohore me format e saj karakteristike për çdo periudhë dhe për çdo shtet. Edhe sot krimi i organizuar me format e saj të shfaqjes paraqet një rrezik dhe kërcënim serioz për çdo shtet por edhe më gjerë në rajon por edhe në nivel ndërkombëtar dhe për këtë shkak shumë studjues i përdorin termet krimi i organizuar ndërkombëtar ose transnacional. Në lidhje me termet që përdoren ndaj krimit të organizuar përdoren terme të ndryshme gjegjësisht sinonime si: krimi i organizuar ndërkombëtar, krimi i organizuar transnacional, krimi i organizuar global, krimi i organizuar shumëkombësh, krimi i organizuar multinacional. Kohëve të fundit më përfshirjen e saj në shumë shtete duke mare formën e krimit ndërkombëtar ose transnacional ku në bazë të përbërjes heterogjene të grupeve të tilla kriminale rritet edhe interesimi i shoqërive, shteteve por edhe të studjuesve të kësaj fushe për përkufizimin e vetëm ndërkombëtar përshkak të rrezikshmërisë së madhe dhe serioze.

Aspekti ndërkombëtar i krimit të organizuar më së miri është paraparë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar sidomos në nenin 3 me titull "fusha e aplikimit". Neni 3. Paragrafi 2 një vepër penale ka një natyrë ndërkombëtare në qoftë se: (a) kryhet në më shumë se një Shtet; (b) kryhet në një Shtet, por pjesa thelbësore e përgatitjes, planit, drejtimit ose kontrollit kryhet në një Shtet tjetër; (c) kryhet në një Shtet, por në të është përfshirë një grup kriminal i organizuar, i cili angazhohet në aktivitete kriminale në më shumë se një Shtet; ose (d) kryhet në një Shtet, por efektet thelbësore i ka në një Shtet tjetër.[553]

Në lidhje më përcaktimin e definicionit të vetëm dhe të përbashkët për krimin e organizuar përveç kriminologjisë dhe kriminalistikës, përpjekje kanë treguar shtetet me inkorporimin e saj në

[549] Po aty

[550] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.19

[551] Burić, Željka. Disertacion i doktoraturës "Pravni i institucionalni okvir za suzbivanje trgovanja ljudima u Republici Hrvatskoj". Zagreb, 2011, fq.13

[552] Po aty, fq.14

[553] Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000, neni 3, paragrafi 2

ligjet e tyre dhe në anën tjetër në aspektin ndërkombëtar shum sudjues dhe ekspert të kësaj fushe përmes pjesëmmarjes së tyre në tribuna, konferenca, takime, samite kanë miratuar shumë dokumente, konventa ndërkombëtare, marëveshje bilaterale dhe multilaterale dhe në këto takime është munduar të përcaktohen elementet sidomos karakteristikat e kësaj vepre penale të cilët dë të lehtësojnë dhe do të arrijnë në një definim të vetëm dhe t përbashkët për çdo shtet. Kur në një takim, siç ishte Konferenca e Londrës (Konferenca e minsitrave të BE mbajtur më 25 nëntor 2002) e cila kushtohej krimit të organizuar në Evropën Juglindore, marrin pjesë 300 personalitete të cilët përfaqësonin 57 shtete, ku si prioritet është theksuar zhvillimi i aftësisë së BE-së që t'i kundërvihet kërcënimit nga krimi i organizuar dhe ndërrprerja e aktiviteteve të grupeve kriminale brenda apo jashtë BE-së.[554] Me të drejtë, ***Dr. Vasilika Hysi***, konstaton "Ndonëse nuk ekziston një përkufizim uniform i krimit të organizuar, grupet kriminale në Evropë dhe më gjerë po bëjnë përpjekje për të bashkërenduar aktivitetet dhe ndarë zonat e veprimit ndërmjet tyre. Krimi i organizuar po njeh zhvillime të reja në llojet të aktiviteteve kriminale dhe mënyrat e realizimit të tyre."[555]

Ndikim dhe një hap për përcaktimin e përkufizimit të krimit të organizuar kontributin e saj të vetëm në mënyrë më të detajuar ka dhënë Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, në Palermo në vitin 2000 e cila ka hyrë ne fuqi në vitin 2003 ku është afruar përcaktimit të definicionit për krimit të organizuar. Konventa e Kombeve të Bashkuara ose Konventa e Palermos në aspektin ndërkombëtar ka bërë hapin më serioz drejt përkufizimit, luftimit, ndërmarrjen e masave preventive dhe represive ndaj kësaj dukurie edhe masat që duhet të mirren nga shtetet dhe të njejtat të inkorporojnë në legjislacionet e tyre penale si masa ligjore që do të dënoj këtë vepër penale dhe kryersit e tyre. Detyrimi parësor i Konventës ka të bëjë me përcaktimin si vepër penale të sjelljes konkrete. Sipas saj nëse një vepër kriminale nuk i ka elementet dhe karakteristikat që janë të paraparë atëherë ajo vepër nuk do të llogaritet si krim i organizuar dhe do të jetë si veprat tjera penale, e jo vepër e cila do të jetë e organizuar. OKB përmes organeve të tij-para së gjithash Asambleja e përgjithshme, Këshilli i sigurisë dhe Gjykata ndërkombëtare e drejtësisë- si dhe përmes organizatave të veçanta, që janë të lidhura me to, thekson vazhdimisht rëndësinë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për procedurat penale dhe sistemin penal.[556]

Përkufizimi i kuptimit dhe definicionit të krimit të organizuar e pranuar ndërkombëtarisht parasheh neni 2 i konventës së Palermos në pjesën e "përdorimi i termave". "Grup kriminal i organizuar" nënkupton një grup të strukturuar, i cili ka ekzistuar për një periudhë kohe të caktuar, i përbërë nga tre ose më shumë persona, të cilët veprojnë në harmoni me njëri-tjetrin, me qëllim që të kryejnë një ose më shumë krime ose vepra penale serioze, të përcaktuara si të tilla në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, me qëllim që të sigurojnë, në mënyrë direkte ose indirekte, përfitime financiare ose materiale.[557] Si grup i strukturuar llogaritet grupi i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen momentale të krimit dhe e cila nuk është e domosdoshme të ketë rol të definuar të anëtarëve të saj, kontinuitet në anëtarësinë e saj dhe strukturë të zhvilluar.[558] Pikësynimi i kësaj Konvente është ta përkrahë bashkëpunimin për parandalim dhe luftim të krimit të organizuar ndërkombëtar, në mënyrë më efektive për gjitha format e paraqitjes së saj, duke

[554] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.173

[555] Po aty, fq.178

[556] Хекер, Бернд. "Европско Кривично Право". Скопје, 2010, fq.173

[557] Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000, neni 2, paragrafi (a)

[558] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.17

filluar nga krimi i organizuar lidhur me kontrabandën me narkotikë, kontrabandën me armë dhe municion, vlera të artit, me automjete, korrupsionin, larjen e parave, trafikimin e qenieve njerëzore si dhe krimin e organizuar në fushën e teknologjisë së lartë.[559] Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar[560], e paraparë në nenin 1 në pjesë e "deklarimi i qëllimit" të Konventës së lartëpërmendur. Pra nga kjo mund të përfundojmë se bashkëpunimi ndërkombëtar mes shteteve ka një rëndësi të posaçme në lidhje me luftimin dhe parndalimin e kësaj dukurie negative dhe e cila i tangon të gjitha shtetet në botë.

Përkufizimi i Konventës së Palermos është pranuar edhe nga Këshilli i Evropës (CE) dhe Bashkimi Evropian (BE).[561] BE-ja filloi me aktivitete intensive në luftën kundër krimit të organizuar pas traktatit të Amsterdamit nga viti 1997, me të cilin shtylla e tretë e UE-së, bashkëpunimi gjyqësor dhe policer në sferën penale është vënë në contest të zhvillimit të BE-së si regjion i lirisë, sigurisë dhe drejtësisë me qëllim të harmonizimit të legjislacioneve penale evopiane, Këshilli i ministrave të BE-së në vitin 2005 miratoi vendimin kornizë, në të cilin është precizuar përkufizimi i organizatës kriminale, identik me Konventën e Palermos.[562] Sipas planit të përbashkët të Unionit Evropian të 21 dhjetorit 1998, në të gjitha vendet anëtare të tij, "organizatë kriminale do të quhet organizata që ka një strukturë të përbërë nga dy ose më shumë persona, e krijuar për të vepruar gjatë një kohe të caktuar dhe që kryen krime për të cilat ligji parashikon një maksimum prej të paktën 4 vite burgim ose dënime më të rënda".[563] Një konstatim gjithëpërfshirës lidhur me definicionin e kriminalitetit të organizuar e ka dhënë autori **H.Abadinsky** i cili konstaton se: "Kriminaliteti i organizuar është një shoqatë pa premisa ideologjike e një numri personash, të cilët ndërmjet veti krijojnë afërsi të ngushtë të interaksionit shoqëror, e organizuar në bazë hierarkie, më së paku në tri nivele, me qëllim të krijimit të profitit dhe fuqisë, duke iu falëndëruar pjesëmarrjes në veprimtarirë jo legale dhe legale".[564]

Duke u bazuar në rrezikshmërinë e lartë dhe shumë të dëmshme të funksionimit të krimit të organizuar në një shtet dhe në arenën ndërkombëtare, mirren masa për parandalimin dhe luftimin e saj në çdo shtet, rajon dhe më gjerë duke filluar nga ligjet nacionale deri te aktet ndërkombëtare. Për shkak të rrezikut dhe dëmit shoqëror, të gjitha shoqëritë po përpiqen ta luftojnë atë (me prevencion ose represion) përmes gjetjes së vazhdueshme të metodave dhe mjeteve adekuate dhe efikase.[565] Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar i obligon edhe shtetet që të konsolidoj ligjet e tyre në bazë të direktivave që jepen me këtë Konventë. Sipas nenit 27, "Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit" të Konventës: "Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin, në përputhje me sistemet e tyre përkatëse ligjore dhe administrative, për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit në luftë kundër veprave penale të përfshira në këtë Konventë. Me synimin për t'i dhënë efekt kësaj Konvente, shtetet pjesëmarrëse duhet konsideruar hyrjen në pajtimet apo marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale në kooperimin direkt në mes të

[559] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.56
[560] Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000. Neni 1
[561] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.18
[562] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.19
[563] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, vep. e cit., fq.28
[564] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, vep. e cit., fq.26
[565] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.155

degëve të ruajtjes së rendit dhe, kur pajtimet dhe marrëveshjet e tilla tanimë ekzistojnë në përmirësimin e tyre.[566]

2.2. Kuptimi dhe përkufizimi i krimit të organizuar sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë

Dukuria e krimit të organizuar gjegjësisht rreziku nga kjo dukuri kanë ndikuar që shumë shtete dhe qeveri të bëjnë një hap një qasjeje juridiko-penale shumë serioze dhe profesionale të qeverive të shtetetve konkrete, organizatave ndërkombëtare por edhe të gjithë shoqërive në nivel botëror. Që nga paraqitja e krimit të organizuar nga historia e deri në ditët e sodit kjo dukuri ka pësuar ndryshime të mëdha sidomos në përsosshmërin e organizimit të brendshëm dhe format e realizimit të veprimtarive kriminale.

Ekzistojnë definicione të ndryshme të nocionit të krimit të organizuar, në varshmëri prej qëllimit të tyre si dhe prej funksioneve juridike-dogmatike dhe kriminale-politike të definimit të këtij nocioni.[567] Nga aspekti i trajtimit penalo-juridik të pjesëmarrjes së organizuar të më shumë personave në vepër penale, më i përshtatshëm është definicioni që i kombinon elementet dhe qëllimet penalo-juridik të reaksionit të posaçëm dhe të përforcuar: kryerja e veprave penale nga ana e shoqatës kriminale për të realizuar profit ose fuqi, me përdorimin e forcës ose me shfrytëzimin e pozicionit të posaçëm në shoqëri, me zvogëlimin e rrezikut nëpërrmjet kyçjes në aktivitete legale ekonomike, politike dhe aktivitete tjera dhe me sistem që më parë të krijuar të mbrojtjes nga ndjekja.[568] Edhe Republika e Maqedonisë që nga dita e pavarësisë së saj e deri sot permanent është munduar të gjej zgjidhje ligjore në lidhje me krimin e orgnizuar. Duke e pas parasysh se kjo problematikë e tangon edhe Republikën e Maqedonisë me pozitën e saj edhe si shtet i origjinës, si shtet tranzit dhe destinacioni në pajtueshmëri me konsolidimin e ligjeve të saj me ligjet e Bashkimit Evropian dhe në pajtueshmëri ose inkriminim direkt të detyrave dhe obligimeve që lindin nga Konventat e ndryshme të kësaj fush, e ka të paraparë inkriminim e kësaj dukurie negative si vepër penale në Kodin Penal të saj.

Në Kodin penal të Maqedonisë nuk ekziston krimi i organizuar si vepër penale të veçantë përshak se ajo paraqet bashkim ose shoqërim të veprave panele, sidomos paraqet një sërë veprash penale me një lidhshmëri kauzale në aspektin e shfrytëzimit të mundshëm kriminal dhe të kryer nga më shumë se disa persona, të cilët janë pjesë si anëtar të grupeve, shoqata e kriminale dhe bandave. Pra, nga kjo del se ligjet e Maqedonisë nuk e definojnë dhe nuk e inkriminojnë strikt krimin e organizuar por kuptimin e saj mundohet të definoj dhe inkriminojë përmes shoqatave kriminale, grupit dhe bandës. Këtë definim dhe kuptim e parasheh paragrafi 20 e nenit 122 të Kodit Penal të Maqedonisë. *Me grup, bandë ose shoqërim tjetër kriminel ose organizatë nënkuptohen të paktën tre persona të cilët janë të bashkuar për kryerjen e veprave penale, në të cilin numër bën pjesë edhe organizuesi i shoqatës.*[569] Shoqërimi apo bashkimi kriminal është një formë veçanërisht e rrezikshme e veprimtarisë përgatitore për kryerjen e veprave penale dhe përmes këtij neni numri i pjesëmarësve duhet të jetë tre persona që të llogaritet organizatë ose shoqërim krimnel. Thelbi i

---

[566] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.58

[567] Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018, fq.222

[568] Kambovski, Vlado. "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Shkup, 2010, fq.412

[569] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 122, paragrafi 28

saj konsiston në mobilizimin, organizimin e më shumë njerëzve për veprim të përbashkët sidomos në bazë të një plani të përgatitur paraprakisht nga ana e organizatës dhe me detyra dhe obligime të ndara të anëtarëve. Kjo veprimtari kriminale ka karakterin e një vepre të pavarur dhe e veçantë (delictum sui generis). Pra vepra penale llogaritet vet organizimi i shoqatave të tilla kriminale pa marë parasysh se a është kryer ndonjë vepër penale nga plani i paraparë paraprakisht. Për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të vetë shoqërimit ose bashkimit kriminal, kjo vepër është e pavarur në krahasim me kryerjen e veprave të parapara në planin e shoqatës kriminale. Organizatori dhe anëtarë janë përgjegjës për këtë vepër si dhe atëherë kur vjen në realizimin e ndonjë vepre konkrete që është e paraparë në planin e shoqatës. Pra, nga kjo nënkuptojmë se edhe para kryerjes së ndonjë aktiviteti kriminal nga ana e organizatës dhe anëtarëve të saj kemi një vepër penale e cila nënkupton se vepra penale para kryerjes së veprës kriminale është vet marëveshja, organizimi apo anëtarësimi në organizatë me qëllim dhe paramendim që në të ardhmen të kryhet ndonjë vepër penale. Kjo më së miri ilustrohet në nenin 393, paragrafi 1 ku detajisht e parasheh marëveshjen për kryerjen e veprës penale si vepër penale. Neni 393 paragrafi 1 thot: "*Ai që do merret vesh me tjetër që të kryej vepër penale për të cilën mund të shqiptohet denim me burg prej tre vjet ose denim më i rëndë, do të dënohet me denim me para ose me burg deri në një vit*."[570] Pra, në këtë paragraph si pike këye e vlerësimit të kësaj vepre penale është marrëveshja për kryerjen e krimit për veprat që parashihet dënimi me burgim prej tre vjet ose më të rëndë. Kurse paragrafi 2 i nenit të njejtë parasheh pajtueshmërin e personit në jryerjen e krimit si pike kyçe dhe ate: "*Me dënimin nga pragrafi 1 do të dënohet edhe ai që do të pajtohet me kryerjen e veprës penale për të cilën është përcaktuar dënim me burg prej katër viteve ose më të rëndë*[571]" Përkundrazi nëse nuk ka marëveshje mes dy personave ose më shumë personave atëherë nuk do të kemi vlefshmërinë e këtij neni. Por nëse vin në kryerjen e veprës penale e cila më herët ka pasur marëveshje për atë vepër ata nuk do të dënohen për veprën e mareveshjes për kryerjen e veprës penale sepse në mes të marëveshjes paraprake dhe veprës së kryer penale ekziston dhe vlen parimi i përshkallshmërisë ose i subsidiaritetit. Organizatori dhe anëtarët e shoqatës janë përgjegjës për këtë punë edhe kur një nga punimet e planifikuara vjen në realizim. Zgjedhje të tillë ka njohur edhe legjislacioni jonë i mëparshëm (KPM-pjesa e përgjithshme e vitit 1992, n26: ai i cili për shkak të kryerjes së veprave penale krijon ose shfrytëzon organizatën, bandën apo grupin, do të dënohet për të gjitha veprat që kanë dalë prej planit kriminal të atyre organizatave sikur t'i ketë kryer ai vetë).[572] Më vonë ky inkriminim pëson ndryshim ku organizatori anulohet si shtytës i veprës penale e cila nuk nënkupton se plotësisht largohet përgjegjësia e tij si pjesëmarrës në veprën penale. Por në Kodin Penal të Maqedonisë janë të paraparë disa nene të cilët e inkriminojnë dhe i sanksionojnë grupet dhe anëtarët e grupit që kryejnë vepra penale të cilët janë të organizuara nga ana e shoqatave kriminale dhe ate: shoqërim kriminal (neni 394), organizatë terroriste (neni 394-a), organizim të grupit për kryerje të veprës tregti me njerëz, me person të mitur dhe kontrabandë me emigrantë (neni 418-v). Për kryerjen e këtij lloji të kriminalitetit numër të caktuar të njerëzve organizohen në shoqata, grupe ose banda kriminale të cilët veprojnë për kohë të papërcaktuar breda të cilës ekziston hierarki dhe dicipilnë të rreptë dhe përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të detyrave I realizojnë veprimtaritë e tyre kriminale. Neni 394 i Kodi Penal parash shoqërimin kriminal të personave të cilët bashkohen në një grup, bandë ose shoqatë me qëllim të kryerjes të një ose disa veprave penale me qëllim të nga ajo vepër të përfitohet diçka në dobi të tyre sidomos në krijimin e grupit kriminal. *Ai që do të krijojë grup ose bandë që ka për qëllim kryerjen e vepërs penale për*

[570] Po aty, neni 393, paragrafi 1

[571] Po aty, neni 393. paragrafi 2

[572] Kambovski, Vlado. "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Shkup, 2010, fq.413

të cilat mund të shqiptohet dënim me burg prej tre vjetëve ose dënim më i rëndë, do të dënohet me burg prej një deri në pesë vjet.[573] Për shkak se veprimtaria e krimit të organizuar është e gjërë si një ndër veprimtarit më të rrezikshme llogaritet edhe organizatat terroriste dhe akti i terrorizmit të cilin e parasheh edhe legjislacioni ynë. *Ai që krijon grup, bandë ose organizatë tjetër kriminale për kryerjen e vepërs penale: vrasje, lëndim trupor, grabitje të personave, shkatërim të objekteve publike, sistemeve transportuese, objekteve infrastrukturore, sistemeve informative ose objekteve tjera në përdorim të përgjithshëm, grabitje të aeroplanëve ose mjeteve tjera për transport publik, prodhim, posedim ose tregti me armë bërthamore, biologjike, armë kimike dhe armë të llojeve të tjera dhe materie të rrezikshme, lëshim të substancave të rrezikshme, helmuese dhe substancave tjera të rrezikshme ose shkaktimi i zjarrit ose ekspozionit, shkatërimi i stabilimenteve për furnizim me ujë, energji ose burime tjera themelore natyrore, me qëllim për krijimin e ndjenjës së pasigurisë ose frikës tek qytetarët ose për rrezikimin e rendit kushtetutes në vend ose interesat e organizatës ndërkombëtare ose të shtetit të huaj, do të dënohet me burg së paku tetë vite.*[574] Por si vepra të cilat viteve të fundit ka marrë një hovë të madh ka një rritje drastike në të gjitha vendet janë veprat e kontrabandës me emigrant dhe trafikimi me qenie njerëzore të cilët organizatat e ndryshme të krimit të organizuar ndërkombëtar japin një rrëndësi të veçantë duke u bazuar në fitimet e mëdha kurse rrezikshmëria e zbulimit të tyre është e vogël ose më mir me thënë veprimtari me rrezik të vogël për grupet kriminale. Në nivel botëror për ekzistimin dhe vërtetimin e krimit të organizuar duhet që vepra e kryer të jetë e rëndë dhe serioze, të kemi pjesëmarrje të tre ose të më shumë personave në kryerjen e veprës penale në bazë të funksionimit të bashkëpunimit, ndarjes së detyrave dhe hierarkia e organizatës, organizata të funksionoj një periudhë kohore të nivelit të gjatë, dhe qëllimi i të cilëve në fakt është përfitimi nga vepra penale.

Pra, krimi i organizuar është një formë krimi me rrezikshmëri e nivelit shumë të lartë e cila në vete sot ngërthen një numër të madh grupesh të etnikumeve dhe profileve të ndryshme dhe e lidhur ndërkombëtarisht nga vende të ndryshme të botës, të cilat mund të punojnë së bashku ose veç e veç i realizojnë atkivitetet e tyre kriminale, të cilat përveç aktiviteteve ilegale ata mund të lidhen me një punë legale, nganjëherë edhe bashkohen në një organizatë politike sidomos me shtetas dhe grupe të vendeve fqinje përshkak se bashkëpunimi dhe koordinimi i punlve në mes të tyre është shumë më e lehtë për realizim. Ata sigurisht marrin parasysh krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për bizneset e tyre dhe realizimin e interesave të tyre të ngushta, edhe pse nuk përjashtohet veprimi humanitar (sponsorizimi, dhënia për qëllime humanitare etj.).[575] Me rritjen e numrit të personave të cilët emigrojnë nga vendet e ndryshme botërore sidomos nga vendet me ekonomi të ulët, me sundim të varfërisë si dhe ppër shkak t zhvillimeve të luftërave vendosen në vende më të sigurta dhe në shtete me ekonomi të zhvilluar sidomos në vendet e Bashkimit Evropian. Emigrantë të etniciteteve të ndryshme të cilët të cilët periudha e adaptimit dhe gjetjes së punëve dhe rregullimit të dokumenteve në vendet e destinacionit hoqërohen dhe nga njëherë formojnë edhe grupe kriminale të cilët shfrytëzojnë situatat e ndryshme të shteteve për kryerjen e krimeve të ndryshme. Migrantët ilegal të cilët arrijnë të hyjnë në shtetet e Bashkimit Evropian këtë e realizojnë me ndihmën e grupeve të ndryshme ndërkombëtare të krimit të organizuar të cilët më tutje i shfrytëzojnë ato në kyçjen e tyre në grupet e tilla. Neni 418-v parasheh organizimin e grupit dhe nxitjen për kryerjen e veprave tregti me njerëz dhe kontrabanda me migrantë ku në paragrafin

[573] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 394

[574] Po aty, neni 394-a

[575] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.118

(1) të saj thuhet: "*Ai që organizon grup, bandë ose shoqatë tjetër për kryerjen e veprave penale nga nenet 418-a, 418-b, 418-g dhe 418-d, do të dënohet me burg së paku tetë vite*."[576] Kurse paragrafi 2 e këtij neni parashah për anëtarët të cilët bëhen pjesë e grupit, bandës apo shoqatës kriminale dhe ate: "*Ai i cili do të bëhet pjesë i grupit, bandës ose shoqatës tjetër nga paragrafi 1 ose në mënyrë tjetër e ndihmon grupin, bandën ose shoqatën do të dënohet me burg së paku një vit.*[577] I pandehuri B.B. ka kryer vepër penale Organizimi i grupit dhe nxitja për kryerjen e veprave të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandë të migrantëve sipas nenit 418-v pa. 2 nga KP[578] është një rast nga shumë rastet e evidentuara në sistemin gjyqësor të vendit që ka të bëjë me nenin 418-v, paragrafi 1.

Në kryerjen e veprimtarive kriminale të grupeve të krimit të organizuar sidomos në krimet ndërkombëtare të cilët pothuajse të gjithë realizohen përmes bashkëpjesëmarrjes së personave në kryerjen e veprës dy ose më shumë persona bashkërisht e kryejnë veprën penale të paraparë më parë. Bëhet fjalë për një lloj të bashkëpjesëmarrjes së domosdoshme, i paraparë si formë e rëndë e këtyre veprave: vjedhje e rëndë (e kryer prej më shumë njerëzve që janë shoqëruar për të kryer vjedhje n.236), grabitje dhe vjedhje hajdutësh (të kryera në përbërje të grupit, ose bandës n.237,238), kërcënim me dhunë dhe nënçmim (e kryer në përbërje të grupit, bandës ose organizatës 258,259), larje parash dhe dobi tjetër pasurore (si pjesëtar i grupit, bandë ose organizatë n.237), mundësimi i ikjes së personit i cili është i burgosur (në grup n.372) dhe dhunë (në grup n.386).[579] Nëse dy ose më shumë persona, me pjesëmarrje në veprimin e kryerjes ose me ndonjë kontribut tjetër ndaj kryerjes së veprës, së bashku kryejnë ndonjë vepër penale, çdokush prej tyre do të dënohet me denim të përcaktuar nga ajo vepër.[580] Kemi raste edhe kur personi ka dijeni për ekzistimin e përgaditjes së veprës penale q cila ende është në tentim ose në kryerje por nuk e paraqet atë, pra pjesëmarrës pasiv atëherë edhe kjo kategori e personave sanksionohen për mos paraqitjen e veprës. Ai që e di që është duke u përgaditur kryerja e veprës penale për të cilën sipas ligjit mundet të shqiptohet denim me burg prej pesë vjetëve ose denim më të rëndë, që në kohën kur ka qenë e mundshme të ndalohet kryerja e tij nuk e ka paraqitur atë, ndërsa vepra penale ka qenë në tentim ose e kryer, do të dënohet me denim në para ose me burgim deri në një vit.[581] Nëse nuk është paraqitur përgaditja e veprës penale për të cilën sipas ligjit mundet të shqiptohet denimi i burgimit të përjetshëm, kryerësi do të dënohet me dënimin e burgimit prej një deri më pesë vjet.[582] Mund të thuhet se vendi ynë e ka të rregulluar krimin e organizuar si vepër penale dhe format e shfaqjes së saj në nivel solid për të luftuar dhe parandaluar këtë lloj të aktivitetit kriminal.

2.3. Kuptimi dhe përkufizimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas akteve ndërkombëtare

[576] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418-v, paragrafi 1

[577] Po aty, neni 418-v, paragrafi 2

[578] Aktgjykim nr.193 të datës 16.11.2010 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.3

[579] Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018, fq.226

[580] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 22

[581] Po aty, neni 363, paragrafi 1

[582] Po aty, neni 363, paragrafi 2

Deri vonë në shumë shtete botërore, rregullimi juridiko-penal ndërkombëtar i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore u vonua dhe ishte me mangësi të shumta, për shkak të rregullimit të ndryshëm të kësaj çështjeje në shtete konkrete ku në disa vende ka pasur edhe vakume të shumta ligjore dhe e cila ishte e pamjaftueshme për sanksionimin dhe luftimin e saj dhe kjo situatë vazhdoi deri në fillim të shekullit XX. Ndërkombëtarizmi i kësaj dukurie negative ndikoj që në masë të madhe shtetet të interesohen për një rregullim të mirëfillt dhe të kompletuar në aspektin ndërkombëtar prej nga edhe shtetet në ligjet e tyre nacionale do të inkorporojnë edhe drejtat dhe detyrat që do të burojnë nga ky rregullim.

Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar", Palermo/Itali , e vitit 2000 është dokumenti më i rëndësishëm në aspektin ndërkombëtar e cila e bëri hapin e parë dhe shumë të rëndësishëm e cila shtjellon krimin e organizuar e cila ka rëndësi të veçantë edhe për trafikimin me qenie njerëzore sespe në të shumtën e rasteve realizimi i saj bëhet nga gruper e krimit të organizuar dhe ka për qëllim luftimin dhe parandalimin e saj. Rëndësia e posaçme që i jepet grave dhe fëmijëve bëhet përshkak se kjo kategori është më e nënshtruar dhe e cenueshme ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Sipas organizatës së mirënjohur për mbrojtjen e fëmijëve në botë-UNICEF, gjatë një viti, me qëllim të shfrytëzimit, në botë trafikohen rreth 1.200.000 fëmijë.[583] Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar.[584] Këtë konventë nga dita e miratimit të saj e deri sot kanë nënshkruar dhe miratuar shume shtete në legjislacionet e tyre penale sidomos detyrat dhe obligimet që lindin nga ajo. Kjo më së miri është cekur në Paragrafin (a) dhe (c) të Nenit 2 të Konventës për krimin e organizuar ndërkombëtar e cila parashe që një vepër të ketë karakterin e organizuar të saj duhet së paku duhet të jetë i përbërë nga tre anëtar të saj dhe të kryej një vepër serioze dhe e rëndë me qëllim të përfitimit. Konventa e Palermos për krimin e organizuar parasheh përgjegjësin e personave juridik që janë të involvuar në ndënjë rast kriminal. Paragrafi (1), neni 10 i Konventës parasheh: "Secili Shtet Palë duhet të adaptojë masat e nevojshme, që janë në pajtim me parimet e tij ligjore, për të përcaktuar përgjegjësinë e personave juridikë që marrin pjesë në krime serioze që përfshijnë një grup të organizuar kriminal dhe për veprat penale të cilësuara si të tilla."[585] Republika e Maqedonisë në muajin tetor 2004 e ka ratifikuar Konventën e OKB-së kundër kriminalitetit transnacional dhe protokolet 1 dhe 2 të cilat i kushtohen prevencionit, çrrënjosjes dhe dënimit të tregtisë me njerëy, veçanërisht me gra dhe fëmijë kundër kontrabandës të emigrantëve të cilët, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë edhe ky dokument ndërkombëtar është pjesë përbërëse e rendit juridik në planin e luftës kundër tregtisë me njerëz.[586]

Kuptimi dhe përkufizimi mi i kthjellët dhe i pranuar ndërkombëtarisht është përkufizimi i dhënë në Protokollin mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Sipas paragrafit (a), neni 3 i Protokolit: „"Trafik personash" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e

[583] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.103

[584] Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000, neni 1

[585] Po aty, neni 10, paragrafi (1)

[586] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.182

tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitutet."[587] Nga ky nen mund të konkludojme së elementet që e përbjnë trafikimin me qenie njerëzore janë: akti i kryer, mjetet e kryerjes dhe qëllimi i trafikimit apo eksploatimit. Eksploatimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punës ose shërbimeve të dhunshme, përfshinë lëmoshën, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, pozitën e skllavërisë, shfrytëzimin e veprimtari kriminale ose heqjen e organeve.[588] Pëlqimi i viktimës së trafikut për shfrytëzimin e qëllimshëm të përmendur në nënparagrafin (a) të këtij neni do të jetë i pavend nëse janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a).[589] Kurse paragrafi (c), i nenit 3 të Protokolit sidomos "(c) Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet "trafik personash" edhe nëse në të nuk do të përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të këtij neni."[590] Ky Protokol dallohet nga aktet tjera ndërkombëtare duke pas parasysh se më shumë jep rëndësi viktimave të grave dhe fëmijëve, ku sipas saj ""Fëmijë" nënkupton çdo person nën 18 vjeç."[591]

Duke u bazuar në ate se sulmi i trafikantëve shpesh janë edhe migrantët të cilët i lëshojnë vendet e tyre për punë dhe jetë më të mire, ata keqpërdoren në vendet e destinacionit në lidhje me punësimet por ata i detyrojnë në punë të detyrueshme dhe jo të favorshme të cilët diskriminohen edhe në respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Termi - punë e detyruar - d.m.th. puna apo shërbimi i cili bëhet nga çdo person në formë të një dënimi apo për të cilin personi në fjalë nuk e ka ofruar veten vullnetarisht.[592] Këtë më së miri e ilustron edhe Konventa "Për punëtorët migrantë (dispozita plotësuese), e vitit 1975" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Gjenevë, e cila i obilgon edhe shtetet nënshkruese të marrin një sërë veprimtarish për ti mbrojtur migrantët punëtor, të parandalojnë dhe të luftojnë veprimtaritë e paligjshme ndaj migrantëve shtetet konkrete. Neni 3 paragrafi (a), i Konventës i obligon shtetet me qëllim të: "frenuar lëvizjet klandestine të migrantëve për motive punësimi dhe punësimin e paligjshëm të migrantëve"[593] të cilët janë edhe viktima potencial të trafikimit me arritjen në shtetet e destinacionit po nga kontrabanduesit të cilët shëndrohen në trafikant. Kurse luftimin dhe parandalimin saj parashah paragrafi (b) i të njëjtit nen ku thot: "t'i kundërvënë organizatorëve të lëvizjeve të paligjshme dhe klandestine të migrantëve për motive punësimi që nisen, kalojnë përmes apo arrijnë në territorin e tij, si dhe për t'iu kundërvënë atyre që punësojnë punëtorë që kanë emigruar në kushte të paligjshme me synim parandalimin dhe eliminimin e abuzimeve të përmendura".[594] Neni 14 i KEDNJ-së parashikon që gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura nga Konventa duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në gjini, racë, ngjyrën e lëkurës, gjuhën, fenë, politik ose ndonjë mendim tjetër, origjinë kombëtare ose shoqërore, përkatësi të një pakice kombëtare, pozitë

[587] Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi (a)

[588] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.16

[589] Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi (b)

[590] Po aty, paragrafi (c)

[591] Po aty, paragrafi (d)

[592] Konventa nr.29 në lidhje me abuzimin fizik (ILO),Aprovuar më 28 qershor nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e saj të 14, hyrja në fuqi - 1 Maj 1932, neni 2, paragrafi 1

[593] Konventa nr.143 "Për punëtorët migrantë (dispozita plotësuese), 1975" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Gjenevë, 1975, neni 3, paragrafi (a)

[594] Po aty, paragrafi (b)

materiale, origjinë pas lindjes ose ndonjë status tjetër.[595] Nga kjo del se si karakteristikë ose kushte pët të llogarit një veprimtari si trafikim me qenie njerëzore duhet: personave të cilët dëshirojnë të emigrojnë nga vendet e tyre u ofrohen oferta të rrejshme për punë të sigurtë në vendet e destinacionit, mashtrimi, detyrimi dhe shfrytëzimi i personit duke vendosur në pozitë të nënshtrimit të tij duke mos pasur alternativë tjetër, shfrytëzimi i personit i cili më është nën kontrolin e trafikantëve për qëllime të ndryshme.

Protokoli shtesë i Konventës së Kombeve të Bashkuara për krimin e organizuar ndërkombëtar pra, Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare, ka paraparë rregullim juridik ndërkombëtar duke e përkufizuar kontrabandën me migrantë si dhe ka paraparë masat të duhet të mirren dhe rregullimet juridiko penale nga ana e shteteve nënshkruese të saj. Qëllimi i këtij Protokolli është të parandalojë dhe luftojë trafikun e migrantëve, si edhe të nxisë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Palë për këtë qëllim, duke mbrojtur, në të njëjtën kohë të drejtat e migrantëve.[596] Kuptimi dhe përkufizimi ndërkombëtar i kontrabandës me migrantë parashihet në mënyrë decide në nenin 3 të Protokolit e cila është e pranuar ndërkombëtarisht. "Trafik i migrantëve" do të thotë prokurimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kalimi i paligjshëm në një shtet palë të një personi, në të cilin ai/ajo nuk është shtetas ose rezident i përhershëm.[597] Nga ky nen i Protokolit për kontrabandë migrantësh vërtetohet se elementet e kësaj vepre penale janë: sigurimi i hyrjes ilegale të personit, hyrjen ilegale në një shtet tjetër dhe përfitimi finansiar ose material. "Kalim i paligjshëm" do të thotë kalim i kufirit pa i'u përmbajtur kërkesave të domosdoshme për kalimin e ligjshëm në shtetin pritës.[598] Përveç rrugëve ilegale të cilët shpesh i përdorin rrugët detare apo malore ka raste edhe kur ato kalojnë përmes pikave kufitare por me dokumentet udhëtimi të cilët janë të falsifikuara. "Dokument i falsifikuar udhëtimi ose identifikimi" do të thotë çdo dokument udhëtimi ose identifikimi, i cili: (i) është bërë ose ndryshuar në mënyrë të falsfikuar në rrugë noteriale nga çdokush, me përjashtim të një personi ose agjencie të autorizuar me ligj për të bërë ose lëshuar dokumente udhëtimi ose identifikimi në emër të një Shteti; ose (ii) është lëshuar ose marrë në mënyrë të parregullt, nëpërmjet paraqitjes së të dhënave të falsifikuara, korrupsionit, kërcënimit ose të ndonjë mënyrë tjetër të paligjshme; ose (iii) përdoret nga një person tjetër dhe jo nga mbajtësi i ligjshëm.[599]

Si akt tjetër ndërkombëtar që ka rëndësi të veçantë për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore si pjesë e krimit të organizuar është Konventa e Këshillit të Evropës për Trafikimin e Qenieve Njerëzore e cila ndiqet nga shtetet anëtare të saj dhe shtetet tjera që kanë aspirta të anëtarësohen në familjen e Bashkimin Evropian, që ka dhënë një kontribut të veçantë ndërkombëtar kundër kësaj dukurie. Direktiva e re e Bashkimit Evropian zbatohet për tregtinë brenda industrisë së shërbimeve seksuale ose shfrytëzimit të punës, për shembull, në ndërtim, bujqësi apo familje.[600] Konventa e Këshillit të Evropës për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008, ka për qëllim të: parandalojë trafikimin e qenieve njerëzore, mbrojë viktimat e trafikimit, ndjekë penalisht trafikantët, dhe të nxisë

[595] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.14

[596] Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Palermo/Itali, 2000, neni 2

[597] Po aty, neni 3, paragrafi (a)

[598] Po aty, neni 3, paragrafi (b)

[599] Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi (c)

[600] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.16

bashkërendimin e masave ne nivel kombëtar si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.[601] "Konventa e përkufizon trafikimin e qenieve njerëzore si kombinim të tre elementëve: si veprim: rekrutim, transportim, transferim, strehim ose marrje të personave; si përdorimi të mjeteve të caktuara: kërcënimin ose përdorimin e forcës, ose forma të tjera detyrimi, rrëmbim, mashtrim, gënjim, abuzim kompetencash ose të një pozicioni vulnerabiliteti, dhënie ose marrje të pagesave ose të përfitimeve për të marrë pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër; për qëllimin e shfrytëzimit: minimalisht, shfrytëzimin e prostituimit të të tjerëve, ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë ose shërbime të detyruara, skllavëri ose praktika të ngjashme me skllavërinë, ose heqjen e organeve."[602]

Në lidhje me përkufizimin e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore rëndësi ka edhe Konventa e Varshavës e cila përqëndrohet në mbrojtjen e viktimave të trafikimit e cila në vete ngërthen të gjitha format e trafikimit si dhe në aspektin territorial edhe kuadër të kufijve shtetëror nacional të shtetit si dhe aspektin ndërkombtar nëse ajo realizohet jashtë shtetit. Konventa e përkufizon trafikimin si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si shkelje të dinjitetit dhe integritetit të qenieve njerëzore.[603] Në raste kur vepra penale përfshin personat juridik, mund të kyçen masat dhe sanskionet efektive dhe penalisht të barabarta, duke e kyçur sanksione në të holla kundër personit juridik.[604] Vlera e shtuar e dokumentit të ri ligjor është, ***inter alia***, njohja e trafikimit si dhunim i të drejtave të njeriut, dhe vendosja e një kuadri ligjor për mbrojtjen dhe ndihmën e e viktimave dhe të dëshmitarëve; vendosja e një mekanizmi efektiv monitorimi dhe harmonizimi të legjislacionit Evropian në këtë fushë.[605]

2.4. Kuptimi dhe përkufizimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë

Përveç interesimit të organizatave ndërkombëtare përmes akteve ndërkombëtare, poashtu kemi interesim edhe nga shtetet nacionale përmes rregullimit juridiko-penal të kësaj dukurie të parandalohet dhe të luftohet ky lloj i kriminalitetit kurse kryerësit e kësaj vepre penale të dënohen para organeve të drejtësisë të shtetit në rastin konkret në Republikën e Maqedonisë. Ky lloj i veprës penale është e paraparë dhe e rregulluar në legjislacionin e Maqedonisë sidomos në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale të cilat parashohin elementet e veprës se a ka vepër penale, përgjegjësinë e kryerësit të saj, sanksionin penal për veprën konkrete si dhe procedura penale adekuate e cila duhet të zhvillohet që më në fund të kemi edhe realizimin e sanksionimit penal.

Edhe Maqedonija sikurse edhe shtetet tjera të rajonit që kanë qëllim kryesor anëtarësimin në familjen e Bashkimit Evropian e nënshkroi dhe e ratifikoi Konventën e më me vlerë Kombeve të Bashkuara të Palermos të Italisë kundër krimit të organizuar ndërkombëtar me dy Protokolet e saja shtesë dhe filloj të parasheh dhe të implementoj obligimet që dalin nga ky akt duke e harmonizuar

[601] Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197 (GRETA), fq.2
[602] Po aty, fq.4
[603] Po aty, fq.8
[604] Po aty
[605] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.119

obligimet dhe masat që duhet të mirren për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Një përforcim shtesë të konsolidimit dhe harmonizimit të legjislacionit nacional me atë të Bashkimit Evropian është edhe nënshkrimi i Marrëveshjes për stabilizim dhe asocijim me Bashkimin Evropian dhe anëtarët e saj me të cilën Maqedonia i pranoj masat që duhet të mirren si prevencion dhe luftim ndaj trafikimit me qenie njerëzore dhe aktivitetet tjera sidomos ato të krimit të organizuar. Deri në vitin 2002 në Kodin Penal të Maqedonisë nuk ishte e paraparë aspak vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore si vepër penale e veçantë derisa sa këtë vitë u realizuar ndryshimi dhe plotësimi i Kodit dhe plotësohet me inkorporimin e neni 418-a "Trafikimi I qenieve njerëzore" dhe ate më datën 25.01.2001. Ai i cili me dhunë, me kanosje serioze huton ose forma të tjera të detyrimit, të rrëmbimit, të mashtrimit, me keqpërdorimin e pozitës së vetë ose gjendjen e shtatzanisë, pafuqisë pse paaftësisë fizike ose mentale të tjetrit, ose me dhënien ose pranimin e parave ose dobisë tjetër për shkak të marrjes së pëlqimit të personit i cili ka kontroll të personit tjetër ose në mënyrë tjetër rekruton, transporton, bart, blen, het, strehon ose pranon persona për shkak të eksploatimit me anë të prostituimit ose formave të tjera të eksploatimit seksual, të pornografisë, punës së detyrueshme ose shërbimit, robërisë, martesave të detyrueshme, shtatzani të detyrueshëm, adoptimit të paligjshëm ose raportit të ngjajshëm me të, lypje dhe eksploatim për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj ose transplatimit të palejuar të pjesëve të trupit të njeriut[606] personi dë të llogaritet si kryerës i veprës kurse vepra do të llogaritet si krim në bazë të Kodit Penal. Përveç njerëzve të cilët mund të paraqiten si kryerës të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, poashtu si kryerës mund të paraqiten edhe personat juridik të cilën e parasheh Kodi i parë penal pas pavarësisë së Maqedonisë kemi në nëntor të vitit 1996 ku ngjajshëm me Trafikimin me qenie njerëzore ishte e paraparë vepra penale e "Ndërmjetësimit në prostitucion" (neni 191) dhe "Vendosjen e raportit robërues dhe transporti i personave në raport robërues" (neni 418). Pas, këtij viti kemi edhe ndryshime dhe plotësime të tjera të Kodit sidomos në vitin 2004 ku pëson ndryshime neni 418-a dhe inkorporohen edhe neni 418-b, që ka të bëjë me "Kontrabandën e migrantëve" dhe neni 418-v, gjegjësisht "Organizimi i grupit dhe nxitja për kryerjen e veprave trafikimi i qenieve njerëzore, trafikimi i personave të mitur dhe kontrabanda me migrantë". Kështuu parapanë edhe sanksione kundër personave juridik dhe konfiskimin e mjeteve me të cilën është kryer vepra penale dhe u rrit dënimi pra dënimi minimal. *Gjegjësisht, nga provat materiale dhe verbale të paraqitura deri më tani, ekziston dyshim i bazuar se mu të pandehurit janë autorët e veprave penale për të cilat akuzohen, duke marrë parasysh llojin, karakterin dhe natyrën e veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësia penale, lloji dhe lartësia e dënimit të paraparë për këtë lloj të veprave penale për të cilat akuzohen të pandehurit, si dhe duke u përballur me mundësinë e shqiptimit të një dënimi efektiv me burg, Këshilli konsideron se ekziston një rrezik real i arratisjes së të pandehurve nëse u lejohet të mbrojnë veten në liri, në mënyrë që të shmangin përgjegjësinë e mundshme penale"*[607] është një pjesë e shkëputur nga arsyetimi i vendimit gjyqësor me të cilën vazhdohet masa e paraburgimit ndaj akuzuarve për veprën penale organizimi i grupit dhe nxitja për kryerjen e veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrant. Pra, këtu shihet se në rast të ekzistimit të rrezikur të ikjes së pandehurve dhe sipas karakteristikave të tjera si shkalla e rrezikshmërisë, përgjegjësia penale dhe lartësia e dënimit caktohet masa e paraburgimit nga

[606] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418-a, paragrafi 1

[607] Aktgjykim nr.145 të datës 16.09.2010 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.3

gjykata kompetente. Parapuburgimi si masë mund të shqiptohet edhe kur gjykata vlerson se mbrojtja e tyre në liri mund të ndikoj në përsëritjen (recidivizmin) e veprave penale të njejta ose tjera dhe e cila lidhet me mënyrën rrethanat dhe natyrën e veprës penale të kryer. *"Gjatë analizës së bazës për vazhdimin e masës së paraburgimit, e cila i referohet rrezikut të sjelljes përsëri të kundërligjshme, duke marrë parasysh mënyrën, rrethanat dhe motivet për të cilat janë kryer veprat penale, si dhe ndërlidhjen dhe shkallën e lartë të koordinimit midis të pandehurve gjatë ndërmarrjes së veprimeve, që tregon ekzistimin e një grupi të mirë-organizuar dhe kompakt, të krijuar nga organizatorët dhe anëtarët për të kryer krimet për të cilat akuzohen të pandehurit, Këshilli konsideron se të gjitha këto rrethana tregojnë ekzistimin e rrezikut nëse të pandehurit lirohen të mbrohen në liri, ata mund të përsërisin veprat penale, dmth të ndërmarrin veprime të tjera inkriminuese."*[608] është një shembull i praktikës gjyqësore në kuadër të shumë rasteve të tjera. Në Maqedoni ekziston ligji për administrim me pronën e konfiskuar, dobinë pronësore dhe sendet e sekuestruata në procedurë penale dhe kundërvajtëse, nr.98 të vitit 2008, e cila kontribon në luftimin dhe parandalimin e trafikimit. Me këtë ligj, rregullohet menaxhimi, shfrytëzimi dhe disponimi me pronën e konfiskuar përkohësisht, me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara përkohësisht, si edhe me pronën e konfiskuar, me përfitimin pronësor dhe me sendet e konfiskuara me vendim të plotfuqishëm në procedurën penale dhe të kundërvajtjes[609]. Çështja e kundërvajtjes në Republikën e Maqedonisë parashihet me Ligjin për kundërvajtje nr.124 dhe ate me sa vijon: "Për një kundërvajtje të kryer në kushtet e këtij ligji, shqiptohen:
1) sanksionet kundërvajtëse për kryesit e moshës madhore;
2) sanksione kundërvajtëse për fëmijët;
3) sanksione për kundërvajtje për personat juridikë dhe
4) masa të veçanta për kundërvajtje."[610]
Gjatë vitit 2008 në muajin janar kemi edhe një hap tjetër të standardizimit dhe harmonizimit të legjislacionit penal me ate të Bashkimit Evropian dhe shumë akteve tjera ndërkombëtare, pra kemi edhe inkorporimin e një neni të ri dhe ate neni 418-g, "Trafikimi me fëmi", me të cilën të miturit veçohen nga të rriturit duke u bazuar në zhvillimin e tyre bio-psiqik dhe pjesa ku parashihen dënimet, ata janë më të larta për dallim nga të rriturit kur kjo kategori paraqiten si viktima të trafikimit të tyre. Ai i cili do të mashtrojë fëmijë për kryerjen e veprimeve seksuale ose do të mundësojë kryerjen e veprimeve seksuale me fëmijë apo rekruton, transporton, transferon, blen shet ose ofron për shitje, siguron, dorëzon, strehon ose pranon fëmijë për shkak eksploatimit nëpërmjet shfrytëzimit të tij në aktivtete seksuale për kompensim në para ose kompensim tjetër ose forma tjera të eksploatimit seskual, pornografisë, punës së detyruar ose shërbimit, robërisë, martesave të detyruara, fertilizimit të detyruar, adoptimit të paligjshëm ose zhvatjes së pëlqimit si ndërmjetës që të adoptohet fëmijë, transplatimit të paligjshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet[611] sipas dispozitave të Kodit penal të Maqedonisë. Përveç këtyre neneve të lartëpërmendura në lidhje me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore ku direkt parashihen vepra penale të kemi trafikim të kategorive të ndryshme të personave, Kodi penal në nenin 418-v, parasheh organizimin e grupit, anëtarësimin dhe ndihmën për kryerjen e veprave trafikimit me

[608] Aktgjykim nr.171 të datës 20.10.2010 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2
[609] Закон за управување со конфискуван имот, имотна корист и одземени предмети во кривична и прекршочна постапка. Службен весник на РМ, бр. 98, 2008, neni 1
[610] Закон за прекршоците, Службен весник на Република Македониј број. 124 од 23.07.2015 година, neni 4
[611] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418-g, paragrafi 1

qenie njerëzore dhe të kontrabandës me migrantë sipas neneve 418-a, 418-b, 418-g dhe 418-d, të Kodit.

3. Dallimi në mes të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe veprave tjera penale

Zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë në një anë dhe në anën tjetër arritja e globalizmit botëror në shkallën më të lartë të saj përveç anës pozitive ekziston edhe ana negative ose ana e errët e saj ku bëjnë pjesë krimet e ndryshme me metoda shumë më të sotisfikuara dhe në kuadër të këtyre krimeve pjesa e errët në vete ngërthen edhe trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabandën me migrantë. Trafikimi i qënieve njerëzore shpesh barazohet, si në publikun e gjerë, ashtu dhe në mesin e disa profesionistëve, me kontrabandën me njerëz dhe/ose me prostitucionin.[612] Dallimi i veprave penale ndërmjet veti është e rëndësisë së veçantë përshkak se me dallimin e tyre përcaktohet saktë figura e veprës penale dhe në bazë të së cilës pëson e sanksionimi i kryerësve të saj. Parimi themelor i së drejtës penale i cili konsiston në maksimën: ***nullum crimen, nullum poena sine lege***, mund të aplikohet në mënyrë adekuate vetëm me kualifikimin e drejtë të veprës penale[613] e cila arrihet vetëm duke i dalluar veprat penale në bazë të elementeve kyçe të saj. Pra, kjo nënkupton edhe rëndësinë e dallimit të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe veprave tjera penale e cila shpesh në praktikë por edhe në teori ngatërrohet me vepra tjera penale sidomos me veprën penale të kontrabandës me migrantë dhe veprës penale të ndërmjetësimit në prostitucion. Trafikimi me qenie njerëzore, kontrabanda me migrantë dhe migracioni si fenomene janë të ndërlidhura ngushtë në mes veti dhe si zakonisht në praktikë është shumë e komplikuar dhe e vështirë të bëhet dallimi mes tyre. Lidhshmëria mes këtyre fenomeneve të lartëpërmendura shihet tek një element e cila haset dhe është i përbashkët dhe ajo është "lëvizja e popullsisë". Edhe pse kanë disa elemente të përbashkëta, këto tre terme dallohen thelbësisht.[614]

3.1. Dallimi midis veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrantë

Para se të bëjmë dallimin në mes të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrantës, në rastin konkret përshkak të lidhshmërisë së ngushtë të kësaj vepre penale me migracionin do të ishte e domosdoshme të bëhet dallimi në mes të migracionit, trafikimit me qenie njerëzore dhe veprës penale të konrabandës me migrantë. Këto dukuri edhe pse janë të lidhura dhe të ngjajshme ato gjithashtu edhe mund të dallohen në mes veti si në teori po ashtu edhe në praktik. Migracioni është një fenomen shumë më i gjerë dhe më gjithpërfshirëse për dallim nga trafikimi me qenie njerëzore dhe mund të thuhet se trafikimi me qenie njerëzore është vetëm një pjesë e devijimeve në kuadër të migracionit. Migrimi është lëvizja e njerëzve qoft e përkohshme ose e përhershme nga një vendbanim drejtë një vendbanimi tjetër e cila mund të jetë të llojit nacional (brenda kufijve shtetëror) ose ndërkombëtar (jashtë kufijve shtetëror ose lëvizje prej një shteti drejt shtetit tjetër) ose në anën tjetër legal apo ilegal. Shkurtimisht thënë, fjala është për ndryshimin e përhershëm të vendbanimit të përhershëm të individit ose të grupit shoqëror.[615] Në anën tjetër trafikimi me qenie njerëzore si pjesë e migracionit në përgjithësi nënkupton lëvizjen ose bartjen e qenies njerëzore prej një vendbanimi në një vendbanim tjetër e cila mund të jetë njejt si migracioni

[612] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.11
[613] Zejneli, Ismail. "E drejta penale-pjesa e posaçme". Tetovë, 2007, fq.14
[614] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.11
[615] Po aty

në nivel nacional apo ndërkombëtar por këtu jo sipas vullnetit dhe dëshirës së personit por bartja bëhet përmes detyrimit, kërcënimit, shtrëngimit, mashtrimit, shfrytëzimit dhe formave tjera duke i shkelur liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të cilat janë të garantuara edhe me drejtën nacionale sidomos me drejtën ndërkombëtare. Nga kjo mund të përfundojmë se gjatë lëvizjes apo bartjes së njerëzve prej një vendi në një vend tjetër përdorimi i formave të ndryshme të shtrëngimit, kërcënimit dhe formave tjera është dallimi kryesor dhe primar në mes të migracionit dhe trafikimit me qenie njerëzore. Kërcënimi duhet të jetë serioz, real, i mundshëm, i menjëhershëm dhe i pandërueshëm.[616] Pra, migracionit si definicion realizohet sipas dëshirës dhe vullnetit të vet njeriut migrant, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore lëvizja ose bartja realizohet sipas formave të ndryshme të shtrëngimit. Lidhshmëria e ngusht e këtyre dy fenomeneve në praktikë e vështirësojnë shumë dallimin e tyre si dhe luftimin e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore. "Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e migrantëve ndajnë dinamikë të ngjashme. Faktori më i rëndësishëm që i ndan këto dy koncepte është vullneti."[617] Në praktikë ndodhë që të jepen konstatime të ndryshme lidhur me barazimin në mes veprimtarisë së trafikimit dhe kontrabandës me qenie njerëzore.[618] Në anën tjetër shum me rëndësi është dallimi në mes të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrantë të cilat si dy vepra penale janë shumë të afërta dhe dallimi i tyre është shumë i vogël në praktikë gjë e cila shumë herë edhe sistemin gjyqësor e vë në një turbulencë për përcaktimin e një vepre a është trafikim me qenie njerëzore ose kontrabandë me migrantë. Edhe pse, e njejta nuk është gjithmonë i lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, kontrabanda e migrantëve shpesh kryhet për realizimin e qëllimeve të trafikimit njerëzor.[619] Gjithashtu duhet të bëjmë dallimin në mes të migracionit (migracioni legal) dhe kontrabandës me migrantë (migracioni ilegal) si veprime të ndryshme në mes veti dallohen ku njëra ligjërisht është e lejuar kurse tjetra është e ndaluar dhe e sanksionuar me drejtën pozitive të çdo shteti dhe ate ndërkombëtare. Por, në anën tjetër nëse mirret parasysh motivi i migracionit legal dhe ilegal pothuajse nuk ka dallime mes veti dhe motivet e të dyve janë pothuajse të ngjajshme. Viteve të fundit kontrabanda e njerëzve gjegjësisht të migrantëve shënon rritje të përshpejtuar viteve të fundit e cila nënkupton sigurimin e kalimit joligjor në një shtet e cila nuk është shteti i tij apo shtetas i atij shteti me qëllim të përfitimit material nga ana e njerëzve apo migrantëve që janë objekt kontrabandimi. Migracioni ilegal shpesh emërtohet edhe si kontrabandë me migrantë e cila synon në lëvizjen e migrantëve prej një shteti në një shtet tjetër duke i shkelur rregullat ligjore të së paku njërit nga shtetet që janë pjesë përbërëse të migracionit, si të shtetit origjinë, shtetit tranzit ose shtetit të destinacionit. Anën tjetër trafikimi me qenie njerëzore gjithashtu objekt kryesor e ka qenien njerëzore por në këtë vepër penale trafikimi i njerëzve mund të bëhet edhe në kuadër të territorit të një shteti konkret pa mos dalë jashta saj e cila është e shoqëruar së paku një nga veprimet e cila parashihet me Kodin penal siç janë përdorimi i dhunës, shfrytëzimi, shtrëngimit, kanosja serioze , forma të detyrimeve të ndryshme, rrëmbimi, mashtrimi për realizimin e qëllimeve të trafikantëve. Gjatë veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore si viktima në shumicën e rasteve janë gratë dhe fëmitë dhe si zakonisht kur flitet për këtë vepër penale mendohet për trafikimin e grave. Kontrabanda e migrantëve është një fenomen ose veprimtari e paligjshme nga një person i cili ka qëllim hyrjen në mënyrë të paligjshme ose mbajtja e një personi në mënyrë të

[616] Petrović, Borislav. Jovasević, Dragan. Perhatović, Amila. "Krivično Pravo II ", Saučesnistvo, krivične sankcije i posebni dio. Sarajevo, 2016, fq.392

[617] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.350

[618] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.104

[619] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.2

kundërligjshme në vend ose largimi i paligjshëm nga vendi ku gjendet e cila realizohet përmes ndihmës së personave të tretë pra të kontrabanduesve, përmes një kundërshpërblimi financiar ose llojit tjetër të pagesës. Kurse tek vepra e trafikimit me qenie njerëzore mjafton që viktima të izolohet dhe të largohet nga familja dhe shoqëria ku jeton dhe të dërgohet në një vendbanim tjetër të panjohur e cila mund të jetë në kuadër të atij shteti apo rajoni dhe e cila ka për qëllim që për përfitime materiale të abuzoj dhe të shfrytëzoj nga shërbimet e viktimës. E gjith kjo sjell të ardhura të mëdha që shkojnë në duart e drejtuesve dhe pjesëmarrësve të krimit të organizuar.[620] Tek vepra penale e kontrabandës me migrantë pala ose migranti pajtohet me dëshirën e tij që të kaloj kufirin shtetëror në mënyrë ilegale. Në fakt këto migrantë mashtrohen dhe nuk janë në vetëdije se më veç janë të kontrabanduar dhe këta persona nëse nuk janë të shfytëzuara atëherë kemi veprën penale të kontrabandës me migrantë. Nëse kemi shtytje, ndërmjetësim ose marrje të një shpërblimi për shfrytëzimin e të miturit për veprimtarinë e prostitucionit, kemi të bëjmë me veprën penale të trafikimi të qenieve njerëzore. Gjatë emërtimit të kontrabandës me migrant më mirë do të ishte të emërtohet si kontrabanda me njerëz për shkak se gjatë kontrabandës viktima nuk janë vetëm migrantët, por shpesh shohim se edhe persona jo emigrantë, rrefugjatë, persona pa shtetësi janë objekt i këtij krimi ose si subjekt ose viktimë që kontrabandohet dhe të cilët në të shumtën e rasteve kërkojnë rrugadalje për një jetë më cilësore nga vendi i tij i përhershëm. Nëse veprimtaria e kontrabanduesve vazhdon edhe pas kalimit të kufirit përmes shtrnëgimit dhe shfrytëzimit të migrantit atëherë veç më është vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore dhe është pikë kalimi prej një vepre në një vepër tjetër penale. Shpeshherë, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore fillimisht bëhen viktima të kontrabandës me migrantë e më pas më lehtë kalojnë edhe në viktima të trafikimit me qenie njerëzore. Dalja në sipërfaqe në bashkësinë ndërkombëtare, është e rëndësishme që viktimat e trafikimit njerëzor të mos konsiderohen fajtorë dhe si rezultat i pranimit të shfrytëzojnë të drejtat e viktimës në procesin e hetimit[621] dhe në shumë literaturë migrantët nuk emërtohen si viktima përshkak të shprehjes së vullnetit për kontrabandë. Gjatë anlizës së veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore preferohet që në brendin e saj të kërkohet edhe vepra penale e kontrabandës me migrantë përshkak se dallimi është shumë i vogël mes këtyre veprave penale. Edhe pse kjo mund të jetë e vështirë për tu bërë në fazën fillestare, nga fakti se trafikimi shpesh përfshin një element të kontrabandës, veçanërisht të kalimit të paligjshëm të një kufiri shtetëror.[622] Arsye tjetër e rëndësishme për paqartësitë në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore është se në praktikë shpesh viktimat e trafikimit identifikohen si emigrantë të paligjshëm sepse dokumentet e tyre ligjore janë në duart e trafikantëve ose ato janë të asgjësuara, gjë e cila e rrumbullakson si një vepër penale të një niveli më të ulët nga trafikimi me qenie njerëzore. Sado që këto dy vepra të jenë kontradiktore në mes veti ky rrumbullaksim është shqetësues përshkak se është në rritje fshehja e veprës së trafikimit me qenie njerëzore në kuadër të veprës penale të kontrabandës me migrantë. Pra, sado që të jenë të ngjajshme dhe një vepër të mbulohet në kuadër të veprës penale tjetër, për të mirën e viktimave dhe për hirë të së funksionimit të së drejtës është më se e nevojshme të bëhet dallimi në mes këtyre dy veprave penale nga çdo subjekt shtetëror që e lufton këtë lloj të kriminalitetit. Konsiderohet se nëse kalimi i paautorizuar i kufirit përkon me natyrën e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, tërheqjen e kufirit midis kontrabandës së migrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore, është e rëndësishme që autoritetet kompetente të mund të marrin masat e nevojshme për të ndjekur një veprim më të rrezikshëm, në këtë rast trafikimi i qenieve

[620] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117
[621] Bolat, Gürbüz Akhan. Disertacion i doktoraturës " Berdel töresi ve insan ticareti". Ankara, 2013, fq.27
[622] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.104

njerëzore.[623] Pra, kur marëdhënia në mes të migrantit dhe kontrabanduesit përfundon me kalimin e paligjshëm të kufirit shtetëror kemi veprën penale të kontrabandës me migrantë, por nëse kjo marëdhënie vazhdon edhe pas saj duke e shtrënguar për qëllime të ndyshme siç janë prostitucioni, puna e detyruar, lëmosha, kryerja e veprave tjera penale etj atëherë kemi veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore. Pra, vazhdimsia e marëdhënies me migrantët ose viktimat shpesh realizohet përshkak se në praktikë janë grupet e njejta të organizuara kriminale të cilët si veprimtari e kanë edhe kontrabandën me migrantë por edhe trafikimin me qenie njerëzore ose vepra tjera kriminale dhe rrezikshmëria e viktimizimit nga vepra e trafikimit është shumë e lartë. Edhe pse ka ngjajshmëri të shumta mes tyre siç janë: të dy veprimet e lartëpërmendura janë vepra të kundërligjshme ku si viktimë është njeriu dhe cenimin e dinjitetit njerëzor të viktimave; shkaqet e viktimizimit të viktimave tek të dy veprat janë papunësia, ekonomija e dobët, pagat e ulëta , varfëria e nivelit të lartë, luftërat si dhe shkaqe tjera; në të dy veprat penale viktima transferohet nga një vend në tjetrin (nacional ose ndërkombëtar); në të shumtën e rasteve të këtyre veprave penale ekziston tipari ndërkufitar; gjatë kalimit kufitar dhe transportit përdoret korrupcioni i nëpunësve policor, transporti organizohet dhe mbiqyret nga organizatat kriminale, qëllimi i dy veprave penale është që nga viktimat e tyre të përfitojnë materialisht etj. Korrupsioni më së shpeshti paraqitet në formë të ryshfetit të personave në adminsitratën shtetërore, nepotizmit dhe mashtrim të mjeteve të informimit[624] e cila ndikon në realizimin e veprimit criminal. Në këtë kuptim, në shumicën e vendeve evropiane në legjislacionin ndëshkimorë hasim në në dy lloje të korupcionit të vërtetë: korupcionit aktiv dhe atijë pasiv, ndërsa nga aspekti kriminolokriminalistik shumica e autorëve sjelljen koruprive e ndanë në: atë të rrugës, të kontraktuar, korupcionin në shërbimet publike, korupcionin politik, gjygjsorë, ekonomik si dhe korupcionin e përgjithshëm me të cilën nënkuptohen të gjitha format tjera të sjelljeve koruptive në lamit e ndryshme të jetës shoqërore (shëndetsia, arsimi, ndërtimtaria, sporti, politika sociale etj).[625] Sidoqoftë, duhet të kihet parasysh se vet statusi dhe pozicioni i migrantëve të paligjshëm, si gjatë transferimeve ashtu edhe gjatë qëndrimit të tyre në destinacionin e dëshiruar, e bën këtë grup të prekshëm nga trafikimi me qenie njerëzore, që është pika tjetër në të cilën këto dy dukuri preken.[626] Parandalimi dhe lufta ndaj kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore do të ishte jo e plotë dhe joefektive nëse paraprakisht nuk bëhet dallimi i mirefillt mes tyre. Si pasojë, të dy çështjet nuk mund të analizohen të ndara njëra nga tjetra, por përkundrazi, duhet paralelisht të ndjeken dhe të vërtetohen masat për luftimin e të njejtëve.[627]

Nga e gjith kjo mund të përfundojmë se dallimet kyçe në mes veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrantë janë:

1. Kontrabanda e migrantëve është vepër penale kundër sistemit juridikshtetëror, rendit publik dhe rregullave për kalimin e kufirit shtetëror, kurse trafikimi me qenie njerëzore është vepër penale kundër personit, individit apo njeriut, gjegjësisht kundër lirive dhe të drejtave themelore të tyre.
2. Tek kontrabanda me migrantë ekziston parimi i dëshirës (pëlqimi) së migrantit i cili vullnetarisht e pranon që kalimi i kufirit të bëhet në mënyrë ilegale ose të parregullt, kurse

[623] Burić, Željka. Disertacion i doktoraturës "Pravni i institucionalni okvir za suzbivanje trgovanja ljudima u Republici Hrvatskoj". Zagreb, 2011, fq.53

[624] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.190

[625] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.211

[626] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.11

[627] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.2

tek trafikimi me qenie njerëzore parimi i dëshirës apo vullnetit të viktimës së trafikimit me qenie njerëzore pothuajse aspak nuk ekziston.

3. Tek kontrabanda me migrantë viktimat migrantë janë të vetëdishëm dhe kanë njohuri paraprake për kushtet dhe rreziqet e kalimit dhe nga ajo mund të tërhiqet në çdo kohë e cila varet direkt nga dëshira e tij, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore viktimat nuk janë të vetëdishëm dhe nuk kanë njohuri për kushtet dhe rreziqet që i presin ato.
4. Tek kontrabanda e migrantëve është patjetër të kalohet kufiri shtetëror të së paku dy shteteve (dalja nga shteti i nisjes dhe hyrje në kufirin e shtetit tjetër), kurse te trafikimi me qenie njerëzore përveç se mund të realizohet jashtë shtetit e njejta mund të bëhet edhe brenda kufijve nacional të një shteti konkret.
5. Viktimat e kontrabandimit me migrant nuk shfrytëzohen për qëllime tjera por vetëm kalimi ilegal dhe të parregullt të kufirit shtetëror, kurse viktimat e trafikimit me qenie njerëzore shfrytëzohen për qëllime të ndryshme si: prostitucioni, puna e detyruar, lypja e detyruar, kryerjen e krimeve etj.
6. Ndaj viktimave të kontrabandës me migrantë nuk zbatohet forca, detyrimi shtrëngimi apo dhuna, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore janë prezent këto metoda.
7. Tek kontrabanda me migrant personat e kontrabanduar shkelin rregullat e kalimit kufitar që sipas tendencave të së drejtës ndërkombëtare humanitare nuk duhen të dënohen sepse arsyet e migrimit të tyre janë kushtet e vështira ekonomike, sociale, politike dhe të sigurisë së tyre në vendet e origjinës, kurse viktimat e trafikimit me qenie njerëzore janë viktima të një kriminaliteti në plot kuptimin e saj.
8. Kuptimi i kontrabandës me migrantë është shumë më e ngushtë dhe mundë të llogaritet vetëm si një veprimtari ose etapë në procedurën e trafikimit me qenie njerëzore, ose mund të thuhet se kontrabanda me migrantë është vetëm një nga detyrat shumta të trafikimit me qenie njerëzore.
9. Kontrabanda me migrantë mund të transferohet në veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, kurse, trafikimi me qenie njerëzore nuk mundë të transferohet në veprën penale të kontrabandës me migrantë sepse veç më ajo është një pjesë përbërëse të saj.
10. Gjatë procedurës së kontrabandës me migrantë migrantët janë të lirë gjatë kontrabandës, kurse tek procedura e trafikimi me qenie njerëzore liria e personave të trafikuar veç më nuk ekziston që nënkupton se këta persona janë nën kontrollin e plotë të trafikantëve.
11. Tek kontrabanda me migrantë në të shumtën e rasteve kontaktin e parë me kontrabanduesin e siguron vet migranti që dëshiron kalimin në mënyrë të paligjshme kufirin shtetëror, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore si zakonisht janë trafikantët të cilët i gjejnë dhe i kontaktojnë viktimat e mundshëm sidomos nga kategoria e prekshme e shoqërisë.
12. Kontrabanda me migrantë sipas kohëzgjatjes është më e shkurtër dhe e përkohshme që nënkupton se pas kalimit të kufirit në mënyrë të kundërligjshme migranti është i lirë, kurse tek vepra e trafikimit me qenie njerëzore kohëzgjatja është shumë më e gjatë dhe ajo zgjatë derisa trafikuesit kanë interes në mbajtjen e viktimës për shfrytëzim, derisa mund të zbulohen nga organet përgjegjëse shtetërore ose derisa kut vet viktima mund të shpetojnë me ikje nga mbajtja në peng të trafikantëve.
13. Në aspektin e pagesës tek kontrabanda me migrantë njëherë paguhet kontrabanduesve dhe përfundon me kalimin ilegal të kufirit, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore e shfrytëzojnë dhe përfitojnë financiarisht në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshëm derisa janë nën kontrollin e tyre.

14. Për dallim nga kontrabanda me migrantë ku në mënyrë të kundërligjshme kalohen kufijt shtetëror të një shteti konkret tek trafikimi me qenie njerëzore, kufijtë shpesh kalohen sipas rregullave ligjore të shtetit konkret. Organizatat e ndryshme turistike ku kanë dorë dhe kontroll organizatat kriminale aplikojnë dhe pothuajse e gjith procedura e transferimit nga shteti origjinë dhe deri tek arritja në shtetin e destinacionit janë sipas procedurave ligjore sidomos me aplikimin dhe marrjen e vizave turistike ose leje të ngjajshme, aplikime dhe marrje e lejeve për punë, si dhe shume raste të tjera të ngjajshme përmes të cilave sigurohet qëndrimi i viktimave në një shtet të huaj nën kontrollin e anëtarëve të organizatës kriminale.
15. Tek kontrabanda e migrantëve liria e lëvizjes së migrantëve pas arritjes në vendin e destinacionit janë të lirë pa ndonjë kufizim, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore liria e lëvizjes së viktimave janë të kufizuara në një vend të caktuar të cilën e cakton organizata kriminale dhe si zakonisht është nën kontrollin e organizatës kriminale paraprakisht pasaportat dhe letërnjoftimet janë të marrura.
16. Transportimi i personave gjatë kontrabandës me migrantë realizohen në kushte shumë të vështira dhe jo të favorshme me automjete dhe mjete tjera transportuese ku shpesh pësojnë edhe në tragjedi ku me qindra por edhe me mijëra njerëz vdesin, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore transportimi është më se normale sepse ato veç janë të mashtruar dhe legalisht po kalojnë kufirin.
17. Kontrabanda me migrantë është një lloj krimi në të cilin burrat shihen më shpesh si viktima të mundshëm të cilët kërkojnë perspektivën e tyre në vendet ekonomikisht më të mira dhe më të sigurta për jetën e tyre, kurse trafikimi i qenieve njerëzore shpesh si viktima i zgjedh gratë dhe fëmijët përshkak se kjo kategori e viktimave janë të dobët, të pambrojtur dhe të prekshëm dhe mund të shfrytëzohen në më shumë sektorë.
18. Objekti i veprës penale te trafikimit quhet viktimë, ndërsa te kontrabandimi quhet emigrant, pra nuk quhet viktimë;[628]
19. Realizimi i veprës së kontrabandës me migrantë si domosdoshmëri është aktivizimi i disa personave ose të organizatës kriminale për kryerjen e saj, kurse tek vepra e trafikimit me qenie njerëzore mund të realizohet edhe nga një person.
20. Kontrabanda kërkon që kalimi i kufirit të jetë doemos i paligjshëm;-në trafikim kjo nuk është e domosdoshmëri.[629]
21. Në fund kontrabanda me migrantë mund të perceptohet si një dukuri apo problem i migracionit dhe migrantit, kurse trafikimi me qenie njerëzore perceptohet më gjerë dhe ate si dukuri krimi, migracioni, morali, i lirive dhe drejtave të njeriut, papunësisë, ekonomisë së dobët, forces punëtore etj.

3.2. Dallimi midis viktimave të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të prostitucion ose përfitimi nga shërbimi seksual të ofruar nga viktimat e trafikimit

Prostitucioni përherë që nga kohërat më të hershme të historis së njerëzimit e deri në ditët e sotshme ka ekzistuar në të gjitha vendet e botës dhe shpesh thuhet se është e vjetër sa vet historia e njerëzimit. Shpesh këto dy fenomene ngatërrohen në mes veti gjatë identifikimit të tyre,

[628] Podvorica, Armend. Disertacion i doktoraturës "Trafikimi i qenieve njerzor si formë e krimit të organozuar me theks të veçantë në kosovë për periudhën 2000-2013". Tiranë, 2015, fq.45
[629] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.36

megjithëse janë fenomene krejtësisht të ndryshme që mund të kenë të njëjtën formë, por në thelb janë vepra të ndryshme. Prostitucioni është vetëm një formë dhe qëllim i shfrytëzimit seksual të viktimave të trafikimit njerëzor, që nënkupton se si nocion prostitucioni është më e ngushtë në krahasim me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore. Sidoqoftë, shfrytëzimi seksual është vetëm një formë e trafikimit të qenieve njerëzore (nga puna e detyruar, lypja e detyruar, detyrimi për të kryer krime, adoptim të paligjshëm, martesa të detyruara, trafikim organesh, etj.).[630]

Prostitucion për përfitime materiale ose përfitime të llojeve tjera nënkupton ofrimin e shërbimeve seksuale individuale ndaj klientëve dhe të interesuarve në mënyrë vullnetare. Shpesh afër prostituteve gjenden edhe persona ndihmës të tyre të cilët me marëveshje me prostitutet ndihmojnë në biznesin e tyre dhe mund të quhen si ndërmjetësues në prostitucion. Dallimi mes këtyre dy veprave penale është me rëndësi të bëhet dallimi për hir të së drejtës dhe objektivitetit të ligjeve dhe shtetit ligjor. Si dallim fillestar konsiston në mes të këtyre du dukurive negative është në elementin e vetëdijes së prostitutes dhe viktimës së prostitucionit nga vepra e trafikimit me qenie njerëzore. Dallimet mes këtyre dy fenomeneve mund ti shtjellojm me sa vijon:

1. Prostitucioni si veprimtari anti-shoqërore kryhet me vullnetin dhe dëshirën e personave, derisa prostitucioni si qëllim i trafikimit është kundër vullnetit dhe dëshirës së tyre,
2. Personat që miren vullnetarisht me prostitucion pra me vet dëshirën e tyre e kanë më leht të tërhiqen nga ky fenomen devijant, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit tërheqja vullnetare e viktimave as që nuk miret parasysh derisa ata nuk zbulohen nga organet kompetente shtetërore,
3. Prostitucioni vullnetar nuk është kërcënim në përmasa të mëdha si trafikimi e cila është kërcënim ndaj shoqërisë më të gjërë dhe sigurisë së shtetit dhe e pranojnë se janë marë me prostitucion duke qenë nën kanosje shtrëngim dhe detyrim permanent nga trafikantët,
4. Tek prostitucioni ekziston liria e lëlivjes kurse tek prostitucioni i trafikimi nuk ekziston liria e lëvizjes së viktimave,
5. Tek prostitucioni vullnetar vet i zgjedhin klientët dhe çmimin kurse, tek prostitucioni i trafikimit klientët i zgjedhin ato por trafikantët dhe çmimi caktohet njejt nga ato,
6. Tek prostitucioni vullnetar prostitutet vet i marrin të mirat materiale kurse tek prostitucioni i trafikimit paratë shkojnë trafikantëve dhe grupit të organizuar kriminel,
7. Tek trafikimi ekzistojnë elementet e detyrimit, dhunës, kanosjes, frikës gjë që nuk është tek prostitucionit vullnetar.
8. Tek viktimat e trafikimi për prostitucion viktimat për të siguruar mjete për jetesë, detyrohen që të futen në rrjetet e krimit të organizuar transnacional dhe të merren me shërbime seksi për interesa të grupit të organizuar[631] gjë që nuk është me prostitucionin.
9. Prostitucioni vullnetar përher është individual dhe veprimtari personale, kurse trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit janë të organizuara dhe të kontrolluara si dhe veprimtarinë e tyre e zhvillojnë vetëm në mënyrë të organizuar nga grupet kriminale të krimit të organizuar e cila konsiderohet edhe si pjesë përbërëse e kriminalitetit të organizuar.
10. Tek prostitucioni vullnetar kryerës të veprës penale janë vet ata, kurse tek prostitucioni me qëllim të trafikimit personat në fjalë nuk janë kryerës të veprës penale por janë viktima të veprës.
11. Në lidhje me shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, tek prostitucioni kjo shkelje nuk ekziston kurse tek trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit ekziston dhe është e gjerë dhe e dëmshme për individin dhe shoqërinë.

[630] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.12
[631] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.106

Ekzistojnë shumë definicione në lidhje me këtë fenomen por në përgjithësi, prostitucioni konsiderohet si një formë e devijimit mendor-shoqëror, e cila nënkupton ekzistimin e marrëdhënies seksuale me një grua ose me mashkull pa një ndjenjë emocionale ndaj partnerit në kundërshpërblim në të holla ose ndonjë gjesend tjetër të vlefshme. Pra, si elemente kryesore të prostitucionit llogaritet: pagesa për ofrimin e shërbimit seksual në para ose ndonjë përfitim tjetër dhe numër të madh të shërbimeve seksuale me partner të panjohur. Pra, siç u theksua më lartë, se gjatë definimit të fenomenit të trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit shpesh hasim në vështirësi përshkak të lidhshmërisë së ngushtë mes tyre edhe pse janë dy fenomene të ndara dhe të ndryshme. Lidhshmëria e ngushtë e këtyre fenomeneve është qa e ngushtë sa që kur ceket për prostitucionit mendohet se automatikisht kemi edhe trafikimin e viktimës ose më mirë me thënë se prostitucioni e stimulon trafikimin me qenie njerëzore, përshkak se të dy vepra janë ofrues të marëdhënieve seksuale në të holla por mënyrat dhe shfrytëzimi janë të ndryshëm. Pra, këto dy dukuri apo vepra penale shpesherë në shiqim të parë duken se janë të njejta, ose kanë formë të njejtë të realizimit por thelbësisht janë dy dukuri të ndryshme dhe dallimi i tyre duhet të definohet saktësisht përshkak se prostitucioni llogaritet si një nga format e eksploatimit seksual të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore e cila shpesh realizohet përmes shfrytëzimit të shtypjes, kanosjes dhe mjeteve tjera të shtrëngimit. Pra, momenti kyç i dalllimit të prostitucionit nga vepra e trafikimit me qenie njerëzore është vet elementi i "dëshirës" ose i "vullnetit" së personit që e kryen prostitucionin, gjë që nënkupton se tek prostitucioni personi me vetë dëshirën dhe vullnetin e vet hyn në marëdhënie seksuale me qëllim të përfitimit material ose përfitim tjetër, kurse tek trafikimi me qenie njerëzore kjo situat nuk ekziston por përkundrazi shfrytëzimi seksual është kundër vullnetit dhe dëshirës së personit, përmes shtypjes, kanosjes ose forma tjera të detyrimit dhe shtrëngimit. Karakteristikat e prostitucionit janë: shoqërimi i çdo marrëdhënie seksuale me para ose ndonjë përfitim tjetër; marëdhënja seksuale me një numër të madh klient të ndryshme, dhe të panjohura; mosndjenja emocionale jo vetëm ndaj kënaqësisë seksuale, por edhe ndaj partnerit. **"Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar",** mendojmë se subjekti i kësaj vepre penale ose personi i tretë (klienti) i cili përfiton ose përdor shërbimet e ofruara nga personat e trafikuar, duhet të marrë patjetër statusin e Përfituesit (përfituesit e kundërligjshëm) dhe jo të trafikantit apo shfrytëzuesit, sepse duke marrë parasysh vetëm emërtimin e kësaj dispozite kuptojmë se ligjvënësi në këtë rast ka si qëllim të ndëshkojë penalisht personin që përfiton dhe jo atë që trafikon dhe shfrytëzon në kontekstin e veprës penale të trafikimit të personave.[632] Prandaj, duhet që këto dy vepra penale të ndahen më detajisht që në të ardhmen mos të kemi probleme gjatë identifikimit të viktimave dhe prostituteve gjë që mund të çoj deri te kualifikimi i gabuar i veprës penale dhe të mos arrihet qëllimi dhe parimi i ligjshmërisë. Edhe pse dallimi në mes këtyre dy veprave penale është shumë e rëndë dhe e komplikuar sidomos në praktik dhe mu për këtë shkak rëndësia e dallimit të këtyre dy veprave penale ka rëndësi të veçantë sidomos në shtetet ku prostitucioni është i legalizuar dhe nuk llogaritet si vepër penale, trafikantët mbulohen nën ombrellën e legalizimit të prostitucionit në ato vende duke i ikur përgjegjësisë penale ose keqpërdorimi i prostitucionit vullnetar individual nga vet personat prostitute nën ombrellën e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore duke aktruar se janë viktima e jo si kryerës. Në anën tjetër, shpesh premtimet "karriera artistike" vajzat ambicioze dhe të bukura përfundojnë në shtëpi publike, kurse valltaret dhe këngëtaret e mundshme përfundojnë si prostituta dhe "skllevër" të cilëve i mirret gjithçka filluar pasaportat e deri në lirin.[633] Nuk është e pazakontë që

[632] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.30

[633] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.123

një person që angazhohet vullnetarisht në prostitucion të bëhet viktimë e trafikimit, kjo ndodh kur puna seksuale sipas dëshirës bëhet me detyrim.[634] Format më të shpeshta të joshjes së femrave janë ofertat për punë legale në shtetet e jashtme, kindapimet, arazhmanet e ndryshme turistike, shitja nga familja etj.[635] Në rastin e trafikimit të personave, shfrytëzimi realizohet nëpërmjet dhunës psikike ose fizike apo veprimeve të tjera me natyrë shtrënguese, ndërsa në lidhje me përfitimin apo përdorimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar, ligjvënësi nënkupton një marrëveshje të heshtur midis personit që përfiton (klientit) dhe personit të trafikuar që ofron këto shërbime[636], pra marreveshjen e heshtur në mes të viktimës dhe klientit e siguron dhe e realizon deri në fund trafikanti. Pra, një femër vullnetarisht mund të angazhohet si punëtore seksuale që ofron shërbime në shpërblim me para, por nëse pas kësaj bëhet shënjestër e dikujt që përdor shtrëngim, detyrim shitje ose ndonjë formë tjetër që detyron viktimën kundër vullnetit personal të saj atëherë ajo më është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, pra këto quhet edhe si viktima vullnetar. Pra, mund të konkludojmë se prostitucioni vullnetar dhe punonjësit e saj janë kategori në shënjestër apo kategori e cenudeshme të cilët atakohen nga trafikantët për sigurimin e tyre si viktima të mundshëm të grupit kriminal. Viktima vullnetar ose viktima me vetëdëshirë, është një tip i veçantë i viktimave, të cilat kërkojnë ose pajtohen të bëhen viktima.[637] Trafikimi si vepër penale është realizuar nga dikush tjetër, ndërsa personi i tretë (klienti) përfiton nga kjo veprimtari e paligjshme[638], duke e shfrytëzuar momentin dhe situatën për përfitimin e shërbimeve seksuale të viktimës, kurse aspak nuk ka pikë të përbashkët dhe të kyçet në procedurën e trafikimit të viktimës, dhe në të shumtën e rasteve klienti paraprakisht as që i njeh trafikantët dhe viktimat.

KAPITULLI II

ETIOLOGJIA DHE FENOMENOLOGJIA E VEPRËS PENALE TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE

1. Etiologjia (Faktorët dhe Shkaqet) që ndikojnë të trafikimit me qenie njerëzore


Një person qoft të jet trafikant i cili do të realizoj trafikimin e një personi, qoft të jetë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore përher duhet të ekzistoj një faktor, shkak, arsye, një moment i cili do ta shtyj personin që të bëj hapin si trafikant ose si viktimë e trafikimit. Këto faktor ndikojnë që personi të realizoj veprimtarin e tij dhe mund të jetë nga faktori i brendshëm ose i jashtëm. Pra, fjala është për një degë shkencore e cila angazhohet për njohjen, përcaktimin dhe analizën e faktorëve, shkaqeve, burimeve dhe rrënjëve të dukurisë së kriminalitetit në vend.[639] Faktorët e brendshëm janë të lidhura me personalitetin e vet personit, shkaqe ose arsye personale që e shtyjnë personin të veproj, si zakonisht ata janë faktorët psikologjik të personave, si psh. karakteri, tepmeramenti, intelegjenca, shprehjet, prirjet, emocionet, motivet, çregullimet mentale etj.

[634] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.12
[635] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.106
[636] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.30
[637] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.55
[638] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.30
[639] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.235

Faktorët e jashtëm janë ata faktorë që janë jashtë personalitetit të njeriut dhe nuk varet direkt nga personi por nga rrjedhojat jashta tij, si zakonisht këta faktorë janë faktorët ekonomik, mikrogrupor, politik, social, luftërat, kushtet e rënda jetësore dhe në praktikë janë të shprehura më shuma se sa shkaqet apo arsyet e brendshme. Edhe pse legjislacioni penal nacional e konsoliduar sadopak me ate ndërkombëtar parashohin detajisht por prap si faktor gjeneral e cila ndikon në ekzistimin por edhe në përforcimin e ekzistimit të trafikimit me qenie njerëzore në një shtet po edhe në shtetin tonë është mosluftimi dhe parandalimi i duhur dhe efikas ose më mirë të thuhet mos perceptimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëze si e tillë ose të gabuar gjatë kualifikimit nga personat përgjegjës që e luftojnë ate si dhe qasja nga ana e organeve shtetërore për këtë fenomen negativ. Nga kjo del se edhe pse ekzistojnë *de jure* rregullim të mirëfillët dhe detajuar ligjor për këtë fenomen, aspekti *de facto* apo luftimi në praktik nga personat dhe organet kompetente është shumë e dobët për shkaqe të ndryshme (në shumë shtete si shkak i korrupcionit). Gjithashtu, nuk ekziston asnjë hulumtim serioz shkencor për fenomenologjinë dhe etiologjinë e krimit të organizuar te ne, e asnjë iniciativë e argumentuar për krijimin e strategjisë nacionale për preventivë dhe represion,[640] ndaj krimit të organizuar e në veçanti ndaj trafikimit me qenie njerëzore.

E gjith kjo çka u përmend për faktorët e brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore për realizimin e saj në një anë duhet të ekzistojn faktorë që do e shtyjnë në paraqitjen e trafikimit dhe në anën tjetër duhet të ekzistojnë edhe faktorët tërheqës dhe nxitës të trafikimit që kjo të realizohet deri në fund. Siç shihet faktorët shtytës dhe nxitës janë të lidhura njëra me tjetrën dhe sikur funksionojnë paralelisht për realizimin e veprës penale ta trafikimit me qenie njerëzore. Në përgjithësi si faktorë të kriminalitetit në vitin 1989 është sqaruar edhe nga ana e ***Sampsonit*** dhe ***Grovesit***.

Tabela nr.2
Faktori i krimit sipas *Sampson* dhe *Groves'it* (1989)[641]



Edhe nga tabela e lartëpërmendur, shihet rëndësia dhe rënditja e shkaqeve sidomos shkaqeve të jashtme siç janë: statusi i ulët socio-ekonomik, urbanizmi, problemet familjare, llojllosjhmëria

[640] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.9
[641] Dolu, Osman. "Suç Teorileri", Teori, Araştırma ve uygulamada Kriminoloji. Ankara, 2011, fq.217

etnike si dhe migracionit ndikojnë në paraqitjen e krimit. Kjo nënkupton se nga këto shkaqe sociale vin deri te rrëzimi i mekanizmave të kontrollit ndaj tyre e më pas deri në paraqitjen e kriminalitetit, në rastin konkret edhe të trafikimit me qenie njerëzore.

Rëndësia e parandalimit dhe luftimit të kësaj vepre jonjerëzore qëndron në zgjidhjen apo uljen e ndikimit qoft direkt apo indirekt të faktorëve shtytës dhe tërheqës të cilët reflektohen në paraqitjen e kësaj vepre penale në një shoqëri, pra duhet dë gjinden zgjidhje sa më efektive dhe të dobishme për shoqërin në përgjithësi. Shkaqet apo faktorët nuk duhet të kërkohen vetëm tek kryerësit e veprës penale përshkak se kemi vepra penale kur me të vërtetë fajin e ka kryerësi por ka raste kur shtytës dhe nxitës janë vet viktimat ku vet kërkojnë ndihmë dhe rrugëdalje duke pranuar edhe aktivitete të kundërligjshme si p.sh., tek kontrabanda me migrantë ose tek prostitucioni ku kemi ndërmjetësues ose mashtrimi dhe bindja e viktimave tjerë të vijojnë punën e atyre dhe tek këto vepra penale viktima është ai që i kontakton personat e tilla të ndihmojnë për realizimin e qëllimeve të veta pra kemi vetiniciativ të vet viktimave të veprave penale. Arsyet e paraqitjes së veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore janë të shumta por si më të shpeshta që paraqiten në çdo vend po edhe në vendin tonë janë si p.sh.: ekonomija e dobët, papunësia, arsimimi jo-adekuat dhe jo-kvalitet, urbanizimi, izolimi, luftërat, komunikimi publik, rrjetet sociale, kërkesa e tregut botëror, korrupcioni, kufizimi i lëvizjes së lirë,liberalizimi i vizave, migracioni, remitancat, dhuna në familje dhe shkaqe tjera. Sot, vepra e trafikimit me qënie njerëzore po rritet me shpejtësi të madhe për shkak të faktorëve si: dallimet e mëdha në mes të shteteve në aspektin ekonomik (shtete të varfëra dhe të pasura), dallimet në zhvillimin industrial ekonomik midis vendeve, papunësia dhe pabarazia gjinore midis burrave dhe grave dhe shumë shkaqe të tjera. Si element apo mjet e cila më shpesh ndihmon në realizimin e verës penale të trafikimit me qenie njerëzore llogaritet korrupcioni sidomos të zyrtarëve të institucioneve të cilët e kanë për detyrë të luftojnë kriminalitetin sidomos trafikimin si p.sh.: policia, policia kufitare, gjyktatat, prokuroria publike etj. Në përputhje me nenin 2 të Ligjit mbi pengimin e korrupsionit nënkuptohet shfrytëzimi i funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare dhe autorizimit me qëllim të shfrytëzimit të çfarëdo fitimi për vete apo për tjetrin[642] cila ka raste të shumta edhe në vendin tonë sidomos korrupsioni i zyrtarëve të lartë qeveritarë të cilët i pengojnë luftimin dhe parandalimin e trafikimit. Trafikimi i qënieve njerëzore si vepër penale është një dukuri shumëdimensionale globale duke qenë nën ndikimin e shumë faktorëve politikë, ekonomikë dhe shoqërorë. Përshkak se trafikimi me qenie njerëzore funksionon në bazë të parimit ofertë-kërkesë për atë arsye shkaqet apo faktorët kanë rëndësi të veçantë dhe mund ti grupojmë në dy grupe dhe ate: faktorët shtytës dhe faktorët tërheqës (nxitës).

1.1. Faktorët shtytës të trafikimit me qenie njerëzore

Vendet e origjinës së migrantëve, viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandës me migrantë, karakterizohen me prezencën faktorëve shtytës të cilët kanë ndikim direkt apo të tërthortë tek personi ose grup personash që të largohen nga ai vend dhe të migrojnë drejt vendeve me perspektiv më të mire se sa në vendlindjet e tyre dhe të cilët rrezikohen të jenë viktima të mundshëm të organizatave kriminale që për detyrë kryesore e kanë trafikimin me qenie njerëzore. Arsyet si papunësia, varfëria, mungesa e arsimimit dhe kushteve për arsim, pabarazia e mundësive në fusha të ndryshme, kushtet e vështira dhe minimale për jetesë dhe luftërat në vendet, dhuna ndaj grave dhe vajzave të reja, papunësia dhe varfëria, pagat e ulëta dhe skamja, martesat e detyruar të

[642] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.190

vajzave të reja, dhe të tjerë përbëjnë shkaqet më me ndikim në trafikimin e qenieve njerëzore. Gjendja e tyre biopsikike, papjekuria fizike e shpirtërore, lidhjet e ndjeshme emocionale me prindër, obligimet e prindërve ndaj fëmijëve dhe keqpërdorimet e autorizimeve të tyre, e bëjnë këtë dukuri edhe më komplekse dhe më shqetësuese në shoqërinë bashkëkohore[643], pra kur kemi të bëjmë me të miturit ose me fëmijët si kryerës ose si viktimë të krimit Sipas Agnewe, llojet e tensionit që kanë potencialin më të lartë për ta tërhequr individin në krim janë:

1. Tensionet që janë të vlerësuara si të padrejta,
2. Tensionet e intensitetit dhe sasisë së lartë,
3. Tensione që lidhen me kontrollin e ulët shoqëror,
4. Tensionet që ushtrojnë presion ndaj individëve për të zgjidhur problemet e tyre duke kryer krime ose duke ofruar disa inkurajime në këtë drejtim.[644]

Viteve të fundit si faktor ndaj të cilit duhet të jepet rëndësi dhe kujdes të veçantë është fenomeni i globalizimit botëror që nënkupton heqjen e kufijve midis vendeve, lehtësinë e komunikimit dhe kështu tek njerëzit formohet një mendim se ata mund të jetojnë një jetë më perspective dhe më të mire edhe në ndonjë vend tjetër duke shpreh dëshirën për të migruar. Përveç aspektit pozitiv të globalizimit, përparimet teknologjike dhe lehtësia e transportit çojnë edhe në rritje të krimit të organizuar dhe përfshirjes së grupeve të krimit të organizuar në rrjetet globale të organizatave kriminale. Para përcaktimit dhe definimit se pse ekziston trafikimi i qenieve njerëzore në botë, është e nevojshme të identifikohen dhe analizohen faktorët që ndikojnë dhe që krijojnë këtë fenomen, si dhe zhvillimet dhe shkaqet aktuale botërore. Gratë, fëmijët dhe grupet e e cenueshme dhe të margjinalizuara bëhen më të prekshme dhe më të rrezikuara ku strukturat shoqërore shkatërrohen dhe zvogëlohet mbështetja sociale nga vet shoqëria dhe shteti. Vendet e origjinës të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore karakterizohen me grupimin e faktorëve shtytës dhe ate: **faktorë ekonomiko-shoqëror:** ekonomi të varfër dhe papunësi të nivelit të lartë, varfëria në shoqëri, skamja dhe uria, urbanizimi, **faktorë socio-patologjik:**prostitucioni, alkoolizmi, patologjia seksuale, narkomania, bixhozi, bredhja dhe lëmosha, Aids-i, **faktorë mikrogrupor:** familja, shkolla, mjedisi shoqëror, **faktor politik**: konflikte politike, konflikte kulturore,lufta, arsimimi mjetet e komunikimit public-masmediat, religjioni dhe sektet ekstreme religjioze, **faktori i proceseve të migracionit:** emigrimi, imigrimi, remitancat, migracioni turistik ose i përkohshëm, migracioni studentor etj.

1.1.1. Faktorët ekonomiko-shoqëror

Ndonëse gjatë trajtimit dhe hulumtimit të kriminalitetit dhe sjelljeve kriminale, shpeshherë, në shikim të parë fitohet përshtypja se në paraqitjen e tij, rëndësi kryesore ka personaliteti i kryerësit dhe se veprimet e tij devijante janë rezultat i strukturës dhe vetive të tij të brendshme, kjo përshtypje, në realitet, nuk është e drejtë pasi që personaliteti formohet dhe është i kushtëzuar nga një varg faktorësh të natyrës objektive, e në rend të parë të faktorëve ekonomikë dhe shoqëror.[645] Faktori ekonomik duhet të shihet si pjesë e një rrjeti kompleks të lidhjeve me aspektet individuale, morale, kulturore dhe të tjera shoqërore.[646] Personat nga vendet me ekonomi të dobët që lëvizin drejt vendeve me ekonomi të zhvilluar sidomos shtetet perëndimore që kanë standarde më të larta

[643] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.184
[644] Dolu, Osman. "Suç Teorileri", Teori, Araştırma ve uygulamada Kriminoloji. Ankara, 2011, fq.328
[645] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.241
[646] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.342

jetese dhe paga më të nalta janë të ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të veprimtarive të grupeve të ndryshme të krimit të organizuar ku bën pjesë edhe trafikimi me qenie njerëzore të cilët viktimat e mundshme i shohin si objekt abuzimi për përfitime materiale. Zhvillimi i ulët dhe i ngadalshëm ekonomik direkt ndikon në rritjen e papunësis dhe më pas rezulton me varfëri dhe skamje të shoqëris e cila mund të ndikojë drejtpërdrejtë në situatën e sigurisë në vend, por edhe të zhvillimit të mëtutjeshëm të krimit të organizuar si dhe të kriminalitetit në përgjithësi dhe në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore. Megjithatë, kriminaliteti nuk vjen dhe nuk është shkak i përhershëm e individëve që janë me ekonomi të dobët të të ardhurave ose janë të papunë ose të varfër, por ndonjëherë ndodhë që kriminaliteti të kryhet edhe nga persona të cilët janë të punësuar dhe nuk janë ekonomikisht të dobët ose të bien pre e viktimizimit të trafikimit me njerëz. Kështu, për shembull Suedia e cila ka një standard të lartë të jetesës pa dyshim është në mes të vendeve të parë në botë, dhe ka shumë të përhapur delikuencën e të miturve nga shtresat e mesme dhe të larta të shoqërisë.[647] Sigurisht që është e nevojshme kujdes në notimin ose vlerësimin e ndikimit të varfërisë në sjelljet kriminale.[648]

Sipas mendimit të ***Milutinoviç***, depresioni ekonomik me forcën e saj të reaksionit zinxhiror po ndikojnë në një sërë dukurish (papunësia, varfëria, konfliktet) cilët mund të ndikojnë dukshëm në paraqitjen në radhë të parë të krimit kundër pasurisë[649], e cila më pas mund të lehtësoj viktimizimin e trafikimit. Teza e vjetër dhe e njohur e ***Aristotelit***, ***"varfëria është nëna e krimit, dhe mirëqenia nëna e imoralitetit"***, vazhdoi edhe një periudhë të gjatë të zhvillimit të mendimit kriminilogjik për të gjetur shumë adhurues edhe në periudhën moderne[650], mendim i cili sot e kësaj dite e ka peshën dhe rëndësinë e vet. Varfëria dhe papunësia si faktorë ekonomiko-shtytës llogaritet si faktorë kryesor dhe shumë të rëndësishëm që ndikojnë drejtëpërdrejt në paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore. Dukuria e varfërisë dhe e papunësisë janë fenomene permanente që vazhdojnë me prezencën e tyre pothuajse në çdo vend të botës dhe është shqetësuese për të gjithë njerëzimin duke fulluar nga periudhat më të vjetra të historisë e deri më sot me shpresë për një zgjidhje të këtyre dy dukurive. Personat nga shtetet e tyre dëshirojnë që sa më shpejt të ikin dhe largohen nga varfëria dhe papunësia që i ka kapluar dhe të përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre në vende tjera më të zhvilluara ku shohin edhe perspektivën e tyre dhe pasardhësve.

Papunësia, varfëria, mungesa e arsimimit, mungesa e mundësive, dhuna ose diskriminimi mund të inkurajojnë dikënd të bëj përpjekje të ndërtoj jetë në ndonjë vend tjetër, dhe "shtyn" të kërkojnë zgjidhje.[651] Gjendja e papunësisë shkakton një apati dhe zhgënjim i cili lidhet me paperspektivën e zgjidhjes së problemeve të cilat krijohen në familje dhe te individët.[652] Kjo kategori e personave largohen nga vendet e tyre duke e parë si të pamundur të jetojnë një jetë të lumtur dhe pa telashe si p.sh.: mbulimin e nevojave familjare siç janë arsimi i mirëfillt, punësime meritore dhe me paga solide, mosndikimi i politikës në vendet e punës etj. Kriza ekonomike, shtresa sociale dhe në përgjithësi varfëria në shumicën e shteteve të Afrikës dhe Azisë, forcojnë njerëzit, që në kërkesë të ekzistencës të kërkojnë rrugë dhe mënyra për të shkuar në vende të zhvilluara të Evropës, Amerikës, Australisë etj[653] të cilët shpesh janë sulm i trafikantëve. Gjatë kërkimit për punësim, të pamjaftueshën në vetëdije për rrezikun që ata mund të pësojnë si objekt i

[647] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.167
[648] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[649] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.166
[650] Po aty, fq.167
[651] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.12
[652] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.249
[653] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.122

trafikimit, nuk është e pazakontë që viktimat të pranojnë oferta pa hezitim cilët në dukje janë tërheqëse.[654] Kërkimi për një jetë më të mirë, mundësitë e punësimit, fitim më të mirë, kërkim për arsim më kualitativ ose, prap, dëshira për të zbuluar vende të reja të kombinuar me mungesën e informacionit ndikon në miratimin e vendimeve jo të informuara të cilët shumë lehtë mund të jenë të shfrytëzuara nga ana e trafikantëve.[655] Lloji evropian i trafikimit është i lidhur me proceset sociale në vendet e Evropës Lindore, nga të cilat vajzat midis 20-23 vjeç, me shkollë të mesme dhe shumë me arsim të lartë, po vijnë në metropole si Gjermania, Italia, Suedia dhe vende tjera evropiane perëndimore dhe përmes prostitucionit kërkojnë fatin për jetë më të mire nga kushtet materiale të pasigurta të cilat ofrohen në vendet e tyre.[656] Pra, situatë jo e mirë dhe e rëndë ekonomike në një shtet sidomos në një shoqëri mund të jetë si faktor i mundshëm dhe dominues i ndikimit në paraqitjen e viktimave vullnetar të prostitucionit. Kjo nuk do të thotë që të gjithë të papunët janë viktima të trafikimit por kjo situate dhe zhgënjim shfrytëzohet nga grupet kriminale për të siguruar anëtarë të rinj në aktivitetet kriminale si dhe viktima të mundshëm për aktivitete të ndryshme kriminale të organizatës duke premtuar dhe i mashtruar përmes shfrytëzimit të gjendjes së tyre ekonomike.

Viktimat në vështirësi ekonomike ku dominon varfëria shpesh mashtrohen nga trafikantët me metodat veç më të njohura si premtime për punë, nganjëherë me premtime për martesë, oferta si modele në reklama të ndryshme dhe çohen në një vend tjetër dhe detyrohen të punojnë për prostitucion, punë e detyruar, kryerjen e krimeve të ndryshme, bredhja dhe lëmosha, transplantim organesh nga trafikantët njerëzorë. Shpeshherë, disa individ dhe grupe, duke dashur që të dalin nga kjo gjendje e vështirë, fillojnë të mirren me disa aktivitete dhe veprime të dëmshme sociale, p.sh., me prostitucion, bredhje lëmoshë, braktisje të familjes dhe të fëmijëve.[657] Qëllimi i njerëzve që migrojn drejt vendeve të zhvilluara ekonomikisht që të kenë një jetë më të mirë, të ardhura që do ti mbulojnë nevojat e tyre dhe perspektivë për pasardhësit e tyre, por në anën tjetër trafikuesit, i shfrytëzojnë gjendjen e tyre dhe momentin e duhur që janë pjesë e rrjeteve kriminale të cilat kanë për qëllim shfrytëzimin dhe abuzimin e viktimave të mundshëmm për përfitime materiale. Pra me këtë shihet se ëndrrat për tu pasuruar dhe për të pasur një jetë më të mirë të personave që migrojnë si shkak i papunësisë, varfërisë, skamjes dhe urris nga vendet e tyre përfundojnë me pasurimin e trafikantëve të cilat i abuzojnë dhe pasurohen me shfrytëzimine viktimave të trafikimit. Pra, faktorët ekonomik janë motivacion i migracionit të njerëzve duke vendosur në vende tjera që ti tejkalojnë papunësinë, varfërinë, skamjen dhe urinë dhe më pas për rritjen e prosperitetit ekonomik dhe material të familjes të tyre po edhe më gjerë. Faktorët sociogenik gjithashtu duhet të ndikoj në rrënien e standardeve të jetesës, veçanërisht për shkak të rritjes së papunësisë, gjegjësisht shkarkimin e punëtorëve nga punët e tyre për shkak të krizës ekonomike dhe pamundësisë për të punësuar.[658]

Nga e gjith kjo mund të përfundojmë se personat të cilët janë të ekspozuar direkt apo indirekt apo indirekt diskriminimit në sektorin ekonomik sidomos në çështjet e papunësisë varfërisë skamjes dhe urisë shumë leht mund të jenë viktima të formave të ndryshme të trafikimit duke u

[654] Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. "Prevencija trgovine ljudima". Beograd, 2006, fq.14

[655] OSCE. Прирачник за новинари. "Трговија со луѓе и медиумите", Скопје, 2010, fq.12

[656] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.214

[657] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.249

[658] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117

ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të abuzimit, keqtrajtimit dhe format tjera të shfrytëzimit ku më e shpeshta është prostitucionit.

1.1.2. Faktorët socio-patologjik

Në shumë vende, industria argëtuese dhe seksi janë burim i rëndësishëm i të ardhurave dhe kërkesa krijohet nga ana organizatave kriminale për punëtor femra që do punonin për paga të ulëta. Edhe sot në shumë vende të botës në bazë të traditave që dominojnë gjinia femrore si pjesë e shoqërisë janë të kufizuara në shumë sfera. 70% e viktimave nga Rusia dhe Evropa lindore shiten veçanërisht në shtetet si Gjermania, Franca, Italia , Anglia, Austria Holanda, Greqia drejt Evropës perëndimore, 15% veçanërisht nga Izraeli dhe Arabia Saudite drejt Lindjes së Mesme dhe veçanërisht Japonia dhe Tajlandi drejt Lindjes së largët, 3% ose 5000 në Amerikë dhe Kanadë, dhe pjesa e mbetur veçanërisht nga Hungaria, Polonia, Republika e Çekis drejt Evropës Qendrore.[659] Pra, përveç faktorëve tjerë vend të veçantë kanë edhe faktorët socio-patologjik në rritjen e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Tek shoqëritë e varfëra ku dominon skamja ende ekziston dhuna në familje, kërcënime ndaj grave për relizimin e punës së detyruar, mos ndjekja e arsimit të femrave, mosdhënja e ndihmës pas divorcit, pabarazia sociale, të izoluara dhe këto ndikojnë që shumë gra së bashku me fëmit e tyre të vendosin të migrojnë të cilët e rrezikojnë veten nga trafikantët për viktimizim të mundshëm. Në kriza të gjera martesore, siç dihet, fëmijët vuajnë për një sërë arsyesh: për humbjen e iluzioneve për mirësinë dhe drejtësinë e prindërve të tyre, për një jetë të vazhdueshme në shenjë të një rrugëdalje të pasigurt për ta për shkak të prishjes së familjes[660] dhe e cila rezulton me pasoja dhe trauma. Por, fatkeqësisht dhuna nuk ekziston vetëm në shtetet e tyre të origjinës pra, në familje ose shoqërin ku jetojnë, sepse dhuna mundë të shoqërojë edhe gjatë procesit të migrimit të këtyre personave të cilët shpesh shoqërohen nga personat që miren me kontrabandën me migrantë ose grupet e krimit të organizuar apo personave që miren me trafikimin me qenie njerëzore edhe në shtetet e tranzicionit e deri në shtetet e destinacionit dhe kështu kemi viktimizimin e këtyre personave dhe përdorimin e dhunës ndaj tyre. Sidoqoftë, ekzistojnë disa faktorë më dominues që sigurojnë shfrytëzimin seksual të grave në fushën e trafikimit, pra viktimat shfrytëzohen për prostitucion nga ana e trafikantëve dhe nga ato faktorë mund të dalllojmë papunësinë e grave në vendet e tyre papërshtatshmëria e punëve që ofrohen, mungesa e arsimimit të duhur, izolimi social i grave, dhuna në familje, detyrimi në punë të rënda etj.

Transformimi dhe ndryshimet ekonomik nga zonat rurale drejt zonave urbane, pra, qyteteve ku është përqendruar kapitali shtetëror fillon rritja e migracionit të meshkujve kurse gratë mbesin në vendet e tyre rurale duke e rrezikuar veten nga trafikantët. Domethënë, ata, me kujdes hulumtojnë vende të varfëra në cilin do qoft shtet, duke rekrutuar vajza të reja tek ata të cilëve u premtojnë fitime të mëdha nga prostitucioni.[661] Pra, të gjithë ata që janë objekt i abuzimit për qëllime të ndryshme në vet familjet e tyre dhe shoqëria ku jeton vendosin më lehtë për të lëshuar vendet e tyre duke shpëtuar nga ajo situate e rëndë abuzuese për to. Vlerësohet se 70% e fëmijëve që punojnë në sektorin e prostitucionit në Filipine janë viktima të trafikimit njerëzor duke ikur nga shtëpia për shkak të dhunës në familje.[662] Në raportin bazë të policisë ndërkombëtare, në botë në vit ka rreth 700.000 viktima të trafikimit në kushte të skllavërisë nga të cilat disa janë të angazhuar

[659] Po aty, fq.359
[660] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.189
[661] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[662] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.356

në dhënje të shërbimeve seksuale të detyruar, kurse tjerit në punë të detyruar.[663] Sipas raportit të fundit të trafikimit, midis 600,000 dhe 800,000 njerëz trafikohen përtej kufijve ndërkombëtarë çdo vit ndërsa miliona viktima trafikohen brenda vendit të tyre.[664] Sipas vlerësimeve të njejta, nga të cilat 200.000 janë viktima të trafikimit e cila zhvillohet ose fillon në Ballkan.[665]

Sot, në të gjithë botën me një dinamik dhe shpejtësi të madhe është e përhapur dhe është prezent pothuajse në të gjithë shtresat e shoqërisë sidomos tek të rrinjtë përdorimi dhe konsumimi i substancave narkotike të cilët llogariten si dukuri shumë e rrezikshme e cila si pasojë e ka edhe vdejken e përdoruesve të tyre. Alkoolistët dhe narkomanët, në statistikat kriminale dhe viktimologjike, sot i hasim si kryerës të sjelljeve devijante apo kriminale, por edhe si viktima.[666] Kjë kategori e personave nuk mund të sigurojnë raporte të shënodsha as me familjen e as me shoqërinë në përgjithësi duke ikur përgjegjësis në punë, familje dhe shoqërinë ku jeton dhe kështu këta persona me gjendjen e tyre të pakontrollur mund të paraqiten edhe si kryerës të veprave penale por edhe si viktima të ndonjë vepre penale nga personat e tjerë, si p.sh.: veprat penale të vrasjes, vjedhjet, dhunimet seksuale, aksidente rrugore, dhuna në familje sidomos bashkëshortes dhe fëmijëve, po edhe të trafikimit me qenie njerëzore sidomos kur mbesin pa të mira materiale përmes të cilëve ata sigurojnë lëndët narkotike. Kur flitet për narkomaninë si faktor socio-patologjik në kriminologji, zakonisht mendohet për të gjitha pasojat e kësaj dukurie, e në rend të parë për raportet dhe lidhjet e saj me sjelljet kriminale.[667] Përdorimi, shfrytëzimi dhe varshmëria nga substancat narkotike pas një kohe të shkurtër fillon ndikimi i saj negativ sidomos në shkatërimin psiqik dhe fizik të personit dhe kështu më leht mund të kontrollohen dhe të viktimizohen. Këta persona nën ndikimin e substancave narkotike dehëse bëjnë çmos përveç narkomanisë vetëm e vetëm sigurimit të të ardhurave duke u aktivizuar në vjedhje, ndërmjetësim në prostitucion dhe krime tjera të ndryshme si dhe rrjetet kriminale e shfrytëzojnë varshmërinë e tyre duke detyruar edhe në veprimtaritë e krimit të organizuar. Personat narkomanë janë të kyçur edhe në krimet e dhunës e sidomos me organizimin e prostitucionit, reketizmit, kidnapimit të fëmijëve, shantazheve të ndryshme dhe shpesh marrin pjesë edhe në çregullime të rendit publik.[668] Nga veprat konkrete që hyjnë në këtë kategori, në literaturë ceken: - dehje dhe abuzim të drogës, - egërsi dhe lypje, - bixhozi, - prostitucioni dhe akte të tjera seksuale vullnetare të të rriturve dhe - delikte të të miturve (ikja nga shtëpia, kotësi).[669] Nëse aktivitetet e personave të tillë nuk janë nën kontroll, ata munden, por ndonjëherë ate edhe e arrijnë, shkatërrimin e tërë grupit shoqëror.[670] "Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 5,6% të të gjitha vdekjeve te meshkujt dhe 3,2% te femrat në tërë botën ndodhin përshkak të alkoolit. Në botë sot thuhet se ka afro 2 miliardë njerëz që konsumojnë pije alkoolike dhe 76,3 milionë konsumues të alkoolit me çregullime të diagnostifikuara shëndetësore, pra si viktima të përdorimit të tij."[671] Konsumimi i tepërt i pijeve alkoolike në Amerikë, Suedi, Frncë, Gjermani, Rusi etj., ka ndikuar në shtimin e sjelljeve

[663] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.698
[664] Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. "Prevencija trgovine ljudima". Beograd, 2006, fq.16
[665] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.698
[666] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.110
[667] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.308
[668] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.186
[669] Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011, fq.136
[670] J.Gordon, Nathan. L.Fleisher, William. Akademija za obuku iz naucnih metoda vodenja istrage. "Efikasne tehnike vođenja razgovora i ispitavanja". Sarajevo, 2002, fq.1
[671] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.110

kriminale dhe huligane të personave të mitur dhe të rinj në këto vende.[672] Pra, gjendja e personave të cilët janë përdorues të alkoolit, substancave narkotike dhe varshmëria nga ato, krijon cenueshmërinë e tyre, dhe ndaj të cilëve trafikantët me leht e kanë për ti viktimuzuar për qëllime të ndryshme duke shfrytëzuar gjendjen depressive dhe problematike të tyre.

1.1.3. Faktorët mikrogrupor

Faktorët mikrogrupor ose më konkretisht arsyet sociale dhe familjare janë gjithashtu ndër arsyet që personat-viktima abuzohen nga grupet e krimit të organizuar sidomos nga trafikantët me qenie njerëzore. Një ndër teoritë më të përmendura lidhur me këtë çështje është ajo e ***Edvin Saterlandit***, sipas së cilës i mituri bëhet me sjellje negative, nëse shoqërohet me njerëz të cilët rrjedhin prej familjeve të dezorganizuara dhe me qëndrime delikuente.[673] Familja, llogaritet si faktori më I rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e shëndoshë të gjeneratave të reja sidomos në lidhje me formimin e personalitetit të njeriut e cila do të ndikojë në funksionimin e mirëfillt të raporteve familjare. Mosfunksionimi i familjes është një faktor kryesor në shfaqjen e fenomeneve të ndryshme socio-patologjike midis anëtarëve.[674] Mirëpo, disa familje, sidomos të ashtuquajturat familje problematike dhe familjet e shkatërruara, shpeshherë, këto funksione nuk i kryejnë si duhet dhe ato bëhen burim i shumë dukurive negative dhe sjelljeve kriminale.[675] Pra, arsyet familjare ndikojnë në mashtrimin e të rrinjve sidomos të vajzave të reja që duan të largohen nga familjet e tyre janë në shënjestër të trafikantëve me qenie njerëzore me premtimin dhe oferta të ndryshme për të fituar para dhe një jetë më të mirë. Atakimet e trafikantëve janë të shpeshta tek ato familje ku dominon dhuna, mosmarëveshja konfiktet dhe problemet mes anëtarëve të familjes, familje shumë anëtarëshe ose të mangëta, familje ku përdoret alkooli etj., kështu që pasojat negative ku shpesh kemi edhe ikjen nga familja të fëmijëve. Vendosja në një rreth tjetër të cilët për fëmijët është e panjohur ose pak e njohur i duhet një koh për adaptim në rethin e rri shoqëror e cila shpesh here është aq e rëndë dhe e komplikuar saqë shpesh mospërballimi i tyre ndikon edhe në devijimin e sjelljeve të tyre të cilët shpesh janë edhe viktima të mundshëm të sjelljeve të ndryshme kriminale po edhe të trafikimit me qenie njerëzore. Është shumë e rëndësishme që prindërit të jenë të vetëdijshëm për sjelljen e fëmijës sa më shpejt të jetë e mundur përmes vëzhgimit nga afër lëvizjet e fëmijës.[676]

Shkollat si institucione arsimore janë shumë të rëndsishëm në formimin e personalitetit të njeriut sepse fëmijët që nga moshat e hershme të fëmijërisë përmes ndjekjes së arsimit, përmes fitimit të njohurive edukativo arsimore fillojnë të përfitojnë sjellje etike dhe moralshme në rrethin ku jetojnë dhe përgaditen për sfidat në jetën e tyre. Por, shkolla jo përher dhe jo në çdo vend ka të bëjë me proces edukativo-arsimor kualitiativ për rininë, por në disa vende shpesh kemi edhe ndikimin negative përshkak të mungesave të kuadrit professional, kushteve të rënda për arsim mungesës financiare për shkollim por edhe mungesa e finansave për përmirsimin e kushteve të shkollave. Në këtë drejtim flitet për dukuritë e ikjes nga shkolla, për marrjen e nxënësve me sjellje delikuente, për sjelljet e dhunshme dhe agresive, për dukurinë e pirjes së alkoolit dhe konsumimit të pijeve narkotike të nxënësve gjatë kohës kur ata janë në shkollë.[677]

---

[672] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.306
[673] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.147
[674] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.16
[675] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2002, fq.265
[676] Dolu, Osman. "Suç Teorileri", Teori, Araştırma ve uygulamada Kriminoloji. Ankara, 2011, fq.281
[677] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.284

Dhuna në familje sidomos ndaj grave dhe vajzave të reja të cilët janë të papunë dhe në anën tjetër ofertat për punë në vende të ndryshme duke ofruar edhe paga të larta ofron mundësinë e një jetesë më të mirë dhe më kualitative kurse fëmijve të largohen përgjithmon nga dhuna kështu që ata vendosin të pranojnë ofertat e tilla. Ka raste kur prindërve të dhunshëm dhe kriminel u konvenon të kenë edhe fëmijë kriminel. Prindërit kriminel dhe antisocial kanë tendencë të kenë fëmijë delikuentë dhe antisocialë, siç është sqaruar në hulumtimet klasike dhe afatgjate të ***McCord*** (1977) në Boston dhe ***Robbins*** (1979) në St. Louis.[678] Kushtet dhe perspektivat negative të grave në vendet e tyre të origjinës do të kontribuojnë pozitivisht trafikantëve me qenie njerëzore për një atak të mundshëm përshkak se grate përmes këtyre problemeve përjeton diskriminimin gjinor në një shoqëri. Autori ***Buchler***, dhunën në familje e përkufizon si atakim të integritetit trupor dhe mendor ndaj një personi në kuadër të një personi familjar, duke përdorur forcën apo dhunën fizike dhe psikike nga personi i cili është më i fuqishëm fizikisht.[679] Gratë-viktima të dhunës familjare janë, para së gjithash, viktima të vetë shoqërisë, diksriminimit gjinor, traditat e rrënjosura, roli patriarkal i burrit në familje dhe faktorë tjerë.[680] Sipas autorit tjetër, ***Schneider***, me dhunë familjare kemi të bëjmë kur një person ushtron ose tenton të ushtrojë dhunë fizike, dhunë psikike ose dhunë seksuale brenda një marrëdhënieje familjare apo martesore në vazdhimësi oseherë pas here.[681] Deklarata e OKB-së mbi eliminimin e dhunës ndaj gruas, e cila është aprovuar kohë më parë, si dhunë të këtillë e cilëson çdo akt të dhunës dhe agresionit, të bazuar në përkatësinë gjinore, si të përshtatshëm për fyerjen, lëndimin fizik e psikik dhe keqtrajtimin seksual të gruas.[682] Mos pengimin e dhunës me aparatin shtetëror ato edhe më shumë i ndihmojnë ajo të përhapet duke mos i dënuar dhunuesit e cila ndikon që gratë të jenë sa më afër migracionit e më pas edhe rrezikshmërisë së viktimizimit të tyre nga trafikantët.

1.1.4. Faktorët politik

Faktorët politik dhe në kuadër të saj luftërat dhe konfliktet rajonale që po zhvillohen në shumë vende botërore gjithashtu kanë ndikim në rritjen e pasigurisë dhe frikës së njerëzve. Njerëzit që janë në vende ku zhvillohen konflikte të ndryshme të armatosura sidomos nën ndikimin politikave dhe intervenimeve të ndryshme, njerëzit me çdo kusht mundohen të ikin nga dëmet eventuale ndaj tyre dhe familjeve si dhe rreziqet që mund të paraqiten në ato vende ndikon direkt në migrimet masovike të popullsisë të cilët bëhen të prekshëm dhe shënjestër e grupeve kriminale po ashtu edhe të trafikimit me qenie njerëzore. Në këtë situatë punon e ashtuquajtura ***bursë e zezë***, paraqiten persona dhe grupe që merren me kontrabandë dhe spekulime të ndryshme, pastaj lulëzon i ashtuquajturi kriminalitet i nëntokës.[683]

Në të kaluarën, në shumë shtete që janë zhvilluar luftëra siç janë Amerika Latine, Afrika Evropa, Azia po edhe shtetet ballkanike sidomos në ish shtetet e Jugosllavis (Kroaci Bosnja dhe

[678] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.613
[679] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.75
[680] Информативна Брошура за жени-жртви на семејно насилство " Можности за економско зајакнување на жените-жртви на семејно насилство". Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија, Скопје, 2010, fq.10
[681] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.75
[682] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.181
[683] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.257

Hercegovina, Kosova) me ndikimin e klimës negative politike para, gjatë dhe pas luftës ka pasur ndikim negative në paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore si vend origjine për forma të ndryshme të shfrytëzimit dhe në të shumtën e rasteve për prostitucion. Faktori kryesor në këto konflikte është dëshira e një grupi politik për të eleminuar grupin tjetër politik duke ushtruar dhunë, vrasje, shkatrime, abuzime të llojeve të ndryshme etj. Në këtë fazë, në njërën anë, vërejmë pasurimin dhe begatimin e shpejtë të individëve dhe grupeve të caktuara, fitimin e madh, grumbullimin e pasurisë, ndërsa në anën tjetër, vërehet skamja, varfëria, bredhja dhe lëmosha etj.[684] Për shkak të luftës dhe konflikteve të armatosura, krijimi i zonave të personave të ikur nga lufta dhe kampeve të ndryshme është mundësi dhe zona të përshtashme shumë e mirë për aktivizimin e krimit të organizuar për trafikimin me qenie njerëzore për gjetjen sa më të lehtë të viktimave të mundshëm.

Edhe pse janë të ralla vendet botërore ku konfliktet etnike dhe diskriminimi etnik janë pjesë e shtetit dhe të shoqërisë në ato vende, ndoshta në sasi më të vogël por prap ndikon në paraqitjen e kriminalitetit si dhe të trafikimit me njerëz. Sot në shumë vende nga grupe të ndryshme të njerëzve ekziston keqpërdorimi i rregullave fetare të feve të ndryshme me interpretime të ndryshme me qëllime të ndryshme sidomos ajo e përfitimit material me formimin sekte ekstreme religjioze të cilët gjithashtu janë ndikues të paraqitjes së kriminalitetit në përgjithësi po edhe të trafikimit me qenie njerëzore. Por, grupet të ndryshme kriminale duke u mbuluar nën ombrellën fetare dhe duke i keqpërdorur persona të caktuar devijohen nga rregullat e vërteta fetare duke u kuçur në disa rregulla të reja duke i thirur në emër të sektës në luftime dhe konflikte të armatosura kundër atyreve që janë kundër politikës dhe ideologjisë së sektës së caktuar. Shumë organizata kriminale me qëllim të përfitimit financiar rekrutojnë fëmijë për të luftuar për qinse ideologji fetare duke i nënshtruar viktimat ndaj trajtimeve të vrazhda dhe jonjerëzore. Në asnjë rrethanë grupet e armatosura, të ndara nga forcat e armatosura të një shteti, nuk do të rekrutojnë ose përdorin në veprime luftarake persona nën moshën 18 vjeç.[685] Pothuajse në çdo shtet të botës ekzstojnë me mijëra sekte të ndryshme fetare. Në SHBA thuhet se ekzistojnë më tepër se 3000 bashkësi apo sekte të ndryshme fetare, në Japoni më tepër se 230 mijë organizata fetare legale prej të cilave 180 mijë janë të regjistruara si ndërmarrje dhe korporata që merren me aktivitete të biznesit dhe punëve tjera afariste.[686] Pra, konfliktet etnike dhe diskriminimi etnik në pjesë të ndryshme të botës çojnë në fenomenin e trafikimit njerëzor, i cili shpreh praktikën aktuale të skllavërisë. Përveç faktorëve të lartëpërmendur, dallimet politike, socio-kulturore kanë një rol të veçantë dhe specifik për vendet e ndryshme. Në secilin vend, pabarazitë politike, kulturore, shtypjet dhe mosnjohja dhe mosrespektimi drejtave politike shkaktojnë dëshëprim zhgënjim të gjeneratave të reja të cilët e kanë më lehtë të vendosen në vendet e reja duke kërkua mirëqenie politike, sociale dhe kulturore.

Pra, konfliktet politike, konfliktet e armatosura, konfliktet etnike dhe konfliktet kulturore kanë qenë faktorë që miliona njerëz të shpërngulen, varfërohen dhe të migrojnë dhe veçanërisht gra dhe fëmijë duke u përpjekur të mbijetojnë dhe të ikin sepse gjatë periudhës së këtyre konflikteve gratë dhe fëmitë kanë qenë më të prekshëm nga veprat siç janë: dhunimi, kërcënimet, prostitucioni, puna e detyruar, marrja dhe shitja e organeve dhe shfrytëzime të ngjajshme.

1.1.5. Faktori i proçeseve të migracionit

[684] Po aty, fq.257

[685] Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, miratuar më 25.5.2000, neni 4 paragrafi 1

[686] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.272

Sot, proceset e migracionit nuk janë një dukuri apo fenomen i ri në, por, përkundrazi kjo dukuri është njohur që nga kohrat e lashta e cila vazhdon të jetë present në çdo shoëri edhe në ditët e sodit ndosha në sasi dhe dinamik më e madhja që e njeh historia e njerëzimit. Dihet se njerëzit që nga kohërat më të lashta të njerëzimit janë larguar nga vendbanimet e tyre të përhershme drejt vendeve tjera në kuadër të shtetit të tyre ose jashta saj nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm ku më së shumti kanë qenë varfëria e madhe skamja dhe uria, luftërat, kushtet e rënda klimatike etj. Vendimi për të lënë vendlindjen dhe për të emigruar zakonisht mbështetet nga një projekt emigrues që mund të jetë i një karakteri tërësisht individual ose familjar[687] ose viteve të fundit të karakterit global. Proçesi i migracionit në vete ngërthen tre dukuri dhe ate emigracionin, imigracionin, dhe migracioni në shtetet e tranzitit. Por, si faktor shtytës në kuadër të proçeseve të migracionit paraqitet vetëm emigracioni dhe migracioni në vendet tranzit, e cila nënkupton vendosjen apo lëvizjen e një personi ose të një grup personash prej një vendi drejt një vendi tjetër duke kaluar kufirin shtetëror të një ose të më shumë shteteve për arsye të shumta siç janë: ato ekonomike, sociale, politike etj, kurse për shtetet e destinacionit ardhja e migrantëve nënkupton ardhjen e imigrantve të cilët janë të huaj në krahasim me shtetasit e tyre.

Sot, përmes mjeteve të teknologjisë së sotisfikuar në mes të shteteve dhe individëve marrja dhe dhënia e informacioneve për standardet e jetesës, dallimet në mes shteteve, nevoja e punësimeve dhe shumë çështje tjera mund të realizohen nga vet personat më afër se kurdoher tjetër dhe kështu kjo dukuri ndikon që personat nga vendet e varfëra dhe me ekonomi dë dobët të kenë aspiratat e tyre të jetojnë sikur personat që jetojnë pa brenga financiare në shtetet tjera të zhvilluara, por këto lëvizje permanent janë nën ndjekjen e krimit të organizuar dhe trafikantëve me qëllim të gjetjes së klientëve duke ofruar lehtësime dhe zgjidhje për nevojat që i kanë në lidhje me vendosjen në shtetet e destinacionit. Lëvizja e njerëzve në përgjithësi bëhet nga vendet e varfëra drejt vendeve të pasura, nga vendet ku nuk ka ekonomi të zhvilluar dhe punë drejt vendeve me ekonomi të zhvilluar dhe me vende të lira të punës, nga vende me popullsi të stërngarkuar drejt vendeve ku popullsia është në numër të vogël të cilët kanë nevojë për vendosjen e popullsisë së re si p.sh. emigrimi drejt Australisë përshkak të nevojës shtetërore për popullimin e vendit dhe ngritjes së ekonomisë përmes fuqisë punëtore.

Ndikimi i globalizmit është ë lidhur ngusht me proceset e migracionit dhe të lëvizjes së njerëzve anë e mbanë botës e cila ndikimin e saj përveç njerëzve ka edhe ndaj shtetit, përmes të cilave shtetet realizojnë integrimin e tyre në kapital, biznes, treg, punë siç është Bashkimi Evropian dhe benefitet e shteteve që janë anëtare të këtij Bashkimi. Viteve të fundit me zhvillimin e kapitalizmit si dukuri dhe anën tjetër të urbanizimit dhe zhvillimit industrial dhe pabarazisë së zhvillimit ekonomik në mes të shteteve dhe regjioneve kemi migrime masive të popullatës nga vendet e pazhvilluara drejt vendeve me industri dhe ekonomi të zhvilluar për të tejkaluar vështirësitë që ekzistojnë në vendbanimet e tyre. Pra, kemi rritje të migrimit të popullatës për punësime dhe një jetë më të mire sesa që e kanë në vendet e tyre, migrimet prej një shteti drejt një shteti tjetër, në kuadër të një shteti migrimet nga vendet rrurale drejt vendeve urbane etj. Njerëzit nga vendet dhe zonat e kapluara nga krizat ekonomike, papunësia , varfëria, skamja dhe uria ose nga katastrfoat naturore sidomos kushtet e rënda klimatike me qëlim të mbijetesës dhe të një jetë stabile e ndjejnë nevojën e zhvendosjes nga vendet etyre duke emigruar drejt vendeve tjera që nuk i kanë këto problematika dhe të cilët atakohen nga trafikantët duke menduar se me ndihmën e tyre lehtësohet procedura e migracionit. Në këtë mendim është edhe B.R. i cili deklaron se: “Proceset e migracionit në RMV e hapën rrugën për krijimin e grupeve të organizuara të kontrabandës së

[687] Zenelaga, Brunilda. Disertacion i doktoraturës “Familja emigrante përballë sfidave të integrimit. Rasti i emgrantëve shqiptarë në rajonin e Toskanës, Itali”. Tiranë, 2013, fq.26

migrantëve dhe të trafikimit të qenieve njerëzore si një proces dhe rezultat i të njëjtës."[688] Grupet e tilla kriminale shpesh hasen në vendet ku migrantët grumbullohen sidomos afër pikave kufitare duke I atakuar me shërbime dhe oferta që të ndihmojnë të kalojnë kufijt si dhe në gjetjen e punëve dhe rregullimin e tyre në vendet e destinacionit.

Rajoni i Ballkanit paraqet në atë kuptim qendër tranziti në të cilën janë sjell njerëz me rrugë ilegale dhe prej andej dërgohen në vendet e zhvilluara të Evropës.[689] Në kërkim të një jete më të mire shumë persona vendosin për emigracion të paligjshëm në shtete të pasura, sidomos në Amerikë dhe Unionin Evropian.[690] Në një vit, numri i zbuluar i migrantëve të paligjshëm të nga Afrika dhe Azia është rritur për 172%.[691] Nevoja e vet shteteve të destinacionit për fuqi punëtore e përkrahin vendosjen e tyre duke ofruar punë nga punëdhënësit e tyre dhe duke ndihmuar në adaptimin e tyre në sitemin e shtetit të destinacionit. Pra, është e padiskutueshme se fuqia punëtore ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi në rastin konkret të shteteve të destinacionit dhe siguron të ardhura për punëdhënsin, por në anën tjetër rritet edhe mungesa e fuqisë punëtore në shtetin e origjinës. Duke pasur parasysh dezavantazhet e tanishme në tregun e punës, pra papunësinë e lartë, Republika e Maqedonisë në të ardhmen duhet të vazhdojë të ketë një politikë fleksibile dhe të orientuar drejt tregut për të pranuar punëtorët e huaj në përputhje me qëllimet afatgjata të politikës së punësimit.[692] Në anën tjetër duke rrit numri i personave që migrojnë drejt vendeve të destinacionit, këta shtete bëhen faktorë që ndikon në rrezikun e paraqitjes së trafikimit me qenie njerëzore përshak se viteve të fundit janë bërë ndryshime ligjore të fushës politike, migracionit, sociale dhe rregullave më të rrepta të pranimit të migrantëve dhe dhënjen e lejes së punës që për migrantët është një bllokadë e rëndë dhe kështu ndikon që këta individ rrugëdaljen të gjejnë duke i kontaktuar grupe të ndryshme kriminale që mirren me trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabandën me migrantë dhe kështu leht bien në duart e trafikantëve. Pra, shtetet që janë shënjestër e emigracionit i kanë forcuar rregullat ligjore për emigrim, përforcimin e kontrollit të hyrje daljeve të kufijve shtetëror, ndryshime në ligjet që i takojnë marëdhënieve të punës për migrantë, kurse në anën tjetër kjo është një arsye e mirë e shfrytëzimit të kësaj situate nga ana e trafikantëve për gjetjen e viktimave potencial. Gjithashtu edhe veprat penale të cilët lidhen me migrimet ilegale, qëndrim illegal janë të rrepta me sanksione të larta nga organet siç janë gjykatat dhe prokuroria. Sidoqoftë, zgjerimi i nevojshëm i juridiksionit penal ndërkombëtar nuk duhet të orientohet vetëm në mënyrë të njëanshme, ndaj kërkesave dhe dëshirave të prokurorisë, por të jetë i kujdesshëm, në të gjitha aspiratat e arsyeshme drejt efektivitetit, dhe respektimit shtetëror-juridik për të drejtat civile.[693] Sidoqoftë, për shkak të shqetësimeve ekonomike dhe sociale të vendeve të synuara, duke ndryshuar politikat e pranimit të imigracionit dhe ligjet e punës, e bën të vështirë pranimin e emigrantëve, zvogëlon mundësitë për hyrje, qlndrim dhe punë legale në vendet e destinacionit, e cila ndikon që njerëzit të kërkojnë rrugëdalje diku tjetër dhe si pasojë të bien në rrjetin e trafikantëve. Shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut, ndjekjet, persekutimet, torturat dhe krimet kundër njerëzimit e gjenocidi ndaj disa grupeve etnike e nacionale, ka ndikuar që shumë njerëz të regjioneve dhe shteteve të ndryshme, me qëllim të shpëtimit të jetës së vet ose të familjes,

[688] Intervista me B.R. Shef i Njësisë për Hetimin e Krimit Kompjuterik në Sektorin e Krimit Kompjuterik dhe forenzika digjitale, Byroja e Sigurisë Publike, Ministria e Punëve të Brendshme të RMV

[689] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117

[690] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148

[691] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.11

[692] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.20

[693] Хекер, Бернд. "Европско Кривично Право". Скопје, 2010, fq.21

t'i braktisin vendet e tyre dhe të kërkojnë strehim dhe punë në shtete tjera më të sigurta.[694] Vendet pritëse, komunitetet pritëse, vendet e zhvendosjes dhe vendet me tranzit të lirë dhe të sigurt jo vetëm që ndajnë barrën, por shpëtojnë jetën dhe jetesën e njerëzve.[695] Nga e gjith kjo del se, migrantët janë të vendosur edhe përkundër kufizimeve dhe kontrolleve kufitare të udhëtojnë drejt vendeve të synuara duke mos menduar aspak të kthehen në vendet e tyre të origjinës, situate e cila është shqetësuese për të gjitha vendet.

1.1.6. Faktor të tjerë

Përveç faktorëve të lartëpërmendura shtytës të popullatës që të lëvizin apo migrojnë drejt vendeve tjera brenda apo jashta shtetit nga vendet e origjinës siç ishin Luftërat, kushtet klimatike, faktorët ekonomik, papunësia, faktorët socio-patologjik, kulturor etj., ekzistojnë edhe faktorë të cilët mund të llogarisim se janë të nivelit më të ulët përshkak se në numër janë më pak raste. Faktorë tjerë që ndikojnë drejt lëvizjeve të njerëzve dhe në trafikimin me qenie njerëzore janë edhe migrimi i kategorisë së popullatës të cilët janë në kërkim të një jete me standarde më të larta për jetesë ose një jetë luksoze e cila u mungon në vendet e tyre ë origjinës, migrimi i njerëzve për kualifikime të reja, të përfitojë një zanat (profesoion) tjetër nga ajo çka e ka, vazhdimin e arsimit në universitete prestigjioze e cila mungon në vendet e tyre, të mësuarit e një gjuhe të huaj etj. Globalizmi i shtyn njerëzit e vendeve të origjinës dhe ato të destinacionit që të homogjenizojnë ose të barazpeshojnë sistemin e jetesës dhe kulturën në mes të njerëzve dhe me këtë në shumë vende organizatat kriminale e kanë të aktivizuar prostitucionin e ashtuquajtur "prostitucioni elit", e cila ka të bëjë me vizitën e klientëve që mirren me politikë, persona të biznesit, persona të njohur në media si: actor, këngëtar etj. Prostitucioni elit me ndihmën e trafikantëve u sigurohet këtyre klientëve elit në shuma marramendëse duke ofruar vajza të reja për zbavije, arrgëtime dhe shëtitje luksoze e cila realizohet përmes ndihmës së zyrtarëve të korruptuar. Pra tek ky lloj i prostitucionit shihet ekzistimi i krrupsionit tek zyrtarët shtetëror nga të cilat marrin ndihma në forma të ndryshme sidomos në sektorin e doganave dhe forcave policore gjegjësisht sektori i policisë i cili mirret me krimin e organizuar ku bën pjesë edhe vepra e trafikimit me qenie njerëzore për interesa të ndryshme duke përfituar nga këto veprimet kriminale. Policia duhet të jetë në vijë të parë të frontit kundër krimit të organizuar e asesi nuk duhet menduar korrupcionin e tyre si dhe në asnjë çmim nuk duhet të jetë pasiv ndaj kriminalitetit. Policia si organ kryesor për ruajtjen e rendit, siguris së qytetarëve, rruajtjen nga devijimet dhe kriminaliteti I organizuar qytetarit e atij vendi me profesionalizëm dhe objektivitet maksimal nda detyrave që u takojnë me ligj dhe të jetë me qytetarin kundër luftës së përbashkët kundër kriminalitetit. Veprimtaria e policisë që është orientuar drejt problemeve, është veprimtari ekipore, dhe në fund policia në bashkësinë lokale ka ndryshuar, ndryshime këto që shprehen edhe në filozofinë e veprimtarisë policore gjatë viteve të fundit.[696] "Këshilli Lokal për Parandalim" është një nga "mjetet" më të njohura për zhvillimin dhe ndërtimin e konceptit Puna policore në bashkësi, veçanërisht në vetëqeverisjen lokale.[697]

Fatkeqësitë natyrore gjithashtu paraqiten si faktor shtytës të cilët ndikojnë në paraqitjen e migracionit dhe më pas edhe rezikun për paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore. Fatkeqësit natyrore siç janë tërmetet, vullkanet, vërshimet, ndryshimet klimatike, valët e nxehta dhe të thata

[694] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.156

[695] https://www.undp.org/content/undp/en/home/blog/2017/safe-migration-in-a-world-on-the-move.html, të datës 09.09.2020, ora 13:41

[696] Xhukleski, Goce. Racaj Muhamet."Hyrje në kriminalistikë". Shkup, 2012, fq.252

[697] https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/CE&C%20STRATEGY_MK.pdf, të datës 14.09.2020, ora 22:23

e bëjnë jetën të pamundur për njerëzit që jetojnë sidomos grate dhe fëmijët dhe kështu kemi një detyrim të largimit të njerëzve nga këto zona drejt zonave me kushte për jetesë. "Në këtë drejtim, mjafton të përmenden numrin e madh të viktimave nga uragani Katrina, numrin e madh të viktimave të Tsunamit në Indonezi, numrin e viktimave të vërshimeve dhe përmbytjeve në Bangladesh dhe Indi. Vetëm nga tërmeti i vitit 2005 në Pakistan përllogariten rreth 40 mijë viktima në njerëz. Një ndër rastet më të reja të viktimizimit të njerëzve me përmasa të mëdha është edhe tërmeti dhe cunami që ndodhi në muajin mars të vitit 2011 në Fokushima të Japonisë, i cili shkaktoi edhe shpërthimin në centralin atomik dhe rriti nivelin e radioaktivitetit në përmasa katastrofike për popullatën e regjionit ku ndodhi kjo tragjedi."[698] Përsëri në këto situara shfrytëzues të rasteve të tilla janë trafikantët që kërkojnë viktima të mundshëm sidomos më shpesh paraqiten gratë dhe fëmitë e pambrojtur.

1.2. Faktorët tërheqës (nxitës)

Përveç faktorëve që e shtyjnë individin të viktimizohet nga vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore që ishin faktorë objektiv, ekzistojnë edhe faktorë tërheqës që ndikojnë personin të pranoj bashkëpunim, oferta për punë dhe lehtësime të ndryshme gjatë procesit të migracionit si dhe adaptimin dhe plotësimin e nevojave në shtetet e origjinës. Si faktorë tërheqës llogariten fitimi i lartë dhe risku i ulët si të trafikantëve po ashtu edhe të viktimave, kërkesa e tregut botëror sidomos ajo me qëllim të prostitucionit dhe liberalizimi i vizave për disa shtete sidomos për vendin tonë, faktori tjetër me rëndësi është ajo i mjeteve të komunikimit publik, elektronik dhe rrjetet sociale si dhe faktorë të tjerë.

1.2.1. Fitimi i lartë dhe risku i ulët

Fitimi i lartë dhe risku i ulët nënkupton që kemi të bëjmë për një veprimtari e cila është shumë fitimprurëse kurse rreziku i saj për tu zbuluar dhe sanskionuar është shumë e ulët, si për vet trafikantët e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, po ashtu edhe për viktimat e tyre. Trafikimi me qenie njerëzore llogaritet të jetë një veprimtari aktivitetet më profitabile menjëherë pas veprës penale të trafikimit me armë dhe me substanca narkotike. Fitim prurësia e kësaj veprimtarie kriminale, pra, të trafikimit me qenie njerëzore nënkupton të ardhurat që vijnë nga realizimi I kësaj vepre penale siç janë shfrytëzimi dhe abuzimi i viktimave të trafikimit nga ana e trafikantëve për qëllime të ndryshme si: prostitucioni, puna e detyruar, bredhja dhe lëmosha e organizuar, trafikimi i organeve, me qëllim të kryerjes së krimeve etj., të cilët në mënyrë permanente dhe për një periudhë kohore shumë të gjatë përfitojnë materialisht nga ofrimi i shërbimeve të viktimave. Trafikimi me qenie njerëzore sidomos me qëllim të prostitucionit është një veprimtari e kundërligjshme por me fitim të madh të trafikantëve të cilët i shesin dhe i shfrtëzojnë duke fituar nga puna e viktimave si prostitute përmes ofrimit të shërbimeve seksuale. Kërkesa permanente e trafikimit dhe shfrytëzimit të viktimave për prostitucion është në rritje përshkak se ekzistojnë zbrazëtira ligjore duke i ndihmuar që trafikantët të marrin dënime minimale ose dënime formale në krahasim me vepra tjera penale të nivelit më të ulët sesa trafikimi me qenie njerëzore përshkak se ende nuk kemi mekanizma të sotisfikuara dhe të mirëfillta për luftimin dhe parandalimin e saj. Rëndësia e një qasjeje serioze të kësaj dukurie është edhe ajo se sipas vlerësimeve se trafikimi me qenie njerëzore është një krim i organizuar dhe për shkak të natyrës së saj nacionale po edhe ndërkufitare ato i shkelin legjislacionet e shumë vendeve në të njëjtën

[698] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.115

kohë dhe që grupet e krimit të organizuar janë duke dhënë rëndësi kësaj veprimtarie për shkak të fitimeve shumë maramendëse dhe kjo veprimtari shënon rritje permanente çdo vit. Këto të ardhura forcojnë rrjetet kriminale dhe kanë një ndikim të rëndësishëm negativ afatgjatë në ekonominë e Evropës.[699] Për mosdënimin adekuat dhe të merituar të trafikantëve përveç më të njohur të mjetit të korrupcionit, këtu vlen të ceket se për mos dënimin e trafikantëve ndikon edhe kanosja e trafikantëve dhe mosparaqitja e viktimave duke marë parasysh se kanë hyrë në mënyrë të paligjshme kufirin shtetëror, domethënë në shtetin e destinacionit ata janë duke qëndruar ilegalisht dhe puna e tyre si prostitute është ilegale dhe vepër e viktimave, pra kjo e zvogëlon rrezikun kurse anën tjetër e rrit fitimin nga kjo veprimtari të kundërligjshme. Përveç fitimit të lartë ky lloj i kriminalitetit shënon rritje permanente në nivel botëror për shkak të rregullimeve të ndryshme ligjore, prezenca e korrupcionit, vakumeve ligjore për luftimin e saj dhe në fund të mosdënimit adekuat dhe serioz të trafikantëve ku shpesh kemi dënime minimale ose kualifikohen për vepra tjera të rrezikshmërisë më të ulët që nënkupton se risku i dënimit ty tyre është i ulët. Në përputhje me rrethanat, tregtarët migrantë janë njerëz që punojnë në shumë vende, nga agjencionet e udhëtimit legal të cilët kontrollohen nga grupet e krimit të organizuar dhe trafikantët të cilët përfitojnë nga migrimi i të tjerëve, pavarësisht nëse janë të ligjshëm apo jo. Agjencionet e tilla ofrojnë edhe ndërmjetësimin në sigurimin për gjetjen e punëve të ndryshme në fabrika, plantazhe etj në shtetet e destinacionit. Përveç komisionit që ata marrin nga punëdhënësit që kërkojnë punëtor të pakualifikuar, këto agjenci përfitojnë të ardhura të dyfishta duke ngarkuar në pagesa të rënda për punëtorët përmes kanosjes dhe të cilët janë viktima të padrejtësive, mashtrimeve apo dhunës gjatë punës së tyre. Pra, rrjeti i krimit të organizuar me qëllimit të fitim të lartë dhe riskut të ulët të zbulimit të tyre shpesh trafikantët janë të punësuar nëpër agjencione të ndryshme turistike legale apo ilegale dhe të cilët rrjetin e tyre e kanë deri tek nëupunësit ndërkufitar si bashkëpuntor të cilët e lehtësojnë kalimin e personave të cilët kontrabandohet ose trafikohen. Pra, sot procedurat e rënda për marrje të vizave në shtete të ndryshme dhe për shkak të mundësive të zvogëluara të migracionit legal, kontrabanduesit dhe trafikantët e migrantëve sigurojnë që njerëzit migrojnë në mënyrë të paligjshme dhe të fitojnë para me çmime shumë të larta duke shfrytëzuar situatat e tyre.

Fitimi më i lartë nga trafikimi me qenie njerëzore ka të bëjë kur qëllimi është edhe marrja e organeve nga trupi i njeriut. Marrja e organeve nga trupi i një njeriu të lartë shpesh bëhet në bashkëpunim me spitale si dhe në bashkëpunim më mjek të kësaj fushe ku viktimat shpesh janë fëmij dhe persona tjerë të shëndosh të cilët skamja dhe varfëria e madhe ndikon që ata ti shesin organet e tyre në mënyrë vullnetare. Shumica e trafikimit të organeve bëhet në mënyrë ilegale, kurse shitësit kryesisht jetojnë në mjerim dhe varfëri, kështu që shëndeti i tyre rrezikohet ndjeshëm pasi organi shitet dhe jeta e tyre është në pyetje[700], dhe e cila është vështirë të zbulohet për shkak të marrëveshjeve paraprake mes trafikantëve dhe klientëve shitës dhe blerës të organeve. Pra, si ndërmjetësim në këtë vepër shpesh paraqiten grupet e krimit të organizuar të cilët viktimës japin shumë formale të hollave, kurse shitja është me dhjetëra ose qindar here më të mëdha. Pra, fitimet maramendëse të grupeve kriminale ndikojnë që trafikimi të jetë në rritje të vazhdueshme si vepër e rezikshme kriminale. Risku i ulët i zbulimit si dhe dënimet e ulëta për kontrabanduesit dhe trafikantët nga sistemi gjyqësor ndikojnë që në grupet e krimit të organizuar të jetë një veprimtari primare për kryerje. Pra, nga kjo mund të përfundohet se personat të cilat janë viktima të trafikimit përmes rëmbimit apo mashtrimit me qëllim të prostitucionit, lëmoshës, punës detyruar, heqja e

[699] https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/facilitation-of-illegal-immigration, të datës 14.09.2020, ora 18.38

[700] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.212

organeve, kryerjes së krimeve ose ndonjë qëllim tjetër përmes kryerjes së punëve të cilët u jepen viktimave organizatorët e grupeve kriminale fitojnë për aq kohë dhe sasi sa zgjat kohëzgjatja dhe puna e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

1.2.2. Kërkesa e tregut botëror dhe liberalizimi vizave për shtetasit e Republikës së Maqedoniut

Rritja e madhe e kërkesave permanente në vendet e destinacionit për punonjësit e seksit dhe abuzimeve të fuqisë punëtore, ose kryerjen e krimeve ose organizimin e lëmoshës janë faktor dominues të cilat kanë ndikim tek trafikimi me qenie njerëzore dhe janë si faktorë tërheqës së viktimave. Për shumë punëdhënës në shtetet e zhvilluara pra të destinacionit konvenon gjendja e vështirë ekonomike në vendet e origjinës, ndikimi i globalizimit dhe komunikimit të lehtë përmes rrjeteve komunikuese për gjetjen e fuqisë punëtore të cilëve do të paguhet edhe më lirë sesa për shtetasit e vet. Kjo ndikon në masë të madhe që vet njerëzit sa më lehtë të vendosin të hyjnë konktakt me persona të cilët do ta mundësojnë transferimin e tyre drejt vendeve të destinacionit dhe gjetjen e punës. Rritja e kërkesave për punëtore migrantë apo të vendit për prostitucion në vendet me ekonomi të zhvilluar sidomos në vendet perëndimore llogaritet si një faktorë shumë të rrëndësishëm tërheqës e cila ndikon që trafikantët që sa më shumë të koncentrohen në gjetjen e viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit. Në këtë drejtim pozita e Maqedonisë si shtet burimor për shtetasit e vet dhe tranzit për migrantët të cilët janë veç kalimtar nga territori i vet, paraqiten si viktima të trafikimit me qenie njerëzore drejt shteteve evopiane ku dominon ekonomia e zhvilluar sidomos drejt evropës perëndimore dhe qendrore janë të rrezikuar nga trafikantët sidomos me qëllim të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar, sidomos të miturit dhe fëmijët. Grupi i rrezikuar i fëmijëve zakonisht vijnë nga pakicat etnike të varfra dhe/ose të margjinalizuara dhe/ose familjet me burime të kufizuara dhe për këtë shkak janë të ekspozuar rrezikut nga familjet jofunksionale, njëprindërore, shumë-anëtarëshe, fëmijëve të prindërve të divorcuar dhe familjeve në të cilat është prezente dukuria soci-patologjike ku janë të përfshirë edhe vet ata.[701] Rezultatet e kërkimeve të këtilla empirike e veçmas kur kanë të bëjnë me abuzimin seksual të fëmijëve dhe të miturve vërtetojnë se si viktimat ashtu edhe rrethi familjar, turpërohen të pranojnë se kanë ndodhë këto veprime kriminale.[702] Në kushtet bashkëkohore të jetës është e njohur dukuria e trafikimit të grave me qëllim të prostitucionit dhe xhirimin e filmave pornografik, "sex trafficking".[703] Në vendet e destinacionit sidomos në vendet evropiane me ekonomi të zhvilluar fuqia punëtore vendase nuk janë të gatshëm dhe të disponueshëm për të punuar disa lloje të punës, si punë të ndyrë, të rrezikshme dhe të vështirë si p.sh.: puna në ndërtimtari, plantazhe, miniera etj. Kështu që edhe kjo ndikon në tregun botëror si nevojë e fuqisë punëtore nga shtetet më të varfëra ku dominon skamja dhe varfëria dhe të cilët paguhen edhe më pak se punëtorët vendas. Pra, plotësimin e shprazëtirave të disa sektorëve punëdhënësit janë të gatshëm të marrin punëtor edhe të cilët kanë hyrë ilegalisht në territorin e tyre dhe të cilët janë të gatshëm të punojnë çdo lloj pune vetëm për të siguruar ekzistencën e tyre.

[701] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.13


[702] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.190

[703] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.214

1.2.3. Faktori i mjeteve të komunikimit publik, elektronik dhe rrjetet sociale

Sot kur teknika dhe teknologjia ka arritur nivelin më të lartë të përsosshmëris së tyre njerëzit shumë leht si kurrë më parë mund të marrin informata të ndryshme për shtetet tjera në nivel botëror. Derisa zhvillimi i teknikës dhe tekonologjisë ka përparuar në masë të madhe në kuptimin pozitiv të saj dhe shërbimeve që ofron, në anën tjetër zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë sidomos në komunikimin publik, elektronik dhe rrjetet sociale ka ndikuar edhe në paraqitjen e shume veprave penale sidomos të trafikimit me qenie njerëzore. Konstatimet lidhur me ndikimin dhe rolin e mjeteve të komunikimit masiv në kriminalitet, janë të llojllojshme.[704] Mjetet e komunikimit publik, elektronik dhe rrjetet sociale mund të ndikojnë pozitivisht në formimin e personalitetit të njeriut nëse përmbajtja e tyre janë edukative, morale duke respektuar ligjet e shtetit dhe përkundrazi mund të ndikoj negativisht nëse përmbajtjet e tyre janë jomorale, ku kemi nxitje dhe propaganda në fusha të ndryshme të cilët ndikojnë negativisht tek njerëzit sidomos tek fëmit të cilët ende nuk janë të formuar bio-psiqikisht. Tregimet për kriminalitetin dhe interpretimi i tyre janë dhe kanë qenë gjithmonë një pjesë e rëndësishme e përmbajtjes së të gjitha mediave.[705] Posaçërisht, bëhet vërejtje për dominimin e programeve dhe shfaqjeve televizive në të cilat në mënyrë permanente prezentohet dhuna, jeta e lirë, prostitucioni, konsumimi i drogës dhe aktiviteteve të tjera destruktive dhe antisociale[706] dhe kështu nxiten aktivitetet kriminale tek popullata sidomos tek të rrinjtë. Mediat nuk japin një pamje "neutral" dhe "objektiv" të realitetit.[707] Në vijim do të paraqesim të dhënat statistikore të qytetarëve në lidhje me ate se sa i vizitojnë portalet, mediat dhe rrjetet sociale me përmbajtje kriminale.

Grafikoni nr.17 Pyetja nga anketa: A vizitoni ndonjëherë portale, media ose rrjete sociale me përmbajtje kriminale sipas moshës



Testi Chi-Square tregoi një ndryshim statistikisht të rëndësishëm (χ 2 = 205.959, df = 12, p = 0.000 <0.05) për vizitën e mediave sociale me aktivitete kriminale. Pra, anketuarit që aspak nuk vizitojnë

[704] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.263
[705] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.305
[706] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.265
[707] Kval. Mellbye. Tranoy. "Politika dhe Demokracia". Prishtinë, 2006, fq.107

tek mosha 18-29 është 5.50%, mosha 30-51 me 12.67% 32-61 me 13.50 dhe mbi 61 vjet me 2.42% që nënkupton se me rritjen e moshës ulet vizitat e dukurive kriminale në media për ate si kategori e rrezikuar e devijimit në një anë kurse në anën tjetër e marrjes më shumë informata për kriminalitetin janë të rrinjtë. Shumë pak është e shprehur personat që shumë i vizitojnë dukurit kriminale dhe ata janë shumica të rinjë sidomos mosha 18-19 vjet me 2.67% dhe mosha 30-51 me 2.58%.

Tabela nr.3 Pyetja nga anketa: A vizitoni ndonjëherë portale, media ose rrjete sociale me përmbajtje kriminale sipas gjinisë

		A vizitoni ndonjëherë portale, media ose rrjete sociale me përmbajtje të dukurive kriminale?					
		Aspak nuk vizitoj	Nuk e di	Pakës	Nganjëherë/rallë	Shumë	Total
Gjinia:	Mashkull	198	5	208	178	61	650
	Femer	211	2	225	107	5	550
Total		409	7	433	285	66	1200

Sa i takon gjinisë në lidhje me vizitën e dukurive kriminale në portale, media apo rrjete sociale me përgjigjen shumë dukshëm dominon gjinia mashkullore me 61 të anketuar kurse femra me 6 e cila është në pajtueshmëri me aspak nuk vizitoj ku dominon gjinia femërore me 211 anketuar kurse meshkujt janë afër me 198 të anketuar. Marur në përgjithësi edhe femrat edhe meshkujt janë visitor të këtyre dukurive në portale dhe rrjete sociale.

Sot, në të shumtën e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore, trafikantët dhe grupet kriminale trans-nacionale, gjithnjë e më shumë po i përdorin shërbimet e teknologjinë informatike, respektivisht internetin dhe shërbimet e tij on-line, për të rekrutuar viktimat e tyre nëpërmjet ofertave të punësimit, ofertave për martesa dhe dhomave të komunikimit (chat-rooms), apo për të reklamuar shërbimet e viktimave tashmë të rekrutuara në mënyrë tradicionale.[708] Sipas Europolit dhe policive të shteteve anëtare thuhet se, "Interneti dhe telefonat mobil, janë përdorur për ti rekrutuar viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, më se shumë sa ishte menduar fillimisht".[709] Dinamika e zhvillimit të teknologjisë komjuterike dhe shpejtësia e zgjerimit të aplikimit të përditshëm zbulojnë mundësi të reja për keqpërdorim apo forma të reja të paraqitjes së kriminalitetit kompjuterik[710], andaj edhe informimi i qytetarëve për rreziqet e mediave dhe portaleve të ndryshme do të ishte një preventive ndaj kësaj dukurie.

2. Fenomenologjia (Format dhe Llojet) dhe qëllimi i trafikimit me qenie njerëzore

Me sjelljet kriminale rrezikohen, cenohen ose asgjësohen vlerat individuale dhe shoqërore.[711] Gjatë historisë zhvillimi i krimit të trafikimit me qenie njerëzore është e lidhur ngushtë me shumë fenomene tjera duke filluar që nga ekonomija e dobët, papunësia, skamja dhe varfëria e shoqërisë në një shtet e deri tek paraqitja e formave dhe llojeve ttë saj me të cilën mirret fenomenologjia e trafikimit me qenie njerëzore. Sipas të dhënave të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), 700,000 deri në 4,000,000 njerëz çdo vit, janë viktima të trafikimit njerëzor që

[708] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.108
[709] Po aty, fq.109
[710] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.288
[711] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.20

shfrytëzohen në punë të paligjshme që ne mund t'i kategorizojmë, siç është punësimi në organizata kriminale, veçanërisht me qëllim të abuzimit seksual, puna e lirë, adoptim ilegal, pedofilia, pornografi, seks turizmi, shërbyes në shtëpi, kujdesi i fëmijëve, kujdesi i të moshuarve, infermierist, lypës, martesa të detyruara, trafikimi i organeve, puna në organizata kriminale.[712] Sipas KPM-së (neni 122 paragrafi 22), viktima e veprës penale është çdo person që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtimin fizik ose psikik, dëmin emocional, humbjen materiale ose dëmtim tjetër ose rrezikim të të drejtave themelore të njeriut si pasojë e kryerjes së veprës penale, definicion i cili konsiderohet edhe si nocion më i ngushtë për viktimën.[713] Pra, nga kjo shihet se viktima paraqitet si subjekt pasiv i një aktiviteti kriminal , por si subjekt pasiv mund të paraqitet edhe i dëmtuari që ka pësuar ndonjë dëm material nga kryerja e nje vepre penale dhe e cila dallon nga viktima si subjekt.

Trafikimi me qenie njerëzore viteve të fundit prap ka marë një hov të madh sidomos të grave duke pas parasysh sot se me zhvillimi e teknikës dhe teknologjisë janë zhvilluar edhe metoda të reja të kryerjes së trafikimit sidomos sistemi elektronik dhe kompjuterik veçanërisht zhvillim të madh kemi në industrinë e seksit në internet dhe pornografisë e fëmijëve. Sikurse tek televizori poashtu edhe nëpërmjet internetit shumë të mitur, m shpejt mund të vijnë deri te shikimi i skenave të ndryshme filmike me përmbajtje negative për ta, qofshin ato të zhanreve kriminalistike apo të zhanreve pornografike.[714] Trafikimi i qënieve njerëzore kontrollohet nga organizatat ndërkombëtare kriminale, dhe organizatat lokale janë nën kontraktorët e këtyre organizatave ndërkombëtare.[715] Trafikimi me qënie njerëzore konsiderohet si një nga tre aktivitetet më fitimprurëse kriminale, pas trafikut me droge dhe trafikimit të paligjshëm të armëve.[716] Trafıkantët e njerëzve synojnë të abuzojë me viktimën për sa i përket abuzimit seksual, punës së detyruar, ta përdorëmë si skllav, të detyrojë të kryej çdo shërbim tjetër dhe të vjedh organet e tij.[717] Trafikimi i qënieve njerëzore përfshin veprimtarinë kriminale në lidhje me rekrutimin, detyrimin, transportin, blerjen dhe shitjen, transferimin dhe fshehjen e personave për shfrytëzimin e tyre seksual ose ekonomik.[718] Pra, me veprat penale të grupeve të krimit të organizuar cenohen dhe dëmtohen të mirat individuale, shoqërore dhe shtetërore. Të mira të individit janë: jeta, pasuria, nderi, prestigji e të tjerë, ndërkaq të mira të bashkësisë shoqërore janë: rregullimi shoqëror dhe shtetëror, siguria e shtetit e të tjerë.[719] Me rëndësi është të ceket se elementi kryesor i trafikimit të qenieve njerëzore është shfrytëzimi i personitme format e saja, kurse vepra penale ndryshon dhe varet nga qëllimi dhe identiteti i viktimave. Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, janë si meshkujt e moshave të ndryshme të cilët më së shpeshti janë viktima të punës së detyruar, femrat që janë viktima të prostitucionit dhe fëmijët për kërkim lëmoshe apo për shitje te familjet pa fëmijë.[720] Format themelore të krimit të organizuar janë: trafikimi me narkotikë, terrorizmi,

[712] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.353
[713] Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018, fq.85
[714] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.139
[715] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.343
[716] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.9
[717] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.342
[718] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.212
[719] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.20
[720] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.109

korrupcioni, pastrimi i parave, trafikimi me qenie njerëzore, reketi, kriminaliteti kompjuterik, trafikimi me armë dhe materialit nuklear.[721]

Viteve të fundit format ose qëllimi i trafikimit me qenie njerëzore në të gjithë botën është zgjeruar në disa drejtime ku si qëllime apo forma më të shpeshta paraqiten:trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit, trafikimi me qëllim të lëmoshës, trafikimi me qëllim të kryerjes së krimeve, trafikimi me qëllim të punës së detyruar si dhe për qëllime tjera. Si formë e cila paraqitet më shpesh dhe e cila është në kërkesë të tregut botëror është trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit. Në vendet e Ballkanit, siç u tha tashmë, krimi i organizuar është veçanërisht i dukshëm në fushat e trafikimit të paligjshëm të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore dhe migracionit të paligjshëm, si dhe në sferën ekonomike dhe financiare, përhapjen e armëve konvencionale dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit masovik.[722] Në shumicën e dokumenteve ndërkombëtare që merren me problemin e trafikimit të qënieve njerëzore, theks i veçantë i është kushtuar trafikimit të grave dhe fëmijëve, sepse gratë dhe fëmijët përbëjnë mbi 90% nga gjitha viktimat e identifikuara.[723]

"Institucionet qeveritare po ashtu raportojnë për një rritje të vëllimit të emigrantëve pa dokumente dhe të huaj në Republikën e Maqedonisë, kategori e cila më shpesh është e prekshme ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Midis tyre janë veçanërisht të dukshme raste të të miturve pashoqërim, një kategori të cilën institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare konsiderojnë teje të prekur dhe me rrezik të lartë për trafikimin e qenieve njerëzore."[724] Në vendet e pazhvilluara dhe vendet në tranzicion, shkaqet janë në: forma të ndryshme të situatave anomike, deorganizimi shoqëror dhe shfaqja e "ekonomisë gri".[725] Republika e Maqedonisë paraqitet si shtet burimi, tranzit dhe si vend i destinacionit për meshkuj, femra dhe fëmijë, të cilët janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore për qëllimet e lartëpërmendura si lloje apo forma të trafikimit ose më mirë të thuhet si qëllim i shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Sipas llojit të shfrytëzimit më e shprehur është shfrytëzimi seksual, dyfishiseksual I shfrytëzimit dhe shfrytëzimi për punë, martesat e detyruara me persona të mitur nga komuniteti etnik rom të rekrutuar në Maqedon, kurse shfrytëzimi në vendet e BE-së.[726] "Gjatë dy dekadave të fundit, trazirat socio-ekonomike dhe politike në rajon kanë çuar në një rritje të konsiderueshme të migrimit të paligjshëm nga dhe përmes Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian (BE). Bashkimi harton një politikë me qëllim:

(a) sigurimin e heqjes së çdo kontrolli mbi personat, të çfarëdo shtetësie qofshin, kur kalojnë kufijtë e brendshëm;

(b) realizimin e kontrolleve mbi personat dhe vëzhgimin efikas të kalimit në kufijtë e jashtëm;

(c) futjen graduale të një sistemi menaxhimi të integruar për kufijtë e jashtëm.[727]

---

[721] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.199

[722] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq. 127

[723] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.12

[724] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.39

[725] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.199

[726] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.4

[727] Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila është shpallur në Strasburg, më 12 dhjetor 2007 nga Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni (GZ C 303, 14.12.2007, neni 77, paragrafi 1, pikat a, b, dhe c

Kjo rritje dhe lëvizjet e njerëzve që rrjedhin prej saj kanë kontribuar gjithashtu në rritjen e dukshmërisë së trafikimit njerëzor nga, në dhe rreth rajonit"[728], ku bën pjesë edhe Republika e Maedonisë dhe kështu përmes migrimit të paligjshëm kemi edhe trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabanën me migrantë. Sipas llojit të të shfrytëzimit më shumë është shprehur shfrytëzimi seksual, shfrytëzimi për punë, martesat e detyruara me persona të mitur nga komuniteti etnik rom të rekrutuar në Maqedoni kurse të shfrytëzuara në vendet e UE-an.[729]

2.1. Trafikimi i femrave me qëllim të prostitucionit

Trafikimi i femrave apo grave ose ndryshe emërtohet edhe si skllavëria e bardh nuk është një fenomen i ri por ajo daton që nga kohërat e lashta e cila në forma më të sotisfikuara vazhdon edhe në ditët e sodit. Në përghithësi pjesa dërmuese e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore janë gra dhe vajza sidomos të moshës se re, të cilët janë të mashtruara në vendet e destinacionit nga trafikantët përmes punëdhënësve fiktiv ose të rremë përmes premtimeve për punë si kamariere, pastruese, përkujdesje dhe shërbime shtëpiake. Gjatë historisë trafikimi me qenie njerëzore varësish nga situata të ndryshme botërore: luftërat, papunësia, varfëria, dhuna në periudha dhe vende të ndryshme është paraqitur në forma, lloje, sasi, vëllim dhe dinamika të ndryshme. Kolapsi ekonomik që pasoi me tranzicionin nga socializmi në kapitalizëm dhe demokracinë parlamentare, si dhe iluzionet e një jete të mirë në anën tjetër të ish-"Perdes së Hekurt" për të cilën ata nuk dinin asgjë, ka ndikuar që shumë njerëz, veçanërisht gra dhe vajza, të shkonin në Evropën Perëndimore[730], shumica e të cilëve janë shfrytëzuar për qëllime të ndryshme të trafikimit, sidomos në sektorin e prostitucionit. Prostitucioni paraqet një sjellje devijante, negative shoqërore e cila çrregullon funksionimin normal të raporteve në mes gjinive në shoqëri dhe si e tillë është e dëmshme dhe e papranueshme[731], e cila llogaritet si forma më e shprehur e trafikimit. Viktimat e Evropës Juglindore punojnë me të vërtetë në industrinë e seksit në Azinë Juglindore, afrikanët përdoren në industrinë e seksit evropian, Evropianët e Lindjes nga ana tjetër, janë shumë të kërkuara dhe të përdorura në industrinë e seksit në Amerikën Qendrore.[732]

Si rezultat i rritjes së vlerave dhe kërkesave të tregut botëror, grate, vajzat e reja dhe fëmijët si grup më i cenueshëm i shoqërisë janë në rrezik më të lartë të viktimizimit si në jetën e tyre të përditshme ashtu edhe në proceset kritike siç është procesi i migracionit, sepse shumë shtete po ashtu edhe Republika e Maqedonisë si shtet i tranzicionit gradualisht e humbin kontrollin dhe funksionin e tyre për mbrojtjen e grupeve të rrezikuara. Tek na sidomos para liberalizimit të vizave, viktimat e trafikimit me qenie njerzore me qëllim të shfytëzimit seksual ose prostitucionit të detyruar, shumica dërmuese vijnë nga shtetet e rajonit si Serbia, Shqipëria, Kosova Bulgaria, si edhe nga shtetet edhe më të largëta si uUkraina, Bosnja dhe Hercegovina, Moldavia, Romania. Në këto vende, niveli i ulët i arsimimit dhe niveli i ulët i mundësive për punësim të vendit i bëjnë njerëzit më të lehtë dhe objektiva të cenueshëm për trafikantët.[733] Raporti i të Drejtave të Njeriut i Stejt Departamentit tregon se në çdo kohë në Maqedoni (në Veleshtë, Tetovë dhe Gostivar) ndërmjet 2,400 dhe 2,600 gra po qëndrojnë për t'u transferuar në vendet e Evropës Perëndimore,

[728] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.22
[729] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.4
[730] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.10
[731] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.162
[732] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 201, fq.358
[733] Po aty, fq.354

ose vazhdojnë të shfrytëzohen në mënyra të ndryshme, më shpesh seksualisht në bare lokale dhe bordelet.[734] Faktori kryesor që mbështet faktin që gratë dhe vajzat janë shënjestra kryesore e trafikantëve njerëzorë është se varfëria dhe pabarazia e shkaktuar nga shumë faktorë kanë efekte shumë më negative të dëshpërimit dhe zhgënjimi ndaj këtyre grupeve për shkak të diskriminimit të bazuar në gjini. Ofertat e ofruara në shtetet e destinacionit në situate të tilla pranohen lehtë dhe shpejt pa mos pasur dijeni dhe informata se janë të mashtruara me vendet e tyre të punës. Vetëm një përqindje shumë e vogël e këtyre grave mund të kenë pasur dijeni se do të punojnë në sektorin e prostitucionit, por jo edhe për kushtet e punës të cilët shpesh janë fatale për viktimat. Vet viktimat e trafikimit me qenie njerëzore shpesh nuk janë të vetëdijshëm se janë viktima, mendojnë se janë vetëm fajtor për gjithçka që ka ndodhur, ndjejnë turp të madh për shkak të punës që është dashtë të ushtrojnë dhe nuk kanë dijeni se mund të kërkojnë ndihmë.[735] Mos pasja e dijenisë për të kërkuar ndihmë nga organet kompetente edhe më shumë e komplikon organet shtetërore të luftojnë dhe parandalojnë këto krime me sukses.

Luftërat lokale, konfliktet politike, konfliktet fetare, aktivitetet terroriste, aksionet vetëvrasëse, skamja dhe papunësia e madhe, për çdo ditë shtyjnë me qindar mijëra njerëz që të marrin rrugën e largimit nga vatrat e tilla dhe të kërkojnë kushte më stabile dhe më të mira të jetesës në vende apo regjione të tjera[736] dhe kështu kjo kategori e popullatës të cilët janë të rrezikuar nga këto faktorë janë më afër viktimizimit nga grupet e krimit të organizuar sidomos nga vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të prostitucionit. Pra, trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit në masë të madhe ka të bëjë me gjininë femrore (gra dhe vajza të reja) si viktimë e trafikimit e cila më tutje shfrytëzohet për shërbime seksuale me qëllim të fitimit material nga ana e individëve ose grupeve kriminale. Sidomos tani në kohën e një dinamike të jetës shoqërore kur dominon kriza ekonomike në shumë shtete përmes shfrytëzimit seskual të femrave dhe grave kjo formë e trafikimit me qenie njerëzore ka të bëj me shfrytëzimin e viktimave të mundshëm përmes shitjes së viktimave, prostitucionit apo prostitucionit të detyruar duke aplikuar masa të shtrëngimit siç janë: përdorimi i forcës, shtrëngimit, kërcënimit apo forma tjera të detyrimit të viktimës për ushtrimin e prostitucionit. Trafikimi i femrave zakonisht është i lidhur me detyrimin e tyre për prostitucion dhe veprime tjera në dëm të tyre me anë të mashtrimit, kërcënimit, rrëmbimit, dhunimit, keqtrajtimit, kufizimit të lirisë së lëvizjes me qëllim të shfrytëzimit.[737]

Kur bëhet fjalë për trafikimin e qenieve njerëzore, kur njerëzit detyrohen të bëjnë prostitucion, liritë e tyre seksuale eliminohen.[738] Gjatë periudhave të krizës pëson edhe kriza në familje, për shkak të vështirësive të mëdha social-ekonomike dhe prishja e marëdhënieve në mes të anëtarëve.[739] Personat që gjenden në këto kushte janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të dhunës (psikologjike, fizike, seksuale), me qëllim që të sigurojnë kontroll të plotë, të thyejnë rezistencën e tyre dhe të sigurojnë ndëgjueshmëri ndaj trafikantëve me qenie njerëzore. Pra, prostitucioni i trafikimit me qenie njerëzore dallohet nga prostitucioni vullnetar dhe ndërmjetësimit në prostitucion përmes elementeve kyçe të dallimit që ka të bëj me ose jo përdorimin e aktiviteteve siç janë rëmbimi, kanosja, bartja prej një vendi në një vend tjetër, furnizim, pritje përmes kanosjes,

[734] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, vep. e cit., fq.2
[735] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.16
[736] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.109
[737] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.103
[738] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.324
[739] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.16

shtypjes, përdorimit të dhunës, mashtrim dhe abuzime tjera. Pra, tek trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit kemi përdorimin e kanosjes, dhunës, abuzimin e ndikimit ndaj viktimës, mashtrimit, derisa tek prostitucioni këto pothuajse aspak nuk ekzistojnë.

Është e ditur se trafikimi i femrave dhe grave është shkelje e të drejtave themelore të njeriut, ngase me trafikimin në mënyrë të vrazhdë atakohet liria dhe të drejtat e njeriut, në këtë rast të femrës.[740] Kjo do të thotë që liritë personale dhe të drejtat personale që gëzojnë çdo individ, pra qytetari, paraqiten si një objekt mbrojtjeje në këto krime.[741] Kur flasim për gra që përfundojnë në zinxhirin e trafikimit njerëzor, publiku për fat të keq tregon një tendencë për të vlerësuar nëse ajo "e donte atë", "e dinte se çfarë do të bënte", nëse ajo ishte "naive dhe budalla".[742] Zbulimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit është e vështirë sidomos në vendet ku është e legalizuar prostitucioni. Pra, grupet e krimit të organizuar që meren me krimin e trafikimit me qenie njerëzore në këto situata ku prostitucioni është i legalizuar ja arrijnë qëllimin që veprimet e tyre kriminale ti fshehin në kuadër të veprmtarisë legale-jurudike, pra në kuadër të prostitucionit si një vepimtari e lejueshme. Në këto shtete veprimtaria e organeve përgjegjëse për luftimin e trafikimit janë të orientuara kundër viktimave sesa kundër kryerësve të saj. Viktimat me vet arritjen e tyre në shtetet e destinacionit arrijnë të zhyten në borxh ndaj trafikantëve e cila ndikon që ata të punojnë kundër dëshirës së tyre dhe pasuria e cila fitohet nga puna e kryer të konfiskohet nga grupet e krimit të organizuar. Sasia e borxhit të viktimave migrantë në shtetet e destinacionit janë aq të larta sa që me vite të tëra duhet punuar që të paguhet kontrabanduesve, agjencive fiktive turistike si dhe punëdhënësit. Motivet apo arsyet më të shpeshta që viktimat i përmendin gjatë intervistave pse kanë marrë rrugën e trafikimit janë dëshira dhe premtimi se do të punësohen, në 76.09% të rasteve, "ofertat" për martesë, në 2.02% të rasteve, dëshira për udhëtime turistike dhe zbavitje, në 9.31% të rasteve dhe diku afro 13% të rasteve janë për arsye të tjera ose arsyet janë të panjohura.[743] Përdorimi i internetit nga grupet e organizuara kriminale me qëllim të rekrutimit të viktimave të tyre, nuk është një formë e re e trafikimit, por thjeshtë një armë e re në duar të trafikantëve.[744] Viktimat të cilët njëherë kanë rënë në kurth të trafikantëve apo të rrjeteve kriminale, shumë vështirë e kanë të lirohen nga kjo gjendje.[745] Kontrolli mbi viktimat realizohet përmes arrestit shtëpiak, duke i marrë dokumentet personale dhe përmes kërcënimit, presionit, kanosjes dhe përdorimit të dhunës dhe mjeteve narkotike, po edhe shpërnguljet e shpeshta të viktimave që të humbet çdo kontakt apo gjurmë dhe ato shfrytëzohen në sektorin e prostitucionit. Forca dhe kërcënimi mund të zbatohen drejtpërdrejt tek subjekti pasiv ose tek një person i afërt me të.[746] Viktimat shpesh rrihen dhe dhunohen, kufizohen në lëvizje, mbahen në izolim për periudha të gjata, privohen nga ushqimi dhe uji, drogohen dhe torturohen me gjësende të mprehta dhe cigare, por të gjitha me qëllim të nënshtrimit.[747] Kjo problematikë e mosdallimit të tyre në praktikë dhe shfrytëzimin e sistemit juridik të shteteve tranzitit nga ana e grupeve të krimit të organizuar drejt vendeve ku prostitucioni është e legalizuar për mosdënimin e trafikantëve e rrit edhe më shumë numrin e viktimave. Prandaj, kundër këtij fenomeni duhet që gjitha shtetet që

[740] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.165
[741] Petrović, Borislav. Jovasević, Dragan. Perhatović, Amila. "Krivično Pravo II ", Saučesnistvo, krivične sankcije i posebni dio. Sarajevo, 2016, fq.337
[742] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.16
[743] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.105
[744] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.109
[745] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.106
[746] Petrović, Borislav. Jovasević, Dragan. Perhatović, Amila. "Krivično Pravo II ", Saučesnistvo, krivične sankcije i posebni dio. Sarajevo, 2016, fq.392
[747] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.17

prostitucionin mos të legalizojnë përshkak se ajo është veç në dobi të trafikantëve dhe të mundohen përmes bashkëpunimit dhe dënimeve më të rrepta të luftojnë këtë dukuri negative shoqërore.

Zbulimi dhe luftimi i trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit në praktikë është shumë e rëndë dhe e komplikuar sepse ka raste edhe kur femrat në fakt nuk janë viktima të vërteta të trafikimit njerëzor, por tregojnë veten e tyre sikur janë me qëllim që të ikin nga përgjegjësia dhe prap të vazhdojnë punën e tyre si prostitute. Por, ka raste kur viktimat e vërtetë për shumë shkaqe duke u bazuar në procedurën e komplikuar dhe të rëndë të identifikimit të gjykohen dhe të burgosen si kryerëse të veprave penale, por në fakt ata janë viktimat e vërtet dhe sipas parimit të mosdënimit nuk duhet të gjykohen dhe dënohen, përkundrazi dënimi dhe burgimi i tyre rezulton me drejtën e kompensimit të dëmit të shkaktuar. Për këto raste aktet ndërkombëtare dhe nacionale e njohin të drejtën e kompensimit të dëmit të të dënuarit pa arye ose të privuar na liria pa bazë juridike. Kushtetuta e RM-së neni 13 paragr.2 dhe LPP (n.11), duke u mbështetur në nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të drejtat e njeriut dhe në dokumente të tjera ndërkombëtare, parashihin se personi të cilit në mënyrë kundërligjore i është kufizuar liria, është paraburgosur ose joligjërisht është gjykuar (dënuar), ka të drejtë në kompenzim dëmi nga mjetet buxhetore, se ka të drejtë të rehabilitohet, si dhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj.[748] Prezentimi i rrejshëm i tyre si viktima të trafikimit me qenie njerëzore u ikin edhe deportit eventual që mund të bëhen ndaj tyre dhe ti dërgojnë drejt vendlindjes dhe gjithashtu atyre u mundësohet që nga ana e shtetit ti jepet eedhe dëmshpërblim eventual duke luajtur rolin e viktimës së trafikimit me qenie njerëzore.


Në rrjetin global të trafikimit të qenieve njerëzore, Maqedonia kryesisht është një vend tranzit, megjithëse në një raport të fundit nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Maqedonia shfaqet edhe në listën e vendeve që konsiderohen si destinacion, si dhe vend nga të cilat burojnë viktimat e trafikimit me qenie njerëzore njerëzor.[749] Femrat dhe vajzat e reja në Maqedoni janë objekt i trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim eksploatimit seksual dhe shfytëzimit të tyre nga ana e trafikantëve nëpër objekte hotelerike, bare dhe klube të natës në vend por edhe jashta saj. Kështu, për shembull, gratë e detyruara në prostitucion duhet të kenë marrëdhënie me një numër të madh klientësh çdo ditë, shpesh pa mbrojtje, ndërsa trafikantët shpesh përdorin drogë për t'i kontrolluar ato.[750] Në vijimë do të paraqesim mendimin e qytetarëve të vendit në lidhje me ate se kush janë më shumë viktima të trafikimit me qenie njerëzore sipas gjinisë dhe statusit social të anketuarve.

Grafikoni nr.18 Pyetja nga anketa: Sipas jush kush janë më shumë viktima të trafikimit me qenie njerëzore sipas gjinisë

[748] Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë". Tetovë, 2007, fq.63

[749] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, fq.2

[750] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.16



Grafikoni në lidhje me me pyetjen se kush janë më shumë viktima nuk ka ndonjë dallim të madh dhe mund të llogaritet se gjinia femërore dhe mashkullore në lidhje me viktimat femra edhe dominon si viktima më shumë të shprehur dhe janë pothuajse të nagjajshëm sidomos meshkujt me 24.67 mendojnë se janë femrat dhe gjinia femërore mendojnë se femrat janë viktima të trafikimit me 17.83%.

Tabela nr.4 Pyetja nga anketa: Sipas jush kush janë më shumë viktima të trafikimit me qenie njerëzore sipas statusit social

		Sipas jush kush janë më shumë viktima të trafikimit me qenie njerëzore?					Gjithsejt
		Fëmitë	Vajzat e reja	Femrat	Meshkujt djemt e ri	Nuk e di	
Statusi social:	Punësuar në administratë shtetërore	77	70	108	11	0	266
	Pa punësuar	79	65	146	14	3	307
	Punëtor sezonal	50	69	114	19	0	252
	Student	0	0	2	0	0	2
	Punëtore krahu	116	82	140	34	1	373
Gjithsejt		322	286	510	78	4	1200

Nga tabela e paraqitur supas statusit social ndaj pyetjes se kush janë më shumë viktima të trafikimit me njerëz nga të anketuarit dukshëm mendojnë se viktima janë të gjinisë femërore sidomos femra 510 të anketuar dhe vajza të reja 286 të anketuar më pas vijon fëmitë si viktima me 322 të anketuar kurse gjinisë mashkullore si viktima të trafikimit mendojnë vetëm 78 të anketuar disomos për meshkujt dhe djemt e ri.

2.2. Trafikimi i femrave dhe fëmijëve me qëllim të lëmoshës

Femrat dhe fëmijët si kategori më e cenueshme e shoqërisë të cilat përveç trafikimit të tyre me qëllim të prostitucionit ata shfrytëzohen edhe me qëllim të lëmoshës ndaj të cilëve përveç rregullimit juridik të brendshëm rëndësi të veçant i jepet edhe në kuadër të akteve dhe konventave ndërkombëtare. Kjo kategori e shoqërisë në veçanti është e paraparë edhe me paragrafin a) të nenin 2 në pjesën e deklarimit të qëllimit të Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve si plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar ku ceket se qëllimi i Protokolit është "të parandalojë dhe të luftojë trafikun ndërkombëtar të personave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve".[751] Në kuadër të këtij lloji të trafikimit raste më të rënda janë kur viktimat janë fëmijë. Me trafikim të fëmijëve nënkuptojmë rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pranimin e fëmijëve me qëllim të shfrytëzimit dhe abuzimit, qoftë brenda, qoftë jashtë shtetit.[752] Fëmijët nuk duhet dalluar nga të rriturit vetëm në bazë të moshës që e kanë por duhet të miret parasysh edhe zvillimi i tyre psiqik dhe fizik e cila tek fëmijët ende nuk është formësuar dhe kështu fëmijët e prekur nga vepra penale të llojeve të ndryshme kanë pasoja më të mëdha në krahasim nga të rriturit. Në vend që të kontrollojnë fort lëvizjen dhe dhunën fizike, ata përdorin gjithnjë e më shumë kërcënime dhe shantazhe, shpesh duke përfshirë anëtarët e afërt të familjes[753], është një nga karakteristikat e viktimave të femrave dhe fëmijëve me qëllim të lëmoshës që përjetojnë dhunë.

Trafikantët e fëmijëve dhe femrave për krijimin e ekuilbrit të ofertës dhe kërkesës si dhe për rritjen e kërkesës së tregut bëjnë përpjekje nga më të ndryshmet sidomos përmes mashtrimeve dhe ofertave të rrejshme ndaj viktimave, me qëllim të vetëm që të riten përfitimet finansiare nga shumë vepra penale e në rastin konkret nga lëmosha. Në këto raste fëmijët dhe gratë largohen dhe kufizohet e drejta e lëvizjes dhe liritë elementare të tyre si nga aspekti i integritetit trupor po ashtu edhe psiqik duke e shfrytëzuar si mjet për përfitime nga lëmosha rrugëve të qyteteve të mëdha. Grupet kriminale që do ti shfrytëzojnë femrat dhe fëmijët për lëmoshë nuk i intereson mënyra se si është kryer trafikimi dhe në çfarë kushtesh por mënyra se si do të përfitojnë nga atë duke i organizuar që të kërkojnë lëmoshë dhe të pasurohen nga ajo veprimtari kriminale duke i shfrytëzuar viktimat në fjalë. Në këtë kontekst, krimi i trafikimit njerëzor zakonisht paraqitet si një fenomen që e mer parasysh gjinin dhe moshën e viktimave, përshkak se meshkujt janë relativisht të favorshëm në rastet kur nuk nuk plotësojnë kushtet ligjore për migracion dhe pajtohen për kontrabandë, kurse femrat janë të pafavorshëm në raste të mosplotësimit të kushteve për migracion legal dhe kështu shumë leht bien në duart e trafikantëve në çdo fazë të këtij procesi dhe bëhen viktima të veprës së trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të ndryshme, në rastin konkret me qëllim të lëmoshës. Rrezikimi i tyre kështu bëhet një pre e lehtë e organizatave kriminale, dhe kur ata bëhen të vetëdijshëm, zakonisht është tepër vonë të kthehen në një mënyrë jetës normale.[754]

Shkaqet dhe arsyet e shumta si papërvoja e fëmijëve, mungesa e arsimimit, varësia nga të rriturit dhe mundësitë e ulëta për ikje nga trafikantët e bëjnë më të lehtë trafikimin e fëmijëve në krahasim nga të rriturit. Fëmijët dhe femrat si shkak i viktimizimit të tyre nga trafikantët me qëllim të lëmoshës janë të llojeve të ndryshme ku në të shumtën e rasteve ceken: familjet e degraduara, familje me shumë anëtar ose në mungesë të një ose ty dy prindërve ku mungon dashuria dhe vëmendja ndaj fëmijëve, përdorimin e dhunës në familje sidomos ndaj femrave dhe fëmijëve

[751] Protokolli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000, neni 2, paragrafi a)
[752] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.107
[753] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.24
[754] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117

mosndjekja e arsimit, papunësia, varfëria dhe skamja dhe shumë shkaqe tjera. Migrantët, me një fjalë, e gjejnë veten në kushte të ndryshuara, sepse çdo ndryshim i papritur i mjedisit shoqëror ka një efekt negativ në personalitetin dhe shpesh shkakton çrregullime serioze në to.[755]

Shumë arsye mund të parashtrohen se pse fëmijët dhe femrat abuzohen shpesh në krimin e trafikimit njerëzor në krahasim nga të rriturit ku si arsye më të shpeshta llogariten: pafuqia natyrore e fëmijëve, mosrezistenca, më lehtë mund të kontrollohen, fëmijët që shfrytëzohen me qëllim prostitucioni janë me pak të rrezikshëm nga infektimi i sëmundjeve seksuale të transmetueshme kështu që rritet edhe kërkesa ndaj prostitucionit të fëmijëve, femrat dhe fëmijët gjatë lëmoshës më lehtë e kanë ta keqpërdorin humanitetin e njerëzve duke i ndihmuar ato dhe kështu dita ditës trafikimi i fëmijëve shënon rritje permanente. Pra, tek trafikimi me qenie njerëzore të femrave dhe fëmijëve kemi rrëmbimin, mashtrimin, kanosjen dhe në fund abuzimin apo shfrytëzimin e tyre si viktima për lëmoshë vetëm e vetëm në përfitimin e personave apo organizatave kriminale që e kryejnë këtë vepër penale. Në shumë raste sidomos në familjet problematike dhe ku dominon varfëria e madhe dhe skamja prindërit vet i shesin fëmijët e tyre trafikantëve për të siguruar ekzistencën e tyre dhe anëtarëve të tjerë. Shpesh, prindërit që përfshihen në trafikun fëmijeve të tyre shprehen se ata nuk kanë mundësi tjetër për të jetuar dhe bëjnë një zgjedhje që sipas tyre eshte më e mira, duke trafikuar fëmijët e tyre në vendet perëndimore për një të ardhme më të mirë.[756] Trafikimi e privon fëmijën viktimë nga ushtrimi i një game të gjerë të drejtash, përfshirë të drejtën për ruajtjen e identitetit të vet, të drejtën për arsimim, kujdes shëndetësor, pushim e kohë të lirë si dhe të drejtën për të mos rënë pre e torturave, apo trajtimeve mizore, çnjerzore e poshtëruese ose ndëshkimeve e që të mos i privohen liritë në mënyrë të paligjshme apo arbitrare.[757]

Organizimi i lëmoshës në botë po edhe në vendin tonë nga ana e krimit të organizuar dhe të trafikantëve organizohet dhe realizohet nëpër rrugët më të frekventuara të qyteteve, para qendrave të mëdha tregtare, vende turistike, stacione të ndryshme, pra ku lëvizja dhe grumbullimi i njerëzve është më i madh. Vlen të ceket se periudha kohore dhe vendi i lëmoshës nga ana e femrave dhe fëmijëve është në rritje gjatë sezoneve të verës dhe vende turistike, sidomos gjtë muajve kur ka ardhje të mërgimtarëve. Organizatorët apo trafikantët shpesh janë edhe kontrollor apo mbikëqyrës të realizimit të lëmoshës, të cilët paraprakisht edhe i ushtrojnë ato për mënyrat dhe teknikat e lëmoshës ku shpesh ata kamuflojnë sikur janë invalid ose tregojnë dokumente të falsifikuara për operacione mjekësore, rrëzimi i shtëpisë etj., përmes të cilëve do të jenë inkurajim ndaj popullatës që të dhurojnë më shumë. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe Protokolli i Palermos për Parandalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Fëmijëve, në rend të parë, kanë parasysh trafikimin tejkufitar të fëmijëve, i cili bëhet në mënyrë të organizuar, mitëpo, për shkak të dukurisë së trafikimit të fëmijëve brenda për brenda një vendi, këto dispozita duhet të aplikohen edhe ndaj kësaj kategorie të fëmijëve të trafikuar.[758]

Nga e gjith kjo mund të konkludojmë se trafikimi me qenieve njerëzore në përgjithësi përbën një shkelje serioze lirisë dhe të së drejtës për një jetë të shëndoshë, efikase, normale dhe të lumtur në kuadër të normave shoqërore e jo të ketë ndikim dhe efekte negative serioze në shëndetin, psiqikën dhe në zhvillimin pozitiv të fëmijëve, pra, kështu fëmijët rriten me trauma dhe në të ardhmen ata do të përjetojnë këto pasoja. Në këtë vepër penale Republika e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me fëmijët dhe femrat sidomos të nacionalitetit romë të cilët dominojnë për nga numri dhe shumica janë të shfrytëzuar për lëmoshë të detyruar edhe pse ka raste kur e njejta kryhet

[755] Mlađenović-Kupčević, Rajka. "Kriminologija". Sarajevo, 2001, fq.164
[756] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.7
[757] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.17
[758] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.107

me dëshirën e tyre pa ndikimin, shtypjen apo shfytëzimin nga ana e personave tjerë ku në të shumtën e rasteve janë familjarët e tyre si prindërit, bashkëshorti etj. Në Maqedoni numri i femrave dhe fëmijëve sidomos të nacionalitetit romë është shumë i madh dhe hasen në çdo kënd, rrugë apo rrugicë në qytete të vendit sidomos në kryeqytet përshkak të madhësisë dhe numrit të popullsisë vendase dhe turistëve. "Viktimat vendas janë kryesisht të mitur. Ato kanë origjinë nga Gostivari, Tetova, Prilepi, Gjevgjelia, Kumanova dhe Shkupi, dhe shfrytëzohen në rajonin veri-perëndimor të Pollogut të Republikës së Maqedonisë, dhe një pjesë e tyre jashtë vendit".[759] Në këtë formë organet kompetente shtetërore duhet të koncentrohen edhe në paraqitjen e formave dhe trendeve të reja të organizimit të lëmoshës. Për shembull, megjithëse trafikimi i qenieve njerëzore për shkak të lëmoshës së organizuar të fëmijëve është identifikuar si një fenomen i ri në disa raporte dhe intervista, disa informatorë dhe të anketuar kanë deklaruar se nuk është një fenomen i ri në rajon, por vetëm kohët e fundit është njohur si një formë e mundshme e trafikimit të qenieve njerëzore.[760] Çdo shoqëri bashkëkohore njerëzore e organizuar në shtet ndërmerr masa preventive nëpërmjet institucioneve të ndyshme (familjes, shkollës, organeve të kujdesit social, të entiteteve të tjera joqeveritare dhe mediumeve) dhe represive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale.[761]

2.3. Trafikimi i personave me qëllim të kryerjes së krimeve

Përveç qëllimeve veç më të njohura të trafikimit me qenie njerëzore siç janë prostitucioni, lëmosha, puna e detyruar trafikantët, grupet e krimit të organizuar viktimat e tyre i shfrytëzojnë edhe në kryerjen e krimeve tjera të ndryshme varësisht nga kërkesat e tregut dhe interesat e grupeve kriminale. Pëndryshe, krimi është, një nga problemet më aktuale në të gjitha vendet moderne, po ashtu edhe në vendin tonë, e cila dëshmohet nga fakti se ajo është në rritje të vazhdueshme.[762] Pra, sjellja kriminale definohet si sjellje anti sociale, gjegjësisht sjellje që i shkel ligjet e miratuara dhe së këndejmi bartë edhe dënime të caktuara.[763] Edhe te ky lloj i trafikimit pjesa dërmuese e viktimave vijnë nga shtetet e varfëria dhe nga vendet ku popullata jeton në kushtet e papunësis, varfëris dhe skamjes të cilët shpesh luftojnë edhe për ekzistencën e tyre. Shpesh kushtet për këtë mënyrë "normale" të jetës është vështir për t'u arritur, kështu që rrugët alternative (droga, prostitucioni dhe forma të tjera të krimit) janë më të pranueshme, pasi kriza e familjes jo vetëm që çon në kolaps ekonomik, por edhe në shkatërrimin e moralit dhe vlerave morale.[764] Ky lloj trafikimi është i organizuar kryesisht me qëllim të krijimit të kapaciteteve për organizimin e prostitucionit të fëmijëve, por edhe për përfshirjen e fëmijëve në veprimtari të ndryshme kriminale që sjellin përfitime të konsiderueshme materiale.[765] Kështu p.sh., sipas ***Kaiserit***-të miturit më së shumti kryejnë vepra penale kundër pasurisë dhe vepra penale të delikteve në trafikun rrugor[766] të cilët janë nën kontrolin e trafikantëve dhe të grupit kriminel të organizuar. Në këtë drejtim, dallohet

[759] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.5
[760] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.38
[761] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.21
[762] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.155
[763] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalitetit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.7
[764] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117
[765] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.201
[766] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.17

një lloj i profesionalizmit dhe specializimit të kryerësve në kryerjen e krimeve të caktuara kundër pasurisë.[767]

Trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të kryerjes së krimeve të ndryshme viktimat tyre i shfrytëzojnë duke i detyruar edhe në shitjen e substancave narkotike nëpër rrugët e metropoleve të mëdha shpesh dukshëm janë edhe persona shitës nën moshën 18 vjeç dhe këta fëmijë dhe persona permanent janë nën mbikqyrjen dhe monitorimin nga bosat dhe trafikantët e tyre. Një studim i vitit 1992 në Itali vërejti se organizatat mafioze po rekrutonin "mijëra" fëmijë e të rinj për të kryer veprimtari kriminale të vijës së parë të frontit, përfshirë shpërndarjen e drogave dhe mbajtjen e fshehjen e armëve të zjarrit.[768] Sot, kjo është një biznes jashtëzakonisht i zhvilluar në të cilin për nga aspekti i organizimit dhe konspirativitetit, vështirë se mund të krahasohet me ndonjë veprimtari tjetër nga lëmi e kriminalitetit profesional.[769] Kontrabanda, prodhimi dhe shitja e mjeteve narkotike është një vepër penale e cila dita ditës është në rritje sidomos tek të rinjtë dhe paraqet një shqetësim për shumë shtete në botë. "Viktimat e drogave dehëse janë të përshtatshme për t'u manipuluar për qëllime të ndryshme. Ato, si karaktere, janë labile, janë servile, të prirura të gënjejnë për doza të vogla të substancave narkotike. Në kohën e krizës janë në gjendje të ndërmarrin veprime e sjellje të pamenduara dhe të kryejnë edhe krime të ndryshme"[770] e cila konvenon grupeve kriminale që të aktivizojnë këtë kategori të personave në shitjen e narkotikëve. Narkotikët të cilët trafikohen më shpesh janë: heroina, kokaina, marihuana dhe drogat sintetike-amfetamini, LSD, etj.[771] Veçmas është evidente rritja e madhe e rasteve të kontrabandimit të drogave të rënda, si kokaina dhe heroina, si droga më të kërkuara dhe më të shtrenjta në tregun botëror.[772] Avganistani, Pakistani, po edhe Irani[773] llogariten si prodhues më të mëdhenj drogave.

Trafikimi i personave përveç një qëllimi të caktuar mund të jenë të ekspozuar ndaj disa prej këtyre llojeve të shfrytëzimit në të njëjtën kohë dhe kështu me kalimin e kohës këta persona bëhen kriminel profesional në kuadër të shtetit por edhe ndërkombëtar si dhe në mënyrë permanente janë përsëritës të kryerjes së krimeve si dhe shumë karakteristika të tjera. Ka të bëjë me karakteristikat e mëposhtme:

a) rritje e recidivizmit (domosdoshmëri për shkak të krimeve në masë),

b) Rritja e profesionalizmit (një numër në rritje i kriminelëve po gjejnë një burim të përhershëm të ardhurash në disa nga aktivitetet e krimit të organizuar).[774]

Gjatë tërë historisë së njerëzimit, kjo kategori e kryerësve të veprave penale në të drejtën penale ka pasur trajtim të posaçëm, është trajtuar ndryshe nga personat e rritur, një trajtim më të butë dhe më të privilegjuar.[775] Mirëpo përshkak të shumë specifikave të kryerësve të mitur të veprave penale, sidomos të moshës së tyre si dhe të aspekteve sociologjike, psikologjike, juridike, etj., është treguar më se domosdoshme që kriminaliteti i të miturve të trajtohet ndaras nga kriminaliteti i personave madhorë.[776] Në kuadër të sanksioneve penale ndaj të miturve, masat edukuese përbëjnë masat themelore, qëllimi i të cilave qëndron kryesisht në preventive dhe në

[767] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.206

[768] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.112

[769] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.70

[770] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.112

[771] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.20

[772] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq. 74

[773] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.121

[774] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.191

[775] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.14

[776] Salihu, Ismet. "E drejta Penale për të mitur" (Me ligjin penal për të mitur). Prishtinë, 2005, fq.11

riedukim.[777] Pra, këta persona kriminel aktivitetin e tyre kriminale kryejnë edhe në vepra tjera penale në vendin ku veprojnë dhe organizohen në grupe të vogla ose më të mëdha kriminale. Grupi kriminel-mund të jetë çdo grup i organizuar spontanisht ose me arsyetim përshkak të kryerjes së veprave penale në një formë bashkëpunimi.[778] Kriminelët ndërkombëtar gjithnjë e më shumë po implikohet në vjedhjen dhe trafikun e veturave, "një fushë me fitime të jashtëzakonshme, që nuk përbën shumë rrezik", konkludoi një konferencë e OKB-së në 1996, ku merrnin pjesë ekspertë nga 40 vende të Evropës dhe të Amerikës së Veriut.[779] Edhe pse ekzistojnë shumë rreziqe nga vjedhjet, plaçkitjet, vjedhjet e makinave dhe zjarrvëniet, të cilat janë krime tradicionale kundër pasurisë, ka edhe shpërblime të tjera që u ofrohen kriminelëve përveç sigurimit të parave dhe emocionit[780] si emërimi lider i grupit nga grupi kriminel, e shijon kënaqësin e punës së kryer person i ndëgjueshëm dhe i suksesshëm, kështu këto viktima kryerës të krimeve inkurajohen edhe më shumët në kryerjen e veprave të tjera penale.

2.4. Trafikimi i personave me qëllim të punës së detyruar

Puna e detyruar është problem global, me të cilin kohëve të fundit kanë filluar të ballafaqohen shumë shtete.[781] Trafikimi i qënieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit të punës është një fenomen kompleks që kërkon përgjigje nga fusha të ndryshme juridike të cilët kryqëzojnë– e drejta penale, të drejtat e njeriut, emigracioni dhe e drejta e punës.[782] "Përkufizimi i punës së detyruar rrjedh nga Konventa e ONP-së për punë të detyruar nr. 29 (1930). Neni 2 (1) i Konventës e definon punën e detyruar si: Çfarëdo pune ose shërbimi që shtrëngohet nga cili do person, me kërcënim për çfarëdo dënimi, për të cilën personi nuk ka shfaqur dëshirë në bazë vullnetare"[783], pra shihet se elementet kyç të definimit është puna përmes kërcënimit dhe kundër vullnetit të punëtorit. Republika e Maqedonisë e ka të inkorporuar në Kodin Penal gjegjësisht në nenin 418-a punën e detyruar e cila është si formë e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, duke i plotësuar standardet që kërkohoet nga Unioni Evopian në luftimin e kësaj dukurie negative, por jo veçmas por në kuadër të veprës së trafikimit me qenie njerëzore. Mosregullimi i veçantë i formave të trafikimit me qenie njerëzore dhe në mënyrë të detajuar pra, edhe të punës së detyruar dë të ishte një shtytje të mendojmë edhe për një ligj të veçantë për veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe format e shfrytëzimit të viktimave e cila do të na mundësonte një pasqyrë më të mirë të kualifikimit të veprave penale të këtij lloji si dhe luftimin më efikas të saj.

Trafikimi i personave me qëllim të punës së detyruar ndryshe njihet si skllavëria moderne e personave dhe realizohet për interesat e grupeve të krimit të organizuar dhe nga ajo detyrë ato përfitojnë finansiarisht në mënyrë permanente Për më tepër, kërkesa e punëdhënësve për punë të lirë dhe përfshirja e grupeve të krimit të organizuar në rekrutimin dhe shfrytëzimin e punëtorëve krijuan një mjedis të volitshëm për trafikim me qëllim të shfrytëzimit për punë të detyruar. Puna e detyruar, si rezultat i tregtisë me qenie njerëzore, është posaçërisht e dëmshme dhe dukuri tejet e

[777] Halili, Ragip. "Penologjia" (E drejta e ekzekutimit te sanksionimi penale). Prishtinë, 2014, fq.257
[778] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.203
[779] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.122
[780] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.247
[781] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.3
[782] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.19
[783] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.8

përhapur, që ushqehet me shpresat dhe ëndrrat e miliona njerëzve - femra, meshkuj dhe fëmijë.[784] Ky nivel i lartë i cenueshmërisë kërkon një reagim adekuat nga agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe nevojën për të mbrojtur viktimën kur shërbimi shtëpiak gjendet në kushte të nënshtrimit të pavullnetshëm, ngjajshëm si skllavëria.[785] Një ndër institucionet më kompetente përveç policisë është edhe inspektoriati i punës. Sipas Ligjit për inspektimin e punës (LIP), roli i inspektorit është të sigurohet që punëdhënësi i zbaton ligjet dhe aktet nënligjore nga fusha e marrëdhënieve të punës, punësimit dhe mbrojtjes gjatë punës në mënyrë gjegjëse, si dhe të ushtrojë mbikëqyrje mbi zbatimin e marrëveshjes së përgjithshme kolektive, marrëveshjeve kolektive të degëve, kontratave të punës dhe akteve tjera relevante (neni 1, LIP).[786] Nga ky ligj shihet se çdo punësim jashtë ligjit ka përgjegjësi personi, kështu që inspektoriati i punës duhet ti bëj kontroll çdo punëdhënësi dhe ndaj çdo objekti ku dyshohet se ka keqpërdorime.

Shpesh si viktima të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të punës së detyruar paraqiten edhe migrantët të cilët i kanë lëshuar vendbanimet e tyre dhe duke pas parasysh se ato janë pa punë, pa mjete finansiare, mosnjohja e gjuhës, mospasja e vendeve të punës dhe vende për të jetuar në vendet e destinacionit, ata bien lehtë nën grackën e krimit të organizuar të cilët shesin dhe i dërgojnë të kryejnë punë të detyruar në kushte dhe pagesa minimale. Gjithashtu, viktimat e trafikimit të punës janë shpesh janë të panjohura kurse rastet rrallë ndiqen penalisht[787], përshkak se këta persona punojnë në sektor të cilët është rëndë të zbulohen si: plantazhet, punë nëpër miniera, si fermerë, punë bujqësore, punë në ndërtimtari etj. Në përgjithësi te ky lloj i shfrytëzimit viktimat femra dhe fëmijët janë më të prekura sidomos shfrytëzimi i tyre si amvise, shërbyese, punë në plantazhe etj. Femra në përgjithësi janë në rritje të kërkesave të shumë vendeve edhe në punët si mbikëqyrëse të personave invalid dhe të moshuar e cila viteve të fundit është një kërkesë në rritje. Tregtarët janë kryesisht individë, shpesh persona afër familjeve të viktimave (shpesh njerëzit i dinë dhe u besojnë atyre) ose anëtarë të grupeve të vogla.[788] Në këtë mënyrë, kthetrat "e çliruara" të familjes tradicionale rekrutojnë të rinjtë që bëhen pre e lehtë e krimit të organizuar, duke u dhënë atyre një pamje të sigurisë dhe një perspektivë për të ardhmen.[789] Përballë papunësisë dhe alternativave të vogla, ata lehtë mund të vendosin të pranojnë oferta të paskrupullta për punë informale, veçanërisht në rajone që gjeografikisht dhe historikisht janë afër Ballkanit Perëndimor - UE, Kavkaz, Azia Qendrore dhe Rusia.[790] Këto viktima u nënshtrohen abuzimeve më çnjerëzore, keqtrajtohen, shfrytëzohen për qëllime të ndryshme, për skllavëri, për punë të rënda fizike, për prostitucion, për lypje dhe për nevoja të tjera.[791] Migrantët e huaj, zakonisht gratë, shpesh rekrutohen nga vendet më pak të zhvilluara për të punuar si shërbyese shtëpiake, pastrues, në vende më të zhvilluara.[792]

Puna e detyruar dhe tregtia me qenie njerëzore janë shkelje të rënda të drejtave të njeriut dhe të punëtorit, të cilat njëherazi gjenerojnë profite të jashtëzakonshme dhe zakonisht lidhen me

[784] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.3
[785] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.23
[786] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.6
[787] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.19
[788] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020". Скопје, 2015, fq.23
[789] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117
[790] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.22
[791] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.571
[792] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.23

aktivitete tjera të paligjshme.[793] Grupet kryesore të përmendura të rrezikuara ishin: punëtorët migrantë, të pastrehët, banorët e zonave rurale (të tërhequr nga mundësia e punësimit afatshkurtër).[794] Puna e detyruar apo skllavëria moderne nënkupton marrjen e dokumenteve personale zyrtare ose ngarkimin e një borxhi shumë të lartë personave nga një borxh paraprak dhe kështu trafikantët i shfrytëzojnë duke kryer punë të detyruar nën direktivat e trafikantëve dhe organizatës kriminale për të cilën po punojnë. Punëtorët në të gjithë botën bien viktimë e punës së borxheve kur trafikantët, ose ata që rekrutojnë ata, shfrytëzojnë në mënyrë të paligjshme borxhin fillestar që një punëtor ka transportuar, si pjesë e kushteve të punësimit.[795] Pra, nganjëherë migrimi i len njerëzit si të pambrojtur, pafuqishëm dhe pa ndihmë shtetërore, kështuqë shpesh këta janë edhe viktima të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të punës së detyruar. Ky lloj i abuzimit të fuqisë punëtore është më intensiv sidomos në punët sezonale kur furnizimi i punëtorëve vendas nuk mjafton dhe kështu nevoja është që të kryhen punët, dhe kështu vin edhe deri tek abuzimi i fuqisë punëtore nga vet shtetet me ekonomi të zhvilluar. Punëtorët emigrantë janë gjithnjë e më të gatshëm të pranojnë punë dhe punë të përkohshme dhe sezonale që nuk kanë siguri afatgjatë ose përfitime të tjera[796] duke pranuar punë edhe në sektorë të rrezikshëm. Sektorët e rrezikshëm ekonomikë:

- ndërtimtaria
- bujqësia, gjedhtaria dhe puna në fushë
- prerja e drunjve
- shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes
- industria e tekstilit
- restorantet, hoteleria dhe turizmi[797] janë sektorë ku më së shumti shfrytëzohen viktimat e krimit të rrezikshëm të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të punës së detyruar.

Një prej roleve kryesore të inspektoratit të punës është identifikimi dhe veprimi në rastet e punës së detyruar, përmes zbatimit të inspektimeve në vendin e ngjarjes tek punëdhënësit dhe në vendet e punës ku punojnë punëtorët.[798] Punët sezonale më shumë karakterizohen me nevojën e fuqisë puntëore të gjinis mashkullore dhe të rritur edhe pse nuk mungon edhe gratë dhe fëmijët. Gratë kalojnë mesatarisht 5.2 orë në ditë në „punë të papaguara“, duke bërë punët e shtëpisë, ndërsa burrat kalojnë rreth një orë në ditë duke bërë këtë.[799] Punëtorët migrantë në fabrika dhe në ferma mund të durojnë kushte të tmerrshme pune, ndërsa punëtorët migrantë shtëpiakë mund të përballen me një mori abuzimesh brenda shtëpive të punëdhënësve[800] duke mos i anashkaluar edhe viktimat fëmi të punës së detyruar. Treguesit e ekzistencës së punës së detyruar të fëmijëve përfshijnë situata në të cilat fëmija, sikur është, nën kujdestari të personit i cili nuk është anëtar i familjes dhe i cili e detyron fëmijën të punojë nga i cili ka përfitim financiar në favor të dikujt jashtë familjes

[793] Doracak “Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës”, Shkup, 2010, fq.3
[794] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.14
[795] OSCE. “Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije”, referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.22
[796] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.30
[797] Doracak “Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës”, Shkup, 2010, fq.14
[798] Po aty, fq.8
[799] Priručnik za novinare “Trgovina ljudima”. Beograd, 2008, fq.13
[800] https://www.hrw.org/topic/migrants, të datës 12.09.2020, ora 17:08

së fëmijës, dhe i cili nuk i ofron fëmijës mundësinë e largimit.[801] Kushtet e jetesës të fëmijeve të trafikuar janë të mjerueshme, punë e rëndë dhe me orar të zgjatur dhe në varësi të kushteve atmosferike, me pagesë minimale (nëse paguhen), e cila u dërgohet prindërve me qëllim që trafikantët të mos kenë probleme me ta.[802] Sipas raporteve, shumë fëmijë mes moshës 8-9 vjeç, në Indi, Pakistan dhe Sri Lanka janë të punësuar në fabrika të vogla ose në kushte shumë të dobëta pune më shumë se dhjetë orë në ditë me një pagë shumë të ulët.[803] Realizimi i mashtrimit, transportit të viktimave për të gjitha llojet e trafikimit me qenie njerëzore janë pothuajse të njejta, kurse realizimi i shfrytëzimit të tyre në vendet e destinacionit ndryshon nga forma dhe qëllimi i trafikimit. Në këtë kuptim, organet shtetërore të shtetit konkret duhet të mbikëqyrin agjencitë e punësimit dhe të kontrollojnë sipas akteve ligjore dhe përgjegjësit rreptësisht të ndëshkohen.

2.5. Trafikimi i personave për qëllime tjera

Përveç llojeve të lartëpërmendura të shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ekziston edhe një lloj tjetër e cila deri më tani nuk është studjuar sa duhet dhe e cila kërkon një studim të thellë dhe të mirëfillt sidomos në vendin tonë dhe në rajon e cila është trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të heqjes së kundërligjshme të organeve të njeriut. Pozicioni i njeriut modern përballë forcave të jashtëzakonshme, të krijuara nga përparimi i madh i të gjitha shkencave, përfshirë mjekësinë, po bëhet gjithnjë e më i pasigurt.[804] Së bashku me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë u zhvilluan dhe përparuan shumë profesione një ndër të cilat është edhe kirurgjia dhe transplatimi i organeve. Pra, heqja e organeve dhe shitja ilegale e tyre si formë ose lloj i trafikimit me qenie njerëzore ka marr hov të madh në botë përshkak se të dy palët kanë dobi nga kjo por edhe organizatat kriminale fitojmë sasi të mëdha të hollash nga ky lloj i kriminalitetit. Pse, themi të dy palët kanë dobi dhe interes përshkak se ky lloj i kriminalitetit përveç mashtrimit, grabitjes dhe marrjes me dhunë realizohet edhe me marrëveshje ku shitësit shkak i skamjes dhe varfërisë së madhe i shesin kurse shumë njerëz të pasur kanë nevojë për organet e tyre e cila shkon në ndërmjetësim të organizatave të trafikimit të cilët e bashkojnë ofertën me kërkesën, pra shitësin dhe blerësin. Në anën tjetër përveç shitjes me dëshirë të organeve ekziston edhe heqja kundër vulnetit dhe dëshirës së viktimave për shkak të fitimeve të mëdha financiare. Edhe pse nuk është e prerë, të ardhurat e organeve, nga shit-blerja dhe transporti te pacienti në nivel botëror janë afërsisht 1 miliard dollarë në vit.[805]

Në shumë vende, listat e pritjes për transplantime janë shumë të gjata dhe kriminelët e kanë shfrytëzuar këtë mundësi për të shfrytëzuar dëshpërimin e pacientëve dhe donatorëve të mundshëm.[806] Sipas raporteve të institucioneve shëndetësore kërkesat për organe çdo vit është në rritje nga 15%.[807]Supozimi është se disa njerëz duket se posedojnë shkallë të ndryshme të probabilitetit për t'u bërë viktimë e ndonjë krimi ose ndonjë aksidenti[808] vetëm që të sigurohet ndonjë organ për shitje. Por, si faktorë kryesor edhe këtu paraqitet faktori ekonomik ku si pasojë e varfërisë dhe skamjes së madhe të shumë vendeve në botë ka ndikuar edhe në rritjen e viktimave

[801] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.24
[802] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.10
[803] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.363
[804] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.162
[805] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.362
[806] https://www.interpol.int/en/Crimes/Human-trafficking/Types-of-human-trafficking, të datës 14.09.2020, ora 12:48
[807] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.361
[808] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.23

të cilëve u largohen organet ku viktimat vullnetarisht pajtohen në largimin dhe shitjen e organeve të trupit vetëm e vetëm për ekzistencën e familjes dhe anëtarëve të tyre.

Heqja e organeve kundër vullnetit të viktimës ndikim të madh ka numri i pamjaftueshëm i organeve që mund të blihen nëpër spitale. Në nivel botëror mes viteve 1978-1994, më së shumti transplantime organesh afërsisht 300,000 u kryhen kryesisht në SH.B.A.[809] Në këtë fushë krimi i organizuar ka gjetur kushtet për veprimtarinë e tij, kështu që situata të tilla përdoren me mjeshtëri për të transportuar organet njerëzore, përmes kanaleve të organizuara, në destinacionin e tyre, d.m.th. për klientët që paguajnë mirë për shërbimin.[810] Kështu që shumë grupe të krimit të organizuar që mirren me trafikimin me qenie njerëzore si aktivitete të tyre kriminale e realizojnë edhe për trafikimin me organe ku si klientë blerës të këtyre organeve paraqiten njerëz të pasur sidomos në vendet me ekonomi të zhvilluar. Personat që kanë nevojë për një organ dhe të cilat nuk dëshirojnë që ajo të zvaritet për një kohë të gjatë e përdorrin rrjetin e krimit të organizuar që të sigurojnë sa më shpejt dhe sigurt. Duke u bazuar në atë se transplatimi i organeve njerëzore edhe i shpëton jetën e shumë njerëzve por edhe në aspektin është një biznes mjaft profitabil dhe realizimi i sukkseshëm i transplatimit në shumë vende duke i falemenderuar profesionistëve dhe teknologjisë së sotisfikuar kompjuterik dhe robotik ka ndikuar direkt në rritjen e madhe të kërkesës për organe. Si organ e cila më shumë kërkohet në tregun botëror janë veshkët dhe thuhet se organet nga njerëzit e gjallë japin rezultate më të mira sesa organet nga persona e vdekur dhe se pacientët e transplantuar jetojnë më të shëndetshëm për një periudhë më të gjatë kohore. Kështu fillon edhe aktivizimi i grupeve të krimit të organizuar me qëllim të trafikimit dhe eksploatimit me organe njerëzore të cilët i atakojnë kategorinë e popullatës në ato shtete ku dominon varfëria dhe skamja duke i bindur ato që ti shesin organet e tyre për sasi të ndryshme të të hollave. Ato trajtohen si thesë për pjesë rezerve, e jo si qenie njerëzore.[811]

Shumë familje me qëllim të ushqimit të fëmijëve të tjerë si dhe për uljen e barës ekonomike në familje i shesin fëmijët e tyre.[812] Pra, në një anë kemi njerëz që mund të paguajnë blerjen e organeve kurse në anën tjetër për arsye të shumta por më së shumti nga varfëria kemi shitës të organeve dhe në këtë situat, marrëdhënien e furnizim-kërkesës si pikë të përbashkët janë organizatat e krimit të organizuar që merren me trafikimin e qenieve njerëzore dhe kështu relizohet vepra e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim shit-blerjes së organeve. Personat e rrezikuar për ekzistencë kështu përfundojnë në organizata kriminale të cilët u sigurojnë atyre kushtet e nevojshme për mbijetesë.[813] Shteti ka funksionin e arritjes së një ekuilibri midis pabarazisë sociale të grupeve të caktuara shoqërore brenda shoqërisë dhe mbajtjes së një politike të paqes sociale në shoqëri[814]me qëllim që të përmirësohet gjendja e cenueshme e popullatës që jeton në varfëri dhe skamje që mos të vij deri në shitjen e organeve të trupit të tyre për mbijetesë.

Për dallim nga veprat tjera penale tek ky lloj i veprës penale sidomos në lidhje me zbulimin e kryerjes së kësaj vepre penale është shumë e rëndë dhe e komplikuar zbulimi i saj përshkak se kërkohet një analizë profesionale mjekësore që të vërtetohet kryerja e saj, si dhe shpesh duhet edhe ndihmën këshilldhënëse të obligueshme nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së shëndetësis për shkak se ka të bëjë me një fenomen mjekësor. Tek na ky lloj i veprës penale rregullohet në kuadër

[809] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.361
[810] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq. 202
[811] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.213
[812] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.355
[813] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.117
[814] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.47

të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore si formë apo qëllim i saj. Në rajon Republika e Kroacisë e ka të rregulluar me nen të veçantë me titull "Trafikimi i pjesëve të trupit të njeriut dhe embrioneve njerëzore" në kuadër të Kodi penal të saj. Kushdo që siguron, posedon, transporton, transmeton, ruan, merr ose transplanton një organ njerëzor, ind, qelizë, embrion ose fetus nëse ai e dinte ose duhej ta dinte që ato kishin origjinën nga një person i cili është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim marrjen e pjesëve të trupit[815] llogaritet si vepër penale dhe dënohet sipas Kodit penal të vendit. Do të ishte e preferuar që edhe vendi ynë të inkurajohet nga shembulli i inkrimimit të veprës penale të heqjes së organeve në mënyrë të kundërligjshme të Kroacisë sepse ka të bëj me rregullimin e saj të veçant e jo në kuadër të trafikimit me qenie njerëzore si formë e saj.

KAPITULLI III

POZITA E SHTETEVE GJATË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE DHE MËNYRA E VEPRIMIT (MODUS OPERANDI) TË KRYERËSVE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

[815] Kazneni Zakon, Republike Hrvatske, Narodne novine" broj: 125/11 i 144/12 – Neslužbeni pročišćeni tekst, neni 107, paragrafi 1

1. Trafikimi me qenie njerëzore dhe pozita e shteteve

Të gjitha shtetet përmes institucioneve përkatëse dhe përgjegjëse kanë për detyrë luftimin dhe parandalimin e dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore varësisht nga vendi i kryerjes së veprës. Pra interesimi i luftimit dhe të parandalimit të veprës penale të rrezikshme të trafikimit me qenie njerëzore është si në shtetet e origjinës, tranzitit dhe të destinacionit. Kjo bëhet edhe më aktuale në ditët e sotme, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se përafërsisht, vlerësohet se në ditët e sotme jetojnë diku rreth 214 milion njerëz jashtë vendit të vendlindjes së tyre ose 3% e numrit të përgjithshëm të njerëzimit, dhe se ky numër ka pësuar rritje enorme, veçanërisht në 20 vitet e fundit"[816] dhe e cila tangon çdo shtet me pozitën e saj. Pra, si shkak i lëvizjeve të ndryshme të popullsisë dhe të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore si brenda shtetit poashtu edhe trafikimi ndërkombëtar ka ndikuar që të gjitha shtetet të preken nga kjo dukuri qoft me pozitën e shtetit të tyre si shtet origjine, të tranzitit ose të destinacionit. Për nga pozita e shteteve ndaj trafikimi burojnë edhe drejtat dhe detyrat e tyre që të ndërmarin masa për zbulimin, arestimin dhe dënimin e kryerësve në një anë, dhe në anën tjetër identifikimin, mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave të mundshëm të kësaj dukurie. Por, nga praktika ka shumë raste që një shtet mund të paraqitet të njëjtën kohë për raste të ndryshme edhe si shtet i burimit edhe si transit por të njëjtën kohë edhe si shtet i destinacionit, si shembull mund të ceket vendi ynë e cila viteve të fundit në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore i ka të tre pozitat: origjinë, transit dhe destinacion I trafikimit dhe të viktimave të tyre.

"Trafikimi me njerëz" do të kuptojë rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose mbajtjen e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës, apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, pandershmërisë, të abuzimit me pushtetin ose me pozitën vulnerabël apo të dhenies ose marrjes se pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi për të kontrolluar një tjetër, me qëllim shfrytëzimin[817], prej një vendi në një vend tjetër. Rritja e kërkesës në sektorë të tillë si seksi, pornografia, bujqësia, birësimi në botë bazuar në trupin ose forcën e njeriut ka shkaktuar një përpjekje për të siguruar që njerëzit që mund të punësohen nga organizatat kriminale në këto zona, përdoren përmes metodave të paligjshme, siç janë dhuna mashtrimi dhe pafuqia[818] ka ndikuar që nga disa vende njerëzit të zhvendosen, tranzitojnë dhe të vendosen në destinacionin përfundimtar.

Ndryshime të mëdha në situatën gjeopolitike të Evropës dhe zhvillimin ekonomik kanë hapur rrugë të reja migracioni (Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore nga vendet e origjinës dhe tranziti janë bërë vendet pranuese), dhe migracioni ndërkombëtar kanë pësuar ndryshime të rëndësishme kuantitative dhe kualitative[819]dhe kjo ka ndikuar në rritjen e viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore. Pasiguria ekonomike dhe diskriminimi ndaj grave është një nga shkaqet kryesore të trafikimit të qenieve njerëzore, siç tregohet nga drejtimi gjeopolitik i përcaktuar mirë i zinxhirit të tij: vendet e origjinës në përgjithësi janë vendet më pak të zhvilluara të Evropës Lindore dhe Juglindore, ndërsa destinacionet më të zakonshme janë vendet e zhvilluara ekonomikisht të Evropës Perëndimore dhe Veriore.[820] Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e

[816] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.6

[817] Informacion. "Nxitja e migracionit të rregullt dhe parandalimi i trafikimit në njerëz në Shqipëri". Tiranë, 2006, fq.15

[818] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.337

[819] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.35

[820] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.13

përshtatshme në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislacionin, për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat.[821]

Megjithëse krimi i organizuar në Ballkan mund të ndodhë në çdo formë që është e pranishme në botën bashkëkohore, ekzistojnë disa forma të tij që praktikohen gjithnjë e më shumë në këtë rajon, në rastin konkret në Republikën e Maqedonisë, ku situata socio-ekonomike e vendit dhe prezenca e korrupcionit ka një efekt të domosdoshëm në përcaktimin e rolit dhe të pozitës së vendit në trafikimin e qenieve njerëzore.[822] Në Republikën e Maqedonisë edhe përkundër reformave sidomos në përforcimin e sundimit të ligjit, sigurisë, trafikimi i qenieve njerëzore ende mbetet një formë e krimit të organizuar në të tre pozitat e saja, që kërcënon sigurinë dhe stabilitetin e vendit. Mungesa e informacionit për trafikimin e qenieve njerëzore si dhe informacione të vërteta mbi mundësitë e trafikimi jashtë vendit, korrupsionit të zyrtarëve qeveritarë në vendet e origjinës, tranzitit dhe destinacionit përgjegjës për luftimin e saj, regjimet e rrepta të vizave, si dhe aftësia e pamjaftueshme e atyre që janë përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe kontrollin e kufijve ndikojnë në lehtësim dhe në rritjen të veprimit trafikimi i qenieve njerëzore dhe rritja e cenueshmërisë së popullatës sidomos gjatë procesit të identifikimit të viktimave. Edhe pse Republika e Maqedonisë është pjesë e Mekanizmit Transnacional të Referimit që ka të bëjë me procesin e referimit prej identifikimit fillestar deri në kthimin dhe ndihmën në vendet e destinacionit, tranzitit dhe të origjinës, duke përfshirë edhe bashkëpunimin midis institucioneve të ndryshme qeveritare, rajonale, ndërkombëtare dhe OJQ-re ende është shqetësuese gjendja e këtij fenomeni dhe vazhdon edhe më tutje.

Në të kaluarën, Maqedonia ishte një nga vendet e destinacionit, kurse tani, për fat të keq, ajo kaloj në një vend të origjinës dhe destinacionit[823] dhe viteve të fundit edhe si shtet i tranzitit sidomos gjatë vitit 2015 me fluksin e migrantëve nga Lindja. Nga e gjith kjo që u cek vlen të theksohet se në bazë të kryerjes së veprës penale do të përcaktohet edhe vendi i kryerjes dhe në bazë të ligjeve të atij shteti do të dënohet kryerësi. "Sipas nenin 30, të Kodit penal të RM-së, vepra penale konsiderohet se është kryer si në vendin ku kryerësi ka vepruar ose ka qenë i detyruar të veproj, ashtu edhe në vendin ku është shkaktuar pasoja (paragrafi, 1). Pregaditja dhe tentativa e veprës penale, konsiderohet sikurse vendi ku ka vepruar kryerësi ashtu edhe vendi ku sipas parashikimeve të tij pasoja është dashur të shkaktohet ose ka mund të shkaktohet (paragrafi, 2)"[824] dhe për këto shkaqe pozita e shteteve gjatë kryerjes së veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore ka një rëndësi të veçantë.

1.1. Shteti origjinë

Vendi i origjinës apo i burimit të viktimave të trafikimit i referohet vendit në të cilin viktima ishte një qytetar ose ku ai jetonte përpara se trafikantët të zhvendosin në nkë vend tjetër. "Nëse shikojmë se nga cilat vende më shumë janë viktimat e trafikimit, do të shohim se ata janë kryesisht të ashtuquajtur vende të me ekonomi të dobët, vendet në zhvillim dhe vendet në tranzicion.

[821] Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, neni 3

[822] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.119

[823] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.2

[824] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.70

Konfliktet politike, etnike, religjioze, kulturore, luftërat lokale e civile, skamja, varfëria dhe fatkeqësitë e ndryshme natyrore, në shumë regjione të botës kanë nxitur lëvizjen dhe zhvendosjen e miliona njerëzve nga vendbanimet e tyre të përhershme kah vendet dhe regjionet që cilësohen si më të sigurta[825], të cilët pranojnë edhe migrime ilegale dhe të parregullta vetëm e vetëm të largohen. Nga perspektiva e vendeve dërguese, parregullsia vërehet për shembull në rastet kur një individ e kalon kufi rin ndërkombëtar pa një pasaportë ose dokument udhëtimit të rregullt, ose nuk përmbush kërkesat administrative për tu larguar nga vendi.[826] Shpërndarja e pabarabartë e fuqisë dhe mundësive, varfëria dhe papunësia, krijojnë një mjedis që shpesh përdoret për të rekrutuar viktimat sepse njerëzit janë vazhdimisht në kërkim të punës. Krizat ekonomike, luftërat civile dhe faktorë të tjerë kanë kushtëzuar migracionin, gjegjësisht lëvizjet migratore.[827] Për më tepër, korrupsioni dhe prania e mundshme e konfliktit të armatosur në një vend ose afër tij u sigurojnë trafikantëve një mjedis të favorshëm për punë"[828], sidomos viteve të fundit luftërat në Lindjen e Mesme ku masovikisht kishte shpërngulje ku shumica ishin viktima potencial edhe të trafikimit me qenie njerëzore.

Lëvizjet e tafikantëve gjatë periudhave të ndryshme ndryshojnë shtetet dhe lëvizjet e migrantëve varësisht nga oferta dhe kërkesa për viktimat si dhe arsye të tjera, që nënkupton se ndryshojnë edhe vendet e origjinës. Luftimi institucional, kundërshtimi nga familjarët e viktimave ndaj trafikantëve është një factor e cila ka ndikuar në ndryshimin e vendeve të origjinës. Por, vendet ku ka luftëra, konflikte, sëmundje, varfëri, papunësi dhe skamje, janë vende të origjinës përshkak se klima jo e kontrolluar nga shteti ndikon që trafikantët të gjejnë më lehtë viktimat e tyre. Në nivel botëror vendet si: Afrika, një pjesë e Azisë, Evropa Qendrore dhe Lindore, Amerika Latine vlerësohen brenda kësaj kategorie. Vendet më të njohura të trafikimit klandestinë, janë: Tajlanda, Filipinet, Pakistani, Irani, Libani, Turqia, Bullgaria, Rumania, Ukraina, Moldavia, Serbia, Greqia, Maqedonia, Shqipëria, Kosova etj.[829] Korrupsioni është një nga fenomenet kriminale që siç kemi parë edhe më parë, në kohën tonë po shkatërron gjithnjë e më shumë institucionet e qeverisjes[830] e cila ndikon që këto vende të jenë vende të origjinës ku marrin pjesë edhe vendet e rajonit, Ballkanit, pra edhe Maqedonia. Vepra penale e pranimit të ryshfetit paraqet veprën më kryesore dhe domethënëse në kategorinë e veprave penale të korrupsionit.[831] Andaj këta njerëz, të cilët i lëjnë vendet e tyre drejt vendeve me ekonomi të zhvilluar një pjesë e mirë të tyre janë viktima potencial të trafikantëve duke krijuar një situate negative në vendet e origjinës me vet faktin e ikjes së tyre.

Midis migrimeve të jashtme dhe formimit të diasporave ekziston një lidhje shumë e ngushtë[832] dhe në anën tjetër lidhja e diasporës dhe të emigrantëve me vendin e origjinës. Shtetet e origjinës nga emigrimi i popoullsisë përfiton vetëm në disa pika të fushës ekonomike dhe ate: nga remitancat apo dërgesat materiale të emigrantëve, krijimin e mundësis së investimeve të emigrantëve, ulja apo zbutjen e papunësisë si pasojë e emigrimit. Pra, investimet e bëra nga

[825] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.156

[826] Informacion. "Nxitja e migracionit të rregullt dhe parandalimi i trafikimit në njerëz në Shqipëri". Tiranë, 2006, fq.15

[827] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.213

[828] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.12

[829] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.157

[830] Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011, fq.154

[831] Бабић, Милош. Марковић Иванка."Кривично Право", Посебни дио. Бања Лука, 2007, fq.300

[832] Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012, fq.39

emigrantët në vendin e tyre, e forcojnë ekonominë, ndihmojnë në përcjelljen e ideve të reja dhe përmirësimin e mirëkuptimit midis vendeve që pranojnë dhe pranojnë emigrantët.

Shtete origjine të njohura në botë cilët përbëjnë një pjesë të mire të trafikantëve në Evropë janë nga vendet si: Rusia, Ukraina, Moldavia, Rumunia, Bullgaria, Kosova, Shqipëria, Maqedonia dhe vende të tjera.

Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e trafikimit njerëzor në kushtet e vendit të burimit:

1. Zhvillimi i ulët në demokraci dhe të drejtat e njeriut
2. Arsyet ekonomike, ndryshimi midis standardeve të jetesës ekonomike dhe sociale midis vendeve, dëshirës së masave të prekura nga hendeku i shpërndarjes së të ardhurave midis vendeve për të pasur një jetë më të rehatshme dhe të mirë,
3. Luftërat rajonale dhe civile, konfliktet civile, konfliktet e interesit që ndodhin midis vendeve.
4. Pabarazia e mundësive dhe papunësia
5. Konflikte Sociale dhe Politike (shoqëri e paqëndrueshme, e zhvendosur)
6. Praktikat sociale dhe kulturore,
7. Presioni ndaj grave dhe vajzave në komunitet,
8. Shitja e grave të reja nga familjet e tyre
9. Shitja e fëmijëve të varfër familjeve të pasura me status / birësim më të mirë financiar, etj. Shumica e familjeve i shesin fëmijët e tyre për të ushqyer fëmijët e tjerë dhe për të zvogëluar barrën ekonomike për familjen.[833]
10. Diskriminimi seksual
11. Dhuna në familje dhe prishja e rendit familjar
12. Aktivitetet e organizatave terroriste

"Fakti që margjinalizimi ekonomik dhe shoqëror i grave janë shkaqet më të zakonshme të trafikimit të grave dhe migracionit të grave ilustrohet nga të dhënat e marra nga një analizë e rasteve të grave viktima të trafikimit në tre vende të Evropës Perëndimore - Itali, Belgjikë dhe Hollandë gjatë vitit 2001. Në Itali, 92.40% e viktimave femra të identifikuara jetonin në vendin e origjinës me familjen e tyre, 68.75% kishin përvojë pune, ndërsa 58.75% e grave jetonin në kufirin e varfërisë. Motivi më i zakonshëm për pranimin e ofertës së personave të rekrutuar në vendin e origjinës ishte puna (35%), paratë për nevoja themelore (30%) dhe paratë për familjen (23%)."[834] Se ku do të na çojnë këto presione, do të varet në atë se si do të përgjigjen liderët politikë, sa fleksibël bëhen tregjet e punës dhe nëse rritja e përgjithshme ekonomike është aq e madhe, sa të thithë një numër në rritje të punëtorëve të mbetur pa punë[835], pra kjo nënkupton se si do të jetë politika migratore dhe politika kundër krimit të organizuar e në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore.

Bazuar në të gjitha të dhënat e disponueshme (nga burime vendase dhe të huaja), vëllimi i përgjithshëm i emigrimit nga Republika e Maqedonisë në periudhën e tranzicionit mund të përafrohet të paktën 150 mijë njerëz.[836] " Periudha pas vitit 2000, karakterizohet me emigrimit të përhershëm dhe ribashkimi i familjeve. Emigracioni i përkohshëm ekonomik është në rritje, dmth punësimi i përkohshëm i qytetarëve maqedonas në vendet fqinje dhe më gjerë"[837] është bërë një process standard I shtetasve vendas. "Raportet e fundit tregojnë se tregtia e brendshme është në

[833] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.355

[834] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.14

[835] Ajazi, Kristina. Disertacion i doktoraturës "Sfidat e përkthimit në epokën e globalizmit. Globalizmi dhe ndikimi i tij në përkthimologji parë në qasjen e teksteve publicitare në anglisht dhe shqip". Tiranë, 2012, fq.48

[836] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.13

[837] Po aty

rritje. Sipas UNDP, numri i shtetasve të huaj në Ballkanin Perëndimor po bie dhe numri i viktimave të trafikimit të brendshëm njerëzor po rritet (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Serbi-Mali i Zi, përfshirë edhe Kosovën). Sidomos në Kosovë, numri i viktimave të tregtisë së brendshme është shumë i lartë."[838] Kjo do të thotë që kushtet e përgjithshme janë karakteristike për krimin e organizuar në përgjithësi, të kombinuara me faktorë "vendorë", që është një garanci e funksionimit "të suksesshëm" të këtyre grupeve kriminale.[839]

1.2. Shteti tranzitë

Përveç shteteve me pozitën e tyre si shtet i origjinës, gjatë lëvizjeve të njerëzve si migrantë, migrantë të paligjshëm dhe ilegal, si viktima të kontrabandës me migrantë ose si viktima të trafikimit sidomos gjatë lëvizjeve ndërkombëtare të distancave më të gjata paraqiten shtete me pozitën e shtetit tranzit. Shtete tranzit janë vendet që gjenden në mes të shtetit të origjinës dhe asaj të destinacionit prej nga në përgjithësi migrantët, viktimat dhe kontrabanduesit, e në veçanti trafikantët dhe viktimat e trafikimit me qenie njerëzore kalojnë pa qëllim që të vendosen në këto shtete por e realizojnë vetëm kalimin e përkohshëm apo tranzit. Në përgjithësi varësisht nga perriudhat kohore dhe shkaqet tjera që lidhen me veprimtarinë e krimit të organizuar, sidomos të grupeve të trafikimit me qenie njerëzore, disa shtete e humbin pozitën e shtetit të origjinës apo të destinacionit përkohësisht dhe paraqiten si vende të tranzicionit siç ishte në vitin 2015 me fluksin e migrantëve ku Maqedonia u njoh si shtet tranzit. Pra, zbehja e rolit të vendit të origjinës u shoqërua njëkohësisht me shfaqjen dhe forcimin e rolit si vend tranzit për shumë viktima të rekrutuara në shtete të tjera prej nga vinin sidomos nga Lindja e Mesme dhe kalonin Maqedoninë, më pas Serbinë dhe përmes Hungarisë drejt vendeve të zhvilluara të Bashkimit Evropian, ku pjesa dërmuese si shtet të destinacionit e kishin Gjermaninë. Është e njohur edhe vija e dikurshme klandestine e cila nisej nga Kosova për Hungari-Çeki-Austri-Gjermani dhe vija tjetër Kosovë-Shqipëri-Itali etj.[840] Çdo rrutë apo vijë e lëvizjes së viktimave të trafikimit me qenie njerëzore pjesa dërmuese të tyre si vende të destinacionit i kanë vendet anëtare të zhvilluara të Bashkimit Evropian ku ata lirshëm mund të lëvizin brenda saj.

Andaj kontrollimi i rreptë dhe professional i kufijve shtetëror edhe nga shtetet me pozitën e shtetit tranzit do të ndihmojnë vendit konret, rajonit po edhe botës parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore. Sipas Ligjit për kontroll kufitar të Republikës së Maqedonisë: " "vija kufitare" është një seri pikash në sipërfaqen e tokës të përcaktuara nga koordinatat, përgjatë të cilave shtrihet kufiri shtetëror që përcakton territorin e Republikës Maqedonia nga territoret e vendeve fqinje"[841]. Republika e Maqedonisë sidomos në mes të vitit 2015, si shkak i fluksit të madh të migrantëve e përforcoi me të madhe kontrollimin e vijave dhe pikave kufitare si dhe të patrullimeve dhe mbikëqyrjes së tyre si dhe formoi Qendrën e tranzitit në afërsi me kufirin me Greqinë, në qytetin e Gjevgjelisë, me qëllim që të kontrollohen dhe realizohen hyrjet legale dhe të ligjshme të tyre në vendin tonë. Në këtë drejtim vendi ynë ka përgatitur një Strategji për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe një Plan Veprimi me qëllim të lehtësimit të luftimit të kësaj dukurie. Fatkeqësisht me qëllim të kontrollit të fluksit të migrantëve në vendin tone sidomos në kufirin Greqi-Maqedoni nga ana e policëve janë të regjistruara tejkalimi i forces policore, ushtrimi I dhunës si dhe trajtim jo etik dhe degradues. Burra, gra dhe fëmijë - shumica nga Siria, Somalia

[838] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.12
[839] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq. 119
[840] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.157
[841] Закон за гранична контрола. Службен весник на РМ, бр. 171, 2010, neni 3, paragrafi 1

dhe Afganistani - kanë përjetuar dhunë policore dhe trajtim çnjerëzor, trajtim degradues dhe ndalim arbitrar në Maqedoni, një vend kyç kalimtar tranzit përgjatë rrugës së migracionit në Ballkanin Perëndimor drejt Bashkimit Evropian.[842]

Në përgjithësi kalimi ilegal dhe i paligjshëm i migrantëve personalisht ose përmes kontrabanduesve dhe në veçanti të viktimave të trafikimit ndërkombëtar me njerëz sidomos në shtetet tranzit shpesh paraqitet me pasojën e rrezikimit të shëndetit dhe jetës së tyre. Përveç kalimeve kalimeve legale nga pikat kufitare zyrtare të vendeve të tranzitit, kalimit të parregullt përmes falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit viktimat dhe trafikantët shpesh janë duke ndjekur edhe rrugët alternative, të cilat janë më të vështira dhe të rrezikshme, në mënyrë që të heqin qafe kontrollet gjithnjë e më të rrepta kufitare. Nga rrugët alternative siç janë: rrugët malësore dhe pyjore, rrugët detare dhe përgjatë lumenjve rezultojnë edhe me aksidente dhe vdekje përshkak të kushteve të rënda sidomos gjatë stinëve të dimrit kur kushtet janë edhe më të vështira për lëvizje. Në shumë vende të dhënat për aksidentet dhe vdekjet e njerëzve nga kalimet ilegale nuk publikuar shpallen dhe as nuk informohen nëpër media, përveç lajmeve dhe të dhënave nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare vendore apo ndërkombëtare. Gratë, të cilat janë shumicë midis emigrantëve të paligjshëm, viktima të trafikimit, janë të ekspozuar ndaj diskriminimit dhe dhunës në bazë gjinore si në vendet e origjinës, në vendet e tranzitit poashtu edhe në vendet e destinacionit. Gratë dhe vajzat e reja si dhe fëmijët e tyre, është kategoria më e cenuar dhe e diskriminuar në fusha të ndryshme, edhe në vendet e tranzitit dhe kampe, sidomos në lidhje me mungesë të dhomave të ndara.

I kushtëzuar nga vendndodhja e tij gjeografike, si dhe nga situata aktuale ekonomike dhe sociale, Republika e Maqedonisë përcaktohet kryesisht si një vend tranzit.[843] Kështu, në rastet kur kalohen kufijtë, tregtia përfshin hyrje të ligjshme ose të paligjshme ose qëndrim në vendin e tranzitit ose destinacionin përfundimtar.[844] Luftërat e zhvilluara në territorin e ish-Jugosllavisë kontribuan vetëm në zhvillimin e një rruge të sigurt tranziti, e cila shpesh ishte edhe vendi i shfrytëzimit të përkohshëm të viktimave.[845] Meqense çështja e migrimit prej një vendi në vendin apo regjionin tjetër është e reduktuar ose në disa shtete është pamundësuar, në skenë del trafikimi klandestin[846] ose kontrabanda me migrantë e cila më vonë ndikon në trafikimin e qenieve njerëzore si vepër më e rrezikshme. Në rrjetin global të trafikimit me qenie njerëzore, Maqedonia llogaritet si shtet tranzit dhe për këtë shkak ajo përballet me faktin se ilegalisht barten gra nga shtetet tjera si Serbia dhe Bullgaria cilët mtutje barten në shtetet si Greqia dhe Shqipëria që mëtutje të arrijnë në Evropën Perëndimore- në destinacionin e tyre përfundimtare.[847] Tranziti tjetër i njohur kohëve të fundit është ruta apo rruga tranzitore nga Greqia përmes Maqedonisë dhe Serbisë për në Hungari drejt vendeve të zhvilluara të Bashkimit Evropian ku edhe është qëëlimi i arritjes së migrantëve. Në Shtator 2015, kalimi i refugjatëve filloi të bëhej në një mënyrë të organizuar përmes kampeve të improvizuara të tranzitit në jug, afër Gjevgjelisë (Vinojug), dhe në veri, afër Kumanovës (Tabanovce).[848] Pra, këtu lëvizja ishte prej Gjevgjelisë si hyrje e migrantëve dhe dalje në

[842] Истражување "Како да не сме луѓе" на Полициска бруталност врз мигрантите и барателите на азил во Македонија, 2015, fq.64

[843] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.29

[844] Po aty, fq.31

[845] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.10

[846] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.109

[847] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, fq.1

[848] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.3

Kumanovë në kufi me Serbinë e cila rutë u bë e njohur në nivel ndërkombëtar. Kështu që, nga e gjith kjo shtetet e tranzitit për menaxhimin dhe kontrollin e kufijve shtetërore dhe flukseve masovike të lëvizjeve të migrantëve duhet të shfrytëzoj bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në lidhje me shkëmbimin e informatave dhe të kontrollit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të situatave të tilla.

1.3. Shteti i destinacionit

Vendet e destinacionit ndryshe quhen edhe si vende të synuara apo vende pritëse dhe konsiderohen si vende përfundimtare me të cilën realizohet qëllimi i trafikantëve sepse në këto vende qëllimi i trafikantëve është shfrytëzimi i viktimave dhe përfitimi material nga ato. Mungesa e fuqisë ose kërkesa për punonjës seksi brenda sektorit të prostitucionit në vendet e destinacionit është një nga qëllimet kryesore e trafikimit të qenieve njerëzore drejt vendeve të destinacionit e cila së pari vlerësohet nga trafikantët dhe më pas bëhet furnizimi i viktimave. Vendet e destinacionit janë vende të pasura dhe të zhvilluara janë vendet ku trafikantët e furnizojnë kërkesën e tyre përmes shfrytëzimit të viktimave për qëllime të ndryshme si: puna e detyruar, prostitucioni, lëmosha e detyruar, kryerja e krimeve etj. Si shembull të vendeve të destinacionit mund ti llogarisim: SHBA, Kanada, Danimarkë, Gjermania, Franca, Austria, shtetet skandinave dhe shuë vende tjera në botë.

Përveç trafikimit me qenie njerëzore drejt vendeve të destinacionit, paraprakisht mund të ekzistojë edhe migrime të organizuara ilegale, ose kontrabanda me migrantë të cilët llogariten edhe si viktima të mundshëm të trafikimit. Nga perspektiva e vendeve të destinacionit, ai është hyrja, qëndrimi ose puna e paligjshme në një shtet, gjë që do të thotë se migranti nuk ka dokumentet ose autorizimin e nevojshëm që kërkohet sipas rregullave të imigracionit për të hyrë, qëndruar dhe punuar në një shtet të caktuar[849], të cilët më lehtë mund të atakohen nga trafikantët. Kësisoj, në shtetet demokratike dhe të zhvilluara të perëndimit është rritur shumë numri i azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave tjerë të përndjekur, të cilët nuk janë përherë të mirëpritur.[850] Në këtë drejtim shteti ynë që nga viti 2007 ka marrë një hap të rëndësishëm për avancimin e kualitetit të dokumenteve personale siç janë pasaportat, letërnjoftimet dhe lejet për vozitje për qytetarët e vet dhe të huajt që kërkojnë leje qëndrimi në shtetin tonë në baza të ndryshme. Në përputhje me nevojën për harmonizimin e legjislacionit nacional në fushën e sigurisë së dokumenteve personale për qytetarët me standardet e IKAO 9303 dhe rregullativat ISO 7810 të UE nga Prilli 2007, Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë ka filluar zbatimi i projektit për dokumente të reja të identifikimit personal, gjegjësisht sistemin e ri për lëshimin e pasaportave me çipa elektronik sipas standardeve më të fundit evropiane për mbrojtjen e dokumenteve personale të identifikimit.[851] Por, keqpërdorimi i dokumenteve legale është rëndë të zbulohet përshkak se viktimat dhe trafikantët e kanë më të mësuar metodën e mënyrës së marrjes së vizave sidomosnë lidhje me procesin e aplikimit, deklarimit dhe intervistës për marrje të vizës. , tregojnë ato që thonë dhe bëjnë në një intervistë pas aplikimit për vizë. Gjithashtu, garancat nga punëdhënësit në vendet e destinacionit, të dhënat e rreme të punëdhënësve dhe llogaritë bankare përdoren për të marrë viza.

[849] Informacion. “Nxitja e migracionit të rregullt dhe parandalimi i trafikimit në njerëz në Shqipëri”. Tiranë, 2006, fq.15
[850] Halili, Ragip. “Kriminologjia”. Prishtinë, 2011, fq.156
[851] Резолуција. “Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014”. Скопје, 2008, fq.11

Republika e Maqedonisë përveç pozitës së saj si shtet origjine dhe tranzit llogaritet edhe si shtet i destinacionit për migrim të të huajve si dhe për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore. Sipas vendit të origjinës, Serbia qëndron me pjesëmarrjen më të lartë, dhe përfaqësimi i punëtorëve të huaj nga Turqia, Greqia dhe Bullgaria është relativisht i lartë[852] në vendit tonë. Ardhja e të huajve si punëtor legal, hapje biznesi, turist ndikon në interesimin për shërbime seksuale e cila ndikon që trafikimi të rritet me qëllim të shfrytëzimit të viktimave të tyre. Andaj lëvizja e njerëzve në baza të ndryshme në mes të shteteve ndikon direkt në trafikimin me njerëz për qëllime të ndryshme ku bëjnë pjesë edhe kategoria e fëmijëve dhe vajzave të reja. Fëmijët shpesh janë të shfrytëzuara seksualisht, detyrohen të lypin, ndërsa kur bëhet fjalë për shfrytëzimin e burrave të rritur, më së shpeshti është punë e detyruar në vendet e ndërtimit, pronat bujqësore dhe të ngjashme[853], të cilët vijnë nga vendet ku dominon varfëria dhe papunësia, dhuna dhe diskriminimi etj. Një nga rrethanat që trafikantët e grave shfrytëzojnë është mungesa e vetëdijes, veçanërisht e grave më të reja, për realitetin e migrimit në vendet e Evropës Perëndimore - ata nuk dinë ose dinë shumë pak për kushtet e jetesës dhe të punës në vendet e Unionit Evropian.[854] Numri i vërtetë i këtyre viktimave sot nuk dihet, por është e ditur se flitet për miliona azilantë, emigrantë, qytetarë të huaj, të cilët bredhin prej një vendi të tjetrin dhe se ata në çdo hap i nënshtrohen një dhune dhe diskriminimi më të vrazhdë.[855] Zakonisht, familjet e tyre janë të varfëra, me gjendje të rëndë materiale, të shkapërderdhura dhe me prani të dukurive patologjike, si: konsumim të alkoolit, drogës, bredhjes, braktisjes së fëmijëve dhe rrethana të tjera, të cilat ndikojnë që këta të lihen pas dore dhe të bëhen më lehtë viktima të trafikimit.[856]

Në lidhje me lëvizjet e popujve prej një vendi në një vend tjetër dhe të trafikantëve dhe viktimave të tyre qasje dhe identifikim më objektiv dhe më reale ka Organizata Ndërkombëtare për Migracion-IOM. IOM gjithashtu ka identifikuar rrugët kryesore të trafikimit njerëzor midis vendeve Lindore dhe Evropës Juglindore. Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia tani konsiderohen të jenë një nga vendet kryesore destinacion në Evropën Juglindore, ndërsa vendet përreth përfaqësojnë zona të tranzitit dhe origjinës.[857] Sot, në shumë vende që marrin emigracion, mendimet po rriten se migracioni është jashtë kontrollit, dhe një pamje negative e migracionit është mbizotëruese në pjesën më të madhe të shoqërisë sepse "emigrantët kryejnë punë të cilët punëtorët vendas nuk duan ti bëjnë"[858]. Në këto shtete, shpesh ardhacakët e këtillë fajësohen për rritjen e dukurive të krimit dhe sjelljeve devijante[859] si dhe është top temë e politikave të ndryshme ku ndaj migrantëve përdoren shprehjet si "racist", "asimilues" etj. Nga ana tjetër, në shumë vende që duan të mbajnë pretendimet e tyre për të qenë një shoqëri demokratike, qeveritë kanë përqafuar konceptin e "integrimit" për qëllime të luftimit të racizmit dhe eliminimit të pabarazive me të cilat përballen emigrantët.

Në vendet e Ballkanit ekzistojnë qasje positive-negative politike ndaj migrantëve, por jo në atë nivel sin ë disa vende të Bashkimit Evriopian përshkak se tek na ata nuk e kanë si pikësynim të mbeten në këto vende por vetëm shfrytëzojnë si vende tranziti. Sipas vendeve të origjinës së aplikantëve për nënshtetësi, Shqipëria (7213 persona), Greqia (1120) dhe Bullgaria (868 persona)

---

[852] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.20

[853] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.16

[854] Po aty, fq.14

[855] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.109

[856] Po aty, fq.108

[857] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.14

[858] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.31

[859] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.156

dallojnë sipas numrit të shtetësisë së fituar, pjesëmarrja e përbashkët e të cilëve në numrin e përgjithshëm të shtetësive të lëshuara është 9.3%[860] e karakaterizon vendin tonë si vend I destinacionit. Të dhënat e fundit për viktimat e trafikuara në Maqedoni (viktima të huaj dhe maqedonase) të cilët janë identifikuar dhe të cilëve u është ofruar ndihmë tregojnë se:
- numri i përgjithshëm i viktimave - shtetas të huaj, të cilëve u është dhënë ndihmë në Maqedoni, nga 2000 deri në 2009 është 778;
- Që nga zbulimi i problemit në 2004 deri në dhjetor 2008, numri i përgjithshëm i viktimave të identifikuara - shtetas maqedonas
- 83 viktima, dhe 52 viktima morën mbrojtje në një strehimore. Rreth 40% e tyre janë viktima të mitur.[861] "Analiza, nga ana tjetër, argumenton se numri i shtetasve të huaj të identifikuar si viktima të trafikimit njerëzor ka rënë ndjeshëm që kur Rumania dhe Bullgaria u bashkuan në Bashkimin Evropian. Ky pretendim i referohet faktit se në periudhën nga 2005 deri në 2007, shumica e viktimave ishin shtetas të huaj, dhe Republika e Maqedonisë ishte kryesisht një destinacion për viktimat e trafikuara, shumica e të cilëve vinin nga vendet e Evropës Lindore."[862] "Si arsye e uljes së numrit të çështjeve penale, të cilësuara si Trafikim me qenie njerëzore, mund të cilësohet edhe fakti se në vitin 2008, si vepër penale, u shtua edhe neni trafikimi me persona të mitur. Deri në vitin 2008, të gjitha veprat e identifikuara si trafikim me qenie njerëzor ishin analizuar bashkërisht, pavarësisht nga mosha e viktimës"[863]. Në vijim do të paraqesim mendimin e qytetarëve të përfshirë në anketën e realizuar në vendin tonë në lidhje me atë se cilët persona kanë rrezikshmëri të jenë viktima të trafikimit me qenie njerëzore.

Grafikoni nr.19 Pyetje nga anketa: Sipas jush cilët persona kanë rrezikshmëri për tu trafikuar




Tabela 19 paraqet mendimin e popullatës së anketuar në lidhje me shtetësinë apo shtetas vendor, të huaj apo të gjithë kanë rrezikshmëri për tu trafikuar. Edhe pse trafikimi me njerëz nuk njeht shtetësi nga të anketuarit shumë pak mendojnë se rrezik kanë të gjithë pa dallim shtetësie me 15.92%, kurse të mendimit shtetas të huaj janë 32.42% dhe me më shumë përgjigje të rethuar nga të anketuarit janë shtetasit vendor me 51.67%. Këto të dhëna tregojnë se tek popullata në lidhje me viktimat nuk kemi njohuri të duhura në lidhje me shtetësinë e viktimave të mundshëm.

[860] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.28
[861] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.12
[862] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.9
[863] Po aty

Tabela nr. 6 Sipas jush cilët persona kanë rrezikshmëri për tu trafikuar sipas statusit social?

		Sipas jush cilët persona kanë rezikshmëri për tu trafikuar?			
		Shtetas të R.M	Shtetas të huaj	Të gjithë	Gjithsejt
Statusi social:	Punësuar në administratë shteterore	142	64	60	266
	Pa punësuar	134	133	40	307
	Punëtor sezonal	114	104	34	252
	Student	0	1	1	2
	Punëtor krahu	230	87	56	373
Gjithsejt		620	389	191	1200

Në lidhje me pyetjen e njejt se kush ka rrezikshmëri për tu trafikuar sipas statusit social është si vijon: 620 të anketuar mendojnë se rrezikshmëri kanë shtetasit vendor ku dominon kategoria e punëtorëve të krahutme 230 që mendojnë se janë shtetasit vendor, kurse më pak janë punëtorët sezonal dhe pastaj punësuarit në administrate shtetërore, më pas për shtetas të huaj mendojnë 389 të anketuar dhe ate 133 të papunësuarit mendojnë se janë shtetasit e huaj, 1 student dhe 64 të punësuar në administrtë shtetërore dhe më pak mendojnë se rrezikshmëri kanë të gjithë me 191 të anketuar ku dominon anketuarit e punësuar në administrate shtetërore me 60 të anketuar. Nga kjo del se të punësuarit sidomos ata në administrate kanë më shumë njohuri se kush mund të jetë e rrezikuar nga viktimizimi kurse papunësuarit dhe punëtorët e krahut janë më pak të njohur me këtë çështje.

2. Mënyra e veprimit (Modus operandi) të kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore dhe fazat e kryerjes së saj

2.1. Kuptimi i mënyrës së veprimit (Modus Operandi) të kryerësve të trafikimit me qenie

Trafikimi me qenie njerëzore si fenomen është i paraqitur nga faktorë të ndryshëm të cilët paraqiten në të gjitha fazat e procesit të trafikimit me qenie njerëzore: në vendet e origjinës (papunësia, varfëria, luftërat, jostabiliteti politik, kushte e këqia sociale, pabarazia gjinore) në vendet e destinacionit (kërkesa për fuqi punëtore të lirë ose politika repressive të migracionit) dhe gjatë migrimit (mungesa e mundësive të migracionit të sigurt dhe legal)[864] të cilët ndikojnë edhe në mënyrën e veprimtarisë së grupeve kriminale dhe të trafikantëve për realizimin e veprës. Por, duhet pas parasysh se rolet dhe detyrat e veprimtarisë së anëtarëve dhe trafikantëve ndryshojnë në varësi të llojit të veprimtarisë, kohës, vendit dhe grupeve të ndryshme të përfshira në trafikim.

Prej vet fjalës *Modus Operandi*, nënkuptojmë modelet e operacioneve të kriminelëve gjegjësisht mënyrën e veprimit të tyre në realizimin e plotë të trafikimit, ku shpesh grupet e ndryshme kriminale varësisht nga vepra penale konkrete ndryshojnë edhe mënyrën e veprimit të

[864] OSCE. Прирачник за новинари. "Трговија со луѓе и медиумите", Скопје, 2010, fq.11

tyre me qëllim që të kenë rezultat pozitiv në arritjen e qëllimit dhe në anën tjetër të jenë të pakapshëm organeve policore. Ndryshimi i mënyrave të veprimit të trafikimit varet nga profili i viktimave, nga shteti i origjinës dhe transporti i tyre deri në vendin e destinacionit, nga kërkesa e tregut në vendin e destinacionit ku do të shfrytëzohen, nga përdorimi dhe shfryëtizimi e tyre permanent. Viteve të fundit ndryshimi i Modus Operandit nga ana e trafikantëve dhe grupeve kriminale ka të bëjë përdorimin e teknikës dhe teknologjisë më të re që nga faza e gjetjes dhe rekrutimit të klientëve, transportit dhe transferimit, fshehjes dhe shfrytëzimit si dhe gjatë ritrafikimit të tyre. Pra, këto grupe dhe trafikantë përdorin teknologjinë kompjuterike sidomos rrjetet sociale të cilët më shumë përdoren nga njerëzit të cilët veprimtarinë e tyre e kryejnë sa më shpejt, pa rrezik për zbulim, dhe pa shpenzime duke u dalluar nga trafikimi klasik kur trafikantët e kishin patjetër të lëvizin drejt vendeve të origjinës që të gjejnë dhe të bindin klientë të mundshëm. Mendimin e njejt e ndan edhe B.R. i cili pohon se: "Trafikimi i qenieve njerëzore zhvillohet nën tokë, por trafikantët përdorin mediat sociale për të komunikuar dhe organizuar transportin njerëzor."[865] Përveç rrjeteve sociale trafikantët përmes webfaqeve fiktive të tyre për punësim legal në vendet e ndryshme të Evropës kërkojnë, gjejnë dhe bindin sa më shumë klientë me qëllim të trafikimit dhe shfrytëzimit të tyre të mëtutjeshëm. Këto grupe dhe trafikantë janë në kërkim permanent të mënyrave të reja të veprimit të cilët do të siguronin më shumë klientë dhe do të kenë më pak rrezik për tu zbuluar në lidhje me mënyrat e veprimit në të gjitha fazat e trafikimit. Pra, në të ardhmen mund të zbulohen dhe përdoren edhe mënyra të tjera të reja të operimit dhe veprimit të trafikantëve. Pra, derisa ekzistojnë faktorë dhe shkaqe që e favorizojnë përfitimin nga trafikimi i qënieve njerëzore nuk do të shuhet asnjëherë, kurse mënyrat e veprimit të tyre mund të ndryshojnë dhe në të ardhmen mund të bëhen edhe më të pakapshëm ndaj organeve përgjegjëse nëse paralel edhe organet përgjegjëse nuk marrin hapa për ndryshimin e veprimtarisë së tyre.

Në kontekstin e trafikimit të personave *Modus Operandi* ka të bëjë me mënyrat, taktikat, strategjitë e shumëllojshme që përdorin elementët kriminelë ose grupet krimit të organizuar për rekrutimin, transportimin, transferimin dhe fshehjen/shfrytëzimin e personave në të gjitha format [866] e saja. Kështu që kohët e fundit metoda që përdoret më së shpeshti nga trafikantët është e ashtuquajtura **metoda e dashnores** ku kryesisht i dashuri ose partneri i mundshëm është rekrutuesi ose ndërmjetësuesi në transferimin ose shitjen e vajzës nga një skaj i vendit në tjetrin.[867] Pra, rekrutuesit në këto raste duken se janë mbrojtësit e viktimave duke u lidhur emotivisht dhe shpirtërisht me viktimat dhe tek këto raste në fillim ndaj viktimës nuk përdoren masat e njohura shtrënguese, dhunuese dhe e cila ndikon në mos paraqitjen e akuzës dhe dëshmisë së dëshmitarit-viktimë në organet e drejtësisë dhe ndikon në moszbulimin e trafikimit. Pra, këtu *Modus Operandi* i trafikantëve është si një maskë për tu mbrojtur duke arsyetar se janë në lidhje me "viktimën" dhe kufijtë shtetëror shpesh i kalojnë legalisht me dokumente të rregullta duke i respektuar procedura e kalimit të kufirit (garancë në vendin e destinacionit, viza turistike ose për punë në sektorë dhe punë legale etj.) deri në shtetin e destinacionit. Strukturat e grupeve kriminale të trafikimit me qenie njerëzore janë struktura të qëndrueshme dhe organizimi i tyre është mjaft profesional dhe të lidhura me grupe tjera kriminale të këtij lloji pothuajse në çdo vend të botës për shkak shtrirjes së fazave të trafikimit në territorin e disa shteteve.

[865] Intervistë me B.R. Shef i Njësisë për Hetimin e Krimit Kompjuterik në Sektorin e Krimit Kompjuterik dhe forenzika digjitale, Byroja e Sigurisë Publike, Ministria e Punëve të Brendshme të RMV

[866] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.145

[867] OSCE. Прирачник за новинари. "Трговија со луѓе и медиумите", Скопје, 2010, fq.40

Pra, *Modus Operandi* i grupeve të krimit të organizuar në vende të ndryshme të botës po dhe në vendet e Ballkanit ku bën pjesë edhe vendi ynë, sidomos të trafikimit me qenie njerëzore, përveç mënyrave të njejta dhe të ngjajshme të veprimit me grupet e krimit të vendeve tjera botërore ka edhe dallime të mëdha sa i takon përbërjes etnike, pozitës gjeo-strategjike të vendevese si, ekonomija e dobët e vendeve, rregullimi jurudiko-penal i trafikimit sidomos vakumet ligjore dhe paqartësi gjatë interpretimit ligjor, ekzistimi i korrupcionit politik-shtetëror si dhe shumë faktorë të tjerë, të cilët lehtësojnë veprimtarinë dhe e përforcojnë edhe më shumë aktivitetet e tyre në vend dhe jashta saj. Në nivel botëror mënyra e veprimit të grupeve të trafikimit me qenie njerëzore në vendet e Ballkanit sidomos Maqedoni paraqet një *Modus Operandi* në vete e cila dallon nga multietniciteti i trafikantëve duke i shfrytëzuar faktorët ekonomik (papunësinë dhe varfërinë e viktimave), politik (destabilizimet e shpeshta politike), ekzistimin e korrupcionit në institucione shtetërore, pozitën territorial të vendit dhe shumë arsye dhe faktorë të tjerë e cila viteve të fundit nga trafikimi ndërkombltar u transformua në trafikimin e brendshëm të qenieve njerëzore.

2.2. Fazat e trafikimit me qenie njerëzorë

Në literatura të ndryshme në përgjithësi njihen tre faza kryesore të trafikimit me qenie njerëzore dhe ate: Faza e rekrutimit, Faza e transportit dhe Faza e shfrytëzimit të viktimave. Faza e shfrytëzimit të viktimave është faza që mungon në veprën penale të kontrabandës së migrantëve përshkak se është një vepër që është me marrëveshje dhe me vet vullnetin e migrantit dhe përfundon me kalimin ilegal dhe të parregullt të kufirit shtetëror. Përkatësisht, kontrabanda e migrantëve, ndryshe nga trafikimi i qenieve njerëzore, përbëhet vetëm nga dy fazat dhe ate: Faza e parë - faza e kontaktit ndërmjet kontrabandistit dhe migrantit dhe Faza e dytë - faza e transportit. Sa i takon fazave të realizimit të trafikimit me qenie njerëzore në praktikë hasen:

a) Faza e parë është rekrutimi i viktimave në vendet e origjinës,
b) Faza e dytë është transportimi i viktimave sidomos realizohet në vendet e tranzitit, pjesërisht edhe në vendet e origjinës dhe të destinacionit,
c) Faza e tretë është transferimi e cila realizohet në vendet e tranzitit apo në vendin e destinacionit,
d) Faza e fshehjes dhe e shfrytëzimisht është karakteristikë kryesisht për vendet e destinacionit dhe
e) Faza e ritrafikimit e cila mund të realizohet nga vendet e origjinës drejt vendeve të treta.

Disa faza të lartëpërmendura karakterizohet nga një numër krimesh ndaj viktimave veç e veç në çdo fazë dhe ate në:

a) Fazën e rekrutimit: mashtrim dhe rëmbim,
b) Fazën e transferimit: Transporti dhe ilegal, transporti në kushte dhe mjete që kanë rrezik për jetën dhe shëndetin e viktimave, mundësia e shfrytëzimit gjatë transportit dhe
c) Fazën e shfrytëzimit: detyrimi në prostitucion, lëmosha e detyruar, kryerja e krimeve, puna e detyruar, heqja ilegale e organeve të trupit etj.

2.2.1. Faza e rekrutimit

Trafikimi me qenie njerëzore si vepër e rëndë penale fillon me fazën e rekrutimit e cila llogaritet edhe si faza më e rëndë nga e gjith procesi i trafikimit dhe faze e cila fillon të siguroj përfitime materiale organizatave kriminale të kësaj fushe. Kjo fazë si faze fillestare është faza më

e butë më fleksibile ku dhuna, shtrëngimi janë shumë të kufizuara, kurse më shumë shprehet bindja përmes mashtrimit për ofertat që i ofrohen viktimave potencial. Rekrutimi si fazë realizohet përmes mashtrimit ose shtrëngimit paralel me ofertat joshëse për punësime duke u bazuar në kushtet e jetesës familjare të viktimave. Trafikantët shpesh rekrutojnë njerëz nga vendet e varfra, veçanërisht zonat rurale, ku ka një shkallë të ulët papunësis dhe ku njerëzit nuk janë mjaft të njohur me problemin e trafikimit. Ata premtojnë njerëzve mundësi për një punësim më të mire sidomos punë në familje pasanikësh, përkujdesje për fëmijët, punës si modele ose punë në turizëm. Viktimat e mundshme mund të rekrutohet në çdo fazë të procesit të trafikimit, në vendin e origjinës, tranzitit ose në vendin e destinacionit[868] e cila varet nga situata konkrete, qëllimi i shfrytëzimit dhe në cilën fazë gjendet viktima. Në përgjithësi trafikantët janë persona të gjinisë mashkulllore të cilët paraqiten në çdo fazë të saj, por në fazën e rekrutimit si fazë e parë angazhohen njerëz më profesional të cilët do të arrijnë ti bindin dhe mashtrojnë viktimat e mundshëm. Nga vështrimi i të dhënave të studimeve dhe intervistave të viktimave, del se si rekrutues shpesh paraqiten persona të gjinisë femrore,[869] përshkak se viktimat femra dhe vajza të reja më lehtë mund të binden dhe besojnë personave të gjinisë së njejtë sesa e kundërta, femrat janë më elastik dhe melankolik në bisedë sidomos me rolin e tyre aktrojnë më lehtë sesa meshkujt. Pra, në fazën e rekrutimit së pari duhet gjetja, vendosja e kontaktit, biseda në lidhje me tema që ato interesohen dhe u tangojnë sidomos tema me problemet që i kanë, ofrimin e ofertave që do të mundësojnë zgjidhjen e problemeve të tyre, bindja, mashtrimi dhe rekrutimi për fazën e dytë deri në arritjen në vendin e destinacionit ose përmes rëmbimit apo të shtrëngim. Pra, përveç rekrutimit të viktimave të tyre përmes mashtrimit duke bërë premtime të rreme, ka edhe raste kur rekrutojnë viktima nën kërcënim dhe detyrim ndaj viktimave që kanë leje apo pajtueshmëri nga prindërit ose antarët tjerë të familjes. Informimi dhe njohuritë e popullatës në lidhje me fenomenin e krimit të organizuar dhe kriminalitetin e trafikimit me qenie njerëzore është e një rëndësie të vepantë dhe në lidhje me këtë e kemi edhe mendimin e të anketuarve si më poshtë.

Tabela nr.7 Pyetje nga anketa: Nga kush jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore sipas nivelit të arsimit

		Nga kush jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore?											
		TV	Gazetat	Shoqëria	Vendi I punës	Prindërit	Fakultet	Rrjetet sociale	Shkollë	Nga klienti	Nga viktimat e trafikimit	Nuk jam e informuar	Total
Niveli i arsimit:	Fillore	90	34	45	2	2	0	6	3	1	1	0	184
	Mesme	155	153	172	37	4	3	39	39	28	9	1	640
	Fakultet	26	74	16	94	0	100	6	19	0	0	0	335
	Magjistër	0	5	0	3	0	26	1	0	0	0	0	35

[868] Прирачник. “Трговија со луѓе”, Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.18
[869] Halili, Ragip. “Viktimologjia”. Prishtinë, 2011, fq.106

	Doktorant	1	1	0	1	0	2	0	0	0	0	0	5
	Të tjerë	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Total		273	267	233	137	6	131	52	61	29	10	1	1200

Tabela paraqet mendimin e anketuarve sipas nivelit të arsimit se nga kush janë të informuar për trafikimin ku shihet se mediat e shkruara dhe të pashkruara janë dominuese dhe ate nga TV janë 273 të anketuar, nga gazetat janë 267 të anketuar si dhe rrjetet sociale me 52 persona. Është interesante se komunikimi mes njerëzve për këtë çështje është e madhe ku nga të anketuarit 233 persona informohen nga shoqëria dhe më pas vijon edhe roli i vendit të punës nga ku informohen me 137 të anketuar. Niveli I arsimit tregon se personat me fakultet më shumë janë të njoftuar nga fakulteti ku kanë studjuar, më dhe nga gazetat 74 persona. Anketuar me shkollë të mesme më shumë janë të informuar nga mediat e shkruara dhe të pashkruara por më shumë nga shoqëria me 172 persona. Personat me arsim fillor më shumë informohen nga mediat sidomos TV 90 persona, gazetat 34, rrjetet sociale 6 të anketuar, si dhe nga shoqëria informohet një pjesë e madhe me 45 persona. Të arsimuarit me arsim të lartë, magjistra dhe doktora shkence janë të informuar në kohën e arsimimit sidomos nga fakultetit ku kanë studjuar.

Tabela nr.8 Pyetje nga anketa: Nga kush jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore sipas moshës

		Nga kush jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore?											
		TV	Gazetat	Shoqëria	Vendi I punës	Prindërit	Fakultet	Rrjetet sociale	Shkollë	Nga klienti	Nga viktimat e trafikimit	Nuk jam e informuar	Total
Mosha:	18 - 29	69	63	91	27	2	35	36	36	13	7	0	379
	30 - 51	105	125	96	74	3	68	15	23	10	2	0	521
	52 -61	82	65	46	36	1	28	1	2	6	1	1	269
	mbi 61	17	14	0	0	0	0	0	0	0	0	0	31
Total		273	267	233	137	6	131	52	61	29	10	1	1200


Kjo tabelë paraqet mendimin e anketuarve soipas moshës ku shihet se të gjithë kategoritë e moshës së anketuarve më shumë janë të informuar nga mediat e shkruara dhe të pashkruara si TV, gazetat dhe rrjetet sociale, dhe më pas nga vet shoqëria e cila tregon se njerëzir në mes tyre bisedojnë për trafikimin me qenie njerëzore. Mosha prej 18-29 dhe 30-51 që e përbëjnë shumicën e të anketuarve janë të informuar nga sistemi I arsimit dhe të cilët janë apo kanë qenë në arsimimin e tyre.

Në përgjithësi rekrutimi i viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore realizohet duke i mashtruar përmes:

a) Premtimit për fejesë ose martesë,

b) Ofertës për punë që ata dëshirojnë,
c) Ofertës për punë ku paguhen paga të larta,
ç) Ofertës studimi,
e) Ofertës turistike për shëtitje,
f) Shitjes nga vet prindërit ose anëtarë tjetër të familjes dhe
i) Shtrëngimit ose rëmbimit (e cila është mjet shtrëngues e jo mashtrim).
Ofertat që u ofrohen viktimave të mundshëm realizohen sidomos me reklama të ndryshme varëisht nga viktima potenciale dhe kërkesa e tregut më shpesh përmes mediave elektronike dhe të shtypura. Ekziston një përshtypje e padiskutueshme që teknologjia e informacionit në mënyrë shumë agresive pushton hapësirën e jetesës njerëzore pa lënë as pjesën më të vogël të asaj hapësire nga ndikimi i saj.[870]

Grafikoni nr.20 Pyetje nga anketa: Nga kush jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore sipas gjinisë



Grafikoni paraqet mendimin e informimit të tyre sipas gjinisë ku pyetjes se nga kush jeni të informuar tek meshkujt dominon informimi nga gazetat, pastaj pothuajse njejt janë ngaTV dhe shoqëria dhe më pak janë vendi i punës pastajprindërit fakultetet, rrjetet sociale shkolla klienti apo viktimat, kurse tek femrat dominon përgjigja se janë të informuar së par inga TVmë pas shoqëria gazetat vendi i punës dhe fakultetet kurse më pak nga rrjetet sociale shkolla klienti apo viktima. Nga e gjith kjo nënkuptojmë se ndikim në informimin e popupllatës ndikim të madh kanë mediat e shkruara dhe të pashkruara si dhe komunikimi në mes të njerëzve.

Siç u cek më lartë, teknologjia informative e në kuadër të saj Interneti, ofron një shumëllojshmëri të gjerë të qasjes në rekrutimin e personave, duke filluar nga ofertat për mundësitë e punësimit (kryesisht jashtë shtetit) dhe trafikimit për motive të ndryshme, si eksploatimi seksual dhe për punë, ku në të shumtën e rasteve viktimat shumë shpesh e vetëdije viktimizojnë vet vetën duke kërkuar zgjidhje për dalje nga kriza dhe varfëria apo për nevoja të tjera.[871] Rekrutimi ka lidhje

[870] Ачкоски, Југослав. "Сигурност на компјутерски системи, компјутерски криминал и компјутерски тероризам". Скопје, 2012, fq.19
[871] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.113

direkte me dëshirën e personave që dëshirojnë të migrojnë dhe ndodh që vetë personat që duan të migrojnë apo familjarët e tyre që të kontaktojnë rekrutuesit dhe të interesohen për punësime jashta vendit. Personat që e kryejnë rekrutimin mund të joshin viktimat duke bërë premtime të rreme për punë të paguara mirë në vendet e huaja.[872] Mënyra elektronike sidomos përmes rrjeteve sociale ku njerëzit janë më shumë aktiv reklamohen shtete dhe vende pune ku paguhen me paga të larta, me qëllim të joshjes së viktimave potencial nga reklama me qëllim që ata të fillojnë të interesohen për reklamën në fjalë. Ka raste kur personi është i vetëdijshëm për punën që do të bëjë, por ka akoma mashtrim përsa i përket kushteve të punës.

Rekrutimi vullnetar i njerëzve që nuk supozojnë se janë viktima të mundshme - të tërhequr nga ofertat për një jetë më të mirë, shumë njerëz iu drejtohen vullnetarisht tregtarëve që i rekrutojnë.[873] Është haruar fakti që ata janë mashtruar për sa i përket kushteve në të cilat do të punojnë, d.m.th. ata ishin mbajtur me bindjen se shkonin jashtë vendit ose në një qytet tjetër për të punuar si kamariere, mbajtës fëmijësh, modele, punëtorë të fabrikës, motër medicinale e të ngjashme. Nga ana tjetër, ka viktima që nuk janë në dijeni fare se nuk do të bëjnë veprimtarinë për të cilën kanë aplikuar. Më në fund, në destinacionin përfundimtar, kërkohet një lloj tjetër i punës. Motivi kryesor, i cili është edhe karrem, është përfitimi financiar që u ofrohet atyre, por për fat të keq është tepër vonë që ata të kuptojnë se nuk do të kryejnë ndonjë veprimtari me rëndësi juridike. Tregtarët e kanë ideuar këtë proces aq mirë sa të heqin dokumentet e identifikimit të viktimave, të përdorin dhunën ndaj viktimave dhe të kufizojnë lirinë e tyre të lëvizjes. Në kuadër të rekrutimit të viktimave të rritur për qëllime të ndryshme mund të hasen edhe viktima fëmijë. Shumica dërmuese e viktimave, fëmijë të trafikuar, kanë ardhur si pasojë e faktorëve dhe rrethanave të ndryshme, si: divorci, rimartesa e nënave të vetmuara pa të ardhura, skamja, papunësia, çrregullimet familjare etj. [874]

Rekrutimi nga ana e trafikantëve përdorin mjete të cilat ndikojnë që viktima të bëhet i varur nga rekrutuesi dhe ate:

- Mashtrimi i plotë ka të bëj me mashtrimin e viktimave nga ofertat, transporti i tyre e deri te kushtet për punë,
- Mashtrimi i pjesëshëm bëhet kur viktimat potencial mund ose janë të vetëdijshëm pë punët e caktuara, por jo edhe kushtet e punës,
- Rekrutimi i dhunshëm bëhet përmes rëmbimit të viktimave sidomos të fëmijëve,
- Mashtrimi përmes borxhit të viktimës ndaj trafikantëve, e cila shpesh është edhe një mjet i fortë mashtrimi ku viktimat për pagesën e borxhit pranojnë ofertat e rekrutuesve.

Mënyrat në të cilat viktimat e mundshme tërhiqen ose mashtrohen janë të ndryshme:

- Rekrutimi mund të bëhet nga individë që punojnë në rajon ose në mërgim;
- Përmes rrjeteve joformale, të cilat mund të përfshijnë anëtarët e familjes dhe miqtë;
- Nëpërmjet reklamimit mediatik të konkurseve tërheqëse ose ndërmjetësuesve legal / gjysmë legal, përfshirë agjensitë e rekrutimit që ofrojnë punë në vend ose jashtë (shoqërimi i biznes partnerëve, maser/e në studio kozmetike, model/e në agjenci të modës, zgjedhja e Miss, babbysiter, puna në anije, valltare në klube të njohura), studim jashtë vendit, ndërmjetësim për lidhje të martesës me të huaj, etj .;
- Vitet e fundit, gjithnjë e më shumë viktimat e mundshme rekrutohen përmes internetit. Në fillim, kontakti është vetëm një ftesë naive dhe miqësore për kafe, duke u shoqëruar, deri në një takim ku do të shpallet dashuria, oferta për martesë. Cilado nga mënyrat e mëparshme të rekrutimit të

[872] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.17
[873] Po aty
[874] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.108

zbatohen, ai është gjithnjë i drejtuar nga nevojat e pakënaqura të viktimës së mundshme: mundësia e punësimit, puna mirë e paguar, sigurimi i ekzistencës për veten dhe familjen e vet, realizimi i dëshirës dhe ëndrrës për të njohur vende të reja, etj .;
- Përveç saj, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore shpesh rrëmbehen brutalisht nga familjet e tyre, gjë që ndodh veçanërisht me fëmijët - për lëmoshë ose për adoptim të paligjshëm;
- Në rastet e varfërisë ose patologjisë ekstreme, vetë familja mund t'i shesë anëtarin e saj trafikantëve njerëzorë.[875]

2.2.2. Faza e transportimit

Faza e transportimit është faza e dytë e trafikimit me qenie njerëzore dhe për nga rëndësia e saj vijon menjëherë pas fazës së parë të rekrutimit. Kjo fazë fillon të zbatohet menjeherë pas rekrutimit, pra pasi viktima ka vendosur të zhvendoset prej vendbanimit të tij dhe transportimi I viktimës mund të realizohet si brenda ashtu edhe jashta shtetit të vet duke kaluar edhe rrugë të gjata të cilët mund të zgjasin edhe ditë apo javë të tëra. Themi se mund të zgjasë ditë apo javë të tëra përshkak se transportimi i tyre varet nga ajo se viktima a është me dokumentacion të rregullt e cila do të siguroj hyrje-daljet legale ose ilegale, si dhe varësisht nga largësia e territorit ku duhet të vendoset. Në këtë fazë mund të llogarisim edhe lëvizjet e migrantëve të cilët pranojnë nga kontrabanduesit të ndihmojnë në kalimet ilegale të cilët më tutje mund të vikzimizohen nga trafikantët për shfryëtzimin e tyre. Hyrja e paligjshme në vendet e tjera është gjithashtu e lidhur me këtë veprimtari kriminologjike, duke shmangur kalimet kufitare për përfitime ose përfitime të tjera.[876] Gjatë transportimit të viktimave e cila realizohet më transportin legale pra hyrje-daljet kufitare me dokumentacion të rregullt por ajo realizohet edhe në mënyrë ilegale dhe të parregullt si: transporti me automjete private, ose automjete për bartje të udhëtarëve taksi, minibus apo autobus, ecja në këmbë përmes maleve apo pyjeve për të kaluar kufirin shtetëror të një shteti konkret, dhe raste të ngjajshme ose përmes dokumentacionit apo identitetit të falsifikuar të viktimave. Transportimi fillohet me dorrëzim-pranim të viktimave prej *"rekrutuesit"* në *"transportuesin"* apo shoqëruesin e viktimës i cili duhet të transferoj në vendin e destinacionit e cila shpesh bëhet me mashtrimin e tyre por edhe me kanosje dhe frikë. Kur transportimi i parregullt bëhet përmes kufijve zyrtar, me anë të dokumenteve të falsifikuara, transportuesi/shoqëruesi udhëheq me viktimën sepse shpesh kemi ndihmë nga nëpunësit kufitar i korruptuar të cilët bashkëpunojnë me trafikantët. Në këtë fazë, viktimat janë në një gjendje të kaosit piskologjik duke mos qenë në dijeni se ça po ndodh , dhe ende shpresojnë në premtimet për një punë legale ku do të përfitojnë, sidomos viktimat të cilët janë me dokumente të falsifikuara janë gjithnjë e më të motivuar të bashkëpunojnë dhe ndëgjojnë udhëzimet e transportuesit/shoqëruesit. Gjatë transportit, viktima mund të shitet nga një në një trafikant tjetër, pa e ditur ajo ate, si dhe shpesh të zhvendoset pa pëlqimin e saj"[877], për ate shfrytëzimi i viktimës mund të realizohet edhe para arritjes në vendin e destinacionit.
Pra, nga e gjith kjo që u cek më lartë mund të përfundojmë se transportimi i viktimave të trafikimit mund të realizohet në dy mënyra dhe ate:

[875] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.18
[876] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.212
[877] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.20

a) Transportimi legal dhe I rregullt I viktimave ka të bëjë me mashtrimin e plot të tyre që të transportohen prej vendit të origjinës drejt vendit të destinacionit me dokumentacion të rregullt, vizë turistike ose të punës, dhe
b) Transportimi ilegal dhe të parregullt ka të bëj me transportin përmes rrugëve ilegale ose përmes dokumentacionit të parregullt dhe të falsifikuar.

Shumë grupe, individë dhe organizata legale, gjysmëlegale, por edhe mafioze, fitojnë shuma të mëdha të parave duke organizuar bartjen ilegale të këtyre viktimave në nevojë, me dokumentacione false ose pa dokumentacion fare[878], por fatkeqësisht në kushte shumë të rënda dhe të rrezikshme. Kushtet dhe mjetet me të cilat realizohet transportimi është i rëndësisë së veçantë për viktimat për shkak të ruajtjes së shëndetit dhe jetës së viktimave. Shumë shpesh ndodh që shumica e njerëzve të mos arrijnë në vendet e destinacionit si shkak i kushteve të transportit: kushtet e rënda klimatike si ftohje, mbytje dhe të ngjajshme, dhe si shkak i mjeteve transportuese: mbytje në pjesë të fshehta të automjeteve si shkak i frymëmarrjes së rënduar cilët me orë të tëra rin aty derisa të kalohet kufiri shtetëror, mbytjet në ujëra të lumenjve ose në det të cilët në shpesh janë të stërmbushura dhe të vjetra. Kushte të këqija gjatë udhëtimit - shkelje e marrëveshjes së mëparshme nga trafikanti, për shembull, mbërritja në një vend tjetër të destinacionit, jo në vendin e rënë dakord më parë, udhëtimi në grupe të mëdha të stërmbushura dhe mënyra dhe mjete të pasigurta të transportit, transferimi nga trafikanti në trafikant, abuzimi fizik, psiqik dhe seksual dhe të tjerë.[879] Janë të njohura rastet e avarive të anijeve, mjeteve të tjera transportuese, mbytjeve në masë nëpër dete, lumenj, ose asfiksime në kamionë dhe mjete të tjera joadekuate të bartjes së tyre klandestine.[880] Aksidente trafiku të këtij lloji ka pasur edhe gjatë kalimit të migrantëve në territorin e Maqedonisë cilët kanë përfunduar me lëndime të rënda trupore dhe me vdekje të migrantëve. "Më 24 prill 2015, afër Velesit, një tren vrau 14 refugjatë, nga të cilët së paku gjashtë ishin persona të mitur. Gjatë periudhës nga fundi i vitit 2014 deri në maj të 2015, u vranë së paku 29 refugjatë dhe migrantë, duke përfshirë foshnjë, fëmijë dhe gra."[881]

2.2.3. Faza e transferimit

Transferimi është hapi i parë që bëhet menjëherë pas arritjes në vendin e destinacionit dhe këtu realizohet e ashtuquajtura dorëzim-pranim i viktimës. Transferuesit janë ata që e marrin viktimën nga transportuesi me qëllim të fshehjes, strehimit dhe fillimit të fazës së fundit të trafikimit, pra të fshehjes dhe shfrytëzimit të viktimave. Nga praktikae trafikimit, është vërtetuar se personat ndaj të cilët transferohen ose dorëzohen viktimat janë persona që do të përfitojnë nga viktimat me shfrytëzimin e tyre, pra janë blerës të cilët në pjesë dërmuese janë pronarë të lokaleve, fabrikave, punëtorive, pra të objekteve ku viktimat dë të punojnë dhe dë të shfrytëzohen.

Shpesh herë, këta persona pretendojnë dhe mbrohen me ate se ata nuk janë të përfshirë në veprimtari kriminale të trafikimit me qenie njerëzore. Megjithatë, këta janë persona apo pronarë të cilët do të përfitojnë plotësisht ose pjesërisht nga shfrytëzimi i viktimave varësisht nga marrëveshja paraprake me grupin e krimit të organizuar dhe të trafikantëve. Prandaj, shpesh nga ato kurrë nuk do të përmirësohen, pasi ato vazhdojnë të paguajnë transferimet e tyre të paligjshme kur të arrijnë në vendin që ata dëshirojnë, kjo është arsyeja pse disa detyrohen të kryejnë vepra të

[878] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.109
[879] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.18
[880] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.110
[881] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.10

ndryshme.[882] Kështu, me transferimin realizohet edhe arritja e sigurt e viktimave në vendet e destinacionit dhe dorëzimi i tyre pronarëve të vendeve të punës e cila për nga kohëzgjatja është më e shkurtër në krahasim me fazat tjera të trafikimit.

2.2.4. Faza e fshehjes dhe shfrytëzimit

Pas mbërritjes në destinacionin përfundimtar, viktima tashmë është e vetëdijshme se ajo është viktimë e trafikimit njerëzor dhe nëse nuk pranon të bashkëpunojë me blerësin, ajo i nënshtrohet dhunës, shantazhit dhe kërcënimeve për jetën e saj ose jetën e anëtarëve të familjes së saj dhe se do të jetë e deportuar nëse njofton policinë dhe kështu e kanë shumë vështirë të pamundur të lirohen apo të arratisen nga kjo situatë viktimat. Kjo për arsye se dokumentet personale, pasaportat, paratë apo gjësendet e tjera me të cilat do të mund të identifikoheshin, u merren dhe në këtë mënyrë atyre u kufizohet liria e lëvizjes, mbyllen gjatë tërë ditës, ndërsa gjatë natës duhet t'u ofrojnë shërbime seksuale klientëve.[883] Kjo i bën viktimat pa identitet dhe konfirmon statusin e tyre të paligjshëm në vend dhe i pamundëson që ata të kërkojnë ndihmë, të kthehen në vendin e tyre ose të ikin në një vend tjetër.[884] Gjegjësisht, dokumentet e viktimës mirren në momentin e blerjes së viktimave dhe strehim-akomodimin e tyre në objekte të fshehta dhe larg njerëzve, sidomos objektet e strehimit dhe të fshehjes janë objektet e njejta me vendin e punës. Akomodimi, nënkupton sigurimin e një vendi për jetesë, sigurimin e nevojave të tij.[885] Për punën e kryer nga viktimat gjegjësisht nga shfrytëzimi i tyre për qëllime të ndryshme, viktimat nuk paguhen ose paguhen formalisht vetëm për mbijetesë ose në sasi minimale që u dërgohen familjarëve. Mos pagesa nga trafikantët dhe pronarët e vendeve të punës ka të bëjë me marrëveshjen paraprake të trafikantëve dhe pronarëve të vendeve të punës me preteksin se duhet koh që të paguajnë borxhin paraprak, dhe se pagesat shkojnë në ushqimin, veshmbathjen. Pra, viktimat në fazën e fshehjes janë të nënshtruara mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes së trafikantëve dhe shfrytëzuesve dhe ate: fshehja dhe kufizimi i lirisë së lëvizjes së viktimave, konfiskimi i dokumenteve të udhëtimit, mospagesa për punët e kryera të viktimave, përdorimin e shtrëngimit, dhunës, kanosjes, frikës, mbajtja peng. Atyre u mohohet kontakti me familjen e tyre, shpesh të izoluar, gjë që i bën ata të varur nga trafikanti.[886]

Edhe në këtë fazë ndihma e njerëzve të institucioneve shtetërore është më se e nevojshme për trafikantët me qëllim të shfrytëzimit të tyre përshkak se në këtë fazë pëson përfitimi material nga shfrytëzimi i viktimave si: për prostitucion (rrugëve, sallone masazhe, vende hotelierike), punët të detyruar (ndërtimtari, bujqësi, miniera, plantazhe, fabrika), lëmosha e organizuar (rrugëve, qendrave të qyteteve, para qendrave tregtare, rrugëve të tregjeve të qytetit ku ka lëvizje të njerëzve), heqja e organeve (shtëpi private, spitale private) dhe kryerja e krimeve (vjedhje, shitja e substanvave narkotike, vrasje). Këta persona janë të punësuar në vende që u nevoiten trafikantëve që pa pengesa të zhvillojnë veprimtarinë e tyre ilegale si: policë, nëpunës në sektorin për të huaj kuadër të policisë, nëpunës në ambasada të vendeve të viktimave sidomos policë kufitar dhe nëpunës doganor që lejojnë paraprakisht hyrjet ilegale. sidomos nëpunësve kufitar dhe doganor. Përkundrazi kontrolli doganor është një veprimtari e cila duhet të jetë shumë profesionale dhe

[882] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.148
[883] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.106
[884] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.22
[885] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.326
[886] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.16

objektive me qëllim të pengimit të çdo lloji të kalimit kufitar të paligjshëm të personave dhe të mallrave sepse nga këtu sigurohet hyrja e viktimave. Kontrolli doganor është kryerja e veprimeve konkrete siç janë inspektimi i mallrave, kontrolli për ekzistimin, besueshmërinë dhe saktësinë e dokumenteve, inspektimi i librave të punës dhe evidencave të tjera, inspektim dhe kërkim të mjeteve të transportit, inspektimit dhe kërkimit të bagazhit personal dhe mallrave të tjerë të cilat i mbajnë personat me ose mbi vete, kryerjen e hetimeve zyrtare dhe veprime tjera të ngjashme në drejtim të respektimit të rregulloreve doganore, dhe kur ëhtë e nevojshme edhe të rregulloreve të tjera që vlejnë për mallra që është objekt i mbikëqyrjes doganore.[887]
Shembuj më të shpeshtë për eksploatim dhe keqpërdorim nga punëdhënësit janë:
- prishja e kontratës së dakorduar në fillim
- punëtorët punojnë orë të gjata, rroga nuk u paguhet aspak ose jo në tërësi, nuk e marrin shumën e rrogës së dakorduar ose paguhen pa të holla dhe/ose punojnë në ndonjë sektor tjetër nga sektori i dakorduar;
- nuk kanë të drejta për pushim mjekësor dhe/ose të drejtë pushimi;
- kryejnë punë të rrezikshme;
- maltretimi fizik, shpirtëror dhe seksual;
- izolimi shoqëror dhe vendosja substandarde;
- ushqimi joadekuat.[888]

2.2.5. Faza e ritrafikimit ose riciklimi i viktimave

Përveç shkeljeve të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut si pasojë e shfrytëzimit të viktimav, gjendja përkeqësohet edhe më shumë nëse pas abuzimeve viktimat ritrafikohen ose riciklohen trafikantëve, grupeve kriminale të tjera me qëllim të shfrytëzimit. Dalja nga ky zinxhir i trafikantëve dhe grupeve të viktimave është pothuajse e pamundshme, në anën tjetër edhe nëse dalin ata janë prap të rrezikuar dhe viktima potencial të ritrafikimit ose riciklimit sepse rimëkëmbja, tejkalimi i traumave dhe krizave të përjetuara, paragjykimi, mospranimi apo refuzimi i pranimit nga familja dhe shoqëria që e rrethon viktimën prap janë të cenueshme dhe të ekspozuara ndaj ri-viktimizimit, viktimizimit të sërishëm apo viktimizimit sekondar. Si shkaqe të tilla rëndom përmenden: frika nga kryerësi, kërcënimi nga kryerësi apo të afërmit e tij, frika nga turpi dhe gjykimi moral i mjedisit, droja nga ekspozimi i rrezikut edhe më të madh për jetë të vetvetes apo të afërmve më të ngushtë, mosbesimi në efikasitetin dhe objektivitetin e organeve të drejtësisë, frika dhe pasiguria fizike e shpirtërore nga viktimizimi sekondar etj.[889] Me rëndësi është mendimi i popullatës për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore sidomos me qëllim të prostitucionit e cila është e shprehur më shumë në vendin tonë, se kanë njerëzit paragjykime për ti pranuar si viktima apo si kryerës ose njerëz të pamoralshëm dhe me këtë kemi mendimin e të anketuarve sim ë poshtë. Se sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit sipas moshës meshkujt janë të mendimit me 191 se nuk e dine, pak me 179, aspak 177 mesatarisht 83 dhe shumë 20, kurse femrat 213 nuk e di aspak 148 pak 132 pak mesatarisht 53 dhe shumë 4. Nga kjo del se pranimi i viktimave si njerëz jo të rrezikshëm pa paragjykime mendojnë shumë pak dhe ate vetëm 323 persona nga 1200 të anketuar dhe nëse e shtojmë edhe mendimit se nuk e di me 404 atëherë ajo është një mendim shumë negative dhe jo

[887] Закон за царинската управа, Службен весник на РМ, бр.46/2004, neni 2, paragrafi 9
[888] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.18
[889] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, vep. e cit., fq.55

përmirësues për viktimat që mund të ndikojë në riviktimizimin e tyre. Kjo më së miri vërehet në tabelën nr.9.

Tabela nr.9 Pyetje nga anketa: Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni sipas gjinisë

		Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni?					
		Aspak	Nuk e di	Pak	Mesatarisht	Shumë	Gjithsejt
Gjinia:	Mashkull	177	191	179	83	20	650
	Femer	148	213	132	53	4	550
Gjithsejt		325	404	311	136	24	1200

Tabela nr.10 Pyetje nga anketa: Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni sipas nivelit të arsimit

		Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni?					
		Aspak	Nuk e di	Pak	Mesatarisht	Shumë	Gjithsejt
Niveli i arsimit:	Fillore	33	87	42	20	2	184
	Mesme	169	226	151	75	19	640
	Fakultet	107	84	104	37	3	335
	Magjistër	11	7	13	4	0	35
	Doktorant	4	0	1	0	0	5
	Të tjerë	1	0	0	0	0	1
Gjithsejt		325	404	311	136	24	1200

Tabela nr.10 ka të bëjë anketën e popullatës sipas nivelit të arsimit se si mendojnë për rrezikshmërinë e kthimit të viktimave në shoqëri dhe ate mendim pozitiv apo aspak nuk ka rrezik nga 325 persona më shumë janë me shkolë të mesme që tregon se viktimat I pranojnë si viktimë e jo me paragjykime më pas me 107 të anketuar me fakultet, interesant është tek personat magjistra janë të mendimit vetëm 11 persona nga 35 të anketuar. Mendim pozitiv kanë dhënë edhe personat me arsim fillor me 33 të anketuar por më shumë nuk dijnë se a janë të rrezikshëm ose jo dhe mendimit pak janë me 42, mesatarisht me 20 dhe shumë 2 të anketuar. Shumë të rrezikshëm domino nata me shkollë të mesme me 19 të anketuar më pas fakultet me 3 dhe 2 të anketuar me arsim fillor. Me përgjigjen aspak dominon personat me shkollë të mesme 169, me fakultet 107 fillore 33 magjistra me 11 doktorant me 1 dhe të tjerë 1. Vetëm personat me doktoraturë 4 mendojnë se aspak ska rrezikshmëri kurse vetëm 1 mendon se ka pak.

Tabela nr.10 Pyetje nga anketa: Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni sipas regjionit

		Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni?					
		Aspak	Nuk e di	Pak	Mesatarisht	Shumë	Total
Regjioni:	Shkupi	139	138	110	38	2	427
	Perendim	117	187	129	64	18	515
	Jug	29	33	26	14	0	102
	Veri	32	40	35	13	4	124
	Lindje	8	6	11	7	0	32
Total		325	404	311	136	24	1200

Rastet e arratisjes apo ikjes së viktimave nga zinxhiri i trafikantëve eshe pse është shumë vështirë realizohet me ndihmën e bastisjeve, klientëve, qytetarëve që vërejnë një viktimë dhe ikja nga vet viktima. Thuhet se është vështirë të shpëtojnë për shkak të mënyrave të shtrëngimi në një anë dhe në anën tjetër përshkak të asaj se trafikantët viktimat e tyre i lëvizin shpesh prej një vendi në një vend tjetër. „Viktimat shpesh lëvizin nga një vend në tjetrin për të humbur orientimin e tyre se ku janë (nganjëherë ata as nuk e dinë se ku janë, madje as në cilin vend janë) dhe t'i parandalojnë ata të zhvillojnë miqësi dhe të bëhen të afërt me rrethinat e tyre. Po bëhet gjithashtu një ndërrim për të bërë më të vështirë për policinë që të mbledhë informacione dhe të prishë zinxhirin e trafikimit njerëzor.“[890] Duke u bazuar në shkaqet e viktimizimit të parë, apo shkaqe që kanë ndikuar që ata të viktimizphen sidomos në vendin e tyre të origjinës ekziston mundlsia që kur viktimat kthehen në vendbanimet e tyre ende ekzistojnë shkaqet e njejta të cilat ndikuan ë viktimizim nuk janë eliminuar, atap rap janë të cenueshëm dhe shkqet e njejta mund të ndikoj që atap rap të hyjnë në zinxhirine trafikimit dhe shfrytëzimit të tyre sit ë rriturit ashtu edhe fëmijët. “Fenomeni i trafikut të fëmijëve riciklohet disa herë. Jo rrallë është vënë re se në rastet kur femijët, viktima të trafikimit, kthehen në vendin e origjinës, ata gjejnë përsëri mundësi ilegale për tu rikthyer në vendet ku kanë qenë të trafikuar më parë.”[891] Nga intervistat e femrave të trafikuara, shihet se këto shpesh “shiten” dhe përcillen prej një shfrytëzuesi te tjetri, prej një qendre në tjetrën.[892] “Shumica e viktimave të trafikimit kthehen në të njëjtën situatë nga të cilat u përpoqën të shpëtonin - ambienti nuk e di dhe nuk dëshiron të dijë se çfarë u ndodhi atyre, ata nuk kanë asnjë shpjegim pse kthehen në shtëpi pa para, janë të frikësuar, ndjehen të poshtëruar duke besuar se janë të vetmit kujt i ndodhi diçka e tillë. Familja dhe institucionet shpesh hedhin poshtë çdo përgjegjësi dhe përveç kësaj imponojnë ndjenja faji dhe turpi, këto vajza shpesh nuk duan të kthehen në shtëpi. Duhet mbajtur mend se ka edhe kriminelë vendorë në të njëjtin mjedis që mund t'i gjejnë dhe rishitin ata.”[893] Nëse këta persona nuk pranohen nga rrethi ku jetojnë, nëse nuk ndihmohen që të punësohen, të pranohen si anëtarë të barabartë të shoqërisë e, veçanërisht në fazën tranzitore në të cilën jetojmë, atëherë ka mundësi që këta persona përsëri të merren me kriminalitet

[890] Priručnik za novinare “Trgovina ljudima”. Beograd, 2008, fq.17
[891] Raport. “Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri”. Tiranë, 2003, fq.7
[892] Halili, Ragip. “Viktimologjia”. Prishtinë, 2011, fq.106
[893] Priručnik za novinare “Trgovina ljudima”. Beograd, 2008, fq.18

qoftë si të mitur apo më vonë si person të rritur.[894] Politikat e trafikantëve dhe të grupeve të tilla kriminal për garantimin e kthimit të viktimave që kanë ikur nga ky zinxhir i trafikimit ka të bëjë edhe me shtatzënin e qëllimshme të trafikantëve kurse në këndvështrimine viktimës shtatzani e detyruar dhe e padëshiruar me qëllim që përsëri të kthehen tek grupet e tilla.

Andaj politikat e institucioneve përgjegjëse sidomos në lidhje me riviktimizimin e viktimave duhet të koncetrohet në politika preventive dhe parandaluese si përmirësimi i gjendjes sociale dhe ekonomike të viktimave dhe ofrimin e këshillave psikologjike nga ana e institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare duke mbështetur edhe kompensimin e demit të viktimave e cila llogaritet edhe si kushti më kryesor për përmirësimin dhe riintegrimin e viktimave në shoqëri, e cila sado pak ndikon në lehtësimin e dhimbjes, varfërisë dhe skamjes. Në rajon, ekzistojnë vetëm disa raste të dokumentuara në të cilat viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në fakt kanë pranuar kompensim nga trafikantët e tyre ose nga shteti (e cila dallohet nga nga dhënia e kompensimit)[895], e drejtë e cila viktimave u takon në bazë të ligjit por mos marrja e kompensimit në shumë raste buron përshkak të procedurave shumë të komplikuara dhe të stërgjatura e cila ndikon në joinkurajimin e viktimave të aplikojnë për kompensim dhe dëmshpërblim. Në rast kur kërkesa pronësoro-juridike nuk mund të realizohet nga prona e kryesit, sipas rregullave ligjore aktuale, për momentin vetëm viktimat e mitur të krimit, përfshirë viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në vendin tonë mund të paguajnë kërkesën (kompensimin e dëmit) nga ana e shtetit, gjegjësisht nga Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë.[896] ”Të pafajshmit duhet të gëzojnë më shumë përparësi se sa delikuentet kurse viktima më shumë se sa ai që e ka dëmtuar”[897], është një thënie e njohur në aspektin ndërkombtar në lidhje me procedurën e kërkimit të kompenzimit të demit (dëmshpërblimi i viktimave) që kanë pësuar nga një vepër penale e në rastin konkret nga trafikimi me qenie njerëzore e cila llogaritet edhe si masë preventive.

Pra, politika preventive duhet të përfshijë aktivitete në lidhje membrojtjen, ndihmën dhe parandalimin e viktimizimit sekondar, aktivitete dhe fushata për shpërnarjen informacionene për rrezikshmërinë nga trafikimi me qenie njerëzore sidomos në rrjetet sociale ku pjesëmarrja e njerëzve është e madhe, projekte ekonomike, psikologjike dhe sociale ndaj viktimave nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe organizatat joqeveritare etj. Në lidhje me parandalimin e viktimizimit sekondar apo riciklimit të viktimave shtetet duhet ti përforcojnë kontrollet kufitare dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve kundër kalime ilegale, të parregullta dhe me dokumente personale të falsifikuara.

2.3. Kompjuteri si mjet i kryerjes së trafikimit me qenie njerëzore (modus operandi)

Zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë informatike sidomos përdorimi i kompjuterit sot ka arritu niveline e lartë të përdorimit për shumë veprimtari positive të ndryshme të njerëzve por fatkeqësisht ka hapur rrugën edhe në keqpërdorimin e tyre. Një arsye e fundit por shumë e rëndësishme, lidhet me ndryshimin e modus operandi të trafikantëve por edhe si mjet i sotisifkuar për kryerjen e aktiviteteve kriminale në përgjithësi është edhe teknologjia informatike e cila e lehtëson dhe e përshpejton aktivitetet e tyre. Përdorimi i kësaj teknologjie ndikon edhe në uljen e shpenzimeve të trafikantëve për gjetjen, sigurimin, bindjen dhe mashtrimin e viktimave potencial

[894] Zejneli, Ismail. “Delikuenca e të miturve”. Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.102
[895] Извештај. “Трговија со луѓе во Западен Балкан”. IOM-Geneva, 2014, fq.60
[896] Анализа. “Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија”. Скопје, 2014, fq.28
[897] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina “Politika e luftimit të kriminalittit”. Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.106

e cila më herët realizoheshte me udhëtime, akomodime në vendet të ndryshme dhe bëlerje e dhuratave të shtrenjta me qëllim të bindjes dhe të mashtrimit. Përdorimi gjithnjë e më i përhapur i kompjuterëve dhe zhvillimi i teknologjisë kompjuterike kanë kontribuar në lehtësimin e bërjes së shumë punëve, komunikim më të thjeshtë dhe unik, ose më të shpejtë dhe më efikas, por gjithashtu mundësuan abuzim më të madh nga individë, grupe dhe organizata sistematike të formuara.[898] Përdorimi i tyre si mjet për realizimin e veprimeve kriminale në fusha të caktuara, duke përdorur mekanizma të automatizuar, për modifikim dhe manipulim të formave elektronike të vlerave shoqërore, siç janë programet kompjuterike dhe të dhënat të cilat prezantojnë mallin, paratë ose informatat, në rastin konkret, kompjuteri e mundëson dhe lehtëson punën e kryesit në realizimin e veprimeve të caktuara kriminale[899], pra kompjuteri paraqitet si modus operandi të shumë aktiviteteve kriminale në rastin konkret të veprës penale të trafikimit me qenie njerzore.

Von zur Muhlen (1973), i pari e ka shkruar punimin e gjerë shkencor mbi kriminalitetin kompjuterik, duke përdorur definicionin e gjerë mbi këtë dukuri, e cila, sipas tij, përfshin të gjitha sjelljet në të cilat kompjuteri është mjet dhe qëllim i veprimtarisë kriminale[900], sidomos të realizimit të trafikimi me qenie njerëzore sidomos në fazën e rekrutimit të viktimave potencial. Kompjuteri dhe internet ka ndikuar që shumë trafikantë me qëllim të prostitucionit por edhe vet vajzat që mirren me prostitucion duke i reklamuar dhe prezentuar klientëve të mundshëm përmes webfaqeve dhe profileve në rrjetet sociale dhe rrjetet që kanë të bëjnë me shërbimet seksuale. Ideatori i parë i Internetit ka qenë amerikani ***J.C.R. Licklidet***, i cili e ka vendosur ashtuquajturën rrjetën galaktike të rrjetit global, nëpërmjet të të cilit çdo njeri mund të ketë çasje të shpejtë në të dhënat dhe programet kompjuterike[901] gjegjësisht klientët të cilët interesohen për shërbime të ndryshme seksuale duke mundësuar grupeve kriminale të trafikimit me njerëz zhvillojnë dhe intensifikojnë edhe më shumë shfrytëzimin kompjuterit dhe të internetit për qëllimet e tyre sidomos në industrin e seksit. Kompjuteri sot konsiderohet si një ndër mjetet më të përsosura dhe ofron mundësi që të bisedohet me ndonjë person në ndonjë vend tjetër të botës, të punohet ndonjë prezantim, i cili në të njëjtën ditë do të mund të vlerësohet diku tjetër në botë, etj.[902] Krimi kompjuterik është një lloj i delikuencës, gjegjësisht tipologji e fenomeneve kriminale që është krijuar në lidhje me keqpërdorimin e teknikën, teknologjinë dhe elektronikën kompjuterike[903] nga grupet e krimit të organizuar sidomos të trafikantëve. Në Kodin Penal të Maqedonisë në nenin 251, 251-a, 251-b është paraparë vepër penale, dëmtim dhe hyrje e paautorizuar në sistemin kompjuterik, ai i cili në mënyrë të paautorizuar do të fshijë, ndyshon, dëmton, apo në ndonjë mënyrë tjetër do të pamundësoj përdorimin e sistemit kompjuterik.[904] Gjithashtu Kodi parasheh edhe mashtrimin përmes kompjuterit si vepër penale dhe ate me sa vijon: "Ai i cili me qëllim për vete ose për dikë tjetër përfiton dobi pronësore duke futur në kompjuter ose sistemin informatik të dhëna të pavërteta, duke mosfutur të dhëna autentike, duke falsifikuar nënshkrimin elektronik ose në mënyrë tjetër shkakton rezultat joautentik gjatë përpunimit elektronik ose bartjes së të

[898] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.219
[899] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.33
[900] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.287
[901] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.38
[902] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.139
[903] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.219
[904] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.139

dhënave"[905] dë të përgjigjet për veprën penale të mashtrimit kompjuterik sipas dënimit të paraparë në bazë të këtij Kodi. Sipas autorit ***Sykiotou***, viktimat krejtësisht të pafajshme janë: viktimat si p.sh., të rinjtë dhe fëmijët që duke kërkuar nëpër web faqet „jo të dëmshme", joshen nga web faqet pornografike, web faqet e paraqitura si punë-kërkues, grackat nga mashtruesit e agjencive të punësimit dhe viktimat që përdorin web faqet potencialisht të rrezikshme, në faqet e agjencive për martesa, pa qenë të vetëdijshëm për rreziqet që mund tu ndodhin atyre.[906] Kompjuteri si mjet i kryerjes së veprës penale, ku kryerësi e përdor kompjuterin për ta kryer veprën e caktuar penale, më së shpeshti mashtrimin, vjedhjen, shpërdorimin; kompjuteri si objekt i atakimit, me ç'rast kompjuterët dhe informacionet e vendosura në të janë qëllimi i atakimit kriminal qoftë kompjuteri objekt i dëmtimit, i çrregullimit ose i asgjësimit ose dëshirohet që në mënyrë të paautorizuar të nxirren informacionet të cilët janë të vendosura në të nga motivetë ndryshme; kompjuteri si mjet për organizim, planifikim, udhëheqje dhe realizim të aktiviteteve kriminale[907] nga ana e personave ose grupeve kriminale për kryerjen e veprave të ndryshme kriminale ku bën pjes edhe vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore.

Pra, nga kjo u cek më lartë del se organizatat e krimit të organizuar sidomos të trafikimit me qenie njerëzore e kanë të ndryshuar modur operandin në lidhje me përdorimin e teknologjisë kompjuterike dhe të komojuterit si mjet për kryerjen e aktiviteteve kriminale e cila sot është më se e përsosur dhe e sotisfikuar për to. Sidoqoftë, është e nevojshme që shtetet të veprojnë me anti-teknologji gjegjësisht system kompjuterik më të zhvilluar dhe përparuar me qëllim të zbulimit dhtë rasteve të keqpërdorimit të trafikantëve, me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie sidomos ndaj të rrinjve të cilët janë përdorues masovik të kompjuterit dhe internetit dhe të cilët janë shënjestra primare e trafikantëve sidomos grat dhe vajzat e reja. Sektori për kriminalitet kompjuterik dhe forenzikës digjitale (SKKFD) në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme u themelua në vitin 2013 e cila I ka ingerencat me sa vijon:

- "Ndërmarrja e masave dhe veprimtarive për prevencion dhe zbulimin e rasteve që lidhen me kriminalitetin kompjuterik,
- Veprimtari proaktive për lokalizimin dhe identifikimin e kryerësve të veprave penale nga fusha e kriminalitetit kompjuterik,
- Zbulimi dhe parandalimi i formave më serioze të kriminalitetit kompjuterik, veçanërisht të veprave të drejtuara drejt infrastrukturës kritike informatike të vendit,
- Pjesëmarrje aktive në hetimet rajonale dhe ndërkombëtare tëë fushës së kriminalitetit kompjuterik;".[908]

Në këtë kategori, proceset kompjuterike janë kyçe dhe ato shërbejnë për të mundësuar, lehtësuar dhe shpejtuar realizimin e veprave të caktuara kriminale dhe gjithsesi kompjuteri e krijon dhe ndihmon këtë ambient.[909] Kompjuteri mund të krijoj një maskë ideale për kryerjen e disa veprimeve të caktuara kriminale, duke ju dhënë atyre një kualitet të veçantë.[910] Ajo që është evidente, globalizmi, mediat dhe interneti janë duke pasur një ndikim të fuqishëm hapësinor dhe

---

[905] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 251-b, paragrafi 1

[906] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.112

[907] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.288

[908] Национална Стратегија. "Развој на воспоставениот систем за интегрирано гранично управување". Скопје, 2009, fq.9

[909] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.33

[910] Po aty, fq.35

kohor në ndërveprimin shoqëror midis popujve që kanë distancë fizike dhe njëkohësisht janë duke ndihmuar në intensifikimin e ndërkomunikimit në përmasa globale.[911] Sidoqoftë, transformimi i madh që po ndodh para syve tanë shoqërohet me implikime dhe pasoja të caktuara përcaktuesit kryesorë të të cilave janë varësia në rritje e komunitetit shoqëror nga teknologjia e re, ndjeshmëria e saj në rritje, dmth prekshmëria ndaj çrregullimeve që mund të rezultojnë nga ajo.[912] Nga ajo që u theksua më lartë, konstatohet se edhe përkundër anëve pozitive të shërbimeve të cilat i ofron Interneti, në raste të veçanta kjo mundësi elektronike e komunikimit sot në masë të madhe po keqpërdoret nga një kategori e caktuar e personave të cilët i bëjnë këto veprime me qëllim të përfitimeve materiale për vete apo për interes të personave të tretë.[913] Kështu, mund të thuhet se rekrutimi i viktimave të trafikimit përmes Internetit nuk është një formë e re, por thjesht një mjet i ri i rekrutimit në posedim të grupeve kriminale.[914] Këto rrethana dukshëm e ndihmojnë kryersin në kryerjen e veprave penale me efektivitetet, gjë që e vështirëson zbulimin dhe të provuarit e veprimtarisë së tij kriminale.[915] Tek vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore, trafikantët gjegjësisht rekrutuesit e viktimave e përdorin sistemin kompjuterik për mashtrimin dhe për rekrutimin e viktimave për procedurën e transportit të tyre ose për ofrimin e punëve, martesave apo bizneseve në vende ekomonikisht të zhvilluara. Zakonisht konsistojnë në futjen ose regjistrimin e të dhënave të pasakta me qëllim që vetes ose tjetërkujt t'i sigurojnë dobi të kundërligjshme pasurore.[916] Andaj luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit kompjuterik nga ana e trafikantëve është më se e nevojshme dhe shumë e vonuar.

KAPITULLI IV

AKTORËT E VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

1. Kuptimi dhe llojet e aktorëve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore

1.1. Kuptimi i aktorëve të trafikimit me qenie njerëzore

Në përgjithësi pothuajse çdo lloj i veprës penale nuk mund të realizohet pa pjesëmarjen e aktorëve të veprës përmes të cilëve kryhet vepra penale, dëmtohen nga vepra penale, si dhe aktorët persona apo institucione të cilat kanë një farë roli në vet procesin e veprës penale sidomos të trafikimit me qenie njerëzore. Grupi i parë i aktorëve emërtohen si aktorë aktiv, pra personat të cilët janë aktiv gjatë kryerjes dhe realizimit të veprës së trafikimit, persona të cilët janë kryerës të

[911] Ajazi, Kristina. Disertacion i doktoraturës "Sfidat e përkthimit në epokën e globalizmit. Globalizmi dhe ndikimi i tij në përkthimologji parë në qasjen e teksteve publicitare në anglisht dhe shqip". Tiranë, 2012, fq. 52

[912] Ачкоски, Југослав. "Сигурност на компјутерски системи, компјутерски криминал и компјутерски тероризам". Скопје, 2012, fq.19

[913] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti komjuterik". Prishtinë, 2009, fq.38

[914] Po aty, fq.110

[915] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.289

[916] Po aty, fq.290

kësaj vepre dhe janë përfitues finansiar ose ndonjë vlerë tjetër të çmueshëm. Pra, aktorët aktiv janë trafikantët individual, trafikantë të organizuar në grupe të vogla kriminale, trafikantë profesional të një grupi kriminel ose trafikantë të cilët janë anëtar të grupeve të ndryshme kriminale ndërkombëtare. Grupi i dytë i aktorëve që janë pjesë përbërëse e trafikimit me qenie njerëzore janë të llojit pasiv të cilët janë edhe si objekt atakues së trafikantëve dhe grupeve të ndryshme kriminale të krimit të organizuar. Këta persona quhen pasiv përshkak se nuk janë aktiv në këtë vepër por janë objekt sulmi dhe u kufizohen shumë të drejta elementare siç është e drejta e lëvizjes. Pra, me një fjalë tjetër këta persona janë vet viktimat dhe personat që pësojnë një dëm ngga realizimi i kësaj vepre penale ose persona të dëmtuar. Grupi tjetër apo grupi i tretë e cila llogariten si aktorë indirekt apo pjesëmarrës indirekt janë nëpunësit e korruptuar në institucionet shtetërore dhe zyrtarët qeveritarë ose zyrtarë që kanë për detyrë të luftojnë dhe parandalojnë këtë lloj të kriminalitetit e cila është shumë e rrezikshme për viktimat e saj por edhe për tërë shoqërinë. Për këtë arsye, krimi i trafikimit të qenieve njerëzore paraqitet si një dukuri komplekse dhe heterogjene dhe si pasojë e shumë faktorëve: ekonomik, politik, social etj., ndikojnë në paraqitjen edhe të aktorëve të ndryshëm të trafikimit me qenie njerëzore duke u dalluar nga profili i tyre. Arsyet e paraqitjes së aktorëve ka të bëjë me ate se aktorët aktiv insistojnë në përfitime materiale nga vepra, kurse aktorët pasiv direkt viktimat si shkak i mashtrimeve përshkak të varfërisë, papunësisë, luftërat etj., dhe si aktorë aktiv indirekt janë nëpunësit e korruptuar të institucioneve shtetërore të cilët për mos intervenimin dhe ndihmën indirekte ndaj trafikantëve janë përfitues material.

1.2. Llojet e aktorëve të trafikimit me qenie njerëzore

1.2.1. Aktorët aktiv të trafikimit me qenie njerëzore

Aktorët aktiv llogariten ata aktor të cilët më së shumti e inicojnë dhe realizojnë kryerjen e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe pa të cilat nuk do të kishim edhe realizimin e saj. Tek vepra e trafikimit me qenie njerëzore aktorët aktiv si kryerës të trafikimit mund të jenë vet liderët, organizatorët e grupit kriminel të organizuar, trafikantët, transportuesit, ndërmjetësuesit, shitësit apo blerësit, dhe të cilët janë përfitues direkt nga ky biznes shumë profitabil të cilët mund të paraqiten në çdo fazë të trafikimit me njerëz dhe ate në fazën e: rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes dhe shfrytëzimit dhe ritrafikimit të viktimave. Trafikimi me qenie njerëzore është një lloj krimi që mund të kryhet nga të dyja gjinit si nga femrat ashtu edhe nga meshkujt, sidomos në fazën e rekrutimit më shumë janë aktiv femrat që kanë përvojë në këtë drejtim sidomos në bindjen e viktimave potencial. Kësisoj, flitet për aftësinë e femrës që ta vejë në lajthim viktimën, për shfrytëzimin e vetive të saj fizike, për dinakërinë dhe për përdorimin e disa mjeteve të veçanta të kryerjes së veprave penale etj.[917] Në fazën e transportit, transferimit dhe shfrytëzimit ose riciklimit të viktimave janë meshkujt, kurse viktima janë të të dy gjinive por dominon gjinia femërore varësisht nga qëllimi i trafikimit. Çdo person ose grup që dëshiron të fitojë mjete financiare të paligjshme, ilegale dhe të shpejtë, mund të jetë kryerës i këtij lloji të krimit, motivimi kryesor i të cilit është të krijojë të përfitime të mëdha materiale.

Trafikantët kryejnë funksione të ndryshme me role aktive edhe para fazave të trafikimit, pra para rekrutimit, sidomos në krijimin e agjencioneve fiktive për punësime jashta vendit në sektorë të ndryshëm dhe reklamime të ndryshme në rrjetet sociale të internetit dhe në webfaqe, përmes të cilëve krijohet bazamenti për fillimin e gjetjes së klientëve, bindjes së tyre dhe më pas rekrutimit të tyre. Këto veprimtari të aktorëve aktiv janë shumë të rrezikshëm e cila ndikon edhe në pasigurinë

[917] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.132

shoqërore të vendit konkret ku atakohet kategoria e cenueshme, dhe të cilët janë edhe më të rrezikshme kur paraqiten grupe masovike të lëvizjeve të njerëzve siç ishte vala e migrantëve edhe në vendin tonë. Ndikimet negative kryesisht ndërlidhen me rrezikimin e sigurisë kombëtare, përfshirjes së migrantëve dhe të tjerëve në aktivitete të ndryshme kriminale dhe efekte tjera negative për vendin.[918] Pra, nga e gjith kjo shihet se aktorët aktiv bëjnë çmos që të vijnë deri në realizimin e veprave penale të trafikimit me qëllim të përfitimit material të përhershëm nga shfrytëzimi i viktimave.

Krimi kryhet gjithnjë e më shumë në shenjën e përdorimit të forcës, dhunës, terrorit, si pjesë e dhunës gjithnjë e më të pranishme në botën e sotme.[919] Trafikantët i ekspozojnë viktimat e tyre në dhunë psiqike dhe fizike, në të shumtën e rasteve për realizimin e qëllimit të prostitucionit ose për qëllime tjera. Por dhuna e aplikuar ndaj viktimave shkakton dëme dhe pasoja negative afatgjate pothuajse gjatë tërë jetës, dhe madje edhe nëse shpëtojnë ikjen nga trafikantët, ato lëjnë gjurmët e asaj. Aktorët aktiv përveç veprës së trafikimit me qenie njerëzore janë aktiv edhe gjatë proceseve të migracionit sidomos për emigrimin e personave nga vendet e tyre drejt vendeve të destinacionit e cila lidhet edhe me trafikantët dhe kontrabanduesit. Këta aktorë aktiv paraqiten edhe si ndërmjetësues duke i shfrytëzuar lidhjet familjare, miqësore duke i ndihmuar për të marrë vendime për migracionin, për të krijuar rrugët e migracionit, duke krijuar pasiguri, e cila me arritjen në vendin e destinacionit janë shumë afër viktimizimit nga trafikimi me qenie njerëzore dhe shfrytëzimi i tyre për qëllime të ndryshme. Grupet kryesore të përmendura të rrezikut ishin: punëtorët migrantë, të pastrehët, banorët e zonave rurale (të tërhequr nga mundësia e punësimit afatshkurtër)[920], pra banorë të vendeve ku dominon papunësia, varfëria dhe skamja. Këto lidhje përmes familjarëve dhe marrëdhënieve miqësore të aktorëve aktiv dhe viktimave potenciaë u ndihmon organizatave kriminale që më lehtë të transformojnë nga migrantë në kontrabandë me migrantë, e pastaj në trafikimin me qenie njerëzore. Këto familjarë të ashtuquajtur ndërmjetësues me nxitjen e viktimave potencial dhe me rritjen e kandidatëve të mundshëm përfitojnë nga kjo veprimtari. Karakteristikë për trafikantët është se një pjesë nga fitimi i fituar kriminal përdorin për korrupsion të nëpunësve shtetëror në institucione me qëllim të sigurimit funksionimit pa panegesa të veprimtarisë kriminale.[921] P.sh. njoftohet shpesh se vajza të moshës 13 deri 19 vjeç janë trafikuar nga të afërmit e tyre, përfshirë të afërm femra, si dhe prej të rinjsh që shfaqen si të dashur ose të fejuar.[922]

1.2.2. Aktorët pasiv të trafikimit me qenie njerëzore

Aktorët pasiv janë personat të cilët nga kryerja dhe realizimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore janë personat të cilët më së shumti dëmtohen dhe pësojnë humbje të mëdha nga shfrytëzimi që i bëhen duke filluar nga lirit dhe të drejtat themelore, shëndetin por edhe jetën e tyre dhe emërtohen si viktima. Sipas autorit ***Poasch*** me viktimë kuptojmë personin fizik apo juridik, të cilit i janë lënduar apo atakuar të mirat e tij të garantuara me ligj, si: jeta, integriteti trupor e moral, liria, prona etj.[923] Viktimat si aktorë pasiv në vet procesin e realizimit të trafikimit

[918] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.7
[919] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.73
[920] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.14
[921] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.7
[922] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.31
[923] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.48

janë persona që janë përfshirë në këtë vepër duke i mashtruar rrëmbyer, shitur ose blerë nga trafikantët, ndërmjetësuesit, shitësit ose blerësit duke shfrytëzuar pozitën e tyre të mjerueshme dhe të rëndë në vendbanimet e tyre të përhershme dhe kushtet familjare ku shpesh ekziston skamja dhe varfëria si dhe dhuna në familje ose duke i blerë nga të afërmit e tyre etj. Viktimat si aktorë pasiv varësisht nga shfrytëzimi i tyre nga krimi i organizuar në përgjithësi zgjidhen nga mesi i të rinjve femra sidomos me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion dhe punë të detyruar. Viktimat, para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, janë persona të cilëve u shkilen lirit dhe të drejtat themelore të njeriut të garantuar me drejtën nacionale si dhe me të drejtën ndërkombëtare. Viktimat e trafikimit të grave apo femrave, duke u gjendur në këto pozita të vështira të ekzistencës jetësore, rëndom i marrin vendimet për të dale jashtë vendit, me shpresë se do të gjejnë kushte më të mira të punësimit dhe sigurimin e një burimi të të ardhurave, që u mundëson një jetë më të sigurt për vete dhe për anëtarët e tjerë të familjes.[924] Pozicioni i një viktimë të mundshme dhe aktuale të një njeriu në sistemin juridik, përfshirë edhe tonën, nuk i plotëson të drejtat e tij njerëzore, dhe në radhë të parë ai ka të drejtën për jetën, shëndeti dhe siguria duhet të përmirësohen.[925] Shpeshherë këta persona hasen me diskriminim, dhunë, kërcënim, ngarkesë të borxheve marramendëse, kushtet teje të vështira për jetesë dhe shumë vështirësi të llojeve të ndryshme si në vendbanimet e tyre nga ku largohen por edhe në vendet e destinacionit ku ata shfrytëzohen. Gratë detyrohen të ofrojnë shërbime seksuale në klubet e natës ose në shtëpi publike[926], por fatkeqësisht shpesh ata fajësohen dhe trajtohen si kriminel dhe persona kryerës të veprës penale të prostitucionit për të cilën detyrohen të punojnë nga gruper kriminale, nga ana e shteteve ku gjinden. Gjatë arestimit në këto shtete ata u nënshtrohen një sjelljeje negative duke I dëbuar në mënyrë të pakontrolluar, kështu që këta prap po rrezikohen të bien në duart e trafikantëve. Viktimat nga shërbimet e ofruara fitojnë një sasi shumë të vogë të të ardhurave vetëm për të mbijetuar ose dërguar familjeve të tyre, dhe klientët mendojnë se këto femra prostitute nuk janë viktima por vet vullnetarisht janë të kyçur në prostitucion dhe zyrtarët e kontrollit mendojnë se janë të dyshimtë si kriminel e jo si viktima. Shpesh ndodh që në shkrimet e gazetave, viktimat e trafikut të fëmijëve të penalizohen, kurse trafikantët merren në mbrojtje.[927] Involvimi i fëmijës viktimë në aktivitete kriminale nuk duhet të rrezikojë statusin e tyre si fëmijë dhe si viktimë.[928] Fakti që viktimat paguhen në mënyrë ilegale me një sasi të ulët të financave për shërbimet e ofruara nuk i ndalon ata të jenë viktima të trafikimit me qenie njerëzore. Ushtrimi i prostitucionit që dëgjohet në vendet e viktimave sidomos të afërmit dhe familjarët e tyre i kufizon mundësitë e grave për të kërkuar ndihmë dhe i bën ata të dëshpëruar e cila mund të ndikoj që prap të bien në duart e trafikantëve.

Si aktorë pasiv idnirekt ose si pjesëmarrës indirekt paraqiten zyrtarët dhe nëpunësit shtetëror të cilët janë përgjegjës për luftimin dhe parandalimin e krimit pra këtë paraqiten si njerëz që luftojnë krimin dhe përpiqen të parandalojnë krimin gjatë gjithë fazave të trafikimit me qenie njerëzore. Por shpesh herë këta persona mund të jenë edhe arsyeja ose indikatorë kryesor të paraqitjes dhe përhapjes së ktëij krimi, dhe shpesh mund të gjeëmë në pzotiën e ndërmjetësuesve. Këta përfshijnë:

- Policë të korruptuar që janë të vetëdijshëm për rekrutimet që kanë bërë trafi kantët dhe nuk bëjnë asgjë për t'i ndaluar ata, ose pse kanë marrë ryshfetë ose për arsye të tjera.
- Njerëz që i transportojnë fëmijët nga një vend në tjetrin, si me automjete private ashtu dhe me mjete të transportit publik.

[924] Po aty, fq.105

[925] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.11

[926] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.698

[927] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.8

[928] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.155

- Falsifikatorë që u sigurojnë trafikantëve pasaporta ose dokumenta të tjerë identifikimi të rreme.
- Punonjës të korruptuar kufiri që pranojnë ryshfete për të nxjerrë viza ose për t'i lënë fëmijët të kapërcejnë kufirin pa dokumentat e kërkuara të identifikimit ose pa lejen shprehimore të prindëve (e cila në disa vende kërkohet përpara sesa fëmija të dalë jashtë shtetit pa qenë i shoqëruar nga ndonjëri prej prindëve). Punonjës të korruptuar kufiri që pranojnë ryshfete për të nxjerrë viza ose për t'i lënë fëmijët të kapërcejnë kufi rin pa dokumentat e kërkuara të identifi kimit ose pa lejen shprehimore të prindëve (e cila në disa vende kërkohet përpara sesa fëmija të dalë jashtë shtetit pa qenë i shoqëruar nga ndonjëri prej prindëve)[929].
- Punonjës të paaftë kufiri që nuk kontrollojnë siç duhet nëse të rriturit që shoqërojnë adoleshentët janë me të vërtetë prindët e tyre ose nëse këta kanë të drejtë t'i marrin ata me vete jashtë shtetit.[930] Askush nuk mundet kryerjen e funksionit, kompetencat zyrtare dhe pozita, si dhe punët nga interesi publik, ti shfrytëzojë për realizimin e qëllimeve personale[931]e cila ndalohet me ligjet pozitive të shteteve konkret.

Si aktorë tjerë pasiv pa të cilën nuk do të ekzistonte edhe vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore dhe ekzistimi i tyre e mban aktiv edhe këtë vepër penale është përfituesit nga shërbimet e viktimave të trafikimit gjegjësisht janë klientët e viktimave. Klientët janë ata të cilat i vizitojnë lokalet dhe objektet ku zhvillohet prostitucioni dhe janë burrimi kryesor i të ardhurave për viktimat dhe organizatat kriminale të cilët janë organizues të prsotitucionit. Vendet dhe objektet e vizitave të klientëve janë: saunat, sallon masazhesh, bare konsulente dhe kafene, dhe agjencitë që ofrojnë shërbime shoqërimi ose thirrjeje, barre, hotele, villa etj. Klientët edhe pse nuk janë të kyçur direkt në ciklin e trafikimit me qenie njerëzore siç janë trafikantët ose viktimat si aktorët kryesor, prap se prap këto kanë një rëndësi të veçantë sepse në bazë të tyre rritet ose zvoglohet edhe numri i viktimave të trafikimit edhe pse janë pjesëmarrës pasiv gjatë ciklit të këtij krimi. Klientët në bazë të qëllimit të shfrytëzimit të veprës së trafikimit me qenie njerëzore paraqiten si persona që i shfrytëzojnë dhe që janë paralelisht të kyçur me viktimat që shfrytëzohen për qëllime seksuale, të cilët paguajnë para për organet që janë vjedhur ose marrë, ose që ofrojnë mundësi punësimi për viktimat që përdoren për punë të detyruar dhe këto llogariten edhe si shkaktarë të paraqitjes së trafikikimit me qenie njerëzore. Kontrollimi i objekteve të tilla është, në veçanti, i nevojshëm duke pasur në konsiderim se këto nuk janë vetëm vende ku kryhet prostituimi i detyruar me dhunë, por edhe vende ku fshihen viktimat e trafikimit me qenie njerëzore deri në shitjen e tyre përfundimtare.[932] Kontrollet policore në objektet e lartëpërmendura më shumë orinetohen kundër viktimave sesa kundër kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore gjë që ndikon në mos zbulimin dhe dënimin e trafikantëve dhe kryerësve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit. Si p.sh,. gjatë racisë klasike në bordele, policia në tl shumtën e rasteve i burgos, i merr në pyetje, dhe i deporton gratë për shkak të prostituimit jolegal apo për shkak të punës jo legale, përderisa anëtarët e grupeve të organizuara kriminale ngelin të pa zbuluara dhe të pa dënuara.[933]

2. Përkufizimi i Profilit të kryerësve dhe të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore

[929] Po aty, fq.31
[930] Po aty
[931] Закон за спречување на корупцијата, (Пречистен текст), бр. 10-4275/2 од 12 ноември 2004 година, Скопје, neni 4, paragrafi 2
[932] Strategjia. “Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë”. Shkup, 2006, fq.9
[933] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë “Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike”. Tetovë, 2009, fq.146

Të gjithë mund të jenë kryerës të veprës së trafikimit me qenie njerëzore[934], si dhe viktimë e veprës së njejtë, por këta në vete ngërthejnë dhe janë të ndërtuara në karakteristika e tyre personale e cila emërtohet edhe si profil i aktorëve (kryerësve dhe viktimave) të trafikimit me qenie njerëzore. Studimi dhe shtjellimi i profilit të trafikantëve ose kryerësve si dhe të viktimave cilët njëkohësisht janë edhe aktorë kryesor të veprës së trafikimit me qenie njerëzore, pa të cilët nuk do të ekzistone vepra penale e trfikimit, do të ishte ndihmesë e veçantë shteteve dhe organeve përgjegjëse përmes veprimtarive profesionale dhe më aktive, me të vetmin qëllim luftimin dhe parandalimin e personave të paraqiten si kryerës ose ndërmjetësues të kryerjes së veprës penale të trafikimit me qeni njerëzore në një anë, dhe në anën tjetër të viktimizimit të personave të cilët llogariten si kategori e cenueshme e shoqërisë sidomos të femrave dhe fëmijëve varësisht nga qëlllimi i trafikimit. Pra, kjo kategori e shoqërisë në literaturë shpesh haset me terminologji të ndryshme, dhe ate si: grupe të rrezikuara, persona socijale të përjashtuara, grupe të cenushme të shoqërisë etj dhe ka të bëj me kategorinë e shoqërisë që mungojnë shumë gjesende jetësore. Materialisht të pasiguruara, persona nga bashkësi të caktuara etnike, persona/fëmijë të shfrytëzuar për punë, person/ fëmijë që lypin, persona/fëmijë me probleme në familje, fëmijë të përjashtuar nga procesi arsimor, fëmijë që jetojnë pa prind/kujdestar të caktuar, fëmijë nga institucione, të mitur të lënë pas dore/kryerës të krimeve, viktima të dhunës në familje[935] janë karakteristika të grupeve të rrezikuara, të cenuara, socijalisht të përjashtuara në shëqori që ndikojnë në viktimizim dhe që e përbëjnë profilin e viktimave të trafikimit.

Trafikantët e krimit të trafikimit me qenie njerëzore varësisht nga detyra dhe rolin të cilën e kanë mund të jenë të gjinisë mashkullore ose femërore, mosha ka të bëjë më shumë me moshën e mesme apo të pjekur të kryerësve, shumica e të cilëve janë me dosje paraprake kriminale. Sa i takon territorit dhe nacionalitetit të kryerësve duhet të ceket se varësisht nga organizata kriminale ata mund të dallohen, në kuptimin se nëse organizata kriminale është transnacionale kryerësit janë të vendbanimeve dhe nacionaliteteve të ndryshme dhe e kundërta nëse organizata është nacionale atëherë kryerësit janë të venbanimit dhe nacionalitetit ku edhe operon organizata kriminale. Në përgjithësi kryerësit janë me arsim fillor dhe të mesëm të cilët kanë pasur probleme sociale sidomos me punësim dhe varfëri dhe këtu kyçen me qëllim të përfitimeve materiale dhe aktivitetet e tyre i realizojnë gjatë stinës së verës dhe pranverës por nuk mungon edhe gjatë stinës së dimrit dhe vjeshtës si dhe trafikimin e realizojnë natën kur lëvizshmëria e qytetarëve tjerë është më e ulët. Viteve të fundit sidomos me përdorimin e kompjuterit si Modus Operandi, me fitimet e larta financiare, investimin e përfitimeve kriminale në veprimtari legale kanë ndikuar që në kuadër të grupeve të trafikimit të aktivizohen edhe persona me arsim të lartë të profesioneve të ndryshme. Një karakteristikë e veçantë e kryerësve të trafikimit është se ka edhe persona të cilët para se të bëhen trafikantë, kanë qenë vetë viktima të trafikimit cilët janë shftytëzuar, por për shkak të frikës, kërcënimeve, kanosjes, ose frika nga përdorimi i dhunës ndaj tyre dhe të afërme ose nga pranimi i ofertave të organizatave për përfitime materiale ata transferohen si trafikantë dhe anëtar të organizatave kriminale.

Përveç profilit të aktorëve kryesor të veprës së trafikimin ekziston edhe profili i aktorëve të cilët indirect janë aktiv, të cilët në masë të madhe ndihmojnë grupet e trafikantëve në realizimin e veprimtarive ilegale dhe të cilët janë përfaqësues apo nëpunës të institucioneve shtetërore cilët janë përgjegjës për luftimin e kriminalitetit, sidomos nëpunësit në Minsitrinë e Punëve të

[934] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.316

[935] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.9

Brendshme. Mirëpo, në mënyrë që nëpunësi policorë që është në gjendje të përgjigjet këtyre detyrave, ai duhet të është i arsimuar dhe profesional sepse nga policia kërkohet "aftësi e madhe dhe dituri, standarde të larta profesionele, autorizime të duhura ligjore dhe autorizime joformale, pamvarsi e caktuar, krenari profesionale, kritere të larta me rastin e punësimit, e para se gjithash lëvdëratë publike".[936]

Në realizimin e këtyre qëllimeve detyrimisht duhet të nisemi nga rezultatet shkencore deri tek të cilat kanë ardhur në taktiken kriminalistike, teknike, metodike, kriminologji dhe disiplinat tjera shkencore, me ndihmën e të cilave operativa policore në realizimin e detyrave të saja do të mund të shpreh shpejtësinë e masave, punëve dhe veprimin.[937] Në organizimin dhe rregullimin sistemor të vendeve në tranzicion potenciali i rëndësishëm njerëzor dhe ekonomik si dhe ai i përgjithshëm shoqëror, kryesisht zhytet në kërkesa dhe interesa personale që në njërën anë e dobëson shtetin në luftë kundër ktimit të organizuar e në anën tjetër dukshëm e ndihmon zhvillimin e krimit të organizuar i cili shkatërron pjesët më të shëndosha të atij vendi.[938] Shteti ynë dhe qeveria e saj si shtet në tranzicion nuk i përmbushin tërësisht standardet minimale e cila është si direktiv edhe nga faktori ndërkombëtar sidomos nga Bashkimi Evropian për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, por prap bëhen përpjekje të rëndësishme për realizimin e standardeve e cila është edhe kusht për anëtarësim të shtetit tonë në familjen evropiane, sidomos luftimin rigoroz zë krimit të organizuar dhe të korrupcionit. Profesionistët maqedonas marrin trajnime të vazhdueshme për identifikimin dhe luftë kundër trafikimit me qenie njerëzore[939] e cila është një hap i rrëndësishëm në profesionalizimin e kuadrove vendas, me shpresë për rezultate pozitive në këtë drejtim.

3. Profili i trafikantëve ose kryerësve të trafikimit me qenie njerëzor

3.1. Vëllimi dhe dinamika e trafikantëve

Vëllimi dhe dinamika e prezencës, përhapjes dhe të zhvillimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe të kryerësve lëviz varësisht nga prezenca e shumë faktorëve të cilët ndikojnë direkt në prezencën e trafikantëve në një vend. Vëllimi dhe numri i saktë varet nga rastet e zbuluara, të akuzuara dhe të dënuara e cila mund të jetë ndryshe numri i realtë i veprave të kryera. Themi ndryshe nga numri i realtë sepse shumë vepra penale ende nuk janë të zbuluara, ose vera e zbuluar por kryerësi ende nuk është i zbuluar, arrestuar apo të dënuar, pra vëhet fjalë për rastet që u takon numrit të errët dhe numrit të përhimtë të kriminalitetit. Kjo dukuri nuk është e re, megjithatë ndryshimet politike, shoqërore dhe ekonomike që përfshinë kontinentin në dekadën e fundit i kanë vënë një vulë të veçantë dinamikës së trafikimit[940]e cila varet edhe nga faktorë të cilët ndikojnë që në perriudha të caktuara kohore dhe vende të ndryshme numri i veprave penale të trafikimit dhe vet trafikantëve të rriten ose të zvogëlohen.

Kur flitet për praninë dhe shtrirjen e një fenomeni shoqëror, zakonisht bëhet përpjekje që të prezentohet dhe të zbardhen disa tregues kuantitativë ose vëllimi i tij në hapësirë apo kohë[941], si

[936] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.207
[937] Po aty, fq.90
[938] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.124
[939] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.3
[940] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.3
[941] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.49

p.sh., gjatë krizave të migrantëve rritet numri i rasteve të trafikimit me njerëz, gjatë stinëve të verës dhe të dimrit kur kemi ardhje të mërgimtarëve në vendlindjet e tyre rritet numri i veprave, trafikantëve po edhe të viktimave të tyre, ose kur kur shteti përforcon kontrollet kufitare, bastisjet në objekte të dyshuara në atë periudhë kohore kemi ulje të numrit të veprave, trafikantëve si dhe të viktimave të trafikimit.

3.2. Nacionaliteti i trafikantëve

Duke u bazuar në ate se kriminaliteti në përgjithësi e në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore është i pranishëm pothuajse në të gjitha vendet e botës, logjike është që edhe trafikimi dhe trafikantët të kryhen nga persona të nacionaliteteve dhe etniciteteve të ndryshme. Në lidhje me nacionalitetin e trafikantëve apo të kryerësve, ata mund të jenë të nacionaliteteve të ndryshme përshkak se në të shumtën e rasteve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore organizatata kriminale janë të llojit transnacional dhe duke pasur parasysh fazat e trafikimit që nga vendi i origjinës, vendit tranzit dhe në fund shtetit të destinacioniot mund të kalojnë në disa shtete si dhe në anën tjetër kërkesat e klientëve që i shfrytëzojnë shërbimet e viktimave të jenë të nacionaliteteve të ndryshme.

Përveç nacionalitetit të ndryshëm të trafikantëve të trafikimit me njerëz kjo është evidente edhe tek vepra penale e kontrabandës me migrantë dhe shumë vepra tjera penale të grupeve të krimit të organizuar. Përkatësia e ndryshme etnike është në veçanti evidente edhe në Organizimin e grupës dhe nxitjes në kryerjen e veprave tregti me njerëz, tregti me person të mitur dhe kontrabandë me migrantë, ndëshkues sipas nenit 418 v, ku mund të vërehet lidhja transnacionale me grupën e organizuar kriminale.[942] *"Të dënuarit N.F., M.S. së bashku me personin U. N., gjatë kontakteve të ndërsjella në vitin 2012 morën iniciativën për krijimin e një grupi, në mënyrë që të përfitonin përfitimin që kishte për qëllim kryerjen e veprave penale Kontrabandimi i migrantëve nga neni 418 - b, në të cilin grup anëtarësh gjithashtu u bashkuan me të dënuarit tashmë D. I., D. Gj., B. A., A. T., B. S., S. D., Lj. Lj., K.Lj., T.B., M. Z., të pandehurit M. M.dhe I.S., të cilët janë të paaritshëmedhe pas detyrave të përcaktuara më parë, duke përdorur të njëjtat raste në shum momente, gjatë vitit 2012, siguruan pritje, transport dhe strehim për mbi 60 migrantë".*[943] Kjo është e natyrshme si për veprën e trafikimit po ashtu edhe për veprën penale të kontrabandës së migrantëve për shkak të karakteristikave të tij transnacionale karakteristika, përkatësisht nevojës për t'u përfshirë në grup, si të shtetasve të Republikës së Maqedonisë me përkatësi të ndryshme etnike, ashtu edhe të shtetasve të huaj.


3.3. Gjinia e trafikantëve

Gjinia është një fenomen biologjik dhe si karakteristikë biologjike është e natyrshme dhe ndahet në dy grupe dhe ate: gjinia mashkullore dhe gjinia femërore. Gjinia është me rëndësi përshkak se në bazë të gjinisë shihet edhe profili i trafikantëve dhe gjinit dallohet sipas rolit, detyrës dhe qëllimit të trafikimit me qenie njerëzore. Lidhjet midis gjinisë dhe krimit janë të thella, të përhershme dhe paradoksale.[944] Sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në shumë vende të botës në SHBA, Gjermani, Francë, Angli, Japoni, dhe vendet tjera, deri në kohën më të re, gjinia

[942] Informacion. "Tregtia me njerëz dhe migrimi ilegal në Maqedoni në vitin 2009". Shkup, 2010, fq.24
[943] Aktgjykim nr.113 të datës 24.02.2016 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1
[944] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.381

mashkullore, përkatësisht kryerësit e veprave kriminale të gjinisë mashkullore, kanë dominuar në mënyrë absolute[945], gjë që nuk është edhe viteve të fundit ku në shumë vepra penale paraqiten edhe persona të gjinisë femërore.

Grafikoni nr.21 Kryerës madhor të paraqitur, akuzuar dhe gjykuar sipas viteve[946]




Siç shihet nga grafikoni i paraqitur sipas viteve numri i kryerësve të paraqitur në krahasim me numrin e kryerësve të akuzuar dhe gjykuar ka dallim të madh ku dominon kryerës të paraqitur, në anën tjetër kryerës të akuzuar është më shumë e cekur sesa kryerës të gjykuar dhe mund të përfundojmë se renditja sipas sasisë mund të renditet kryerës të paraqitur, akuzuar dhe gjykuar. Në ate se cili vit ka më shumë kryerës të paraqitur shihet se sipas viteve janë përafërsisht të njejt vetëm se dallohet me më shumë raste të paraqitur në vitin 2014 me 37164 kryerës kurse më pak në vitin 2015 me 26 069 kryerës ku dallimi mes tyre është në ulje prej11095 që është një dallim shumë i madh në krahasim prej 1 viti dallim. Në lidhje me kryerës të akuzuar viti me më shumë raste është në vitin 2014 që nënkupton se edhe kryerës të paraqitur në atë vit ka më shumë dhe është 13699 kryerës të akuzuar, kurse më pak është në vitin 2009 me 11905 kryerës, që paraqet një dallim prej 1794 të akuzuar. Në fund shihet se viti 2014 njejt si në rastet e paraqitura dhe akuzuara dominon me 11699 persona të gjykuar, kurse më pak të gjykuar ka në vitin 2012 me 9042 raste që paraqet një dallim prej 2641 persona të gjykuar. Nga e gjith kjo përfundojmë se dallimi në mes të minimumit dhe maksimumit kemi në personat e paraqitur me 11095, pastaj të gjykuar me dallim prej 2641 persona të gjykuar dhe në fund të akuzuar me dallim prej 1794 të akuzuar. Në përgjithësi edhe në vendin tonë si kryerës të veprave penale më shumë paraqiten persona të gjinisë mashkullore sesa femërore, që nga faza e zbulimit të veprës penale, akuzimi dhe në fund deri te gjyqimi i tyre, po është e shprehur edhe kryerës të gjinis femërore.

Grafikoni nr.22 Kryerës madhor të paraqitur, akuzuar dhe gjykuar, sipas gjinisë dhe viteve[947]

[945] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.131

[946] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Sudstvo/125_SK2_ml_T-19.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 15.07.2020, ora 09:21

[947] http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__Sudstvo/125_SK2_ml_T-19.px/table/tableViewLayout2/?rxid=3200dcc1-3228-4418-9d15-24f09d972990, të datës 15.07.2020, ora 10:52



Dallimi gjinor i personave të paraqitur, akuzuar dhe gjykuar qartë shihet një dallim të cekur mes dy gjinive ku dominon gjinia mashkullore dhe ate: në rastet e paraqitura gjinia mashkullore më shumë ka në vitin 2014 ka 35371 raste për dallim nga femra që ka më shumë raste në vitin 2014 me 1893 raste. Të akuzuar meshkuj më shumë ka në vitin 2014 me 12327, kurse femrat me më shumë raste të akuzuar në vitin 2013 me 1105 raste. Persona të akuzuar mes dy gjinive është si vijon: meshkuj të gjykuar ka më shumë në vitin 2014 me 10557 persona kurse gjinia femërore në vitin e njejt me 1126 persona të gjykuar. Pra shihet se në çdo vit dominon gjinia mashkullore me më shumë raste të paraqitur, akuzuar dhe gjykuar sesa gjinia femërore.

Në veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe migrimi ilegal, në vitet e fundit është evidente se pothuajse të gjithë kryerësit e veprave penale janë mashkuj.[948] Gjinia mashkullore gjatë trafikimit është evidente në fazat më të rrënda dhe më të rrezikshme siç janë: faza e transportit dhe e shfrtyëzimit si dhe nëse ekziston edhe riciklimi i viktimave prej një grupi kriminel në një grup tjetër përmes shitjes së tyre, kurse karakteristike është se gjinia femrore është evidente gjatë mashtrimit, gjetjes së klientëve, si dhe gjatë rekrutimit të viktimave.

Edhe pse raporti i meshkujve ndaj personave femra, të akuzuar për veprën penale tregon se në numër më të madh të rasteve kryerës janë të persona të gjinisë mashkullore, por në vepra ku thelbi i veprës përbëhet nga shfrytëzimi seksual i viktimës paraqiten edhe femrat si kryerës. Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtëpërdrejtë apo organizatore të krimeve të caktuara[949], ku bën pjesë edhe vepra e trafikimit me qenie njerëzore. Pas monitorimit të shkeljeve, u vërejt se burrat dhe gratë dallohen në shkallën e krimit dhe modelet e sjelljes kriminale.[950] Shënimet statistikore gati në të gjitha vendet e botës tregojnë se po rritet pjesëmarrja e femrave të mitura në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme kriminale, siç është marrja me prostitucion, marrja me bixhoz, kontrabanda me drogë dhe forma të reja të sjelljeve të rrezikshme kriminale.[951] Sipas disa të dhënave statistikore, nga literatura kriminologjike, në vendet e ndryshme, përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të përgjithshëm të personave të gjinisë femërore, sillet nga 8-10% të të gjithë pjesëmarrësve.[952]

3.4. Mosha e trafikantëve

[948] Пројект-Информација. “Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010”. Скопје, 2011, fq.19

[949] Halili, Ragip. “Kriminologjia”. Prishtinë, 2011, fq.131

[950] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. “Оксфордски прирачник за Криминологија”. Скопје, 2010, fq.381

[951] Zejneli, Ismail. “Delikuenca e të miturve”. Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.118

[952] Halili, Ragip. “Kriminologjia”. Prishtinë, 2011, fq.131

„Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. ***Këteleja*** (***Quetele***) e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit.“[953] Pikëpamja më e vjetër dhe më e pranuar në kriminologji, siç thuhet në pjesën e moshës dhe krimit, është se 1. Me moshën e avancuar, mundësia e kryerjes së krimeve zvogëlohet dhe 2. Në çdo moshë, burrat kanë më shumë gjasa të kryejnë krime sesa gratë.[954] Edhe pse mosha e kryerësve varësisht nga lloji i veprës penale, në përgjithësi si pjesëmarrës në kryerjen e veprave penale të rrinjtë nën moshën 18 vjet janë dominues dhe llogariten si të mitur dhe ata nën 14 vjet si fëmijë dhe në shumicën e shteteve sipas legjislacionit të tyre penal janë jashtë përgjegjësisë penale për veprën e kryer. Mosha e mitur ndahet në të mitur të rrinj, e cila përfshin moshën 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën 16-18 vjet[955] dhe ndaj të cilëve legjislacioni penal i shumë shteteve shqipton masa të kontrollit të shtuar nga ana e prindërve ose kujdestarit ose mbiqyrjen nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore sidomos nga entet sociale dhe institucionet tjera që kanë për detyrë kujdesin, trajtimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve dhe llogariten si masa mbrojtëse për fëmijë. Këto masa mbrojtjeje përfshijnë, kur është e përshtatshme, procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës.[956]

Sipas ***Michael Gottfredson*** dhe ***Travis Hirshi***, ekziston një prirje rritëse e niveleve të krimit që arrijnë kulmin në moshën e mesme dhe të re.[957] Mosha e kryerësve apo trafikantëve ka një rëndësi të veçantë në krahasim nga viktimat përshkak se rekrutimi i viktimave si fazë fillestare e cila fillon me mashtrimin dhe bindjen e kandidatëve potencial nevoiten persona-trafikantë me përvojë, psikologji bindëse me qëllim që viktimave të jep një përshtypje serioze dhe bindëse, sepse në fazën e rekrutimit të viktimave trafikantët janë persona në moshë më të rritur sesa viktimat që rekrutohen për shkak të aftësive të tyre për mashtrim dhe manipulim me qëllim të shfrytëzimit. Është e qartë se delikuenca dhe krimi janë dominues në moshë më të re[958], kurse tek trafikimi m në mëshë të mesme dhe më të rritur përshkak të rrezikshmërisë dhe bindjes së viktimave.

Nëse shikohen të dhënat statistikore, gjyqësore dhe të dhënat nga kërkimet empirike kriminologjike në botë, vërehet se moshat më prezente në veprimet kriminale janë moshat prej 25-30, pastaj grupi i moshës 30-50 dhe më pak grupi i moshës mbi 60 vjet.[959] Pra, varësisht nga mosha e kryerësve të veprave kriminale kryhen edhe veprat kriminale. Shpesh kemi raste kur persona të moshës së re paraqiten si kryerës së veprave penale të rënda siç është trafikimi me qenie njerëzore ose kontrabanda me migrantë. *“Aktgjykim në bazë të pranimit të fajita, të akuzuarit 1.A. B nga babi A., nëna M., i lindur më 26.11.1990 në Shkup. Ndërsa jeton në rr.4 nr.50 në f.Haraçinë, me NUAQ 2611990450087, shtetas i RM, i martuar, i papunësuar, student. 2. S. D. inga babai S., nëna S. i lindur më 27.11.19988, në Haraçinë me NUAQ 2711988453332, shtetas i RM, i martuar, baba i një fëmije të mitur,”*[960] të cilët akzuohen dhe dënohen për veprën penale të kontrabandës me migrantë nga nenit 418-b, paragrafi 2. Në përgjithësi, personat e moshës së re më shumë janë

[953] Zejneli, Ismail. “Delikuenca e të miturve”. Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.114
[954] Içli, Tülin Günşen. “Kriminoloji”. Ankara, 2016, fq.424
[955] Halili, Ragip. “Kriminologjia”. Prishtinë, 2002, fq.130
[956] Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve 44/25, 20 nëntor 1989, hyri në fuqi me 2 shtator 1990, neni 19, paragrafi 2
[957] Içli, Tülin Günşen. “Kriminoloji”. Ankara, 2016, fq.387
[958] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama”. Zagreb, 1985, fq.115
[959] Halili, Ragip. “Kriminologjia”. Prishtinë, 2011, fq.130
[960] Aktgjykim nr.89 të datës 27.09.2016 të Gjykatës Themelore Shkupi i Shkup, fq.1

kryerës të veprave më të lehta penale penale siç janë: vjedhjet, plaçkitjet, shitja e narkotikëve, kurse persona të moshës së mesme ose më të rriturit janë kryerës të krimeve siç janë: trafikimi me narkotikë, armë, terrorizmi, si dhe në rastin tonë trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabanda me migrantë dhe shumë vepra tjera kriminale të rrezikshmërisë së lartë.

3.5. Niveli i arsimimit të trafikantëve

Kur flasim për nivelin e arsimimit të trafikantëve, më herët trafikantët janë dalluar si persona që nuk kanë pasur arsim të duhur ose kanë qenë me arsim të mesëm, por, sot nën ndikimin e globalizmit dhe zhvillimit të teknikës dhe teknologjisë e cila ndikoj edhe ndryshimin e *Modus Operandit* të kryerësve vin në shprehje edhe trafikantë me arsim të lartë por edhe ato me studime postdiplomike të kryera. Kjo ndodh kështu përshkak se sot tek organizatat kriminale, anëtarët e tyre por edhe në shoqëri brenda për brenda është e njohur thënien: "sa më shumë fitim finansiar në rrugë ilegale dhe të shpejt". Por, prap si dominues janë trafikantët të cilët niveli i arsimimit është me arsim fillor dhe të mesëm. Në rastet nga trafikimi me qenie njerëzore, niveli i arsimimit të kryesit është dukshëm më i ulët, pra 50% janë me arsim fillor jo të kompletuar, 40% me arsim fillor, ndërsa 10% janë me arsim të mesëm të përfunduar.[961]

3.6. Territori (vendbanimi) i trafikantëve

Kriminaliteti mund të studiohet në raport me vendin e kryerjes së tij, ai është i përhapur sikurse në vendet rurale poashtu edhe në vendet urbane, mirpo kriminaliteti është i përhapur më shumë në zonat urbane se sa në ato rurale.[962] Në këtë drejtim, shpeshherë në literaturën kriminologjike përdoret termi „**Zona kriminale**" përmes të cilit dëshirohet të theksohen disa regjione ku kriminaliteti është më tepër i pranishëm se sa në regjionet tjera.[963] Në përgjithësi kriminaliteti siç janë: shitja e substancave narkotike, organizimi i bizhozit dhe lojërave të fatit, vjedhjet dhe plaçkitjet organizimi i ushtrimit të prostitucionit por edhe vet trafikimi me qenie njerëzore me qëllime të abuzimeve të ndryshme si dhe kontrabanda me migrantë më shumë janë prezente dhe dukshëm dita ditës rritet prezenca e tyre në shtete me popullsi të lartë, shtete dhe vende turistike, qytete të mëdha të njohura dhe tërheqëse për turistët si shkak i lëvizjes së madhe të qytetarëve dhe prezencës së bizneseve të mëdha. Në anën tjetër vendet apo rajonet rurale (fshatrat) janë më pak të prekura i shkak i mos pasjes së fuqisë ekonomike, numrit të vogël të popullatës, lidhjet miqësore dhe farefisnore në fshatra si dhe popullata në vende të vogla njihen në mes veti, gjegjësisht nga vendet rurale vijnë viktimat si shkak i mospasjes së kushteve për mirëqenie sociale. Por, mund të ceket se për gjetjen, sigurimin, mashtrimin dhe rekrutimin e viktimave të trafikimit me njerëz më shumë janë të përhapura në vendet rurale ku dominon papunësia, kushtet e rënda, diskriminimi, varfëria etj. Përveç kësaj, kryerësit e veprave penale mund të jenë edhe shtetes të huaj sidomos më shumë paraqiten edhe shtetas të shteteve fqinje në kryerjen e krimeve të ndryshme në vend. Kjo shihet edhe në Aktgjykimin-në bazë të pranimit të fajit nr.13/15 për të akuzuarin SH.B. me të dhënat: "*Preshevë, R.Serbisë, jeton në f.Ranatovcë, Preshevë, shqiptar, shtetas i R.Serbisë*".[964]

---

[961] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.20

[962] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.122

[963] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.128

[964] Aktgjykim Nr.13 të datës 27.02.2015 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

3.7. Statusi social i trafikantëve

Statusi social ka të bëjë me statusin e trafikantëve të punësuar ose të papunë. Në literaturën kriminologjike, një kohë të gjatë ka dominuar mendimi se kriminaliteti është karakteristik për shtresat e ulëta, sidomos për kategorinë e punëtorëve dhe njerëzve të papunë dhe të varfër.[965] Por, sot tek shumë vepra penale si dhe në rastin konkret edhe tek vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore si kryerës paraqiten edhe persona të shtresave të larta siç është e njohur edhe kriminaliteti i jakës së bardhë si dhe persona të cilët janë organizator të krimit të organizuar njëkohësisht janë edhe persona me biznese të mëdha legale ose me poste në qeveritë shtetërore. Në kryerjen e veprave Kontrabandë e migrantëve dhe Organizim të grupit dhe nxitje për kryerje të veprave tregti me njerëz,tregti me person të mitur,dhe kontrabandë e migrantëve,më shpesh janë të involvuar persona të papunësuar[966], por ekzistojnë edhe persona trafikantë të cilët kanë një profesion dhe janë të punësuar. Shumica e të pandehurve janë shoferë, gjë që nuk është për t'u habitur, duke marrë parasysh faktin se vepra është kryer në atë mënyrë që migrantët transportohen në vendinin tonë si tranzit ose nga territori i Republikës së Maqedonisë deri në vendkalimin kufitar të një vendi fqinj[967], të cilët shpesh paraqiten edhe si trafikantë nëse vazhdohet raporti i viktimave dhe të kontrabanduesve ose të trafikantëve edhe në vendin e destinacionit. Statusi social sidomos statusi i punësimit të kryerësve varet nga vepra penale gjegjësisht nga qëllimi I trafikimit me qenie njerëzore. Krahas personave të papunësuar të cilët paraqiten në përqindje më të madhe, dukshëm është edhe numri i personave të punësuar në objekte hotelierike[968], taksist veturash apo të minibusave, persona të korruptuar të policies, profesionist të teknologjisë informatike etj.

3.8. Gjendja martesore të trafikantëve

Gjendja martesore e trafikantëve është e ndryshme ku ata mund të paraqiten si persona që janë të martuar, jetojnë në bashkësi jashtëmartesore ose nuk janë të martuar. Nuk janë të pakta rastet ku në veprimtarinë kriminale të kryerësve paraqiten edhe anëtarët tjerë të familjes si bashkëshortët, partnerët, prindërit apo fëmijët duke e parë si biznes familjar, por ka raste edhe kur anëtarët tjerë të familjes nuk kanë aspak dijeni për aktivitetet kriminale të kryerësve. Trafikantët si prindë të fëmijëve të tyre përshkak të varfërisë dhe skamjes së madhe ka raste kur fëmijët e tyre dhe fëmijët e të afërme të tyre i viktimizojnë sidomos në veprat si martesa e detyruar, shitja e fëmijëve, shfrytëzimi seksuale etj. Është rritur shqetësimi për faktin se të rriturit përdorin fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale për të kryer aktivitete kriminale, pikërisht sepse e dinë që këta fëmijë nuk mund të përndiqen e se zakonisht do të lirohen menjëherë mbasi janë arrestuar.[969] Në bazë të shënimeve të evidencave statistikore të vendeve të ndryshme, vërehet se numri më i madh i kryerësve të krimeve, janë të martuar, në rend të dytë vijnë personat e pamartuar, personat e ndarë dhe të shkurorëzuar dhe në fund personat e ve.[970]

---

[965] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.133

[966] Informacion. "Tregtia me njerëz dhe migrimi ilegal në Maqedoni në vitin 2009". Shkup, 2010, fq.27

[967] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.21

[968] Po aty, fq.22

[969] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.112

[970] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.133

3.9. Veçoritë kohore dhe sezonale aktiviteteve të trafikantëve

Kriminaliteti si një fenomen global e në veçanti trafikimi me qenie njerëzore që është prezente pothuajse në çdo shoqëri, ku më pak e ku më shumë, posedon edhe disa karakteristika kohore dhe sezonale të realizimit të tyre. Shumë autorë në këtë drejtim kanë hulumtuar dhe vërtetuar në kërkimet e tyre empirike se kriminaliteti dallohet prej kohës në kohë, vërehen karakteristika të veçanta të kriminalitetit gjatë natës, ditës, gjatë sezonës, prej një regjioni në regjionin tjetër etj, ndonëse disa forma të kriminalitetit janë bërë gati universale për të gjitha regjionet e botës.[971] Varësisht nga lloji dhe forma e paraqitjes së kriminalitetit disa vepra penale paraqiten gjatë natës siç janë vjedhjet dhe plaçkitjet e rënda, vrasjet, ushtrimi i prostitucionit si dhe në rastin konkret trafikimit me qenie njerëzore si dhe kontrabanda me migrantë. Gjatë ditës më shumë paraqitej kriminaliteti i fëmijëve, mashtrime të llojeve të ndryshme. Sa i takon veçorive sezonale vlen të ceket së këto vepra penale më shumë janë të theksuara gjatë stinëve të pranverës sidomos stinës së verës kur edhe kushtet klimatike i konvenon në realizimin më të lehtë të këtyre veprave penale, kurse dimrit si shkak i kushteve jo të volitshme numri i këtyre veprave penale dukshëm zvogëlohet. Kryerja dhe realizimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore por edhe të kontrabandës me migrantë preferohet në stinët kur koha është e nxehtë përshkak të fazës së transportit të tyre mos të përballen me kushte të rënda klimatike siç janë: shiu, bora, stuhia dhe shkaqe tjera. Kurse sa i takon kohës brenda 24 orëve kjo vepër penale preferohet të kryhet në mesnatë drejt mëngjesit të hershëm kur lëvizshmëria e njerëzve dukshëm bie dhe pothuajse nuk ka lëvizje me qëllim që sa më leht dhe pa pengesa të realizohet kryerja e krimeve në përgjithësi si dhe të trafikimit, kontrabandës dhe shumë vepr tjera penale të krimit të organizuar.. "*Me datë 19.03.2011 rreth orës 04:00 me veturën "Pollo Klasik"me shenja të regjistrimit TE 910 CL, në pronësi të H.D-t në rr.Lublanska, tek Arabati Baba Teqe në Tetovë e ka bartur emigranten M.XH.* "[972] është një veçori kohore nga shumë rastet e regjistruara ku qartë shihet kohën në të cilën është bartur viktima. Këtu vlen të ceket ushtrimi i prostitucionit nga viktimat e trafikimit me njerët e cila është e kontrolluar nga trafikantët të bëhet në orët e vona të mbrëmjes deri në orët e mëngjesit si shkak i sigurisë së ushtrimit të detyrës së kundërligjshme me qëllim të moszbulimit dhe të ikjes sa më të lehtë nga bastisjet eventuale policore. Forcat e policisë janë thirrur që të analizojnë aktorët e grupeve të veprave kriminale për të identifikuar shkaqet diskrete dhe problemet si dhe për të formuluar përgjigjet e duhura[973], kjo do të thotë se çdo aksion i organizuar në zbatimin e masave kriminalistike duhet të përgaditet në atë mënyrë që ta befasojë kundërshtarin, pra, të mos e dijë ai këtë para kohës së duhur,[974] sidomos gjatë racioneve policore në vendet ku dyshohet se ka trafikim me njerëz ose ndonjë vepër tjetër penale. Në anën tjetër si stinë më e volitshme për kryerësit e krimit është stina e pranverës sidomos e verës si shkak i kushteve të volitshme për realizimin e krimeve. *"Më 26.08.2011 rreth orës 23:30 në afërsi të kufirit maqedono-grek tek vendi i quajtur Separaci, akuzuarit pas marrëveshjes paraprake dhe në bashkësi me qëllim të transportimit, i kanë pranuar migrantët.. "*[975] shihet qartë se vepra gjegjësisht pranimi i migrantëve është bërë në stinën e verës sidomos në muajin gusht të vitit 2011, kur edhe kushtet klimatike janë mjaftë të volitshme për lëvizjen e njerëzve.

---

[971] Po aty, fq.127

[972] Aktgjykim Nr.42 të datës 06.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

[973] Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011, fq.148

[974] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.18

[975] Aktgjykim nr.76 të datës 27.02.2012 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2

3.10. Recidivizmi (rikthimi) i trafikantëve

Recidivizmi ose përsëritja e sjelljes kriminale paraqet një formë të veçantë të manifestimit të kriminalitetit, që në vete ndërlidh rrezikshmërinë e posaçme shoqërore.[976] Recidivizmi po rikthimi i trafikantëve nënkupton se këta persona kanë dosje dhe më herët kanë qenë të kyçur në aktivitete kriminale si trafikantë, të cilët vazhdojnë ose prap kthehen në aktivitetet e tyre kriminale pas një kohe. Në veçanti interesante janë të dhënat për gjykueshmërinë e mëparshme personave të akuzuar, e cila duhet të ketë rol në vërtetimin e lartësisë së sanksionit të cilën do ta caktojë gjykata për kryerësin e fajshëm,si dhe për analizën e profilit të kryerësit të këtyre llojeve të veprave penale.[977] Të dhënat për dënimin e mëparshëm janë të rëndësishme, jo vetëm për analizën e profilit të kryesit të veprave penale, por edhe për matjen e sasisë së sanksionit që do të përcaktojë gjykata për kryerësin fajtor[978], gjë që e cila tregon se recidivizmi është i rrezikshëm si për shoqërinë ashtu edhe për shtetin.

Sipas kuptimit kriminologjik, recidivizmi nënkupton përsëritjen e sjelljeve kriminale dhe delikuente të një personi pa marrë parasysh se a ekziston më parë gjykimi i plotfuqishëm, ose pa marrë parasysh se a është mbajtur dënimi për veprat e mëparshme penale.[979] Kryerja e sërishme nga i njëjti person merret si indikator, se sjelljet e tija nuk janë të rastësishme dhe nuk kanë karakter episodik por janë fituar gjatë kohës nga faktorë të ndryshëm subjektiv dhe objektiv[980] e cila ndikon edhe në procedurat gjyqësore. Sipas nenit 39 paragrafit 2 „Gjyqi do t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë që dënimi të jetë më i vogël ose më i madh (rrethanat lehtësuese dhe rënduese), posaçërisht: shkalla e përgjegjësisë penale, nxitjet nga të cilat është kryer vepra, fuqia e kërcënimit ose shkeljes së të mirës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, kontributi i viktimës në kryerjen e veprës, jeta e mëhershme e kryerësit, gjasat e tij personale dhe sjellja e tij pas veprës së kryer penale, si dhe rrethana të tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit."[981] Në anën tjetër paragrafi 4 po njejtit nen cekën: „Kur gjyqë ia përcakton dënimin kryerësit të veprës penale të kryer në kompensim, në veçanti dë të ketë parasysh nëse vepra e mëhershme është nga lloji i njëjtë si edhe vepra e re, nëse veprat janë kryer nga nxitjet e njëjta dhe sa kohë ka kaluar nga gjykimi i mëhershëm, respektivisht nga dënimi i vuajtur ose i falur."[982] Sipas kuptimit juridiko-penal me recidivizëm nënkuptojmë kryerjen e përsëritur të veprave penale nga ana e personit i cili ka qenë më parë i dënuar për ndonjë vepër penale[983] e cila u vërejt në nenet e cekura të Kodit penal të Maqedonisë.

4. Profili i viktimave të trafikuara

[976] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.101

[977] Informacion. "Tregtia me njerëz dhe migrimi ilegal në Maqedoni në vitin 2009". Shkup, 2010, fq.26

[978] Пројект-Информација. "Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010". Скопје, 2011, fq.21

[979] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.230

[980] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.101

[981] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 39, paragrafi 2

[982] Po aty, paragrafi 4

[983] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.229

Viktimat janë të gjithë ata që vuajnë, nga një njeri tjetër dhe nga sistemi, në shoqëri dhe në natyrë[984], në rastin konkret vuajtjet që janë nga vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikantëve të tyre. Çdo person që i nënshtrohet rekrutimit, transportit, transferimit, blerjes, shitjes, fshehjes, shfrytëzimit me qëllim të prostitucionit, punës të detyruar, martesës së detyruar, lëmosha e detyruar, kryerja e krimeve, heqja e organeve nga trupi i njeriut ose ndonjë lloj të shfrytëzimit tjetër quhet viktimë. Profili i viktimave të trafikuara ka të bëjë me veçoritë personale të vet viktimës duke filluar nga nacionaliteti, gjinia, mosha, niveli i arsimimit, vendbanimi, statusi social, gjendja martesore, si dhe veçoritë kohore dhe sezonale të viktimizimit të tyre dhe të viktimave tjerë të mundshëm. Viktimë e mundshme ose potencial është çdo person i cili, duke e marë parasysh rrethanat në të cilat është gjetur, dhe ekzistencën e fakteve që çojnë në një dyshim të bazuar se është viktimë dhe janë kategoria që është më afër viktimizimit dhe në të shumtën e rasteve ata llogariten si kategori e enueshme e shoqërisë Është e rëndësishme të përmendet situata se sot nuk mund të kemi një përcaktim përfundimtar dhe statik të profilit të viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore përshkak të vëllimit dhe dinamikës së përhapjes së saj në territore të ndryshme, ndaj personave të moshave të ndryshme si një biznes mjaft fitimprurës po ndryshon vazhdimisht dhe mer forma më të përsosura të trafikimit të viktimave. Njëkoshësisht është një vepër zbulimi i së cilës është mjaft komplekse sidomos tek trafikimi ndërkombëtar e cila ndikon që edhe shumë raste pra, numri i realtë dhe objektiv mos të evidentohet.

4.1. Vëllimi dhe dinamika e viktimave të trafikuara

Vëllimi dhe dinamika e viktimave të trafikuara është prezente pothuajse në çdo shtet, por numri, niveli apo vëllimi dhe dinamika dallohet nga shteti në shtet. Dinamika e tranzitit të refugjatëve dhe migrantëve nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë ishte e ndryshme në periudha të ndryshme[985], e cila ndikon në vëllimin dhe dinamikën e lëvizjes së viktimave të trafikimit. Vëllimi i viktimave të trafikuara nënkupton pranin, sasinë e viktimave të trafikimit në një shoqëri, vend, rajon apo bashkësi, kurse dinamika nënkupton lëvizjen e sasisë, numrit së prezencës dhe përhapjes së viktimave të trafikimit. Fatkeqësisht, të dhënat mbi vëllimin, dinamikën e lëvizjes së numrit të viktimave në vendin tonë, por edhe në vendet e tjera, janë më tepër fragmentare, jo të plota dhe të pasistemuara sipas kërkesave të mirëfillta të metodologjisë kërkimore dhe rregullave e teknikave të njohura statistikore.[986]

Shumë viktima janë të panjohura organeve shtetërore siç janë: policia, gjykata, prokuroria, enti social, ose ndonjë insitucion tjetër, edhe pse kanë pësuar nga ndonjë aktivitet kriminal ose thjesht janë viktima të trafikimit, përshkak se nga ana e tyre për disa arsye nuk paraqiten veprat penale dhe këta persona emërtohen si viktima të panjohur dhe e paraqesin numrrin e errët të trafikimit. Numri i viktimave të panjohur tek vepra e trafikimit me qenie njerëzore është i madh sidomos nëse trafikimi është bërë me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion, si shkak i mosparaqitjes së vet viktimave duke menduar se shoqëria nuk do të pranojë në mjedisin e tyre dhe e llogarisin si një vepër e turpshme duke e ndjerë veten si fajtor të saj. Të gjitha këto shkaqe ndikojnë në mosigurimin e fakteve të nevojshme e cila e rëndon edhe punën e prokurorit dhe të gjykatës që të jenë objektiv dhe të dënojnë kryerësit e trafikimit. Në anën tjetër Ligji për procedurë penale në pjesën e përgjithshme sidomos në nenin 15 të saj e parasheh parimin e objektivitetit të gjykatave dhe organeve shtetërore. Gjykata dhe organet shtetërore janë të obliguara që me

[984] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.11
[985] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа". Скопје, 2016, fq.30
[986] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.49

vëmendje të njëjtë t'i shqyrtojnë dhe t'i përcaktojnë si faktet që e ngarkojnë të akuzuarin, poashtu edhe ato që janë në dobi të tij[987], në mënyrë të drejtë dhe objektive.

4.2. Nacionaliteti i viktimave të trafikuara

Në përgjithësi nacionaliteti i viktimave të veprave penale po edhe të trafikimit me qenie njerëzore varet nga shumë faktorë dhe rrethana që ndikojnë direkt apo indirekt në përcaktimin e saj. Nacionaliteti i viktimave të trafikuara përshkak të llojit dhe rrethanave se si realizohet vepra penale në të shumtën e rasteve varet direkt nga dëshirat dhe kërkesat e klientëve të cilët në shtetet e destinacionit janë shfrytëzues si dhe nga cilët vende burojnë viktimat. Pra, klientët shfrytëzues të shërbimeve të viktimave, sidomos sipas kërkesave të tyre e përcaktojnë edhe nacionalitetin e viktimave në vendet e destinacionit. Klientët si vizitor dhe shfrytëzues të shërbimeve janë ata që kërkojnë gra dhe vajza të nacionaliteteve të ndryshme, kështu që përkatësia nacionale luan një rol të rëndësishëm për sa i përket rritjes së viktimave të naionaliteteve të ndryshme të krimit të trafikimit me qenie njerëzore për prostitucion.

Martesat e detyruara të viktimave të mitur të nacionalitetit romë viteve të fundit në kontinuitet është prezente për shkak të abuzimit të regjimit të vizave, i cili si faktor ndikoj në rritjen e numrit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore[988], është një karakteristikë e vepantë në vendin tone. Shumë shtete përshkak të përbërjes heterogjene të popullatës pakicat hasen të diskriminuara dhe është një faktor e cila mund të ndikoj që ata të jenë kategori e cenuar dhe e rrezikuar si viktima apo kryerës të veprave penale siç është tek na rasti me pakicat e romëve. Anketa e ***Danielit*** (viti 1968) zbuloi se njerëzit që i përkisnin grupeve të pakicave etnike gjithmonë kishin punë në bazë të nivelit të tyre të trajnimit dhe se ata ishin të përjashtuar hapur, d.m.th. nuk u jepej vende adekuate në sektorin publik ose privat.[989] Në vitin 2013, u identifikuan gjashtë viktima të huaja të trafikimit të qenieve njerëzore: - tre shtetase të rritur serbë, të shfrytëzuara seksualisht dhe për punë në objekte hotelierik në zonën e Tetovës, - një shtetase e mitur shqiptare, e detyruar të ofrojë shërbime seksuale për klientët në zonën e Gostivarit - një shtetase e rritur shqiptare, e shfrytëzuar për punë në zonën e Tetovës, dhe - një qytetare e rritur kosovare, e shfrytëzuar për punë në zonën e Tetovës,[990] nga ku shihet edhe përbërja heterogjene e viktimave.

4.3. Gjinia e viktimave të trafikuara

Viktima të veprave penale sidomos të trafikimit me qenie njerëzore paraqiten të dy gjinit, pra, gjinia mashkullore dhe gjinia femërore. Varësisht nga qëllimi i shfrytëzimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dallohen edhe paraqitja e viktimave të gjinisë mashkullore ose femërore. Nëse kemi trafikim me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion, lëmosha e detyruar, shërbyese në shtëpi, fabrika tekstili më shumë paraqiten viktima të gjinisë femërore (gra dhe vajza të reja), kurse tek trafikimi me qëllim të punës së detyruar më shumë ku kërkohet fuqi më të madhe fizike më shumë viktima janë personat e gjinisë mashkullore si shkak

[987] Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150 од 18.11.2010 година, neni 15

[988] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.5

[989] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010., fq.423

[990] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.8

i forcës fizike dhe se janë më të durueshëm ndaj punëve fizike të rënda. Mirëpo, pjesëmarrja më e madhe apo më e vogël e gjinive në viktimizim varet nga faktorët socio-konomikë, nga pozita e gjinive në shoqëri, nga pozita dhe roli i femrës në familje, nga ndikimi i normave tradicionale si dhe shumë faktorëve të tjerë.[991]

Përqindja e grave dhe vajzave të reja është duke u rritur dita ditës në mesin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Në shtetin tonë gjatë periudhave të ndryshme kohore kemi paraqitjen e viktimave në numër më shumë se sa gjinia mashkullore. Në vitin 2013, u identifikuan gjithsej 15 viktima, të gjitha femra, nga të cilat 9 ishin të mitur (8 vendas dhe 1 të huaj), 6 të rritur (1 vendas dhe 5 të huaj).[992] Miliona gra në të gjithë botën po dërgohen nga një vend në tjetrin me qëllim për të gjetur "punë" në industrinë e seksit[993] e cila llogaritet edhe si arsye e rritjes së numrit të gjinisë femërore si viktima të trafikimit. Pra, pjesën më të madhe dhe dominuese të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore e përbëjnë gratë dhe vajzat e reja ku shumica e tyre shfrytëzohen në tregtin e seksit, pastaj vijojnë puna e detyruar dhe shërbimet nëpr shtëpi si shërbyese, e më pas punët në fabrika dhe plantazhe etj., përmes përdorimit të dhunës , mashtrimit, kanosjes, ose formave tjera të shtrëngimit. Sipas një burimi tjetër, aktualisht ka rreth 150,000 fëmijë dhe gra viktima të krimit të organizuar të këtij lloji në rajonin e Ballkanit.[994] Gjinia e viktimave të trafikuara luan një rol të rëndësishëm sidomos gjatë fazës së trasnportit përshkak se gratë dhe vajzat e reja në këtë fazë janë të pafuqishëm të durojnë kushtet dhe kohëzgjatjen e transportit ku ka raste trasporti të zgjatë edhe me javë të tëra. Gratë dhe vajzat e reja ndjehen të vetmuara dhe më të rrezikuara gjatë transportit ku rreziqet rriten nën kushtet e rënda në mjetet e transportit dhe në shtetet e tranzitit sidomos në kampe, udhëtime ilegale përmes maleve gjatë kushteve kohore me shi, borë dhe temperatura të ulëta, pa kushte higjienike e cila ndikon edhe në rritjen e rreziqeve shëndetësore, por të cilët nuk kanë rrugëdalje të shpëtojnë nga trafikantët përshkak se janë të parezistueshëm ndaj kërcënimeve, dhe dhunës që përdoren ndaj tyre.

Kushtet e këqija të udhëtimit – shkelja e kontratës paraprake nga ana e tregtarit, për shembull, nisja drejt shtetit tjetër si destinacion dhe jo në shtetin e dakorduar paraprakisht, udhëtimi në grupe tepër të mëdha dhe mënyrat dhe mjetet e pasigurta të transportit, bartja prej tregtarit tek tregtari tjetër, keqpërdorimi fizik, shpirtëror dhe seksual, etj.[995] Edhe Maqedonia me ligj të veçantë është garantues i mosdiskriminimit në punë në bazë gjinore. Grave dhe burrave duhet të jenë të siguruara mundësi të barabarta dhe tratmat të njejtë në lidhje me:

1) qasje në punësim, përfshirë avancimin dhe trajnimin ekspertë dhe profesional në punë;
2) kushtet për punë;
3) pagesë të njejtë për punë të njejtë;
4) skema profesionale për sigurim social;
5) mungesa nga puna;
6) orari i punës dhe
7) anulimi i kontratës së punës.[996]

Trafikimi me qenie njerëzore të gjinisë mashkullore me qëllim të shfrytëzimit të punës së detyruar ka të bëjë me numrin më të errët të rasteve të moszbulimit për shkak të natyrës së

[991] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.52

[992] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.4

[993] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, fq.1

[994] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. "Heuristička Kriminalistika". Travnik, 2011, fq.698

[995] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.18

[996] Закон за работните односи (пречистен текст), 2017, neni 6, paragrafi 2

shfrytëzimit, si dhe përshkak të "fshehjes" së viktimave në vendin e punës nga ana e punëdhënësve ku punon ose nga kanosjet dhe kërcënimet e punëdhënësve të cilët i kanë pranuar në mënyrë ilegale punësimin e viktimave dhe është shumë rëndë të zbulohen përshkak të mospasje së informative në këtë drejtim sidomos nga inspektoriati i tregut të punës të shtetit konkret. Inspektori është i autorizuar, në procedurën e inspektimit të mbikëqyrjes, të kërkojë dokumente personale (letërnjoftim, pasaportë, dhe të ngjajshme) nga personat që gjenden në punë tek punëdhënësi, të cilët janë të detyruar që dokumentet e kërkuara ti japin për inspektim.[997] Në kuadër të këtij ligji, inspektorati i punës ka formuar trup të posaçëm kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes, ekskluzivisht në fushën e punës në amvisëri/shtëpi.[998]

4.4. Mosha e viktimave të trafikuara

Mosha përcaktohet në bazë të një vlerësimi të plotë të të gjithë informacionit të disponueshëm, duke i dhënë rëndësinë e duhur çdo dokumenti zyrtar, të tillë si certifikata e lindjes, të dhënat e shkollës, të dhënat statistikore, deklarata e prindit për moshën ose deklarata e vetë të miturit dhe një raport i bazuar në ekzaminimin mjekësor.[999] Si viktima të veprave penale në përgjithësi dhe në veçanti të veprës së trafikimit me qenie njerëzore mund të paraqiten të gjitha grupmoshat e personave por disa grupmosha janë më shumë të prekura nga kjo dukuri negative. Edhe mosha ngjajshëm si gjinia e viktimave ka rëndësinë e saj të veçantë për shkak se rrezikshmëria ndaj viktimave të moshës së re sidomos personave nën moshën 18 vjet ose ato nën moshën 14 vjet që quhen fëmijë janë kategori edhe më të rrezikuara në çdo fazë të trafikimit sidomos në fazën e transportit dhe shfrytëzimit të tyre. "*ka kryer sulm gjinor ndaj së dëmtuares V.T. e cila nuk ka mbushur 14 vjet*"[1000], është një pjesë e shkëputur nga Aktgjykimi nr.11/2011 ku shihet viktima nën moshën 14 pra fëmijë.

Ka dëshmi të qarta se numri i fëmijëve që janë përdorur për aktivitete kriminale në Europë është rritur në dhjetëvjeçarin e fundit.[1001] Fëmijë viktimë konsiderohet çdo fëmijë deri në moshën 18 vjet, të cilët kanë pësuar dëmtime, përfshirë ato fizike dhe mentale, vuajtje emocionale, humbje materiale apo dëmtime tjera, rrezikimi i të drejtave, si rezultat i pasojave të kryerjes së veprimeve që me ligj është e përvaktuar si vepër penale.[1002] Kjo kategori e moshave të mitura zakonisht abuzohet dhe viktimizohet për qëllim shfrytëzimi seksual, eksploatimi për punë të rënda fizike, për rekrutim në formacione të armatosura apo në grupe dhe organizata terroriste.[1003] Kështu, këto grupmosha janë prezente më tepër si viktima të krimeve të vrasjes, të krimeve të dhunës në martesë, të krimeve të dhunës seksuale, të krimeve të torturave dhe përndjekjeve politike , të krimeve të trafiqeve ilegale me njerëz dhe të krimeve të abuzimit të alkoolit dhe substancave narkotike.[1004] Kjo do të thotë që megjithëse shumica e emigrantëve janë në moshë pune, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë në kategorinë e të varurve.[1005] Janë të identifikuar edhe nëntë viktima vendas të trafikimit, qytetarë të Republikës së Maqedonisë: - katër viktima të mitur të trafikimit

[997] Закон за инспекцијата на труд. Консолидиран текст, 2017, neni 11, paragrafi 3
[998] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.31
[999] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.117
[1000] Aktgjykim Nr.11 të datës 21.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2
[1001] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.112
[1002] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.25
[1003] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.51
[1004] Po aty
[1005] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.17

me qenie njerëzore të moshës nga 13-17 vjeç, dy nga Shkupi, një nga Prilepi dhe një nga Gostivari në bazë të martesës së detyruar (një viktimë në Belgjikë, dy në Francë dhe një në Tetovë) - dy viktima të mitur të trafikimit me qenie njerëzore nga Tetova në moshën 16 vjeç kanë qenë të shfrytëzuaa seksualisht në zonën Gostivar-Tetovë - dy viktima, një e mitur nga Gjevgjelia dhe një viktimë e rritur nga Shkupi kanë qenë të shfrytëzuara seksualisht jashtë kufijve të Maqedonisë, në Kroaci dhe Zvicër, dhe - një viktimë e mitur e trafikimit me qenie njerëzore ka qenë e shfrytëzuar për punë dhe seksualisht në Kumanovë[1006], është një tregues në rritjen e viktimave të mitur dhe fëmijë.

Mosha e viktimave sidomos fëmijët viktima në trafikimin me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion kërkesaat rriten çdo ditë e më shumë, kështuqë rritet edhe numri i fëmijëve në mesin e viktimave dhe kështu zvogëlohet mosha e fëmijëve përshkak se kërkesat e klientëve për viktima të fëmijëve ka të bëjë me rrezikut shumë më të ulët të infektimeve të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme. Fëmijët si viktima të trafikimit shfrytëzohen për qëllime të ndryshme jo vetëm për abuzim seksual, por edhe si aktorë të pornografisë së fëmijëve, shfrytëzimi i punës së detyruar, lëmosha, kryerja e krimeve etj. Këta fëmijë janë trafikuar kryesisht në vendet fqinje, për tu shfrytëzuar seksualisht, për lypje, për të punuar si skllevër dhe për pjesmarrje në rrjete mafioze dhe kriminale, në interes të trafikantëve.[1007] Kurse në lidhje me transportin e fëmijëve, ndaj fëmijëve si viktima ka pasoja të mëdha si psiqike po ashtu edhe fizike sepse imuniteti, fizika dhe psiqika e kësaj kategorie është me pasoja të rënda duke e marrë parasysh se ata ende nuk janë të formësuar në aspektin biopsiqik. Ashtu si dhe në format e tjera të keqtrajtmit të fëmijës, shpesh plagët psiqike janë shumë më të vështira për t'u shëruar sesa dëmtimet fizike.[1008] Për këto arsye pothuajse çdo shtet në ligjet e saj nacionale po edhe aktet ndërkombëtare e kanë të rregulluar me nen të veçantë trafikimin e personave të mitur dhe dënimet për këtë vepër penale janë shumë më të larta në krahasim me trafikimin e personave madhorë. Në kodin penal të Maqedonisë është e paraparë vepra penale e Sulmit gjinor ndaj fëmijës në nenin 188 të saj e cila vepër nga kryerësit është e lidhur shpesh me veprën tjetër penale të tregimi i materialit pornografi të një fëmije në nenin 193 të saj. Me aktgjykim të gjykatës themelore *S.1 S.S. K.br.2586 / 11 të vitit 06.09.2011, i pandehuri Lj. P. nga Sh., i shpallur fajtor për veprën e kryer penale-Sulm gjinor ndaj të miturit i cili nuk ka mbushur 14 vjet sipas ne.188 par.1 na KP dhe vepra penale-Tregimi i materialit pornografik të miturit nga ne.193 pa.1, me ne.45 pa.1 nga KP është gjykuar me dënim me burg gjatësi prej 12 vite dhe 6 muaj, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim[1009]*. Dënim edhe më të lartë është një rast tjetër ku fajtori dënohet me 15 vite burg e cila është edhe dënimi minimal i paraparë me ligj për këtë vepër penale. "*I pandehuri S. T. ka kryer vepër penale-Sulm gjinor ndaj të miturit e cila nuk ka mbushur 14 vjet nda ne.188 pa.2 lidhur me pa.1 nga KP. Pajtueshmlri me nenin e lartëpërmendur dhe nenenet: 32, 33, 35, 39 dhe 47 nga KP dhe ne.89 dhe 92 nga KPP, gjykata e Gjykoj me dënim me burg 15-pesëmbëdhjet vjet*."[1010]

Viktimat vendas, shumica janë persona të mitur.[1011] Janë shfrytëzuar persona të mitur femra të moshës 13-17 vjeç që janë rekrutuar nga Republika e Maqedonisë me qëllim për të hyrë në

[1006] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.8

[1007] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.10

[1008] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.77

[1009] Решение бр.24 датум 24.01.2012 од Кривичниот Совет при Основниот Суд Скопје 1 Скопје, fq.1

[1010] Aktgjykim nr.11 të datës 21.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2

[1011] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.5

martesa të detyruara në vendet e BE (Belgjikë, Francë), por edhe në Republikën e Maqedonisë.[1012] Viktimat e dhunës janë më shpesh (90%) të rritur, por në disa krime, siç është përdhunimi seksual, të miturit janë viktima më të shpeshta (rreth 30% të rasteve).[1013] Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij.[1014] "Për të gjykuar moshën, treguesit fillestar duhet të përfshijnë:
1. Pamjen fizike të të riut në fjalë
2. Pjekurinë e tij/të saj psikologjike;
3. Deklaratat e të riut/së resë; dhe
4. Dokumentin që ajo apo ai mban me vete, ose mungesën e një pasaporte apo atë të dokumentave të tjera.
Nëse përsëri është e paqartë mosha e personit të ri, duhen bërë edhe këto dy shqyrtime:
6. Një ekzaminim mjekësor - vetëm me pëlqimin e subjektit në fjalë - dhe duhet marrë opinioni i një punonjësi profesionist të shëndetësisë.
7. Shqyrtimi me një ambasadë ose autoritete të tjera të vendit më me gjasë nga vjen i riu/e reja - por vetëm nëse është krejt e qartë se personi në fjalë nuk ka për qëllim të kërkojë azil. Kurrsesi nuk duhet bërë ky kontakt në qoftë se fëmija po kërkon azil."[1015]

4.5. Niveli i arsimimit të viktimave të trafikuara

Zakonisht viktimat e trafikimit me njerëz në lidhje me përgaditjen arsimore apo niveli i shkollimit të tyre llogariten si persona me nivel të ulët të arsimit, sidomos të paarsimuar, me fillore dhe me arsim të mesëm, kurse vitieve të fundit ekzistojnë edhe viktima me arsim të lartë. Më herët i obligueshëm ka qenë vetëm arsimi fillor por më vonë para disa viteve edhe arsimi i mesëm u bë i obligueshëm me qëllim të rritjes së shkallës së arsimit, intelegjencës e cila do të ndikoj që personat të dijnë shkrim lexim dhe të informohen për drejtat dhe rregullat në jetën e tyre të përditshme e cila do të ndihmonte edhe në mosmashtrimet e trafikantëve. Një nga shumë rastet e evidentuara në vendin tone vërtetohet kryerja e arsimit fillor të akuzuarit nga Akgjykimi nr.11/2011 dhe ate si vijon: "*me arsim fillor të kryer*".[1016] Përfitimi i njohurive të përgjithshme dhe të zbatueshme cilët janë të nevojshme në jetën e përditshme ose për arsimimin e mëtutjeshëm, dhe zhvillimi harmonik, intelektual, emocional dhe social të nxënësve pajtueshmëri me aftësitë e tyre[1017] janë vetëm disa nga qëllimet e arsimimit fillor në Republikën e Maqedonisë. Por, ekzistojnë edhe viktima me arsim të lartë dhe që kanë një profesion, por si shkak i mospagesës së duhur ose mosgjetjes së punës në drejtimin të cilin e kanë kryer, diskrimineve në baza gjinore apo etnike dhe shumë shkaqe tjera, vendosin që punësimin të realizojnë jashtë vendit të tyre me shpresë për vlerësimin e arsimit që e kanë të cilët mund të mashtrohen dhe më pas të abuzohen nga trafikantët.

Arsimimi luan rol të rëndësishëm tek personat që llogariten të mitur që janë nën moshën 18 vjet, sidomos fëmijët që llogariten persona nën moshën 14 vjet përshkak se këta persona ende janë

[1012] Po aty
[1013] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.81
[1014] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.117
[1015] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.49
[1016] Aktgjykim Nr.11 të datës 21.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1
[1017] Закон за основното образование, Службен весник на Република Македнија, број. 103 од 19.08.2008 година, neni 3 paragrafi 1, pika 1 dhe 2

në arsim dhe formësim të sipër të personalitetit të tyre. Mungesa e arsimit themelor tek fëmija (aftësia për të numëruar dhe shkrim-këndim), e aftësive jetike si dhe kualifikimi profesional mund të kenë qenë faktorë që i kanë bërë ata viktima të lehta për trafikantët.[1018] Andaj mashtrimi i të miturve sidomos të fëmijëve është shumë me e lehtë në krahasim nga të rriturit edhe në aspektin e jofërmësimit bio-psiqik por edhe nga aspekti i arsimimit.

4.6. Vendbanimi dhe shpërndarrja territoriale e viktimave të trafikuara

Vendbanimi dhe shpërndarja territoriale viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ka rëndësi sepse me ate bëhet lokalizimi i vendit të mashtrimit dhe të rekrutimit nga ku nis edhe transportimi i viktimave dhe shpesh dimonojn vendet rurale ose qytetet e vogla dhe të mesme ku, papunësia dhe varfëria është e lartë kurse mundësia e punësimit është e ulët dhe kështu kjo ndikon direkt tek viktimat të kërkojnë rrugëdalje nga këto situata të vështira drejt qyteteve të mëdha ose drejt shteteve me ekonomi të zhvilluar, duke pranuar çdo lloj të punës së ofruar dhe kështu bien preh organizatave kriminale të trafikimit me qenie njerëzore. Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore burojnë nga shtetet e varfëra, rajone rurale dhe fshatra si shkak i mospasjes së perspektivës, si viktima potencial paraqiten gra, vajza të reja si dhe fëmijë. Nga analiza e rezultateve të kërkimeve viktimologjike në botë mbi shtrirjen hapësinore të viktimave del se numri më i madh i viktimave është i përqëndruar në vende, rajone dhe lokalitete ku ka çregullime, konflikte sociale, politike, etnike, fetare, në vende ku ka luftëra civile dhe aktivitete të shtuara terroriste.[1019] Gjithashtu nga këto vende shumë persona të gjinisë mashkullore si kategori aktive e popullatës për fuqi punëtore janë burim i shumë migrantëve të cilat si pikësynim i kanë vendet perëndimore për sigurimin e një jete më të mirë dhe më kualitative për ta dhe për fëmijët e tyre të cilët mund të keqpërdoren nga trafikantët. Këto viktima udhëtojnë apo trafikohen drejt metropoleve dhe qyteteve të mëdha ku lulëzon prostitucioni, vjedhjet, plaçkitjet, narkomania bixhozi dhe shumë aktivitete tjera kriminale. Në këtë vende të destinacionit kemi lëvizje të madhe të njerëzve, njerëzit nuk njihen mes veti ku mund të sigurohet edhe diskrecioni për viktimat e trafikimit të cilët mund të përdoren për prostitucion, lëmoshë, punë të detyruar dhe për qëllime tjera.

Në qendrat urbane dhe në qytete, veçmas kanë ndikim të madh mjetet e informimit dhe komunikimit publik, të ashtuquajtura "masmedia", të cilat shpeshherë me shkrimet dhe mënyrën e paraqitjes nxisin te qytetarët dhe individët e ndryshëm kërkesa, instikte dhe dëshira që nuk përkojnë shpesh me mundësitë reale të tyre.[1020] Shumica e studiuesve të mediave besojnë se media ka një ndikim të madh, megjithëse nuk është e lehtë për tu demonstruar, dhe shumica do të pajtoheshin që mediat japin një kontribut të rëndësishëm në konstrukcionin shoqëror të realitetit[1021] dhe shpesh ndikojnë në migracion, migracion ilegal dhe të parregullt, kontrabandë me migrantë dhe trafikim me qenie njerëzore. Trendi i migrimit të paligjshëm shënoi ndryshime të caktuara, veçanërisht në numrin e migrantëve të zbuluar ilegalë (rritur me 66%), sipas strukturës nacionale (nga Lindja e Afërt dhe e Mesme dhe Afrika e Veriut) si dhe një rritje e madhe e numrit të përpjekjeve për hyrje ilegale në Republikën e Maqedonisë në mënyrë të paligjshme nga R. Bulgari. Si rezultat i ngjarjeve aktuale në Siri dhe ngjarjeve në Afrikën V. disa vjet më parë (e ashtuquajtura

[1018] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.81
[1019] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.52
[1020] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.129
[1021] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.321

"Pranvera Arabe"), në periudhën e fundit janë vërejtur disa ndryshime në trendet e migracionit të paligjshëm në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në numrin e zbuluar të migrantëve ilegal dhe në strukturën kombëtare[1022] cilët në masë të madhe ndikon në favorin e trafikantëve për gjetjen e viktimave potencial. "*Gjatë muajit qershor viti 2013 në T., i akuzuari F.B.,, ka organizuar ilegalisht të barten migrantë përtej kufirit shtetëror*",[1023] është një nga rastet e shumta të organizimit të veprave penale për arritjen e qëllimit kryesor përfitimin financiar. Gjatë viteve të tranzicionit disa qytete janë bërë qendra të trafikut të qenieve njerëzore, ku perfshihen dhe femijët e trafikuar[1024], pra qendra të trafikimit të brendshëm dhe ndërkombëtar. Në trafikimin me njerëz në shtetin tonë sidomos të personave vendbanimet nga vijnë viktimat janë të vendbanimeve të ndryshme drejt destinacioneve ku ka kërkesë nga klientë për shfrytëzim. „*Ata vijnë nga Gostivari, Tetova, Prilepi, Gjevgjelia, Kumanova dhe Shkupi, dhe shfrytëzohen në rajonin veriperëndimor të Pollogut të Republikës së Maqedonisë, dhe disa prej tyre jashtë vendit. Viktimat e huaja vinin nga Republika e Shqipërisë, Serbisë dhe Kosovës dhe më së shpeshti qëndronin në ambiente hotelierike si përcjellës për argitimin e mysafirëve, kamariere dhe "valltare"*"[1025] është një rast nga shumë rastet që e karakterizon vendin tonë me viktimat nga shtetet fqinje.

4.7. Statusi social i viktimave të trafikuara

Në përgjithësi viktimat varësisht nga cila vepër penale viktimizohen, personat i takojnë shtresave të ndryshme shoqërore me status social të ndryshëm. Vështirësitë e problemeve sociale që kanë ndodhur kohët e fundit për shkak të rritjes së papunësisë, veçanërisht midis të rinjve, për shkak të vështirësive ekonomike me të cilat po kalon Jugosllavia, krijon tensione të reja, shtesë, frustrime dhe burime konflikti mes njerëzve[1026], ku bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë. Sa i përket të drejtave sociale, në kushtet e tanishme vetëm azilkërkuesit, njerëzit nën mbrojtje humanitare, viktimat e trafikimit njerëzor, refugjatët e pranuar dhe të huajt me vendbanim të përhershëm kanë qasje të plotë në të drejtat sociale.[1027] Më herët ka pasur një mendim absolut se viktimat e veprave penale por edhe të veprës së trafikimit me qenie njerëzore burojnë nga shtresat e margjinalizuara shoqërore, persona të varfër, të papunë, persona me shumë anëtarë, persona që kanë mungesë të një ose të dy prindërve, persona të sëmurë, persona të nacioanliteteve që janë pakicë dhe të diskriminuar etj.

Por, kohëve të fundit si viktimë të disa veprave penale paraqiten edhe persona që takojnë shtresave të mesme dhe shtresave që kanë pozita më të larta në shoqëri ku edhe viktimat e trafikimit të cilët më shpesh viktimizohen shkak i diksriminimit gjinor dhe perspektivës jë të mire dhe jetës jo kualitative në vendet e tyre. Mirëpo, përhapja e formave të ndryshme të krimit të organizuar, kriminaliteti ekonomik, kriminaliteti "i Jakës së Bardhë", aktiviteti kriminal terrorist dhe forma të tjera të krimeve në shoqërinë bashkëkohore, kanë vërtetuar se edhe shtresat as gruper e tjera sociale, qarqet politike, njerëzit me status të lartë në hierarkinë e pushtetit, nuk janë të kursyera nga viktimizimi.[1028] Pra, ngo kjo shihet se personat nga shtresat e larta shoqërore mund

[1022] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.10

[1023] Aktgjykim Nr.59 të datës 03.02.20104 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

[1024] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.8

[1025] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.5

[1026] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985. fq.116

[1027] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.25

[1028] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.52

të paraqiten si viktima të disa veprave penale siç janë: mallverzime finaciare ndaj bizneseve të mëdha, vrasja, likuidimi dhe kidnapimi i personave të biznes sektorit dhe ata që miren me politikë etj. Por, pjesën dërmuese të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore e përbëjnë viktimat që janë të papunë, varfër dhe jetojnë në skamje të madhe.

4.8. Gjendja martesore të viktimave të trafikuara

Gjendja martesore e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore mund të paraqiten persona që kanë status të ndryshëm familjarë-martesor. Në bazë të gjendjes martesore të viktimave të kriminalitetit në përgjithësi mund të jenë persona të pamartuar, të shkurorzuar, ose persona të cilët janë të martuar por gjenden nën dhunën familjare të bashkëshortit. Mirëpo, në këtë drejtim, te disa forma të krimit të organizuar, si, p.sh., te trafiqet ilegale me femra dhe fëmijë, vërehen viktima me status të personave të pamartuar, të divorcuar, të ve, fëmijë të braktisur, fëmijë jashtëmartesor etj.[1029] Personat viktima me këtë gjendje martesore viktimizohen më lehtë përshkak se kjo gjendje e tyre shpesh është si shkak i dëshpërimeve dhe zhgënjimeve në martesë të cilët ndikojnë edhe në vendimmarjen e tyre që të largohen nga ai mjedis martesor dhe të cilat mund të atakohen nga trafikantët.

4.9. Veçoritë kohore dhe sezonale të viktimizimit të viktimave të trafikuara

Veçoritë kohore dhe sezonale të viktimizimit të viktimave të trafikuara lirisht mund të thuhet se realizohen paralel me veçoritë kohore dhe sezonale të trafikantëve përshkak se paralel me kryerjen e veprës penale të trafikimit me qenie njerlzore viktimizohet edhe viktima potenciale e trafikimit. Nga kjo del se varësisht nga lloji dhe forma e e kriminalitetit apo të trafikimit me njerëz viktimat mund të vikzimizohe, në të gjitha periudhat kohore dhe sezonale si gjatë ditës, pasditës, mbrëmjes apo natës, dhe në anën tjera në të gjitha stinët e vitit por gjatë pranverës dhe verës është më e shprehur. Sa i takon veçorive kohore brenda 24 orëve viktimizimi i viktimave më shumë shprehet gjatë orëve të natës së vonuar kur bisedat mund të zhvillohet në qetësi dhe kur lëvizshmëria e njerëzve është më rallë, kurse veçortië kohore karakterizohen me ate se kryhen në pranverë, vjeshtë sidomos gjatë stinës së verës si shkak i kërkesave më të shumta të klientëve dhe kushtet më të volitshme klimatike që nënkupton se edhe transporti i tyre mund të zhvillohet më në rregull pa fatkeqësi të ndryshme. *"Gjegjësisht i akuzuari më 27.01.2015 rreth orës 03:30, me automjetin e markës Folksvagen tip Pasat me targa KU 870-CA, në afërsi të kazinos Senator, në Gjevgeli, i ka pranuar të katër migrantët…" është një nga shumë rastet e territorit të viktimave pra vende afër kufijve me shtetet të tjera, në rastin konkret me Republikën e Greqisë"*[1030]është një rast në vendin tone e cila qartë tregon se orët e hershme të mëngjezit kur lëvizja e njerëzve është mjaft e ulët realizohen një sërë aktivitete të këtij lloji. Edhe stinët janë të rëndësishme në lidhje me profilin e viktimave ku stinët më të volitshme për kryerjen e krimeve llogaritet stina e pranverës, verës dhe vjeshtës si shkak i klimës më të mire për lëvizjen e kryerësve po edhe të viktimave. *"I akuzuari më 22.10.2012 rreth orës 07:30 në rrugën Kumanovë-f.Vaksincë te rruga hekurudhore në dalje të f.Reçicë, së bashku dhe pas marrëveshjes paraprake me personin XH.N me dy automjete transportuan migrantë…"*[1031] është një shkputje nga një rast në vendin tone ku shihet se vepra

[1029] Po aty
[1030] Aktgjykim nr.13 të datës 27.02.2015 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.2
[1031] Aktgjykim nr.18 të datës 25.04.2013 të Gjykatës së Apelit Shkup, fq.3

është kryer në muajin tetor ose stina e verës së vonë apo vjeshtës ku kohërat janë të volitshme për kryerjen e krimeve.

5. Profili organizativ i grupeve për trafikim me qenie njerëzore

Siç është përmend edhe më lartë, profil-struktura e organizatave kriminale varet nga lloji i aktivitetit kriminal dhe përfshirjes territorial të tyre. Profili organizativ i grupeve apo organizatave kriminale nënkupton strukturën dhe format e funksionimit dhe realizimit të krimeve, kurse shpërndarja territoriale nënkupton se aktivitetet e tyre kriminale janë në suaza të shtetit konkret ose edhe ndërkombëtar. Pra, profili organizativ i grupeve kriminale në përgjithësi dhe në veçanti ato të trafikimit me qenie njerëzore i kanë karakteristikat e veta organizative, strukturën e brendshme dhe veprimtarinë territoriale kriminale.

Pra, grupet kriminale, të cilët punojnë dhe funksionojnë nën thënien fitime të mëdha nga këto vepra kriminale, ndryshojnë njëra nga tjetra për sa i përket madhësisë, vëllimit, fuqisë, shtrirjes territoriale së tyre si dhe llojit të krimit që kryejnë. Organizatat kriminale klasifikohen sipas madhësisë so organizatës dhe shtrirjes territoriale të veprimtarisë së tyre kriminale ku ata veprojnë, si dhe mund të klasifiohen sipas mënyrës së kryerjes së veprimtarisë kriminale. Nga e gjith kjo me rëndësi më të madhe është se në çfarë territori është i shtrirë veprimtaria e tyre kriminale dhe për këtë shkak si organizata kriminale më të mëdha dhe më të rrezikshme për çdo shtet janë organizatat kriminale transnacionale përshkak se veprimtaria e tyre është edhe në kuadër të nj shteti nacional por edhe jasht kufijve nacional dhe shumë herë përfshin disa shtete. Në këtë drejtim, shikuar nga shumë aspekte, mund të thuhet se, sot ne jetojmë në një botë të pabarabartë, ku ëndrrat e njerëzve për të përmirësuar më mirë jetën e tyre, mund të shfrytëzohen me lehtësi nga grupet e krimit të organizuar të çfarëdo niveli, nacional apo ndërkombëtar.[1032] Nga e gjith kjo del se ekzistojnë disa lloje të grupeve kriminale dhe ate: organizata kriminale të nivelit të ulët, organizata kriminale të nivelit të mesëm, organizata kriminale të nivelit të lartë (kriminaliteti i jakës së bardhë) dhe organizata kriminale transnacionale.

1.1. Organizata kriminale të nivelit të ulët

Organizatat kriminale të nivelit të ulët ose shpesh emërtohen si organizata kriminale amatore dhe prej vet emërtimit të tyre nënkuptojmë organizata kriminale të një kapaciteti dhe niveli të ulët dhe të cilat sipas territorit funksionin e tyre e kanë në nivel lokal në vendbanimin ku jetojnë dhe vendbanimet përreth, pra në kuadër të territorit të shtetit konkret. Këto organizata rrjetin e tyre e kanë të përbërë nga familjarët e tyre, nga njerëz të të njëjtit fis dhe etni, të rrethit të ngushtë. Ky lloj i organizatave kriminale të nivelit të ulët në një farë mënyre funskionojnë si banda të vogla dhe locale, por të cilët janë të dobët të strukturuar dhe kanë një organizim joprofesional, e jo si tek organizatat kriminale translacionale ku kemi ndarjen e roleve dhe detyrave të anëtarëve. Përshkak se organizimi i tyre është i kufizuar dhe i vogël, edhe numri i viktimave është i kufizuar dhe i ulët. Në grupet e vogla kriminale dhe dobët të ndërlidhura mes veti, rekrutuesit e thjeshtë veprojnë edhe si transportues dhe eksploatues dhe janë shokë apo të njohur të grave të ardhshme[1033], sidomos viktimat e tyre janë të vendit në kuadër të shtetit. Këto organizata themelohen, formohen dhe zhvillohen në vendbanime të vogla dhe janë të lehta për t'u formuar dhe veprimtaria e tyre

[1032] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.101

[1033] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.147

kriminale është e kufizuar sa i takon veprës së trafikimit me qenie njerëzore, si për nga numri i kryerësve dhe viktimave, ashtu edhe për nga territorit të vogël të shtrirjes së aktiviteteve të tyre. Si shembull këto organizata kriminal, në bazë të madhësisë së tyre, blejnë dhe shesin njerëz viktima të trafikimit me qenie njerëzore të cilët paraprakisht janë rekrutuar, trasnportuar, transferuar ose edhe të shfrytëzuar. Këto organizata i përdorin lidhjet dhe marrëdhëniet e familjarëve dhe anëtarëve të grupit për të gjetur viktima vetëm për një qëllim e cila më shpesh është në industrinë e prostitucionit.

1.2. Organizata kriminale të nivelit të mesëm

Organizatat kriminale të nivelit të mesëm janë një shkallë më të avancuara sesa organizatat kriminale të nivelit të ulët ose amatore dhe këto shfaqin vetëm disa karakteristika të organizatave kriminale profesionale ndërkombëtare. Këto organizata kanë një strukturë më të kompletuar, me më shumë anëtar dhe përfshin një territor më të gjerë dhe janë më të organizuar. Kurse në anën tjerët, këto organizata janë më të vogla dhe me veprimtari më të kufizuar dhe më të ngushtë si dhe me një strukturë shumë më të vogël dhe mungesë e kriminelëve profesionist se organizatat e nivelit të lartë (krimi i jakës së bardhë) si dhe nga organizatat ndërkombëtare të trafikimit njerëzor. Organizatat e tilla kanë një strukturë me shumë shtresa dhe ofrojnë gjithçka që u nevojitet për kryerjen dhe realizimin e veprimeve kriminale si dhe të trafikimit me qenie njerëzore.

Këta mund t'i gjejnë vetë viktimat e tyre dhe duke i siguruar dokumentet e nevojshme të udhëtimit i transportojnë në një territor më të largët nga organizatat e nivelit të ulët në kuadër të kufijve shtetëror të një shteti konkret, si dhe shpesh vet janë edhe shfrytëzues të viktimave. Anëtarët e organizatës kriminale të nivelit të mesëm janë më brutal që përdorin mekanizma shtrëngues kontrolli për të siguruar disiplinën dhe shfrytëzimin e viktimave në tërësi si një objekt e cila trafikohet ngjajshëm me skllevërinë. Këto organizata nuk e konsiderojnë trafikimin e qenieve njerëzore si një biznes afatgjatë, por si një biznes afatshkurtër dhe fitimprurës. Ata realizojnë profit duke i shitur viktimat e tyre blerësve dhe pajisjet në qendrat tranzite kryesore të industrisë, veçanërisht në qytetet kryesore apo në zonat-ndërkufitare.[1034] Në vend që të investojnë për të përmirësuar dhe zgjeruar bizneset e tyre, ata i përdorin të ardhurat e tyre për të blerë mallra të tjera që menjëherë mund t'i shndërrojnë në para, ose thjesht i shpenzojnë në aktivitete të ndryshme joprofitabile dhe joinvestimore. Organizatë kriminale është një shkallë më e lartë e strukturës kriminale sesa një shoqatë e thjeshtë kriminale, ato përfaqësojnë një anëtarësi të strukturuar fortë dhe është një mjedis i mbyllur i rregullave të rrepta të brendshme të marrëdhënieve, një subkulturë e veçantë, e cila ndryshon në shumë mënyra nga bandat klasike kriminale[1035] dhe është karakteristike vetëm për organizatat kriminale të nivelit të mesëm.

1.3. Organizata kriminale të nivelit të lartë (kriminaliteti i jakës së bardhë)

Përkufizimet ligjore të krimit të organizuar, si etiketat e tjera sociale siç është "sjellja antisociale", bazohen në masat që ligjvënësit dëshirojnë të ndërmarrin kundër veprimtarive të liga dhe "llojeve të njerëzve", dhe veçanërisht ndaj kombinimit të njerëzve të ndryshëm.[1036] Krimi i

[1034] Po aty, fq.148

[1035] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.203

[1036] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.780

organizuar përmes organizatave kriminale të nivelit të lartë ose siç njihet kriminaliteti i jakës së bardhë me veprimtaritë e tyre kriminale sidomos veprat penale të kategorisë së rëndë siç është trafikimi me narkotikë, blerja e akcioneve, ikja nga pagimi i tatimit, krimet financiare-ekonomike, trafikimi me armë, pastrimi i parave, korrupcioni, kontrabanda me migrantë, trafikimi me qenie njerëzore kanë sjellur dëme të mëdha pothuajse në çdo shtet të botës dhe ndaj këtij fenomeni të rrezikshëm nuk mbeti imun edhe Republika e Maqedonisë. Sipas ***Sutherlandit***, këta kriminel, kalojnë një jetë të dyfishtë: në një anë paraqiten si njerëz autoritativ, njerëz dhe përfaqësues të qarqeve të larta të rrespektuar, me autorizime të mëdha, me poste të rëndësishme në politikë, në biznes, në polici, në gjykata, në jetën kulturore, në masmedia etj., ndërsa, në anën tjetër janë të lidhur ngushtë me nëntokën kriminale, bashkëpunojnë dhe u ndihmojnë kriminelëve dhe delikuentëve të ndryshëm.[1037]

Sot, krimi i "*jakës së bardhë*" është shumë aktuale në shumë zona dhe rajone, dhe aktorët e saj janë anëtarë të të pasurve[1038], ose shpesh njihet si kriminaliteti i shtresave të larta ose të pasura në shoqëri, të cilët janë të kyçur direkt apo indirekt pothuajse në të gjitha pozitat e pushtetit shtetëror, si pushteti ekonomik, politik, gjyqësor financiar etj. Struktura e tyre e organizuar fleksibile përfshin rekrutim, bodigard, transportues dhe persona të cilët sjellin vendime dhe të cilët bisedojnë në lidhje me kushtet financiare me makrotë dhe pronarët e bordeleve[1039], gjatë trafikimit me qenie njerëzore sidomos me qëllim të prostitucionit. Në shtetin tonë paraqitja e organizatave kriminale të nivelit të lartë është si pasojë e ndikimit të drejëpërdrejtë të faktorëve ekonomik (papunësia dhe varfëria), faktorëve politik dhe social kurse përhapja edhe më e madhe e tyre është si pasojë e mosreagimit dhe luftimit profesional të institucioneve shtetërore përshkak të ekzistimit të korrupcionit si në prokurori, gjyqësor poashtu edhe në policin e vendit, ku de fakto në këto veprimtari kriminale shpesh herë janë të kyçur direkt apo indirekt edhe zyrtarë shtetëror të nivelit qendror apo lokal. Gjendja jo e mire ekonomike sidomos papunësia dhe varfëria ka një lidhshmëri të afërt me këtë lloj të organizatave kriminale të cilët e shfrytëzojnë ekonominë jo të mire të vendit për viktimat potencial. Kjo gjendje ekonomike u lehtëson punën trafikantëve, të cilët në emër të emigracionit dhe shanseve për një jetë më të mirë, përfitojnë dhe tërheqin në rrjetet mafioze dhe trafiqe femijët.[1040] Siç thekson ***Milutinović*** (331), përhapja e sjelljes delikuente përcaktohet, ndër të tjera, nga karakteri i strukturës së klasave dhe strukturave të tjera shoqërore, kështu që është shumë e rëndësishme të studiohet krimi nga pikëpamja e përkatësisë në klasa të caktuara dhe shtresave dhe grupeve të ndryshme shoqërore.[1041] "Mafia si niveli më i lartë i organizimit kriminal është një strukturë dhe një mjedis specifik delikuent që vepron brenda formave të krimit të organizuar.

"Në 1939, kriminologu i mirënjohur ***Edwin H. Sutherland*** përshkroi krimin e jakës së bardhë në fjalën e tij si President i Shoqatës Sociologjike Amerikane. Sipas tij, krimi i jakës së bardhë përfshin shkelje të ligjit penal nga njerëz "të respektuar", të cilët zënë status të lartë shoqëror gjatë zhvillimit të profesionit."[1042] Organizatat mafioze nga shoqatat e thjeshta kriminale dallon sipas pozitës së statusit, aftësisë origjinale për të poseduar "fuqi të frikësimit", "gjendje të

[1037] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.139
[1038] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq. 149
[1039] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.149
[1040] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.11
[1041] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq. 149
[1042] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.289

nënshtrimit", "premtim heshtjeje"."[1043] Vendet në tranzicion kanë shumë çështje të pazgjidhura, të paorganizuara, të pazbatuara në sistemin përkatës të funksionimit të shtetit në kuadër nacional dhe relacion ndërkombëtar[1044] e cila edhe më shumë e përforcon dhe zhvillon organizatat kriminale të nivelit të lartë në vend. Këtyre rrethanave ju duhen shtuar edhe ndryshimet politike dhe sistemore të shteteve të caktuara me ndikim në trendë dhe përmasa të paraqitjes së krimit të organizuar dhe vështirësitë dhe pa mundësit e parandalimit dhe luftimit të tyre , sidomos në shtetet në transicion.[1045] Kohëzgjatja e gjatë e periudhës së tranzicionit në shtetin tonë ndihmoj edhe më shumë në lulëzimin , zgjerimin dhe përsoshmërinë e organizatave kriminale të nivelit të lartë në shtetin tonë përshkak të ekzistimit të korrupcionit, ndërhyrjes apo ndihmës së politikanëve dhe subjekteve politike në mbështetje të krimit të organizuar. Kriminelët e jakës së bardhë kanë raporte dhe miqësi shumë të afërt dhe të fortë me udhëheqësin shtetërore sidomos me isntitucionet të cilët e luftojnë kriminalitetin siç janë: policia, gjykatat dhe institucionet e shqiptimit të dënimit (burgjet), ku në krahasim me kriminelët tjerë këta janë më të favorshëm në çdo institucion ku rallë herë marrin sanskione dhe nëse dënohen, dënimet janë formalisht ose dënime minimum. Ndër veprimet më të shpeshta kriminale të këtyre personave janë falsifikimet dhe transakcionet e ndryshme në bursat financiare, manipulimet në treg, marrja dhe dhënia e mitos dhe ryshfetit. Sipas kriminologut ***John Braithwaite***, kriminelët e jakës së bardhë shpesh motivohen nga mospërputhja midis qëllimeve të kompanisë dhe mundësive të kufizuara që punonjësit e kompanisë mund të arrijnë brenda kornizës së praktikave tradicionale të biznesit.[1046] Janë të njohura aferat, skandalet, dorëheqjet, arrestimet, gjykimet dhe dukuritë tjera, të cilat janë të pranishme në disa shtete si p.sh. në Amerikë afera "Watergate" e "Lewinski" të cilat ndikuan në shkarkimin gjegjësisht tentim shkarkimin e kryetarëve Nikson dhe Klinton, në Itali gjykimi i Julio Andreotit, kryeministrit Silvio Berluskone dhe gjykime tjera të ish-politikanëve në Japoni, Kore, Rusi dhe vende tjera.[1047] Ndërmjetësimi në lidhjen e kontratave me interes të madh, shmangia e pagimit të kontributeve dhe tatimeve, mundësimi i shfrytëzimit të beneficioneve të ndryshme, dhënia e lehtësimeve dhe mundësimi i blerjes së aksioneve të ndryshme[1048] janë vetëm disa nga krakteristikat e veprimtarisë së tyre. ***Herbert Edelhertz*** e përkufizon krimin me jakë të bardhë si një seri aktivitetesh të paligjshme ose aktivitete të kryera në mënyra jo fizike, duke u fshehur ose në mënyrë dinake, për të shmangur humbjen e parave ose pronave, ose për të përfituar nga vendi i punës ose i individit.[1049]

1.4. Organizata kriminale transnacionale

Përhapja e madhe dhe e shpejtë e trafikimit me qenie njerëzore si dhe fitimi i lartë finansiar nga ky lloj i kriminalitetit ka ndikuar që edhe më shumë të investohet në organizatat kriminale me qëllim të profesionalizmit dhe organizimit më të mirë të brendshëm të organizatave kriminale duke marrë përmasa edhe më të gjëra botërore të veprimtarive të tyre kriminale të shtrijnë edhe jashta kufijve shtetëror. Edhe pse lloje të ndryshme të krimit dhe sundimi i tyre janë kryesisht lokale, media elektronike dhe e shkruara nxjerrin në pah komponentët transnacionale të trafikut të drogës,

[1043] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.203
[1044] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.123
[1045] Latifi, Vesel. Elezi , Ismet. Hysi, Vasilika. "Politika e Luftimit të Kriminalitetit". Prishtinë, 2012, fq.194
[1046] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016. fq.292
[1047] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.140
[1048] Po aty
[1049] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.290

punës ilegale / trafikimit të qenieve njerëzore, mashtrimit dhe terrorizmit, dhe konsiderohet se vendi i veprime kundër këtyre fenomeneve është në tregjet politike ndërkombëtare, rajonale dhe globale.[1050] Që nga vitet 1990, shihet se organizatat kriminale kanë zgjeruar aktivitetet e tyre përtej kufijve dhe se ata kanë organizuar trafikimin me qenie njerëzore veçanërisht të grave dhe fëmijëve, dhe në këtë botë të civilizuar i kanë sjellur njerëzit në robëri.[1051] Për kriminalitetin e organizuar është karakteristikë, se sot në botë për këtë fenomen përdoren disa terma, siç janë: krimi i organizuar ndërkombëtar, krimi i organizuar transnacional, krimi i organizuar multinacional dhe krimi i organizuar global, i cili ndërlikon më tej përkufizimin unik konceptual.[1052]

Organizatë kriminale transnacionale nënkupton organizatën kriminale të cilët kanë një ose disa organizatorë në një shtet por përshkak të madhësisë, vëllimit dhe dinamikës së veprimtarisë kriminale veprimtarinë e tyre kriminale e kanë të shtrirë në dy ose më shumë shtete, pra kemi tejkalimin e kufijve shtetëror nacional. Ata funksionojnë në disa shtete dhe ate: shtete të origjinës, tranzitit dhe destinacionit. Organizatat kriminale transnacionale janë grupe që bashkëpunojnë me grupet e nivelit të mesëm dhe të ulët që janë kontrollues të trafikimit dhe shfrytëzimit të viktimave në nivel lokal ose territor më të vogël. Këto organizata për nga natyra e tyre, kanë aftësi të përgatisin menjëherë alternativa të rrugëdaljeve ndaj ndryshimeve juridike ndërkombëtare dhe metodave për luftimin e krimit në shtete të ndryshme. Organizatat kriminale transnacionale përbëhen nga struktura të fushave të ndryshme dhe anëtar shumë profesionale dhe me përvojë të mëhershme kriminale të bazuara në ndarje të punës sipas shtresave dhe veprimtarive kriminale. Veprimtaria kriminale e këtyre orgnizatave është shumë e gjerë duke filluar nga trafikimi me narkotikë, me armë e deri tek kontrabandimi me migrantë dhe trafikimi me qenie njerëzore duke siguruar organizatës fitime maramendëse materiale, në shumët shtete ku operojnë. Këto rrjete janë shumë të stërvitura[1053] dhe përmes kryerjes profesionale të veprimtarive kriminale organizatës arrijnë të përfitojnë mjete finaciare me shifra marramendëse . Në vitin 2015, rrjetet kriminale të përfshira në kontrabandën e migrantëve vlerësohet të kenë pasur një qarkullim midis 3-6 bilion eurosh.[1054]

Pasi krimi i organizuar është një fenomen kompleks dhe heterogjen negativ i shoqërisë, ai nuk manifestohet në të njëjtën mënyrë në vende ndryshme.[1055] Krim i organizuar transnacional nënkupton grupe kriminale, të cilët kanë një organizator (ose organizator) në një vend, por veprojnë në vende të tjera për shkak të fushëveprimit të veprimtarive kriminale.[1056] Këto organizata kriminale, trafikimin me qenie njerëzore e shohin si një biznes afatgjatë e cila nuk ka mbarim dhe viktimat kanë një lidhje varshmërie nga trafikantët dhe rritjes permanente të numrit të viktimave duke shfrytëzuar gjendjet e rënda në vendet e origjinës, tranzitit apo të destinacionit.

Të ardhurat e mëdha finansiare organizatat transnacionale i investojnë për të përmirësuar dhe zgjeruar bizneset e tyre legale siç janë blerja e patundshmërive, investime në hapjen e fabrikave dhe bizneseve tjera legale. Pasuria e këtyre organizatave kriminale transnacionale janë aq të mëdha

---

[1050] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. “Оксфордски прирачник за Криминологија”. Скопје, 2010, fq.771

[1051] Yurtcan, Erdener. “Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti”. Ankara, 2016, fq.314

[1052] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. “Kriminologija”, etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.197

[1053] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë “Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike”. Tetovë, 2009, fq.147

[1054] https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-trends/crime-areas/facilitation-of-illegal-immigration, të datës 14.09.2020, ora 19:15

[1055] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. “Kriminologija”. Sarajevo, 2004, fq.189

[1056] Po aty

sa që në shumë shtete kanë arritur të depërtojnë edhe në sistemin politik të shtetit dhe duke pasur ndikim në proceset politike, ekonomike të shtetit, përmes mekanizmit të njohur të „korrupcionit“ ndaj institucioneve shtetërore. „Për këto qëllime, ata inkorporojnë dhe shfrytëzojnë grupe shoqata, dhe organizata të themeluara më parë ose shoqatat e reja të cilat si veprimtari të tyre oficiale e kanë marrjen me transakcione të ndryshme të cilat nuk janë të ndaluara në pikëpamje formale. Shpeshherë, këto grupe, shoqata dhe organizata, janë të paraqitura dhe të regjistruara në mënyrë legale dhe lajmëruar një veprimtari e cila gjoja ushtrohet.“[1057] Grupet e organizuara të kriminelëve me lidhje ndërkombëtare janë në gjendje të japin ryshfet nëpunësit shtetëror dhe anëtarët e qeverisë.[1058] sa më shumë që ky krim përshkallëzohet në nivelin ndërkombëtar, vendet individuale i qasen problemit në mënyra të ndryshme, reciproke dhe kundërshtuese, sipas problemeve dhe motiveve të tyre, të cilat mund të jenë shumë të ndryshme.[1059]

Gjatë historisë së kriminalitetit në nivel botëror ekzistojnë shumë organizata të njohura kriminale botërore sidomos në Itali. Këto janë, mafia italiane: Cosa nostra, mafia siciliane me komandën kryesore në Palermo, Camora, mafia Napolitane, mafia Ndragheta nga Kalabria dhe Nuova sacra corona unita me komandën supreme në Bari[1060], si dhe mafia tjera të njohura jan: mafia Ruse, Yakuza japoneze, Triadat kineze, kartelli Medellin (karteli kolumbian) dhe shumë organizata të tjera, por prap si më të rëndësishme llogaritet mafia italiane dhe Cosa Nostra amerikane. Sa i përket trafikimit të njerëzve në vendet e para renditen Triadat kineze, Jakuza Japoneze, rrjetet kriminale ruse dhe mafia shqiptare.[1061] Po ashtu edhe në disa pjesë të Ballkanit grupet e organizuara kriminale edhe pse jo aq të forta sa mafia ruse dhe kineze, gjatë luftërave të fundit në Ballkan janë forcuar dhe konsoliduar dhe kanë vënë bashkëpunim me mafien dhe krimin e organizuar ndërkombëtar në vendet e Evropës perëndimore si në Francë, Itali dhe Belgjikë duke rrezikuar shtetet e posa formuara ballkanike por edhe vet Bashkimin Evropian.[1062]

2. Sktruktura dhe veçoritë e organizatave kriminale për trafikim me qenie njerëzore

Kriminaliteti i organizuar është një lloj i delikuencës aktive kriminologjike të "llojit të përkohshëm" dhe njëkohësisht një tipologji e fenomeneve kriminale që lidhen me veprimtaritë profesionale kriminale, përkatësisht kuadrot mafioze të organizatave të profilizuara[1063], të cilët si një nga veprimtaritë primare e kanë edhe trafikimin me qenie njerëzore. Struktura e brendshme e organizatave kriminale të nivelit të lartë ose ato transnacionale për trafikim me qenie njerëzore bazohen në një hierarki vertikale të funksionimit të tyre. Këto organizata kriminale ndërkombëtare kanë një strukturë të mirëfilltë të cilët organizimit të brendshëm japin një rëndësi të veçantë. “Në krye të familjes qëndron shefi-godfather i cili emërtohet me emra të ndryshëm: **Nuni**, **Boss** ose **Don** i cili ka pushtet të pakufizuar dhe autoritet të madh. Bossi ka zëvendësin-**underboss**, këshilltarët të cilët quhen **konsigliere** dhe ushtarët të cilët quhen soldiers. Në mes tyre gjenden persona që quhen **kaporigjina** që mbajnë lidhje në mes bosit, këshilltarëve dhe anëtarëve apo

[1057] Halili, Ragip. “Kriminologjia”. Prishtinë, 2011, fq.142
[1058] Национална Стратегија. “Интегрирано гранично управување”. Скопје, 2003, fq.12
[1059] Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. “Heuristička Kriminalistika”. Travnik, 2011, fq.700
[1060] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. “Kriminologija”. Sarajevo, 2004, fq.193
[1061] Latifi, Vesel. “Kriminalistika”. Prishtinë, 2004, fq.175
[1062] Vula.G, Veton. “Kriminaliteti i organizuar”. Prishtinë, 2013, fq.281
[1063] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. “Kriminologija”, etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.197

ushtarëve të thjeshtë."[1064] Në lidhje me organizimin e brendshëm dhe të ndarjes së detyruave e cila e përbën edhe strukturën e organizatës dhe dallon nga organizatat tjera kriminale nacionale janë kriteret e organizatës. Kriteret e organizatës së krimit të organizuar janë renditur në disa burime si më poshtë:

1. Personat që formojnë një strukturë hierarkike për të fituar të ardhura, mblidhen në një ndarje funksionale të punës. Fitimet e synuara këtu mund të jenë ekonomike ose politike. Në këtë kontekst, organizatat terroriste mund të përshkruhen si mafi politike për shkak të ngjashmërive midis tyre,
2. Fitimet e synuara fitohen përmes krimit,
3. Krzerja e krimit është i vazhdueshëm,
4. Ekziston një sistem sanksionimi brenda organizatës së krimit,
5. Kjo organizatë e praktikon dhunën,
6. Vendosja e marrëdhënies së krimit të kryer me sektorin publik dhe/ose privat,
7. Pastrimi i parave të fituara,
8. Për pastrimin e parave krijohen kompani zinxhirore.[1065]

Një ndër veçoritë kryesore të organizatave kriminale pothuajse të njejta për të gjitha llojet duke filluar nga ato të nivelit të ulët, të mesëm, të lartë (kriminaliteti i jakës së bardhë) dhe organizatat kriminale transnacionale është veprimtari e kundërligjshme dhe ilegale me qëllim të përfitimit financiar. Veçori të tjera të këtyre organizatave janë: anëtarët e tyre janë të specializuara, profesionalizuara dhe me përvojë të madhe në realizimin e disa veprave penale ndërkombëtare siç është trafiku me narkotikë, trafiku me armë, kontrabanda me migrantë si dhe në rastin konkret me trafikimin me qenie njerëzore. Qarkullimi i mjeteve financiare pra, përfitimet finaciare gjatë shitjes ose blerjeve ose pagesës së shërbimeve nga viktimat që shfrytëzohen realizohen me pagesë në dorë ose „cash" pagesë pa mos hyrë rrugëve bankare me qëllim mos të evidentohen nga organet kompetente. Sidomos organizatat kriminale transnacionale kanë një bashkëpunim të mirëfillt me organizatat kriminale nacionale pra të nivelit të ulët dhe të mesëm të vilët më shumë funskionin e tyre e kanë brenda shtetit nacional për realizimin e shumë veprimtarive kriminale. Karakteristikat më të rëndësishme të krimit të organizuar janë: që është një organizatë kriminale - sindikatë kriminale; hierarkia, përgjegjësia dhe nënshtrimi; struktura e rrjetit; fleksibiliteti në punë; depërtimi në strukturat shtetërore dhe ekonomike; ndërlidhja me organet qeveritare dhe institucionet e tjera; dhuna si metodë; fitimi si qëllim; profesionalizmi si karakteristikë; karakter transnacional; rrezik i theksuar shoqëror; sërë formash të ndryshme, duke e ndarë udhëheqësin nga pjesët operative të sistemit; veçantitë në format e formave të ndryshme të organizimit kriminal, etj., ngritja e profesionalizmit (ku numri i kriminelëve rritet në kryerjen e disa prej veprimtarive të krimit të organizuar duke arritur kështu burimet sekrete të të ardhurave)[1066], përdorimin e mjetit të njohur të "korrupsionit" ndaj zyrtarëve shtetëror, organeve të drejtësis dhe të policisë,në mes anëtarëve rolet janë të ndara, përdorimin e "shantazhit" ndaj personave të njohu në publik, pagesa dhe shpërblime të anëtarëve për veprën e kryer, bashkëpunimi me të gjitha organitatat kriminale të çdo niveli, respektimin e parimit të diskrecionit dhe të heshtjes, transferimin e mjeteve të fituara nga aktivitete kriminale në aktivitete legale (shpërlarja e mjeteve), përbërja e anëtarëve janë të dy gjinive por dominon gjinia mashkullore, ekzistojnë edhe persona me arsim të lartë të profesionalizuar në fusha të ndryshme sidomos ajo e teknologjisë informatike, përdorin programe

[1064] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.145
[1065] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.298
[1066] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.198

dhe mjete komunikimi të cilët funksionojnë vetëm për komunikim në mes të anëtarëve dhe shumë veçori të tjera. Në Republikën e Maqedonisë veprimtaria e kriminalitetit të organizuar në përggjithësi është i koncentruar në veprat kriminale si: Kontrabranda me migrantë, trafikimi me qenie njerëzore, korupcioni sidomos dhënia dhe pranimi i mitos, pastrim parash, trafikimi me narkotikë dhe armë, trafikimi me trashëgimin arkeologjike, kulturore dhe historike, organizimi i lojrëave të fatit dhe bixhozit.parandalimi dhe luftimi i kësaj dukurie mjaft të rrezikshme është e rëndësisë së veçantë sepse përkundrazi mund të vij deri te kalimi i etapave të organizimit të grupeve kur shpesh grupet kriminale të nivelit të ulët me kalimin e kohës rriten dhe bëhen të nivelit të mesëm e kështu me radhë deri tek ato të nivelit të lartë e në disa raste ato riten deri tek grupet kriminale transnacionale.

KAPITULLI V

IDENTIFIKIMI, MBROJTJA DHE NDIHMA NDAJ VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

1. Identifikimi i viktimave të trafikuara

1.1. Kuptimi dhe Rëndësia

Identifikimi është procedurë që në fakt mund të llogaritet edhe si shpëtimtar i viktimave, e cila fillon të zbatohet kur kemi dyshim të bazuar se një person mund të jetë viktimë e një vepre penale, dhe përmes një sërë indikatorësh personal të viktimës së mundshme, intervistës dhe përgjigjet nga ajo grumbullohen informacione të cilët pas vlerësimit vërtetohet se personi në fjalë është ose nuk është viktimë. “Ndjekja penale e veprës penale të trafikimit është shpesh një proces

që fillon me identifikimin e viktimave. Dëshmia më e rëndësishme që ka ndodhur krimi është prania e viktimave."[1067]

Njohuritë tona mbi viktimat është në gjendje të evoluimit të vazhdueshëm.[1068] Problemi i viktimës mund të shtrohet si çështje që ka të bëjë me dukurinë ose rastet e pësimit nga veprimi kriminal dhe kundërligjor[1069], sidomos të trafikimit të tyre. Me fjalën viktimë e trafikimit me qenie njerëzore nënkuptojmë çdo person që është palë e fazave të trafikimit me qenie njerëzore si: rekrutimi, transporti, transferimi, fshehjes dhe shfrytëzimit apo në disa raste edhe ritrafikimi ose riciklimi i këtyre personave përmes blerjes, shitjes, strehimit ose pranimit për shfrytëzim përmes prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, pornografisë, lëmoshës, punës së detyruar ose skllavërisë, kryerjes së krimeve, martesës së detyruar, shtatzënisë së detyruar, heqjes së paligjshme dhe shit-blerjes së organeve të trupit të njeriut si dhe për qëllime të tjera nda ana e personave ose grupeve kriminale të krimit të organizuar. Identifikimi i viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore është një proces përmes të cilit informacioni në lidhje me kryrësit dhe viktimat e veprës penale sigurohet përmes shumë treguesve siç janë: intervistat, dëshmitarët, faktet dhe provat materiale etj, përmes të cilave pastaj vlerësohet se personi është ose nuk është viktimë e trafikimit. Identifikimi është procesi më i rëndësishëm në zinxhirin e përpjekjeve për të siguruar mbrojtjen dhe asistencën e viktimave të trafikimit[1070] me qenie njerëzore e cila në fund e kthen viktimën në jetën normale. Teoria e provave studion jo vetëm parimet e përgjithshme të të provuarit , por edhe metodat e veçanta që përdoren, për mbledhjen, këqyrjen, ekzaminimin dhe vlerësimin e provave.[1071]

Identifikimi i viktimave të kriminalitetit duhet të dallohet nga klasifikimi i veprave penale sado që të jenë të afërta po aq janë edhe dalluese. Qëllimi kryesor i klasifikimit të veprave penale është arritja e një procesi të drejtë dhe efikas të arestimit të kriminelëve dhe shpartallimit të veprimtarisë kriminale[1072], kurse identifikimi i viktimave ka për qëllim që përmes identifikimit të saktë dhe të shpejtë të zbulohet viktima e vërtetë dhe të ofrohet mbrojtje dhe ndihmë e cila është e drejtë e tyre sipas ligjeve nacionale poashtu edhe sipas akteve ndërkombëtare. Nëse viktimat e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore "identifikohen" nga zyrtarët përgjegjës të zbatimit të ligjit të shtetit konkret, këtyre personave u jepet statusi i "viktimës së trafikimit me qenie njerëzore". Viktimat femra të trafikuara për shfrytëzim seksual mbeten grupi më i madh i rasteve të identifikuara, edhepse me njohjen universale tek palët e interesuara ekzistojnë edhe shumë forma të tjera të trafikimit me qenie njerëzore[1073] siç janë: viktima meshkuj të punës së detyruar, viktima fëmijë dhe të mitur me qëllim të lëmoshës, viktima gra të dhënies së shërbimeve në amvisëri etj. Viktimat fëmijë dhe të mitur gjithashtu janë objekt i procesit të identifikimit por kjo

[1067] Dündar, Tuba. Özel, Elif. "Insan ticareti suçunu anlamak", Istanbul, 2017, fq.29

[1068] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.461

[1069] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.7

[1070] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.19

[1071] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004. fq.26

[1072] Правилник (Прирачник). "Регионални упатства за идентификација на жртвите на трговија со луѓе", за Југоисточна и Источна Европа, Татјана Фомина, Интернационален центар „Ла Страда"- Молдавија и Мариа Вогиаци, Центар за заштита на човековите права – Грција, 2012, fq.12

[1073] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.71

kategori identifikot me masa, mjete dhe rregulla tjera dhe është e rëndësisë së veçantë. Identifikimi i të miturve viktima të trafikimit duhet të bëhet në prani të prindërve ose kujdestarëve ligjorë.[1074]

Identifikimi i viktimave mund të bëhet në vendin e dëstinacionit, tranzit ose në vendin e origjinës të personave të trafikuar, pasi të jenë kthyer[1075], varësisht se në cilin shtet zbulohen nga organet kompetente. Identifikimi i suksesshëm i viktimave potencial në shumë shtete zbatohet e ashtuquajtura bashkëpunimi me viktimat e cila është evidente edhe në Maqedoni. Për shembull, dhënia e një leje qëndrimi të përkohshëm është e kushtëzuar me bashkëpunimin e viktimave me organet qeveritare (leja lejon periudhë refleksioni deri në 60 ditë për raste e huaja dhe 30 ditë për rastet vendore, pas së cilës viktimës mund të lëshohet leje për qëndrim të përkohshëm për gjashtë muaj, e cila mund të zgjatet në rastet e procedurave gjyqësore që janë në procedurë).[1076] Pas skadimit të periudhës së vendosjes të përcaktuar në nenin 81 të këtij ligji apo paraprakisht nëse organet kompetente shtetërore vlerësojnë se i huaji tregon qëllim të qartë për bashkëpunim, të huajit i cili është viktimë e tregtisë me njerëz mund t'i jepet leje për qëndrim të përkohshëm, nëse:
- qëndrimi i tij në Republikën e Maqedonisë është i domosdoshëm për shkak të zbatimit të procedurës gjyqësore,
- tregon qëllim të qartë për bashkëpunim me organet kompetente në zbulimin e veprave penale dhe kryerësve, dhe
- i ka ndërprerë marrëdhëniet me personat për të cilët ekziston dyshim i bazuar se janë të përfshirë në kryerjen e veprës penale "Tregtia e njerëz".[1077] Pra, leja e përkohshme qëndrimi deri 6 muajve e cila sipas situatës së viktimës mund të zgjatet ose të përsëritet llogaritet si mbrojtje e viktimës me qëllim të kthimit në vendin e lindjes.

Pa marrë parasysh larmin e orientimeve aksiologjike në shoqëritë dhe kulturat e ndryshme si dhe në sferat e njohurive dhe veprimeve njerëzore, një gjë mbetet fakt se çdo shoqëri është përpjekur të formojë institucionet adekuate normative dhe institucionet tjera në mënyrë që sjelljet e këtilla ti identifikoj dhe ti sanksionoj[1078], të cilët llogariten edhe si autoritete kompetente për identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Termi "Autoritetet Kompetente" do të thotë që autoritetet publike që mund të kenë kontakt me viktimat e trafikimit, të tilla si Policia, Inspektoriati i Punës, Policia Kufitare, Autoritetet e Emigracionit, Ambasadave, Konsullatave.[1079] Reagim i shpejtë autoritativ dhe efikas në rastet e ndërlikuara të sigurisë, dhe mënyra sistematike e identifikimit të problemit, me ç'rast duhet të vjen në shprehje iniciative, aftësia, kreativiteti, guximi, përgjegjësia, dhe vlerësimi efikas, si dhe mendjehollësia dhe shkathtësia në zgjidhjen e situatave komplekse të theksuara[1080] sidomos gjatë identifikimit të viktimave. Një tjetër aspekt i rëndësishëm i procesit të identifikimit qëndron në vet-identifikimin e personave të trafikuar, d.m.th kapaciteti i tyre për të analizuar, kuptuar dhe pranuar idenë se ata janë bërë viktima të veprës së

[1074] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.67
[1075] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.52
[1076] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.59
[1077] Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.35 miratuar më 23.03.2006, neni 82, paragrafi 1
[1078] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.29
[1079] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.51
[1080] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.56

rëndë të trafikimit njerëzor[1081]. Vet idenitifikimi nga ana e viktimave do të ishte kontribuesi më i madh i zgjedhjes së shpejt të problematikës së fenomenit të trafikimit me qenie njerëzore dhe viktimat e saj. Vetidentifikimi do të lehtësonte shumë punën e organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare përshkak se procedura e identifikimit të veprës penale të trafikimit sidomos të disa formave të shfrytëzimit të këtyre viktimave është shumë e vështirë dhe në disa raste pothuajse e pamundshme përshkak të natyrës së tyre. Pra, disa forma të shfrytëzimit të trafikimit me qenie njerëzore janë shumë më të vështira për tu identifikuar. Trafikimi me qenie njerëzore me qëlim të punës si sherbetor shtëpiak, viktimat e punëve në blegtori, pylltari dhe bujqësi është vështirë për tu zbuluar që pengon edhe identifikimin si shkak i punëve që kryejnë larg syve të njerëzve.

Rol të veçantë gjatë procesit të identifikimit e deri tek riintegrimi e ka Ministria e punës dhe politikës sociale, sidomos instituti publik Qendra ndër-komunale për punë sociale. Ekipet e ekspertëve janë të përfshirë në procesin e ndihmës dhe mbështetjes së viktimave të trafikimit me qenie njerëzore nga identifikimi e deri në riintegrim në mjedisin shoqëror.[1082] Edhe në vendin tonë realizohen një sërë procese të identifikimit të viktimave të mundshëm nga organet kompetente ku viteve të fundit identifikohen më shumë viktima të gjinisë femërore. Vitet e fundit, numri i viktimave të identifikuara dhe të ndihmuara të trafikimit për shkak të punës së detyruar dhe lypje ka qenë relativisht më i lartë sesa për shfrytëzimin seksual[1083] sidomos tek popullata rome.

Problematika e identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ka të bëjë me qëndrimin dhe mendimin negativ të viktimave ndaj nëpunësve zyrtar të cilët e kanë për detyrë marrjen në pyetje përshkak se viktimat mendojnë se vet ata janë kryerës të krimit. Viktimat nga aspekti i të menduarit mendojnë dhe prodhojnë pavetëdije një mendim dhe thënie e cila nuk i ndihmon atyreve duke e ndjerë veten fajtor me punën ilegale, qëndrimin e paligjshëm në atë shtet dhe frika nga dënimi, puna që e kanë bërë ka qenë pa leje dhe e kundërligjhme, frika nga deportimi, ndalesat dhe dënimet me burg ose me para ndaj tyre. Këto shkaqe të larëpërmendrua mund të jenë në avantazh të trafikantëve që ata të ikin përgjegjësisë penale, përshkak se viktimat do të ikin deklaratës së vërtetë. Pra, në këto raste të lartëpërmendura mund të ndikojnë tek femrat dhe vajzat e reja sidomos tek prostitucioni vullnetar që në deklaratën e tyre të japin se janë viktima të trafikimit e jo si kryerës të veprës penale, kjo nënkupton se këta persona e keqpërdorin situatën duke u paraqitur si viktima dhe të përftojnë nda mbrojtja dhe ndihma që i takon viktimave, dhe këta persona shpesh quhet edhe si viktima simuluese, por faktikisht nuk janë viktima të vërtetë por të rremë. Viktima simuluese-viktima e shpifur, apo viktima e rrejshme, është tip i veçantë i viktimave, të cilat në realitet nuk kanë pësuar, por shtiren në mënyrë artificiale se gjoja kanë pësuar dhe shpesh akuzojnë dhe fajësojnë të tjerët për viktimizim apo për shkaktimin e dëmeve të ndryshme.[1084] Njerëzit që janë viktima të trafikimit me qenie njerëzore pas një kohë pranojnë situatën e tyre dhe më mund të llogariten si pjesë e këtij sektori.[1085]

"Pse është e rëndësishme identifikimi i viktimave të trafikimit?

- Siç u shpjegua më lart, për t'i ofruar viktimat në shërbime, ato së pari duhet të identifikohen.
- Viktimat e migrantëve të padokumentuar kanë rrezik të dëbohen pa u identifikuar.

[1081] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.59

[1082] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. "Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе". Скопје, 2014, fq.9

[1083] Резолуција. "Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014". Скопје, 2008, fq.31

[1084] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.55

[1085] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.356

- Viktimat e trafikimit mund të kenë nevojë urgjente për ndihmë të shëndetit fizik dhe mendor.
- Viktimat e trafikimit dhe të afërmit e tyre jetën e kanë nën rrezikun që buron nga trafikantët.
- Identifikimi i gabuar (informator i trafikantit) mund të lejojë organizatën kriminale të arrijë në vendet ku ofrojnë shërbim dhe mund të paraqes rrezik."[1086]

Rëndësia e identifikimit si proces e cila është shumë i ndërlikuar dhe e komplikuar për bzatim në praktik sepse viktimat e abuzuar dhe e shfrytëzuar shpeshherë në mënyrë më çnjerëzore mund të kenë nevoja për ndërhyrje sa më të shpejtë dhe urgjente për shkak të problemeve shëndetësore fizike, seksuale ose psikologjike. Identifikimi i personave të trafikuar është me rëndësi për sigurimin e të Drejtave të Njeriut, që nga identifikimi i parë dhe më kryesorja duhet menduar të sigurohet aksesi për mbrojtjen dhe ndihmën e nevojshme.[1087] Nëse mungon identifikimi i duhur, viktimës i mohohen të drejtat, ri-viktimizohen dhe procedura penale mund të mbetet pa një burim të rëndësishëm informacioni dhe/ose dëshmitarë, dhe kryerësi pa gjykim[1088] si dhe pamundësohet identifikimi i tërësishëm i viktimave të dyshimt. Identifikimi i personit e cila është objekt i trafikimit me qenie njerëzore mund të jetë proces kompleks për të cilën është e nevojshme kohë, udhëzim profesional dhe struktura për mbështetje, me qëllim të krijimit të hapësirës së sigurt për viktimën.[1089]

1.2. Fazat dhe rregullat e identifikimit

Procedura e identifikimit të personave që janë viktimë të veprave penale në përgjithësi dhe në rastin konkret të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore bazohet në prova dhe faktet që kanë lidhje me veprën penale dhe palët e saj dhe që llogaritet si një rregull për identifikim. Që një fakt të ketë vlerë duhet të ekzistojë lidhja e tij me çështjen dhe që njoftimi në këtë fakt të ketë dalë nga një burim i ligjshëm, të jetë marrë sipas rregullave procedurale të parashikuara për çdo provë në vete.[1090] Provat janë njoftimet mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara me ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.[1091] Përmbushja e detyrave në mënyrë juridike dhe profesionale, duke inkuadruar dhe vendimet të cilat duhet të merren[1092], siç shihet edhe tek identifikimi i viktimave të mundshëm të trafikimit si procedurë e cila kërkon një kohë të gjatë, këmbëngulësi, profesionalizëm nga nëpunësit e organeve kompetente përshkak se kemi të bëjmë për një kategori të shoqërisë e cila veç më janë cenuar liritë dhe të drejtat e tyre themelore si dhe ndaj tyre është ushtruar abuzime psiqike, fizike, dhe seksuale si ndaj të rriturve po ashtu edhe ndaj të miturve dhe fëmijëve si një kategori e veçantë. Në parim disa tregues të thjeshtë si p.sh. nëse fëmija ka dokumente, nëse e flet gjuhën e vendit, nëse jeton në kushte nënnormale ose i mbikëqyr, nëse nuk jeton me prindët ose të afërmit apo nëse është i përfshirë në

[1086] Dündar, Tuba. Özel, Elif. "Insan ticareti suçunu anlamak", Istanbul, 2017, fq.31
[1087] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.17
[1088] Jovanović, Slađana. Savić, Marijana. "Nacionalni mehanizam upućivanja žrtava trgovine ljudima u republici Serbiji". Beograd, 2008, fq.43
[1089] OSCE-ODIHR. Практичен прирачник "Национални механизми за упатување, здружување на напорите на заштита на правата на лицата кои се предмет на трговија". Poland, Warsaw, 2004, fq.17
[1090] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.26
[1091] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.26
[1092] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.65

veprimtari kriminale apo të paligjshme, nëse ka shenja të dukshme dëmtimi e abuzimi, mund të jenë shenjat e para se fëmija mund të jetë trafikuar.[1093]

Në përgjithësi identifikimi i personave të cilat mund të jenë viktima të mundshëm të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore kalon në disa faza: vlerësimi paraprak dhe përcaktimi, analiza fizike dhe psikologjike, realizimi i intervistët ndaj viktimave të dyshimtë, vendimi përfundimtar.

Procesi i identifikimit përfshin:

1. Udhëzimi fillestar: viktima e supozuar udhëzohet ose i drejtohet vetë autoriteteve kompetente për kërkesë fillestare;
2. Dhënia e informacionit preliminar: dhënia e informacioneve themelore viktimës së caktuar dhe diskutimi për nevojat e tyre urgjente;
3. Vlerësimi i hershëm i rrezikut: vërtetimi i rrezikut të shëndetit dhe siguria e viktimës;
4. Gjuha dhe përkthimi: mundësimi i bisedës në gjuhën e kuptueshëm me viktimën e caktuar;
5. Identifikimi (për tu vërtetuar statusi i viktimës): parashtrimi i pyetjeve dhe rishqyrtimi i rrethanave për identifikimin e viktimës së caktuar si viktimë e trafikimit me qenie njerëzore ose ndonjë lloj tjetër të kriminalitetit;
6. Dhënia e informacioneve pas identifikimit: marrja e pëlqimit nga viktima në bazë të këmbimit paraprak të informacioneve dhe kyçjen e saj në programin për ndihmë;
7. Periudha e vendimmarrjes dhe lejes për qëndrim të përkohshëm e cila mundëson rimëkëmbjen dhe vendimin për bashkëpunim me organet kompetente dhe mundësi për marrjen e lejes për qëndrim të përkohshëm.[1094]

Kështu që ka vende të cilët identifikimin e bëjnë organet e zbatimit të ligjit si policia, policia kufitare, punëtorët social, inspektoriati i tregut ose organizatat joqeveritare varësisht se në cilën fazë janë të zbuluara. Për shembull, në shumë vende po edhe në Maqedoni fazën e parë të identifikimit zyrtar joformal e bën policia kufitare, shërbimet konsullore dhe inspektoriati i punës dhe kjo llogaritet edhe si identifikimi i hershëm kurse procedurën përfundimtare se një person a është ose jo viktimë e trafikimit me qenie njerëzore e kanë për detyrë qendrat e punës sociale si dhe në fund gjykatat dhe prokuroritë përkatëse të vendit me aktvendimet e tyre miratojnë vendime në lidhje me mbrojtjen dhe ndihmën ndaj tyre. Pra, identifikim e viktimave në fazën e parë e kryen Ministria e punëve të brendshme duke u bazuar në ate se ata janë të parit që mund të zbulojnë viktimat e mundshëm të trafikimit dhe është e radhës që fazën e parë të identifikimt të kryejnë policët. Për të bërë një identifikim formal korrekt dhe sipas procedurave, punonjësit e Shërbimit Social duhet t'i përgjigjen në çdo kohë thirrjes së punonjësit të Policisë të Sektorit për Trafikun e Paligjshëm për të marrë pjesë në intervistën formale dhe të bashkëpunojnë me të, të respektojnë qëllimin e intervistës formale/identifikimin formal, të komunikojnë dëshirën për të dëgjuar, të respektojnë identifikimin fillestar dhe informacionin e mbledhur.[1095] Procedurat standarde operative i detyrojnë autoritetet kufitare të informojnë Njësinë kur ekziston dyshimi për një rast të trafikimit me qenie njerëzore.[1096] "Identifikimi po bëhet nga policia dhe nëpunësit e kufirit, rallë, por shpesh edhe me kyçje të pamjaftueshëm të punonjësve socialë dhe OJQ-ve. Pjesëmarrësit tjerë,

[1093] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.51

[1094] Влада на Република Македонија, Национална Комисија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција "Стандардни оперативни процедури за постапување со жртви на трговија со луѓе", Скопје, 2010, fq.11

[1095] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.21

[1096] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.53

veçanërisht inspektorët e punës, kryesisht janë ose joformalisht të kyçur në identifikim, nuk janë aspak aktivë, ose përballen me pengesa në përmbushjen e përgjegjësive të tyre."[1097]

1.3. Mjetet dhe teknikat e identifikimit

Në kuadër të fazave të identifikimit të personave të dyshimtë të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore, identifikimi realizohet duke u përmbajtur dhe respektuar disa rregulla dhe parametra. Parametrat e mëposhtme llogariten si mjete dhe teknika më të rëndësishme nëse një person i cili llogaritet si subjekt trafikimit është ose nuk është viktimë e dyshimtë e trafikimit me qenie njerëzore për qëllime të ndryshme.

Mjetet dhe teknikat për identifikimin e viktimave të mundshëm të trafikimit me qenie njerëzore (indikatorë të përgjithshëm) janë:

***Vlerësimit paraprak**:* mosha, gjinia, nacionaliteti (shtetësia), dokumentet e identifikimit (pasaporta, letërnjoftimi), vendi i viktimave, personat tjerë (personat e tretë, ndërmjetësuesit ose trafikantët), numri i personave në mjetin transportues etj. Edhe shkenca e kriminalistikës përmes mjeteve, teknikave, kuadrove ndihmon në masë të madhe gjatë procesit të identifikimit qoftë viktimat ose kryerësit e veprave penale. Mjetet për identifikimin kriminalistik janë: lista abecedike, antropometria, daktiloskopia, monodaktiloskopia, kiroskopia, fotografia sinjaletike, fotografia e përshkruar, pyetja e dëshmitarit, ekspertimi i letërnjoftimit[1098] dhe të dokumenteve personale të viktimës ose të kryerësit të veprës penale.

Ekzaminimi (analiza) fizike dhe psikologjike e viktimave llogaritet si fazë e dytë e cila realizohet ndaj viktimave të mundshëm përshkak se ndaj tyre mund të jetë përdorur abuzime fizike dhe psikologjike me qëllim të shfrytëzimit të tyre për interesat e trafikantëve. Në shumicën e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore, është vërejtur se viktimat e shfrytëzuara për prostitucion, punë të detyruar, lëmosha, kryerja e krimeve, heqja e organeve ose ndonjë shfrytëzim tjetër janë të ekspozuar ndaj abuzimeve të ndryshme fizike dhe seksuale pas konfiskimit të dokumenteve personale me qëllim të realizimit të objektivave të organizatës kriminale dhe të trafikantëve. P.sh. trafikantët mund të mbështeten mbi ndonjë detyrim borxhi dhe forma të ndryshme frikësimi e jo në konfiskimin e dokumentave të identitetit dhe barrierat gjuhësore për personat e trafikuar.[1099]

Realizimi i intervistët ndaj viktimave të dyshimtë si fazë para marrjes së vendimit përfundimtar ka rëndësi të veçantë sepse nëpunësit zyrtarë dhe viktima potencial e trafikimit përballohen direkt dhe parashtrohen pytje e cila mund të jetë një bazë e dyshimt dhe më në fund e njejta mund të jetë edhe dyshimi parapak i bazuar se personi është ose nuk është viktimë e trafikantëve. Realizoni intervista të besueshme, nëse është e nevojshme, për t'i marrë të dhënat e besueshme[1100] është një nga qëllimet e intervistës. Intervista duhet të bëhet kur viktima e presupozuar do të ndjehet e gatshme dhe do të jep pëlqim ose deri në skadimin e periudhës për përshtatje dhe vendimmarrje.[1101] Pra, nëpunësit që do të jenë në krye të intervistës duhet të njohin mirë teknikën e marrjes në pyetje dhe të hetimit të dyshuarve. Në të gjitha rastet e marrjes në pyetje, dhënies së deklaratave, intervistave, zyrtarët që i zbatojnë ato duhet të kenë parasysh

[1097] Po aty, fq.92

[1098] Latifi, Vesel. "Kriminalistika". Prishtinë, 2004, fq.28

[1099] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.30

[1100] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.21

[1101] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.219

respektimin e dinjitetit dhe integritetit të saj fizik, moral dhe familjar.[1102] Pyetjet e parashtruara duhet të jenë të qarta dhe të shkurtëra si dhe jetë në pajtueshmëri me nivelin e arsimit të viktimës.

***Vendimi përfundimtar**:* pëson menjëherë pas përfundimit të intervistës së detajuar dhe kur ekziston dyshimi I bazuar nga ana e nëpunësit zyrtar se personi i dyshuar a është me të vërtetë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore ose vet vullnetarisht e ka kryer punën e cila me ligj është e ndaluar. Pra, këtu realizohet përfundimisht identifikimi i personave të dyshuar paraprakisht si viktima të trafikimit me qenie njerëzore.

2. Mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të trafikuara

Me nocionin mbrojtja e viktimave nënkuptohen të gjitha veprimet e bazuara në norma ligjore lidhur me ofrimin e ndihmave dhe mbrojtjen e viktimave që kanë pësuar nga cenimet dhe atakimet kriminale.[1103] Shumë pak prej tyre marrin ndihmë dhe mbrojtje si viktima të një krimi të rëndë, më shpesh, ata arrestohen, ndalohen dhe akuzohen për shkelje të rregullave të imigracionit, për prostitucion, apo përfshirje në punë të paligjshme, për deklarime të rreme, apo gjobiten për shkelje të ligjeve dhe rregullave administrative[1104] pra llogariten si kryerës e jo si viktimë e krimit. Rendi juridik i ka njohur disa të drejta viktimave dhe atyreve që kanë pësuar dëm[1105], pothuajse në gjitha vendet e botës. Megjithatë, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore kanë nevoja që shpesh nuk mund të shprehen: ata duhet të mbështeten në baza afatgjate për të bërë kalimin nga "viktima" në "të mbijetuar" në person të pavarur.[1106] Plani afatgjatë i ndihmës duhet të përfshijë: vlerësimi individual; kujdestaria; kujdesi; mbështetje psikosociale; mbrojtje shëndetësore; arsim/edukim; ndihmë juridike; përkthyes.[1107]

Mbrojtja dhe ndihma ndaj viktimave të trafikimit me qenie njerëzore mbetet një sfidë dhe pikësynim për institucionet e vendit tonë edhe pse ekzistojnë hapa për përmirësimin e gjendjes së viktimave sidomos në krijimin e kushteve për mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës së nevojshme por prap ekzistojnë shumë pengesa në praktikë, sidomos në pjesën e riintegrimit. Masat, programet dhe shërbimet që kanë të bëjnë direkt me viktimat që nga momenti i zbulimit të tyre si viktima të trafikimit e deri tek rehabilitimi dhe reintegrimi i tyre në shoqëri llogariten si aktivitete që kanë për qëllim mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave. Këto masa mund të ofrohen nga organizata joqeveritare, qeveritare ose ndërkombëtare në vendet e destinacionit, tranzitit ose origjinës.[1108] Mbrojtja dhe ndihma e viktimave të mundshëm të trafikimit bëhet përmes organeve kompetente shtetërore dhe organizatave joqeveritare sidomos nga ana e kuadrove të trajnuar dhe profesionalizuar në atë lëmi në mënyrë të shkruar organeve kompetente. Policia , organet e judikaturës, shërbimet shëndetësore dhe sociale si dhe personeli tjetër duhet të aftësohen që t'u ofrojnë ndihmë adekuate dhe me kohë viktimave.[1109]

[1102] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.142

[1103] Po aty, fq.14

[1104] Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit, Tiranë, 2014, fq.7

[1105] Öztürk, Bahri. Erdem, Özbek, Veli Özer, Mustafa Ruhan, Erdem.. "Uygulamali Ceza Hukuku ve Emniyet Tedbirleri Hukuku". Ankara, 2003, fq.303

[1106] Упатства за рехабилитација и реинтеграција на жртви од трговија со луѓе -Прирачник за земјите од Западен Балкан, Скопје 2015 , fq.4

[1107] Стандардни оперативни процедури за постапување со непридружувани деца-странци. Скопје, 2015, fq.33

[1108] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.10

[1109] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.136

Lidhur me çështjen e ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, Republika e Maqedonisë po ndërmerr aktivitete për sigurimin e sistemit juridik dhe administrativ, që do të përfshijë masa sigurimi të informatave të viktimave, të procedurave gjegjëse gjyqësore dhe administrative përballë organeve përgjegjëse, ndihmë e cila mundëson qëndrimet e tyre të jenë të paraqitura dhe të shqyrtuara në fazat gjegjëse të procedurave penale kundër kryesve të akteve penale, në atë mënyrë që të mos ndikohet në të drejtën e mbrojtjes.[1110] Agjencioni për koordinim të mbrojtjes nga trafikimi me qenie njerëzore ka si detyrë kryesore sigurimin e të drejtave të viktimave, identifikimin dhe ndihmën e viktimave dhe koordinimin e aktiviteteve të qeverisë dhe agjencionet e organizatave joqeveritare.[1111]

Personit që ka qenë viktimë e trafikimit, pas largimit nga trafikimi me qenie njerëzore nevojitet:

- të kujdeset sigurt, vend të sigurt,
- të mbrohet nga ana e shtetit prej trafikantëve të qenieve njerëzore,
- të marrë informacione për drejtat e tij,
- të merr ndihmë juridike,
- të marrë kujdes mjekësor,
- të ketë të drejtë të kërkojë testimin për HIV,
- nëse është shtetas i huaj të marrë një përkthyes,
- të merr ndihmë, mbështetje dhe terapi psikologjike,
- të ketë drejtën e përfitimeve sociale,
- të ketë drejtën e kompensimit.[1112]

Viktimat e huaja të trafikimit kanë këto të drejta: akomodim adekuat dhe të sigurt, ndihmë mjekësore, këshillimi dhe informacioni, veçanërisht sqarim i të drejtave dhe detyrimeve në gjuhën që ata kuptojnë, ndihmë juridike gjatë procedurave penale dhe procedurave të tjera në të cilat viktimat gëzojnë të drejtat e tyre, informacion mbi qasjen në selitë diplomatike dhe konsullore të shteteve të origjinës ose ku e kanë vendbanimin e zakonshëm, informacion mbi mundësitë dhe procedurat e kthimit dhe llojet e ndryshme të trajnimit dhe arsimit, në varësi të mundësive financiare.[1113]

2.1.Mbrojtja dhe ndihma viktimave për ndihmë të parë, strehim dhe ushqim

Ndihma e parë, strehimi dhe ushqimi i viktimave janë ndihmat e para që patjetër viktimave tu sigurohet menjeëher pas zbulimit dhe është hapi i parë dhe më kryesori dhe më se nevojshmi për viktimat, shëndetin dhe jetën e tyre dhe mëpas të mendohet për mbrojtje dhe ndihma të tjera. Ndihma e parë, strehimi dhe ushqimi duhet që sa më shpejt të sigurohet përshkak se viktima e ndëron ambientin ku më parë ka qenë nën kontrollin dhe kushtet që i ka ofruar trafikanti, kurse tani më është në duart e organeve kompetente shtetërore dhe duhet të kthehet kushteve normale për jetë. Në institucionet e përkujdesjes shoqërore pranohen: a) fëmijët e trafikuar, ose në rrezik

[1110] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.12

[1111] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.14

[1112] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.28

[1113] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.40

trafikimi; b) personat mbi 18 vjeç, të identifikuar si viktima trafikimi, ose viktima të mundshme trafikimi; c) personat e huaj, të identifikuar si viktima trafikimi, ose viktima të mundshme trafikimi.[1114] Të vlerësohen në mënyrë më të shpejtë se cilat janë nevojat më të domosdoshme në momentin e parë për mjekim, për vendosje, për sigurim fizik etj.[1115] Ndihma e parë dhe kontrollet shëndetësore kanë një vlerë të veçantë përshkak se viktimat e trafikimit mund të kenë probleme të ndyshme shëndetësore që kanë fituar për shkak të keqtrajtimit dhe shfrytëzimit gjatë procesit të trafikimit sidomos sëmundjes e rrezikshme nga ushtrimi i prostitucionit siç është HIV/SIDA si sëmundje të transmetueshme.

Të drejtën e mbrojtjes shëndetësore me Ligjin për mbrojtje shëndetësore të Maqedonisë sipas nenit 63, paragrafi 1 pika 4 kanë personat personat e huaj në vend pra këtu bëjnë pjesë edhe viktimat e huaj të trafikimit dhe shpenzimet i mbulon shtetidhe ate si vijon: "Republika siguron mjete për: ofrimin e kujdesit urgjent mjekësor për shtetasit e huaj"[1116]. Ndihma mjekësore gjegjësisht ndihma e parë në rastin konkret viktimave të trafikimit me qenie njerëzore është e patjetërsueshme dhe obligim ligjor të personelit mjekësor dhe në të kundërtën kanë përgjegjësi penale. Stafi mjekësor përgjegjës për viktimën duhet të përgatisë plane që propozojnë tretman ose terapi për viktimën, dhe me pëlqimin e saj të njëjtën të dërgojë edhe tek organizatat joqeveritare që vepron në rajonin dhe e cila mund të ndihmojë në implementimin e tretmaneve të tilla.[1117] Këtu rëndom përfshihen veprimet e ndihmës rreth kujdesit mjekësor, reth strehimit, ushqimit, veshmbathjes, vënies së kontakteve me familje apo të afërm, shoqërimit, ofrimit të mbrojtjes dhe sigurimit të tyre nga kërcënimet dhe shantazhet, ofrimit të masave siguruese, vënien nën mbikëqyrje dhe kujdes të policisë pos shërbimeve të tjera.[1118]

Strehimi dhe akomodimi realizohet menjëherë pas dhënies së ndihmës së parë nga personeli mjekësor. Transporti i sigurt dhe akomodimi i viktimave të trafikimit, qoftë të huaj apo vendas, është parakushti i parë për të ndihmuar viktimat, në përputhje me Procedurat Standarde të Operimit për trajtimin me tiktimat e trafikimit me qenie njerëzore.[1119] "Në ato vende ku ka strehimore dhe qendra rehabilitimi për viktima të rritur të trafikimit me qenie njerëzore, procedurë standarde është që viktimat të jetojnë atje në fillim menjëherë të arritjes së tyre. Nëse ata nuk janë në gjendje vet të ballafaqojnë, nuk munden ose nuk duan të kthehen në familjet e tyre dhe nuk kanë një vend të përhershëm për të qëndruar, atëherë organizata duhet t'i ndihmojë ata të vendosen në strehimore ose shtëpi të përkohshëm."[1120] Ata së pari vijnë në strehimore dhe mund të marrin mbështetje të tilla si shërbimi shëndetësor dhe psikologjik i quajtur një periudhë fuqizimi, e drejtë e cila garantohet me ligj edhe nga shteti jonë. ofroni kujdes shëndetësor për viktimat e trafikimit njerëzor, përveç nëse parashikohet ndryshe. Pas përcaktimit të gjendjes dhe nevojave të viktimës, ekipi në strehimore, i përbërë nga psikologë, punonjës socialë, mjekë (të trajnuar posaçërisht për këtë lloj pune), bën një plan për mbështetje psikosociale dhe rehabilitim shoqëror të viktimës.[1121]

Mbështetjen dhe ndihmën e viktimave të veprës penale e parasheh edhe Ligji i procedurës penale të Maqedonisë në nenin 53 të saj sidomos paragrafi 1 pika 3. Ndihmë efikase psikologjike

---

[1114] Raport. "Mekanizmat kundër dhunës dhe trafikimit". Tiranë, 2015. fq.51

[1115] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.141

[1116] Закон за здравствена заштита (пречистен текст), Сл. Весник на Р.Македонија бр. 38/91; У. суд - 73/92; 46/93 и 55/95 и пречистен текст - 17/97 од 10.04.1997 година, neni 63, paragrafi 1, pika 4

[1117] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.93

[1118] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.151

[1119] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. "Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе". Скопје, 2014, fq.12

[1120] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.107

[1121] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.28

dhe ndihmë tjetër profesionale dhe mbështetje nga ana e organeve, institucioneve dhe organizatave për ndihmë viktimave për vepa penale[1122] është detyrim ligjor i shtetit. Një prej shërbimeve të rëndësishme që qendrat ofrojnë është dhe ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve me familjen dhe këshillimi në familje[1123], pra kjo nënkupton ndërmjetësim me qëllim të rivendosjes së raporteve me familjarët si dhe përforcimin e marëdhënieve në mes të viktimës dhe anëtarëve të familjes në vendin e origjinës. Ndihmën e sigurojnë falas dhe e njëjta përfshin akomodimin, ndihmën mjekësore, këshillimin dhe programin për ri-integrim, të cilat mund të përfshijnë trajnime profesionale, ndihmë për gjetje të vendeve të punës dhe një skemë mikro-kredie e cila lejon viktimave të fillojnë bizneset e tyre[1124], të cilat e karakterizojnë shtëpitë e strehimit edhe në shtetin tonë. Personi që është identifikuar si viktimë e trafikimit, sipas nevojave, pajiset me akomodim në një strehë të sigurt hapësirë (strehim) dhe plotësohen nevojat e tij themelore.[1125] Që viktimës t'i sigurohen ambienti dhe atmosfera e besimit të plotë se mund të tregojë rrjedhën e viktimizimit dhe të eliminojë frikën në këto raste është pranishme[1126] në strehimore do të ishte një hap i rëndësishëm drejt identifikimit më të shpejtë dhe më të suksesshëm. Të informojë viktimat për vendstrehimet për viktima, për shoqatat apo organizatat joqeveritare, që merren me ofrimin e dihmës së pare apo vendstrehimin e përkohshëm të tyre[1127], nga ana e policisë ose punëtorëve social të cilët marrin në pyetje viktimat që më lehtë të orientohen me hapat e mëtutjeshme.

Në vendin tonë ekzistojnë dy strehimore që ofrojnë mbrojtje, ndihmë dhe shërbime viktimave ku njëra është nën kontrollin e Ministrisë së Punëve të brendshme për viktima të huaj të trafikimit me qenie njerëzore por edhe për migrantët e paligjshëm, kurse tjetra është nën kontrollin e organizatës joqeveritare La Strada për shtetasit e maqedonas dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Shërbimet të cilat janë në dispozicion të viktimave të trafikimit:

- Udhëzimi dhe akomodimi në strehimore, vlerësimi i nevojave dhe intervenimi në krizë,
- Ekip profesional që kryen aktivitete në ndërrime ditore dhe nate, si dhe shoqërimi i viktimave në destinacionet e nevojshme,
- Ushqim i siguruar gjatë qëndrimit të tyre, mjete higjienike, veshje dhe këpucë,
- Përfshirja në programin e ndihmës psiko-sociale (punëtori të ndryshme, trajnime për punë në kompjuter, orë bazë për mësim të gjuhës angleze, etj.),
- Organizimi i aktiviteteve profesionalo-rekreative, në varësi të afiniteteve siç janë: vizatimi në qelq, vizatimi në kanavacë, teknika me peçeta, bizhuteri të punuar me dorë, vizatim në porcelan, thurja, qepja, teknikat origami,
- Janë siguruar kontrolle themelore mjekësore dhe kontrolle të specializuara gjinekologjike, ekzaminime laboratorike, testime për HIV, hepatit A, B dhe C,
- Këshilla juridike dhe njohje me sistemin gjyqësor dhe përfaqësim para organeve gjyqësore nga një avokat në procedurat gjyqësore paraprakisht të filluara,
- Plan individual afatgjatë për përfshirje në procesin arsimor pas kthimit në vendin e jetesës;
- Mbështetje psikologjike për viktimat, duke përfshirë lloje të ndryshme të trajtimeve dhe seancave, terapi në grup dhe këshillime psikologjike individuale një herë në javë, si dhe ndihmë urgjente dhe më intensive sipas nevojës,

[1122] Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150 од 18.11.2010 година, neni 53, paragrafi 1, pika 3

[1123] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.37

[1124] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.58

[1125] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.28

[1126] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.141

[1127] Po aty

- Tejkalimi i stresit dhe traumës, formimi i shprehive, përmirësimi i aftësive të leximit, të menduarit pozitiv, njohuritë themelore rreth problemeve të zhvillimit të adoleshentëve, marrëdhëniet dhe lidhjet emocionale me bashkëmoshatarët, rreziqet e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe shtatzënisë së padëshiruar.[1128]

2.2. Mbrojtja dhe ndihma viktimave dhe anëtarëve të familjes për siguri fizike nga kërcënimet

Sigurimi i ndihmës për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore në thelb është shumë i rrezikshëm dhe asnjë sistem i sigurisë, sado i sofistikuar dhe i pajisur të jetë, nuk mund të eliminojë plotësisht elementin e rrezikut.[1129] Pra, rrezikshmëria e ofrimit të mbështjetjes, mbrojtjes dhe ndihmës viktimave nga ana e anëtarëve të krimit të organizuar dhe trafikantëve ka të bëj sidomos kur ata dëshmojnë kundër tyre dhe tregojnë shfrytëzimin që janë bërë derisa sa kanë qenë nën kontrollin e tyre. Andaj, gjatë procedurës së identifikimit dhe ofrimit të mbrohtjes dhe ndihmës viktimave nga ana e nëounësve të institucineve kompetente duhet të vlerësohet rreziku që mund të pësoj viktima dhe dëshimtarët si dhe anëtarët e familjes së viktimës me qëllim të menaxhimit sa më të mirë të procesit të identifikimit. Pra vlerësimi i rrezikut ka të bëj me identifikim e suksseshëm, të saktë dhe të hershëm të viktimave të trafikimit me qenie njerëore. Nga kjo del se procesi i përgjithshëm i vlerësimit të rrezikut duhet të jetë permanent dhe ti ndjek çdo fazë të identifikimit të viktimave, sepse nuk mjafton dhe ska sukses vlerësimi të bëhet një herë dhe të ketë sukses sepse rreziku mund të paraqitet në çdo fazë të identifikimit.

Rreziku definohet si situatë e shkaktuar nga njeriu, kafsha apo fuqia natyrore, në të cilën ekziston mundësi që kufizohet, për shkelje të ndonjë të mire juridike të mbrojtur[1130] në rastin konkret nga grupet e krimit të organizuar dhe trafikantët. Viktimës që në momentin e parë të rastit viktimizues, duhet t'i ofrohet siguri e plotë që ajo lirshëm të tregojë gjendjen dhe ndjenjat e saj lidhur me rastin[1131]. Përmes përkrahjes,mbështetjes së viktimës realizohet dhe formohet një besim më të fortë viktimës ndaj organeve shtetërore, sistemin gjyqësore, prokurorisë publike, objektivitetin e organeve për mbrojtjen dhe ndihmën ndaj tij dhe përmes kësaj ti relizoj të drejtat që i takojnë me ligj duke e respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tij të cilat garantohen me aktin më të lartë juridic, pra me Kushtetutë. Nëse viktimat binden se çështjet e tyre nuk përfillen, nuk garantohet liria e paraqitjes së kërkesave dhe nuk sigurohet jeta e tyre, gjasat janë shumë të vogla që ato të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë për zbardhjen e rastdve kriminale.[1132] Pasi viktimat zbulohen dhe vendosen në strehimore ata i pret një periudhë kohore ku ata duhet të realizojnë një sërë të drejtash në institucione të ndryshme dhe i duhet një lëvizje të lirshëm dhe të sigurtë. Me zbulimin e viktimave raporti me trafikantët pra, me lryerësit e veprës penale nuk përfundon këtu sepse në shumë raste kryerësit edhe më tutje i shqetësojnë viktimat në mënyrë direkte apo indirekte. Pavarësisht nga vendi ku ndodh shfrytëzimi, personat e trafikuar kanë gjithmonë frikë nga hakmarja e trafikantëve, e cila nuk është shënjestruar vetëm kundër tyre, por edhe kundër familjarëve.[1133] Shqetësimet direkte apo indirekte janë të llojit të kërcënimeve,

[1128] Годишен Извештај. "Превенција и заштита од трговија со луѓе". Министерство за труд и социјална политика, Скопје, 2015, fq.5

[1129] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.3

[1130] Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018, fq.114

[1131] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.141

[1132] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.152

[1133] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.18

atakimeve ndaj tyre apo familjarëve të cilët i njohin nga më herët, shantazhime të ndryshme ndaj tyre ose familjarëve (prindërit, fëmijët, anlëtarë tjerë të familjes së ngushtë), hakmarrje përmes përdorimit të dhunës dhe frikës, gjë që e dëshmon se kryerësit i shqetësojnë që viktimat të heqin dorë nga ndjekja penale, dëshmia ndaj tyre etj.

Zbulimi dhe hetimi i krimeve të organizuara kërkon marrjen e masave mbrojtëse ndaj viktimave të mundshme, dëshmitarëve dhe personave të penduar, të cilët ndihmojnë në zbulimin e aktiviteteve të grupeve kriminale.[1134] Në të vërtetë, në cilindo stad të procedures penale palët, mbrojtësi, i dëmtuari ose dëshmitari mund t'i paraqesin gjyqtarit lutje për caktim të masës mbrojtëse pse për urdhër për anonimitet kur ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin ose për anëtarin e fmiljes së tij.[1135] Në këtë drejtim, viktimat duhet të shoqërohen, nëse vlerësohet si e domosdoshme, gjatë seancave gjyqësore ose gjatë vajtje-ardhjeve në polici apo në organe të tjera ose gjatë ballafaqimit me viktimizuesit e tyre.[1136] Viktimave është e dëshirueshme t'u ofrohet një siguri dhe komoditet gjatë tërë kohës, e veçmas derisa të zgjasë procesi gjyqësor, në mënyrë që të evitohet dukuria e riviktimizimit, e cila, përshkak të neglizhencës së organeve policore dhe gjyqësore, shpesh ndodh në praktikë.[1137] Përveç viktimës siguria fiike duhet të ofrohet edhe anëtarëve të familjes së viktimës sidomos në vendbanimin ku jetojnë duke i kufizuar edhe lëvizjen e tyre derisa sa të përfundojnë këto shqetësime të kryerësve. "Në këto mjedise policia zakonisht shton praninë gjatë 24 orëve apo në kohë të caktuar dhe ndërrmer masa të tjera të kontrollit me qëllim të eliminimit të frikësimit të viktimave apo dëshmitarëve të rasteve viktimizuese. Në shumë vende viktimave, familjarëve dhe dëshmitarëve u lihen në dispozicion numra special të telefonave për raste urgjente të paraqitjes së kërcënimeve apo tentim atakimeve nga kryerësit apo personat e tjerë. Në disa vende vendbanimet, rrugët dhe banesat apo shtëpitë e viktimave, të familjarëve, apo dëshmitarëve janë të lidhura në incizime me videokamera dhe vëzhgohen nga punkte të stacioneve të policisë apo shërbimeve të tjera të specializuara për këto qëllime."[1138]

2.3. Mbrojtja dhe ndihma juridike pa pagesë viktimave të trafikimit

Duke ditur se në kuadër të aktiviteteve të luftimit dhe parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore nga ana e organeve shtetërore në vete ngërthen hetimin, ndjekjen penale dhe procedurën penale që sa më shpejt të përfundohet hetimi dhe ndjekja penale si dhe në fund të procedurës penale që kryerësit të marrin dënimin e merrituar kurse viktimave të sigurohet mbrojtje dhe ndihmë juridike pa pagesë nga fillimi deri në përfundim të kthimit në vendin e origjinës dhe risocializimin e tyre. Viktimat shpesh nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe për këtë arsye është e rëndësishme të informohen për zgjidhjet ligjore të disponueshme për ta, si dhe për shanset e suksesit dhe rreziqet e mundshme.[1139] Nevoja e dhënies së ndihmës pa pagesë viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, është e kushtëzuar nga fakti se periudha e shfrytëzimit, si rregull paraqet pasoja serioze negative ndaj shëndetit fizik dhe psiqik të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore[1140] dhe normal dëshira e viktimës do të jetë dënimi i merituar ndaj trafikantëve.

[1134] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.125

[1135] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.273

[1136] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.151

[1137] Po aty

[1138] Po aty, fq.152

[1139] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.100

[1140] Упатства за рехабилитација и реинтеграција на жртви од трговија со луѓе -Прирачник за земјите од Западен Балкан, Скопје 2015 , fq.14

Viktima në praktikë, shpeshherë është inicues i procedurës penale, ajo e vë pra në lëvizje aparatin shtetëror për trajtimin e rastit viktimizues.[1141] Pozicioni i viktimës në sistemin gjyqësor dhe në sistemin juridik dhe shoqëror në përgjithësi duhet të jetë i tillë që të sigurojë maksimalisht realizimin e të drejtave të njeriut dhe nevojën e tyre themelore për siguri.[1142] Në Ligjin për ndihmën juridike falas rregullohet e drejta e ndihmës juridike falas për personat të cilët, duke pasur parasysh pozicionin e tyre material, nuk mund të ushtrojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligj, pa e rrezikuar ekzistencën vetanake dhe ekzistencën e anëtarëve të familjes së tyre me të cilë jetojnë në një familje të përbashkët.[1143] Kjo ndihmë konsiston në ofrimin e këshillave juridike, në informacionet për të drejtat në procedurë, në paraqitjen e kërkesave me shkrim, në formulimin e parashtresave lidhur me ankesat apo kundërshtimet, në paraqitjen dhe arsyetimin e kërkesës për dëmshpërblim dhe kompensim dhe për çështje të tjera relevante të cilat viktimat vetë nuk janë në gjendje t'i bëjnë.[1144] Me këtë ligj rregullohen e drejta e ndihmës juridike falas, procedurën në të cilën realizohet, shfrytëzuesit, kushtet dhe mënyra e realizimit të saj, ofruesit e ndihmës juridike falas, organet kompetente për vendimmarrje, mbrojtja e së drejtës për ndihmë juridike falas, financimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të saj, organizimi i ditëve të këshillave juridike falas, ndihma juridike falas në mosmarrëveshjet ndërkufitare, si dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji.[1145] Ndihma juridike përbëhet nga informimi i viktimës për drejtat dhe statusin, dhënien e informacionit të përgjithshme juridike për të gjitha veprimet procedurale që rrjedhin nga përfaqësimi, hartimi dhe ngritja e padive, ankesave dhe parashtresave të tjera, rrjedha e procedurës, përkatësisht prania e tyre në rolin e dëmtuarve/dëshmitarëve gjatë udhëheqjes së procedurës penale, për opsionet juridike të disponueshme për mbrojtjen e tyre nëse ata paraqiten si dëshmitarë në procedurën e hetimit dhe seancës kryesore, mundësinë e fillimit dhe kompensimit të dëmeve, si dhe veprimeve të tjera që lidhen me zhvillimin e procedurës.[1146]

Përveç organeve shtetërore si rol kyç në mbrojtjen dhe ndihmën juridike të viktimave e kanë organizatat joqeveritare që meren me këto çështje sidomos me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë tërë procedurës penale me pëlqim paraprak të viktimës duke i respektuar ligjet e brendshme dhe aktet ndërkombëtare. Ndihma juridike e përshtatshme dhe në kohë është vërtetuar se është një mjet i suksesshëm për të zvogëluar ankthin e viktimës dhe për ta ndihmuar atë të marrë vendimin e duhur nëse ajo është e gatshme të bashkëpunojë me institucionet e zbatimit të ligjit ose të paraqitet në gjykatë.[1147] Viktimat e trafikimit përfitojnë përfaqësim ligjor nga shteti në rast të përfshirjes së tyre në procese ligjore, por viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit e kanë të nevojshme konsultimin dhe orientimin ligjor edhe në raste të mospërfshirjes në procese gjyqësore, dhe këto konsultime aktualisht kryhen nga avokatët e qendrave apo shërbimeve ligjore të organizatave të shoqërisë civile[1148] sidomos ndaj viktimave të mitur dhe fëmijë. "Ndihma juridike

[1141] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.142

[1142] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.264

[1143] Анализа. "Усогласеноста на одредбите од Законот за превенција, спречување и заштита од семејно насилство со стандардите содржани во Конвенцијата на Совет на Европа за спречување и борба врз жените и домашно насилство (Истанбулска Конвенција)". Скопје, 2013, fq.19

[1144] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.151

[1145] Закон за бесплатна правна помош („Службен весник на Република Македонија" бр.161/09 и 185/11), neni 1

[1146] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. "Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе". Скопје, 2014, fq.18

[1147] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.100

[1148] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.30

ndaj fëmisë viktimë sigurohet me drejtë advokat i cili ka ndjekur trajnim të specializuar për të drejtat e fëmisë. Mbrojtja e fëmijëve realizohet me sigurimin e kushteve dhe nivel të standardit jetësor që përgjigjet në zhvillimin fizik, mental, emocional, moral dhe social të fëmijëve.[1149] Trajnimi zgjat së paku pesë ditë gjatë vitit në vend ose jashta."[1150]

Pra, viktimat ka të drejtë të marrë informata në lidhje me procedurat, dokumentet, provat, analizat dhe gjësendet tjera që të përgaditet më mire në lidhje me mbrotjen e vet. "Ajo ka të drejtë të ndërmarrë veprime ose të angazhojë mbrojtës. Nëse ajo nuk ka mjete për sigurimin e mbrojtjes apo përfaqësuesit juridik, në shumë vende këtë ia mundëson shteti apo OJQ-të që kujdesen për viktimat."[1151] Shoqata të autorizuara qytetare mund të ofrojnë ndihmë juridike paraprake nëse i plotësojnë kushtet me këtë ligj[1152], pra me Ligjin për ndihmë juridike falas. Avokati është ai i cili do i mbrojë viktimat gjatë gjithë procedures juridike pranë organeve kompetente dhe paraprakisht duhet të sqarojë procedurën për mbrojtjen e të drejtave të tyre i cili në takimin e pare e ndëgjon deklaratën e viktimës në lidhje me rastin e viktimës gjatë periudhës së trafikimit që sa më mire të mbrojë të drejtat e viktimave. Për të shmangur efektin negative dhe për t'u rezistuar pyetjeve të pakëndshme, viktima duhet të ketë mbrojtje profesionale, që më parë duhet të përgaditet për seanca gjyqësore, ku mund të parashtrohen pyetje sfiduese etj.[1153]

Gjatë procedures penale vëmendje duhet të ketë ndaj viktimës po edhe ndaj dëshmitarit për moszbulimin publikut si dhe trafikantëve personazhet e viktimës dhe dëshmitarit, dhe për këto vepra penale sencat janë të mbyllura, me pseudonime, dhe veçmas ndëgjoihet dëshmitari pa prenzencën e pandehurit nëse kërkon nevoja njejt veprohet edhe me viktimën. Në rastë se ekziston rreziku që dëshimtarët të kërcënohen, kanosen dhe të hakmirren nga ana e trafikantëve atëherë ata duhet të sigurohen me ligj përmes masave të parapara me ligj për mbrojtjen e tyre, në pjesën e llojeve të masave për mbrojtje. Mbrojtja e dëshmitarëve mund të ofrohet para, gjatë dhe/ose pas përfundimit të procedurave penale dhe mund të përfshijë një ose më shumë masa të parashikuara nga Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve.[1154]

2.4. Mbrojtja dhe ndihma viktimave në organet shtetërore

Policia gjegjësisht nëpunësit policor të cilët në hapin e parë të mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave marrin në pyetje viktimën dhe pas asaj ata duhet që ti udhëzojnë se cilat janë organet ku ata duhet të drejtohen për mbrojtje dhe sigurimin e të drejtave që u takon me ligj. Të informojë viktimën mbi të drejtat e saj në këtë fazë, të njoftojë atë me shërbimet që mund t'i gëzojë, ta udhëzojë se cilave organe dhe institucione mund t'u drejtohet për inicimin e procedurës gjyqësore që duhet të pasojë, për ndihmat që mund t'i përfitojë si viktimë, për procedurat e kompensimit të demit.[1155] Autoritetet e zbatimit të ligjit (d.m.th. prokurorët e gjykatësit) duhet të sigurohen që fëmijët viktima nuk janë subjekte procedurash penale ose sanksionesh për shkelje që kanë të bëjnë

[1149] Закон за заштита на деца. (Консолидиран текст), 2018, neni 2, paragrafi 2

[1150] Закон за правда за децата, Службен весник на Република Македониј број.148 од 29.10.2013 година, neni 145, paragrafi 5

[1151] Po aty

[1152] Закон за бесплатна правна помош („Службен весник на Република Македонија" бр.161/09 и 185/11), neni 17, paragrafi 1

[1153] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.143

[1154] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.10

[1155] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.141

me situatën e tyre si persona të trafikuar ose që fëmijët viktima të mbahen në ruajtje për arsye që lidhen me gjendjen e tyre si viktima[1156] sepse mos të ishin viktima as që do i kryejshin ato shkelje, situatë e cila vlen edhe për të rriturit viktima. Pra, organet shtetërore sidomos gjykata, prokuroria dhe policia sipas ligjeve të vendit kanë për detyrë të informojnë viktimat për drejtat dhe detyrat që u takojnë gjatë thirjes në çdo organ shtetëror të informohen sakt dhe në kohë për drejtat dhe detyrat që u takojnë për të siguruar drejtësinë që u takon me ligj dhe me akte ndërkombëtare.

Viktima ka të drejtë të jetë i informuar për drejtat në procedurën para penale, penale dhe pas seancës kryesore për gjendjen në të cilin gjindet dhe drejtat gjatë tërë procesit (e drejta në përkthyes nëse është shtetas i huaj, e drejta në periudhë të vendimmarjes, leja për qëndrim të përkohshëm).[1157] Rrallë ka (ose aspak nuk ka) përkthyes të disponueshëm në stacionet policore, kështuqë dhënat e aplikantit zakonisht përmban vetëm informacione biografike themelore, dhe jo informacione të tjera të rëndësishme për statusin e refugjatit ose mbrojtje të veçantë.[1158] Kushtet për dhënien e lejes për qëndrim rregullohen në nenin 82 të Ligjit për të huajt, me ç'rast vërtetohet si vijon:
Pas skadimit të periudhës së vendimmarrjes ose paraprakisht përderisa organet kompetente shtetërore vlerësojnë se i huaji tregon qëllim të qartë për bashkëpunim, të huajit i cili është viktimë e tregtisë me njerëz mund t'i jepet leje për qëndrim të përkohshëm në qoftë se:

- qëndrimi i tij në Republikën e Maqedonisë është i nevojshëm për realizimin e procedurës gjyqësore,
- tregon qëllim të qartë për bashkëpunim me organet kompetente shtetëror në zbulimin e veprave penale dhe të kryerësve të tyre dhe
- i ka të ndërprera marrëdhëniet me personat me të për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se janë përfshirë në kryerjen e veprës penale tregtia me njerëz. Leja për qëndrimin e përkohshëm do të jepet në periudhë prej gjashtë muajsh dhe e njëjta do të vazhdohet, po qe se plotësohen kushtet.[1159]

Këto detyrime kanë të bëjnë me informacionet për fillimin e hetimeve, fazën apo stadin e parë të procedurës, për veprimet e ndërmarra nga policia, prokuroria apo gjykata lidhur me filllimin e çështjes penale, si, p.sh:
- njoftime për arrestimin e viktimizuesit,
- për ngritjen e aktakuzës,[1160]
- për datat dhe orarin e mbajtjes së seancave gjyqësore,
- për provat që duhet deponuar,
- për rastet e lirimit nga paraburgimi të kryerësit apo viktimizuesit,
- për rastet e heqjes dorë të prokurorit nga akuzimi,
- për rastet e arratisjes së kryerësit,
- për rastet e shqiptimit të dënimit apo lirimit me kusht të kryerësit dhe për çështje të tjera.[1161]

Viktima mund të jetë dhe është një faktor domethënës në ushtrimin e funksionit gjyqësor: gatishmëria e viktimës për të paraqitur dhe për të njoftuar për vuajtjet e tij/saj është shumë e

[1156] Udhërrefyes. "Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë".Tiranë, 2007, fq.60
[1157] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. "Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе". Скопје, 2014, fq.19
[1158] Анализа. "Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен". Скопје, 2017, fq.5
[1159] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.223
[1160] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.150
[1161] Po aty

pabarabartë dhe ndikon ndjeshëm në veprimet e instancave të kontrollit shoqëror.[1162] Mbrojtja dhe ndihma e viktimave që kanë pësuar nga vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore para organeve shtetërore sidomos para organit i cili ka për qëllim ruajten e qetësisë dhe rendit publik, pra, të Ministrisë si punëve të brendshme ka një peshë më të veçantë në një anë si organ i parë me të cilën ballafaqohet viktima dhe në anën tjetër shpesh paraqitja e viktimave me paragjykime, mosbesim dhe frikë nga nëpunësit policor dhe kontakti i viktimës me policinë është i llojit të veçantë kontakti mes tyre. Po ashtu, kur konsiderohet se ballafaqimi me kryerësin apo viktimizuesin do të ndikojë që ajo të riviktimizohet, apo të pësojë strese, trauma e shqetësime të rënda, asaj duhet t'i mundësohet të deponojë deklaratën me videoinçizime dhe në distancë, pa kontakt të drejtëpërdrejtë me viktimizuesin e vet.[1163] Nga ky kontakt do të varen shumë rrjedha e procedurës lidhur me mbrojtjen e viktimave dhe kompensimin e tyre, por edhe lidhur me një punë më efikase për parandalimin e krimit dhe viktimizimit në shoqëri.[1164]

2.5. Mbrojtja dhe ndihma viktimave nga dhuna në familje

Dhuna familjare vazhdon të jetë një nga veprat penale më së paku të paraqitura.[1165] Mbrojtja dhe ndihma viktimave nga dhuna në familje ka një rëndësi të veçantë dhe në shoqërin bashkëkohore u jepet një kujdes të veçantë viktimave të dhunës në familje, sidomos femrave dhe grave të keqtrajtuara dhe të abuzuara të cilët në mënyrë permanente janë të rrezikuara nga kjo lloj i dhunës. Me dhunë në familje nënkuptohet malltretimin, fyerjen, rrezikimin e sigurisë, dëmtimin e trupitor, gjinor ose dhunë tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënim ose frikë, përfshirë edhe kërcënime për veprimeve të tilla, ndaj një bashkëshorti, prindërve ose fëmijëve ose persona të tjerë që jetojnë në bashkësi martesore ose bashkësi jashtëmartesore ose në një shtëpi të përbashkët, si dhe ndaj bashkëshortit aktual ose ish-bashkëshortit, partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë një fëmijë të përbashkët ose janë në një lidhje të ngushtë personale, pavarësisht nëse kryesi ka apo nuk ka ndarë të njëjtën qëndrim me viktimën apo jo.[1166] Kështu, kryerësve dhe viktimizuesve u ndalohet kontakti fizik, kontakti me telefon, qasja në hapësirë, lokale, vendbanim, shtëpi, vende të punës apo territor në distana dhe parametra të caktuara.[1167] Kryerësit shpesh i shqetësojnë viktimat e tyre me kërcënime, telefonata, kanosje direkte apo indirekte duke i shqetësuar viktimat në masë të madhe dhe duke formuar tek ato frigë nga ndonjë vepër penale ndaj tyre edhe nga vet prindërit dhe anëtarët tjerë të familjes.

Viteve të fundit është në rritje llojet e dhunës në familje sidomos dhuna ndaj femrave dhe grave, dhuna ndaj fëmijëve, dhuna ndaj të moshuarve etj. Prandaj, nga kjo që u cek më lartë gjykata duhet të shqiptoj edhe masa preventive me të cilat kryerësi i veprës penale në rastin konkret trafikantët që të jenë largë palës së dëmtuar, pra të viktimës por edhe familjarëve dhe të afërme të tyre. Gjykata kryerësit duhet ti ndalojë kërcënimet dhe paraqitjen e frigës nga dhuna viktimës, familjarëve të viktimës, duke ndaluar kontaktin ose komunikimin si dhe lëvizjen afër vendbanimit ku jeton viktima ose anëtarët tjerë të familjes. Si në shumë shtete poashtu edhe në shtetin tonë,

---

[1162] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.264

[1163] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.142

[1164] Po aty, fq.139

[1165] Информативна Брошура за жени-жртви на семејно насилство " Можности за економско зајакнување на жените-жртви на семејно насилство". Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија, Скопје, 2010, fq.10

[1166] Закон за превенција, спречување и заштита од семејното насилство, Службен весник на РМ, бр. 138 од 17.09.2014 година, neni 3

[1167] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.143

dhuna në familje është i rregulluar me ligj të veçantë, pra me Ligjin për dhunë në familje e cila ka për qëllim luftimin e veprës penale të dhunës në familje. Ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes që janë viktimë e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara[1168] sidomos kur viktimat kthehen në familjet e tyre. Në këtë drejtim për luftimin dhe parandalimin e dhunës në familje institucinet shtetërore së bashku me organizatat joqeveritare duhet të jenë sa më afër këtyre viktimave dhe zbulimin e më hershëm të tyre do të ishte në favor të viktimës sepse kjo vepër penale shumë rrallë paraqiten nga ana e viktimave. Ministria e punës dhe politikës sociale, Ministria e punëve të brendshme, Ministria e shëndetësisë, Ministria e arsimit dhe shkencës, Ministria e drejtësisë, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet që kryejnë veprimtari nga fusha e mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve, punët e brendshme, shëndetësia, punësimi dhe arsimi, marrin masa për të mbrojtur viktimën dhe parandalimin e dhunës, realizojnë bashkëpunim dhe koordinim reciprok.[1169]

2.6. Mbrojtja dhe ndihma në integrimin e viktimave të trafikimit

Mbrojtja dhe ndihma në integrimin apo riintegrimin e viktimave të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore si fazë e fundit që u aplikohet viktimave llogaritet si çështje me rëndësi të veçantë dhe me vlerë të posaçme për shkak se në këtë fazë viktima duhet në mënyrë permanente të kthehet jetës normale me dinjitet dhe në mënyrë të sigurt dhe që të ketë të drejta të barabarta me personat tjerë. Ri-integrimi i viktimave është ribashkimi me familjen, bashkësisë ose integrimin e tyre në një bashkësi të re.[1170] Rehabilitimi dhe përgatitja për reintegrim në mjedisin jetësor do të bëhet në qendrën e pranimit, nëpërmjet të dhënies së mbështetjes psiko-sociale dhe trajnimit të aftësive shoqërore për reintegrimin e fëmijëve viktima trafikimi[1171]. (Ri) integrimi, nënkupton paketë masash dedikuar në kthimin e të drejtave të viktimës, statusin social dhe shëndetin, për t'i ndihmuar asaj të kthej prap kapacitetet të rëndësisë vitale cilët kanë qenë të lënduar ose kufizuar si rezultat i një ose shkaqeve të tjera.[1172] Rehabilitimi, nënkupton sigurimin e paket masave për rehabilitimin e shëndetit fizik dhe psiqik të të mbijetuarit (viktimës).[1173] Pra, qartë shihet se nevoja e rehabilitimit sidomos të riintegrimit të viktimave është i rëndësisë së veçantë përshkak se mos arritja e riintegrimit të tyre ata gjithmon do të jenë në shënjestër të viktimizimit sekondar e me radhë të traikantëve dhe të grupeve kriminale të krimit të organizuar. Kështu, ndihma për riintegrim të viktimës së trafikimit me qenie njerëzore mund të përfshijë një sërë shërbimesh, siç është ndihma gjatë strehimit në strehimore ose lloj tjetër të strehimit, kujdes shëndetësor dhe psikiatrik, këshilla sociale dhe juridike, kthim në shkollë dhe trajnim profesional[1174] e cila do të mundësoj viktimës të kthehet jetës normale si çdo qytetar tjetër. Ndërsa ndihma e ofruar secilit viktimë varet

[1168] Po aty, fq.147

[1169] Закон за превенција, спречување и заштита од семејното насилство, Службен весник на РМ, бр. 138 од 17.09.2014 година, neni 5, paragrafi 1

[1170] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.10

[1171] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.62

[1172] Упатства за рехабилитација и реинтеграција на жртви од трговија со луѓе -Прирачник за земјите од Западен Балкан, Скопје 2015 , fq.12

[1173] Упатства за рехабилитација и реинтеграција на жртви од трговија со луѓе -Прирачник за земјите од Западен Балкан, Скопје 2015 , fq.12

[1174] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.84

individualisht nga nevojat e tyre individuale, ndihma e përshkruar më poshtë adreson kryesisht atë që është në interesin më të mirë të viktimave të trafikimit:

- Shërbime të kujdesit mjekësor/shëndetësor,
- Këshillim,
- Ndihma financiare,
- Ndihma juridike,
- Kthimi në sistemin arsimor,
- Trajnim professional,
- Aktivitetet për biznese të vogla dhe realizimi i profitit,
- Punësimi, subvencione për paga, programe stazhiere,
- Strehimi dhe akomodimi[1175]

Pra, nga kjo që u cek më lartë del se organet shtetërore dhe organizatat joqeveritare nacionale dhe ndërkombëtare që janë përgjegjës për procesin e rrintegrimit të viktimave në planet e tyre i kanë të përfshira të gjitha fushat e përmirësimit të sjelljeve dhe përfitimin e gjitha ndihmave që do të ishte në favorin e tyre. Në praktikë shpesh ndodh që anëtarët tjerë të familjes sidomos njerëzit që jetojnë në vendbanim të njejtë dhe që e njohin viktimën e pranojnë me një rezervë dhe paragjykime duke e njollosur si individ delikuent dhe nuk gëzon mbështetjen morale nga ato gjë që e ngadalëson dhe pengon riintegrimin e viktimës. Situata të tilla për viktimën ndikon shumë negativë për te dhe kështu mund të ndikojë prap që viktima të jetë në shënjestër të trafikantëve dhe të riviktimizohet prap. Kështu që, shteti dhe organizatat joqeveritare që merren më integrimin e viktimave duhet të krijojnë plane afatgjate të integrimit të tyre e cila kërkon kohë dhe mund më të madh. Faktorët ndikues për një riintegrim të suksesshëm, sipas ofruesve të shërbimit përfshijnë mjedisin familjar dhe komunitetin, bashkëpunimin mes institucioneve për ofrimin e shërbimeve reintegruese, trajtimi i rasteve të vështira, përputhshmëria e shërbimeve të ofruara me nevojat e viktimave, informimi për shërbimet, qëndrueshmëria në financimin e strehëzave, arsimi, formimi profesional dhe punësimi i viktimave, këshillimi psikosocial, ndihma financiare, shërbimet shëndetësore, mbrojtja ligjore.[1176] Në përgjithësi, integrimi dhe rehabilitimi afatgjatë, duke përfshirë mundësitë e edukimit të vazhdueshëm dhe të unësimit për viktimat e trafikimit[1177] do të tejkalonte riviktimizimin e tyre. Kështu, në identifikimin e personave të trafikuar kryesisht është e nevojshme dhënia e mbrojtjes së të drejtave të viktimës në mënyrë që të sigurohet riintegrimi i suksesëshëm.[1178] Planet e reintegrimit duhet të bëhen vetëm në vendet ku pranohen viktimat, dhe asnjëherë në vendet nga të cilat udhëzohen, sepse organizatat në ato vende nuk janë në pozitë të kryejnë një vlerësim adekuat të situatës në vendin ku udhëzohet viktima.[1179] Shpesh në shtetet ku kthehen viktimat për periudhën e integrimit u ndihmohet përmes granteve integrimi i tyre. Granti i riintegrimit ka për qëllim të lehtësojë riintegrimin e suksesshëm dhe dinjitoz në shoqëri dhe të mbulojë shpenzimet themelore siç janë akomodimi, ushqimi, veshmbathja dhe gjësende tjera të mevojshme, sa për fillim, zakonisht për periudhë prej 30 deri 90 ditë pas kthimit.[1180] Këshillimi dhe mbështetja për punësim i viktimave të trafikimit janë ndër faktorët më të rëndësishëm në

[1175] Po aty, fq.92

[1176] Raport. "Mekanizmat kundër dhunës dhe trafikimit". Tiranë, 2015, fq.50

[1177] Analizë. "Lufta kundër trafikimit me njerëz", Kërkesat e BE-së për Kosovën, Kipred, Prishtinë, Nr.2/15, 2015, fq.16

[1178] Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012, fq.19

[1179] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.86

[1180] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.99

procesin e riintegrimit, që mundësojnë pavarësinë ekonomike[1181]. Organizata që pranon viktimën duhet të bëjë çdo përpjekje dhe të ndërmarrë hapa për të siguruar që viktima të mos bëhet e varur gjatë zbatimit të planit të riintegrimit, dhe të ndihmojë viktimën që të normalizojë jetën e tyre dhe ta kthen vetëbesimin.[1182]

2.7. Mbrojtja dhe ndihma viktimave të trafikimit për kompensim dhe dëmshpërblim të dëmit

Duke ditur se shpesh viktimat e trafikimit me qenie njerëzore janë të ekspozuar ndaj shkeljeve serioze të të drejtave elementare të tyre si qytetar dhe përveç traumave të rënda fizike dhe psikologjike, mund të pësojnë edhe humbje ekonomike për shkak të krimeve të kryera kundër viktimave siç janë humbjes së pagave ose pronës. Kompensimi për viktimën është absolutisht i nevojshëm.[1183] Nga kjo rezulton se kompensimi i dëmit të shkaktuar viktimës gjegjësisht bashkësisë është shumë më i rëndësishëm se sa dënimi i kryesit.[1184] Me kompensim, dëmshpërblim apo zhdëmtim të viktimave nënkuptohen veprimet ligjore të organeve të ndryshme me qëllim që personit apo familjes së atij që ka pësuar dëme materiale, dëme pasurore, dëm moral dhe frikë e dhimbje, t'i kompensohet ajo në masë dhe kohë të përshtatshme.[1185] Kompensimi është një institut që rregullohet me dispozitat materiale të ligjeve që rregullojnë marrëdhëniet detyrimore dhe legjislacionin penal, ndërsa mënyra e realizimit të tij është subjekt i rregullimit të dispozitave procedurale të procesit gjyqësor dhe procedurës penale.[1186]

Në Republikën e Maqedonisë po edhe në vendet e rajonit shumë pak janë rastet kur viktimat kanë fituar dëmshpërblim nga trafikantët ose nga ana shteti e cila u garantohet me ligjet nacionale po edhe me aktet ndërkombëtare për këtë çështje. Çështja e kompensimit të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Republikën e Maqedonisë është një çështje që është relativisht e kohëve të fundit dhe aktualizimi i saj është kryesisht për shkak të përpjekjeve të ndërmarra nga Porta e Hapur - Lastrada Maqedonia për qasje më të lehtë dhe realizim të kësaj të drejte në vendin tonë.[1187] Sidoqoftë, këto ligje kërkojnë që viktimat të kërkojnë dëmshpërblim ndaras nga procedura penale kundër trafikantëve; as shteti dhe as organizatat joqeveritare nuk ofrojnë mbështetje për viktimat në mënyrë që të marrin kompensim[1188], pra dëmshpërblimi duhet të bëhet me padi civile veçmas nga procedura penale paraprake dhe gjitha shpenzimet dhe gjitha pagesat për shpenzime gjyqsore duhet paguar nga vet viktima. Kërkesa pronësoro-juridike fillon me ngritjen e padisë për kompensim, në gjykatën kompetente në procedurë civile ose me propozim për kërkesë në procedurë penale. Shumë vende duket se kanë procedura jofunksionale dhe shumë komplekse për të kërkuar dëmshpërblim, nuk ofrojnë ndihmë juridike për viktimat për të kërkuar dëmshpërblim, dhe në disa raste, autoritetet dekurajojnë në mënyrë aktive viktimat nga kërkimi i dëmshpërblimit.[1189]

[1181] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.35

[1182] IOM. "Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе", Скопје, fq.90

[1183] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.264

[1184] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.102

[1185] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.15

[1186] Анализа. "Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.6

[1187] Анализа. "Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.4

[1188] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.60

[1189] Po aty

Në emër të kompensimit të dëmit i dëmtuari mund të kërkojë kompensim si të dëmit material (dëm real – *damnum* emergens), fitimin e humbur (*lucrum cesans*) e po ashtu edhe kompensimin e dëmit moral i cili ka të bëjë me lëndimin e ndonjë të mire personale, nderit, prestigjit, përjetimit të dhembjes fizike ose shpirtërore etj.[1190] Vendimet e dëmshpërblimit mund të miratohen duke marrë parasysh dëmtimin individual; humbjet nga vjedhja, dëmtimi ose dëmtimi i pronës, humbja nga mashtrimi, humbjet financiare për shkak të mungesës nga puna, humbjet për shkak të shpenzimeve mjekësore, shpenzimet e udhëtimit, dhimbja dhe vuajtja e pësuar.[1191] Në përgjithësi viktimat, kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmet materiale dhe jo materiale, dhe nëse autori i krimit nuk mund të paguajë atëherë ky obligim i takon shtetit konkret.

Kompensimi dhe dëmshpërblimi i takon me ligj viktimave e cila do të jetë e nevojshme për rrintegrim dhe rimëkëmbje pas periudhës së rëndë që ka kaluar tek duart e trafikantëve. Neni 53, paragrafi 3, pika 2 i Ligjit për procedurë penale të Republikës së Maqedonisë në lidhje me kompensimin parashesh siç vijon: "kompensim të dëmit material dhe jomaterial nga fondi shtetëror në kushte dhe mënyrë të përcaktuar me ligj të veçantë, nëse kompensimi i dëmit nuk mund të sigurohet nga i dënuari."[1192] Kompensimi përfshin kompensimin e urdhëruar nga gjykata për autorët e veprës (mbështetur në dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale), dëmshpërblimet e urdhëruara me anë të procedurave civile dhe kompensimit shtetëror.[1193] Këtu vlen të ceket se ka raste kur edhe shteti jep kompensim shtesë sepse nuk kompensimi i marur nga kryrësi i veprës (pandehuri) nuk është i mjaftueshëm. Pra, pamundësia e pagesës së dëmshpërblimit dhe komepnsimit nga kryerësi i veprës penale ndaj viktimës për shkaqe të ndryshme, atëherë rrugëdalja e vetme nga kjo situatë është pagesa nga ana e shtetit, gjegjësisht nga Ministria e drejtësisë. "Për viktimat e rritur të trafikimit, kompensimi nga shteti do të shtyhet deri në momentin e miratimit të Ligjit për fondin shtetëror. Me miratimin e këtij ligji, Republika e Maqedonisë do të prezantojë për herë të parë një fond të tillë për kompensimin e viktimave të krimit, i cili më tej mund të komplikojë dhe vonojë krijimin e tij."[1194]

Palët në procedurë penale mund të mos pajtohen me aktgjykimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, kështu që palët mund të përdorin mjetet juridike që janë veprime procedurale përmes të cilëve e atakojnë vendimin e shkallës së parë duke kërkuar që procedura të zhvillohet në shkallë të dytë. *"Për veprat penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe të kontrabandës me migrantë Gjykata e Apelit duhet të vendos objektivisht në lidhje me ankesën nëse i është bërë ku shpesh në praktikë vërtetohet vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Ankesa e të pandehurit A.A. nga Shkupi përmes mbrojtësit D.K.J. advokat nga Shkupi,* ***Hedhet poshtë si e pabazë****. Aktgjykimi i Gjykatës themelore Shkup 1 Shkup KOK.BR.55/12 të vitit 19.09.2012,* ***Vërtetohet****."*[1195] Pra, qartë shihet se në procedurë si mjet juridik e drejta e ankesës në shkallë më të lartë lejohet dhe palët mund të përdorin. Procedura sipas mjeteve juridike është në lidhje të drejtëpërdrejtë me parimin shumëshkallësh, i cili mundëson që për një çështje penale të vendosin disa gjykata në shumë shkallë.[1196] Viktima, si palë e dëmtuar, apo si palë që ka parashtruar kërkesën për zhdëmtim apo

[1190] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.167

[1191] Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. "Оксфордски прирачник за Криминологија". Скопје, 2010, fq.479

[1192] Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150 од 18.11.2010 година, neni 53, paragrafi 3, pika 2

[1193] Raport. "Përputhshmëria e Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore".Greta, 2016, fq.33

[1194] Анализа. "Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.4

[1195] Aktgjykim nr.70 të datës 13.12.2012 të Gjykatës së Apelit Shkup, fq.1

[1196] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.228

kompensim, nëse është e pakënaqur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka të drejtë të bëjë ankesë në gjykatën më të lartë.[1197]

"Lidhur me këtë çështje, thuhet se në Republikën e Maqedonisë ka raste në të cilat është dhënë kompensim dhe se kap vlerën 400,000 denarë ose afërsisht 7,000 EUR. Por, edhepse kompensimi i është caktuar, ata nuk mund të realizohen sepse kryerësi nuk ka pasur pronë."[1198] Gjatë vitit 2013 janë miratuar 4 aktgjykime përfundimtare, 3 në shkallë të dytë dhe 1 në shkallë të parë, janë fituar dëmshpërblime për 4 viktima / dëmtuar në shumë prej 400,000 denarë për secilën viktimë.[1199] Ekspertët u bëjnë thirrje autoriteteve maqedonase të krijojnë një fond shtetëror të kompensimit, veçanërisht duke marrë parasysh që në asnjë rast të kompensimit të dhënë viktimave nuk janë kompensuar.[1200] Arsyet për këtë problem janë të shumta dhe mund të përmblidhen se ato përfshijnë probleme me kornizën themelore ligjore; mungesa e identifikimit proaktiv në vendet ku ekziston mundësia e zbulimit të viktimave; mungesa e përfshirjes së të gjithë sektorëve të nevojshëm; mungesa e aftësive tek aktorët kryesorë, shpesh keqësohet përshkak të qarkullimit të lartë të stafit; dhe në disa vende, ka mungesë të angazhimit politik.[1201]

Situata të tilla sipas Portës së Hapur - La Strada Maqedonia në lidhje me realizimin e kësaj të drejte kushtëzohen nga disa faktorë, siç janë: çështja e kompensimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore nuk paraqet një element kyç për mbështetje dhe ndihmë të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, e as paraqet një element kyç i politikave dhe masave të trafikimit me qenie njerëzore, mosnjohja e viktimave për mundësinë e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim; disa dispozita ligjore (materiale dhe procedurale) që e vështirësojnë shpërblimin e dëmeve në procedurat gjyqësore, pamundësia për të ekzekutuar kompensimet e dhëna kryesisht është në pjesën e marrëdhënieve të parregulluara të pronës, pra mosekzistencës së pasurisë në emër të të pandehurit, ose pasurive të parealizuara në emër të të pandehurit, posedimi i ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, të cilat nuk janë të regjistruara në librat e përshtatshme kadastrale, mungesa e mundësisë për kompensim nga shteti për viktimat e rritur të trafikimit me qenie njerëzore; mos pasja e mekanizmave për kompensimin nga ana e shtetit, etj.[1202]

2.8. Mbrojtja dhe ndihma viktimave sipas parimit të mosdënimit

Trafikantët shpesh i detyrojnë viktimat të kryejnë vepra kriminale dhe i ekspozojnë ata në rrezik nga kriminalizimi, me qëllim që t'i frikësojnë ata të bashkëpunojnë me organet e ndjekjes dhe organet e gjyqësis, duke shmangur kështu përgjegjësinë e vet.[1203] Grupet e krimit të organizuar gjegjësisht vet trafikantët në kuadër të abuzimeve dhe detyrimeve ndaj viktimave ekziston edhe kryerja e veprave penale e cila është në favor të trafikantëve siç është vjedhjet, shitja e substancave narkotike, mashtrime, shantazhet si dhe shumë vepra penale, me qëllim që ti shtyjnë viktimat të ndiqen penalisht nga organet kompetente siç është policia, gjyqësia dhe prokuroria kështu që ata përfitojnë statusin si shkelës të ligjit dhe rëndë është të zbulohen se janë viktima të trafikimit me

[1197] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.143

[1198] Анализа. "Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.10

[1199] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.9

[1200] Анализа. "Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.11

[1201] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.71

[1202] Анализа. "Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.12

[1203] Анализа. "Примената на начелото на неказнување на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.4

qenie njerëzore gjë që e rëndon edhe më shumë situatën e identifikimit, mosdënimit dhe dëshmisë së tyre kundrejt traikantëve. Një numër i vogël marrin ndihmë dhe mbrojtje si viktima të trafikimit me qenie njerëzore, shumë shpesh ata arrestohen ose privohen nga liria për shkaqe të ndryshme, u shqiptohen dënime dhe masa të tjera për vepra penale ose akte të tjera kriminale që kryejnë si rezultat pse janë të trafikuar, për shembull, për mosrrespektimin e rregullave të migracionit, hyrjen dhe qëndrimin e paligjshëm, përdorimin e dokumentit të udhëtimit të rremë, dhënien e deklaratave të rreme, mashtrimit, nxitjes dhe kryerjes së prostitucionit, prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve dehëse, rritjen e kanabisit ose kryerjen e akteve të tjera të kundërligjshme.[1204] Për këto arsye të lartëpërmendura e drejta ndërkombëtare kërkon nga shtetet që të njohin dhe praktikojnë në vendet e tyre parimin e mosdënimit për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore që kanë kryer vepra penale derisa kanë qenë nën shtypjen dhe kontrollin e trafikantëve dhe tu jepet mbeshtetje, mbrojtje dhe ndihmë që u takon si viktima.

Parimi i mosdënimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore që kanë kryer vepra penale si viktima nënkupton që personat e identifikuar si viktima të trafikimit me qenie njerëzore që mos të ndiqen penalisht, të mos arrestohen dhe të mos dënohen përshkak se viktimat nuk e kanë kryer veprën penale me dëshirën e tyre por si shkak i shtypjes, detyrimit dhe shfrytëzimit të trafikantëve dhe të grupit të krimit të organizuar për kryerjen e veprimeve të ndryshme kriminale. Në anën tjetër në rast se ndaj viktimave veç më ka filluar ndonjë procedurë për ndjekje ose është arrestuar ose dënuar ajo procedurë duhet të ndalohet dhe viktima të lirohet sipas parimit të mosdënimit. Viktimat kur arijnë në destinacionin e duhur trafikantët dhe grupet e krimit të organizuar sidomos gjatë abuzimit dhe shfrytëzimit të tyre për qëllime të caktuara ata, pra viktimat kryejnë ose janë të detyruar të kryejnë vepra të kundërligjshme. Në raste të kryerjes së veprave penale të detyruara nga trafikantët viktimat nuk duhet të shihen si kryerës të veprave penale dhe ndaj tyre nga ana e organeve shtetërore mos të jepen gjoba, dënime dhe sanksione penale gjë që është kundër parimit themelor të së drejtës penale pra, parimi i mosdënimit të viktimave. Duke pasur parasysh se viktimat e trafikimit me qenie njerëzore vuajnë pasoja të rënda nga shfrytëzimi që kryhet ndaj tyre, si në bazë psiqike ashtu edhe fizike, arrestimi i tyre, dënimi dhe realizimi i procedurës penale për veprat për të cilat kanë qenë të detyruar të kryejn, çon në rishfaqjen domethënë viktimizimin sekondar dhe mosrespektimin e të drejtave themelore të njeriut.[1205] Shumë viktima të trafikimit me qenie njerëzore nuk paraqesin se janë viktima dhe këta persona janë persona të panjohura si viktimë dhe e rrisin numrin e errët në organet kompetente shtetërore, pra viktimat i llogarisin si kriminel. Këta janë ata që krijojnë një pjesë të "numrave të errët" të krimit, disa viktima nuk e raportojnë atë për një sërë arsyesh, veçanërisht në rastet kur ajo vetë është shantazhuar për ndonjë lëshim të vërtetë ose të imagjinuar ose nuk dëshiron ta ekspozojë veten para publikut[1206], kjo shpesh ndodh tek trafikimi me qenie njerëzore me qëllim të prostitucionit. Prandaj, shtetet duhet të jetë plotësisht të vetëdijshme për këto zhvillime për të mundësuar identifikimin e saktë të viktimës dhe hetimin e efektshëm të krimit të trafikimit, si dhe për të siguruar mbrojtje të efektshme të të drejtave të viktimës, përfshirë mosdënimin për ato shkelje të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata janë trafikuar.[1207] Me këtë parim do të ndikohet dhe do të inkurajohen viktimat që ma së shumë të paraqesin veprat penale sidomos të paraqiten si viktima të trafikimit me qenie njerëzore, e cila do të ndikoj edhe në uljen e numrit të errët të evidencave

[1204] Po aty

[1205] Po aty

[1206] Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama". Zagreb, 1985, fq.12

[1207] Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit, Tiranë, 2014, fq.7

statistikore të kësaj vepre penale e cila shpesh nga viktimat nuk paraqiten, për shkak të turpit, frikës, nga gjykimi i mjedisit ku jeton, kërcënimi paraprak i krerësve të veprës penale etj. Pra, nga e gjith kjo që u cek më lartë del se viktimat e veprës së trafikimit me qenie njerëzore nuk duhet të dënohen sipas parimit të mosdënimit për veprat penale që i ka kryer gjatë periudhës kohore derisa ka qenë viktimë nën kontrollin e trafikantëve dhe me detyrimin e tyre ka kryer vepra penale. Në shumë raste apo vepra penale qoft si kryerës ose si viktimë personat nuk janë të paraqitura, zbuluara, dënuara apo të identifikuara nga organet kompetente, gjë që e cila e rrit edhe numrin e errët e cila është e pranishme në pdo shtet ku më pak ku më shumë.

Pra, viktima shpeshherë e ka në dorë fatin e rasteve kriminale dhe të evidencave mbi krimin dhe, nëse ajo nuk i paraqet rastet në të cilat ka pësuar, evidencat janë të mangëta, nuk pasqyrojnë gjendjen reale të krimit dhe në këtë mënyrë rritet numri i errët i krimit.[1208] Nga ndikimi i faktorëve të ndryshëm shumë persona që janë viktimë e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore nuk e paraqesin në organet kompetente, kjo në literaturën kriminologjike njohet edhe si metoda mbi zbulimin e viktimave. Sipas kësaj metode, ose studimi mbi viktimat (*Study of Victims*) bëhet anketimi dhe intervistimi i personave të ndryshëm për faktin se a kanë qenë ndonjëherë viktimë e krimeve të caktuara dhe a i kanë paraqitur ato në organet e policisë apo në gjykata[1209], të dhëna të cilat mund të jenë edhe më shumë nga rastet e evidentuara. Në këto raste duhet të parashihet mundësia e mosdënimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për ate se ata kanë qenë të përfshirë në veprimtari të kundërligjshme deri në momentin që ata kanë qenë të detyruar të punojnë punë të kundërligjshme që ka qenë objekt i veprës kryesore penale të trafikimit me qenie njerëzore. Kjo nënkupton se viktimat mos të kishin qenë viktima të trafikimit veprat për të cilat dënohet as që do i kishte kryer nëse nuk do ishte viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, pra veprat penale të viktimave lidhen direkt me trafikantët dhe veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore sepse me dënimin e viktimave do të mohohet vepra penale e trafikimit dhe statusi i tyre si viktimë e trafikimit si dhe shkelje e dinjitetit dhe moralit të viktimës. Andaj identifikimi profesional, i saktë dhe në kohë të duhur e ka rëndësinë e veçantë që viktimat të shpëtojnë nga dënimi për veprat penale të kryera derisa kanë qenë viktima të trafikimit me qenie njerëzore. Identifikimi i hershëm ka edhe rolin preventiv dhe e parandalon dënimin dhe trajtimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore si persona të dyshuar.[1210] Shtetet e kanë për detyrim t'i ndihmojnë këta persona dhe të mos i trajtojnë si kriminelë.[1211] Detyrimi për të mos dënuar, mbështetur në të drejtën ndërkombëtare, duhet të zbatohet nga Shtetet në praktikën e tyre vendase. Në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë nuk ekziston dispozitë ligjore e cila e rregullon direkt çështjen e mosdënimit të viktimave kryerës të veprave penale, ose përjashtimin e përgjegjësisë penale të viktimave derisa kanë qenë nën kontrollin dhe detyrimet e trafikantëve ose grupit të krimit të organizuar, pra sipas parimit të mosdënimit. Penalisht është përgjegjës kryerësi i cili është i matur dhe që veprën penale e ka kryer me paramendim ose nga pakujdesia dhe gjatë kësaj ka qenë i vetëdijshëm ose ka qenë i detyruar dhe ka mundur të jetë i vetëdijshëm për ndalimin e veprës[1212], e parasheh neni 11,

[1208] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.139

[1209] Halili, Ragip. "Kriminologjia". Prishtinë, 2011, fq.59

[1210] Анализа. "Примената на начелото на неказнување на трговија со луѓе во Република Македонија". Скопје, 2014, fq.8

[1211] Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit, Tiranë, 2014, fq.13

[1212] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 11, paragrafi 1

paragrafi 1 i Kodit penal të vendit në pjesën e përgjegjësisë ku shihet se këtu kemi vërtetimin e shkallës apo nivelit të përgjegjësisë e jo direkt mosdënimin e personit.

PJESA E TRETË

MASAT PËR LUFTIMIN DHE PARANDALIMIN E TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE DHE ASPEKTI KRAHASIMOR NË DISA SHTETE

KAPITULLI I

TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE DHE SANKSIONIMI I SAJ SIPAS AKTEVE NDËRKOMBËTARE DHE LEGJISLACIONIT PENAL TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. Trafikimi me qenie njerëzore si figurë e veprës penale dhe masat që parashihen sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë

Tranzicioni, luftërat, kriza e thellë politike dhe ekonomike në rajon, si dhe shumë vite izolim dhe sanksioneve të vendosura nga bashkësia Ndërkombëtare, të cilat kanë rezultuar në rritje të varfërisë dhe papunësisë, kanë krijuar terren pjellor për një rritje të të gjitha formave të krimit dhe në paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore si forma më e rëndë e krimit.[1213] Lidhur me trafikimin me qenie njerëzore, janë dhënë definicione dhe konstatime nga autorë të ndryshëm, në mesin e tyre edhe autori ***V. Latifi*** ka konstatuar se, "trafikimi i qenieve njerëzore nënkupton vënien e një personi nën sundimin e paligjshëm dhe faktik të personave të tjerë me anë të dhunës, kërcënimit, shpërdorimit të autoritetit apo intrigues me qëllim të ushtrimit të prostitucionit, formave të shfrytëzimit seksual dhe përdhunimit të të miturve apo tregtimit të fëmijëve të braktisur. Këto forma përfshijnë edhe prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e materialeve pornografike me fëmijë."[1214] Edhe Republika e Maqedonisë si shumë shtete në botë në legjislacionin e saj penal gjegjësisht në Kodin Penal e ka të inkriminuar veprën trafikimin me qenie njerëzore si figurë e veprës penale.

Si pasojë e firmosjes së Konventës së KB kundër krimit të organizuar transnacional dhe dy protokoleve të saj nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, vepra Trafikimi me njerëz për herë të parë është e inkorporuar në sistemin gjyqësor ndëshkues maqedonas me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të kodit penal nga 25. 01.2002, Gazeta zyrtare e RM nr. 04/02[1215], dhe më pas në vitet e ardhshme ka pësuar ndryshime dhe plotësime, sidomos me ndryshimin dhe plotësimin nr.08-7559/1 të datës 28 dhjetor 2018 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë. Para se të studjojmë veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe sanksionimin e saj, para do të analizojmë veprën penale të skllavërisë përshkak të ngjajshmërive në mes të tyre.

Themelimi i marrëdhënies së skllavërisë dhe transportimi i personave në marrëdhënie të skllavërisë është titulli me të cilin fillon neni 418 i Kodit tonë penal dhe i cili ka të bëjë me kufizimet dhe transportin e personave që janë viktimë të veprës penale.

Neni 418 Themelimi i marrëdhënies së skllavërisë dhe transportimi i personave në marrëdhënie të skllavëriesë.

1. Ai i cili duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, do të vendos një tjetër në skllavëri ose në një marrëdhënie të ngjashme si ajo, ose e mban në marrëdhënie të tillë, e blen, e shet, e dorëzon personit tjetër, ose ndërmjetëson në blerjen, shitjen ose dorëzimin e personave të tillë, ose e nxit tjetrin të shesë lirinë e vet ose lirinë e personit të cilin e mban ose i cili kujdeset për të, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vite.

2.Ai i cili transporton persona cilët gjendet në skllavëri ose marrëdhënie të ngjashme nga një vend në tjetrin, do të dënohet me burg prej gjashtë muajve deri në pesë vite.

3.Ai i cili veprën nga paragrafët 1 dhe 2 do të kryej ndaj personit të mitur, do të dënohet me burg së paku pesë vite.[1216]

Në paragrafin 1 të këtij neni parashihet statusi i skllavërisë së viktimave të trafikimit e cila është kundër rregullave të së drejtës ndërkombëtare dhe më pas viktimat shiten, blehen ose dorëzohen personave të tretë duke e kufizuar lirinë dhe të drejtën elementare pra të lëvizjes së lirë të viktimës.

[1213] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.16

[1214] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, vep. e cit., fq.102

[1215] Informacion. "Tregtia me njerëz dhe migrimi ilegal në Maqedoni në vitin 2009". Shkup, 2010, fq.7

[1216] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418

Më tutje në paragrafet e radhës të këtij neni parashihet veprimi i transportit të viktimave dhe veprimi ndaj viktimës i cili është i mitur.

418-a Tregëtia me njerëz

1. Ai i cili me forcë, kanosje serioze e vë në lajthitje ose forma tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, me keqpërdorimin e pozitës së vet ose gjendjes së shtatzanisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore të tjetrit, dhënien ose marrjen e parave ose përfitimeve tjera për shkak të marrjes së pëlqimit të personit i cili ka kontroll të personit tjetër ose në mënyrë tjetër rekruton, transporton, transferon, blen, shet, strehon ose pranon persona për shkak të eksploatimit seksual, pornografisë, punës së detyrueshme, shtatzanisë së detyrueshme, adoptimit të paligjshëm ose veprimit të ngjajshëm me të, lypje ose eksploatim me qëllim të aktivitetit të ndaluar me ligj ose transplantimit të paligjshëm të pjesëve të trupit ë njeriut, do të dënohet me dënim me burg së paku katër vite.

2. Ai i cili merr ose shkatërron letërnjoftim, pasaportë ose dokument tjerër identifikues me qëllim për të kryer veprën nga paragrafi 1 të këtij neni, do të dënohet me burg së paku katër vite.

3. Ai i cili shfrytëzon ose mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale ose lloj tjetër të eksploatimit nga personat për të cilët ai dinte ose ka qenë i detyruar të dinë se është viktimë e trafikimit me qenie njerëzore, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vite.

4. Nëse vepra nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni është e kryen personi zyrtar në kryerjen e shërbimit, do të dënohet me burg së paku pesë vite.

5. Pëlqimi i viktimës së trafikimit për qëllim të shfrytëzimi i parashikuar në paragrafin 1 nuk është i rëndësishëm për ekzistencën e krimi nga paragrafi 1.

6. Nëse vepra nga ky nen e kryen personi juridik do të dënohet me dënim në të holla.

7. Nuk do të dënohet viktima e trafikimit me qenie njerëzore e cila ka qenë e detyruar të kryej vepër penale ose vepër tjetër të dënueshme derisa ka qenë viktimë, ndërsa e njëjta në mënyrë të drejtpërdrejt ndërlidhet me pozitën e saj si viktimë.

8. Patundshmërit e shfrytëzuar dhe mjetet e transportit të përdorura për kryerjen e veprës do të konfiskohen.[1217]

Nga ky inkriminim i veprës së trafikimit me qenie njerëzore shihet mjetet e përdorura nga trafikantët, mënyrat apo fazat e trafikimit dhe qëllimet e trafikimit të njerëzve. Por, në krahasim nga disa vende ku qëllimet janë të inkorporuar veç e veç në nene të veçanta (Republika e Kroacisë e ka të rregulluar me nen të veçantë, neni 107 me titull "Trafikimi i pjesëve të trupit të njeriut dhe embrioneve njerëzore" në kuadër të Kodi penal të saj), kurse në Maqedoni të gjithë qëllimet e trafikimit janë inkorporuar në kuadër të këtij neni ku definohet vepra e trafikimit me njerëz. Përveç përshkrimit të veprimtarisë kriminale, mjetet, mënyrat dhe qëllimet e trafikimit paragrafi i radhës parasheh dënim edhe për individët të cilët për qëllim të trafikimit me ose shkatëron dokumentet personale të identifikimit të viktimave sidomos të pasaportës sipas paragrafit 2. Gjithashtu në këtë nen, sidomos në paragrafin 3 parashihet shfrtëzimi seksual gjegjësisht dënohen individët që e shfrtëzojnë ose mundësojnë që tjetri të shfrtëzoj nga viktima shërbime seksuale ose shfrtëzim të llojit tjetër në të cilën ekziston vetëdija e viktimizimit të viktimave. Kodi penal e bën dallimin e personave trafikantë ose anëtarë tjerë të një grupi kriminel dhe personave zyrtar cilët mund të llogariten edhe si rrethanë më e rëndë gjatë krerjes së veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore

[1217] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418 a

sipas paragrafit 4. Në Kodin tonë penal për situatat kur mund të kemi pëlqim të viktimës për veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas paragrafit 1 parashihet në paragrafin 5 të saj dhe nuk mirret parasysh ose nuk është i rëndësishëm ekztistimi i veprës. Përveç personave fizik kryerës të trafikimit me qenie njerëzore Kodi parasheh edhe përgjegjësinë dhe dënimin e personave juridik në paragrafin 6 të të njejtin nen. Një hap i rëndësishëm drejt avancimit të masave kundër trafikimit është rregullimi ligjor i pozitës së viktimave sidomos viktima kryerës të krimeve e cila bazohet në parimin e mosdënimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore për periudhën derisa kanë qenë të detyruara të kryejnë vepra të kundërligjshme parashihet në paragrafin 7. Duke u bazuar në ate se gjatë krerjes së trafikimit, trafikantëve dhe grupeve kriminale më se e nevojshme janë mjetet që shfrytëzohen për trafikim e cila e lehtëson veprën Kodi penal parasheh konfiskimin e të njëjtëve nëse janë përdorur dhe shfrytëzuar në paragrafin 8 të nenit 418-a.

Njëkohësisht Kodi Penal i Maqedonisë me nen të veçantë e parasheh edhe kontrabandën me migrantë në pajtueshmëri me kërkesat ndërkombëtare për luftim dhe parandalim botëror. Rëndësia e shtjellimit ligjor të kësaj vepre penale në këtë punim është e nevojshme duke u bazuar në atë se viteve të fundit sidomos gjatë migracioneve ndërkombëtare ku numri i migrantëve është shumë i madh trafikantët, grupet e krimit të organizuar dhe kontrabanduesit duke shfrytëzuar cenueshmërinë e migrantëve arrijnë që ata ti kontrabandoj në vende të ndryshme e cila është shumë afër viktimizimit të migrantëve nga vepra e trafikimit me qenie njerëzore në vendet e synuara. Andaj nevoja analizës së veprës penale të kontrabandës me migrantë është e pashmangshme. *Ai i cili, me forcë ose me kërcënim serioz se do të sulmojë ndaj jetës ose trupit, me rrëmbim, mashtrim, nga lakmia, me keqpërdorim të pozitës së tij zyrtar ose me shfrytëzimin e pafuqisë së tjetrit ilegalisht bart migrantë përtej kufirit shtetëror , si dhe ai që bën, furnizon ose posedon dokumente të rrejshme udhëtimi me qëllim të tillë, do të dënohet me burg prej së paku katër vite.*[1218] Duke u bazuar në këtë paragraf edhe në praktik fatkeqësisht organet kompetente, pra gjykatat e vendit shpesh shqiptojnë dënime minimale për këtë vepër penale si p.sh.: *"Me veprimet e larta i akuzuari M. D. nga Tirana, R.Shqipërisë ka kryer vepër penale-Trafikim me migrantë nga n.418-b pr.2 nga KP, kështuqë në pajtim me këtë nen si dhe nenet 4, 32, 33, 35, 39 dhe n.47 nga KP dhe n.102 dhe 105 nga LPP, gjykata e dënoi me denim me burg në kohëzgjatje prej 1-një vjet"*.[1219] Në përgjithësi, migrantët mbeten më pak të mbrojtur sesa shtetasit e vendeve tranzite dhe vendeve të destinacionit.[1220]

Nëse veprat penale trafikimi me qenie njerëzore, kontrabanda me migrantë dhe trafikimi i personave të mitur kryhet nga grup ose organizatë kriminale dhe për organizimin dhe nxitjen për kryerje të atyre veprave Kodi penal me nen të veçant parasheh sanksionimin e tyre në nenin 418-v.

Neni 418-v Organizimi i grupit dhe nxitja për kryerjen e veprave të trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të të miturve dhe kontrabandës së migrantëve.

1. Ai i cili organizon grup, bandë ose shoqatë tjetër për kryerjen e veprave penale nga nenet 418-a, 418-b, 418-g dhe 418-d, do të dënohet me burg së paku tetë vite.

[1218] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/ , бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11, бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418 b, paragrafi 1

[1219] Aktgjykim nr.57 të datës 27.05.2015 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

[1220]https://www.ohchr.org/_layouts/15/WopiFrame.aspx?sourcedoc=/Documents/HRBodies/CMW/CommentsCMWonSDGsaheadHLPF2018.docx&action=default&DefaultItemOpen=1, të datës 08.09.2020, ora 9:52

2. Ai i cili do të bëhet pjesëtar i grupit, bandës ose shoqatës tjetër e parashikuar nga paragrafi 1 ose në mënyrë tjetër e ndihmon grupin, bandën ose shoqatën, do të dënohet me burg së paku një vit.
3. Pjesëtari i grupit nga paragrafi 1 i cili do të zbulojë grupin para se të kryej vepër penale në përbërjen e vet ose për të, do të lirohet nga dënimi.
4. Ai i cili thëret, nxit ose përkrah kryerjen e veprave penale nga nenet 418-a, 418-b, 418-g dhe 418-d, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vite.[1221]
Për funksionimin e grupës, bandës apo shoqatës patjetër duhet të ekzistojnë së paku 3 persona të cilët mund të jenë anëtarë ose në udhëheqësinë e grupit dhe ky anëtarësim është e kundërligjshme dhe e dënueshme me burg së paku 8 vite e paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni. Si rrethanë lehtësuese apo rrethanë e cila do të lirojë nga dënimi eventual janë rastet kur personi anëtar apo pjesëtari i grupit e zbulon grupin kriminel para kryerjes së veprës penale, kurse personat që bëjnë thirje apo nxitje për kryerjen e aktiviteteve kriminale do të dënohen sipas këtij Kodi do dënohet së paku 1 vit sipas paragrafit 2.

Pra, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore përveç personave të rritur ata shpesh janë edhe persona të mitur dhe fëmijë, kështuqë edhe Kodi penal i vendit e parasheh në nen të veçantë trafikimin e fëmijëve.

Neni 418-g Trafikimi me fëmijë

1. Ai i cili do të manipulojë fëmijë për kryerje të veprimeve seksuale ose do të mundësoj kryerje të veprimeve seksuale me fëmijë ose rekruton transporton, transferon, blen, shetë ose ofron për shitje, furnizon, siguron, strehon ose pranon fëmijë për qëllim të eksploatimit përmes shfrytëzimit të tij në aktivitete seksuale për kompensim monetar ose për kompensim tjetër ose forma të tjera të eksploatimit seksual, pornografi, punë të detyruar ose shërbim, robëri, lypje ose eksploatim për shkak të aktivitetit të ndaluar me ligj, skllavëri, martesa me detyrim, fertilizim me detyrim, adoptim të paligjshëm ose shtrëngim për pëlqim si ndërmjetësues të adoptoj fëmijë, transplantim i palejueshëm të pjesëve të trupit të njeriut, do të dënohet me burgim me më së paku tetë vjet.

2. Ai i cili veprën nga paragrafi 1, do të kryej me forcë, kërcënim serioz, duke vë në lajthim, ose forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, keqpërdorimit të pozitës ose gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë, paaftësisë fizike ose mendore të tjetrit, ose me dhënien ose pranimin e parave ose përfitime përshkak përfitimit të pëlqimit të personit i cili ka kontroll te personin tjetër ose vepra e kryer ndaj fëmiut i cili nuk ka mbush 14 vjet, do të dënohet me burg së paku dhjetë vite.
3. Ai i cili shfrytëzon ose mundëson tjetrit përdorimin e shërbimeve seksuale ose lloj tjetër të shfrytëzimit nga fëmiu, për të cilin ka ditur ose ka qenë i detyruar të dinë se personi është viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, do të dënohet me burg së paku tetë vite.
4. Shfrytëzuesi i shërbimeve seksuale prej fëmiut nën 14 vjeç do të dënohet me burg së paku 12 vite
5. Ai i cili do të merr ose shkatërron letërnjoftim, pasaportë, ose dokument tjetër identifikimi të huaj me qëllim të kryerjes së veprave nga paragrafët 1 dhe 2, do të dënohet me burg së paku katër vite.
6. Nëse vepra nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni e kryen persoi zyrtar gjatë kryerjes së shërbimit, do të dënohet me burg së paku dhjetë vite.

[1221] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/ , бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11, бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418 v

7. Pëlqimi i fëmisë me veprimtaritë e parapara në paragrafin 1, nuk është e rëndësis për ekzistimin e veprës penale, nga paragrafi 1.
8. Nëse vepra nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim në të holla.
9. Nuk do të dënohet fëmijë- viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore në rastet në të cilat ligji parashikon dënimin e fëmijës, kur kryesi i veprës penale e ka detyruar të kryej vepër penale, nëse veprimi i tillë i tij është pasojë e drejtpërdrejtë të pozicionit të tij të viktimës.[1222]
Pra, nga vet sasia e sanksionit të paraparë prej së paku tetë viteve tregon qartë rëndësinë e moshës si viktimë të trafikimit me persona të mitur e cila është edhe dyfish më lartë se tek viktimat e rritur. Paragrafi 2 parasheh kategorinë e viktimave fëmijë të cilët në momentin e viktimizimit të tyre nga trafikimi me persona të mitur nuk ka mbush moshën 14 vjet dhe llogaritet fëmijë. Dënimi i lartë është më se normale sepse vetdija, ndërgjegja, kuptimi i veprës dhe pasojat nga ajo tek kjo kategori është e kufizuar dhe keqpërdorimi i moshës së tyre do jetë me denim më të rëndë edhe se miturit e most ë flasim krahasimin me viktimat e rritur, për të cilë kodi parashe dënimin me burg së paku dhjetë vite. Kodi parasheh dënim edhe për shfrytëzuesit ose mundësimi tjerëve që nga fëmiu të shfrytëzojnë shërbime seksuale ose shfrytëzim tjetër edhe nëse ka qenë i vetëdishëm se bëhet fjalë për fëmi viktimë sipas paragrafit 3 si dhe nën 14 vjet nëse kemi shfrytëzim seksual do të dënohet me burg së paku 12 vite është sipas paragrafit plotësues 4 të neni 418-g. Dënim të njejt si tek viktimat e rritur parasheh Kodi në rastet e shkatërrimit të dokumenteve personale të identifikimit me qëllim të kryerjes së veprës do të dënohet me burg së paku katër vjet e paraparë në paragrafin 5 me burg së paku katër vite. Nëse veprën e trafikimit e kryen personi zyrtar dënimi është së paku dhjetë vite, dënim i cili është dyfish më i rëndë tek viktimat fëmijë në krahasim me viktimat të rritur ku dënimi është me burg së paku pesë vite parasheh paragrafi 6. Pajtueshmëria e fëmisë për kryerjen e punëve të parapara të trafikimit të fëmijëve si rrethanë nuk ka aspak rëndësi dhe nuk mirret parasysh gjatë shqiptimit të dënimit parasheh paragrafi 7 i të njejtin nen. Përveç dënimit me burg për kryerësit, dënimi në të holla parashihet për kryerësit persona juridik sipas paragrafit 8. Edhe këtu njejt si tek viktimat e rritur, sipas parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit fëmitë nuk do të dënohen për veprën penale të kryer derisa ka qenë viktimë dhe i detyruar të kryej ndonjë vepër e cila me ligj është i dënueshëm edhe për këtë kategori është e paraparë sipas paragrafit 9 të nenit 418-g.

Shpesh edhe tek popullata por edhe tek nëpunësit e institucioneve shtetërore dhe ato joshtetërore në terminologji por edhe si akt nuk dallojnë veprën e trafikimit me qenie njerëzore dhe të ndërmjetësimit në prostitucion dhe viktimat e tyre. Në pjesën e dytë, kapitulli I, të punimit e kemi bërë dallimin e këtyre dy veprave penale në aspektin e realizimit të të dy veprave, kurse këtu do të paraqesim rregullimin e saj ligjor dhe sanksionin e paraparë. Në bazë të rezultateve analitike të vështruara në numrin më të madh të rasteve të parealizuara bëhet fjalë për fenomenin e prostituimit të detyruar të shtetaseve të huaja në banesa të marra me qira ose në banesa private, shtëpi, si edhe në shtëpitë e pushimit (vilat).[1223]

Neni 191 Ndërmjetësimi në prostitucion

[1222] Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/ , бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11, бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14, neni 418 g

[1223] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.9

1. Ai cili rekruton, shtyn, nxit apo mashtron persona në prostitucion, dhe ai i cili në çfarë do mënyrë të jetë mer pjesë në dorëzimin e personit tek tjetri me qëllim të kryerjes së prostitucionit, do të dënohet me burg prej pesë deri dhjetë vite.
2. Ai i cili për shkak të përfitimit i mundëson tjetrit shfrytëzimin e shërbimeve seksuale, do të dënohet me burg prej tre deri pesë vjet.
3. Ai i cili organizon kryerjen e veprave nga paragrafët (1) dhe (2) ose veprat do ti kryej gjatë kryerjes së dhunës familjare, do të dënohet me dënim së paku 10 vite.
4. Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim në të holla.
5. Patundshmëritë e përdorura dhe sendet e përdorura për kryerjen e veprës, konfiskohen.
Pra, në paragrafin 1 të këtij neni parashihet roli i ndërjmetësuesit dhe përgjegjësia e saj, pra këtu nuk kemi mjetet si tek vepra e trafikimit me qëllim të prostitucionit si: dhuna, detyrimi, forca apo kanosja. Në paragrafin 2 parashihet mundësimi i shfrytëzimin ndaj personave të tretë të shërbimeve seksuale ku përfitimin nga ajo merr ndërmjetësuesi dhe sipas Kodit dënohet me burg prej tre deri pesë vite. Dënim më të rëndë tek vepra penale e ndërmjetësimit në kryerjen e prostitucionit Kodi parasheh për personat që janë organizator, pra ata që e organizojnë ofrimin e shërbimeve seksuale me qëllim të përfitimit material dhe dënimi është së paku 10 vite e paraparë në paragrafin 3. Edhe tek kjo vepër penale ngjajshëm si veprat penale të lartëpërmendura personave juridik shqiptohet dënim në të holla kurse sendet e përdorura gjatë kryerjes konfiskohen nga organet kompetente shtetërore parashihet sipas paragrafit 4 dhe 5.

2. Masat që parashihen dhe aplikohen sipas akteve ndërkombëtare

Duke ditur se dukuritë e proceve të migracionit, sidomos migracioni ndërkombëtar (kalimet ilegale dhe të parregullta të kufijve shtetëror, kontrabanda me migrantë dhe sidomos vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore e tangojnë të gjitha shtetet në botë është e radhës të parashihen edhe masat sipas akteve ndërkombëtare. Këto ngjarje të emigrantëve paraqesin sfida të mëdha sigurie për qeveritë evropiane[1224], por edhe për botën dhe shtetin tonë e cila më shumë paraqitet në pozitën e shtetit tranzit për emigrantët ndërkombëtar nga e cila paraqitet edhe kontrabanda me migrantë dhe vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore. Luftimi i këtyre krimeve kërkon bashkëpunim ndërkombëtar për shkak të efekteve negative të kontrabandës së migrantëve dhe aktiviteteve të trafikimit të qenieve njerëzore në më shumë se një vend.[1225] "Pas observimit të vazhdueshëm në kongreset e OKB-së pë parandalimin e krimit (VII-Milano, 1985; VIII-Havanë, 1990), Luftimi i krimit të organizuar më në fund është ngritur në nivel të problemit global në Konferencën ministrore për krimin e organizuar transnacional, në Napoli në vitin 1994. Plani global për aksion, i miratuar në konferencë, i përmend këto karakteristika të nocionit të tij: organizatë kriminale, marëdhënie kierarkike në grup të cilat i lejojnë udhëheqësit që ta kontrollojë, dhunë, frikësim dhe korrupsion si mjet për realizimin e profitit apo kontrollit të të territorit apo tregut, larja e përfitimeve jo legale dhe infiltrimi i tij në ekonominë legale, aftësia për zgjerim në çfarëdo aktivitet tjetër edhe jashtë kufijve nacional dhe bashkëpunimi me grupet tjera transnacionale. Rezultatet e kësaj konference dhe të planit të miratuar në te janë: së pari, pranimi zyrtar i ekzistimit të problemit të krimit të organizuar; dhe së dyti, fillimi i reformave

[1224] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.153
[1225] Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016, fq.353

ligjdhënëse."[1226] Pra, qartazi shihet interesimi dhe serioziteti për këtë vepër të rezikshme dhe nevojën e ndërmarjes së masave konkrete për luftimin dhe parandalimin e saj.

Një hap i rëndësishëm në avancimin e instrumenteve ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar transnacional, dmth një dokument me rëndësi globale, është Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional me Protokollin për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit me njerëz, veçanërisht të grave dhe fëmijëve dhe Protokollin kundër kontrabandës së paligjshme të migrantëve përmes rrugës tokësore, ujore ose ajrore[1227] dhe llogaritet si akti i parë dhe më i rëndësishëm për luftimin dhe parandalimin e saj, të cilën Maqedonia e ratifikoj në vitin 2005. Sipas Protokolit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. me ""*Trafik personash*" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitutet."[1228] Kjo tregon se kemi të bëjmë me një definim të detajuar që edhe shtetet nënshkruese të saj janë të obligura të inkriminojnë në legjislacionin e tyre sipas veprimeve të cekura. Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, të datës 16.5.2005 në nenin 23 me titull sanksionet dhe masat i obligon shtetet që të miratojnë masa legjislative dhe masa tjera sipas nevojës së shtetit konkret për të siguruar që veprat penale sipas kësaj konvente të dënohen me sanksione efektive, në mënyrë proporcionale dhe bindëse.[1229] Edhe Konventa e OKB-së kundër krimit të organituar transnacional e vitit 2000 kurse ka hyrë në fuqi në vitin 2003 apo siç quhet Konventa e Palermos i obligon shtetet nënshkruese të inkriminojnë veprime të caktuara në legjislacionet e tyre penale. Konventa paraqet obligimin për inkriminimin e këtyre veprimeve: pajtim i një apo më tepër personave për kryerjen e veprave serioze, nga i cili rrjedh kryerja e veprës nga njëri nga pjeslmarrësit apo inkuadrimin në grupin e organizuar; pjesëmarrja në aktivitetet e grupit; organizimi, orientimi, shtytja, lehtësimi apo këshillimi në kryerjen e veprave serioze me inkuadrim të grupit të organizuar criminal (neni 3)[1230] dhe janë veprime të cilët japin rëndësinë dhe vlerën e masave të parapara sipas akteve ndërkombëtare.

Prandaj, politika e luftimit të kriminalitetit implikon nevojën që në bazë pikëpamjeve interdisiplinare shkencore dhe në bazë të evidencave të burimeve të ndryshme të rrezikueshmërisë të analizojë, sistematizojë dhe ofrojë parashikime sigurie si udhërrëfyes për planifikimin dhe zbatimin e masave preventive-represive për luftimin e kriminalitetit.[1231] Në këtë drejtim në

[1226] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.17

[1227] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.7

[1228] Protokolli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000, neni 3, paragrafi a

[1229] Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197, neni 23, paragrafi 1

[1230] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.17

[1231] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.34

Maqedoni Qeveria formoi Komision nacional për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe migracion ilegal nën koordinimin e Ministrisë së punëve të brendshme me qëllim të prevencionit dhe represionit si dhe bashkëpunimit mes institucional dhe me organizatat joqeveritare ndaj këtij fenomeni. Duke pasur parasysh faktin se në hapësirat tona ekziston prania e kategorisë së fëmijëve të rrezikut të lartë që janë viktima të mundshme të trafikimit me qenie njerëzore në suazat e Komisionit nacional në vitin 2004, u formua një nëngrup për të luftuar kundër trafikimit me fëmijëve.[1232] Detyra kryesore e Komisonit Nacional është:

- Monitorimin dhe analizën e situatave në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe migracionin e paligjshëm;
- Koordinimin e aktiviteteve të institucioneve kompetente qeveritare;
- Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare relevante dhe shoqatave qytetare.[1233]

Veprimtaria e Komisionit Nacional është më strukturor dhe teorik sesa praktik sidomos ka të bëjë me përgatitjen e politikave dhe strategjive shtetërore, mbikëqyrjen e realizimit të projektve shtetërore kundër trafikimit, si p.sh., Plani Nacional i Veprimit. Edhe pse jo çdo veprim i trafikimit të qenieve njerëzore është një veprim i krimit të organizuar, por ekziston si krim individual, madje si krim i mundësive, grupet e organizuara kriminale janë ato që udhëheqin dhe kontrollojnë pjesën më të madhe të këtij "biznesi".[1234] Ekzistojnë edhe akte ndërkombëtare me të cilat shtetet obligohen të marrin masa luftimin dhe parandalimin e migracionit illegal dhe të paligjshëm e cila mund të transformohet në kontrabandë dhe në trafikim me qenie njerëzore. Çdo Palë do të marrë masat e duhura, sipas nevojës, për të siguruar migrimin që të bëhet në mënyrë të ligjshme, veçanërisht nëpërmjet bërjes publike të informacionit të saktë nga zyrat përkatëse, mbi kushtet që mundësojnë hyrjen e ligjshme dhe qëndrimin në territorin e vet[1235] me qëllim të parandalimit të trafikimit si vepër e rrezikshmërisë së lartë. Sipas Konventës së Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore parashihet që: "Çdo Palë do të vendosë dhe/ose forcojë politikat dhe programet efektive, për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore me anë të mënyrave të tilla si: kërkimi, informacioni, ndërgjegjësimi dhe fushatat arsimore, nismat shoqërore e ekonomike, dhe programet e trajnimit, veçanërisht për personat e ndjeshëm ndaj trafikimit dhe për profesionistë të interesuar mbi çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore."[1236]

Në lidhje me trafikimin me qenie njerëzore sidomos për mbajtjen në robëri të personave e parasheh edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 8 të saj ku ceket se: "Askush nuk duhet të mbahet në robëri; robëria dhe tregtia me robër janë të ndaluara në të gjitha format e tyre."[1237] Ku shpesh viktimat e trafikimit janë të abuzuara nga abuzime prej më të rëndave dhe ngjajnë robërve të kohëve më të vjetra. Unioni evropian si një union i shtrirë në territorin e Evropës ku edhe shteti ynë ka aspirata për anëtarësim ka të paraparë definicionin e krimit të organizuar e cila vlen për shtetet anëtare të saj. Sipas planit të përbashkët të Unionit Evropian të 21 dhjetor 1998, në të gjitha vendet anëtare të tij "organizatë kriminale do të quhet organizata që ka një strukturë të përbërë nga dy ose më shumë persona, e krijuara për të vepruar gjatë një kohe

---

[1232] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.9

[1233] Влада на Република Македонија "Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016", Скопје, 2012, fq.25

[1234] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.10

[1235] Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197, neni 5, paragrafi 4

[1236] Po aty, paragrafi 2

[1237] Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, hyrja në fuqi: 23 mars 1976, neni 8, paragrafi 1

të caktuar dhe që kryen krime për të cilat ligji parashikon për të vepruar gjatë një kohe të caktuar dheqë kryen krime për të cilat ligji parashikon një maksimum prej të paktën 4 vite burgim ose dënime më të ronda".[1238] Shtetet-anëtare të UE janë të lidhura në rrjetin kompleks të sistemeve botërore, evropiane dhe ndërshtetëror të bashkëpunimit, cilët e kanë të vendosur bashkëpunimin ndërkombëtar në lëndët penale si një pjesë të fushave të saj të veprimtarisë, nga e cila mund të përfundojmë se me anëtarësimin e vendit në UE luftimi dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore dhe veprave tjera të rrezikshme dë të jetë më e suksesshme.

3. Masat tjera që parashihen dhe aplikohen në Republikën e Maqedonisë

Tregtia me njerëz është kriminalitet që viteve të fundit përjeton ekspanzion të madh në të gjithë botën, e veçanërisht në regjionin e Evropës Juglindore, më pas përfshirë edhe Republikën e Maedonisë.[1239] Shumë vende po edhe shteti ynë që nga kohërat më të lashta janë përpjekur të parandalojnë dhe luftojnë sjelljet devijante dhe kriminale të njerëzve ose grupeve me qëllim që të sigurohet stabilitet dhe siguri si dhe në ruajtjen e vlerave themelore shpqërore përmes mekanizmave dhe masave shtetërore dhe joshtetërore, e cila e përbën politikën shtetërore kundër kriminalitetit. Konventa e Palermos së bashku me dy protokollet e saj, mund të thuhet se ishin edhe si udhërrëfyes për shumë shtete në kuptimin e krijimit dhe forcimit të bazës ligjore në nivel kombëtar, kundër kriminalitetit të organizuar transnacional[1240], sidomos kundët trafikimit me qenie njerëzore si forma më e rrezikshme. Detyra primare e saj është analizimi, sintetizimi, përpunimi, reagimi dhe parashikimi i sjelljes së caktuar kriminale[1241], pra të politikës kriminale të shtetit. Sot, kur teknika dhe tekonologjia ka arritur zhvillimin më të lartë të saj dhe përmes këtyre zhvillimeve kemi kriminalitet të sotisfikuar përmes përdorimit të mjeteve dhe tekonogjive të fundit. Institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar kanë mungesë të pajisjeve të nevojshme teknike dhe teknologjisë informative si dhe hapësirës për punë.[1242] Pra, edhe Maqedonia duhet të realizoj këto kërkesa për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe të mjeteve për zbulimin , luftimin dhe parandalimin e trafikimit me njerëz.

Viktimat deri sa janë nën kontrollin e trafikantëve u nënshtrohet ndaj veprimeve dhe malltretimeve të ashpra, çnjerrëzore dhe ofenduese dhe përmes saj rrezikohet siguria e viktimës. Ndalimin e torturës e parasheh edhe Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themore dhe ate: "Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese."[1243] Kryerësit nuk hezitojnë aspak edhe kategorinë e quajtur fëmi për abuzime dhe vepra të ndryshme me qëllim të përfitimit material dhe është e nevojshme edhe masat kundër këtyre personave. Mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual parasheh më së miri Konventa e Këshillit të Evropës n2.201 të datës 25.10.2007. Kjo Konventë ka si qëllim të:

- parandalojë dhe të luftojë abuzimin seksual të fëmijëve;
- mbrojë të drejtat e fëmijëve viktima të shfrytëzimit seksual dhe të abuzimit seksual;

[1238] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti kompjuterik". Prishtinë, 2009, vep. e cit., fq.64

[1239] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.181

[1240] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti kompjuterik". Prishtinë, 2009, fq.64

[1241] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.30

[1242] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.327

[1243] Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, 4.XI.1950, neni 3

- nxisë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual të fëmijëve.[1244]

3.1. Parimet kryesore të parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore

Luftimi dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore si shtet juridic sin ë çdo vend të botës edhe tek na realizohet përmes respektimit të rregullave dhe parimeve juridike. Parimet e shtetit juridik, ligjshmëria, drejtësia, humaniteti etj siç do të shohim janë faktorë të pashmangshëm në përcaktimin e drejtimit të aktiviteteve të politikës së luftimit të kriminalitetit sot.[1245]

Parimi i shtetit juridik prej vet fjalës nënkupton se shteti duhet të ofrojë sipas ligjeve drejtësi, liri, lëvizje të lirë, barabartësi dhe shumë të drejta dhe liri të qytetarëve të garantuara nga ana e shtetit dhe organeve të saj. Në njërën anë ky e obligon shtetin dhe institucionet e tij që të veprojnë në pajtim me të drejtën dhe normat ligjore, kurse në anën tjetër, obligon secilin prej nesh që individualisht, gjithashtu, të veprojmë njësoj sipas ligjit.[1246] Në rastin konkret parimi i shtetit juridik për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore nënkupton ndërrmarrjen e masave dhe përdorimin e mekanizmave të luftimit dhe parandalimit ndaj kryerësve dhe viktimave të saj duke e respektuar ligjet dhe aktet tjera juridike të shtetit konkret si dhe aktet juridike ndërkombëtare, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Parimi i ligjshmërisë është e lidhur ngushtë me parimin e shtetit juridik por kjo e ka kuptimin më të ngushtë e cila parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore e ka tek ligji dhe aktet tjera juridike që burojnë nga ato ligje dhe të cilët e rregullojnë çështjen e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore në aspektin e ligjit pozitiv. Parimi i ligjshmërisë nënkupton që çdo aktivitet që ka për qëllim kundërvënien nda kriminalitetit dhe masat që duhet të ndërmerren në pajtim me normat ligjore që kanë të bëjnë me aktivitete të tilla, ose me fjalë të tjera, çdo aktivitet në këtë fushë duhet të ketë bazën ligjore si dhe në dispozitat e tjera juridike që kanë të bëjnë me atë materie.[1247] Për politikën e luftimit të kriminalitetit ky parim është i rëndësisë së jashtëzakonshme meqenëse, ndër të tjera, kërkon përcaktimin paraprak me ligj të veprës penale dhe të sanksionit penalo-juridik.[1248]

Parimi i legjitimitetit vjen në shprehje pas dy parimeve të lartëpërmendura pra, pas parimit të shtetit juridik dhe parimit të ligjshmërisë sidomos ka lidhshmëri të ngusht me parimin e ligjshmërisë sepse edhe ky parim bazën juridike e ka në ligjet pozitive të vendit konkret. Me fjalë tjera ky nënkupton arsyeshmërinë e cilit do vendim juridik të paraqitur në normën ligjore[1249] të institucioneve dhe nëpunësve shtetëror. Në veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore për të siguruar një shtet juridik duhet që ndaj kryerësve të veprave penale të përgjigjet përmes shqiptimit të masave dhe sansksioneve penale sipas ligjit nga organet përgjegjëse dhe legjitime me qëllim që edhe veprimi të jetë legjitim.

Parimi i individualizimit ka një rol dhe vlerë të veçantë sepse përmes këtij parimi politika kriminale e shtetit për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi dhe në veçanti të

[1244] Konventa e Këshillit të Evropës, për "Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual", Seritë e Traktateve të Këshillit të Evropës - nr. 201, Lanzarote, 25. X. 2007, neni 1, paragrafi 1

[1245] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.49

[1246] Po aty, fq.52

[1247] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.312

[1248] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.53

[1249] Po aty

trafikimit me qenie njerëzore ka të bëj me ndërmarrjen e masave dhe sanksioneve penale ndaj veprës penale konkrete, ndaj kryerësit konkret dhe individual të veprës penale si dhe shqiptimi i sanksionit penal ndaj kryerësit të saj. Parimi i individualizimit, si një ndër të arriturat e mëdha shekullore të zhvillimit të kriminologjisë dhe të mendimit penologjik dhe të kalimit nëpër shumë aspekte të deritashme të fazave të gabueshme në koncipimin e qasjes në trekëndëshin vepër penale-kryerës-sanksion penal, është shumë i rëndësishëm si segment i pikëpamjes bashkëkohore mbi kriminalitetin.[1250] Së këndejmi parimi i individualizimit ka rëndësi të jashtëzakonshme, sepse mbështetet në nevojat dhe kushtet konkrete individuale të aplikimit, që gjithashtu është kusht për suksesin e çdo veprimi preventiv.[1251] Pra, rëndësia e këtij parimi ka të bëj me individualizimin e veprës penale, kryerësit të saj dhe sanksionit penal si dhe ndikimi që ai të përmirësohet dhe në të ardhmen të mos jetë përsëritës i krimit, pra të arrihet edhe qëllimi preventiv ndaj kryerësit.

Parimi i humanitetit si parim gjatë gjithë fazave që nga faza hetimore e deri tek vuajtja e dënimit kryerësve të veprave penale e në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore nga ana e përfaqësuesve të organeve shtetërore kërkon sjellje humane duke e respektuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, dinjitetin dhe integritetin njerëzore, si dhe në anën tjetër duke ndaluar sjelljet johumane, ndalon mundimet dhe abuzimet fizike, psiqike të cilët e dëmtojnë shëndetin dhe e rrezikojnë jetën e personave. Ndërkaq parimi i humanitetit nënkupton se aplikimi i masave përkatëse represive (privimi nga liria, ekzekutimi i sanksioneve etj) ndërmerret me respektimin e integritetit fizik dhe psikologjik të personalitetit, të dinjitetit dhe të prestigjit të tij.[1252] Ky parim haset pothuajse në çdo lëmi të shkencave penale, në çdo procedurë dhe fazë penale, pa marr parasysh se personi në fjalë a është i dyshuar, i akuzuar ose i dënuar duke u bazuar në garancat që ofrojnë kushtetutat e vendeve konkrete, ligjet pozitive të shtetit si dhe aktet e shumta ndërkombëtare. Imperativi i veprimit human është e domosdoshme të jetë i zbatuar pa marrë parasysh peshën dhe pasojat e sjelljes së dënueshme.[1253] Sipas këtij parimi edhe ndaj kryerësve të trafikimit me qenie njerëzore duhet të veprohet përmes sjelljeve dhe kufizimeve si dhe forcës duke i respektuar integritetin e tyre psiqik dhe fizik.

KAPITULLI II

MASAT PREVENTIVE TË LUFTIMIT DHE PARANDALIMIT TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

1. Masat preventive të institucioneve shtetërore

Në kuptimin publik-juridik dhe strategjik, asnjë shtet serioz nuk duhet të lejojë rritjen e krimit të organizuar në territorin e tij, i cili shoqërohet me destabilizim ekonomik për shkak të rritjes së pastrimit të parave, rritjes së korrupsionit në sektorin publik, korrupsionit politik, humbjes së kontrollit mbi kufirin shtetëror dhe të ngjashme, e cila përfundimisht rezulton në përvetësimin e pushtetit politik dhe krijimin e një shteti kriminal.[1254] Në të gjithë rajonin, si dhe në të gjitha burimet e të dhënave, lëshimet më të mëdha në reagimin ndaj trafikimit me qenie njerëzore janë

[1250] Po aty, fq.54
[1251] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.315
[1252] Po aty
[1253] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.56
[1254] Priručnik za novinare "Trgovina ljudima". Beograd, 2008, fq.10

të lidhura me identifikimin në kohë dhe të saktë të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore[1255] si dhe me ndërmarjen e masave preventive. Politika e më hershme kriminale, duke u mbështetur në ligje dhe ndëshkime si instrumente themelore të saj, ishte reduktuar kryesisht në masat e drejtuar kah individi, gjegjësisht kryesi i veprës penale, prandaj edhe në përputhje me këtë ishte përpunuar dhe perfeksionuar edhe ndonjëri nga sistemet ndëshkuese (penale), ndërsa politika bashkëkohore e luftimit të kriminalitetit gjithnjë e më tepër hedh karakterin represiv dhe merr preventivën sociale me qëllim të kundërvënies më efikase të kriminalitetit.[1256] Por, viteve të fundit shumë shtete filluan praktikimin e masave preventive pët parandalimin e trafikimit duke ikur masave represive dhe ato i përdorin si masa të fundit kur është e pashmangshme përdorimi tyre. Masat preventive në shtete konrete duhet të jenë ndaj fenomenit të proceseve të migracionit dhe devijimit të tyre, kontrabandës me migrantë si dhe ndaj trafikimit me njerëz. Përparimi dhe mbështetja e shtëpive këshilluese informative ekzistuese dhe linjave telefonike në sektorin joqeveritar në bashkëpunim me rrjetat lokale të OJQve për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore në nivel lokal dhe nacional, që ofrojnë shërbime për informim dhe këshillim për rreziqet që lidhen me largimin e të rinjve jashtë shtetit me qëllim të punësimit të tyre ose të studimeve, këshillim juridik, ndihmë për realizimin e kontakteve me institucionet shtetërore, ndihmë psiko-sociale, mbështetje emocionale dhe intervenime në krizë, ndihmë për kthim në shtetin amë dhe drejtim kah shërbimet (departamentet) e tjera.[1257] Nga masat e dikurshme të frikësimit, që në periudhat e ndryshme historike ishin stil veprimi i institucioneve mbrojtëse të shtetit, sot ato plotësisht janë transformuar përmes ndryshimit implementimit, shndërrimit të tyre në masa preventive, si dhe në masë risocializimi[1258] e cila duhet të ndiqet edhe nga vendi ynë. Nga kategorizimi i cekur më parë, mund të vërejmë se nocioni parandalim përmban në vete të gjitha masat e ndërmarra në mënyrë të planifikuar, të paramenduar dhe të organizuar me të cilat do të bëhen përpjekje të mënjanohen ose së paku të zvogëlohen shkaqet e drejtëpërdrejta dhe të tërthorta të sjelljeve të dënueshme (***Horvatiq, Cvitanoviq***, 1999).[1259] Trajnimi i organizatave joqeveritare në Republikën e Maqedonisë për zbatimin e aktiviteteve parandaluese të trafikimit me fëmijë[1260], do të reflektonte në përmirësimin e gjendjes me trafikimin në përgjithsi dhe në veçanti të fëmijëve. Disa kriminolog gjerman (***Hartman, Lekach dh Shtiler***) i përdorin shprehjen ***lutte contre la criminalite dhe prevention du crime*** si shprehje sinonime të ***politique criminalle*** me të cilin nënkuptojnë *sistemin e masave të veprimit publik dhe social, me të cilat dëshirohet të ndalohet kriminaliteti*.[1261] Masat preventive i parasheh edhe Strategjia Nacionale për menaxhimin me trafikimin me qenie njerëzore e cila është e konsolidar me aktet juridike nacionale dhe ato ndërkombëtare : Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, Konventën e OKB-së kundër krimit transnacional dhe Marëveshjen për stabilizim dhe Asociim me Unionin Evropian. Aktivitete të tjera të parashikuara me Strategjia Kombëtare janë masat preventive me të cilët do të zvogëlohet numri i rasteve të trafikimit me qenie njerëzore,

[1255] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.71

[1256] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.32

[1257] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.60

[1258] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.32

[1259] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.172

[1260] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.59

[1261] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.35

programe për të ndihmuar dhe mbështetur viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, programe për kthimin dhe ri-integrimin e tyre, bashkëpunimin dhe koordinimin ndërkombëtar në zbatueshmërin e ligjeve, edukimi i punonjësve, koordinimi në mes të institucioneve të ndryshme në zbatimin e programit, si dhe programe të tjera që do të kenë ndikim në mendimin publik.[1262] Pra, fushëveprimi i masave preventive është shumë i gjërë dhe kaplon që nga proceset e migracionit dhe devijimet e tyre, kontrabanda me migrantë, trafikimi me qenie njerëzore dhe viktimat e tyre, institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare. Kështu nganjëherë me preventiv nënkuptohen edhe të gjitha aktivitetet e drejtuara në pengimin e mekanizmave të cilit sjellin deri tek lindja e akteve kriminale.[1263] Mediat si mekanizëm për përhapjen e lajmeve dhe informacioneve ka rëndësi të veçantë sepse depërton tek çdo familje. Trajnimi i përfaqësuesve të mediave me qëllim të njohjes së tyre me problemin e trafikimit me fëmijë dhe prezantimi më adekuat i rasteve nëpërmjet të mjeteve për informim publik[1264], do të ishte një hap shumë i rëndësishëm sepse informimi paraprak do të ndikonte tek popullata në ngritjen e vetëdijes nga rrezikshmëria e kësaj vepre penale, sidomos informimi në lidhje me pasojat trishtuese të trafikimit dhe viktimizimit nga ajo vepër sidomos të fëmijëve. Të gjithë këto aktivitete dhe veprimtari preventive mund të arrihet me edukimin profesional dhe ndjekjen e arsimit special për këtë fushë nga nëpunësit e organeve themelore që e luftojnë këtë fenomen si: policia, policia kufitare, gjykatat dhe prokuroria. Kështu masat preventive ndaj kriminalitetit mund ti ndërmarrin: organet shtetërore dhe ato me autorizime publike, organizatat jo qeveritare, shoqatat, fondacionet private, institucionet e informimit publik, shtypi , mediet publike, institucionet edukative arsimore, shoqatat profesionale në kuptimin e gjerë të fjalës, familja si grup fondamental social i çdo shoqërie.[1265] Ekzistojnë tre lloje të masave preventive dhe ate:


a) *masa preventive primare*: nënkuptohet masa të cilat ndërmirren nga ana e organeve shtetërore dhe organizatave joqeveritare para realizimit të krimit. Preventiva primare (vepron në publik dhe në ambient në përgjithësi) realizohet përmes përmirsimit të kushteve të përgjithshme sociale apo më saktë përmes asimilimit të shkaktareve më të mëdhenj të kriminalitetit.[1266]Ky tip i parandalimit të kriminalitetit paraqet aktivitetin e përhapur gjerësisht dhe përfshin: dizajnin e mjedisit (zgjidhjet adekuate arkitektonike, ndriçimin publik, mbikëqyrja e qasjes ndaj objektit ose hapësirës), rojën në vendbanime, angazhimin e agjencioneve të sigurisë, arsimimin e qytetarëve me qëllim të vetëmbrojtjes.[1267]
b) *masa preventive sekondare*: ka të bëjë me masat që ndërmirren nga organet shtetërore dhe joshtetërore pas kryerjes së veprës penale. Pra, lloji i këtillë i aktivitetit (program) nënkupton identifikimin e zones brenda bashkësisë lokale me shkallën më pak ose më shumë të shprehur të kriminalitetit.[1268]
c) *masa preventive terciare*: janë masa që aplikohen pasi i është shqiptuar dënimi kryerësit kurse viktimës nevoitet risocializimi, riedukimi me qëllim që të kthehet si person i

[1262] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, fq.3
[1263] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.42
[1264] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.59
[1265] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.43
[1266] Po aty, fq.46
[1267] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.319
[1268] Po aty, fq.320

barabartë në shoqëri. Qëllimi themelor i parandalimit terciar është zvogëlimi i shkallës së recidivizmit në bashkësi, përmes aplikimit të masave më të llojllojshme policore të mbikëqyrjes së shtuar dhe të kontrollit të recidivistëve.[1269]

Në vijim dë to paraqesim mendimin e qytetarëve pjesëmarrës në anketën e realizuar në lidhje me ate se kush ka ndikim më të madh në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore, faktikisht cili institucion e realizon parandalimin.

Grafikoni nr.23 Pyetje nga anketa: Sipas jush kush ka ndikim më të madh në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore sipas gjinisë



Testi Chi-square tregoi se nuk ka ndonjë ndryshim statistikisht të rëndësishëm nga gjinia e të anketuarve (χ 2 = 4.443, df = 5, p = 0.488> 0.05). Pra, nga të anketuarit tek të dy gjinitë dominon mendimi se policia ka ndikim më të madh për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe më pak organizatat joqeveritare. Pas Policisë të dy gjinit mendojnë se shoqëria gjithashtu ka ndikim të madh në parandalim ku meshkujt janë me 14.08% dhe femra me 14.00% dhe në rendin e tretë është familja ku tek meshkujt është 9.33% kurse te femrat 8.08%. parandalimi nga organizatat joqeveritare është meshkujt me 3.33% kurse femrat me 2.75%.

Tabela nr.11 Pyetje nga anketa: Sipas jush kush ka ndikim më të madh në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore sipas regjionit

		Sipas jush ndikim më të madh për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore kanë?						Total
		Familja	Shoqëria	Shkolla (arsimimi)	Policia	OJQ	Nuk e di	
Regjioni:	Shkupi	78	122	21	201	2	3	427
	Perëndim	81	156	32	241	1	4	515
	Jug	21	14	9	56	2	0	102

[1269] Po aty, fq.321

	Veri	24	33	7	57	3	0	124
	Lindje	5	12	4	9	2	0	32
Total		209	337	73	564	10	7	1200

Tabela nr.11 në lidhje me parandalimin e trafikimit sipas regjionet shihet se nga çdo regjion i vendit të mendimit se policia ka më shumë ndikim janë 564 të anketuar më pas vijon shoqëria me 337 të anketuar, familja me 209, arsimimi me 73, organizatat joqeveritare me 10 dhe nuk e di me 7 të anketuar. Nga të gjith regjionet perëndimi dominon me mendimin se policia ka ndikim me 241 (nga gjithsejt 515) të anketuar, Shkupi me 201 (nga gjithsejt 427) të anketuar, veri 57(nga gjithsejt 124), jug 56 (nga gjithsejt 102) dhe lindje 9 (nga gjithsejt 32) të anketuar

Tabela nr.12 Pyetje nga anketa: Sipas jush kush ka ndikim më të madh në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore sipas vendbanimit

		Sipas jush ndikim më të madh për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore kanë?						
		Familja	Shoqëria	Shkolla (arsimimi)	Policia	OJQ	Nuk e di	Total
Vendbanimi:	Fshat	73	151	24	216	1	2	467
	Qytet	136	187	50	346	9	5	733
		209	337	73	564	10	7	1200

Sa i takon krahasimit vendet urbane dhe ato rurale të anketuarit e vendeve rurale nga gjithsejt 467 mendojnë se policia ka ndikim me 216, shoqëria me 151, familja me 73 arsimimi me 24, organizata joqeveritare me 1 dhe nuk e di me 2, kurse nga gjithsejt 733 nga vendet urbane mendojnë se ndikim ka policia me 346, shoqëria me 151, familja 136 organizatat joqeveritare 9 dhe nuk e di 5 nga të anketuarit. Kjo tregon se sipas gjinisë, regjionit dhe vendbanimit shumica dominon të mendimit se policia është më me ndikim kurse më pak ndikim OJQ.

1.1. Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional në vend, rajonal dhe ndërkombëtar

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem serioz dhe kompleks ndërkombëtar, biznesi i tretë më i madh kriminal pas trafikimit të drogës dhe armëve dhe një nga format në rritje të krimit të organizuar në nivel global, e cila është e pranishme si në vendet e varfra edhe të pamjaftueshëm të zhvilluara ashtu edhe në vendet e zhvilluara[1270], pra e cila është prezente edhe në Republikën e Maqedonisë. Dukuria komplekse dhe e realizuar në mënyrë shumë profesionale nuk mund të paramendohet luftimi dhe parandalimi i saj me sukses nëse në mes të institucineve vendore, rajonale dhe ndërkombëtare kompetente nuk ekziston një bashkëpunim dhe koordinim të masave dhe aktiviteteve kundër këtij fenomeni.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i organeve dhe institucioneve përkatëse qeveritare, i organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare me qëllim të vendosjes së një sistemi efikas të identifikimit, drejtimit, pranimit dhe dhënies së ndihmës dhe mbrojtjes për fëmijët-viktima/

[1270] Прирачник. “Трговија со луѓе”, Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.11

dëshmitarë, si dhe ndjekja penale e kryesve të veprave penale[1271], do të ndikonte shumë në parandalimin dhe luftimin më efikas të kësaj dukurie negative në vendin tone por edhe më gjërë. Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional duhet të jetë në mes të subjekteve apo institucioneve themelore dhe organizatave joqeveritare të cilët e kanë për detyrë luftimin dhe parandalimin e krimit e në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore. Për veprim të suksesshëm preventiv, zbulim, ndjekje dhe sanksionim të këtyre veprave penale është e nevojshme një qasje më e koordinuar në mes të gjitha institucioneve pavarësisht se në çfarë mënyre dë të ndeshet me këtë lloj të kriminalitetit, parasëgjithash policia, prokuroria dhe gjykatat.[1272] Duke u bazuar se çdo shtet e ka të kombinuar masat (preventive dhe represive) që ndërrmiren ndaj trafikimit me qenie njerëzore nga institucionet të cilët janë përgjegjëse për implementimin e këtyre masave do ndahen në dy grupe. Grupin e parë të institucioneve të cilët si qëllim e kanë luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore ndërmarrin masa represive e cila e përbën politikën kriminale të shtetit dhe ato institucione janë: policia, prokuroria publike, gjykatat si dhe entet e ekzekutimit të sanksioneve penale. Gjithashtu këto institucione e kanë rolin preventiv para kryerjes së krimit përmes seminareve, konferencave aktivitete të informimit të qytetarëve etj. Në anën tjetër kategoritë shoqërore të cilat në aktivitetet e veta realizojnë më tepër detyra preventive sikurse është familja, institucionet arsimore, entet për punë sociale shpesh quhen subjekte jashtë penale të politikës kriminale[1273] së bashku me organizatat joqeveritare. Të dy grupet e cekura, pra institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare si dhe kategoria shoqërore: familja, shkollat, entet sociale duhet që në mes veti të bashkëpunojnë dhe ti koordinojnë gjitha aktivitetet preventive dhe represive që parandalimi dhe prevencioni ndaj trafikimit dhe viktimave të tyre të jetë në nivel më të lartë.

Nga të gjithë këta subjekte, policia ushtron aktivitet më të dendur dhe gjithëpërfshirës në drejtimtë zbulimit të veprës penale dhe kryesit e saj.[1274] Policia është një ndër institucionet të cilët kanë një rëndësi të veçantë dhe të cilët shpesh ndërrmarin masa *post delictum* pra, pas veprës penale sidomos në lidhje me veprën penale, kryerësin e veprës penale, sigurimin e provave dhe dëshmitarëve, e cila është si isntitucion i cili praktikon masat represive. Pra, shihet se veprimet e marrura nga policia duhet të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të disa veprimeve me organet tjera si gjykata, prokuroria, policia kufitare, enti për punë sociale dhe organizatat joqeveritare. Sipas LPP-ë nëse ekzistojnë bazat për dyshim se është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, policia ka për detyrë, qoftë me vetiniciativë ose me kërkesë të prokurorit publik, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme[1275]. Pra, shihet së për ndërrmarjen e masave të nevojshme nga policia realizohet edhe përmes kërkesës së prokurorisë të cilët duhet të bashkëpunojnë dhe kordinojnë aktivitetet. Sot, kur teknika dhe teknologjia ka arritur nivelin më të lartë të përdorimit të mjeteve teknologjike kryerësit e trafikimit me qeni njerëzore e kanë shfrytëzuar këtë përparim dhe si mjet i kryerjes së trafikimit dhe përdorin shpesh kompjuterin, telefonat androit dhe rrjete të ndryshme sociale. Andaj policia duhet që bashkëpunimin të zgjeroj edhe me sektorin shoqëror sidomos me profesionist të teknologjisë të cilët mund të kryejnë ekspertizë mbi pajisjet elektronike të kriminelëve. *Nga raporti për pajisjet mobile nr.reg.23.7-70796/2 të vitit 14.02.2013 Gjykata*

[1271] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.63

[1272] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.189

[1273] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.65

[1274] Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. "E drejta e procedurës penale". Prishtinë, 2013, fq.310

[1275] Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. "E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë". Tetovë, 2007, fq.214

vërtetoi se është kryer ekspertizë të përmbajtjes-të dhënat që gjenden si në memorien e vet pajisjeve telefonike ashtu edhe në sim kartelet, në bazë të cilit në ekspertizë është përgaditur gjetja me shkrim edhe ate për pajisjen e telefonit mobil.[1276] Në bazë të kësaj, shteti sidomos ministria e punëve të brendshme duke pasur parasysh këtë duhet të zhvilloj dhe avancoj edhe më shumë masat kundër kriminalitetit kompjuterik që llogaritet si kriminalitet përmes mjeteve më të përsosura komojuterike dhe teknologjike. Inspektoriati i punës dhe të tregut gjithashtu kanë një rol të madh në ndërmarjen e masave preventive sidomos në zbulimin dhe identifikimin e parregullsive në vendet e punës dhe objekte të ndryshme sidomos lokalet dhe objektet ku dyshohet se ekziston shfrytëzimi viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, por edhe sipas legjislacionit nacional, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektorike, inspektori i punës i kryen veprimet në kuadër të ingjerencave të tij dhe ka të drejtë t'i qaset të gjitha agjencive shtetërore që mbledhin të dhëna ose mbajnë regjistra dhe të kërkojnë prej tyre t'ia dorëzojnë informatën e kërkuar.[1277] Pra, vet qasja në të gjithë agjencitë shtetërore në lidhje me trafikimin e njerëzve nënkupton bashkëpunimin dhe koordinimin e punëve mes institucioneve. Ministria e punës dhe politikës sociale ka për detyrë të kryejë rregullisht inspektime të rrepta të bizneseve të ndryshme me qëllim të sigurimit që të mos bëhet eksploatimi i çfarëdo lloji.[1278] Më pas në lidhje me luftimin dhe parandalimin e dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore pothuajse çdo ministri në kuadër të drejtave dhe detyrave që i posedojnë në bazë të ligjeve nacionale marrin masa konkrete sip janë: Ministria e drejtësisë merr masa në lidhje me kuadrin ligjor dhe aktet tjera nën ingerencat e saja, Minsitria e shëndetësis merr masa në lidhje me shëndetin e viktimave të trafikimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet e vendit, Ministria e arsimit dhe shkencës merr masa në lidhje me ngritjen e nivelit të kuptimit të rreziqeve të këtij fenomeni përmes projekteve konkrete arsimore etj. Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë një numër të madh masash - përmes ndryshimit të legjislacionit dhe duke aplikuar mekanizmat e duhur të politikës së migracionit, duke u mbështetur edhe në burimet e veta dhe në bashkëpunimin me numër të madh të vendeve brenda dhe jashtë rajonit të Evropës Juglindore.[1279]

Në Ballkanin Perëndimor, qeveritë dhe aktorët e tjerë kanë krijuar disa struktura për të koordinuar dhe siguruar bashkëpunim ndërkufitar efektiv për t'iu përgjigjur trafikimit me qenie njerëzore[1280] sidomos kordinimi dhe bashkëpunimi primar i Republikës së Maqedonisë është me shtetet fqinje të saj. Bashkëpunimi rajonal në këtë lëmë është një proces të cilit po i kushtohet një rëndësi e veçantë. Në përputhje me konkludimet e miratuara në mbledhjet e Koordinatorëve nacionalë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Zagreb, është arritur edhe një konsensus i përgjithshëm se ekzistimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e shpartallimit të trafikimit me qenie njerëzore, duhet të përforcohet vazhdimisht, në veçanti pas përfundimit të mandatit të Grupit punues për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore të Paktit të stabilizimit dhe asociimit.[1281] Në Ballkanin Perëndimor, qeveritë dhe palët e tjera të interesuara kanë krijuar disa struktura për të koordinuar dhe siguruar bashkëpunim ndërkufitar efektiv për t'iu përgjigjur trafikimit me qenie njerëzore.[1282] Platforma më e gjerë për bashkëpunimin rajonal në lidhje me

[1276] Aktgjykim nr.113 të datës 24.02.2016 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.13

[1277] Doracak "Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës", Shkup, 2010, fq.32

[1278] Извештај. "Борба против трговија со луѓе", Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009, fq.5

[1279] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа". Скопје, 2016, fq.26

[1280] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.68

[1281] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.13

[1282] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.68

trafikimin e qenieve njerëzore paraqet Strategjia e Integruar e BE për menaxhimin e integruar të kufijve, e cila përfshin bashkëpunimin në fushën e vizave, azilit dhe migracionit.[1283]Komisioni Nacional për menaxhimin e integruar të kufijve është themeluar si një trup ndihmës dhe këshillues i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, me kompetencë për zbatimin e masave dhe aktiviteteve për Sistemin e krijuar të menaxhimit të kufijve të integruar, me qëllim që të: realizon bashkëpunim ndërkombëtar në lidhje me aktivitetet për menaxhimin e integruar të kufijve.[1284]Ekzistojnë edhe disa marrëveshje bilaterale që përqendrohen në aspektet juridike të bashkëpunimit policor, të nënshkruar midis Shqipërisë, Bullgarisë, Kroacisë dhe Bosnjë-Hercegovinës me Serbinë në 2010 (Scarabelli, 2014).[1285] Bashkëpunimi përbëhet nga patrulla të rregullta të përbashkëta, shpërndarje të koordinuar të burimeve teknike dhe njerëzore dhe aktivitete në qendrat e përbashkëta të kontaktit.[1286] Por, këto marvëeshje bilaterale për koordinim dhe bashkëpunim nuk janë të llojit operativ por më shumë janë procedura administrative të gjata dhe komplekse të cilat në praktikë nuk japin rezultate konkrete.

Aspekti ndërkombëtar i këtyre dukurive kriminale bën që format e ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, siç është bashkëpunimi polici me polici, si edhe instrumentet ligjore më zyrtare, siç janë ndihma e ndërsjelltë juridike apo ekstradimi, të jenë jetike për suksesin e hetimeve, ndjekjeve penale apo dënimeve ndërkombëtare.[1287] Këshilli i Evropës kaherë e ka sjellur draftin e Konventës për luftë kundër tregtisë me njerëz, e cila ka potencuar nevojën për bashkëpunim në mes shteteve në luftë kundër kësaj forme të kriminalitetit të organizuar.[1288] Bashkimi vendos bashkëpunimin policor me përfshirjen e autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare, duke përfshirë policinë, doganat dhe shërbimet e tjera të specializuara të forcave të ligjit, lidhur me parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale.[1289] Bashkëpunimi policor nëpërmjet Interpolit dhe Europolit (Sistemi Shengen) apo organizatave tjera regjionale dhe ndërkombëtare dhe rrjeteve ndërkombëtare të zyrtarëve policor duhet gjithashtu të shkojë përpara me qëllim të rritjes së efikasitetit të aktiviteteve të policies nacionale dhe bashkëpunimi regjional/global në luftë kundër kriminalitetit.[1290] Këto pengesa në Evropën jug-lindore ose në vendet e ish jugosllavisë, apo shtetet e Ballkanit më shumë janë të afërta me legjislacionine cila e rregullon trafikimin, politika të ngjajshme dhe raporte të mira të bashkëpunimit përveç raporteve bilaterale siç janë: raporti Maqedoni-Greqi para ndryshimit të emrit, Kosovë-Serbi. Si vërtetim për këtë vetëdijësim të vonuar është padyshim miratimi i instrumentit më të rëndësishëm ndërkombëtar-Konventa e OKB-së për parandalimin e krimit të organizuar transnacional (Konventa e Palermos), që ndodhi më vitin 2000 si reaksion ndaj aktiviteteve të dobëta dhe jo të koordinuara të shteteve në koncipimin dhe zbatimin e strategjisë konzistente preventive dhe represive për luftimin e rrezikut më të madh

[1283] Po aty, vep. e cit., fq.68

[1284] Национална Стратегија. "Развој на воспоставениот систем за интегрирано гранично управување". Скопје, 2009, fq.7

[1285] Извештај. "Трговија со луѓе во Западен Балкан". IOM-Geneva, 2014, fq.69

[1286] Стратегија. "Развој на полицијата 2016-2020". Скопје, fq.37

[1287] Udhëzues për bashkpunim ndërkombëtar. "Trafikimi i qenieve njerëzore-kalimi kontrabandë i migruesve". UNODC, Beograd, 2010, fq.18

[1288] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.141

[1289] Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila është shpallur në Strasburg, më 12 dhjetor 2007 nga Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni (GZ C 303, 14.12.2007, neni 87, paragrafi 1

[1290] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.135

për liritë dhe të drejtat e njeriut.[1291] Ekziston edhe bashkëpunimi joformal në mes të institucineve sidomos të policisë për shkëmbim të informatave kundër krimit të organizuar ndërkombëtar e cila e shpejton punën operative policore. "I përdorur në këtë kontekst, termi "bashkëpunim joformal" ka të bëjë me shkëmbimin e informacionit që behet drejtpërdrejt midis agjencive të forcave të ligjit dhe enteve rregullatore me homologët e tyre të huaj. Ndonjëherë quhet edhe ndihmë polici me polici apo dikaster me dikaster."[1292]

Të fuqizojnë, si duhet, bashkëpunimin me shtetet e tjera për shkëmbimin e informacionit lidhur me identitetet, përdorimin keqbërës të dokumenteve dhe mjetet dhe metodat e përdorura nga trafikantët[1293], është një nga kërkesat e Protokollit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Parandalimin, Ndalimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve. Sipas kësaj Konvente, shtetet pjesëmarrëse duhet të bashkëpunojnë ngushtë njëra me tjetrën, në përputhje me ligjet e tyre të brendshme përkatëse dhe sistemet e tyre qeverisëse, që të rrisin efektivitetin e veprimeve të ruajtjes së rendit, që të luftojnë veprat dhe kundërvajtjet e paraqitura sipas kësaj Konvente[1294], pra edhe ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Shpesh bashkëpunimi dhe koordinimi varet edhe nga dëshira, interesimi dhe vullneti për të bashkëpunuar kundër krimit të organizuar, dhe këtu vlen parimi i reciprocitetit. Veprimi reciprok është një parim zakonor i cili, në thelb, është një garanci që jep shteti që bën kërkesën për ndihmë se do të përmbushë të njëjtin lloj kërkese dhe do të ofrojë bashkëpunim të ngjashëm për shtetin të cilit i drejtohet kërkesa në një rast të ngjashëm në të ardhmen.[1295] Gjatë përpjekjeve për të siguruar një menaxhim efektiv me krizën e refugjatëve dhe migrantëve nga viti 2015/2016, Republika e Maqedonisë vendosi bashkëpunim të ngushtë me shumë vende të Evropës Juglindore, veçanërisht ata që gjinden në gjatësi të ashtuquajturës "rruta e Ballkanit Perëndimor" (Serbia, Kroacia, Sllovenia), si dhe vendet e grupit të Vishegradit (Hungaria, Sllovakia, Republika Çeke dhe Polonia)[1296], sidomos bashkëpunim në lidhje me shkëmbim të informative në lidhje me profilin e refugjatëve dhe migrantëve, kontrabanduesve dhe të trafikantëve të cilët shtetin toni e kalonin tranzit. Trendi i migracionit ilegal shënon ndryshime të caktuara, veçanërisht në numrin e migrantëve ilegalë të zbuluar (rritur për 66%), sipas strukturës nacionale (nga Lindja e Afërt dhe Mesme dhe Afrika e Veriut) si dhe një rritje e madhe e numrit të përpjekjeve për hyrje ilegale në Republikën e Maqedonisë nga R. e Bullgarisë që paraqet ndryshimin më karakteristik në trendin e migracionit ilegal në vitin 2013.[1297] Rritja e madhe e numrit të përpjekjeve për hyrje ilegale të zbuluara në Republikën e Maqedonisë nga R. e Bullgarisë është ndryshimi më karakteristik në trendet në 2013, së bashku me paraqitjen e migrantëve ilegal- qytetarë të Sirisë (116), e cila nuk ishte rast në vitet e mëparshme.[1298] Prandaj, masat për parandalim dhe luftim kundët migrimeve ilegale, kontrabandës apo trafikimit me njerëz duhet të ec në trend si veprat penale që të njejtat të kenë sukses. Sipas Frontex, Agjencioni për kufijtë e jashtme të BE-së, në vitin 2014 ishin vërejtur më shumë se 66,000 kalime të parregullta kufitare në pesë vendet e Ballkanit Perëndimor:

[1291] Po aty, fq.10

[1292] Udhëzues për bashkpunim ndërkombëtar. "Trafikimi i qenieve njerëzore-kalimi kontrabandë i migruesve". UNODC, Beograd, 2010, fq.20

[1293] Po aty, fq.13

[1294] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.56

[1295] Udhëzues për bashkpunim ndërkombëtar. "Trafikimi i qenieve njerëzore-kalimi kontrabandë i migruesve". UNODC, Beograd, 2010, fq.27

[1296] Студија. "Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа". Скопје, 2016, fq.34

[1297] Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. "Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година". Скопје, 2014, fq.3

[1298] Po aty, fq.11

Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia, e cila paraqet rritje prej 65 përqind në krahasim me 2013-ën[1299] numër e cila tregon edhe nivelin e rezikshmërisë nga rritja e viktimave të trafikimit dhe kontrabandës. Andaj për shkak të krimit të organizuar, migrimeve ilegale dhe të paligjshme, kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore nuk mund të iket bashkëpunimit dhe koordinimit vendor, rajonal dhe ndërkombëtar të këtyre fenomeneve.

1.2. Bashkëpunimi dhe koordinimi mes institucioneve shtetërore dhe institucioneve lokale dhe organizatave joqeveritare

Trafikimi i qenieve njerëzore si një fenomen i rrezikshmërisë së lartë përveç pasojave në shtet ajo ka pasoja në çdo vend, familje, bashkësi dhe person. është një problem serioz shoqëror dhe paraqet formën më të rëndë të shkeljes së të drejtave themelore të njeriut - drejtës për jetë, të lëvizjes së lirë, të lirsë së zgjedhjes dhe të drejtat dhe liritë tjera. Natyra komplekse e kriminalitetit ka kushtëzuar nevojën e miratimit të një sistemi normash koherente, institucionesh, mjetesh dhe formash të aspektit penal-juridik, kriminologjik, penologjik, sociologjik dhe të aspektit politikologjik[1300] e cila nënkupton një sistem më gjithpërfshirës. Kur themi në mënyrë më gjithëpërfshirëse mendohen në çdo institucion shtetëror, joshtetëror, hulumtime shkencore, analiza empirike, në çdo individ dhe familje. Mungesa permanente e hulumtimeve shkencore në fushën e parandalimit të kriminalitetit, pa dyshim prodhon pasoja të caktuara në shoqëri, të cilat reflektohen pastaj përmes bashkëpunimit të organeve represive dhe bashkësisë, me çka mund të mbrohet në mënyrë të argumentuar qëndrimi për nevojën tepër të madhe për veprimtari preventive në shoqëri.[1301] Ndërlidhje e organizuar me përmasat e gjera sociale dhe me institucionet në përgjithësi në zbatimin e programeve preventive janë hapë jashtëzakonisht i rëndësishëm i cili është i pa zbatueshëm pa pjesëmarrjen e profesionistëve të cilët nga aspekti interdisiplinare do të japin udhë rrëfimin shkencor profesional për konkretizimin e përmbajtjeve preventive.[1302] Në lidhje me ate se sa i besojnë qytetarët e vendit institucioneve përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e trafikimit do të shohim tabelat e mëposhtme.

Tabela nr.13 Pyetje nga anketa: Cilit institucion i besoni më së shumti për ta lajmëruar, dëshmuar për trafikant ose viktimë sipas nivelit të arsimit

		Cilit institucion i besoni më së shumti për ta lajmëruar, dëshmuar se një person është trafikant, viktimë ose klient?						
		Nuk e di	OJQ	Ministria e punëve të brendshme	Komunat	Presidenti	Qeveria	Gjithsejt
Niveli i arsimit:	Fillore	70	11	15	84	0	4	184
	Mesme	123	109	108	268	3	29	640

[1299] Истражување “Како да не сме луѓе” на Полициска бруталност врз мигрантите и барателите на азил во Македонија, 2015, fq.3

[1300] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina “Politika e luftimit të kriminalittit”. Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.34

[1301] Po aty, fq.38

[1302] Po aty, fq.44

	Fakultet	19	176	58	55	1	26	335
	Magjistër	2	18	7	4	1	3	35
	Doktorant	1	4	0	0	0	0	5
	Të tjerë	0	0	0	1	0	0	1
Gjithsejt		215	318	188	412	5	62	1200

Tabela paraqet se cilit institucion i besoni më së shumti për të lajmëruar, dëshmuar për trafikantë ose viktimë qytetarët sipas nivelit të arsimit mendojnë si vijon: me arsim mesëm nga gjithsejt 640 më shumë i besojnë komunave me 268, nuk e di me 123, OJQ me 109, Ministria e Punëve të Brendshme me 108 Qeveria me 19 dhe presidenti me 3, me fakultet besojnë më shumë OJQ-ve me176, Ministria e Punëve të brendshme me 58, komunat me 55, Qeveria me 26, nuk e di me 19 të anketuar. Sa i takon anketuarve me me arsim fillor nga gjithsejt 184 më shumë besojnë: komunat me 84, nuk e di me 70, Ministria e Punëve të Brendshme me 15, OJQ-të me11 dhe Qeveria me 4 të anketuar, kurse ata me magjistraturë: OJQ-re 18, Ministria e Punëve të Brendshme 7, komunat 4, Qeveria 3, nuk e di 2 dhe presidenti 1 të anketuar, kurse anketuarit me doktoratur: OJQ-re 4, nuk e di 1 të anketuar nga gjithsejt 5. Nga kjo del se institucionit të policies e cila ka për detyrë luftimin dhe parandalimin nga të anketuarit vetëm 188 i besojnë nga gjithsejt 1200 të anketuar e cila është për tu brengos dhe të mirret me seriozitet përmirësimi i kësaj gjendjeje.

Tabela nr.14 Pyetje nga anketa: Cilit institucion i besoni më së shumti për ta lajmëruar, dëshmuar për trafikant ose viktimë sipas nacionalitetit

		Cilit institucion i besoni më së shumti për ta lajmëruar, dëshmuar se një person është trafikant, viktimë ose klient?						Total
		Nuk e di	OJQ	Ministria e punëve të brendshme	Komunat	Presidenti	Qeveria	
Nacionaliteti:	Maqedon	71	137	50	101	1	25	385
	Shqipëtar	84	132	111	245	4	30	606
	Turk	42	33	21	52	0	6	154
	Romë	14	4	3	12	0	1	34
	Boshnjak	3	10	3	0	0	0	16
	Sërb	1	2	0	2	0	0	5
Total		215	318	188	412	5	62	1200

Sa i përket nacionalitetit në lidhje me besimin ndaj institucioneve është si vijon: Nga gjithsejt 606 shqiptar komunave besojnë 245, OJQ 132, Minsitrisë së Punëve të Brendshme 111, nuk e di 84 Qeverisë 30, Presidentit 4, kurse tek maqedonit nga gjithsejt 385 më shumë besojnë: OJQ me 137, komunave me 101, nuk e di 71 Minsitria e Punëve të Brendshme me 50, Qeverisë me 25 dhe presidentit me 1 mendim të të anketuarve. Edhe nacionalitetet të tjera siç janë turqit, dhe serbët më shumë I besojnë komunave, serbët më shumë komunave dhe OJQ-ve si dhe boshnjakët më shumë OJQ-ve. Edhe këtu shihet se të gjithë nacionalitetet më shumë besojnë komunave 412, OJQ-ve 318, Nuk e di 215 kurse Minsitrisë së Punëve të Brendshme vetëm 188, që tregon gjendjen brengosëse të politikës kriminale të Republikës së Maqedonisë e cila duhet të marrë masa të përmirësojë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore.

Tabela nr.15 Pyetje nga anketa: Cilit institucion më pak i besoni më së shumti për ta lajmëruar, dëshmuar për trafikant ose viktimë sipas nacionalitetit

		Cilit institucion më pak i besoni për ta lajmëruar, dëshmuar se një person është trafikant, viktimë ose klient?						Total
		Nuk e di	OJQ	Ministria e punëve të brendshme	Komunat	Policia kufitare	Qeveria	
Nacionaliteti:	Maqedon	57	12	151	58	59	48	385
	Shqiptare	102	15	229	83	95	82	606
	Turk	34	4	55	20	23	18	154
	Rome	4	0	13	7	7	3	34
	Boshnjak	4	1	5	3	2	1	16
	Serb	0	0	1	0	4	0	5
Total		201	32	454	171	190	152	1200

Edhe kjo tabelë e jep përgjigjen e njejt si tabela e lartëpërmendur këtu në pyetjen e kundërt se cilit institucion më pak I besoni ku dominon Ministria e Punëve të Brendshme nga gjithsejt 1200 të anketuar, 454 më pak I besojnë (Shqiptarë 229, maqedon 151, turq 55, romë 13 boshnjak 5 dhe serb 1), pastaj vijon, nuk e di me 201, Policia kufitare me 190, komunat me 171, Qeveria me 152, dhe OJQ-re me 32 të anketuar. Si tabelat e lartëpërmendura edhe kjo tregon gjendjen apo qëndrimin negative të qytetarëve ndaj institucionit të policies s i takon besimit për të paraqitur ose dëshmuar për veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore.

Aktiviteti preventive ndërmarrin të gjithë organet shtetërore dhe shoqërore, organizatat shoqërore dhe institucionet (familje, shkolla, shoqata të ndryshme, organizata joqeveritare, organe të mbrojtjes sociale, organe përfaqësuese të bashkësive socio-politike, etj.).[1303]

Policia vështrohet si sistem dinamik dhe transparent e cila duke ia përshtatur veprimin e saj ndërrimeve shoqërore moderne dhe demokratike, në mënyrë serioze kujdeset për veprim sensibil në disa situata konfliktuoze, me qëllim të ndërtimit të marrëdhënieve interaktive dhe fitimit të

[1303] Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. "Prevencija Kriminaliteta". Beograd, 2010, fq.34

besimit të qytetarëve[1304], kjo nënkupton edhe afrimin dhe bashkëpunimin me qytetarët. Policia në bashkësinë lokale është një qasje e gjithanshme që kultivon pikëpamjen multikauzale të kriminalitetit dhe qasje multidimensionale për parandalimin e kriminalitetit.[1305] Në këtë kuptim, është shumë me rëndësi që në bazë të kontaktit të parë të ndërtohet mendimi për policinë i ashtuquajturi "shëmbëlltyrë", e cila duhet ta reflektojë besueshmërinë reciproke, sepse nuk ekziston asnjë profesion i cili nuk është i nënshtruar gjykimit publik sikurse policia.[1306] Pra, nga ana e shoqërisë duhet të formohet besimi tek policia që edhe funksionimi preventive së bashku të jetë i suksesshëm ndaj trafikimit me qenie njerëzore. Përkrahja e realtë dhe objektiv përmes besimit të shoqërisë ndaj aktiviteteve dhe masave që i ndërrmer kundër kriminalitetit do të ishte edhe respektim i lirive dhe të drejtave të tyre. Zhvillimet në shërbim, i cili gjithnjë e më shumë u shërben qytetarëve dhe orientohet në raportet më të afërta me komunitetin, duhet të jenë reale, dhe jo sipërfaqësore, dhe prandaj kërkojnë ndryshime esenciale në filozofinë, radhitjen e përparësive dhe ristrukturim potencial masiv të organizatës policore.[1307] Pra, veprimtaria e policisë në shoqëri është një inovacion dhe risi e përparua viteve të fundit e cila edhe në Maqedoni do të ndikojë edhe në rezultate më pozitive të luftimit të kriminalitetit në përgjithësi dhe në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore.

Politika kriminale (politika e luftimit të kriminalitetit), përfshinë apo thënë më mirë duhet të përfshijë sistemin e planifikuar dhe të koordinuar të veprimtarive shoqërore, në pikëpamje të ndryshme përmbajtjesore dhe me subjekte të ndryshme si bartës të tyre unik në qëllimin e përbashkët[1308]preventiv. Prandaj, çdo mungesë bashkëpunimi, koordinimi dhe analize në preventiven e kriminalitetit ndërmjet institucioneve shkencore, profesionale dhe institucioneve tjera sjell deri tek margjinalizimi dhe reduktimi brenda formave më pak të rëndësishme të pikëpamjeve jo formale, jashtë institucionale, sporadike apo formave deklarative të kundërvënies ndaj kriminalitetit.[1309]


Përmes aktiviteteve, seminareve, projekteve për ngritjen e vetëdijësimit dhe rrezikut të trafikimit me qenie njerëzore nga ana e organizatave joqeveritare dhe në anën tjetër të institucioneve arsimore (shkolla fillore, të mesme dhe të larta) si dhe familjarëve nënkupton edhe afrimin e institucioneve me qytetarër për bashkëpunim dhe koordinim si dhe do të ndikonte në preventivën ndaj kësaj dukurie negative. Edhe familja edhe shkolla kanë rolë vendimtarë në përkujdesen e përhershëm ndaj më të rinjve, forcimin e qëndrueshmërisë së tyre psike-sociale dhe zhvillimin e ndjenjës së përgjegjësisë.[1310] Masat parandaluese, që përfshijnë programe edukimi për djem dhe vajza gjatë shkollimit të tyre, të cilat theksojnë natyrën e papranueshme të diskriminimit gjinor dhe pasojat e tij shkatërrimtare, rëndësinë e barazisë gjinore dhe dinjitetin e personalitetin e çdo qenieje njerëzore[1311], do të ndikonte në parandalimin edhe të trafikimit me qenie njerëzore. Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u siguruar se fëmijët, gjatë

[1304] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.19
[1305] Xhukleski, Goce. Racaj Muhamet."Hyrje në kriminalistikë". Shkup, 2012, fq.252
[1306] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.153
[1307] Xhukleski, Goce. Racaj Muhamet."Hyrje në kriminalistikë". Shkup, 2012, fq.253
[1308] Po aty, fq.64
[1309] Po aty, fq.44
[1310] Po aty, fq.100
[1311] Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197, neni 6, paragrafi 1, pika d

arsimit fillor dhe atij të mesëm, marrin informacion për rreziqet e shfrytëzimit seksual dhe abuzimit seksual si dhe për mjetet për mbrojtjen e vetes, përshtatur me kapacitetin e tyre zhvillues.[1312]

Trajtimi preventiv përveç rritjes së ndjenjës së sigurisë tek qytetarët dhe uljes së shkallës së kriminalitetit, gjithashtu e zvogëlon edhe shpenzimet shtetërore në fushën e luftimit të kriminalitetit.[1313] Prandaj, në të ardhmen lypset një koordinim më i madh mes shumët shërbimeve të organeve dhe institucioneve shtetërore dhe sektorëve të tjerë të komunitetit, e veçmas me institucionet shëndetësore, të mbrojtjes dhe kujdesit social e invalidor, agjencive të sigurimit të jetës dhe pasurisë dhe shërbimeve e shoqatave joqeveritare apo organizatave të tjera humane.[1314] Pra, e gjith kjo do të rezultoj inkurajimin edhe të vet shoqërisë që nëse vërejnë aktivitete të ndryshme kriminale ose viktima ti paraqesin organeve kompetente që të intervenohet në kohë të duhur, pra së pari duhet guximi qytetarëve për të paraqit apo dëshmuar.

Grafikoni nr.24 Pyetje nga anketa: Nëse vëreni trafikim me qenie njerëzore a do ta paraqitni dhe dëshmoni para organeve kompetente sipas gjinisë



[1312] Konventa e Këshillit të Evropës, për "Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual", Seritë e Traktateve të Këshillit të Evropës - nr. 201, Lanzarote, 25. X. 2007, neni 6

[1313] Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. "Prevencija Kriminaliteta". Beograd, 2010, fq.38

[1314] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.163

Grafikoni paraqet mendimin e qytetarëve se nëse vërejnë një rastë të trafikimit me qenie njerëzore, trafikant apo viktimë a do të paraqesin ose dëshmojnë para organeve sipas gjinisë është ngjajshëm një situate brengosëse sepse: nuk e di tek meshkujt është 19.00% kurse tek femrat 19.33%, ndoshta meshkujt 17.25% kurse femrat 10.00%, jo meshkujt 7.17% kurse femrat 8.25% dhe po meshkujt 10.75% kurse femrat 8.25 e cila është një përqindje shumë e vogël për paraqitje ose dëshmi para organeve kompetente. Pra, mendimi i meshkujve dhe të femrave është pothuajse e ngjajshme në lidhje me paraqitjen e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore.

Tabela nr.16 Pyetje nga anketa: Nëse vëreni një rast të trafikimit me qenie njerëzore, trafikant, shfrytëzues ose viktimë në vendin tuaj a do të paraqitni dhe dëshmoni para organeve kompetente sipas nivelit të arsimit

		Nëse vëreni një rast të trafikimit me qenie njerëzore, trafikant, shfrytëzues ose viktimë në vendin tuaj a do të paraqitni dhe dëshmoni para organeve kompetente?				
		Jo	Nuk e di	Ndoshta	Po	Total
Niveli i arsimit:	Fillore	42	77	35	30	184
	Mesme	126	268	163	83	640
	Fakultet	17	113	122	83	335
	Magjistër	0	2	6	27	35
	Doktorant	0	0	1	4	5
	Të tjerë	0	0	0	1	1
Total		185	460	327	228	1200

Kjo tabelë është sipas nivelit të arsimit dhe shihet s më shumë guxim për ta paraqit ose dëshmuar një trafikim kanë me sa vijon: personat me arsim të mesëm dhe fillor janë me 83 (nga gjithsejt 640) të anketuar, pastaj me fillore me 30 (nga gjithsejt 184) të anketuar, 27 magjistra(nga gjithsejt 35), 4 doktorant(nga gjithsejt 5) dhe të tjerë. Nga kjo del se sa më e lartë është niveli i arsimit qa më të guximshëm janë personat që ta paraqesin veprën penale dhe e kundërta. Më shumë të të anketuarve janë të mendimit tek të gjithë nivelet me përgjigjen nuk e di 460, ndoshta 327, Po 228 dhe Jo 185. Edhe pse përgjigja Jo pra nuk e paraqes ose dëshmoj në krahasim me përgjigjet të tjera është më e vogël, kjo përgjigje me këtë numër është brengosëse sepse sa më pak paraqitje aq më shumë vepra të trafikimit të pazbuluara dhe e kundërta.

2. Masat preventive të institucioneve joshtetërore

Të veprosh në mënyrë preventive do të thotë të intervenojsh në mënyrë të caktuar dhe me mjete të caktuara[1315], jo vetëm nga institucionet shtetërore por edhe nga institucionet joshtetërore sidomos ato që janë adekuat për fenomenin e trafikimit me qenie njerëzore. Duke pas parasysh rrezikshmërinë e trafikimit me qenie njerëzore andaj politika e shteteve ndaj institucioneve joshtetërore duhet që të jetë më përkrahëse përmes projekteve që kanë për qëllim uljen e rrezikshmërisë së këtij fenomeni. Sfida kryesore në luftën kundër trafikimit me njerëz mbetet ngritja e kapaciteteve, identifikimi i viktimave, mbrojtja , integrimi i tyre dhe mbrojtja e fëmijëve, veçanërisht e atyre që janë viktima të trafikimit të përsëritur.[1316] Në masat preventive të institucioneve joshtetërore rëndësi të veçantë ka: përkrahja e aktiviteteve të organizatave joqeveritare dhe ngritja e vetëdijes dhe reagimit të shoqërisë kundët trafikimit.

2.1. Përkrahja e aktiviteteve të organizatave joqeveritare kundër trafikimit me qenie njerëzore

Me masat preventive të kriminalitetit nënkuptojmë aktivitetet e organeve shtetërore dhe organeve tjera të drejtuara në pengimin e dukurive negative shoqërore që prodhojnë pasoja të dëmshme e të ndaluara, duke krijuar njëherazi kushtet për luftimin e tyre[1317], sidomos përkrahjen e aktiviteteve të organizatave joqeveritare kundër trafikimit me njerëz. Në gjuhën latine, *praeventio* (*prae-venio*, *veni*, *ventum*, *praeventus*, *praevenire*) shënon përcaktimin dhe termin e kaloj, arrijë përpara, e kapërcej një dukuri të caktuar, ose siç do të mund të thuhej në bazë të mendjes së shëndoshë parandalim, mbrojtje paraprake, pengim, shmangie që më parë.[1318]

Veprimtaria dhe kontributi i organizatave joqeveritare ndaj kësaj çështjeje është i rëndësisë së veçantë, në veçanti ato të cilat ofrojnë shërbime dhe ndihma të specializuara dhe profesionale. Këto organizata joqeveritare kryejnë veprimtari dhe projekte të ndryshme arsimore-informuee kategorive më të prekura siç janë fëmitë dhe gratëdhe që llogariten si masa preventive ndaj shoqërisë kundër veprës së rrezikshme të trafikimit me qenie njerëzore. Ata mund të udhëheqin fushatë për mbështetje, të ndihmojnë gjatë përfaqësimit ligjor para tribunaleve të punësimit, të rrisin ndërgjegjësimin e punëtorëve për të drejtat e tyre, të lobojnë dhe të organizojnë për kushte më të mira të punës, dhe të sigurojnë shërbime e patjetërsueshme siç janë këshillimi, strehimi, orë për gjuhë, kujdesi mjekësor dhe trajnime për punë dhe udhëzime.[1319] Qëllimi i masave preventive apo të pengimit, gjegjësisht zbatimi i masave konkrete *ante delictum* është që veprimet eventuale kriminale dhe qëllimet e tyre të dekurajohen, gjegjësisht që të zvogëloj mundësitë për kryerjen e veprimeve dhe sjelljeve kundër ligjore dhe këto masa i quajmë masa preventive[1320] të cilët më së shumti praktikohen dhe realizohen nga organizatat joqeveritare. Kurse në anën tjetër masat që ndërmirren *post delictum* ose pas kryerjes së veprës penale kontribuojnë në zvogëlimin e rethanave dhe shkaqeve për veprime kriminale në të ardhmen dhe i dedikohet vet kryerësve të krimit dhe quhen masa represive. Përkatësisht, masat preventive mirë të paramenduara dhe të aplikuara, mund të jenë shumë më efektive se masat represive, të cilat megjithëse japin rezultate në fushën e luftimit

[1315] Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. "Prevencija Kriminaliteta". Beograd, 2010, fq.33
[1316] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.22
[1317] Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq.45
[1318] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.171
[1319] Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009, fq.43
[1320] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.323

të kriminalitetit, prapëseprap ndikojnë në rritjen e shpenzimeve të funksionimit të sistemit gjyqësor, më pas rezultojnë në rritjen e popullsisë së burgjeve si dhe në rritjen e shkallës së recidivizmit.[1321] Pra, finansimi dhe mbështetja financiare të aktiviteteve dhe projekteve të tyre kundër trafikimit me qenie njerëzore është e rëndësisë së veçantë edhe në arritjen e rezultateve preventive të organizatave joqeveritare. Andaj preferohet që burimi kryesor financiar dhe i rregullt të jetë nga buxheti shtetëror sidomos nga buxheti i insitucioneve përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni e cila do të ndikonte edhe në rritjen e aktiviteteve preventive të organizatave që nënkupton zvogëlimin e rrezikshmërisë së trafikimit me njerëz në vend.

Masat shoqërore ose socijale të cilët burimin e tyre e kanë në vet shoqëri përmes aktiviteteve të organizatave joqeveritare brenda në shoqëri përmes ligjeratave, informimit, paneleve, seminareve nga ekspertë të trafikimit me qenie njerëzore do të ndikonte që vet shoqëria të ndërrmarë masa socijale për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni. Në këtë drejtim, shërbimet e ndryshme, asociacionet, shoqatat joqeveritare, por edhe organet shtetërore botojnë: publikime, materiale informative, doracakë dhe forma të tjera të ofrimit të informacioneve për viktimat[1322]sidomos ndaj grupeve të rrezikuara dhe të prekura. Pjesëmarrja e OJQ-ve në këtë fushë, në të ardhmen, duhet të jetë e dimensionuar në përputhje me kapacitetet të cilat i kanë OJQ-të, më saktësisht me specializimin e tyre, kompetencat dhe trajnimin për të mundur të realizojnë qëllimet e theksuara ose të jenë pjesë e formave tani më të institucionalizuara të edukimit dhe të trajnimit (si faktorë të rëndësishëm në këtë fushë).[1323]

2.2. Ngritja e vetëdijes dhe reagimi i shoqërisë ndaj trafikimit me qenie njerëzore

Përveç masave preventive të përgjithshme çdo shtet, shoqëri dhe organizatë joqeveritare duhet të mendoj për masat e veçanta sidomos masa që kanë të bëjnë me ngritjen e vetëdijesë së shoqërisë e më pas edhe vet shoqëria të reagoj ndaj fenomenit të trafikimit me qenie njerëzore. Ngritja e vetëdijes dhe reagimi i shoqërisë ka një vlerë të madhe përshkak se në shumë vende po edhe në Maqedoni ekzistojnë vendbanime dhe kategori e shoqërisë e cila nuk është e vetëdishme për pasojat dhe rrezikshmërinë e kësaj dukurie dhe përmes mos pasjes së vetëdijes mungon edhe reagimi i shoqërisë ndaj saj. Shoqatat e qytetarëve kryejnë veprimtari parandaluese, arsimim dhe ngritje të vetëdijes publike midis qytetarëve, por gjithashtu janë të përfshirë në mënyrë aktive në ofrimin e ndihmës direkte për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore[1324], kështu që kjo masë preventive duhet të përforcohet edhe më shumë. Një numër të madh të popullatës së vendit nuk janë të informuar për fenomenin e krimit të organizuar sidomos të trafikimit me qenie njerëzore e cila shihet në grafikonet e mëposhtme në bazë të anketës së realizuar.


Grafikoni nr.25 Pyetje nga anketa: A jeni të informuar për krimin e organizuar sipas gjinisë

[1321] Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. "Prevencija Kriminaliteta". Beograd, 2010, fq.38


[1322] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.160

[1323] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë". Shkup, 2006, fq.14

[1324] Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. "Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе". Скопје, 2014, fq.10



Grafikoni nr.26 Pyetje nga anketa: A jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore e sipas gjinisë



Grafikoni 25 pyetja për informimin e qytetarëve për krimin e organizuar dhe grafikoni 26 pyetja për informimin për trafikimin me qenie njerëzore në bazë të moshës të anketuarve del se: në grafikonin 26 dominon përgjigja tek meshkujt se pak jam i informuar me 32.19% në krahasim nga meshkujt në grafikonin 25 për krimin e organizuar me 15.25%, kurse e kundërta është në përgjigjen pjesërisht jam i informuar ku dominon dukshëm grafikoni 25 për krimin e organizuar tek meshkujt me 33.42%, kurse tek femrat 19.60%. Njejt është edhe me përgjigjen shumë i informuar ku tek grafikoni 25 meshkujt janë me 5.42% kurse tek grafikoni 26 me 2.34%. Pra shihet se meshkujt për krimin e organizuar janë më shumë të informuar se sa për trafikimin me qenie njerëzore.

Sa i takon gjinisë femërore dominon vetëm në lidhje me përgjigjen pak jam i informuar në grafikonin 26 me 28.77% kurse në grafikonin 25 e njejta është me 15.42%, kurse përgjigja pjesërisht dominon në grafikonin 25 për krimin e organizuar me 25.92% kurse në grafikonin 26 me 15.01%. Shumë i informuar më shumë është për krimin e organizuar me 4.25% kurse për trafikimin me1.58%. nga e gjith kjo del se informimi dhe njohurit për trafikimin me qenie njerëzore nuk janë të duhura në krahasim me krimin e organizuar ku dukshëm më të informuar janë meshkujt përveç tek femrat dominon përgjigja pak jam e informuar dhe tregon se duhet të punohet në rritjen e onformimit tek gjinia femërore dhe të cilët janë më të cenuar nga trafikantët sidomos me qëllim të shfrytëzimit seksual.

Tabela nr.17 Pyetje nga anketa: A jeni të informuar për kriminalitetin e organizuar sipas moshës

		A jeni të informuar për kriminalitetin e organizuar?				
		Aspak i informuar	Pak jam i informuar	Pjesërisht	Shumë	Total
Mosha:	18 - 29	1	121	226	31	379
	30 - 51	1	146	319	55	521
	52 -61	2	90	149	28	269
	mbi 61	0	11	18	2	31
Total		4	368	712	116	1200

Tabela nr.18 Pyetje nga anketa: A jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore sipas moshës

		A jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore?				
		Aspak i informuar	Pak jam i informuar	Pjesërisht	Shumë	Total
Mosha:	18 - 29	1	231	136	11	379
	30 - 51	1	319	182	19	521
	52 -61	4	162	87	15	268
	mbi 61	1	19	10	2	32
Total		6	731	415	47	1200

Të dy tabelat japin një pasyrë në lidhje me krimin e organizuar tabela 17 dhe trafikimin me qenie njerëzore tabela 18. Nga kjo del se dominon më shumë të informuar për krimin e organizuar me 116 persona të anketuar dhe për trafikimin me shumë të informuar vetëm 47 persona. Shumë të informuar për krimin e organizuar dominon mosha 30-51 (55 anketuar nga gjithsejt 521), 18-29 (31 anketuar nga gjithsejt 379), 52-61 (28 anketuar nga gjithsejt 269), mbi 61 (2 anketuar nga gjithsejt 31). Kurse tek trafikimi me qenie njerëzore përgjigjes shumë jam të informuar 30-51 (19 nga gjithsejt 521 të anketuar), 52-61 (15 nga gjithsejt 268 të anketuar), 18-29 (11 nga gjithsejt 379). Nga kjo përfundomë se totali për krimin e organizuar prej 116 dhe për trafikimin me qenie njerëzore prej 47 nga gjithsejt 1200 të anketuarve është një situate mjaftë shqetësuese për të cilën urgjentisht duhet të mirren masa të përmirësimit të gjendjes tek gjitha moshat sidomos deri në moshën 51 në lidhje me informimin e qytetarëve për trafikimin me qenie njerëzore dhe rreziqet e kësaj vepre penale.

Shpesh viktimat e krimit dhe në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore nuk e kanë ditur se mund të bëhen viktima, pra nuk kanë pasur njohuri dhe vetëdije viktimat për dukurinë e trafikimit me qenie njerëzore dhe viktimizimit të tyre përmes mashtrimit që u janë bërë. Niveli i ulët i arsimimit të grave, veçanërisht atyre nga zonat e varfra rurale, të cilat, për shkak të perceptimeve tradicionale, nuk e vazhdojnë arsimimin e tyre, i bën ata të mos jenë të vetëdijshëm në mënyrë të pamjaftueshme për rreziqet që i ndëgjojnë kur do të vijnë në qytet dhe kur do të pranojnë punë në

kafateri, bar, si kamariere dhe/ose këngëtare etj[1325] ka të bëjë me mosvetëdijen e duhur për mashtrimin dhe pasojat e atij mashtrimi. Kontrollin mbi kriminalitetin mund ta bëjnë strukturat shoqërore të cilat ne i quajmë subjekte të represionit penal, gjegjësisht subjekte të reagimi formal apo zyrtat ndaj krimit, ndërsa në anën tjetër reagimin mund ta bëjnë edhe strukturat e shoqërisë të cilat nuk janë në pikëpamje shoqërore përgjegjëse për të kryer aktivitete të tilla, kurse masat e tilla i quajmë aspekte joformale të reagimit ndaj kriminalitetit.[1326] Pra, në disa vende jepet rëndësi dhe përkrahje të shoqërisë dhe organizatave joqeveritare për masat kundër këtij fenomeni. Disa autorë me parandalimin nënkuptojnë vetëm atë lloj të aktivitetit që ndërmerret në drejtim të pengimit të kriminalitetit nga ana e opinionit, bashkësisë lokale, organeve dhe shërbimeve në përgjithësi, (***Van, Dijk, De Waard*** 1991).[1327] Duke ekzistuar mosvetëdija tek shoqëria për këtë fenomen të rrezikshëm me kalimin e kohës do të rritet edhe më shumë viktimat e trafikimit me qenie njerëzore. Pa përkrahje përgjegjëse të publikut, në një shtet demokratik dhe të rregulluar juridikishtë nuk mund të flitet për suksesshmërinë e zbatimit të detyrave policore[1328] ku bën pjesë edhe parandalimi i trafikimit. Thirja e qytetarëve, si dhe të atyre që janë viktima dhe të tjerëve potencial të krimit të organizuar, t'i bashkohen policisë, prokurorisë dhe gjykatave të parandalimin dhe zbulimin e kryesve të veprave penale dhe të krimit të organizuar[1329] do të ishte një masë preventive shumë domethënëse dhe e skuksesshme. Prandaj, është shumë me rëndësi që organet shtetërore, shoqatat qeveritare, shoqatat joqeveritare dhe asociacionet e organizatat e tjera që merren me çështjet e viktimave, në mënyrë më të organizuar të kontribuojnë në vetëdijësimin e opinionit[1330] dhe inkurajojnë reagimin e shoqërisë ndaj trafikimit me qenie njerëzore.

Ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimi i kategorive të prekura dhe të rrezikuara, përmes masave që ndërmer aparati shtetëror, organizatat joqeveritare janë masa më të preferuara të preventivës në shumë vende evropiane të cilët duhet ti ndjek edhe vendi ynë. Fushatat ndërgjegjësuese shërbejnë dhe ndihmojnë për njohur target - grupet e fenomenit të trafikimit të personave, informimin e qytetarëve mbi ekzistencën e këtij fenomeni, si edhe për ta parandaluar atë."[1331] Përmes programeve adekuate arsimore , fushatave dhe reklamave, po punohet për të rritur ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve të involvuar, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, organizatave ekonomike, kulturore, politike dhe organizatave të tjera, si dhe qytetarëve, gjegjësisht të gjithë shoqërisë për seriozitetin dhe rrezikun e trafikimit të qenieve njerëzore.[1332] Në këtë drejtim lypset të hartohen programe dhe projekte të veçanta për ofrimin e informative, por edhe vlerësime reale për shkallën, vëllimin dhe format e viktimizimit, për faktorët e rrezikut që çojnë në viktimizim, për të drejtat dhe format e mbështetjes së viktimave dhe çështje të tjera.[1333] Në një strukturë kaq moderne, e cila është pranuar edhe si sistemi i vazhdueshëm i sotëm, legjitimiteti themelor i policisë bazohet në vendosjen e rendit publik në emër të shtetit me fuqinë që merr nga

[1325] Прирачник. "Трговија со луѓе", Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016, fq.16
[1326] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.322
[1327] Zejneli, Ismail. "Delikuenca e të miturve". Tetovë/Prishtinë, 2018, fq.172
[1328] Masleša, Ramo. "Policia dhe shoqëria". Sarajevë/Prishtinë, 2008, fq.148
[1329] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.122
[1330] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.161
[1331] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.40
[1332] Информација. "Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година". Скопје, 2009, fq.3
[1333] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.161

shoqëria dhe zbatimin e ligjeve të bazuara në shtetin e së drejtës[1334] andaj shoqëria së bashku me policinë duhet të reagojnë kundër trafikimit. Në vitin 2015, "Porta e hapur"- La Strada organizoi një fushatë për të rritur ndërgjegjësimin për trafikimin e qenieve njerëzore për shfrytëzimin e punës, me qëllim peronat që vendosen jashtë vendit për punë të informohen për rreziqet.[1335]

Për më tepër, politika e prevencionit të kriminalitetit e bashkësive shoqërore është përqendruar gjithnjë e më shumë jo vetëm në kriminalitet, në kuptim të parandalimit të kryerjes së veprave penale, por edhe në forma të ndryshme të sjelljes antisociale që është kusht për paraqitjen e kriminalitetit[1336]. Qeveria e vendit duhet të mbështes edhe më shumë financimin e aktiviteteve, kampanjave seminareve, paneleve, reklamave, shpërndarjen e materialeve reklamuese për rritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të popullatës sidomos kategorive më të prekur të shoqërisë, duke i informuar ato për dëmet që mund të pësojnë nga viktimizimi nga trafikantët si dëmet nga pasojat fizike,shëndetësore, psiqike, trauma dhe strese, çrregullime të llojeve të ndryshme, si dhe dëmet materiale. Në këtë kontekst ndikim të madh për ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë sidomos për kategorinë e cenueshme të shoqërisë rol të madh kanë mediat e eletronike dhe të shkruara sidomos viteve të fundit mediat në rrjetet sociale. Lajmet dhe informacionet në media duhet të jenë shumë profesionale me qëllim që ajo të ketë ndikim tej popullata që të marrin me seriozitet veprën e trafikimit me qenie jerëzore. Mediat duhet që veprën penale të paraqesin më detajisht si p.sh., çka është trafikimi me njerëz, cilët janë mjetet dhe metodat e mashtrimit të tyre, çka ofrojnë personave sidomos të rrinjve e jo sië ka qenë tradita tek na vetëm për zbulimin e rasteve të trafikimit. Këtë detyrë e obligon edhe Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual shtetet palë të saj si në vijim: "Çdo palë inkurajon median të ofrojë informacionin e nevojshëm lidhur me të gjithë aspektet e shfrytëzimin seksual dhe abuzimin seksual të fëmijëve, brenda kuadrit të respektimit të pavarësisë së medias dhe lirisë së shtypit."[1337] Nga kjo mund të konstatojmë se mediat në Republikën e Maqedonisë paraqesin dhe shkruajnë si kampanjë për këtë temë dhe në raste më së shumti kur ka akcion policor ku janë zbuluar viktima të trafikimit me qenie njerëzore[1338] e jo në mënyrë të regullt të informimit. Prandaj, shoqatat dhe organet shtetërore që trajtojnë çështjen e viktimave, patjetër duhet të bashkëpunojnë dhe t'u ofrojnë medieve të gjitha të dhënat lidhur me fenomenologjinë dhe etiologjinë e viktimizimit.[1339] Shfrytëzimi i mjeteve të informimit në sigmatizimin (shënjimin) të kryesve të veprave penale të krimit të organizuar (që edhe ashtu rrallë zbulohen) ose kritikën e institucioneve dhe organeve të caktuara që kanë ngecur në luftë kundër këtij lloji të krimit[1340] do të ishte në përmirësimin e efikasitetit të luftimit të kriminalitetit në përgjithësi dhe në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore.

[1334] Göksu, Turgut. Çevik, Hasan Hüseyin. Filiz, Orhan. Gül, Serdar Kenan."Guvenlik Yonetimi". Ankara, 2011, fq.41

[1335] Скриванкова, Клара. Јовевски, Лазар. Извештај. "Трговија со луѓе со цел трудова експлоатација". Совет на Европа, 2017, fq.40

[1336] Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. "Prevencija Kriminaliteta". Beograd, 2010, fq.37

[1337] Konventa e Këshillit të Evropës, për "Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual", Seritë e Traktateve të Këshillit të Evropës - nr. 201, Lanzarote, 25. X. 2007, neni 8, paragrafi 3

[1338] OSCE. Прирачник за новинари. "Трговија со луѓе и медиумите", Скопје, 2010, fq.45

[1339] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq, 162

[1340] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.122

KAPITULLI III

TRAJTIMI JURIDIKO-PENAL I VEPRËS PENALE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE NË DISA SHTETE

1. Trajtimi juridiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Kosovës

Menjëherë pas përfundimit të luftës zhvillimi i krimit të organizuar sidomos të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë shumë shpejt filloj të lulëzoj dhe të rritet përshkak se legjislacioni i adoptuar nga administrata e UNMIK-ut nuk parashihte veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, por parashiheshte vetëm prostitucionin si kundërvajtje e cila direkt ka ndikuar edhe në rritjen e viktimave të trafikimit sidomos për qëllim të shfrytëzimit për prostitucion. Shprehja "prostitucion" nënkupton ofrimin ose dhënien e shërbimeve seksuale në këmbim të të hollave, mallrave ose shërbimeve, përfshirë, por pa u kufizuar në kryerjen e një obligimi për të paguar ose ofrimin e mallrave apo shërbimeve, përfshirë shërbimet seksuale falas apo me zbritje.[1341] Shumica e rasteve janë të trafikuara me qëllim të shfrytëzimit seksual, mirëpo çdo vit e më shumë përqëndrimi i institucioneve të Republikës së Kosovës është fokusuar edhe në identifikimin e formave të ndryshme të trafikimit, e sidomos ato që lidhen me shfrytëzimin e fëmijëve për lypësi dhe punë të detyruar.[1342]

Ngjajshëm me Maqedoninë, edhe në Kosovë prejardhja e viktimave kanë qenë shtetase të rajonit siç janë Bullgaria, Shqipëria, Moldavia, Rumania të cilët shërbenin klientëve, por edhe viktimat e brendshëm janë në një numër të madh. Klientët që ishin vizitor të objekteve ku punonin vajza të reja viktima të trafikimit me qenie njerëzore përveç shtetasve të vet Kosovar ishin edhe ndërkombëtarët të cilët ishin duke punuar në klube nate pothuajse në tërë territorin e Kosovës ku numri i tyre ishte shumë i madh sidomos në vitet menjëheë pas luftës. *Kushdo që me dijeni ofron lokalin, qoftë si pronar i lokalit, qiradhënës, qiramarrës, shfrytëzues ose person përgjegjës, personit tjetër për qëllim të prostitucionit ose mundësimit të prostitucionit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*[1343] Pra, Kodi penal i Kosovës për disa çështje e ka të paraparë në mënyrë më të zgjeruar inkriminimin e disa fenomeneve siç është fenomeni i dhënies së lokaleve me qëllim të prostitucionit ose mundësimit të saj qoft si qiradhënës, pronar lokali apo shfrytëzues i lokalit apo përgjegjës në lokal dhe parasheh dënimin në të holla dhe burg deri 3 vjet. *Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.*[1344] Ky paragraf i të njejtit nen parasheh ofrimin e lokalit për prostitucion si rrethanë rënduese nëse ai lokal është afër shkollave ose mjedisi tjetër

[1341] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013, neni 228, paragrafi 8

[1342] https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/47/STRATEGJIA%20KOMB%C3%8BTARE%20KUND%C3%8BR%20TRAFIKIMIT%20ME%20NJER%C3%8BZ%20N%C3%8B%20KOSOV%C3%8B%202015-2019.pdf, të datës 16.09.2020, ora 20:26

[1343] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013, neni 242, paragrafi 1

[1344] Po aty, paragrafi 2

për fëmijë në kuadër pre 350 metrash dhe dënohet më rëndë, me gjobë dhe denim me burg prej 6 deri 5 vjet.

Duke ditur se trafikimi me qenie njerëzore përveç individit si kryerës shpesh ose në të shumtën e rasteve paraqiten grupe kriminale të krimit të organizuar për këtë shkak edhe kodi penal i Kosovës e parasheh pjesëmarrjen ose organizimin e grupit kriminal për kryerjen e veprimtarive kriminale si dhe të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandës me migrant. Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore përcaktohet me anë të Kushtetutës së Kosovës, Kodit Penal si dhe Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.[1345] Duke u bazuar në rritjen e trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë, më datën 19.01.2001 administrata e UNMIK-ut përmes një rregullore të veçantë nr: 2001/4 e parashohi veprën e trafikimit me qenie njerëzore si vepër penale e cila më vonë u parapa edhe në Kodin e përkohshëm penal të Kosovës në vitin 2004, dhe më pas sidomos në vitin 2013 e avancoi sqarimin më të detajuar të veprës penale duke u konsoliduar me aktet ndërkombëtare sidomos me Konventën ndërkombëtare të OKB-së dhe dy protokolet e saj për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar e në veçanti të trafikimit me qenie njerëzore.

Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar parashihet në nenin 283, paragrafi 1 të Kodit penal të Republikës së Kosovës dhe ate me sa vijon:

Neni 283 Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar

1. Kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtaritë kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.
2. Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.
3. Kur veprimtaritë e grupit kriminal të organizuar të parapara në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni rezultojnë në vdekje, kryesi dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet ose me burgim të përjetshëm.
4. Gjykata mund të zbusë dënimin e anëtarit të grupit kriminal të organizuar i cili, para se grupi kriminal i organizuar të ketë kryer veprën penale, raporton në polici ose prokurori, ekzistimin, formacionin dhe jep informata për grupin kriminal të organizuar në detaje të mjaftueshme për të mundësuar arrestimin apo ndjekjen e grupit të tillë.[1346]

Pra, paragrafi 1 parasheh dënim të lartë me burg dhe në të holla për personat aktiv me dashje në veprimtari kriminale të grupit për veprat penale që është paraparë denim me burg së paku 4 vjet. Në krahasim rregullimin ligjor në Kodin e Maqedonisë është më ndryshe dhe në nenin 418-v, paragrafi 2 përshkruhet dënim për pjesëmarrje në grup, bandë ose shoqatë dhe parasheh vetëm dënim me burg së paku 1 vit dhe është shumë më e ulët. Paragrafi 2 paresheh dënim me burg dhe në të holla për organizatorin apo themeluesin, kurse në Kodin e Maqedonisë parashihet vetëm denim me burg dhe ate së paku 8 vite e cila është më e ulët në krahasim me këtë paragraf. Paragrafi 3 paraqet dallimin kryesor me Kodin penal të Maqedonisë, sepse ky paragraf në Maqedoni nuk

[1345] Analizë. "Lufta kundër trafikimit me njerëz", Kërkesat e BE-së për Kosovën, Kipred, Prishtinë, nr.2/15, 2015, fq.1

[1346] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013, neni 283

ekziston dhe në vend të kësaj parashihet veprimi i paragrafi 1 dhe 2 nëse kryhet ndaj të miturit. Ky paragraph parasheh edhe dënimin më të rëndë të paraparë sipas Kodit penal të Kosovës pra burgimin e përjetshëm. Paragrafi 4 në Kodin e Maqedonisë nuk ekziston aspak dhe me këtë parashihet si rrethanë lehtësuese për anëtarin e grupit para veprës penale raporton organeve përgjegjëse, e cila mund të shihet edhe si inkurajim anëtarëve të tillë të zbulojnë grupet e tilla. Dihet se vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore i atakon liritë dhe të drejtat themelore të njeriut duke u bazuar në lirinë e lëvizjes, kushtet nën një rregjim të njejtë me skllavërinë dhe rrobërinë ku viktima gjatë gjithë kohës derisa është nën kontrollin e trafikantit liritë dhe drejtat i ka të kufizuar ashtu si i konvenon trafikantit.

Në këtë drejtim kryerësit e veprës së skllavërisë për personat që janë në kushte të ngjajshme me trafikimin e parasheh Kosova në Kodin penal të saj si vepër penale.

Neni 169 Skllavëria, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe puna e detyruar

1. Kushdo që në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mban, ruan, vendos, blen apo shet një person tjetër në skllavëri, në kushte të ngjashme me skllavërinë, robëri ose në punë të detyruar, që përfshin por nuk kufizohet në mbajtjen e personit në pronësi, mohimin e fryteve të punës së tij, shtrëngimin e personit për të punuar ose mohimin e lirisë së një personi për të ndryshuar statusin e tij apo të kushteve të punës, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.
2. Kushdo që në shkelje të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me qëllim të kryerjes së veprave nga paragrafi 1. i këtij neni shtyt një person tjetër të heqë dorë nga liria e tij ose ndërmjetëson në shitjen apo blerjen e një personi tjetër, dënohet me dënimin e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet kundër personit me të cilin kryesi është në marrëdhënie familjare, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.
4. Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj fëmijës, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
5. Kur vepra nga ky nen kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e detyrës së tij, kryesi dënohet me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet për veprën nga paragrafët 1.-3.; ose me burgim prej pesë (5) deri në njëzet (20) vjet për veprën nga paragrafi 4. i këtij neni.

Dallimi i dënimit me Kodin penal të Maqedonisë për këtë vepër penale sipas këtij paragrafi të nenit 169 qëndron në dënimin minimal ku sipas Kodit të Maqedonisë minimum është 1 vjet burg kurse në Kosovë 2 vjet sipas paragrafit 1 të nenit 169. Paragrafi 2 parasheh veprimin e shtytjes me qëllim të realizimit të krimit dhe dënohet prej 2 deri 10 vjet burg njejt sin ë paragrafin e parë, kurse në Maqedoni parashihet veprimi i transportimit dhe dënimi është prej 6 muajsh deri 5 vjet burg. Paragrafi 3 Maqedonia nuk e ka paraparë dhe sipas kësaj keqpërdorimi i marëdhënieve familjare për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 1 dhe 2 do të dënohet me burg 3 deri 10 vjet ku minimumi i kësaj është më e madhe. Sipas paragrafit 4 në krahasim me vendin tonë minimum këtu është më e vogël kurse tek na minimum është pesë vite pa mos e paraparë maksimumin e dënimit. Kryerja e veprës penale nga nenet e mëparshme paragrafi 5 parasheh dënim edhe për kryerësit zyrtar dhe ate më dënime të larta sidomos për fëmijët dënimi është prej 5 deri 20 vjet kurse për të rriturit prej 5 deri 12 vjet dhe ky paragraf nuk ekziston në kodin tonë penal. Migracioni si shumë vende po ashtu është e pranishme edhe në Kosovë sidomos aspiratat e tyre janë vendet me ekonomi të zhvilluar në Evropën perëndimore e cila është një shqetësim i vazhdueshëm për Kosovën, por është i shprehur edhe migracioni i brendshëm. Gjatë viteve të fundit, vërehet lëvizje e popullsisë nga zonat rurale në zonat urbane, sidomos në qendrat e mëdha[1347], apo siç njihet me emrin

[1347] https://ask.rks-gov.net/media/2004/atllas-statistikor-2008.pdf, të datës 15.09.2020, ora 16:34

migracioni nacional apo i brendshëm. Me migrimin e popullatës së moshës së re ndikon në rënien e kategorsië së popullsisë aktive të cilët fuqinë e tyre punëtore ose intelektuale e japin në shtetet tjera e jo në vendin e vet. Emigrantët kosovar, ngjajshëm si në Maqedoni janë persona me paga të ulëta, ku dominon varfëria dhe skamja etj, të cilët mund të jenë nën sulmin e kontrabanduesve. Siç e kemi përmendur se shpesh viktimat e kontrabandës me migrantë pas arritjes në shtetin e origjinës gjenden shumë afër viktimizimit nga vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore, andaj edhe studimi ligjor i kontrabandës me migrantë ka rëndësi. Përshkak të afërsisë së këtyre dy veprave penale dhe shpesh në praktikë vepra penale e kontrabandës me migrantë kalon në veprën e trafikimit me qenie njerëzore. Prandaj, institucionet e Republikës së Kosovës janë përkushtuar të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme pozitive për të garantuar këtë vlerë në mënyrë efektive dhe përveç kësaj, të mbrojnë popullin e Kosovës nga fenomeni negativ i trafikimit të njerëzve dhe njëkohësisht të mbrojnë dhe të promovojnë të drejtat e njeriut për të gjitha viktimat e trafikimit, pa marrë parasysh racën, kombësinë ose gjininë.[1348]

Kodi penal i Kosovës e ka të paraparë si vepër penale kontrabandën me migrantë në nenin 170 të saj. *Kushdo që merret me kontrabandim të migrantëve dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri dhjetë (10) vjet.*[1349] Ky paragraf në krahasim me vendin tone ka dallim të madh në sqarimin e veprës së kontrabandës ku vendi në e sqaron më detajisht si p.sh., mjetet e kryerjes dhe mënyrën e kryrjes, kurse sa i takon dënimit te kan ekziston vetëm minimum prej 4 viteve duke mos e paraparë maksimumin si në Kodin penal të Kosovës. *Kushdo që me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore, prodhon, furnizon, siguron ose posedon dokument të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të kontrabandimit me migrantë, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet*.[1350] Falsifikimi, pra kush e siguron prodhimin, furnizimin ose posedon dokument të rrejshëm identifikimi dënohet maksimum me burg deri 5 vjet ose në të holla, kurse në vendin tonë kjo çështje parashihet në kuadër të paragrafit 1 të nenit 418-b ku dënimi ishteme burg së paku 4 vjet.

"Me da të 19.03.2011 rreth orës 04:00 me veturën "Pollo Klasik" me shenja të regjistrimit TE 910 CL, në pronësi të H. D.-t në rr."Lublanska" tek Arabati Baba Teqe në Tetovë e ka bartur emigrantetn M. Xh., shtetase e Republikës së Shqipërisë, e cila paraprakisht e ka kaluar kufirin me Maqedoninë në mënyrë ilegale, me qëllim që të punojë në RM edhe përkundër asaj se ka pasur ndales për hyrje në RM deri me date 26.01.2013, ndërsa kur janë ndaluar nga patrulla e rregullt e policisë së komunikacionit me të cilën ka udhëhequr dëshmitari P. Gj., i akuzuari emigranten e ka prezentuar si bashkëshorte të tij të cilën është duke e dërguar te mjeku dhe për identifikimin e saj iu ka dhënë letërnjoftim për person të huaj, në emër të M. I.."[1351]

Vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore si vepër më e rrezikshme në krahasim me kontrabandën me migrantë rregullohet në nenin 171 me titull trafikimi me njerëz.

Neni 171 Trafikimi me njerëz

1. Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

[1348] https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/47/STRATEGJIA%20KOMB%C3%8BTARE%20KUND%C3%8BR%20TRAFIKIMIT%20ME%20NJER%C3%8BZ%20N%C3%8B%20KOSOV%C3%8B%202015-2019.pdf, të datës 15.09.2020, ora 17:19

[1349] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013, neni 170, paragrafi 1

[1350] Po aty, paragrafi 2

[1351] Aktgjykim nr.42 të datës 06.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup, fq.1

2. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet në një perimetër prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët ose kur vepra kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjet, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.
3. Kushdo që organizon një grup personash për të kryer vepër nga paragrafi 1. i këtij neni dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej shtatë (7) deri në njëzet (20) vjet.
4. Nëse vepra penale nga ky nen kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me:

4.1. gjobë dhe burgim prej pesë (5) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet për vepër penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni;

4.2. gjobë dhe burgim së paku dhjetë (10) vjet për vepër penale nga paragrafi 3. i këtij neni.

5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1.-4. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.[1352]

Është një dallim nga Maqedonia dhe shumë vende të tjera të rajonit sepse këtu vihet në pah institucioni i arsimit, pra shkolla dhe mosha e viktimës, pra nën moshën 18 vjet dhe dënimi parashihet minimum 3 dhe maksimum 15 vjet. Kurse në vendin tone parashihet me nen të veçantë që nga viti 2008 trafikimi i personave të mitur dhe fëmijëve ku dënimi është së paku 8 vite duke mos e paraparë maksimumin e dënimit.

Paragrafi 3 dallohet nga Kodi ynë që nuk e parasheh në kuadër të trafikimit me qenie njerëzore por tek na parashihet me nen të veçantë 418-v, paragrafi 1 për personat organizator të grupit për kryerjen e veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore, dhe vepra tjera penale të llojit të organizuar.

Personi zyrtar kryerës i trafikimit me qenie njerëzore në Maqedoni dënohet me së paku 5 vjet kurse në Kosovë nëse vepra kryhet nga organizatori atëherë dënohet së paku me burg prej 10 vjet përndryshe dënimi është prej 5 deri 15 vjet burg e paraparë në paragrafi 4. Në paragrafin 5 kemi një dallim tjetër dhe ky paragraf në Maqedoni nuk parashihet. Kodi jonë parasheh regullim në lidhje me dokumentet e identifikimit të viktimave sidomos fshehjen e tyre që e parashohin në nenin e njejt ku përshkruhet trafikimi me qenie njerëzore, dhe nëse vepra e njejt kryhet nga personi zyrtar atëherë dënimi është më i madh edhe në minimum ashtu edhe në maksimum për dallim nga kryerësit jo zyrtar. Në Kosovë kjo është e rregulluar me nen të veçantë dhe ate neni 172, me titull fshehja e dokumenteve të identifikimit të skllavërisë ose trafikimit me njerëz.

Kushdo që fsheh dokumentet personale të identifikimit apo pasaportën e personit për të cilin e din se është viktimë e veprës penale të paraparë në nenin 169 dhe 171 të këtij Kodi, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.[1353]

Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar me keqpërdorimin e pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në shtatë (7) vjet.[1354]

Konsiderohet se gjykatat shqiptojnë dënime të lehta dhe minimale ndaj autorëve të krimit edhe

[1352] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013, neni 171

[1353] Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013, neni 172, paragrafi 1

[1354] Po aty, paragrafi 2

përkundër parashikimeve të ligjit kundër trafikimit me qenie njerëzore.[1355] Luftimi i trafikimit me qenie njerëzore vazhdon të jetë një ndër kushtet e Bashkimit Evropian (BE) për Kosovën.[1356] Poashtu, përveç Kodit të përmendur, varësisht prej formave të paraqitjes së kriminalitetit të organizuar, në Republikën e Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të formave të ndryshme të kriminalitetit të organizuar janë miratuar ligje të veçanta dhe strategji kombëtare si: Ligji kundër korrupsionit nr.2004/34, Ligji për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit nr.03/L-196, Ligjin për armët nr.03/L-143, Ligji për parandalimin edhe luftimin e krimit kibernetik nr.03/L-166, si dhe Strategjia shtetërore të Republikës së Kosovës për luftimin e krimit të organizuar, Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit, Strategjia nacionale dhe plani i veprimit kundër trafikimit me qenie njerëzore etj.[1357] Ligji për Azilin, Ligji për të Huajt, Ligji për Kontrollin e Kufirit, Ligji për Shtetësinë e Kosovës, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Strategjinë për Luftimin e Trafikimit me Njerëz, si dhe janë plotësuar dhe ndryshuar një numër i ligjeve që kanë për qëllim ndërrmarrjen e masave për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni shumë negativ. Ligji nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit është miratuar në shtator të viti 2013 nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe është një rrisi në rajon sepse shumicës së shteteve u mongon ligj i veçantë e cila më detajisht e rregullon luftimin dhe parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të saj. Trafikimi me njerëz – rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthimit, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit.[1358] Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i dispozitave juridike përmes të cilave, autoriteteve kompetente vendore iu jepen të drejta, obligime dhe përgjegjësi, për parandalimin dhe luftimin trafikimit me njerëz në të gjitha format e tij, mbrojtjen e viktimave të trafikuara, përfshirë sigurimin e të drejtave, si ndihmë juridike, ndihmë mjekësore, mbështetje psiko- sociale, sigurimi i kompensimit dhe të drejtave të tjera, për të gjithë personat që supozohen të jenë ose që identifikohen si të trafikuar, pavarësisht moshës, gjinisë, fesë apo kombësisë së tyre, përmes një qasje të bazuar në të drejta të njeriut dhe me theks të veçantë të drejtat e fëmijëve, që ka ndjeshmëri për aspektet kulturore dhe gjinore, në përputhje të plotë me instrumentet dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të parandalimit dhe luftimit të trafikimi më njerëz, dhe sigurimit të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave të trafikuara.[1359]


2. Trajtimi jurudiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Shqipërisë

Si çdo vend në rajon, ashtu edhe Shqipëria është i prekur nga aktivitetet dhe veprimtaritë e paligjshme dhe ilegale të krimit të organizuar sidomos të veprës së rrezikshme të trafikimit me qenie njerëzore. Në fillim të viteve 1990, me ndryshimin e sistemit politik, social, ekonomik në

[1355] Analizë. "Lufta kundër trafikimit me njerëz", Kërkesat e BE-së për Kosovën, Kipred, Prishtinë, nr.2/15, 2015, fq.2
[1356] Po aty, fq.1
[1357] Vula.G, Veton. "Kriminaliteti i organizuar". Prishtinë, 2013, fq.52
[1358] Ligji Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 34 / 4 shtator 2013, Prishtinë, neni 3, paragrafi 1, pika 1.1.
[1359] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.22

Shqipëri, bashkë me emigrimin dhe joshjen për botën e pasur perëndimore, u shfaq dhe fenomeni i trafikut të qenieve njerezore.[1360] Paralelisht me krimin e organizuar dhe trafikut me njerëz ky vend u prek edhe nga migrimet e mëdha dhe në kuadër të saj edhe migrimet e parregullta dhe ilegale drejt shteteve të Evropës së zhvilluar. Problemet e Shqipërisë në ketë periudhë tranzicioni kanë sjelle lëvizje të parregullta të popullsisë brenda dhe jashtë vendit, pamundësi punësimi të përshtatshme për të rinjtë, braktisje të arsimit, etj.[1361] "Sipas të dhënave të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, vendet e destinacionit më të preferuara për emigrantët shqiptarë kanë qenë Italia dhe Greqia, të ndjekura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Mbretëria e Bashkuar (MB), dhe Gjermania. Italia është vendi i destinacionit më i preferuar me 47 përqind të emigrantëve, i ndjekur nga Greqia me 43 përqind të emigrantëve shqiptarë, dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) vijnë si vend destinacioni i tretë."[1362] Në vijim do të paraqesim migracionin neto në Republikën e Shqipërisë sipas viteve

Grafikoni nr.27[1363] Migracioni neto në Shqipëri



Nga grafikoni nr.27 shihet se në Shqipëri gjatë vitit 2014 nga dalja e shtetasve jashta dhe ardha e shtetasve shqiptar apo emigrimi dhe imigrimi, migracioni neto është -21.785 shtetas që e zvogëlon edhe numrin e përgjithshëm të vendit, kurse migracioni neto gjatë vitit 2015 është -20.600, numër më pak në krahasim me vitin 2014. Edhe emigrimi në vitin 2014 ka qenë më shumë se në vitin 2015 në dallim prej 5082 shtetasve shqipëtar.

Emigracioni në Shqipëri ka pasur ndikim të madh në rritjen e kontrabanëds me migrantë dhe të trafikimit me qenie njerëzore sidomos si vend origjine të viktimave të cilët largohen për shkaqe të ndryshme nga vendi. Tre faktorët kryesorë tërheqës të emigracionit kanë qenë: Papunësia (71.8%) e ndjekur nga mundësi më të mira pune 67.7% dhe mundësi për të ardhura më të larta me 64.7%.[1364] Edhe Shqipëria si shume vende tjera është i prekur nga migracioni ndërkombëtar e cila shihet edhe në grafikonin 28.

Grafikoni nr.28 Numri i përgjithshëm i migrantëve ndërkombëtar në Republikën e Shqipërisë


[1360] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.9

[1361] https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/RAPORT_VLERESIMI_2005-2007.pdf, të datës 08.09.2020, ora 14:54

[1362] Raport. "Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri 2013". Tiranë, 2013, Fq.9

[1363] http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2, të datës 16.09.2020, ora 22:16

[1364] Raport. "Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri 2013". Tiranë, 2013, fq.36



Grafikoni paraqet numrin e përgjithshëm të migrantëve ndërkombëtar gjatë periudhës 2005 deri 2015 dhe ate më shumë është i shprehur në vitin 2005 me 64.1 mijë migrime ndërkombëtare, pastaj shënon rënie në vitin 2010 me 52.8 si dhe në vitin 2015 prap një rënie të vogëm kemi pra në 52 mijë.

Nga linjat e trafikimit me qenie njerëzore shihet se Shqipëria si shtet i origjinës si destinacion e kanë vendet evropiane të cilët kanë ekonomi stabile dhe të zhvilluar andaj si shtete të destinacionit paraqitet Anglia Zvicra, Gjermani, Norvegjia dhe Holanda. Është e rëndësishme të përmendet se përpos tregtisë ndërkombëtare me njerëz ekziston edhe tregtia e brendshme me njerëz, e cila në masë të madhe është margjinalizuar nga ana e bashkësisë ndërkombëtare dhe shumë rrallë i kushtohet kujdes.[1365] Trafikimi i brendshëm tregon një tendencë në rritje sidomos në qendrat e reja urbane (si pasojë e migrimit të brendshëm) dhe në kuadër të migrimit sezonal në zonat turistike (trafikimi i grave për shfrytëzim prostitucioni dhe trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe/ose lypje).[1366]

Për shkak se vepra e trafikimi me qenie njerëzore në të shumtën e rasteve realizohet përmes grupeve të krimit të organizuar edhe Kodi penal i Republikës së Shqipërisë e përcakton organizatën kriminale dhe grupin e strukturuar kriminal, dhe ate si vijon:

Neni 333 Organizata kriminale

1.Krijimi, organizimi ose drejtimi i organizatave kriminale dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2.Pjesëmarrja në një organizatë kriminale dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

3.Nëse organizata kriminale është e armatosur dhe pjesëtarët e saj zotërojnë armë dhe lëndë shpërthyese për qëllime të përmbushjes së veprimtarisë së saj kriminale, edhe nëse ato janë të fshehura ose të mbajtura në vende të veçanta, dënimi me burgim shtohet me një të tretën.

4.Kur veprimtaritë ekonomike, të ndërmarra ose të kontrolluara nga pjesëtarë të organizatës kriminale, financohen tërësisht ose pjesërisht me produkte të veprave penale, masa e dënimit, sipas paragrafëve të sipërpërmendur në këtë nen, shtohet me një të tretën deri në një të dytën e tij.[1367]

Paragrafi 1 për dallim nga Maqedonia që parasheh minimum 8 vjet burg pa maksimum, Shqipëria e ka parapa minimum 5 vjet deri në maksimum 15 vjet, kurse shtjellimi i paragrafit në vendin tonë është si vijon: organizatori dënohet për veprat nga nenet 418-a, 418-b, 418-g dhe 419-d. Me paragrafin 2 ekziston dallimi i madh në pjesën e sasisë së dënimit ku Maqedonia e ka paraparë së

[1365] Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë "Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike". Tetovë, 2009, fq.144

[1366] Strategjia. "Lufta kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.9

[1367] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 333

paku 1 vjet burgim, kurse Shqipëria prej 4 deri 8 vjet burgim për anëtarësim në organizatë kriminale. Paragrafi 3 nuk e parasheh Kodi penal i Maqedonisë, përmes së cilës Shqipëria e parasheh nëse grupi kriminal është i armatosur dhe ka rrezikshmëri më të lartë dhe normale është edhe dënimi më i lartë. Me paragrafin 4 parashihet finansimi i veprimtarive ekonomike nga mjetet e fituara përmes veprave kriminale dhe dënimit kryesor i shtohet me një të tretën deri një të dytën e tij. *Krijimi, organizimi ose drejtimi i një grupi të strukturuar kriminal për kyerjen e veprave penale dënohen me burgim nga tre deri në tetë vjet.*[1368] Krijimi dhe organizimi si dhe udhëheqja me grupin e strukturuar Shqipëria parasheh dënim më të lartë në krahasim prej anëtarëve të tjerë. *Pjesëmarrja në grupin e strukturuar kriminal dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*[1369] *Kryerja e veprave penale nga pjesëtarë të organizatës kriminale dhe të grupit të strukturuar kriminal dënohet sipas dispozitave penale përkatëse, duke i shtuar dënimit për veprën penale të kryer edhe pesë vjet burgim, si dhe gjobën në masën një të tretën, por pa kaluar kufirin maksimal të dënimit me burgim.*[1370] Pjesëmarrja në grupin e strukturuar dhe kryerja e krimeve nga këto grupe të strukturuara kriminale parashihet dënimi me burg dhe dënimi në të holla duke mar parasysh rrezikshmërinë e saj.

"Kohët e fundit është rritur numri i rasteve të femrave me shtetësi shqiptare të dërguara në Kosovë, me qëllim shfrytëzimi seksual. Nga vendimet gjyqësore të shqyrtuara dhe deklarimet e ekspertëve rezulton se femra të shtetësisë shqiptare dërgohen në Kosovë me premtime pune si kameriere, valltare dhe këngëtare në lokale me muzikë tallava, në qytete si Prizren, Gjilan, Prishtinë etj."[1371] Në rastin konkret **trafikimi me qenie njerëzore** parashihet si vepër e veçantë penale me të cilën cenohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut të cilën Shqipëria e ka të garantuar me Kushtetut, aktet ligjore si dhe aktet ndërkombëtare.

Neni 110/a Trafikimi i personave të rritur

1. Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

2. Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen
me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

4.Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell

[1368] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 333/a, paragrafi 1

[1369] Po aty, paragrafi 2

[1370] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 334, paragrafi 1

[1371] Studim. "Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,". Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015, fq.55

pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.
5.Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.
6.Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.[1372]
Ky nen sidomos paragrafi 1 inkriminimi dhe shtjellimi i së cilës është shumë i përafërt me Kodin penal të Maqedonisë dallohet në përcaktimin e sanksionit penal dhe ate minimum 8 deri në maksimum 15 vjet, derisa vendi ynë e ka së paku 4 vjet burg. Destinacionet kryesore përfshijnë shtete si Kosovë, Zvicër, Austri, Francë, Gjermani, Belgjikë dhe Mbretëri e Bashkuar.[1373] Për dallim nga legjislacionet penale të rajonit Shqipëria në Kodin penal të saj dallon kur trafikimi bëhet ndaj gjinisë femërore dënimi është më i lartë se sa kur viktima është mashkull. Paragrafi 2 është një dallim i madh me Kodin e Maqedonisë ku ky paragraf nuk parashihet, kurse në Shqipëri parashihet veç nëse trafikimi realizohet ndaj gjinisë femërore e cila duhet të mirret si shembull sepse gjinia femërore llogaritet si kategori më e cenueshme pas fëmijëve dhe të miturve. Organizimi apo financimi i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore gjihashtu parashihet në një paragraf të veçantë të nenit 110/a me titullin trafikimi i personave të rritur. Në nenin e njejt po në paragrafet që pësojnë kemi një rritje të dënimit varësisht nga mënyra e kryerjes dhe veçori tjera të kryerjes së trafikimit me qenie njerëzore e cila në vendin tonë nuk parashihet në kuadër të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore. Në paragrafin 4 vërehet një veçori tjetër e cila është në kuadër të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore në Kodin penal shqiptar e cila nuk ekziston në disa vende të rajonit e parasheh një dënim maksimal nëse nga vepra viktima pëson vdekjen. Kodi penal shqiptar parasheh edhe kur vepra penale në fjalë kryhet me ndihmën e funskionit që ushtron në organ shtetëror si në paragrafin e 6. Me përgatitjen e Strategjisë Kombëtare në luftë Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore të Qeverisë Shqiptare dhe me forcimin e punës së autoriteteve policore, trafiku i fëmijeve nuk realizohet më nëpërmjet rrugëve ilegale (si psh transporti nëpërmjet skafeve), por ka marrë trajta më ligjore[1374], si p.sh. kalimi i kufirit shtetëror sipas procedurave të bazuara në ligj, paraprakisht duke siguruar viza dhe dokumentacion të kompletuar të cilat dë të shfrytëzohen pas arritjes në destinacionin e paraparë.

Grafikoni nr.29[1375] Numri i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas viteve

[1372] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 110/a
[1373] Studim. "Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,". Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015, fq.55
[1374] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.7
[1375] https://migrationdataportal.org/?i=TotalVictims&t=2015&cm49=8, të datës 19.08.2019, ora 21:09



Lëvizja e numrit të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore në Shqipëri prej vitit 2010 deri 2013 është interesante një rënie drastike në vitin 2011 me vetëm 4 vepra penale kurse më shumë është në vitin 2010 me 97 vepra, pastaj viti 2013 me 95 vepra dhe në vitin 2012 kemi 92 vepra penale të trafikimit me qenie njerëzore. Pra, në Shqipëri sasia e veprave penale për vitet në grafikonin e paraqitur shihet se është numër i madh dhe organet kompetente duhet ti përforcojnë politika kriminale për luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie negative.

Fenomeni i trafikut të fëmijëve në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit është kthyer në një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri[1376], dhe kjo problematikë vazhdon sot e kësaj dite në vend por edhe në tërë botën ku viktimave i kufizohet ose heqet liria e saj e lëvizjes.

Neni 128/b Trafikimi i të miturve

1.Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
2.Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
3.Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.
4.Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.
5.Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.[1377]

Edhe tek tek trafikimi i të miturve parashihet dënim për organizatorin, ai që finanson dhe drejtuesin e aktit të trafikimit. Paragrafi 3 karakterizohet me mënyrën e relizimit të trafikimit ku viktima pëson dëmtime fizike dhe psiqike përmes abuzimit ose keqtrajtimit të viktimës për arritjen e qëllimit të trafikantit dhe organizatës kriminale. Në paragrafin 4 sasia e dënimit është e ngjajshme si në nenin 110/a, paragrafi 5 pra nuk ka dënim më shumë edhe pse viktima është fëmijë. Këtu parashihet edhe nëse vepra është kryer nga ana e personit që e shfrytëzon funksionin shtetëror ose publik për të kryer veprën penale ndaj të miturit.

Burimet e rekrutimit të fëmijëve për trafikim janë:

- Nga familje të divorcuara dhe me mungesë të kujdesit familjar.

[1376] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.7
[1377] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 128/b,

- Nga familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike.
- Nga familje fshatare që shpresojnë në ndihmën e fëmijëve.
- Nga fëmijë të mbetur jetime dhe pa kujdes.
- Nga familje që prindërit u janë larguar për punësim jashtë shtetit.
- Fëmijë që kanë braktisur shkollën dhe punojnë si lypësa, shitës në rrugë apo me veprimtari tjetër të kundërligjshme edhe në Shqipëri.[1378]

Në lidhje me rregullimin juridiko-penal të çështjes së trafikimit me qenie njerëzore në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë në nenin 110/c parashihet edhe rrethanat apo situatat që e lehtësojnë kryerjen e trafikimit sidomos falsifikimi e dokumenteve të identifikimi të cilët në të shumtën e rasteve përdorin në kalimet kufitare, për të cilën Maqedonia parasheh dënim së paku 4 vjet burgim.

Neni 110/c Veprimet që lehtësojnë trafikimin

1.Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

2.Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

3.Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet.

Paragrafi i dytë që pëson në nenin 100/c parasheh dënim më të rëndë nëse: kemi bashkëpuntor në kryerjen e veprimit ose bashkëkryerës, nëse vepra kryhet ndaj të miturit pra mundëson trafikantit trafikimin e të miturit si dhe nëse veprimi i njejt realizohet nga personi i cili e ka për detyrë të lëshojë dokumentin e identitetit dhe ate më shumë se një herë. Paragrafi i tretë parasheh kur nga vepra penale pësohet pasoja e rëndë të cilët në praktikë shpesh janë të karakterit fizik, psiqik, moral dhe material.[1379]

Legjislacioni shqiptar parashikon si krim të veçantë "trafikun e njerëzve" të shprehur në trafikun e femrave për prostitucion, trafikun e fëmijëve, si dhe vepra penale të tjera që lidhen me trafikun e njerëzve siç është fshehja ose ndërrimi me dashje i fëmijës, kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror, dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit, dënimet për organizimin e prostitucionit dhe aktiviteteve të lidhura me të.[1380]

Grafikoni nr.30: Policia e shtetit, për vitin 2015, ka evidentuar 80 vepra penale për Trafikimin me persona:


- 17 çështje për "Trafikimi i të miturve" neni 128/b i Kodit Penal;
- 63 çështje për "Trafikimi i personave të rritur" neni 110/a i Kodit Penal.[1381]

[1378] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.10

[1379] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 110 /c


[1380] Raport. "Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri". Tiranë, 2003, fq.16

[1381] https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Raporti-Vjetor-2015.pdf, të datës 17.09.2020, ora 11:26



Nga grafikoni nr.30 del se rastet e evidentuara dhe autorët janë me numër përafërsisht të njejtë kurse të arrestuar në karahasim me të evidentuarit është shumë i vogël gjë që tregon se organet kompetente në realizimin e arrestimit është i pasuksesshëm dhe persona që jnë në gjendje të lirë gjithashtu është i madh që rrezikon ikjen ose përsëritjen e veprimeve kriminale.
Grafikoni nr.31 Policia e Shtetit ka referuar gjithsej 104 vepra penale që kanë lidhje me fushën e Trafikimit dhe ka të bëjë edhe me viktimat që përdoren për prostitucion.
në Persona:

- 23 çështje për "Mbajtje e lokaleve për prostitucion" neni 115 i Kodit Penal;
- 81 çështje për "Shfrytëzim prostitucioni" neni 114/a i Kodit Penal.[1382]




Grafikoni nr.31 karakterizohet me ate se numri i të arrestuarve dhe personave që janë në liri por të cilët kanë mundësinë e ikjes ose përsëritjes së krimeve dhe në anën tjetër numri i rasteve të evidentuara dhe autorët e veprës penale. Nga kjo del se arrestuarit në numër janë shumë pak me autorët e regjistruar dhe ate dallimi është 69 autor të paarrestuar.
Duke u bazuar në ate se trafikantët si qëllim kryesor e kanë përfitimin sidomos ate financiar nga shërbimet që ofrojnë viktimat në nenin 110/b e cila është shtuar me ligjin nr.114/2013 të datës 02.05.2013. *Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.*[1383] Duke u bazuar në analizën juridike-penale të nenit 110/b "Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar", mendojmë se subjekti i kësaj vepre penale ose personi i tretë (klienti) i cili përfiton ose përdor shërbimet e ofruara nga personat e trafikuar, duhet të marrë patjetër statusin e Përfituesit (përfituesit e kundërligjshëm) dhe jo të Trafikantit apo Shfrytëzuesit, sepse duke marrë parasysh vetëm emërtimin e kësaj dispozite kuptojmë se ligjvënësi në këtë rast ka si qëllim të ndëshkojë penalisht personin që përfiton dhe jo atë që trafikon dhe shfrytëzon në kontekstin e veprës penale

[1382] https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Raporti-Vjetor-2015.pdf, të datës 17.09.2020, ora 12:29
[1383] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 110/b, paragrafi 1

të trafikimit të personave.[1384] *Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmijë dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.*[1385] Kodi penal i Shqipërisë parasheh veprën penale të prostitucionit te e cila si kryerës janë personat që ushtrojnë prostitucion dhe për dallim nga kjo parasheh edhe shfrytëzimin e prostitucionit e cila në shtetin tonë emërtohet si ndërmjetësim në prostitucion parasheh për personat që paraqiten si ndërmjetësues ose si shtytës në prostitucion dhe nga kjo vepër ata përfitojnë. Në praktikë shpesh ngatërrohet shfrytëzimi për prostitucion me veprën penale të ushtrimit të prostitucinit ku nga kjo mos dallim shpesh viktimat e trafikimit me qenie njerëzore apo të shfrytëzimit të prostitucionit dënohen nga gjykatat e vendit. Aktualisht, shqetësuese paraqitet situata e trafikimit të femrave dhe të miturve me qëllim shfrytëzimi për prostitucion dhe punë të detyruar në zonat e përqendruara urbane si Tirana, Durrësi, Fieri, Vlora, si dhe në zonat turistike bregdetare gjatë sezonit të verës.[1386]

Grafikoni nr.32 Numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore[1387]



Nga grafikoni nr.32 shihet se viti 2006 është me numrin më të madh të viktimave të identifikuara me 277 viktima, më pas viti 2005 me 274 viktima të identifikuara dhe në vitin 2008 me 108 raste. Rënie e numrit të viktimave shihet që nga viti 2009 deri vitin 2014 kurse më pak raste është në vitin 2007 me vetëm 20 viktima të identifikuar. Në tabelën e njejt vërehet se numri i ndjekjeve penale dhe numri i dënimeve dallim të madh ekziston në vitet: 2007, 2013, 2012, 2011dhe me dallim minimal në vitet: 2009, 2010 kurse vitet tjera janë përafërsisht të njejta.

Kodi penal i Shqipërisë veçohet në drejtim të asaj se me nen të veçantë e parasheh si vepër penale dhe si vepër e dënueshme për mbajtësit e lokaleve**,** shfrytëzuesit, finanuesit dhe dhënies me qira të lokaleve ku zhvillohet prostituioni. *Mbajtja, shfrytëzimi, financimi, dhënia me qira e lokaleve për ushtrim të prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dhjetë vjet.*[1388] Kohët e fundit është shfaqur prirja në rritje e trafikimit dhe shfrytëzimit seksual të femrave si gra të divorcuara dhe me fëmijë apo studente, të rekrutuara përmes ofertave të punës si kameriere, kërcimtare (*'lap-dance'* kërcim në prehër) dhe këngëtare në bare dhe lokale me muzikë.[1389] Në

[1384] Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015, fq.30

[1385] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 110/b, paragrafi 2

[1386] Studim. "Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,". Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015, vep. e cit., fq.53

[1387] Studim. "Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,". Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015, vep. e cit., fq.54

[1388] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 115, paragrafi 1

[1389] Studim. "Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,". Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015, vep. e cit., fq.53

disa raste, femra të cilat janë shfrytëzuar nga pronarë lokalesh dhe hotelesh në Tiranë janë trafikuar më pas edhe drejt Kosovës.[1390] Në mbështetje të luftës kundër trafikimit të personave kanë bashkëpunuar duke koordinuar veprimtarinë e tyre, nëpërmjet zbatimit të planeve të punës, takimeve periodike, informimit, monitorimit dhe nënshkrimit të dokumenteve për të mundësuar mirëfunksionimin e tyre dhe për të finalizuar objektivat me rezultate konkrete.[1391]
Kodi penal i Shqipërisë në nenin 52/a parasheh përjashtimin ose uljen e dënimit për bashkëpuntorët e drejtësisë dhe viktimat. *Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.*[1392] Pra, kjo e drejtë bazohet në parimin e mosdënimit të viktimave të trafikimit të cilën e njohin shumë vende të botës ku edhe vendi ynë dhe është një hap i rëndësishëm në përkrahjen e viktimave të trafikimit. *"Personi që ka kryer njërën nga veprat penale që kanë lidhje me trafikun e narkotikëve, armëve apo municioneve, trafikimin e personave ose për vepra penale të kryera nga organizata kriminale, që bashkëpunon dhe ndihmon organet e ndjekjes penale në luftën kundër tyre ose, sipas rastit, në zbulimin e personave të tjerë, që kryejnë krime të tilla, nuk mund të dënohet më tepër se gjysma e dënimit të parashikuar për veprën e kryer prej tij. Në raste të veçanta, kur konkurrojnë edhe rrethana lehtësuese në favor të tij, ky person mund të përjashtohet nga dënimi."*[1393] Pra rrethanat lehtësuese vijnë parasysh nga Kodi penal vetëm në raste të caktuara dhe nëse i plotësojnë kustet ligjore për atë të drejtë. Përdorimi i internetit në Shqipëri, në pesë vitet e fundit, është trefishuar nga 20% në vitin 2009, në 60.1% në vitin 2014[1394] e cila si mjet mundëson edhe cenueshmërinë e tyre përshkak se trafikantët dhe grupet e krimit të organizuar janë përdorues të madh të internetit përmes të cilës bëhet mashtrimi dhe rekrutimi i viktimave të mundshëm.

4. Trajtimi juridiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës

Fakti është se edhe në RSFJ, dhe më vonë edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, ka pasur trafikim me qenie njerëzore dhe se ky fenomen është i pranishëm, jo vetëm sot, por manifestohet në një masë edhe më të madhe dhe në një hapësirë më të gjerë.[1395] Duke ditur se deri në vitet e 90-ta Bosnja dhe Hercegovina si pjesë e ish sistemit të Jugosllavisë karakterizohet me kriminalitetin, krimin e organizuar si dhe me trafikimin me qenie njerëzore e cila ishte karakteristikë për tërë Jugosllavinë. Sidomos pas pavarësisë së saj filloj edhe strukturimi i personave që mirreshin me krimin e organizuar, dhe formimin e grupeve të krimit të organizuar të cilët filluan veprimtarinë e tyre nacionale dhe më pas edhe në aspektin ndërkombëtar. Kështu, mund të thuhet se krimit të organizuar të Bosnjës dhe Hercegovinës i parapriheshin krime massive individuale, d.m.th., krime të përditshme në rrugë, dhe ate vjedhje nga xhepat, vjedhje nga banesat, vjedhje nga trenat,

[1390] Po aty, fq.54
[1391] Raport. "Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017". Tiranë, 2016, fq.39
[1392] Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017, neni 52/a, paragrafi 2
[1393] Po aty, paragrafi 3
[1394] Studim. "Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,". Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015, fq.95
[1395] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.202

plaçkitje, mashtrim me lodra dhe karta, si dhe prostitucion.[1396] Me kalimin e periudhës së pasluftës në Bosnjë filluan edhe aktivitetet më profesionale të kriminelëve individual e më pas në organizimin e tyre si brenda ashtu edhe në rajon e më gjerë. Pra, edhe klima e formuar menjëher pas luftës ndikoj të formohet një mjedis shumë të volitshëm për veprimtari ilegale sepse shtetit i mungonte ekonomija e zhvilluar, ligjet e mirëfillta, kontrolli, siguria dhe shumë mekanizma tjerë të cilët dë e mbanin nën kontroll mirëqenien shoqërore, pra mund të thuhet se pasiguria e njerëzve që ishte gjatë kohës luftës vazhdoj edhe disa vite pas luftës. Kushtet e luftës intensifikuan tensionet e tranzicionit dhe nga ana tjetër ndikuan shumë në shfaqjen e krimit të organizuar.[1397] Domethënë, gradualisht disa nga drejtuesit e grupeve kriminale, veçanërisht ata që vepronin jashtë vendit, filluan të kryejnë krime të reja, ndërsa disa ndryshuan veprimtarinë e tyre kriminale[1398], e cila ka ndikuar edhe në kryerjen e veprimtarive kriminale, pra edhe të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore në mënyrë të organizuar ose thjesht janë rritur nga kriminel individual në grupe të krimit të organizuar. Karakteristikë e trafikimit me qenie njerëzore në rajonin e Ballkanit është se vendet e këtij rajoni shpesh janë njëkohësisht vende të origjinës, tranzitit, si dhe destinacioni përfundimtar i viktimave të trafikimit ndërkombëtar dhe lokal[1399], duke mos e harruar rrezikshmërinë e nivelit të lartë në çdo status të shtetit ndaj saj, pikërisht për shkak të një shkalle kaq të lartë rreziku shoqëror, trafikimi i qënieve njerëzore është përshkruar si vepër penale e veçantë brenda një pjese të veçantë të ligjit penal të Bosnje dhe Hercegovinës.[1400]

Bosnja dhe Hercegovina ka ndërmarrë masa legjislative dhe operative për të forcuar aftësinë e saj për luftim kundër trafikimit me qenie njerëzore.[1401] „BeH ka katër sisteme juridikopenale të ndara, prej të cilëve çdokush ka ligjin penal. Kodi penal i Federatës së BeH (KP FBeH) dhe rrethi Brçko BeH (KP RRB BeH) parashohin veprën penale "nxitja e prostitucionit", megjithatë një vepër, si e tillë, nuk është në përputhje me kërkesat e Konventës së Këshillit të Evropës kur bëhet fjalë për thelbin e elementeve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore."[1402] Katër sisteme shtetërore, katër sisteme juridike dhe katër ligje penale të ndryshme në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ate: Ligji penal i Bosnjës dhe Hercegovinës, Ligji penal i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Ligji penal i rrethit Brçko të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ligji penal penal i Republikës srbe. Më të rëndësishmet për ne dhe e cila trafikimin me qenie njerëzore e parasheh në pajtueshmëri me aktet ndërkombëtare është ligji penal i Bosnjës dhe Hercegovinës dhe më pas është Ligji penal i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Kur Kodi Penal i BeH u miratua në 2003, ai përfshin një përkufizim të trafikimit të qënieve njerëzore sipas Protokollit të Palermos[1403] dhe aktet ndërkombëtare të nënshkruara nga ana e vendit janë të inkriminuara në sistemin e brendshëm të saj ku këtë e cekën edhe Kushtetuta e vendit. "Të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore dhe në protokollet e saj janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Bosnjë dhe Hercegovinë. Këto akte kanë përparësi mbi të gjitha ligjet e tjera."[1404]

[1396] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.196

[1397] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.115

[1398] Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. "Kriminologija". Sarajevo, 2004, fq.196

[1399] Šejtanić, Esad. "Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu". Mostar, 2017, fq.124

[1400] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.201

[1401] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.27

[1402] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.30

[1403] Po aty

[1404] Ustav Bosne i Hercegovine. Prečišćeni tekst, 1995, neni 2, paragrafi 2

Ai i cili, me përdorimin e forcës ose përdorimin e forcës me kërcënim ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit ose gënjeshtrës, abuzimit të pushtetit ose ndikimit ose pozitës së pafuqisë, ose dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitime të tjera për të bindur një person në kontrollin e një personi tjetër, rekruton, transporton, dorrëzimin, fshehjen ose pranimin e personit me qëllim shfrytëzimin e këtij personi, do të dënohet me dënim me burg së paku pesë vjet.[1405]

Neni 186 Trafikimi ndërkombëtar me qenie njerëzore

1.Ai i cili, me përdorimin e forcës ose përdorimin e forcës me kërcënim ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit ose gënjeshtrës, abuzimit të pushtetit ose ndikimit ose pozitës së pafuqisë, ose dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitime të tjera për të bindur një person në kontrollin e një personi tjetër, rekruton, transporton, dorrëzimin, fshehjen ose pranimin e personit me qëllim shfrytëzimin e këtij personi, do të dënohet me dënim me burg së paku pesë vjet.

2.Kush rekruton, pretendon, transporton, dorëzon, fsheh ose pranon një person që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç qëllimi i shfrytëzimit nga prostitucioni ose formë tjetër e shfrytëzimit seksual, punë e detyruar ose nga shërbimet, skllavëria, ose një marrëdhënie e ngjashme, shërbimi, heqja e pjesëve të njeriut organeve ose për qëllim të ndonjë shfrytëzimi tjetër, në një Shtet në të cilin ai person nuk është me vendbanim ose i të cilit nuk është qytetari, dënohet me burgim për një afat jo më pak se dhjetë vjet.

3. Nëse vepra penale nga parag. (1) dhe (2) të këtij neni kryhet nga një person zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare detyrat, kryerësi dënohet me burgim për një afat jo më pak se dhjetë vjet.

4. Kush falsifikon, merr ose lëshon një dokument udhëtimi ose identiteti ose përdor, ruan, konfiskon, ndryshon, dëmton, shkatërron dokumentin personal ose të udhëtimit të një personi tjetër me qëllim të mundësimit të trafikimit ndërkombëtar me qenie njerëzore, dënohet me burgim për një periudhë prej një deri në pesë vjet.

5. Kushdo që përdor shërbimet e një viktime të trafikimit ndërkombëtar do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

6. Nëse me kryerjen e veprës penale nga parag. (1) dhe (2) të këtij neni shkaktohen shkelje serioze për shëndetin, lëndimin e rëndë trupor ose vdekjen e një personi të përmendur në paragrafin. (1) dhe (2) të këtij neni, kryesi dënohet me burgim për një afat jo më pak se dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë.

7. „Shfrytëzimi brenda kuptimit të paragrafit (1) të këtij neni përfshin: prostitucionin e një personi tjetër ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punë e detyruar ose shërbime, skllavëri ose marrëdhënie të ngjashme, shërbim, heqje të pjesëve të trupit të njeriut ose ndonjë shfrytëzim tjetër.“

8. Sendet, mjetet e transportit dhe objektet e përdorura për kryerjen e veprës do të konfiskohen.

9. Ekzistenca e veprës penale të trafikimit ndërkombëtar të qenieve njerëzore nuk ndikohet nga rrethanat nëse një person ka rënë dakord të shfrytëzohet që është viktimë e trafikimit ndërkombëtar.


10. Kundër viktimës së trafikimit ndërkombëtar me qenie njerëzore i cili u detyrua nga kryerësi i veprës penale të merr pjesë në kryerjen e një vepre tjetër penale, nuk do të zhvillohet asnjë procedurë penale, nëse veprimi i tillë ka qenë si pasojë e drejtpërdrejtë e statusit të saj si viktimë e trafikimit ndërkombëtar me qenie njerëzore.[1406]

[1405] Krivični Zakon Federacije Bosne i Hercegovine, Integralni tekst, ("Službene novine Federacije BiH", br. 36/2003, 21/2004 - ispr., 69/2004, 18/2005, 42/2010, 42/2011, 59/2014, 76/2014, 46/2016 i 75/2017), neni 210a, paragrafi 1

[1406] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 186

Pra, inkriminimi ligjor i Bosnjës dhe Hercegovinës është përafërsisht e njejtë për nga shtjellimi i veprës dhe veprimtarisë së veprës, kurse dallon në minimumin e dënimit e cila është 1 vjet më shumë se e Maqedonisë. Trafikimi i personave nën moshën 18 vjet Kodi penal i Bosnjës dhe Hercegovinës e parasheh në kuadër të këtij neni, në paragrafin 2 kurse tek na është me nen të veçantë për të mitur apo fëmijë. Pra, nga ky inkriminim shihet se edhe në këtë paragraf dallimi është tek lartësia e dënimimit minimal nga vendi ynë me dallim 2 vite. Njejt ky inkriminim ekziston edhe në kodin penale, po këtu dallimi i sasisë së dënimit minimal është i madh dhe ate dallim 5 vjet ku në Bosnjë është minimum 10 vjet e paraparë në paragrafin 3 kurse në Maqedoni së paku 5 vjet dënim me burg. Në paragrafin 4 situata ndryshon ku sasia e dënimit në Maqedoni është më e madhe me sasisë paku 4 vjet dënim me burg, kurse këtu maksimumi është deri në 5 vjet bur me minimum prej 1 vit burg. Paragrafi 5 për nga inkriminimi i veprimtaris është përafërsisht e njejt kurse e njejt është në caktimin e sasisë së sanksionit penal me Kodin penal të Maqedonisë. Paragrafi 6 është një dallim tjetër me Kodin penal të Maqedonisë e cila në kuadër të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sidomos në nenin 418-a të saj nuk e parasheh këtë inkriminim, kurse Kodi i Bosnjës dhe Hercegovinës e parasheh inkriminimin dhe dënimin e lartë së paku 10 vjet ose burgim afatgjat. Karakteristikë e radhës dhe e cila veç nuk shtjellohet në vendet e rajonit është se Bosnja e ka paraparë në paragraf të veçantë nr.7 kuptimin e shfrytëzimit. Njejt si shumica e Kodeve penale si dhe ajo e vendit tonë, edhe Kodi penal i Bosnjës dhe Hercegovinës e parasheh konfiskimin e sendeve dhe mjeteve të transportit. Paragrafi 9 paraqet një inkriminim e cila tregon se edhe nëse viktima ka rënë dakord për trafikimin e tij nuk do të ndikoj si rrethanë apo e njejta tek na ceket si pëlqim i viktimës së trafikimit me qëllim të eksploatimit. Inkriminimi i paragrafit 10 është si në shumë Kode tjera penale që e parashohin duke u bazuar në parimin e mosdënimit të viktimave, e parasheh edhe Bosnja dhe Hercegovina.

Grafikoni nr.33[1407] Numri i veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas viteve




Në krahasim me Republikën e Shqipërisë, Bosnja dhe Hergovina në vitin 2010 me 25 është më pak se Shqipëria me 97 vepra, në vitin 2011 në Bosnjë dhe Hercegovinë ka më shumë raste me 35 përkundër 4 në Shqipëri, kurse nl vitin 2012 me 39 është më pak sesa në Shqipëri me 95 raste. Edhe Bosnja dhe Hercegovina nuk është e paprekur nga trafikimi me qenie njerëzore dhe organet kompetente duhet të vazhdojnë me masa më të intensifikuara të ulin në minimum numrin e veprës penale të trafikimit sepse prej vitit 2010 deri 2103 kemi një rritje të veprave penale të trafikimit.

[1407] https://migrationdataportal.org/?i=TotalVictims&t=2012&cm49=70, të datës 20.08.2019, ora 09:39

"Situata aktuale në BeH është e favorshme për trafikimin e grave. Sipas disa pikëpamjeve, Bosnja dhe Hercegovina në këtë veprimtari merr pjesë në tre mënyra:
1. Në BeH rekrutohen viktimat e trafikimit të grave;
2. Kontrabanda dhe
3. BeH paraqet një destinacion për trafikimin e qënieve njerëzore."[1408]
Ai i cili organizon ose udhëheq grup ose shoqatë tjetër që bashkërisht kryejnë një vepër penale të përmendur në nenin 186 të këtij ligji (Trafikimi Ndërkombëtar i Qenieve Njerëzore), dënohet me dënim me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim afatgjatë[1409], parasheh kodi penal i Bosnjës dhe Hercegovinës. Dallimi me Kodin tonë penal qëndron në lartësinë e dënimit ku Kodi i Maqedonisë parasheh dënim me burg së paku 8 vjet kurse këtu është më pak se 10 vjet ose me burgim afatgjatë, pra me dallim minimum 2 vjet sa i takon dënimit. Organizimi mund të përfshijë veprimtari të ndryshme, siç janë: a) rekrutimi, b) përfshirja e personave të rinj në grup c) lidhshmëria e anëtarëve të grupit, d) krijimi i planit të veprimtarisë, e) sigurimi i mjeteve për verimtarinë e grupit, etj.[1410] *Kushdo që kryen vepër penale brenda grupit ose shoqatës tjetër të përmendur në paragrafin (1) të këtij neni ose më tej përndryshe duke ndihmuar një grup ose shoqatë, do të dënohet me burgim për një afat jo më pak se dhjetë vjet.*[1411] Dallim të madh me Kodin penal të Maqedonisë në lidhje me këtë paragraf, ku shteti ynë parasheh së paku 1 vjet dënim me burg kurse Bosnja dhe Hercegovina me dënim jo më pak se 10 vjet.

Edhe Bosnja dhe Hercegovina si shumë shtete të Ballkanit është i prekur nga ruta e Ballkanit të migrantëve të cilët viteve të fundit është në rritje e sipër. Sipas pamjes së përgjithshme të migracionit në BeH, nuk duhet të harrojmë numrin e kinezëve të mbërritur, të cilët, sipas disa të dhënave, është afër njëzet mijë.[1412]

Grafikoni nr.34[1413] Numri i përgjithshëm i migrantëve ndërkombëtar në Bosnjë dhe Hercegovinë



Pra grafikoni tregon numrin e përgjithshëm të migracionit ndërkombëtar e cila në vitin 2005 është 47.3 mijë dhe shënon rënie ku në vitin 2010 kemi 38.8 mijë dhe një rënie drastike është në vitin 2015 me 3.6 mijë emigrantë ndërkombëtar në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ekzistimi i të huajve numër të madh në shtet është një indikator e cila duhet të analizohet mirë sepse është një sinjal i fortë për ekzistimin e krimit të organizuar dhe migracioni i tyre nuk

[1408] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.202
[1409] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 186a, paragrafi 1
[1410] Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013, fq.201
[1411] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 186a, paragrafi 2
[1412] Masleša, Ramo. Bisić Munib. "Osnovni Sigurnosti". Sarajevo, 2007, fq.202
[1413] https://migrationdataportal.org/?i=stock_abs_&t=2005&cm49=70, të datës 21.08.2019, ora 10:48

është rastësisht qoft si shtet i destinacionit ose shtet tranzit. *Ai i cili me qëllim të marrjes për vete ose tjetrit ndonjë përfitim mënyrë të paligjshme përkthen ose mundëson bartjen e një ose më shumë migrantëve ose personave të tjerë përtej kufirit shtetëror, ose kushdo që bën, siguron ose posedon dokumente false të udhëtimit ose identitetit për atë qëllim, do të dënohet me dënim me burg prej një deri në dhjetë vjet.*[1414] në Bosnjë dhe Hercegovinë në këtë nen parashihet edhe sigurimi apo posedimi i dokumenteve false të udhëtimit në brendin e veprimtarisë së veprës së kontrabandës sidomos përfshihet edhe mundësimi ose bartja e migrantëve për përfitime materiale e cila ngarkon veprën dhe dënimi është prej 1 deri 10 vjet.

Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës me nen të veçantë, përveç organizimin e grupit për trafikimin ndërkombëtar me qenie njerëzore parasheh edhe për kryerjen e veprës penale të kontrabandës së njerëzve e cila në shumë shtete nuk ekziston si vepër penale të veçantë, por organizimin e grupit në përgjithësi për kryerjen e veprave penale. *Ai i cili organizon grup ose shoqatë tjetër për kryerjen e veprës penale të cekur në nenin 189 të këtij ligji (Kontrabanda me njerëz) do të dënohet me denim me burg së paku tre vjet.*[1415] *Ai i cili bëhet anëtar i grupit ose shoqate tjetër nga paragrafi (1) të këtij neni ose në mënyrë tjetër ndihmon grupin ose shoqatën, do të dënohet me denim me burg së paku një vit.*[1416] Tek të dy veprat penale trafikimi me qenie njerëzore dhe kontrabanda me migrantë sipas Kodit penal të Bosnjës dhe Hercegovinës si dhe sipas Kodit të shtetit Federal të Bosnjës dhe Hercegovinës viktimat pësojnë një pozitë njejt sikur skllavëria dhe për këtë edhe Kodi penal i BeH e parasheh në nen të veçantë themelimin e marrëdhënies së skllavërisë dhe transportin e personave që janë në marrëdhënie të skllavërisë. *Ai i cili, duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare, e vendos tjetrin në marrëdhënie të skllavërisë ose të ngjashëm me të ose e mban në marrëdhënie të tillë, e blen, shet, i dorëzon personit tjetër ose ndërmjetëson në blerjen, shitjen ose dorëzimin e personave të tillë ose e inkurajon tjetrin të shesë lirinë e vet ose lirinë e personit për të cilin mbështetet ose kujdeset për të, do të dënohet me burg prej një deri në dhjetë vite.*[1417] Përshkrimi i veprës penale të themelimit të marrëdhënies së skllavërisë është pothuajse e njejt me Kodin tonë penal pa dallime të mëdha si në përshkrimin e veprës ashtu edhe në sasinë e lartësisë së dënimit. Kurse paragrafi i radhës e përshkruan veprn ndaj personave nën 18 vjet pra ndaj të miturve me denim me burg të paraparë së paku 5 vjet. *Ai i cili shkel rregullat e së drejtës ndërkombëtare, blen, shet, dorëzon tjetrit ose ndërmjetëson në blerjen, shitjen ose dorëzimin e personave të cilët nuk kanë mbush 18 vjet për adoptim, heqjen e pjesëve të trupit të njeriut, shfrytëzimin për punë ose qëllime të tjera të paligjshme, do të dënohet me burg së paku pesë vite.*[1418] Veprat penale të migracionit ilegal, kontrabandës me migrantë dhe të trafikimit me qenie njerëzore si në shumë vende të botës po edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë realizohet përmes korrupcionit sidomos të nëpunësve dhe zyrtarëve të lartë shtetëror ku edhe u vërejtën në nenet më lartë edhe dënime shumë të larta në krahasim prej Maqedonisë. *Personi zyrtar ose përgjegjës në institucionet e Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe personi zyrtar i huaj ose nëpunësi ndërkombëtar ose arbitri ose gjyqtari porotë, i cili kërkon ose merr dhuratë ose ndonjë përfitim tjetër për veten e tij ose për person tjetër ose që merr një premtim për dhuratë ose ndonjë përfitim për vete ose për person tjetër, për të kryer brenda funksionit të tij*

[1414] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 189, paragrafi 1

[1415] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 189a, paragrafi 1

[1416] Po aty, paragrafi 2

[1417] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 185, paragrafi 1

[1418] Po aty, paragrafi 3

atë që nuk duhet të kishte bërë ose që ndërmjetëson në ryshfet të tillë të një zyrtari ose personi përgjegjës ose të mos bëjë atë që duhet të kishte bërë, dënohet me burg prej një deri në dhjetë vite.[1419] Një nga karakteristikat e rëndësishme të këtij lloji të kriminalitetit është se ajo është i lidhur me krimin e organizuar, i cili disponon mjete të mëdha financiare të fituara nga kontrabanda e drogës, njerëzve, armëve, materialit bërthamor, mbeturinave të rrezikshme ekologjike, produkteve shumë fitimprurëse, dhe të tjerë, duke përfshirë në kryerjen e saj funksioner të picizionuar lartë në struktura të shtetit nga ryshfeti i tyre.[1420]

Në përputhje me planin Shtetëror akcional për luftimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe imigracionit ilegal, Zyra e koordinatorit shtetëror për luftimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe imigracionit ilegal, në bashkëpunim me Ministrinë e të drejtave të njeriut dhe refugjatëve, vitin 2008 krijuan mekanizëm për monitorimin dhe implementimin e standardeve minimale për mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore nga ana e agjencioneve të ndryshme[1421], dhe ate në qytetet Banja Luka, Mostar, Tuzël dhe Sarajevë. Masat për parandalimin dhe luftimin e fenomenit të migracionit ilegal, kontrabandës me migrantë sidomos të trafikimit që qenieve njerëzore si atakues më i rëndë i lriive dhe të drejtave të njeriut nevojitet buxhet më të madh për të arritu sukses më të mirë. Qëllimet afatgjata të Bosnjë dhe Hercegovinës në fushën e imigracionit dhe azilit janë zhvillimi i një sistemi cilësor të migracionit dhe azilit në nivelin kombëtar, i cili është harmonizuar me standardet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe që përfshin ligjin ndërkombëtar të refugjatëve, si dhe pjesëmarrjen aktive në përcaktimin politika dhe zhvillimi i sistemit të imigracionit dhe azilit në nivelin rajonal.[1422]

5. Trajtimi jurudiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Turqisë

Si çdo vend në botë, poashtu edhe Turqia, nuk është imune ndaj llojeve të ndryshme të kriminalitetit poashtu edhe ndaj veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore përmes të cilës cenohen liritë dhe të drejtat themelore e në shumë raste edhe jeta e shtetasve të tij. *Secili ka të drejtë për jetë, për të mbrojtur dhe zhvilluar ekzistencën e tij materiale dhe shpirtërore*[1423], parashihet në pjesën e dytë të Kushtetutës me titull "Të drejtat dhe detyrat e personit". Pas nënshkrimit të Protokollit të Trafikimit me Qenie Njerëzore (UN, 2000a), në dritën e këtij protokolli, është bërë një rregullim i veçantë në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore në KPT (Gazeta Zyrtare, 18.03.2003, Numri 25052; Gazeta Zyrtare, 9.08.2002, Numri 24841).[1424] "Vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore për herë të parë hyri në drejtën pozitive me ligjin numër 4771 (3.8.2002) në kuadër të ligjeve të pajtueshmërisë. Në atë datë u shtua Neni 201/b në KPT numër 765, i cili ishte në fuqi në atë kohë, trafikimi me qenie njerëzore u konsiderua si një krim dhe u ndëshkua."[1425] Me paragrafin b të shtuar në nenin 201 nën seksionin "Kundërvajtjet kundër lirisë së punës dhe punësimit" në Kodin Penal Turk, personat që kryejnë veprën në fjalë dënohen me "dënime të rënda burgu nga pesë në dhjetë vjet dhe si dënim i rëndë në të holla jo më pak se një miliardë lira" dhe krimi përcaktohet si më poshtë (TCK, 1926, neni 201 / b): trafikimi me qenie njerëzore, puna e detyruar ose shërbime duke iu nënshtruar skllavërisë ose veprimeve të ngjajshme,

[1419] Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine" br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003, neni 217, paragrafi 1

[1420] Бабић, Милош. Марковић Иванка."Кривично Право", Посебни дио. Бања Лука, 2007, fq.301

[1421] OSCE. "Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije", referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011, fq.28

[1422] http://www.msb.gov.ba/PDF/report23052018.pdf, të datës 07.09.2020, ora 18:34

[1423] Türkiye Cumhuriyeti Anayasası. Ligji Nr: 2709, 7.11.1982, neni 17, paragrafi 1

[1424] Bolat, Gürbüz Akhan. Disertacion i doktoraturës " Berdel töresi ve insan ticareti". Ankara, 2013, fq.81

[1425] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.313

me qëllim sigurimin e dhënies së organeve trupore, kërcënime, shtypje, përdorimin e detyrimit ose dhunës, abuzimi, mashtrimi ose kontrolli mbi njerëzit ose duke përfituar pëlqimin e tyre nga pafuqia e tyre duke siguruar persona, rrëmbyer, bartjen e personave prej një vendi në një vend tjetër, transferuar, akomoduar.[1426] Kodi Penal Turk nr.765, shfuqizohet në vitin 2004 dhe në vend të saj miratohet kodi i ri penal turk me numër 5237 dhe veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore e parasheh në nenin 80 të saj, ku ka ngjajshmëri me përkufizimin e mëparshëm por këtu kemi rritje të dënimit për kryerësit e saj dhe ate prej 8 der 12 vite burgim dhe njejta hyn në fuqi më datën 1 qershor 2005. Me ligjin nr.5660 të dates 06.12.2006, neni 80 i Kodit Penal Turk u ndryshua dhe u shtua fraza "Detyrim në prostitucion" në përkufizimin e krimit (KPT, 2004, neni 80).

Gjegjësisht vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore sipas Kodit penal të Republikës së Turqisë parashihet në nenin 80, me titull trafikimi me qenie njerëzore e përbërë nga pragrafet si më poshtë:

1.Detyrimi për punë të detyruar, shërbimi, detyrim në prostitucion ose mbajtja në skllavëri ose me qëllim të sigurimit të dhënies së organeve trupore, kërrcënim, shtypje, përdorimi i detyrimit ose dhunës, abuzimi, mashtrimi ose kontrolli mbi njerëzit ose duke përfituar pëlqimin e tyre nga pafuqia e tyre duke futur persona në shtet, duke i bartur jashtë shtetit, duke siguruar persona, rrëmbyer, bartjen e personave prej një vendi në një vend tjetër ose transferuar ose akomoduar dë të dënohet personi prej tetë deri dymbëdhjetë vite me burg dhe gjobë gjyqësore në të holla deri në dhjetëmijë ditë.

2. Pëlqimi i viktimës është i pavlefshëm nëse ka veprime që e përbëjnë krimin dhe veprime për qëllimet e caktuara të paraparë në paragrafin e pare.

3. Prokurimi, rrëmbimi, marrja nga një vend në tjetrin ose transferimi ose strehimi, i personave që janë nën moshën tetëmbëdhjetë vjet për qëllimet e përcaktuara në paragrafin e parë, atëherë kryerësit i jepen dënimet e përcaktuara në paragrafin e parë, edhe nëse mjetet i krimit nuk janë përdorur në asnjë prej veprimeve.

4. Masat e sigurisë u shqiptohen edhe personave juridikë për shkak të këtyre krimeve.[1427]


Në paragrafin 1 në krahasim me Kodin penal të Maqedonisë e cila parasheh dënim së paku 4 vjet, e ka të paraparë së paku 8 vjet deri në maksimum 12 vjet denim me burg dhe gjobë deri në dhjetë mijë ditë. Në inkriminimin e veprimtarisë së trafaikimit Turqia nuk e ka të paraparë në këtë nen shtatzanin e detyruar, adoptimin e paligjshëm dhe pornografinë siç e ka Kodi i Maqedonisë. Edhe në paragrafin e 2 si në Kodin tonë penal pëlqimi i viktimës nuk e ndryshon situatën dhe nuk ndikon që vepra të llogaritet si vepër penale e trafikimit me qenie njerëzore. Nga ky paragraph shohim se dënimi i paraparë në paragrafin e 1 të këtij neni prej 8 deri 12 vjet dhe dënimi me gjobë deri në dhjetëmijë ditë parashihet edhe për personat nën moshën 18 vjet. Këtu do të ishte preferuar të mirret parasysh mosha e viktimave të cilët janë kategori e cenuar për shkak ende jo formësimit psiqik dhe dënimi të jet më i madh sesa për viktimat e rritura. Në Republikën e Maqedonisë për veprën e njejtë penale parashihet minimum 8 vjet duke mos e përcaktuar maksimumin së në Turqi. Në vijim do të paraqesim veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore sipas viteve.

Grafikoni nr.35[1428] Vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore sipas viteve në Turqi

[1426] Bolat, Gürbüz Akhan. Disertacion i doktoraturës " Berdel töresi ve insan ticareti". Ankara, 2013, fq.81

[1427] Türk Ceza Kanunu nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611, neni 80

[1428] https://migrationdataportal.org/?i=TotalVictims&t=2013&cm49=792, të datës 22.08.2019, ora 10:48



Grafikoni tregon lëvizjen e trafikimit me qenie njerëzore në Turqi prej vitit 2010 deri në vitin 2015 dhe ate: 2010 me 58 vepra, 2011 kemi një rritje të vogël deri në 82, viti 2012 prap rënie me 55, viti 2013 e cila është viti me më pak vepra penale të trafikimit gjatë kësaj periudhe me 21 vepra, kurse në vitin 2014 shënon prap rritje deri 50 dhe në vitin 2015 kemi në rritje të madhe e cila është viti me më shumë vepra penale të trafikimit me 108 vepra e cila është në pajtueshmëri me grafikonin 37 ku tregon se në vitin 2015 kemi një rritje shumë të madhe të migrantëve tl huaj në Turqi e cila ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të trafikimit me 108 vepra penale.


Në Republikën e Turqisë si një shtet i madh në aspekt territorial, numrit të popullsisë, ekonomisë së zhvilluar dhe rreziqet që mund të paraqiten në lidhje me punën e detyruar këtë vepër e ka të paparë deri në Kushtetutën e saj në nen të veçantë. *Askush nuk mund të detyrohet të punojë*[1429] është neni që e parasheh Kushtetuta e vendit me titull "Ndalimi i punës së detyruar", e cila është një nga veprimtarit e shumta të organizatave kriminale dhe trafikantëve në kuadër të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore.

Prostitucioni është i paligjshëm në vendet e rajonit dhe gratë që abuzohen në fushën e prostitucionit përballen me rrezikun e ndalimit dhe deportimit nga autoritetet[1430] e vendit, në rastin konkret në Republikën e Turqisë. Në kodin penal turk ekziston edhe neni 227 e cila e rregullon çështjen e prostitucionit sidomos nxitje apo inkurajim në prostitucion. 72% e grave janë viktima në sektorin e prostitucionit, ndërsa 85% e burrave viktimizohen nga trafikimi i qenieve njerëzore përmes punës së detyruar.[1431] *Ai i cili inkurajon personin në prostitucion, lehtëson rrugën ose ndërmjetëson në prostitucion ose siguron hapësirë për prostitucion, do të dënohet me burg prej dy deri katër vjet dhe gjobë gjyëqsore në të holla deri tre mijë ditë.*[1432] Sipas Kodi penal të vendit tone në pjesën e caktimit të lartësisë së dënimit është shumë më e madhe sesa në Turqi dhe ate në Maqedoni parashihet denim prej 5 deri në 10 vjet denim me burg kurse maksimumi i paparë në Turqi është 1 vjet më pak sesa minimum në Maqedoni. Akti i prostitucionit i përfshirë në përkufizim dëmton lirinë seksuale të personit.[1433] Çdo person lirshëm ka të drejtë të zgjedhë partnerin pa asnjë detyrim, frikësim apo shantazhim. *Ai i cili inkurajon fëmijën në prostitucion, lehtëson rrugën e saj, siguron ose strehon fëmijën për këtë qëllim, ose ndërmjetëson prostitucionin e fëmijës, dënohet me katër deri në dhjetë vjet burg dhe gjobëvënie gjyqësore në të holla deri në pesë mijë ditë.*[1434] Ky paragraf është një dallim e cila në vendin tonë nuk ekziston në kuadër të veprës penale të ndërmjetësimit në prostitucion kurse në Turqi parashihet dënim i veçantë nëse

[1429] Türkiye Cumhuriyeti Anayasası. Ligji Nr: 2709, 7.11.1982, neni 18, paragrafi 1
[1430] Dündar, Tuba. Özel, Elif. "Insan ticareti suçunu anlamak", Istanbul, 2017, fq.26
[1431] Po aty, fq.9
[1432] Türk Ceza Kanunu nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611, neni 227, paragrafi 2
[1433] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.324
[1434] Türk Ceza Kanunu nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611, neni 227, paragrafi 1

viktima është fëmi me denim prej 4 deri dhjetë vjet burg dhe dënim në të holla prej pesë mijë ditë dhe mund të jetë një shembull në inkriminimin e ngjajshëm edhe në Kodin e Maqedonisë. Gratë siriane dhe vajzat e reja i nënshtrohen trafikimit me qenie njerëzore me qëllim të shfrytëzimit seksual në rajon.[1435] Turqia para vitit 2011 ose para krizës së migrantëve sirian nuk ka pasur shumë viktima sirian siç është pas vitit 2011 ku me të madhe rritet numri i viktimave sirian gra, vajza të reja por edhe burra. Para vitit 2011 më shumë ishin viktima të brendshëm si dhe viktima nga Afrika dhe Azia. Vajzat e reja siriane detyrohen të martohen me qytetarë të vendeve pritëse, por kishte edhe raste të cilët nuk ishin "martesë të përkohshme".[1436] Fëmijët sirianë abuzohen në grumbullimin e mbeturinave në rrugë, bujqësi, transportimin e mallrave, ndërtimet, shitjet në rrugë dhe punë të ngjashme dhe në kafene.[1437] Pra, në rastin konkret shihet lidhshmëria e ngushtë e ndikimit të proceseve të migracionit në veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore. Në Republikën e Turqisë në lidhe me proceset e migracionit sidomos në menaxhimin e flukseve të migracionit si dhe bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional është nën udhëheqjen e Drejtorisë së Përgjithshme për menaxhimin e migracionit, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Drejtoria e Përgjithshme për menaxhimin e migracionit: vazhdon aktivitetet e saj për zbatimin e politikave dhe strategjive në lidhje me migracionin, sigurimin e koordinimin në mes të institucioneve dhe organizatave në sigurimin në lidhje me këto çështje, hyrja dhe qëndrimi i të huajve në Turqi, dalja dhe dëbimi nga Turqia, mbrojtja ndërkombëtare, mbrojtja e përkohshme dhe zhvillimin e punëve dhe procedurave për mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.[1438] Në vijim do të paraqesim dinamikën e lëvizjes së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Turqi.


Grafikoni nr.36 Dinamika e viktimave të trafikimit njerëzor sipas viteve[1439]




Nga grafikoni nr.36 shihet se ndikimi i proceve të migracionit sidomos si shkak i luftës në Lindjen e Mesme të viteve 2014 dhe 2015 ka ndikuar në rritjen e numrit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe ate dyfish më shumë nga viti paraprak. Pra, në vitin 2013 nga 21 raste, rritja në 2014 arrin deri në 50, kurse rritje e radhës është në vitin 2015 dhe arrin në 108 numri i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

Grafikoni nr.37[1440] Republika e Turqisë si shtet i destinacionit të refugjatëve ndërkombëtar

[1435] Dündar, Tuba. Özel, Elif. "Insan ticareti suçunu anlamak", Istanbul, 2017, fq.26
[1436] Po aty, fq.27
[1437] Po aty
[1438] https://www.icisleri.gov.tr/goc-idaresi-genel-mudurlugu-hizmet, të datës 14.09.2020, ora 18:08
[1439] https://www.goc.gov.tr/insan-ticareti-ile-mucadele-istatistik, të datës, 08.09.2020, ora 9:22
[1440] https://migrationdataportal.org/?i=stock_refug_abs_&t=2005&cm49=792, të datës 22.08.2019, ora 11:14



Grafikoni nr.38[1441] Numri i përgjithshëm i migrantëve ndërkombëtar



Për të dhënë përgjigjen e dy grafikoneve të lartëpërmendura pra grafikonit 37 dhe 38 pse kemi rritje të numrit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në vitin 2015 tregon ky grafikon ku numri i refugjatëve nga viti 2005 deri 2015 lshtë si vijon: vitin 2005 me 2400 persona, viti 2010 me 10000 persona dhe në vitin 2015 me 2.800.000 persona refugjatë. Ky dallim shihet edhe në grafikonin nr.38 numri i përgjithshëm i migrantëve në Turqi për periudhën 2005 deri 2015 është si vijon: në vitin 2005 është 1.3 milion, në vitin 2010 kemi një rritje shumë të vogë pra, 1.4 milion kurse në vitin 2015 kemi 4.3 milion e cila tregon një dallim mjaft të madh në krahasim prej viteve të tjera. Andaj në raste të valëve masovike të migrantëve duhet që të aktivizohet i tërë aparati shtetëror me bashkëunim ndërkombëtar dhe rajonal për menaxhimin efikas të flukseve dhe luftimin dhe parandalimin më efikas të trafikimit me qenie njerëzore.

Më pas neni 227 plotësohet me paragrafin e 3 e cila parasheh: *Personi që dorëzon, shpërndan ose përhap materiale që përmbajnë imazhe, tekste dhe fjalë të përgatitura me qëllim të lehtësimit të prostitucionit ose ndërmjetësimin në prostitucion do të dënohet me burg prej një deri në tre vjet dhe gjobë gjyqësore në të holla prej dyqind deri në dymijë ditë.*[1442] Është një dallim tjetër e cila në vendin tone nuk parashihet ky inkriminim e cila nënkupton se nëse personi shpërndan materiale të cilat do të ndikojnë që të lehtësohet ndërmjetësimi në prostitucion ose në vet veprën e prostitucionit. Këto akte do të kryhen me kërcënime, shtrëngim, përdorim të forcës ose dhunë, abuzim të pushtetit, mashtrim, marrjen e pëlqimit të tyre duke shfrytëzuar dëshpërimin e viktimave ose duke përfituar nga kontrolli mbi viktimat.[1443] *Personi që ka detyruar një person në prostitucion duke përdorur forcë ose kërcënim, mashtruar ose duke shfrytëzuar dëshpërimin e tij, do të shqiptohet dënim nga gjysma deri deri në dyfishin e saj e paraparë sipas paragrafëve të*

[1441] https://migrationdataportal.org/?i=stock_refug_abs_&t=2005&cm49=792, të datës 22.08.2019, ora 15:42
[1442] Türk Ceza Kanunu nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611, neni 227, paragrafi 3
[1443] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.320

mësipërm.[1444] Shfrytëzimin e dëshpërimit të viktimave dhe duke përdorur mashtrim dhe force me qëllim të shfrytëzimit është një karakteristikë e Kodit Penal Turk. *Bashkëshorti, paraardhësi, vjehrra, vëllai ose motra, birësuesi, kujdestari, edukatori, edukatori,*
kujdestarë, persona të tjerë me detyrën e mbrojtjes dhe kujdestarisë, ose të siguruar nga një shërbim publik ose Në rast të kryerjes me keqpërdorim të ndikimit, dënimi që do të shqiptohet rritet përgjysmë.

Sot, migracioni në përgjithësi e në veçanti migracioni transnacional apo ndërkombëtar ka arritur kulminacionin e saj në të gjithë botën ku është rritur numri i migracionit në nivelin më të lartë të saj në historinë e botës dhe së bashku me këtë edhe migracioni i paligjshëm ku sot e kësaj dite nuk dihet numrat e sakta të migracionit legal dhe asaj ilegal. Varfëria, skamja, papunësia janë burime të pandërprera të pakënaqësive, konflikteve, luftërave, dyndjeve dhe migrimeve të popullsisë në tërë globin tokësor.[1445] Turqia, si shtet që llogaritet urrëlidhëse e Lindjes me perëndimin ka një rol kyç në procesin e migracionit, kontrabandës me migrantë si dhe në trafikimin me qenie njerëzore ndaj migrantëve. Gjatë migracionit, migrantët që shkonin në Turqi u desht të kalonin nëpër Maqedoni por detyroheshin të qëndronin për një kohë të caktuar në Maqedoni si shkak i rregullimit të ndryshëm administrativ dhe ndërkombëtar.[1446] *Lado Gvilav* Shefi i Misionit të IOM në Turqi, deklaroi se: "Me arritjen e mjeteve, taksive dhe autobusave që vinin nga Stambolli, përmes Edirnes rritet numri i migrantëve gjatë ditës."[1447] Me rritjen e migrimeve rriten edhe migrimet ilegale dhe të paligjshme t vet migrantëve por në të shumtën e rasteve me ndërmjetësim të kontrabanduesve. Më është bërë e mundur që migrantët të përdorin rrugë të paligjshme përshkak të suksesit të kontrabandistët lehtë mund të gjenden dhe shumë njerëz kanë arritur me sukses në Evropë duke i përdorur ato dhe për arsye të tilla si rrjetet më të gjera të kontrabandës së migrantëve që inkurajojnë imigracionin e parregullt.[1448] Mjetet politike për kthimin e imigrantëve të paligjshëm dhe pjesëmarrjen në përpjekjet ndërkombëtare për të luftuar imigracionin e paligjshëm gjithashtu përbëjnë një pjesë integrale të politikave të zbatuara nga shumë shtete po ashtu edhe nga Turqia. Politika e kthimit është mjet i rëndësishëm që ndikon në pengimin e migrimit të parregullt, duke dërguar një mesazh të qartë tek migruesit potencial, se respektimi i dispozitave ligjore është mënyra e vetme për të përfituar nga migrimi.[1449] Pra, menaxhimi i flukseve të migracionit, kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore në aspektin politik shtetet në kuadrin e territorit të saj nuk mund të arrijë sukses por duhet një konsesus dhe pajtueshmëri plotike botërore për këtë pështje e cila në praktikë është e pamundshme.

Tabela nr.22 Mjetet politike të përdorura nga shtetet për të luftuar migracionin e paligjshëm.

Masat përpara Kufijve
- Aplikime për viza
- Kontrolli i dokumenteve para udhëtimit në vendet e burimit dhe ato të tranzitit

[1444] Türk Ceza Kanunu nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611, neni 227, paragrafi 4
[1445] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.158
[1446] Pačariz, Sabina. "The migrations of bosniaks to Turkey from 1945 to 1974", The case od Sandžak. Sarajevo, 2016, fq.7
[1447] https://turkey.iom.int/tr/news/t%C3%BCrk-yunan-s%C4%B1n%C4%B1r-hatt%C4%B1nda-13-binden-fazla-g%C3%B6%C3%A7men-bildirildi, të datës 13.09.2009, ora 19:55
[1448]https://turkey.iom.int/sites/default/files/sitreps/G%C3%B6%C3%A7men%20Ka%C3%A7akc%C4%B1l%C4%B1%C4%9F%C4%B1%20Alg%C4%B1s%C4%B1%20ve%20G%C3%B6%C3%A7menlerin%20Karar%20S%C3%BCre%C3%A7leri.pdf, të datës 13.09.2020, ora 19:22
[1449] Strategjia shtetërore. "Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018". Prishtinë, 2013, fq.27

- Fushatat informuese
- Kufizimet e karrierës
- Nëpunësit e ndërlidhjes
- Ndalimi dhe pezullimi
- Proceset rajonale
- Sanksionet penale kundër trafikantëve njerëzorë
Masat për administrimin e kufijve
- Kufijtë e forcuar fizikisht (mur, rrjetë teli, etj., Mbikëqyrje elektronike)
- Përforcimi i kontrolleve dhe revizioneve në kufij
- Dokumentim si veçori të përparuar të sigurisë
- Të dhëna biometrike (Foto, gjurmë gishti, etj.)
- Rritja e trajnimit të rojeve kufitare
Masat paraprake pas hyrjes
- Mbajtje
- Inspektimet në vendin e punës
- Kontrollet e identitetit
- Përshpejtimi i procedurave të dëbimit
- Sanksionet ndaj punëdhënësve
- Kontrolli dhe kufizimi i udhëtimit nacional
- Kufizimi i aksesit në punë, vendbanim, këshilla juridike dhe shërbime të tjera sociale[1450]

Duke e parë rrezikun nga ky fenomen e cila mund të thuhet se ka dalë jashtë konktrollit për menaxhimin e skuksesshëm të flukseve të mëdha si çdo shtet edhe Turqia e ka të inkriminuar veprën penalet të kontrabandës me migrantë që ndikon edhe në paraqtijen e trafikimit me qenie njerëzore. *Me qëllim të përfitimit material direkt ose indirekt, në mënyrë të paligjshme:*
a) Ai i cili do të vendos një të huaj në vend ose e lejon atë të qëndrojë në vend,
b) Ai i cili mundëson që shtetasit turq ose të huajt të udhëtojnë jashtë vendit, dënohet me burgim nga tre vjet në tetë vjet dhe me gjobë gjyqësore në të holla prej njëmijë ditë në dhjetë mijë ditë. Edhe nëse krimi është në fazën e përpjekjes, ai dënohet sikur të ketë përfunduar[1451], e përcakton veprën penale të kontrabandës me migrantë. Pra, siç shihet Kodi turk e parasheh edhe emigrimin (largimin) edhe imigrimin (ardhjen), e cila në kuadër të saj e llogarit edhe përpjekjen për kryerje sikur është kryer dhe përfunduar vepra penale e kontrabandës me migrantë.

Mosekzistimi i harmonisë së politikave të kontrollit të migracionit në nivel ndërkombëtar dhe dallimet që lindin nga kjo mospajtueshmëri ndikojnë në rritjen e kontrabandës me migrantë dhe më pas edhe të trafikimit me qenie njerëzore dhe rritjen e veprimtarive të krimit të organizuar. Duke u bazuar në dallimet që ekzistojnë në mes të shteteve në aspektin e ekonomisë, punësimit, sigurisë, zhvillimit të luftërave edhe Unioni Evropian si një union e cila në lidhje me politikat e migracionit mundëson të kontrolloj me politikat e përbashkëta të shteteve anëtare nuk ja arrin qëllimin e parandalimit të migracionit, kontrabandës me migrantë e as të trafikimit me qenie njerëzore. Dallimet e mëdha midis të varfërve dhe të pasurve, diskriminimi në baza etnike, fetare, politike, raciale dhe rajonale, kanë nxitur n një vale të madhe të pakënaqësive, mostolerancës dhe dukurive të tjera, të cilat drejtëpërsëdrejti apo tërthorazi po kontribuojnë në viktimizimin e njeriut

[1450] Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008, vep. e cit., fq.396
[1451] Türk Ceza Kanunu nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611, neni 79, paragrafi 1

në të gjitha viset e botës[1452] po edhe në Turqi. Hulumtimi i IOM-it ofron prova të shumta se, megjithë mobilizimin e gjerë të instrumenteve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe veprimet antitrafik, një numër i madh i viktimave nga vendet e Evropës qendrore dhe lindore vazhdojnë të trafikohen në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.[1453] Sot, jemi dëshmitar të disa shteteve të Unionit Evropian të cilët janë si shtete të destinacionit të migrantëve dhe të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, të cilëve në një fare mënyrë i konvenon në rritjen e fuqisë punëtore ose në mbajtjen e ekonomisë së vendit me fuqin punëtore të migrantëve. Pra, ky fenomen do të vazhdojë derisa në shtetet e origjinës nuk luftohen shkaqet e migracionit, kontrabandës me migrantë dhe të trafikimit me qenie njerëzore. Në këtë drejtim në lidhje me shkaqet në mënyrë të veçantë e parasheh Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, e vitit 2000. Shtetet Palë nxisin forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim që të trajtohen shkaqet bazë, siç është varfëria dhe prapambetja, të cilat ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve kundrejt shitjes së fëmijëve, prostitucionit me fëmijë, pornografisë me fëmijë dhe turizmit me seks me fëmijë.[1454] Rregullimi juridiko ligjor në mënyrë direkte të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore ka filluar pas vitit 2002 e këndej. Që nga vitet 1990, shihet se organizatat kriminale i kanë zgjeruar aktivitetet e tyre në zonën ndërkufitare, veçanërisht duke organizuar trafikimin e grave, fëmijëve dhe qenieve njerëzore dhe duke i nënshtruar njerëzit në skllavëri në këtë botë të civilizuar.[1455]

Themelimi i organizatave kriminale të krimit të organizuar të cilët si një ndër veprimtarit kryesore e kanë edhe trafikimim me qenie njerëzore me të gjitha format dhe llojet e saja e vënë rrezikun e qytetarit si dhe harmoninë dhe rendin juridik të një shoqërie në tërësi. Neni 220- (1) Ata që themelojnë ose udhëheqin organizata me qëllim të kryerjes së veprave të cilat konsiderohen krime me ligj, dënohen me burgim nga dy deri në gjashtë vjet, nëse struktura e organizatës, numri i anëtarëve dhe mjetet dhe pajisjet janë të përshtatshme për kryerjen e veprave penale.[1456]

Neni 220 Krijimi i organizatës për kryerjen e krimeve

1. "Ata që krijojnë ose drejtojnë organizata për të kryer veprime të gjykuara si krime nga ligji dënohen me burgim nga katër në tetë vjet, nëse struktura e organizatës, numri i anëtarëve dhe mjetet dhe pajisjet janë të përshtatshme për kryerjen e krimeve të qëllimit. Sidoqoftë, numri i anëtarëve duhet të jetë së paku tre për ekzistencën e organizatës."

2. Ata të cilët anëtarësohen në organizatën e krijuar me qëllim të kryerjes së krimit do të dënohen me burg prej dy deri në katër vjet

3. Nëse organizata është e armatosur, ndëshkimi që do të shqiptohet sipas paragrafëve të mësipërm rritet nga një e katërta në gjysmë.

4.Nëse një krim kryhet brenda kornizës së aktiviteteve të organizatës, edhe për këto krime do të shqiptohet dënim i veçantë

5. Drejtuesit e organizatës gjithashtu ndëshkohen si autorë për të gjitha krimet e kryera në kuadrin e aktiviteteve të organizatës.

6. Dënimi që do të vendoset për anëtarësimin në organizatë mund të zvogëlohet deri në një të tretën, në varësi të natyrës së ndihmës.

[1452] Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011, fq.158

[1453] Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. "Prevencija trgovine ljudima". Beograd, 2006, fq.15

[1454] Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, miratuar më 25.5.2000, neni 10, paragrafi 3

[1455] Yurtcan, Erdener. "Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti". Ankara, 2016, fq.320

[1456] Po aty, fq.25

7. Kushdo që me vetëdije dhe me dëshirë ndihmon organizatën, megjithëse nuk përfshihet në strukturën hierarkike brenda organizatës, dënohet si anëtar i organizatës.
Në lidhje me paragrafin 1 vendi ynë parasheh personin që organizon grup bandë apo shoqatë për kryerjen e veprave penale të kontrabandës me migrantë dhe trafikimit me qenie njerëzore me denim prej së paku 4 vjet burg. Në anën tjetër edhe mos anëtarisimi në organizatë për kryerjen e krimit, po nëse krimi kryhet në emët të organizatës ata persona kanë përgjegjësi penale, por kjo vlen vetëm për organizatat e armatosura. Më vitin 2012 kemi plotësim të këtij neni me paragrafin e 7 në lidhje me personat që e ndihmojnë organizatën. "(Ndryshuar: 2/7/2012 - Neni 85/6352) Kodi penal Turk rritje të dënimit për organizatat kriminale parasheh nëse ata janë të armatosura, në pajtueshmëri me paragrafet e mësipërm të këtij neni e cekur në paragrafin e 3. Një karakteristikë tjetër e Kodit Turk ka të bëjë me propagandën që legjitimiton dhe inkurajon përdorimin e forcës, dhunës ose kërcënimit dhe mjeteve tjera të shtrëngimit përmes të cilëve organizatat kriminale e kryejnë veprimtarinë e tyre. Duke u bazuar në individualizimin dhe pjesëmarrjen në krim Kodi penal e ka paraparë këtë paragraf.

Si në çdo shtet po ashtu edhe në Turqi në lidhje me liritë dhe të dretjat themelore të qytetarëve të saj dhe të huaj e rregullon Kushtetuta. Përveç Kushtetutës, ekzistojnë rregullore ligjore që mund të përdoren posaçërisht në luftën kundër trafikimit ndërkombëtar të njerëzve, të cilat mund të llogariten si Ligji i Pasaportave nr. 5682, Ligji Nr. 4817 mbi Lejet e Punës së të Huajve dhe Ligji Nr 5901 i Shtetësisë Turke.[1457] Marëveshja e parë ndërkombëtare në lidhje me trafikimit e grave nga ana e Turqisë është e vitit 1933 e quajtur si "63% e trafikantëve janë burra dhe 37% janë gra. Shkalla e grave që përfshihen në këtë krim është më e lartë se krimet e tjera (në krime të tjera, shkalla e grave kriminale është rreth 10%)."[1458] Ekzistojnë edhe shum akte tjera të cilat Turqia është nënshkruese dhe i ka pranuar të inkorporojë drejtat dhe detyrat që burojnë nga ata dhe ate: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1948), Konventa kundër skllavërisë (1957), Kontrata për Ndërprerjen e Punës të Detyrueshme (1960), Marrëveshja për të drejtat e fëmijëve (1995), Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë (2002), Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (2000), Konventa për Aspektet Ligjore të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve (2000), Konventa nr. 29 e ONP-së për punën e detyruar (1998), Konventa për ndalimin dhe zhdukjen e punës së detyruar të fëmijëve në kushte të rënda ILO 182 (2001), Konventa e KB për Krimin e Organizuar Ndërkufitare, dhe Protokollet për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Kontrabandës së Migrantëve (2003) etj.

[1457] Bolat, Gürbüz Akhan. Disertacion i doktoraturës " Berdel töresi ve insan ticareti". Ankara, 2013, fq.85
[1458] Dündar, Tuba. Özel, Elif. "Insan ticareti suçunu anlamak", Istanbul, 2017, fq.9

Hipotezat kryesore:

Proceset e migracionit a ndikojnë në paraqitjen dhe rritjen e veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
Sa është sensibilizuese sistemi aktual legjislativ dhe informativ në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbi fenomenin e trafikimit me qenie njerëzore?
Cilët janë faktorët domonues që ndikojnë në emigrimin e personave të krahasim me faktorët që ndikojnë në viktimizimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
Në çfarë niveli është bashkëpunimi mes institucional në vend, rajonal dhe ndërkombëtar për luftimin dhe parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore sidomos gjatë proceseve të migracionit?
Sa është sensibilizuese sistemi aktual legjislativ dhe informativ në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me kthimin e viktimave në vendbanimet e tyre të përherhshme dhe si është perceptimi i qytetarëve në lidhje me viktimat e trafikimit me qenie njerëzore?
Grupet e krimit të organizuar për kryerjen e trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë së Veriut a dallohen nga grupet e krimit të organizuar të vendeve të tjera?
Sa është funksionale parimi i mosdënimit dhe dëmshpërblimit i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
Republika e Maqedonisë së Veriut çfarë pozite ka në lidhje me shfrytëzimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore?
Si qëndron raporti në mes trafikimit të qenieve njerëzore të brendshëm dhe ndërkombëtar?
Në Republikën e Maqedonisë së Veriut a ekziston tipologji e re të trafikimit me qenie njerëzore?
Sa qëndron pohimi se besueshmëria e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore kompetente ndikon në përmirësimin dhe suksesin e luftimit ndaj trafikimit me qenie njerëzore?
A do të ndikonte anëtarësimi i vendeve të rajonit në Tier 1, në luftimin dhe parandalimin më efikas të trafikimit me qenie njerëzore?
A do të ishte më efikas menaxhimi i flukseve masovike të migracionit ndërkombëtar dhe parandalimi i devijimit të migracionit së pari në migrime të parregullta dhe ilegale pastaj në kontrabandën e migrantëve si dhe në fund në trafikimin me qenie njerëzore, nëse primare do të ishte bashkëpunimi formal dhe joformal në mes të shteteve që preken nga migrimet masovike që nga vendi i origjinës, tranzitit dhe të destinacionit?
Në lidhje me flukset masovike të migracionit a do të ishte më efikas patrullimi dhe koordinimi i përbashkët të institucioneve kompetente me vendet fqinje si dhe me shtetet e Unionit Evropian?
Në çfarë mase qëndron rrezikshmëria e përdorimit të rrjeteve sociale dhe webfaqeve fiktive për realizimin e trafikimit me qenie njerëzore nga ana e trafikantëve ?
Cilët janë grupet e rrezikuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga trafikimi me qenie njerëzore dhe për cilin lloj të eksploatimit shfrytëzohen viktimat?

Përmbyllje dhe rekomandime:

Proceset e migracionit që nga historia e njerëzimit e deri në ditët e sodit vazhdon të jetë prezente në çdo vend të botës poashtu edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut e cila si pasojë e ndikimit të faktorëve dhe shkaqeve të ndryshme është shprehur në sasi, dinamikë dhe forma të ndryshme në periudha të ndryshme kohore. Përveç emigrimeve të brendshme brenda shtetit vendi ynë viteve të fundit karakterizohet me rritjen e emigracionit ndërkombëtar sidomos pas liberalizimit të vizave nga Unioni Evropian por përshkak të natyrës së kësaj dukurie vendi ynë nuk

ka statistika në lidhje me këtë fenomen përshkak se qytetarët nuk kanë realizuar punime juridike në lidhje me ndryshimin e vendbanimit sidomos të shtetit ku jeton dhe vepron. Nga proceset e migracionit viteve të fundit vërehet një rritje e madhe e migracionit ndërkombëtar të cilët vendit tone e kalojnë transit duke udhëtuar drejt shteteve të perëndimit dhe në krahasim me shtetet e rajonit sidomos me Republikën e Kosovës, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës e cila llogaritet edhe si vala Ballkanike e migrantëve vendi ynë në sasi ka qenë më shumë i prekur nga ky fenomen. Në krahasim me Republikën e Turqisë vendi ynë është shumë më pak i prekur nga vala e migrantëve sepse migrantët Turqinë përveç se e llogarisin si vend transit një pjesë e madhe e tyre edhe si vend i destinacionit që nënkupton se Turqia nga qenë e prekur në masë të madhe nga ky fenomen.

Proceset e migracionit si gjatë historisë po edhe sot e kësaj dite është shoqëruar edhe me devijime të ndryshme të cilët kanë arritë deri në trafikimin e migrantëve për qëllime të ndryshme të grupeve të krimit të organizuar. Devijimi i proceseve të migracionit më shumë është shprehur tek migracionit ndërkombëtar sidomos tek popujt të cilët si faktorë të luftërave, papunësisë dhe varfërisë në vendet e tyre të origjinës në një anë dhe në anën tjetër në shtetet e destinacionit si shkak i lehtësimeve në lidhje me drejtën e azilit, mungesës së fuqisë punëtore, pagave të larta dhe perspektivës ka ndikuar në masë të madhe edhe në rrezikshmërinë e tyre në viktimizim nga trafikantët e qenieve njerëzore si dhe nga kontrabanduesit e kontrabandës me migrantë. Trafikantët e qenieve njerëzore gjetjen, mashtrimin, rekrutimin, transportimin dhe shfrytëzimin e viktimave mund të realizojnë si në vendet e origjinës, tranzitit dhe të destinacionit, por më së shumti në vendet e destinacionit të migrantëve përshkak të natyrës së fenomenit sepse trafikantët ofrojnë ndihmë dhe lehtësime të ndryshme migrantëve duke i mashtruar deri në vendet e destinacionit. Në rastin konkret rrezikshmëria e trafikimit me qenie njerëzore gjatë flukseve masovike të emigracionit ndërkombëtar Maqedonia e Veriut ka pozitën e shtetit të tranzitit dhe e cila kishte një rol kyç të menaxhimit të kësaj dukurie sidomos gjatë viteve 2015-2016.

Trafikimi me qenie njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit në të shumtën e rasteve realizohet ndaj kategorive dhe migrantëve të rrezikuara dhe të cenuara të cilët më shpesh janë grate, vajzat e reja dhe fëmitë. Gjatë flukseve masovike të migracionit ndërkombëtar realizimi I trafikimit me qenie njerëzore nga ana e grupeve të krimit të organizuar së pari realizohet duke I ofruar atyreve ndihmë dhe asistencë sipas marrëveshje paraprake në mes të migrantit dhe kontrabanduesit për kalim të sigurt, shpejt dhe pa pasoja kufijt shtetëror me qëllim të arritjes deri në vendet e destinacionit. Përshkak se bëhet fjalë për grupe kriminale të cilët e kryejnë edhe trafikimin e qenieve njerëzore ata ofrojnë migrantëve edhe punësime, strehim, rregullim të dokumentacionit në vendet e destinacionit duke e shfrytëzuar pozitën e rëndë financiare, mosnjohja e gjuhës dhe të sistemit juridic të vendeve të destinacionit e cila në fakt është edhe faza e pare e trafikimit me qenie njerëzore sidomos mashtrimi apo rekrutimi i tyre. Mashtrimi mund të jetë i plotë apo i pjesërishëm ndaj migrantëve, pra ndonjëherë mashtrohen tërësisht në lidhje me punën, strehimin, kushtet e punës dhe veprimet të tjera kurse ndonjëherë njoftohen për punën që do e bëjnë por jo edhe për kushtet të tjera të punës. Si metodë e re e mashtrimit të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore është e ashtuquajtura metoda e dashnores e cila në mas të madhe sidomos përmet rrjeteve sociale mashtrohen për martesa nga trafikantët dhe të cilët rekrutimin e realizojnë përmes rrjeteve sociale të cilët e vështirësojnë zbulimin, parandalimin dhe luftimin e saj.

Sa i takon faktorëve në shumë vende të botës llogariten faktorët shtytës të emigracionit në vendet e origjinës si më të shpeshta janë: varfëria dhe skamja, papunësia dhe pagat e ulëta, luftërat, kurse si faktorë apo shkaqe tërheqëse në vendet e destinacionit shpesh paraqiten punësimi dhe

kushtet e punës, pagat e larta, perspektiva, bashkimi familjar etj. Këto faktorës shtytës në vendet e origjinës dhe tërheqës në vendet e destinacionit janë karakteristika dhe pothuajse të njejta edhe në vendin Republikën e Maqedonisë ku përveç shkaqeve të luftës nuk e kemi të shprehur siç është rasti me migrantët nga Lindja e Mesme. Fenomeni i migracionit të trurit është në rritje në shumë vende me ekonomi dhe zhvillim ekonomik të dobët dhe ku nuk ekziston një perspective nga ana e personave me arsim të lartë të cilët perspektivën e tyre e shohin në vendet e zhvilluara sidomos të Evropës Perëndimore. Në vendin tone ky fenomen viteve të fundit shënon rritje të madhe sidomos mjekë dhe specialist mjekësor drejt Evropës sidomos viteve të fundit dominon Gjermania shtet i cili shtetasve tonë i lehtësojë procedurat e aplikimit dhe kushtet e marrjes së vizave të punës. Nëse vazhdon rritja dhe trendi i emigracionit ndërkombëtar në Maqedonin e Veriut atëherë në të ardhmen do të kemi mungesë e popullatës active dhe të rrinjve si dhe mungesë e kuadrit professional të drejtimeve të ndryshme sidomos të mjekëve dhe profesionistëve të informatikës.

Ngjajshëm si faktorët e proceseve të migracionit janë edhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore me dallime të vogla. Si faktorë që dominon në shtetet e origjinës në paraqitjen e trafikimit me qenie njerëzore dhe të cilët llogariten si faktorë shtytës janë faktorët ekonomik sidomos papunësia, varfëria dhe skamja. Viteve të fundit dominon edhe faktori i luftës e cila ka ndikuar në masë të madhe sidomos kategoria e cenueshme të grave dhe të fëmijëve të cilët duke kërkuar shpëtim ata bien lehtë pre e grupeve të krimit të organizuar të cilë më tutje trafikohen në vendet e zhvilluara perëndimore për shfrytëzim sidomos me qëllim të shfrytëzimit seksual dhe punës së detyruar. Si pasojë e luftërave trafikimi me qenie njerëzore ndikojnë edhe proceset e migracionit dhe llogariten si faktorë shtytës sidomos migracionit ndërkombëtar që është në favor dhe dobi të trafikantëve duke e shfrytëzuar gjendjen e rëndë të migrantëve të migrojnë përmes mashtrimit i viktimizojnë ato me qëllim të shfrytëzimit si në vendet e origjinës, tranzitit apo të destinacionit. Faktorë tjetër e cila viteve të fundit është në rritje dhe e cila ka të bëjë me ate se viktimat përherë nuk janë persona të papunë ose të varfër por ekzistojnë edhe persona që janë viktima duke u bazuar në fitime të larta dhe risk të ulët. Me zhvillimin e teknikës dhe teknologjisë sidomos me rritjen e numrit të përdoruesve të rrjeteve sociale si një modus operandi i ri që praktikojnë trafikantët janë edhe mashtrimet që ndodhin përmes rrjeteve sociale dhe faqeve fiktive përmes rrugës së internetit të cilët në një anë me lehtë e kanë të gjejnë viktima të mundshëm të trafikimit, mashtrimi dhe bindja më e lehtë e viktimave si dhe në anën tjetër rreziku i ulët i zbulimit nga organet kompetente. Ndikim në rritjen e migracionit ndërkombëtar sidomos rë rrinjve e cila ndikon edhe në rritjen e rrezikshmërisë së viktimizimit të tyre në vendet e destinacionit është edhe liberalizimi i vizave, kërkesa e tregut botëror dhe globalizmit. Ky lloj është rëndë të vërtetohet numri i saktë i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore që shfrytëzohen jashta vendit sepse vendet e destinacionit janë të largëta dhe këta nuk e paraqesin viktimizimin e tyre. Ky lloj i trafikimit me qenie njerëzore llogaritet edhe si trafikimi sezonal i qenieve njerëzore sidomos ky lloj filloj të realizohet pas liberalizimit të vizave duke përfituar lirinë e qarkullimit pa viza për shtetasit e vendit sidomos në shtetet e Unionit Evropian dhe për këtë lloj të trafikimit është rëndë të sigurohen të dhëna statistikore.

Fenomenologjia apo format e trafikimit me qenie njerëzore siç dihet janë me qëllim të prostitucionit, punës së detyruar, lëmoshës së detyruar, kryerjen e krimeve, heqjen e organeve dhe për qëllime të tjera. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut trafikimit me qenie njerëzore e cila më shumë është shprehur është ajo me qëllim të shfrytëzimit për prostitucion dhe lëmosha e detyruar. Vendi ynë karakterizohet me numër të madh të vendeve ku shfrytëzohen viktimat e trafikimit me qenie njerëzore dhe e cila më shumë është shprehur gjatë sezonit të verës dhe të dimrit paralelisht me rritjen e numrit të mërgimtarëve në vend dhe kështu kjo ka ndikuar që forma e shfrytëzimit të

viktimave për prostitucion të marrë formën e shfrytëzimit sezonal për prostitucion të viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Vendet ku shfrytëzohen viktimat me qëllim të prostitucionit janë klubet e natës, striptiz bare, objekte hotelerike dhe tl ngjajshëm, por viteve të fundit është paraqitur edhe prostitucioni e cila mbulohet nën maskën e ofrimit të masazheve profesionale në banesa dhe shtëpia private e cila e vështirëson zbulimin e tyre nga organet kompetente. Sa I takon shfrytëzimit të viktimave të trafikimit për lëmoshë të detyruar në pamje nuk duket se ekziston dhe nga ana e organeve kompetente nuk mirren masa të duhura për këtë fenomen sidomos tek popullata rome ku më shumë si viktima paraqiten grate dhe fëmitë.

Gjatë trafikimit me qenie njerëzore shtetet kanë pozitën e vendit të origjinës të tranzitit apo të destinacionit dhe të cilët sipas pozitës kanë të drejta dhe detyra në lidhje me luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie. Anda vendi ynë më herët sidomos para liberalizimit të vizave llogariteshte si shtet I destinacionit për shumë vajza të reja që vinin nga shtetet fqinje po edhe më larg sidomos: Bullgaria, Serbia, Shqipëria, Kosova, Romania, ukraina dhe shtetet tjera, kurse viteve të fundit më e ka pozitën e shtetit të origjinës dhe të tranzitit.

Profili I viktimave të trafikimit me qenie njerëzore ngjajshëm si në shumë vende poashtu edhe në vendin tonë dominon gjinia femërore, nga vendbanime ku dominon papunësia, varfëria, familje të degraduara me shumë anëtar si dhe familje ku ekiston dhuna. Shumica e viktimave u takojnë moshave nga 25 deri 35 vjet dhe vijnë nga vendbanimet rurale ku dominon pjesa jugperëndimore. Gjithashtu si viktima paraqiten nga të gjithë nacionalitetet duke u bazuar në përbërjen heterogjene të popullatës vendase kur kemi të bëjmë me trafikimin e brendshëm të qenieve njerëzore. Kur kemi trafikimin e viktimave drejt Maqedonisë kemi të bëjmë me shtetase të huaja sidomos nga vendbanimet e shteteve fqinjetë moshës së re të cilët vijnë nga familje ku dominon varfëria, papunësia, problemet familjare etj. Në anën tjetër kryerësit apo trafikantët dominon absolutisht gjinia mashkullore por ka edhe femra sidomos në fazën e pare të trafikimit gjatë rekrutimit sidomos në pjesën e mashtrimit. Kryerësit janë persona të cilët kanë dosje kriminale të mëhershme të llojeve të ndryshme kriminale në vend apo edhe jashta saj dhe janë të moshës së rritur disomos mbi 45 vjet. Këta persona gjithashtu kanë edhe bashkëpunim criminal me grupe dhe persona nga shtetet tjera sidomos nga shtetet prej nga janë edhe viktimat e tyre të cilët bashkëpunojnë në trafikimin e njerëzve. Sai takon nivelit të arsimit si kryerës po edhe si kryerës shumica janë me arsim të mesëm, fillor por ka edhe raste me arsim të lartë por më pak. Kurse sa I takon kryerësve dhe viktimave janë të nacionaliteteve të ndryshme si shkak I përbërjes heterogjene të popillatës e cila ndikon që edhe ata të jenë të nacionaliteteve të ndryshme.

Si një ndër procedurat më të rënda e cila kërkon profesionalizëm të nivelit të lartë është identifikimi I viktimave të trafikimit me qenie njerëzore dhe ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës ndaj tyre. Rëndësia e identifikimit është e veçantë përshkak se në bazë të identifikimit të veërtetë, të saktë dhe në kohë do të realizohej parimi I mosdënimit dhe ofrimit të mbrojtjes dhe ndihmës së nevojshme. Përmes identifikimit të viktimave të trafikimit më pas realizohet edhe e drejta e dëmshpërblimit dhe kthimit të viktimave në vendbanimet e tyre të përherhshme. Andaj identifikimi I viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në vendin tone realizohet me vështirësi të shumta e cila pengon edhe realizimin e një sërë të drejtave dhe ofrimi I mbrojtjes adekuate sepse shpesh këta persona nuk I besojnë organeve kompetente për bashkëpunim me qëllim të zbulimit edhe të kryerësve të trafikimit. Identifikimi duhet të realizohet nga kuadër shumë professional sepse është një çështje shumë e komplikuar sepse në praktikë edhe personat që mirren me prostitucion vullnetar shpesh mbulohen nën ombrellën se janë viktima të trafikimit. Andaj ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të njerëzve sidomos të viktimave të vërtetë është e rëndësisë së veçantë për ariitjen e identifikimit të suksesshëm të viktimave dhe përfitimit të një sërë të drejtave ku e drejta

e dëmshpërblimit dhe të kompenzimit llogaritet si një e drejtë më kryesore e viktimave. Në vendin tone viktmat që kanë fituar dëmshpërblim nga trafikantët janë shumë të pakët si dhe numër të vogël të pagesës së dëmshpërblimit nga ana e shtetit kur viktimat nuk mund të fitojnë nga trafikantët sepse janë në ikje ose nuk kanë asgjë e cila do të mund të kompenzoj dëmin e shkaktuar. Andaj në këtë drejtim shteti duhet të përmirësoj këtë situate duke e rritur buxhetin për realizimin e kësaj të drejte të viktimave.

Aspiratat e vendit tonë për anëtarësim në Unionin Evropian ka ndikuar që të rregullohen një sërë çështjesh ku bën pjesë edhe rregullimi juridiko-penal i trafikimit me qenie njerëzore duke qenë në harmoni me drejtën dhe aktet ndërkombëtare, me drejtën e Unionit Evropian dhe mund të thuhet se kemi një legjislacion juridiko penal që i plotëson standardet evropiane dhe ndërkombëtare për luftimin dhe parandalimin ekëtij fenomeni të rrezikshëm. Përveç rregullimit juridiko penal të mirëfillt ajo duhet edhe të zbatohet në praktikë sidomos me rritjen e numrit të zbulimeve të rasteve dhe zbulimin e formave të tjera të shfrytëzimit të viktimave të trafikimit sidomos për lëmoshë të organizuar, puna e detyruar dhe heqjen e organeve të cilët në vendin tonë shumë pak janë duke u analizuar. Andaj përveç rregullimit të mirëfillt de jure të fenomenit të trafikimit duhet edhe de facto të përsosen mjete dhe metoda të rreja të operativës për zbulimin dhe identifikimin e rasteve të traikimit me qenie njerëzore dhe viktimave të tyre.

Derisa grupet e krimit të organizuar, grupet, bandat apo shoqatat kriminale funksionojnë në bazë të parimit të bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve kriminale në një vend ose në disa shtete është e radhës që të ekzistojë bashkëpunimi edhe në mes të organeve kompetente që e luftojnë kriminalitetin në vend rajon po edhe në nivel ndërkombëtar dhe e cila është e patjetërsueshme në arritjen e rezultateve pozitive ndaj këtij fenomeni shumë të rrezikshëm. Bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve sidomos në pjesën e operativës dhe ndërmarjes së masave të hetimore dhe para hetimore në vend më shumë duhet të jenë në mes të: policisë, policisë kufitare, gjykatave dhe prokurorisë publike si organe kyçe të cilët kanë role aktive në zbulimin, procedurën dhe dënimin e kryerësve të veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore. Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve edhe në mes të inspektoriatit të punës dhe të tregut do të jetë në ndihmë të madhe në zbulimin e viktimave të trafikimi në objekte të ndryshme të cilët nuk janë të paraqitura dhe punojnë në mënyrë ilegale. Po ashtu rëndësi të madhe ka edhe bashkëpunimi dhe kordinimi me punëtorët social pranë Ministrisë së punës dhe politikës sociale si dhe policisë kufitare sepse në rastin konkret kemi të bëjmë trafikimin me qenie njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit. Bashkëpunimi mesinstitucionale në vend duket se ekziston por në praktikë nuk kemi arritje të rrezultateve në rritjen e zbulimit të viktimave të trafikimit sidomos për lëmoshë të organizuar dhe punës së detyruar. Andaj bashkëpunimi dhe kordinimi i aktiviteteve në mes të institucioneve të vendit duhet të jetë të nivelit më të lartë dhe të përmirësohet edhe më tutje. Bashkëpunimi dhe koordinimi formal po ashtu edhe joformal në mes të vendeve të rajonit kundër trafikimit me qenie njerëzore do të ishte një qasje më serioze e cila do të përmirësoj rezultatet e luftimit të këtij fenomeni sidomos me patrullime të përbashkëta dhe intensifikimin e shkëmbimit joformal të informatave në lidhje me këtë fenomen. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërkombëtar është i patjetërsueshëm për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore përshkak se shpesh viktimat barten prej një shteti në një shtet tjetër dhe e cila është e patjetërsueshme që të parandalohet ky fenomen sidomos bashkëpunimi ndërkombëtar policor.

Rëndësi të veçantë në lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin e aktiviteteve sidomos ato preventive ka të bëjë në mes të institucioneve shtetërore në një anë dhe në anën tjetër të organizatave joqeveritare dhe institucioneve lokale. Ky bashkëpunim duhet të përmirësohet dhe të forcohet edhe më shumë në pjesëmarrjen dhe përkrahjen e aktiviteteve të këtyre institucioneve

sepse shpesh qytetarët më shumë besim kanë tek organizatat joqeveritare dhe institucionet lokale sesa institucionet qeveritare që gjë tregon edhe rezultatet e anketës së realizuar në nivel shtetëror. Afrimi dhe realizimi i aktiviteteve të përbashkëta mes institucioneve qeveritare, lokale dhe organizatave joqeveritare do të përmirësoj edhe qasjen më serioze të rrezikshmërisë së këtij fenomeni në vendbanimet e tyre dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucioneve komeptente sidomos ndaj policisë.

Aktivitetet e organizatave joqeveritare janë të llojit preventiv dhe këto aktivitete të tyre do të ishte në ndihmesë të madhe në ngritjen e vetëdijes dhe ndrëgjegjësimit të popullatës për rëndësinë e kuptimit të trafikimit, format e realizimit, mënyrën e veprimit dhe mjetet dhe metodat që përdorin për rekrutimin, trasportin dhe shfrytëzimin e viktimave. Pra, aktivitetet e organizatave joqeveritare duhet të përkrahet nga buxheti shtetëror sidomos përmes realizimit të semianreve, paneleve, përgaditjes së broshurave, fletushkave organizimin e konferancave informative në lidhje me rrezikshmërinë e kësaj dukurie. Përkrahja e aktiviteteve të organizatave joqeveritare më shumë duhet të organizihen grupeve të rrezikuara dhe në vende rurale prej nga edhe buron numri më i adh i viktimave të trafikimit. Përmes rritjes së vetëdijes do të ritet edhe reagimi i shoqërisë ndaj këtij fenomeni sidomos ndaj trafikantëve përmes paraqitjes së rasteve dhe e cila do të ndikoj edhe në rritjen e besueshmërisë ndaj institucioneve shtetërore dhe organizatave joqeveritare. Andaj rritja e bxhetit shtetëror për përkrahjen e aktiviteteve preventive të organizatave joqeveritare në vendit tonë është e patjetërsueshme dhe e domosdoshme e cila viteve të fundit është në zvogëlim të madh të ndarjes që mjeteve financiare për këtë qëllim.

Krahasimi i aspektit juridiko penal të trafikimit me qenie njerëzore në mes të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Republikës së Turqisë, Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës di dhe ndikimi i proceseve të migracionit në këto shtete vlen të ceket se ndikimi i proceseve të migracionit në trafikimin e qenieve njerëzore dhe vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore në këto vende në periudha të ndryshme shprehet në sasi dhe dinamikë të ndryshueshëm në periudha të ndryshme kohore. Proceset e migracionit sidomos migracioni ndërkombëtar më shumë është shprehur në Republikën e Turqisë kurse vepra penale e trafikimit me qenie njerëzore nuk është aq e madhe duke u bazuar në numrin e migrantëve ndërkombëtar sidomos në vitin 2015 dhe në numrin e popullsisë së përgjithshme. Më pas proceset e migracionit të shprehur është Republika e Maqedonisë së Veriut e cila u prek shumë edhe nga valët e migracionit ndërkombëtar, pastaj Republika e Shqipërisë, të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe të Kosovës. Numër të madh të rasteve të zbuluara të trafikimit me qenie njerëzore dukshëm dominon Shqipëria, pastaj Turqia, Bosnja dhe Hercegovina si dhe Maqedonia dhe Kosova më pak.

LISTA E SHKURTIMEVE

ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
LNJF	Ligji për Ndihmë Juridike Falas
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
KPM	Kodi Penal i Maqedonisë
KP	Kodi Penal
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
RF	Republika Federale
UE	Unioni Evropian
KB (OH)	Kombet e Bashkuara
LPP	Ligji i Procedurës Penale
EUCPN	Rrjeti Europian për parandalimin e kriminalitetit
TIER	Rangim nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
LAMP	Ligji për Azil dhe Mbrojtje të Përkohshme
SEKI	Qendër-Sektor për Bashkëpunim Ndërkombëtar policor
BE	Bashkimi Evropian
GRECO	Grupi i shteteve kundër korupsionit
ASEAN	Shoqata e Kombeve të Azisë Juglindore
GRETA	Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
LSD	Lysergic Acid Diethylamide-lloj droge gjysmë sintetike
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
LIP	Ligji për Inspektim të Punës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
UNHCR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
IKAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
ISO	Standard për Menaxhimin e Cilësisë
QPS	Qendra për Punë Sociale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MKR	Mekanizmi Kombëtar për Referim
WAV	Shoqatë Botërore e Viktimologjisë
PAN	Organizatë Amerikane Shëndetësore
LPP	Ligji i Procedurës Penale
SKKFD	Sektori për Kriminalitet Kompjuterik dhe Forenzikës Digjitale
TQNJ	Trafikimi i Qenieve Njerëzore
QSHM	Qendra e Shërbimeve për Migrantë
KDF	Konventa për Drejtat e Fëmijës
QKPVT	Qendra Kombëtare Pritëse për vitimat e trafikimit
BeH	Bosnja dhe Hercegovina
VeT	Viktimat e Trafikimit

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË
CIKLI: PHD
PROGRAMI STUDIMOR: E DREJTA PENALE

Anketë-pyetësor për hulumtimin e perceptimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë

"Trafikimi me qenie njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2015"

Kandidati:
Ma.Sc. Ersin Sulejmani PhD.Candidate

Anketa e bashkangjitur ka për qëllim hulumtimin e perceptimit të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë lidhur me temën e doktoraturës e cila titullohet "Trafikimi me qenie njerëzore si pasojë e ndikimit të proceseve të migracionit në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës 2005-2016" Ju lutem në përgjigje reale dhe objektive nga ana e juaj sepse të dhënat tuaja personale do të jenë plotësisht secrete dhe nuk do të reklamohet për qëllime të reklamimit përveç nevojave të përgaditjes së punimit doktoraturës. Plotësimi i anketës duhet të jetë me rrethim vetëm njërën prej përgjigjeve të cilën mendoni se është e shprehur më shum

Paraprakisht falemenderohem për mirëkuptim!

ANKETA 1
(Trafikimi me qenie njerëzore)-me rrethim të përgjigjes

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME -PERSONALE

1.Gjinia: Mashkull☐ Femër☐
2.Mosha: 18-29☐ 30-51☐ 51- 61☐ mbi 61☐
3.Niveli i arsimit: Fillore☐ Mesme☐ Fakultet☐ Magjistër☐ Doktorant☐ Të tjera☐
4.Regjioni: Shkupi☐ Perëndim☐ Jug☐ Veri☐ Lindje☐
5.Vendbanimi: Fshat☐ Qytet☐
6.Statusi martesor: Martuar☐ Pamartuar☐
7.Statusi social: Punësuar në administratë shtetërore☐ Pa punësuar☐ Punëtor sezonal☐ Student☐ Punëtor krahu☐
8.Gjendja ekonomike: Varfëri ekstreme-ndihmë sociale☐
Varfëri-me hyra jo mjaftueshme mujore☐ Mesatare-ardhura të mjaftueshme dhe përballuese mujore☐ Të pasur☐ Shumë të pasur☐
9.Nacionaliteti: Maqedon☐ Shqiptar☐ Turq☐ Romë☐ Boshnjak☐ Serb☒
10.Religjioni: Musliman☐ Ortodoksë☐ Katolik☐ të tjerë ☒

TË DHËNA PËR PERCEPTIMIN E JUAJ LIDHUR ME TRAFIKIMIN ME QENIE NJERËZORE

11.A jeni të informuar për kriminalitetin e organizuar?
Shumë☐ Pjesërisht☐ Pak jam i informuar☐ Aspak i informuar☐
12.A jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore?
Shumë☐ Pjesërisht☐ Pak jam i informuar☐ Aspak i informuar☐
13.Nga kush jeni të informuar për trafikimin me qenie njerëzore?
Prindërit☐ Tv☐ Gazetat☐ Rrjetet sociale☐ Shkollë☐ Fakultet☐ Shoqëria☐
Vendi I punës☐ Nga trafikantët☐ Nga viktimat e trafikimit☐ Nga klienti☐ Nga të tjerit☐ nuk jam e informuar ☐
14.A vizitoni ndonjëherë portale, media ose rrjete sociale me përmbajtje të dukurive kriminale?
Shumë☐ Nganjëherë/rallë☐ Pakës☐ Aspak nuk viztoj☐
15.A mendoni se ka trafikim me qenie njerëzore në Maqedoni?
Shumë☐ Pakës☐ Nuk e di☐ Aspak☐
16.Sipas jush cilët janë shkaqet që viktimat bien në duart e trafikantëve?
Papunësia☐ Varfëria☐ Problemet familjare☐ Kushtet e rënda të banimit☐ Arsimimi☐ Mashtrim në rrjetet sociale☐ Korrupcioni☐ Nuk e di☐
17.Rrjetet sociale siç janë facebook-u dhe Instagram-i a ndikojnë në viktimizimin e personave nga trafikantët?
Shumë☐ Pak☐ Ndoshta☐ Nuk di☐ Aspak☐
18.A besoni në reklamat e rrejteve sociale për gjetjen e punës dhe rregullimin e dokumentacionit për shtete të ndryshme?
Shumë☐ Pak☐ Ndoshta☐ Nuk di☐ Aspak☐
19.A keni vizituar objekte hotelerike ku ofrohen marëdhënie seksuale dhe striptiz bare?

Shpesh☐ Nganjëherë/rrallë☐ Asnjëherë☐

20.Femrat bëhen viktima të trafikimit si shkak i mashtrimeve për punësim, modele, martesa ose arsimim? Po☐ Ndoshta☐ Nuk e di☐ Jo☐

21.Cilat janë gjasat që ju të jeni viktimë e trafikimit me qenie njerëzore?

Mundshme☐ Pjesërisht e mundshme☐ Nuk e di☐ Aspak e mundshme☐

22.Sipas jush sa është i përhapur trafikimi me qenie njerëzore?

Shumë☐ Mesatarisht☐ Pak☐ Nuk e di☐ aspak ☐

23.Sipas jush sa është i përhapur prostitucioni në RM?

Shumë☐ Mesatarisht☐ Pak☐ Nuk e di☐ aspak ☐

24.Sipas jush cili lloj i prostitucionit është i përhapur më shumë në RM?

Sallone masazhe☐ Objekte hotelerike☐ Restorante☐ Striptiz bare☐ Rrugëve ☐

25.Sa jeni të shqetësuar me prezencën e prostitucionit në RM?

Shumë☐ Pakës☐ Nuk e di☐ Nuk jam☐

26.Cilit institucion i besoni më së shumti për ta lajmëruar, dëshmuar se një person është trafikant, viktimë ose klient?

Qeveria☐ Doganat☐ Policia kufitare☐ Presidenti☐ Komunat☐ Ministria e punëve të brendshme☐ OJQ☐ Nuk e di☐

27.Cilit institucion më pak i besoni për ta lajmëruar, dëshmuar se një person është trafikant, viktimë ose klient?

Qeveria☐ Doganat☐ Policia kufitare☐ Presidenti☐ Komunat☐ Ministria e punëve të brendshme☐ OJQ☐ Nuk e di☐

28.Nëse vëreni një rast të trafikimit me qenie njerëzore, trafikant, shfrytëzues ose viktimë në vendin tuaj a do të paraqitni dhe dëshmoni para organeve kompetente?

Po☐ Ndoshta☐ Nuk e di☐ Jo☐

29.Për çka i shfrytëzojnë më shumë trafikantët me qenie njerëzore viktimat e tyre?

Adoptim☐ Lëmoshë☐ Heqjen e organeve☐ Fuqi punëtore☐ Shfrytëzim seksual☐ Kryerjen e krimeve☐ Nuk di☐

30.Sipas jush kush janë më shumë viktima të trafikimit me qenie njerëzore?

Fëmitë☐ Vajzat e reja☐ Femrat☐ Gratë e moshuara☐ Meshkujt djemt e ri☐ Burat e moshuar☐ Nuk di☐

31.Sipas jush cilët persona kanë rezikshmëri për tu trafikuar?

Shtetas të R.M.☐ Shtetas të huaj☐ Të gjith☐

32.Sipas jush cilët janë shkaqet e trafikimit me qenie njerëzore në RM?

Papunësia☐ Varfëria☐ Problemet familjare☐ Kushtet e rënda të banimit☐ Arsimimi☐ Mashtrim në rrjetet sociale☐ Fitim i madh i trafikantëve☐ Fitim i madh i viktimave☐ bashkëpunimi i policisë me grupe kriminele☐ Korrupsioni☐ Nuk e di☐

33.Sipas jush ndikim më të madh për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore kanë?

Familja☐ Shoqëria☐ Shkolla(arsimimi)☐ Policia☐ OJQ☐ Nuk e di☐

34.Sipas jush sa është i rrezikshëm për rrethin-shoqërinë kthimi i viktimave të trafikimit me qëllim prostitucioni?

Shumë☐ Mesatarisht☐ Pak☐ Nuk e di☐ Aspak☐

BIBLIOGRAFIA

1) Libra dhe artikuj shkencor

- Abazoviq, Mirsad. Muratbegoviq, Elmedin. Haliloviq, Haris. Budimliq, Muhamed. Beqiroviq, Edina "Politika e luftimit të kriminalittit". Sarajevë/Prishtinë, 2006
- Апостолова, Олгица. Студија за "Студија за оценување на сиромаштијата и мапирање на ранливите групи, со фокус на трговија со луѓе". Скопје, 2011
- Ачкоски, Југослав. "Сигурност на компјутерски системи, компјутерски криминал и компјутерски тероризам". Скопје, 2012
- Арнаудовски, Љ., Стојановски, Т. "Трговија со луѓе-криминалитет". Скопје, 2002
- Dutertre, Gilles. "Avrupa insan hakları mahkemesi kararlarından örnekleri", Strasbourg, 2003
- Dündar, Tuba. Özel, Elif. "Insan ticareti suçunu anlamak", Istanbul, 2017
- Dolu, Osman. "Suç Teorileri", Teori, Araştırma ve uygulamada Kriminoloji. Ankara, 2011
- Диксон, Мартин. Мекоркуоел, Роберт. "Случаи и материали од Меѓународно Право". Скопје, 2010
- Димитров, Никола. "Демографија". Битола, 2013
- Дончев, Александар. "Кризен Менаџмент". Скопје, 2007
- Erdoğan, Irfan. "Halkla ilişkiler". Ankara, 2008
- Филиповски, Зоран. "Меѓународни организации". Скопје, 2017
- Göksu, Turgut. Çevik, Hasan Hüseyin. Filiz, Orhan. Gül, Serdar Kenan. "Guvenlik Yonetimi". Ankara, 2011
- Güven, Sami. "Uluslararası işçi Göçünün sosyal politika sorunları". Bursa, 1996
- Grigg, Daniel.B. Ernest, Georg, Ravenstein. "laws of migration"; Journal of Historical Geography, No:3, Fq.41-54, 1977
- Gruda, Zejnullah . "E Drejta Ndërkombëtare Publike".Prishtinë, 2005
- Qendra Europiane "Guidë mbi të drejtën e azilit", Tiranë
- Halili, Ragip. "Kriminologjija". Prishtinë, 2011
- Halili, Ragip. "Penologjia" (E drejta e ekzekutimit te sanksionimi penale). Prishtinë, 2014
- Halili, Ragip. "Viktimologjia". Prishtinë, 2011
- Хекер, Бернд. "Европско Кривично Право". Скопје, 2010
- Islami, Hivzi. "Aspekti etnik i Migrimeve". Prishtinë, 2012
- Ignjatović, Đorđe. "Kriminologija". Beograd, 2011
- Içli, Tülin Günşen. "Kriminoloji". Ankara, 2016
- IOM, "E drejta migratore ndërkombëtare" Fjalorth i terminologjisë migratore, Tiranë, ISSN: 1995-7467, Nr.10, 1995
- J.Gordon, Nathan. L.Fleisher, William. Akademija za obuku iz naucnih metoda vodenja istrage. "Efikasne tehnike vođenja razgovora i ispitavanja". Sarajevo, 2002
- Jovanović, Slađana. Savić, Marijana. "Nacionalni mehanizam upućivanja žrtava trgovine ljudima u republici Serbiji". Beograd, 2008
- Jašarević, Osman. Kustura, Mensur. "Kriminologija", etiologija i fenomenologija kriminaliteta. Travnik, 2013
- Kval. Mellbye. Tranoy. "Politika dhe Demokracia". Prishtinë, 2006
- Kambovski, Vlado. Zejneli, Ismail "Edrejta penale pjesa e përgjithshme", Tetovë, 2018
- Kaygısız, Mustafa. "Olay yeri koruma ve Kriminalistik suc yeri ve delil guvenligi adli bilimler". Ankara, 2012

- Korajlić, Nedžad. Muharremi, Driton. “Heuristička Kriminalistika”. Travnik, 2011
- Korać, Hana. R.Ivanović, Aleksandar. Begović, Alisa. “Prevencija Kriminaliteta”. Beograd, 2010
- Latifi, Vesel. “Kriminalistika”. Prishtinë, 2004
- Latifi, Vesel. Elezi , Ismet. Hysi, Vasilika. “Politika e Luftimit të Kriminalitetit”. Prishtinë, 2012
- Masleša, Ramo. Bisić Munib. “Osnovni Sigurnosti”. Sarajevo, 2007
- Masleša, Ramo. “Policia dhe shoqëria”. Sarajevë/Prishtinë, 2008
- Mesić, Milan. “Međunarodne Migracije”, Tokovi i teorije. Zagreb, 2002
- Mlađenović-Kupčević, Rajka. “Kriminologija”. Sarajevo, 2001
- Мегваер, Мајк. Морган, Род. Рајнер, Роберт. “Оксфордски прирачник за Криминологија”. Скопје, 2010
- Öztürk, Bahri. Erdem, Özbek, Veli Özer, Mustafa Ruhan, Erdem.. “Uygulamali Ceza Hukuku ve Emniyet Tedbirleri Hukuku”. Ankara, 2003
- Öner, S.Gülfer-İlhamur. Öner, Aslı-Şirin. “Küreselleşme Çağında Göç”. Istanbul, 2016
- Petrović, Borislav. Jovasević, Dragan. Perhatović, Amila. “Krivično Pravo II ”, Saučesnistvo, krivične sankcije i posebni dio. Sarajevo, 2016
- Pačariz, Sabina. “The migrations of bosniaks to Turkey from 1945 to 1974”, The case od Sandžak. Sarajevo, 2016
- Petrović, Borislav. “Narkokriminal”, Krivičnopravni, kriminološki, krivičnoprocesni i kriminalistički aspekti. Sarajevo, 2004
- Petrović, Borislav. Meško, Gorazd. “Kriminologija”. Sarajevo, 2004
- Raufer, Xavier. Quere Stephane. “Pretnja Evropi-Albanska Mafija”. Beograd, 2005
- Repovac, Hidajet. “Krestomaci Sociologjike”. Prishtinë, 2005
- Salihu, Ismet. “E drejta Penale për të mitur” (Me ligjin penal për të mitur). Prishtinë, 2005
- Sahiti, Ejup. Murati, Rexhep. “E drejta e procedurës penale”. Prishtinë, 2013
- Sahiti, Ejup. Zejneli, Ismail. “E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë”. Tetovë, 2007
- Sözüer, Adem.”Türk Ceza Hukuku Mevzuatı”. Istabul, 2013
- Gërxhaliu, Selvete. “Trafikimi dhe prostitucioni i femrave”. Prishtinë, 2003
- Shegani, Altin. “E drejta penale krahasuar”. Tiranë, 2008
- Šejtanić, Esad. “Sigurnost i odbrana Bosne i Hercegovine u Evroatlantskom kontekstu”. Mostar, 2017
- Šeparović, Zvonimir. „Viktimologija, studije o žrtvama”. Zagreb, 1985
- Tutar, Hasan. “Kriz ve Stres yönetimi”. Ankara, 2004
- Ukaj, Bajram. “Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë”. Prishtinë, 2006
- Yurtcan, Erdener. “Göçmen kaçakçılığı ve insan ticareti”. Ankara, 2016
- Vula.G, Veton. “Kriminaliteti i organizuar”. Prishtinë, 2013
- Vula.G, Veton. “Kriminaliteti kompjuterik”. Prishtinë, 2009
- Zejneli, Ismail. “E drejta penale-pjesa e posaçme”. Tetovë, 2007
- Zejneli, Ismail. “Delikuenca e të miturve”. Tetovë/Prishtinë, 2018
- Zejneli, Ismail. Kambovski, Vllado dhe të tjerë “Kriminaliteti i Organizuar -Aspektet Juridike”. Tetovë, 2009
- Zejneli, Ismail& Netkova Bistra, Trafikimi me njerez, aspekte juridike, Tetove, 2007
- Xhukleski, Goce. Racaj Muhamet.”Hyrje në kriminalistikë”. Shkup, 2012

2) Akte ndërkombëtare, ligje të aplikueshme, rezoluta, regullore, strategji, analiza, raporte, udhëzues, dokumente dhe akte të tjera

2.1. Akte ndërkombëtare

- Konventa e Këshillit të Evropës, për "Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual", Seritë e Traktateve të Këshillit të Evropës - nr. 201, Lanzarote, 25. X. 2007
- Direktivë e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004, "Për lejen e qëndrimit të lëshuar shtetasve të vendeve të treta që janë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë objekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente", Gazeta Zyrtare L 261, 6.8.2004 F. 0019 – 0023
- Konventa e Kombeve të Bashkuara "Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar ", Palermo / Itali , 2000
- Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare. Palermo/Itali, 2000
- Protokolli mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve. Palermo/Itali, 2000
- Direktivë e Këshillit të Bashkimit Evropian, 2004/80/KE, datë 29 prill 2004, "Për kompensimin e viktimave të krimeve", Gazeta Zyrtare L 261, 6.8.2004 F. 0015 – 0018
- Rekomandime për politikat dhe legjislacionin drejt zbatimit efektiv të parimit të mosdënimit të viktimave të trafikimit, Tiranë, 2014
- Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore , Stasbourg/Francë, Greta, hyri në fuqi me 1 shkurt 2008
- Konventa Evropiane mbi kompensimin e viktimave të krimeve të dhunës, Strasburg 24.11.1983
- Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Varshavë, 16.5.2005 Seria e traktateve europiane ETS nr.197
- Konventa nr.29 në lidhje me abuzimin fizik (ILO),Aprovuar më 28 qershor nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në sesionin e saj të 14, Hyrja në fuqi - 1 Maj 1932
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve 44/25, 20 nëntor 1989, hyri në fuqi me 2 shtator 1990
- Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, 4.XI.1950
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979
- Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian, e cila është shpallur në Strasburg, më 12 dhjetor 2007 nga Parlamenti Europian, Këshilli dhe Komisioni (GZ C 303, 14.12.2007
- Statuti "Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale", miratuar në Romë më 17 korrik 1998.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, hyrja në fuqi: 23 mars 1976
- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 1998, Hyri në fuqi në 1 Korrik 2003

- Konventa për Migrimet në Kushte Abuzive dhe mbi Nxitjen e Barazisë së Mundësive dhe të Trajtimit të Punëtorëve Migrantë. C143, miratuar më 1975 Gjenevë, hyrja në fuqi 1978
- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese (CAT), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 39/46 të datës 10 dhjetor 1984, hyrja në fuqi: më 26 qershor 1987
- Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të punës (ILO) lidhur me parimet dhe të drejtat themelore në punë dhe ndjekja e saj, miratuar nga Konferenca nderkombetare e Punes ne sesionin e tetedhjete e gjashte, Gjeneve, 18 qershor 1998
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 10 dhjetor të vitit 1948
- Raporti i Projektit CARPO mbi gjendjen e Krimit të Organizuar dhe Krimit Ekonomik në Evropën Juglindore, Strasburg, gusht 2006
- Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, miratuar më 25.5.2000
- Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë, miratuar më 25.5.2000

2.2. Ligje të aplikueshme të shteteve konkret

- Кривичен законик (интегрален пречистен текст) https://www.pravdiko.mk/krivichen-zakonik/, бр.80/99, бр.4/02 бр.43/03, бр.19/04, бр.81/05, бр.60/06, бр.73/06, бр.7/08, бр.139/08, бр.114/09, бр.51/11, бр.135/11 , бр.185/11, бр.142/12, бр.166/12, бр.55/13, бр.82/13, бр.14/14, бр.27/14, бр.28/14, бр.115/14 и бр.132/14
- Закон за кривичната постапка, Службен весник на Република Македониј број.150 од 18.11.2010 година
- Закон за правда за децата, Службен весник на Република Македониј број.148 од 29.10.2013 година
- Закон за прекршоците, Службен весник на Република Македониј број. 124 од 23.07.2015 година
- Закон за спречување на перење пари и финансирање на тероризам, Службен весник на РМ, бр. 130 од 03.09.2014 година
- Закон за превенција, спречување и заштита од семејното насилство, Службен весник на РМ, бр. 138 од 17.09.2014 година
- Закон за заштита на сведоци, Службен весник на Република Македониј број 38/2005)
- Закон за вработување и работа на странци (Службен весник на Република Македониј број.217 од 11.12.2015 година)
- Закон за бесплатна правна помош („Службен весник на Република Македонија" бр.161/09 и 185/11)
- Закон за семејството (пречистен текст), (Службен весник на Република Македонија број.153 од 20.10.2014 година)
- Закон за работните односи (пречистен текст), 2017
- Закон за полиција (пречистен текст), 2015
- Закон за странци, Бр. 07-1144/1, 14 март 2006 година, Скопје
- Закон за азил и привремена заштита, (Пречистен текст), Службен весник на Република Македонија број.27 од 12.04.2013 година)

- Закон за спречување на корупцијата, (Пречистен текст), Бр. 10-4275/2 од 12 ноември 2004 година, Скопје
- Закон за основното образование, Службен весник на Република Македнија, број. 103 од 19.08.2008 година
- Законот за заштита на населението од заразни болести Службен Весник на Република Македонија, број 66 од 2004 година
- Закон за заштита на деца. (Консолидиран текст), 2018
- Закон за социјална заштита (пречистен текст), Службен весник на Република Македонија, бр. 148 од 29.10.2013 година
- Закон за управување со конфискуван имот, имотна корист и одземени предмети во кривична и прекршочна постапка. Службен весник на РМ, бр. 98, 2008
- Закон за гранична контрола. Службен весник на РМ, бр. 171, 2010
- Закон за инспекцијата на труд. Консолидиран текст, 2017
- Закон за здравствена заштита (пречистен текст), Сл. Весник на Р.Македонија бр. 38/91; У. суд - 73/92; 46/93 и 55/95 и пречистен текст - 17/97 од 10.04.1997 година
- Закон за еднакви можности на жените и мажите. Пречистен текст, 2015
- Закон за царинската управа, Службен весник на РМ, бр.46/2004
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Amandamentet e Kushtetutës I-XXX, Shkup, 2006
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008.
- Ustav Bosne i Hercegovine. Prečišćeni tekst, 1995
- Türkiye Cumhuriyeti Anayasası. Ligji Nr: 2709, 7.11.1982
- Ligji Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 34 / 4 shtator 2013, Prishtinë
- Ligji për të huajt, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.35 miratuar më 23.03.2006
- Ligji për menaxhim me kriza, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr.29/05
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2012, hyrja në fuqi me 01.01.2013.
- Kazneni Zakon, Republike Hrvatske, Narodne novine“ broj: 125/11 i 144/12 – Neslužbeni pročišćeni tekst
- Krivični Zakon Federacije Bosne i Hercegovine, Integralni tekst, ("Službene novine Federacije BiH", br. 36/2003, 21/2004 - ispr., 69/2004, 18/2005, 42/2010, 42/2011, 59/2014, 76/2014, 46/2016 i 75/2017)
- Krivični Zakon Bosne i Hercegovine Prečišćeni, nezvanični tekst (Službeni glasnik Bosne i Hercegovine” br. 3/03, 32/03, 37/03, 54/04, 61/04, 30/05, 53/06, 55/06, 32/07, 8/10, 47/14, 22/15, 40/15), 27.06.2003
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, gusht 2017
- Türk Ceza Kanunu Nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004 Sayı :25611
- Türk Ceza Kanunu Nr 5237 Yayımlandığı R.Gazete : Tarih : 12/10/2004, 06/12/2006 Sayı: 25611, 5560

2.3. Raporte, Rezoluta, Analiza, Strategji, Udhëzues, Studime dhe akte tjera

- Raport. “Migracioni i kthimit dhe ri-integrimi në Shqipëri 2013”. Tiranë, 2013
- Raport. “Migrimi dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë”. Banka botërore, 2011
- Raport. “Trafikimi i fëmijëve në Shqipëri”. Tiranë, 2003
- Raport. “Ndikimi social i emigracionit dhe migrimit rural-urban në Evropën Qendrore dhe Lindore”. Shkup, 2012
- Raport. “Mekanizmat kundër dhunës dhe trafikimit”. Tiranë, 2015
- Raport. “Përputhshmëria e Kosovës me standardet e Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.Greta, 2016
- Raport. “Migrimi kosovar”.Prishtinë, 2014
- Raport. “Largimi drejt shteteve anëtare të BE-së-shkaqet dhe pasojat e migrimit të fundit nga Kosova”. Prishtinë, 2015
- Raport. “Zbatimi i strategjisë së luftës kundër trafikimit të personave dhe planit të veprimit 2014-2017”. Tiranë, 2016
- Studim. “Vlerësim i riskut të Krimit të organizuar në Shqipëri,”. Fabian Zhilla, Besfort Lamallari, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Tiranë, 2015
- Тодоровски, Киро. Годишен Извештај. “Борба против трговијата со луѓе и илегална миграција во Република Македонија за 2013 година”. Скопје, 2014
- Скриванкова, Клара. Јовевски, Лазар. Извештај. “Трговија со луѓе со цел трудова експлоатација”. Совет на Европа, 2017
- Извештај. “Унапредување и заштита на сите човекови права, граѓански, политички, економски, социјални и културни права, вклучувајќи го и правото на развој”. Совет за Човекови права, 2008
- Извештај. “Трговија со луѓе во Западен Балкан”. IOM-Geneva, 2014
- Годишен Извештај. “Превенција и заштита од трговија со луѓе”. Министерство за труд и социјална политика, Скопје, 2015
- Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Гевгелија, Октомври 2017-Февруари 2018 година
- Прв Квартален Мониторинг Извештај за политиките и услугите за мигрантите на територија на Општина Бутел и Општина Шуто Оризари, Октомври 2017-Февруари 2018 година
- Извештај. “Борба против трговија со луѓе”, Преглед на политиките на Република Македонија, Скопје, 2009
- Извештај на Министерството за труд на САД за 2015 година за најлошите облици на детски труд, Македонија, 2015
- Резолуција. “Миграционата политика на Република Македонија 2009-2014”. Скопје, 2008
- Резолуција. “Миграционата политика на Република Македонија 2015-2020”. Скопје, 2015
- Стандардни оперативни процедури за постапување со непридружувани деца-странци. Скопје, 2015
- Национална Стратегија. “Интегрирано гранично управување”. Скопје, 2003
- Национална Стратегија. “Развој на воспоставениот систем за интегрирано гранично управување”. Скопје, 2009

- Стратегија . “Демографски развој на Република Македонија 2008-2015”. Скопје, 2008
- Стратегија. “Развој на полицијата 2016-2020”. Скопј
- Strategjia shtetërore. “Migrimi dhe plani i veprimit 2013-2018”. Prishtinë, 2013
- Strategjia. “Lufta kundër trafikimit me njerëz dhe migrimit ilegal në Republikën e Maqedonisë”. Shkup, 2006
- Strategjia kombëtare. “Migracioni dhe plani i veprimit për migracionin”. Tiranë, 2005
- Strategjia. “Lufta kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014-2017”. Tiranë, 2016
- Студија. “Ефектите на мигрантската криза во земјите од југоисточна Европа”. Скопје, 2016
- Пројект-Информација. “Мониторинг на судски предмети од областа на трговија со луѓе и илегалната миграција во Македонија 2010”. Скопје, 2011
- Информација. “Правните аспекти и практичните искуства во казненото гонење на сторителите на кривични дела на трговија со луѓе и криумчарење мигранти за периодот 2005-2008 година”. Скопје, 2009
- Informacion. “Nxitja e migracionit të rregullt dhe parandalimi i trafikimit në njerëz në Shqipëri”. Tiranë, 2006
- Informacion. “Tregtia me njerëz dhe migrimi ilegal në Maqedoni në vitin 2009”. Shkup, 2010
- Udhëzues për bashkpunim ndërkombëtar. “Trafikimi i qenieve njerëzore-kalimi kontrabandë i migruesve”. UNODC, Beograd, 2010
- Udhëzues Rajonal për identifikimin e personave të trafikuar, Manual për Europën Juglindore dhe Lindore, 2012
- Rosas, Gianni. Rossignotti, Giovanna. Udhëzues. “Përgaditja e planit kombëtar të aksionit për punësimin e të rinjve”, Zyra Ndërkombëtare e Punës, Gjenevë, 2008
- Udhërrefyes. “Referimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit ne Europë”.Tiranë, 2007
- Национална програма за борба против трговијата со луѓе и илегалната миграција во Република Македонија, („Службен Весник на Република Македонија„) бр.10, 2002 година.
- Analizë. “Të kuptojmë migrimin shqiptar në Gjermani gjatë periudhës 2014-2016”. Tiranë, 2016
- Analizë. ”Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në rajonin e OSBE”, Tiranë, 2008
- Analizë. “Lufta kundër trafikimit me njerëz”, Kërkesat e BE-së për Kosovën, Kipred, Prishtinë, Nr.2/15, 2015
- Анализа. “Меѓународните стандарди и најдобри практики и на постоечките национални закони, политики и планови на антидискриминаторската легислатива”. Скопје, 2010
- Анализа. “Невработеноста на младите луѓе во Република Македонија”. Скопје, 2016
- Анализа. “Усогласеноста на одредбите од Законот за превенција, спречување и заштита од семејно насилство со стандардите содржани во Конвенцијата на Совет на Европа за спречување и борба врз жените и домашно насилство (Истанбулска Конвенција)”. Скопје, 2013

- Анализа. “Обесштетувањето на жртвите на трговија со луѓе во Република Македонија”. Скопје, 2014
- Анализа. “Примената на начелото на неказнување на трговија со луѓе во Република Македонија”. Скопје, 2014
- Анализа. “Националните политики и практики за справување со илегалната миграција и бателте на азил”. Лембовска, Магдалена, Скопје, 2013
- Анализа. “Правата на бегалците: национални и меѓународни стандарди наспроти состојбата на терен”. Скопје, 2017
- Анализа. “Достапноста и пристапот до безплатна правна помош за лицата барателиа на азил во Република Македонија”. Скопје, 2016
- OSCE. Прирачник за новинари. “Трговија со луѓе и медиумите”, Скопје, 2010
- Priručnik za novinare “Trgovina ljudima”. Beograd, 2008
- Збирка “Ризични фактори кај Ромската популација по однос на феноменот трговија со луѓе”, Здружение за еманципација, солидарност и еднаквост на жените РМ, 2006
- Влада на Република Македонија, Национална Комисија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција “Стандардни оперативни процедури за постапување со жртви на трговија со луѓе”, Скопје, 2010
- Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија. “Програма за помош и подршка при реинтеграција на жртви на трговија со луѓе”. Скопје, 2014
- Упатства за рехабилитација и реинтеграција на жртви од трговија со луѓе - Прирачник за земјите од Западен Балкан, Скопје 2015
- Правилник (Прирачник). “Регионални упатства за идентификација на жртвите на трговија со луѓе”, за Југоисточна и Источна Европа, Татјана Фомина, Интернационален центар „Ла Страда“- Молдавија и Мариа Вогиаци, Центар за заштита на човековите права – Грција, 2012
- OSCE-ODIHR. Практичен прирачник “Национални механизми за упатување, здружување на напорите на заштита на правата на лицата кои се предмет на трговија”. Poland, Warsaw, 2004
- IOM. “Прирачник Директна помош на жртвите на трговија со луѓе”, Скопје
- Прирачник. “Трговија со луѓе”, Црвен Крст на Република Македонија, Скопје, 2016
- Doracak “Zbulimi i hershëm të rasteve të tregtisë me qenie njerëzore për inspektorët e punës”, Shkup, 2010
- Rehberlik. “İnsan Ticareti suçunu anlamak”. İngiltere Buyukelçiliği Ankara, 2017
- Влада на Република Македонија “Национална стратегија за борба против трговија со луѓе и илегална миграција во Република Македонија 2013-2016”, Скопје, 2012
- Информативна Брошура за жени-жртви на семејно насилство “ Можности за економско зајакнување на жените-жртви на семејно насилство”. Министерство за труд и социјална политика на Република Македонија, Скопје, 2010
- Međunarodna organizacija za migracije i Ministerstvo prosvete i sporta Republike Serbije, Priručnik za nastavnike. “Prevencija trgovine ljudima”. Beograd, 2006
- OSCE. “Trgovina ljudima u svrhu radne eksploatacije”, referentni materijal s osvrtom na Bosnu i Hercegovinu. Sarajevo, 2011
- Gazeta policore “IPUCU”, 2012. ISSN: 1303-7854. Ankara, 2012
- Analizë nga Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Maqedoni “Integrimi i refugjatëve dhe personave pa nënshtetësi ne Maqedoni”

- Одлука за постоење на кризна состојба заради зголемен обем на влез и транзитирање на мигранти низ територијата на Република Македнија Бр.110/1, 19.08.2015, (Службен Весник на Република Македонија бр.141) Скопје
- Коментари на Македонско здружение на млади правници (МЗМП) на Предлог Законот за странци од април 2018, Скопје
- Истражување "Како да не сме луѓе" на Полициска бруталност врз мигрантите и барателите на азил во Македонија, 2015
- Резиме на предизвиците во справувањето со трговија со луѓе заради трудова експлоатација вп земјоделскиот сектор во регионот на ОБСЕ, Виена, 2009

3) Disertacione të doktoraturës

- Prifti, Aleks. Disertacion i doktoratuës "Trafikimi i personave, dimensioni human dhe karakteri ligjor i luftës ndaj tij". Tiranë, 2015
- Podvorica, Armend. Disertacion i doktoraturës "Trafikimi i qenieve njerzor si formë e krimit të organozuar me theks të veçantë në kosovë për periudhën 2000-2013". Tiranë, 2015
- Grazhdani, Teuta. Disertacion i doktoraturës "Shërbimet e riintegrimit për emigrantët shqiptar që kthehen: mes sfidave të parandalimit të emigracionit dhe forcimit të institucioneve". Tiranë, 2015
- Avdiu, Avni. Disertacion i doktoraturës "Ndikimi dhe roli i medieve të Kosovës në globalizim dhe anasjelltas-globalizimit në medie, prej vitit 1990 deri më 2010". Tiranë, 2017
- Kraja, Blerta. Disertacion i doktoraturës "E drejta migratore dhe e azilit", Tiranë, 2012
- Çiraku, Erarba. Disertacion i doktoraturës "Emigracioni i shqiptarëve në Itali në vitet '90-të. Sfidat dhe problematikat që ai përcjell". Tiranë, 2015
- Ajazi, Kristina. Disertacion i doktoraturës "Sfidat e përkthimit në epokën e globalizmit. Globalizmi dhe ndikimi i tij në përkthimologji parë në qasjen e teksteve publicitare në anglisht dhe shqip". Tiranë, 2012
- Zenelaga, Brunilda. Disertacion i doktoraturës "Familja emigrante përballë sfidave të integrimit. Rasti i emgrantëve shqiptarë në rajonin e Toskanës, Itali". Tiranë, 2013
- Osmani, Fadil. Disertacion i doktoraturës "Integrimi në BE-Sfidë e Kosovës". Tiranë, 2016
- Likaj, Matilda. Disertacion i doktoraturës "Emigrimi dhe itegrimi social i emigrantëve shqiptarë pas viteve 1990". Tiranë, 2015
- Kopliku, Bresena. Disertacion i doktoraturës "Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës". Tiranë, 2013
- Imeraj, Elizabeta. Disertacion i doktoraturës "Aspektet teorike dhe praktike për studimin e trafikimit të qenieve njerëzor". Tiranë, 2011
- Sayın, Hüdayi. Disertacion i doktoraturës "Uluslararası hukuk ve türk hukuku bakımından göçmen kaçakçılığı insan tıcareti cinsel sömürü suçları ve bunlara mücadelede uluslararası işbirliği". Istanbul, 2010
- Sever, Muhammed. Disertacion i doktoraturës "Türkiye'yi hedef alan yasadışı göçmenler: İstanbul örneği ", Ankara. 2015
- Eker, Kemal. Disertacion i doktoraturës"Türkiye'de yasa dışı göç sorunu". İzmir, 2008

- Özyakışır, Deniz. Disertacion i doktoraturës ”İç göç hareketleri ve geriye (tersine) göçün belirleyicileri:TRA 2 bölgesinden (Ağrı, Kars, İğdir, Ardahan) İstanbul’a gerçekleşen göç üzerine bir saha araştırması ”. Erzurum, 2012
- Bolat, Gürbüz Akhan. Disertacion i doktoraturës “ Berdel töresi ve insan ticareti“. Ankara, 2013
- Burić, Željka. Disertacion i doktoraturës “Pravni i institucionalni okvir za suzbivanje trgovanja ljudima u Republici Hrvatskoj”. Zagreb, 2011

4) Jurispudencë-Vendime-Aktgjykime gjyqësore

- Aktgjykim Nr.51 të datës 14.08.2008 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.42 të datës 06.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.13 të datës 27.02.2015 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.57 të datës 27.05.2015 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.89 të datës 27.09.2016 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.145 të datës 16.09.2010 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.171 të datës 20.10.2010 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.2011 të datës 21.12.2011 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.193 të datës 16.11.2010 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.76 të datës 27.02.2012 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.59 të datës 03.02.20104 të Gjykatës Themelore Shkupi I Shkup
- Aktgjykim Nr.70 të datës 13.12.2012 të Gjykatës së Apelit Shkup
- Aktgjykim Nr.18 të datës 25.04.2013 të Gjykatës së Apelit Shkup
- Aktgjykim Nr.113 të datës 24.02.2016 të Gjykatës Themelore Shkup I Shkup
- Решение бр.24 датум 24.01.2012 од Кривичниот Совет при Основниот Суд Скопје 1 Скопје
- Решение бр.10 датум 29.07.2013 од Кривичниот Совет на Одделението за Организиран Криминал и Корупција при Основниот Суд Скопје 1 Скопје

5) Burime nga webfaqe dhe internet

- https://www.pravdiko.mk/
- http://www.unhcr.org/
- http://www.un.org/
- http://www.undp.org/
- https://www.unicef.org/
- https://www.osce.org/
- https://www.ohchr.org/
- https://www.europol.europa.eu/
- https://www.interpol.int/
- https://www.hrw.org/
- http://ask.rks-gov.net/
- https://mpb.rks-gov.net/
- http://www.instat.gov.al/
- http://mb.gov.al/
- http://www.msb.gov.ba

- http://www.goc.gov.tr/
- http://www.turkey.iom.int/tr/
- https://www.icisleri.gov.tr/
- http://www.stat.gov.mk/
- http://makstat.stat.gov.mk/
- http://www.mvr.gov.mk/
- www.doe.iom.int/docs/Flows%20Compilation%202015%20Overview.pdf
- www.aa.com.tr/sq/
- http://esa.un.org/
- http://nacionalnakomisija.gov.mk
- https://migrationdataportal.org/

6) Intervistë me:

- B.R. Shef i Njësisë për Hetimin e Krimit Kompjuterik në Sektorin e Krimit Kompjuterik dhe forenzika digjitale, Byroja e Sigurisë Publike, Ministria e Punëve të Brendshme të RMV
- Z.L. Nëpunës shtetëror në Qendrën për Menaxhim me Kriza, në njësinë rajonale në Gjevgjeli, përgjegjës në kampin për migrantë Vinojug.